

Thomas W. Arnold
HISTORIA E PËRHAPJES SË
ISLAMIT
Rrjedhat historike të misionit

Përktheu: **Nexhat S. Ibrahimi**

Titulli i origjinalit:

The Preaching of Islam -

A history of the Propagandion, of the Muslim Faith, by T.W. Arnold

M.A. C.J.E

London, Constable & Company Ltd.

1913

Titulli në boshnjakishte:

Povijest islama - historijski tokovi misije,

El-Kalem - Izd, djelatnost, III izd., Sarajevo 1990.

Përkushtim

Të gjithë atyre që fjalën, veprën dhe sjelljen vetjake ndihmuan në paraqitjen e drejtë të dini islamit!

PARATHËNIA BOTIMI TË PARË

Këto faqe po i botoj majft i dekurajuar. Temën që e përpunojnë është majft e vëllimshme. Gjatë shkrimit të këtij punimi jam gjetur në kushte të disfavorshme dhe shpresoj në sukses të kufizuar. Pasi që më mirë jam përgatitur për punë, studimet e mëtejme më kanë mundësuar që t'i përmbushi zbratësitet¹ të krijuara në këtë punim. Dëshiroj ta bëjë kontribut të vlefshëm një pjese të lënë pas dore të historisë islame. Për këtë do t'i jam thellë mirënjohës kritikës dhe korrekcioneve të çdo hulumtuesi që dinjitetet ta vërejë këtë libër. Të tillëve dëshiroj t'u drejtohe me fjalët e Shën Augustinit:

"Kush e lexon këtë e thotë: - Të thënë pa dyshim e kam kuptuar - e në këtë nuk ka të vërtetë, ai në realitet shpreh mendimin e vet personal dhe i kundërvihet timit.

Mirëpo, nëse ai këtë e bënë nga dashuria dhe përkushtimi dhe synon që këtë çështje tek unë ta bëjë më të qartë (nëse Zoti më le të jetojë) unë atëherë me këtë punën time do të mundësoj shumë të mira."²

1

Pasi nuk gëzoj kurrfarë të drejte të autoritetit dhe të specialistit për çfarëdo periode me çka merret ky libër dhe pasi shumë ndodhi në të cilat

kam dëftuar në të janë objekt i mospajtimit të hulumtuesve, kam dhënë regjistrin e burimeve të konsultuara.

Kam menduar se më mirë është që gabimin ta kam në tepricë se sa në mëngësi. Jam përpjekur shumë dhe kam humbur aq kohë në dëftimin në vepra të cilat kanë dëftuar ndonjë paqartësi apo pakuptueshmëri. Kam dëshiruar t'i ruaj të tjerët nga mundimet e ngjashme.

Deri sa lexuesit të rëndomtë i dukem së tepërmi cikrrimtar, mbase me këtë e shpëtoj ndonjë hulumtues që dëshiron ta provojë saktësinë e ndonjë teksti ose ta ndjek çfarëdo pjese të punimit më tej.

Mënyra e transkriptimit të fjalëve arabe në këtë libër është aplikuar sipas transkriptimit të aprovuar nga Komiteti për transkripcion i Kongresit të X ndërkombëtar të orientalistëve të mbajtur në Gjenevë më 1894. Përjashtim nga kjo është shkronja e fundit te nyja shquese që asimilohet te të ashtuquajturat shkronjat diellore.

Në rastin e nocioneve gjeografike kjo metodë e shkrimit nuk është aplikuar strikt. Ngjashëm është edhe në rastet e shumta të tjera ku nuk kam mundur ta zbulojë formën origjinale arabe të fjalës (për shembull Mekka, Medina), sepse gjatë përdorimit, me kalimin e kohës, është krijuar emërtim i rëndomtë.

Kjo vepër është pakontestueshëm, siç është shpjeguar kjo në Hyrje, regjistër i përpjekjeve misionariste, e jo histori e persekutimeve.³ Kam tentuar të jam përpikshëmrisht objektiv duke e mbështetur idealin që e ka vënë historiani i krishterë,⁴ i cili i ka shënuar fitoret osmane dhe ramjen e Stambollit duke thënë: "Është e domosdoshme që historiani ta shkruaj historinë jo me dëshirë që bota t'i jep mirënjohje. Nuk guxon të motivohet me urrejtje dhe smirë, apo me averzion dhe kënaqjen e ndjenjave. Duhet shkruar për shkak të vetë historisë në mënyrë që faqet mos të i mbulojnë në botën e harresës, kurse koha e di se si do t'i përhapë".

Dua t'i falënderoj Eks. së Saj princshës BARberinës dhe Eks. së Tij princit Çigi, të respektuarit dr Paul Goctalsit, arqipeshkvit të Kalkutës, të nderuarit Francis Pescit, peshkopit të Allahabadit dhe të respektuarit S.S. Allmutit, anëtarit të misionit të Kembrixhit në Delhi.

I jam mirënjohës drejtorëve të bibliotekës së Wilijamsit në Gordon skuer në Londër, sepse lirisht mi kanë lënë në dispozicion bibliotekat e veta të çmueshme.

Veçanërisht e falënderoj Xhems Kenedin (James Kennedy) ish nëpunësit të Sektorit të drejtimit civil në Bengal (Bengal Civil Service), i cili kurrë nuk ka kursyer angazhimin dhe interesimin për librin tim. Ky është shembull permanent i provuar i rregullit të Horacit: Nonum prematur in annum.

2

Jam borxhli i dijes së tij të vëllimshme dhe arsimimit të gjërë për shumë informata të cilat mua, sikur mos të ishte ai, do të më mbeteshin të panjohura.

Hiç më pak nuk i kam barxh entuziazmit të tij, dashurisë ndaj hulumtimit dhe ndiesisë dhe ndihmesës shërbyese.

Veçan i falnderohem mirësisë së kontit Ugo Balzanit, sepse, sikur mos të ishte ndihma e tij, disa pjesë të këtij libri do të ishin të pasendertueshëm. Mirënjohës i jam edhe profesor Robertson Smithit në sugjestionet e tij të vlefshme në ato elemente të studimit ku ishte i domosdoshëm të zë fill historia e kishës afrikane-veriore dhe pozita e të krishterëve nën sundimin muslimanë. Dhembje e thellë, që e ndiejnë të gjithë hulumtuesit e studimeve semite me humbjen e tij, dyfishohet tek unë. Jam i bindur se kjo është mirënjohja e vetme me të cilën mundem adekuat t'ia shprehi falënderimin tim në ndihmesën dhe mbështetjen e tij të madhe.

Dëshiroj, po ashtu, t'ia pranoj mirënjohjen time Sejjid Ahmedkan Bahadurit (K.C.S.I. LL.D.), sikur edhe kolegu tim dhe shokut Shemsu-lulema Mevlevi Muhammed Shibli Nu'manit, i cili më ka ndihmuar shumë me njohjen e vet të vëllimshme të historisë së hershme islame.

I jam mirënjohës edhe ish nxënësit tim Mevlevi Bahadur Aliut (M.A.). Në fund, mbi të gjitha, duhet t'i falënderohem bashkëshortes time të dashur; sikur mos të ishte ajo, kjo vepër nuk do të paraqitej nga kaosi i materialit të copëtuar. Mirëkuptimi dhe miratimi i saj janë dhurata më e bukur për punimet e mia.

Aligarh, 1896 (Alikra-Indi, vër. e përk.)

1) Për shembull: "Përhapja e islamit në Sicili dhe puna misionarise e evlijave të shumtë muslimanë (njerëzve të mirë).

2) De Trinitote, I, 5 (Migne, vëll. XIII, fq. 822).

3) Prandaj, lexuesi nuk do të mund të gjejë kurrfarë lajmi për historinë e Armenisë ose Kritit, as çfarëdo pjese të historisë së imperatorisë osmane gjatë këtij shekulli (jundi i shek. XIX). Kjo është përndryshe perioda që është unike sipas zbrastësirës në ndërmarrjen misionariste nga ana turke.

4) Phrantzes, fq. 5.

PARATHËNIA BOTIMIT TË DYTË

Pasi botimi i parë i këtij libri nuk ka mbetur, tashmë disa vjetë, kurse është rritë kërkesa për të, është përgatitur ky botimi i ri. Është bërë angazhim në shikimin e sërishëm të veprës në dritën e materialit të ri të tubuar gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të kaluara. Por uk mund të pohoj se plotësisht jam njoftuar me tërë literaturën e lëndës, që është shkruar në dhjetë gjuhë të ndryshme dhe është shpallur gjatë kësaj periode.

3

Forcimi i interesimit për islamin dhe degët e ndryshme të stadiimit në lidhje me të mund të vlerësohet nga fakti se nga viti 1906 janë paraqitur pesë revista që i janë dedikuar hulumtimit të temës të afërt me këtë punim.

Këto revista janë:

- Revue du Monde Musulman (Revista Bota muslimane), e boton: La Mission Scientifique du Maroc (Misioni shkencor i Marokos), Paris, nga 1906.

- Der Islam (Islami), Leitschrift fur Geschichte und Kultur des islamischen Orients (Revistë për historinë dhe kulturën e Orientit islam),

Strassburg, nga 1910. The Moslem World (Bota muslimane), a qarterly review of current events, literature, and thought among Mohommedans, and the progress of Christian Misions in Moslem lands (Revistë tremujore për ndodhitë bashkëkohore, letërsi dhe mesidim te muslimanët, dhe përparimi i misioneve të krishtera në vendet muslimane), London, nga 1911.

- Mir Islama St. Petersburg, nga 1912.

- Die Welt des Islams (Bota e islamit), Zeitschrift der deutschen Gesellschaft fur Islamkunde (Revistë i Shoqatës gjermane për artin islam), Berlin, nga 1913.

Shoqëritë misionare të krishtere po ashtu i përkushtojnë tash kujdes më të madh lëndës së aktivitetit misionit muslimanë. Proporcionalisht kësaj ajo zenë edhe më shumë hapësirë në publikimet e këtyre shoqërive, më shumë se më herët.

Ka mundur ky botimi i dytë të jetë gati qysh para disa vitesh sikur mos të jetë politika e lirë sipas së cilës alla e leximit e Museumit britanik mbyllet në ora shtatë në mbrëmje, që mua praktikisht më ka pamundësuar leximin përveç të shtunën.¹

Për këtë shkak u shpreh falenderimin e thellë atyre miqëve që ma lehtësuan punën me huazimin e librave nga Biblioteka Universitare në Leiden dhe Biblioteka e Universitetit në Utrahte (me mirësinë e profesor Wensinkut), pastaj nga Biblioteka Ecole des Langues Orientales Vivantes (shkolla e gjuhëve të gjalla orientale) në Paris.

Jam borxhli edhe i zotëri J.A. Oldhamit, redaktorit të The International Review of Missions (Revista ndërkombëtare e misioneve) për vjetorët e huazuar të "Allgemeine Mission - Zeitschrift" (Revista gjermane misionariste), të cilat nuk kam mundur t'i gjejë në Londër.

Veçan dëshiroj t'i falënderohem dr. F.W. Thomasit i cili gjatë kohë më ka lejuar hulumtimin (tok me librat tjera nga Biblioteka shtetërore e Indisë) e veprës monumentale "Anasali dell Islam" (Kronika e Islamit) nga Leone Caetani, Principe de Teano. Kjo është vepër me vlerë të pavlerësueshme për historinë e hershme të islamit. Fatkeqësisht, për shkak të çmimit të vet të lartë është e pakapshme për hulumtuesin e rëndomtë.

4

Shumë i kam borxh edhe disa vërejtjeve të çmueshme nga ana e atyre shkencëtarëve, të cilët kanë hedhë shikimin në veprën time kur është botuar herën e parë. Mbi të gjithë i falënderohe profesor Goldziherit interesimi i ndijshëm i të cilit për këtë punë më ka kurajuar që të vazhdojë në të. Londër, 1913

1) Studenti i literaturës shkencore ose artit të bukur i gjenë bibliotekat e Kensingtonit Jugor të hapura deri në ora dhjetë natën, tri ditë në javë. Por, e vetmja bibliotekë në vend, që synon kah kompletshmëria, është në shërbim vetëm për studentët të cilët janë të lirë në kohën e punës së bibliotekës.

PARATHËNIA BOTIMIT NË BOSHNJAKISHT

Kur më 1974 u publikua në Njujork reprinti i i veprës së T.W. Arnoldit

“Historia e përhapjes së islamit”,¹ qenë ky motiv i mirë për idenë që të vazhdojë e përfundojë përkthimi i kësaj vepre në gjuhën boshnjakishte. Me fjalë tjera, para plotë gjysmë shekulli rahmetli D.A. Korkuti e filloi përkthimin e këtij studimi interesant nga gjuha turke² në gjuhën tonë (boshnjake, vër. e N.I.).

Në vazhdime janë botuar gjashtë kaptina (nga 13 sa ekzistojnë) të këtij libri në “Glasnik” të Kryesisë supreme islame të Bashkësisë islame në Jugosllavi në kohën prej vitit 1933 deri 1935.³

Aktualiteti i këtij studimi të Arnoldit, sipas tematikës së vet, nuk ka pushuar as sot, ndonëse prej botimit të tij të parë në Aligarh (India), viti 18964 kanë kaluar nëntë dekada.

Arsye për këtë ka më shumë:

1. Ka të bëjë me veprën që përpunon procesin e përhapjes së njëres prej religjioneve më të reja botërore, domethënia fetaro-filozofike, shoqëroropolitike e kulturore e së cilës është e pranishme plotë katërmbëdhjetë shekuj në gati të gjitha meridianet e botës.

Janë të numërta veprat e autorëve muslimanë e jomuslimanë të cilat, në njëqindvjetëshin e fundit, kanë përfshirë aspektin shoqëroro-politik, ekonomik dhe kulturo-filozofik të islamit, sukseset ose mossukseset e bartësve të tij muslimanëve. Si faktor i përhapjes dhe i ekzistimit të islamit në botë, ana fetare e aktivitetit të muslimanëve pothuaj se është mospërfillur. Thomas Arnoldi pikërisht kësaj pune dhe përpjekje të muslimanëve i përkushton kujdesin e plotë.

2. Autori i veprës T.W. Arnoldi (1864-1930) është orientalist dhe hulumtues i pranuar. Ka qenë profesor në Universitetin islam në Aligarh/Indi (1888-1989), pastaj profesor i filozofiçë në universitetin e Londrës (1898-1904). Është profesori i parë i gjuhës arabe në Shkollën për gjuhët orientale

5 në Londër (1904-1930), kurse ka qenë edhe dekon i saj në kohën prej vitit 1921 deri më 1930.

Është shquar me precizitetin e vet shkencor dhe me ekspozimin objektiv të gjërave. Jeta dhe puna ndër muslimanët i kanë ndihmuar që ta njoftojë islamit jo vetëm nga ana e tij e jashtme, por edhe e brendshme, e kjo është ajo si e përjetojnë vetë muslimanët. Kjo i ka ndihmuar që të hyjë në fshehtësinë e zjarrit fetar të muslimanëve.

T. Arnoldi ka qenë koleg, mik dhe profesor i një varg mendimtarësh dhe shkencëtarësh islamë, siç janë Indusët Muhammed Shibli Nu'mani e dr. Muhammed Ikbali, historiani egjiptian dr. Hasan I. Hasani⁵ e të tjerët.

Njëkohësisht është bashkëpunëtor edhe i orientalistëve të njohur evropianë A. Guillamit, I. Goldziherit, A.R. Nikolsonit e shumë të tjerëve.

Vlerat e tij shkencore i cekin edhe orientalistët tonë sikur dr. Fehim Bajraktareviqi. Në paraqitjen e veprës “Legata e islami” (Legacy of islam) në përmbajtjen e së cilës merr pjesë edhe Ser T.W. Arnoldi, dr. F.

Bajraktareviqi shtronë se Arnoldi ka qëndruar në Bosnie, para luftës së dytë botërore. Me këtë rast ka grumbulluar material të caktuar për kulturë islame

në te, por vdekja e ka penguar që ta botojë.⁶

Arnoldi përveç këaj vepre është autor edhe i shumë punimeve tjera nga fusha e kulturës islame, artit dhe përgjithësisht krijimit shpirtëror e material të muslimanëve.⁷ Ndër to veçan shquhen:

- Caliphate / Teza për hilafetin,
- The Islamic Faith / Besimi islam, dhe
- Painting in Islam / Piktura në islam.

Sipas mendimit të R.A. Nikolsonit, secila nga këto vepra është e veçantë në domenin e vet.⁸ T.W. Arnoldi ka qenë një prej redaktorëve, të disa pjesëve, të botimit të parë të "Enciklopedisë islame" (1910-1911)⁹ në gjuhën angleze.

Përveç shkencëtarëve evropianë notën e lartë të objektivitetit të veprës, që është paranesh, e kanë dhënë edhe disa mendimtarë bashkëkohorë muslimanë si Sejjid Husein Nasri. Për të, kjo është "edhe më tutje punimi më i rëndësishëm nga historia e përhapjes së islamit ë botë"¹⁰

Kjo vepër është përkthyer në shumë gjuhë orientale: urdu, turke, persiane, e në arabishte ka përjetuar disa botime, çka qartë dëfton në konsiderimin / miratimin e saj edhe në midisin musliman.

Konsiderojmë se edhe ky përkthim boshnjakisht i veprës së Arnoldit do të jetë me dobi për ata që merren me islamin, e veçanërisht me fenomenin e përhapjes së tij.

Përveç pasqyrës së përgjithshme të historisë së përhapjes së islamit në botë, Arnoldi na jep prerjen e ardhjes përhapjes dhe veprimit të tij edhe në hapësirat jugosllave¹¹ sikur edhe në hapësirat e fqinjve tanë në Ballkan, që ka qenë me interes të veçantë për përkthimin e këtij libri.

6

Në parathënie të librit autori dëfton në vëllimshmërinë e temës, sepse islami gjatë trembëdhjetë shekujve të kaluar është gjetur në hapësirë të madhe prej Atlantikut deri në Kinë dhe prej arkipelagut Malajas dhe Zanzibarit deri në Ballkan.

Mungesa e burimeve të drejtpërdrejta që flasin për mënyrën, motivat dhe numrin e kalimeve në islam e ka shtyrë hulumtuesin që të shqyrtojë numër shumë të madh burimesh dhe literaturash në mënyrë që në mënyrë indirekte së paku të mësojë diç më shumë për fenomenin e përhapjes së kësaj feje. Duke iu shmangur që punimi t'i bëhet kronologji e ndodhive shoqëroropolitike te popujt muslimanë, me ngulmë ka gjurmuar për "zjarrin dhe përpjekjet misionariste" të pastra të muslimanëve në përhapjen e fesë së vet. E vërteta, Arnoldi në hulumtimet e fenomenit të përhapjes së islamit në botë nuk e mospërfill në këtë proces faktorin politik, shoqëror dhe ekonomik, por gjithkund përpiqet t'ua jep atë masë që u përket. Ndikimi i tyre nuk është i barabartë në të gjitha kohët dhe hapësirat ku është gjetur islam.

Hulumtimet e kanë sjellë deri te përfundimi se ekziston:

- a. angazhimi privat apo vetënismëtar dhe
- b. angazhimi i institucionalizuar në përhapjen e islamit.

Derisa i pari është manifestuar në angazhimin vetjak dhe ndijesinë e

përgjegjësisë, dhe në dëshirën që kënaqësia e bindjes vetjake të ndahet me dikë, deri sa në rastin e dytë ka të bëjë me kujdesin shoqëror që me anë të institucioneve fetaro-arsimore, shoqërore, humanitare, e diku edhe shtetërore të sigurohet kontinuiteti në mësimin e mësimin fetar të islamit. Kjo edhe ka dhënë shkasë që shumë hulumtues të përhapjes së islamit këtë fenomen më së shpeshti e lidhin për suksesin apo mosesuksin politik të atyre të cilët ideologjinë e vet shtetërore e kanë identifikuar me islam.

Konkurentët dhe rivalet e mësimin islam për këtë edhe kanë parë humbjen vetjake në rritjen e numrit të muslimanëve, duke e cekur detyrimin dhe dobiet materiale si mjet të vetëm në islamizimin e popullësisë.

Arnoldi është përpjekur t'i shkoqisë këto nocione dhe të dëftojë në superficialitetin dhe joargumentimin e pohimeve të këtilla, kur është në pyetje shumica e rasteve të kalimit në islam. Ai nuk e përjashton mundësinë e rasteve të kthimit të detyrueshëm, por rastet e tilla kanë motivacinin e vet politik ose tjetër, e jo islam ose fetar, sepse në Kur'an shprehimisht ndalohet përdorimi i dhunës në përhapjen e fesë.

Në hulumtimin e problemit Arnoldi hynë me fuqinë e gjërësisë së pikëpamjeve vetjake dhe objektivitetit shkencor, por edhe me shqyrimin e burimeve dhe literaturës në gjuhët orientale (arabe, turke, persiane dhe urdu) dhe evropiane të cilat mirë i ka njohur. Tërë kjo i ka dhënë shumë çelësa për zgjidhjen e pyetjeve të shumta e më të rënda.

7

Gjatë trembëdhjetë kaptinave të veprës së vet Arnoldi lexuesin në kontinuitet e shpie prej Arabisë në Azinë perëndimore, në afrikë, spanjë, Ballkan, Persi, në Azinë qendrore, Indi, Kinë dhe në arkipelagun Malaj. I vetëdijshëm për lëshimet eventuale në punë, Arnoldi tenton të bëjë plotësime tashmë në botimin e dytë të librit të et. Shkak për këtë nuk është vetëm zbulimi i burimeve të reja, por edhe interesi i forcuar për islamit në botë.

Me anën fetare të aktivitetit të islamit do të preokupohen veçan qarqet misionariste evropiane, intereset e të cilit kanë ditur të ndeshen me praktikën misionariste islame veçant në pjesët e Azisë dhe të Afrikës.

Është interesant se Arnoldi vetëm kalimthi përmend depërtimin e islamit edhe në dy kontinente: Amerikën Jugore dhe Veriore dhe Australinë, fillimeve të së cilës ka qenë bashkëkohës. Ka mundësi që kjo veprimtari misionariste ka qenë - mu në fill, ndonëse pjesa më e mirë e fuqisë punëtore sklllevërore, të importuar nga trolli afrikan në Amerikë, qysh ka qenë nga treva të banuara me banorë muslimanë (të fisit Manding, Fulba etj.). Këta së shpejti u bënë pre e aktivitetit misionarist të krishterë. Mirëpo, popullëzimet e mëtejme në këto treva do të tërheqin edhe njëherë numri të muslimanëve, veçan në qendrat industriale. Këtu do të mbijnë edhe bahskësitë e para muslimane e edhe moesxhidet. Ngjashëm do të ndodh edhe në disa vise të kontinentit të vjetër - Evropës (Anglia, Franca, Gjermania e të tjerat) ku Islami do të gjejë hapësirë për veprimin e vet krahasimtarisht me fetë tjera dhe pikëpamjet në botën.

Preokupimi themelor i Arnoldit është dëshmimi i argumentuar që fuqia e përhapjes së islamit qëndron në faktorët:

- a. subjektivë (të brendshëm) dhe
- b. objektivë (të jashtëm).

Sipas tij të parët janë të personifikuar në:

- mësimin misionarist, të thjeshtë e universal të islamit, që ofrohet me Kur'an,
- praktikën dhe përpjekjet e përpikta të Muhammedit a.s. - felajmëruesit të islamit (sunneti),
- entuziazmit dhe zjarrit fetar të të gjithë ithtarëve të saj - muslimanëve,
- raportet tolerante dhe duruese të muslimanëve ndaj pjesëtarëve të besimeve tjera, si rezultat i mësimin doktrinor të islamit,
- supremacionit dhe të arriturave kulturo-civilezuese që ua ka ofruar bashkësive të prapambetura në jetën private e shoqërore.

Ekspansionit fetar e të tjerë të islamit në Azi, Afrikë dhe Evropë, prej fillimit, do t'i kundërvihet spontanisht ose në mënyrë të organizuar krishterizmi, hebraizmi dhe budizmi. Këtë do ta bëjnë edhe ithtarët e disa mësimëve filozofiko-etike dhe besimeve të ndryshme pagane, sidomos në 8

Azi, që ngushtonin fushën e interesimit misionarist si të islamit ashtu edhe të veprimin misionarist të krishterë.

Rrezatimi dhe ndikimi fetar e kulturor i islamit, në disa pjesë të botës, është i intenzitetit të ndryshëm. Në këtë proces të dukshme janë tri etapa: Gjendja e parë përgatitore është ajo që karakterizon pranimin e vetëm disa elementeve të kulturës islame në jetën e individit ose bashkësisë. Këtu ka të bëjë më tepër mbi mënjanimin e pengesave dhe mundësimin e adaptimit të midiset jomusliman me disa elemente të kulturës religjioze dhe materiale të muslimanëve sikur që janë:

- bartjes së hajmalive - nuskave,
- shenjave / simboleve,
- rrobave dhe,
- pranimit të mënyrës islame të ushqimit dhe të banimit.

Këto elemente të akulturimit vetëvetiu nuk janë specifikisht islame as nuk janë faktorë të dallimit të muslimanëve e të tjerëve. Shpesh kultura e re jep vlera të reja, në këtë etapë, pa ndërrim radikal të të vjetres. Në këtë stadio islami është i detyruar që t'i adaptohet mentalitetit dhe mënyrës së jetës të të ardhurve rishtazi.

Gjendje e dytë është kthimi që në fillim e karakterizon më tepër ndërprerje me rendin e vjetër paraislamik të gjërave se sa adaptim të resë.

Stadio i tretë është proces serioz në të cilin islami e ndërron jetën e tërësishme të individit e edhe të bashkësisë drejt një kualiteti të ri.

Shikuar nga largësia kohore prej shtatë dekadash kur Arnoldi ka botuar botimin e vetë të dytë, të plotësuar të kësaj vepre, deri në ditët tona, shumë sosh është ndërruar në hartën gjeografike të botës muslimane, që ka pasur dhe ka ndikim edhe në planin fetar. Me natalitet ose me kalimin në islam

është dyfishuar numri i pjesëtarëve të tij në rruzullën tokësor.¹² Varbulli i ndodhive politike, shoqërore-ekonomike dhe revolucionare i përmasave botërore nuk e ka kaluar as botën muslimane të dekadave të fundit. Shumë popuj islam do të luftojnë për të drejtat dhe liritë e veta politike e të tjera qoftë nga skllëvëruesit e huaj, kolonializmit e imperializmit botëror, apo tiranisë dhe eksploatuesve të vendit. Lufta për gjetjen e vendit të vërtetë në ato ndodhi është shprehur edhe në zjarrin fetar të muslimanëve në aktivizimin ose pasivizimin e tij.

Mbifujtësia politike e civilizuese e jomuslimanëve, përkundër prapambetjes shoqërore dhe ekonomike të midisit muslimanë, ka nxitur tek ai reaksion të dyfishtë. Te disa islami është fajtor për të gjitha fatkeqësitë e ithtarëve të saj, sepse parositë i janë anakrone e të tejkaluara. Të tjerët, krejtësisht kundër, kanë pohuar se jopërpikshmëria dhe largimi i muslimanëve nga postullatet themelore teorike e praktike të islamit i ka sjellur ata deri te gjendja e inercionit dhe ngecjes.

9

Konfliktet e bartësve të këtyre dy rrumave ndër muslimanët, me ekzistimin e disa më të maturave, kompromiste, janë dashur të manifestohen edhe në planin fetar edhe misionarist të islamit.

Në ato midise muslimane, ku ka fituar rryma e parë, erdhi deri te laicizimi dhe ndarja e islamit nga punët shtetërore dhe tërheqja e fesë në sferën e ekzistimit privat.

As ato vise, ku islami është bërë religjion shtetëror dhe ku anën ia kanë marrë rrymat reformiste në islam, të tubuara rreth personaliteteve udhëheqëse politike ose ulemaje (Alganiu, Abduhu, Abdulvehhabi, Senusi, Xhinahi e të tjerët), apo institucioneve dhe shoqërive, nuk do të mbesin në çdo gjë të përpikta. Dëshirat e bukura së shpejti do të bëhen pre e synimeve të ndryshme politike. Tërë kjo ka dhënë dhe jep fryte të ligshita në të familjarizuarit (mësuarit) e islamit me përditshmërinë e muslimanëve.

Por edhe përveç asaj që sot muslimanët nuk paraqesin ndonjë epërsi politike dhe civilizuese, si dikur, që në midiset më pak civilizuese ka ndihmuar në punën misionariste, ana shpirtërore dhe moralo-etike e islamit ka mbetur edhe më faktor i fuqishëm i tërheqshmërisë.

Në këtë kuptim shkojnë edhe vrotimet e Arnoldit që aktiviteti shpirtëror i islamit nuk është, sikur që anojnë shumëkush ta komentojnë, strikt në lidhje me fuqinë e tij politike. Përkundrazi, humbja e pozicioneve politike dhe ekonomike di të shkaktojë cilësitë më të thella e më të sigjerta shpirtërore, të cilat pikërisht e motivojnë veprimtarinë misionariste.

Islami që misionin e vet e ka filluar në vështirësitë më të mëdha, të cilave u qenë ekspozuar bartësit e tij, në vetë fillimin sikur edhe në disa perioda të mëvonshme, ka ditur pikërisht vështirësitë e tilla t'i shfrytëzojë për lindjen dhe forcimin e sërishtëm.

Shumë më tepër në përhapjen e islamit kanë bërë muslimanët e Indisë dhe arkipelogut Malajas, duke u gjetur nën sundimin jomuslimanë, se sa Turqia apo Maroko si shtete të mëvetshme muslimane, thekson T. Arnoldi.

Merhum Mr. Nijaz Shukriqi

(Ligjëues në Fakultetin e studimeve islame në Sarajevë, i vrarë nga tiranët në Sarajevë, më 1992, N.I.)

1) Arnold, T.W., The Preaching of Islam - A history of the Propagation of the Muslim Faith, AMS, New York, 1974, fq. 467.

Përkthimi tekstual i titullit të veprës është "Thirrje në Islam - Historia e propagandimit të fesë muslimanë". (Titulli përkthyesit në gjuhën shqipe është "Historia e përhapjes të islamit - rrjedhat historike të misionit". (Vër. E N.I.)

10

2) Arnold, T.W., Intishari islam tarihi, përkthimi M. Halil Halid, Yeni matba'a, Istanbul, 1343/1924, fq. 445. Përkthyesi turk ka lëshuar shumicën e shënimeve sikur edhe bibliografinë e Arnoldit të burimeve dhe literaturës së përdoruar. Po këtë e ka bërë edhe D. A. Korkuti. Përndryshe të dy përkthimet janë korrekte.

3) "Glasnik" VIS-a, Islamska zajednica Kraljevine Jugoslavija, Beograd 1933, viti I, nr. 2-12, viti II (1934), nr. 1-12 dhe viti III (1935), nr. 1-9.

4) Botimi i dytë i plotësuar i këtij libri ka dalur në Londër më 1913, e pastaj edhe i treti në Kembrixh në vitin 1935. Të gjitha botimet vijuese sikur edhe reprinti nga viti 1974, janë botuar sipas botimit nga viti 1913.

(përkthimi shqip është bërë në bazë të përkthimit boshnjak "Povijest islama / historijski tokovi misije, përkthyer Dervish A. Korkuti dhe Nijaz Shukriqi, botimi II, Sarajevë, 1990, fq. 612. vërejtje e N.I.).

5) Dr Hasan J. Hasani ka doktoruar te prof. Arnolti në Londër. Me edhe dy kolegë ka përkthyer në gjuhën arabishte „Historinë e përhapjes së islamit“ të Arnoldit me titull "Ed-Da'watu ila l-islam / bahthun fi tarihi neshri-l-'aqidati-l-islaniija", En-Nahda, Kairo, 1958, botimi i dytë.

6) Bajraktareviq, F., Ç'i ka lënë Islami evropës, Srpski knjiveni glasnik, Servia e Re, XLIX, Beograd, 1936, nr. 5, fq. 380-382.

7) Al-Aqiqi, N., Al-Mustashriqun, Das al-me'a-rif bi Misr, Kairo, 1965, II, fq. 504-505.

8) Parathënia e Nikolsonit botimit të tretë të librit të Arnoldit "Historia e përhapjes së islamit, Kembrixh, 1935, sipas përkthimit arab "Ed-Da'wat ila l-islam", fq. 15.

9) Encyclopedia of Islam, E.J. Brill, Leyden, 1910, 1911.

10) Nasr, S.H., Ideals and Realities of Islam, London, 1979, fq. 118.

11) Procesi i përhapjes së islamit apo i a.q. islamizimi ë hapësirat tona ka preokupuar vëmendjen në pesë dekadat e fundit të një varg hulumtuesish muslimanë e të tjerë. Motivet kanë qenë fetare, nacionale, historike, politike dhe kulturologjike.

Varësisht nga kjo janë përdoruar edhe argumentet, burimet disponuese dhe literatura. Pasi përhapja e islamit, në trevat tona, bie në kohën e zhdukjes së bogumilizmit ë B dhe H, edhe islamizimi kapet edhe me këtë problem. Megjithatë, më së shpeshti studiohet në tërësi në sundimit pesëshekullor turk

në hapësirat tona. Me pak përjashtime, si faktorë vendimtarë në kalimin e banorëve vendas në islam të hulumtuesit janë privilegjet e natyrës politike, ekonomike dhe shoqërore, të cilat pushtuesi turk, si ideolog i atëhershëm i islamit, u ka ofruar banorëve të nënshtruar vendas, gjatë sundimit të vet pesëshekullor.

Ky proces i përhapjes së islamit te ne ka qenë me intenzitet të ndryshëm kohor dhe hapësinor. Mbetet enigmatike se si këto privilegje nuk kanë hasur në përgjegjje më të madhe, nëse ato të vetmet kanë qenë vendimtare te

11

kalimi i njerëzve në islam. Është e njohur se Mbretëria Turke nuk ka mundur të gjithëve, që kanë kaluar në islam, t'u ofrojë të gjitha këto privilegje, sidomos jo në kohën e ranijsë së fuqisë së saj politike dhe ekonomike, që fillon tashmë me fundin e shekullit XVI-të.

Kjo na shpie deri te mendimi se ka pasur edhe motivacione e nxitje tjera në kalimin në islam, e ndër ta janë të rëndësishëm edhe ata fetaro-kulturor.

Në kohën e të shkruarit të Arnoldit për përhapjen e islamit te ne as për së afërmi nuk kanë qenë të hulumtuara shumë burime të vendit e të huaja, veçan ato nga arkivat turke (defterët, sixhilët e të ngjashëm) prandaj edhe të dhënat e tij për islamizimin në endin tonë janë mjaft të varfëra.

12) Në Pasqyrën botërore etnografike të popujve muslimanë të R.V. Wecksit, të botuar në Londër në vitin 1978, në bashkëpunim me ekipën e ekspertëve dhe institucionet e numërta në botë, shtrohen të dhënat e rëndësishme për numrin, shtrirjen dhe laramaninë etnike të muslimanëve.

Sipas tij:

- muslimanë ka në të gjitha anët e botës.
- numri e kalon shifrën prej 720 milionë, të ndarë në treqind grupe etnike.
- në 36 vende përbëjnë shumicën e popullësisë, kurse në pesë 50% nga numri i përgjithshëm.
- në vendet ku janë pakicë paraqesin popullatë shumëmilionshe, siç është India dhe ish-BRSS ku janë mbi njëqind milionë.
- flasin rreth njëqind gjuhë e dialekte të ndryshme dhe shërbehen me të gjitha alfabetat e botës.

Weeks, R.V., Muslim peoples, A world ethnographic survey, London, 1978, fq. XV.

KAPTINA I

HYRJE

Njohje me fenë e misionit

Në ligjëratën që e ka mbajtur prof. Max Mülleri gjatë kohës së përshpirtjeve në kishën e Westminsterit në vitin 1987 me rasti e arritjeve misionariste, është marrë për rregull që gjashtë religjionet e mëdha të ndahen në misionariste dhe jomisionariste. Në fetë jomisionariste bëjnë pjesë ajo: hebraike, brahmane dhe e Zoroastros, kurse në ato misionariste ajo: budiste, kristiane dhe islame. Max Mülleri bukur e ka definuar çka mendohet me religjionin misionarist: "Mund të thuhet, se religjioni misionarist është ai

ndjekësit e të cilit sikur edhe themeluesi i saj e konsiderojnë për detyrë të shenjtë ta shpallin të vërtetën e t'i kthejnë në të jobesimtarët. Kjo është fryma që ekziston në zemrat e ithtarëve të fesë së këtillë, kurse i cili nuk mund të gjejë qetësi deri sa, qoftë në mendje, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, 12

nuk manifestohet; i cili nuk mund të qetësohet deri sa të kuptuarit e tij nuk përshkon në zemrat e tërë njerëzisë dhe derisa tërë njerëzia nuk e pranon për të vërtetë atë që ai e konsideron për të vërtetë.:1

Muslimanët, për shkak të mallëngjimit se vetëm feja e tyre është e vërtetë, kanë qenë të frymëzuar me detyrën që në të gjitha viset, në të cilat kanë depërtuar, të fusin predikimin e islamit, që i ka dhënë të drejtë të zë vend ndër religjionet misionariste.

Historia e fillit të këtij entuziazmi predikues dhe fuqitë që e kanë inspiruar, dhe mënyra në të cilën është zbatuar, e përbëjnë lëndën e kësaj vepre.

Ata disa qindra milionë muslimanë, të shpërndarë në të gjitha viset e rruzullit tokësor, janë provë e aktivitetit misionarist trembëdhjetë shekullor.*)

Përhapja e islamit

Rregullat e kësaj feje më së pari i ka shpallur në shekullin e shtatë në Arabi një Pejgamber i Zotit, i cili nën flamurin e vet i ka tubuar fiset e shkapërderdhura dhe ka formuar popullin. Me këtë disponim të ri nacional dhe entuziazëm të zjarrtë, që ushtrisë së tij i ka dhënë fuqi të pamposhtur, ithtarët e tij kanë depërtuar me synime pushtuese në tre kontinente. Së pari para këtij vërshimi kanë rënë: Siria, Palestina, Persia, Afrika Veriore dhe Egjipti.

Njëqind vjet pas vdekjes së Pejgamberit kanë sunduar ithtarët e tij në shtet më të madh se që ka qenë Mbretëria Romake kur ishte në kulminacion të fuqisë së vet. Vendet me të cilat kanë sunduar janë shtrirë në lindje deri te lumi Sind (Siudhu - Indus), e në perëndim deri në Spanjë.

Gjatë kohës kjo perandori e madhe islame është shkatërruar dhe fuqia politike e islamit ka rënë, por pushtimet shpirtërore barabartë kanë vazhduar. Kur hordhitë mongole (1258/656 H.), duke hyrë në Bagdad, kanë shtypur me gjakë dinastinë abasite, kur Ferdinandi (1226/634 H.) i ka perspektuar muslimanët nga rrethi i Kordovës (Cardoba), kur fartifikata e fundit islame në Spanjë, Granada, që e detyruar të paguaj haraç, atëherë islami triumfalisht ka filluar të përhapet në Sumatra dhe ujdhesat tjera Malajase. Dekadencia e tij politike ka rezultuar me pushtimet më të shkëlqyeshme shpirtërore. Dy herë në histori këmbët e barbarive i kanë ngadhjyer ithtarët e këtij historiani i në shekullin e njëmbëdhjetë Selxhukët dhe në shekullin e trembëdhjetë Mongolët, por të dy herët fitimtarët kanë pranuar religjionin e të mundurve. Misionarët islamë edhe atëherë kur nuk kanë pasur kurrfarë fuqie dominuese kanë përcjellur fenë e vet në Afrikën Qendrore, Indokinë dhe Kinë. Sot islami shtrihet prej Marokut deri në Zanzibar, prej Sierra Leones në Afrikën Perëndimore deri në Siri e Kinë, prej Bosnje e Hercegovinës deri te kolonitë

e Guinesë së Re. Pos viseve që janë të larguara nga bota islame, e në të cilat
13

ka mjaft muslimanë, siç janë Kina dhe Rusia, ka edhe grupacione tjra islame të izoluar ndër mosbesimtarët, siç janë Tatarët si banuar në rrethinën e Villnes, Kovnit dhe Grodnit² që flasin me gjuhën polake, dhe muslimanët të banuar në koloninë e Kepit të Shpresës së mirë, dhe punëtorët indus që e sollën islamin në Guinenë e Re. Në kohë të fundit islami ka arritur ithtarë edhe në Angli, Amerikën Veriore, Australi dhe Japoni.*)

Shkaqet kanë qenë të ndryshme: sociale, politike dhe fetare, që islami është përhapur në pjesën kështu të shtrirë të Tokës. Por përveç këtyre ka edhe një që ka qenë faktori kryesor që është arritur rezultat i këtillë i mrekullueshëm, e ky është: aktiviteti i palodhshëm i misionarëve islamë, të cilët për vete për ideal kanë marrë Pejgamberin dhe të cilët i kanë vakufuar jetat e veta për kthimin e jobesimtarëve.

Misionariteti nuk është diç i ri në islam, por ky nga vete fillimi është detyrë e shenjtë e muslimanit. Kjo mund të konkludohet nga këto ajete nga Kur'ani kerimi: "... (En-Nahl, 125); "... (Hud, 112); "... (Ali Imran, 20); "... (Ali Imran, 103), "... (El-Haxh, 67); "... (Et-Tewbe, 6); "... (Et-Tewbe, 11).

Kur teoretikisht dhe praktikisht një nga parimet islame të jetë kështu, atëherë islami është fe e pastër misionariste, sepse ky misionaritet paraqet jetën e Muhammedit a.s. dhe një grupi të madh të misionarëve islamë në krye të të cilëve është vetë Pejgamberi a.s. Ata kanë gjetur mënyrë se si do t'i kthejnë të pafatë. Sikur që nuk do të kërkojmë shfaqjet e frymës misionariste në islam në tiranitë e balozëve dhe në jotolerancën e fanatikëve, si e mendojnë këtë disa në imagjinatë: me shpatë në një dorë, e me Kur'an në dorën tjetër,³ por në aktivitetin modest të predikuesit dhe tregtarit islam, të cilët janë përpjekur që në të gjitha viset e Tokës ta përhapin fenë e vet.

Mënyra e këtillë paqëndrueshme e predikimit nuk është marrë vetëm për atë shkak kur këtë e ka kërkuar politika, as atëherë kur nuk ka qenë e mundur të përdoret fuqia, por për atë arsye sepse këtë mënyrë Kur'ani e urdhëron në shumë ajete: "... (Muzzemmil, 10); "... (El-XHinn, 23); "... (El-Xhathije, 14); "... (En-Nahl, 35); "... (En-Nahl, 82); "... (En-Ankebut, 46); "... (Esh-Shura, 48), "... (Junus, 99); "... (Sebe, 28); "... (El-Bekare, 256); "... (En-Nur, 54); "... (El-Haxh, 49); "... (El-Fet'h, 8-9); "... (El-Maide, 13).

Faqet e këtij libri do të shërbejnë të dëftojnë se si këto ajete në histori janë zbatuar dhe në çfarë mënyre është sendërtuar sistemi i aktivitetit misionarist. E para është t'u shpjegoj lexuesëve se kjo vepër është shkruar që të jetë histori e predikimit islam, e jo e kthimit të detyrueshëm islam.

Prandaj, nuk kam për qëllim t'i cekë shembujt e kthimit me dhunë, të cilët nga koha në kohë duhet të gjenden në historinë islame. Këta shembuj antarët evropianë aq hiperbolikisht i kanë prezentuar sa që nuk duhet fare të frikësohemi se do të harrohen, ndërsa këta shembuj absolutisht nuk bëjnë

pjesë në terrenin e historisë së misionaritetit. Natyrisht, në historinë e misionaritetit të krishterë ndër magët saksonasë sukcesi më i madh është në aktivitetin misionarist të shën Lijogent dhe Vilhardit, se që është në kthimin me forcë me shpatë të Karlit të Madh.⁴

Idhujtarinë nga Danimarka nuk e çrrënjosi mbreti Knut por shën Ansigari dhe trashëgimtarët e tij.⁵ Në aspekt të kthimit të idhujtarëve prusianë pak kanë arritur opati Gottfried dhe ipeshkvi Christian, por veprën e tyre e mbaruan me zjarrë e shpatë "Vëllezërit e shpatës" dhe kryqtarët tjerë, të cilët në fotografinë reale paraqesin misionaritetin e krishterë. Ndonëse kryqimit të detyrueshëm shumë i kanë kontribuar kalorësit e rendit "Ordo fratrum militum Christi" duke i kthyer banorët e Livonisë, mund të dëftohet vetëm në monakët Manihardindhe Teodorikun sikur në misionarët e vërtetë të fesë së Jezusit në ato vise. Ndonëse jezuitët aty-këtu janë shërbyer me mjete detyruese, megjithatë kjo nuk e ka zvogëluar autoritetin e shën Franje Ksaverit (Xavier) dhe predikuesëve tjerë. Kur kleriku suprem në vitin 1699 erdhi në ujdhesën Embonia për të kontrolluar, dha urdhëresë, që të gjithë raxhët (princ indian, N.I.) i kësaj ujdhese të tubohen, që t'i kryqoj, por ky gjest nuk i soli dëm misionaritetit të Valentinit.⁷

Pas fillimit të veprimtarisë misionariste dhe ditëve që na përkujtojnë në zelltarinë e apostujve, të të krishterët erdhën periodat e indolencës dhe apatisë, e në vend të predikimit që është bërë në emër të Zotit, janë përdoruar mjetet detyruese. Fazat e njëjta të elanit e apatisë i ka kaluar historia e përhapjes së islamit në periodat e ndryshme. Pasi që përhapja e fesë është karakteristika kryesore e këtyre dy religjioneve, kjo do të ishte e përshtatshme të ndahet ashtu, që secila nga ato të jetë grup i veçantë i studimit të historisë së misionarizmit dhe këtë, duke mos lëshuar asgjë nga manifestimet e tyre jetësore, të bëhet e dukshme forma e tyre e veçantë. Kjo do të rezultonte me studim të veçantë të analeve të propagandës dhe kthimit të detyrueshëm, qoftë kjo në Kishën e krishterë, qoftë në islam, ndonëse, herë herë, këto dy grupe janë përzier njëra me tjetrën.

Gjithnjë as feja e krishterë nuk është përhapur në atë mënyrë, si e ka përhapur mbreti norvegjez Olaf Trygvesoni, ashtu që duke i mbytur ata që nuk kanë dëshiruar ta pranojnë krishterizmin duke na prerë këmbët e duart dhe duke i persekutuar ata,⁸ as është përhapur sipas rekomandimit të shën Ludevinit (st. Louis), i cili është: "Nëse dikush çkado që keq dëgjon për ligjin e krishterizmit nga ata që nuk janë anëtarë të Kishës, është i obligueshëm që me shpatë ta mbrojë dhe këtë duke e futur shpatën aq, sa mund të hyjë në barkun e jobesimtarit".⁹ Po ashtu as në islam nuk janë shërbyer gjithnjë me mjete detyruese të halifit të fundit të Umevitëve.*) i cili ka thënë: "Do t'i mbysë dhe në kryq do t'i gozhdojë të gjithë Egjiptianët që nuk do ta pranojnë fenë time, që nuk do të luten sikur edhe unë, dhe nuk do t'i ndjekin principet e fesë sime".¹⁰

15

Po ashtu krahas shembujve të Mutevekkilit,**) Hakimit***) dhe Tippo-Sulltanit nuk duhet humbur parasysh Mevlana Ibrahimin i cili e përhap

islamin në ujdhesën Malajase, haxhi Muinuddin Çishtiun dhe misionarët tjerë të cilët në mënyrë paqëndashëse kanë arritur ithtarë.

Edhe pse është lehtë të ndahen kthimet që janë fryt i fuqisë dhe dhunës nga ata që janë arritur me mjete propaganduese, vështirë është të hulumtohen qëllimet për ç'arsye kan ekryer kthimin e njerëzve në fenë e vet: apo për atë shkak që ta fitojnë një kokë më tepër për "kopenë" e vet, apo për atë cak të lartësuar që e kemi përmendur në fillim të kësaj kaptine. Gjithnjë, qoftë në islam, qoftë në krishterizëm, janë gjetur shpirtëra të pastër, që fenë e vetë e kanë konsideruar si të vërtetën më të lartësuar të jetës. Interesi i tyre në aspektin shpirtëror është manifestuar në shpalljen e të vërtetave të shenjta dhe në prudencën që të dominojnë ata principe që ata e konsiderojnë më të përkryerat, ashtu që kjo gjendje është forcë përtëritëse e misionaritetit. Gjithashtu ka edhe të atilë që, pa kurrfarë insistimi nga ana e misionarëve, me entuziazëm janë pajtuar me fenë e re sikur edhe ata të parët. Vërtet, si ndër ithtarët e krishterimit ashtu edhe të islamit, ajo që, për shkak të nevojave të paarsyeshme ose tërheqjes andej këndeje të pyetjeve fetare për pikëpamjet e veta, institucionet e pastra ekleziastike i kanë konsideruar për instrumente të ndonjë të drejte apo disa rrethime sociale. Ndër ato që kanë pranuar ato dy fe të këtillë ka mjaft. Si krishterizmi, ashtu edhe islami shumë ithtarë i ka përvetësuar për shkak të shkaqeve sociale, politike e ekonomike, që nuk kanë të bëjnë asgjë të përbashkët me atë etje shpirtërore që i jep të drejtë ekzistimi misionaritetit të mirëfilltë. Pos kësaj, analet e veprimtarisë misionariste shpesh herë shënojnë konvertitë (të kthyer) të ri, por nuk kanë hyrë në hulumtimin e shkaqeve që i kanë shtyrë në këtë. Sidomos misionariteti islam është i mëngët në këto të dhëna. Këto anale rënë vend me rëndësi në veprat e shkruara të Kishës së krishterë, derisa në letërsinë islame ndihet varfëri e madhe e të dhënave për këtë pyetje. Prandaj, shpesh nuk kemi pasur mundësi që plotësisht t'i zbulojmë motivet e veprimtarisë misionariste islame; a kanë qenë sociale, politike, ekonomike, apo pastër religjioze.

1) Vërejtja në artikullin Mr. Lyalla "Missionary Religions", Fortnighthy Review, July, 1874.

*) Sot muslimanët numrojnë një shekull më tepër (14) në punën e tyre misionariste, e edhe numri në botë i ofrohet miliardës. Të dhënat statistikore të banorëve të disa regjioneve dhe popujve në botë përgjithësisht shpesh janë kontraverze. Prandaj edhe statistika e muslimanëve në botë nuk është gjithnjë e sigurtë. Llogaritjet që në çerekun e fundit të shekullit 20 mund të jenë ndërmjet 600 dhe 900 milionë.

16

Sipas veprës "Popujt muslimanë - pasqyra etnografike botërore - në redakturë të hulumtuesit amerikan Riçard Viksit (Richard Weckes) numri i muslimanëve në botë, sipas të dhënave statistikore nga viti 1977 është numri prej 720 milionë. Janë të ndarë në rreth 300 grupe të ndryshme etnike. Flasin dhjetëra gjuhë e dialekte të ndryshme, kurse shërbehen gati me të gjitha

alfabetet e njohura në botë. Vetëm pjesa më e vogël (28% i banojnë miidiset qytetare, e të tjerët viset bujqësore e blegtorale, që është e manifestuar edhe në mënyrën e profesionit dhe jetës.

Weckes, R.V., Muslim Peoples, A World ethnographic survey, London, 1978, fq. XV-XVI, (Hyrje).

Një hulumtues tjetër Salih M. Abduhu në studimin "Pasojat demografike të vetëdijes minoritare" (Një analizë), sjell të dhënat nga viti 1975, numri i muslimanëve atëherë në botë ka qenë 783.4 milionë. Dy të tretat jetojnë në vendet ku paraqesin shumicën e popullësisë 548,5 milionë), e një e treta (244.9 milionë) përbëjnë pakicën prej 12% ose me përqindje më të ulët në vendet jomuslimane. (Tabela 1 dhe 2).

Saleha M. Abedin, Demographic Consequences of Minority of Conciuousness, (An Analysis), Journal, Insttute of Muslim Minority Affaris, Jeddah, 1980, Vëll. 2, Nr. 1, fq. 97-100. (SH.N.)

2) Reclus, vol. V, fq. 433; Gasztowtt, fq. 320 sqq.

*) Për shtrirjen gjeografike të islamit në kohën tonë të shihet: Historical Atlas of the Muslim Peoples (Atllasi historik i popujve muslimanë), Harward,(?).

- Mu'nis, H., Atlas tarihi -l-islam (Atllasi i historisë së islamit, Az-Zahra li -l- isla al-arabi, Kairo, 1987.

Autori sjell të dhënat vijuese statistikore për muslimanët në botë, nga viti 1984:

- Vendet e Lindjes së Mesme 147.761.00
- Evropa 11.907.530
- BRSS (ish-BRSS - N.I.) 44.236.000
- Afrika 206.276.110
- Azia dhe Oqeania 392.150.200
- Amerika Veriore, e Mesme e Jugore 2.947.290

GJITHSEJ: 805.286.150

Autori i njëjtë konsideron se përqindja e muslimanëve është afër 20% nga popullata e përgjithshme e rruzullit tokësor, që përbënë që një e pesta e kësaj popullate e predikon islamin. (fq. 439-440).

3) Ky shpjegim i gabueshëm i fushatave pushtuese muslimane ka rrjedhur nga supozimi se luftërat janë zhvilluar për arsye të përhapjes së pushtetit musliman mbi vendet jobesimtare kanë pasur për qëllim kthimin e tyre në islam.

17

Goldziheri shkëlqyeshëm ka dëftuar në këtë dallim në veprën e vet "Vorlesungen über den Islam"... Muhammedi e ka lënë atë që në fillim e ka realizuar në midisin e vet arab, si porosi ithtarëve të vet - ummes - e kjo është: kundërvënia mosbesimit dhe përhapja e besimit islam. Këtu është edhe diç më shumë se kjo, e kjo është përhapja e pushtetit islam, i cili në realitet është pushteti i All-Ilahut.

Në fillim, qëllimi i luftës islame nuk ka shkuar drejt ndryshimit të fesë me futjen në islam sa ka pasur për synim tërheqjen e vërejtjes jobesimtarëve

(fq. 25).

4) Shihi Enhardi Fuldensis, në vitin 777, "Pasi që Sahranët janë dobësuar pas luftërave të shumta, kanë pranuar krishterizmin në fund, dhe i janë nënshtruar pushtetit frenk."

H. G. Pertz: Monumenta Germaniae Historica, vol. I, fq. 349 (Shih poashtu fq. 156, 159)

5) "Pasi që popujt e ngadhnyjer iu nënshtruan ligjit të krishterë, pasi që ka zhvilluar luftëra të rënda me mbretëritë barbare, të motivuar me dëshirë të zjarrtë për përhapjen e fesë". (Breviarium Romanum, Jun. 19).

6) Mothurin VEysiere de La Croze: Historie du Christianisme des Indes, fq. 529-531 (The Hague, 1724).

8) Konrad Maurer: Die Bekehrung des norwegischen Stammes zu Christen - thume, vol. I. fq. 284 (München, 1855).

7) Revue de l'Histoire des Religions, vol. XI, fq. 89.

9) Jean, Sire de Joinville: Historie de Saint Louis, ed. N. de Wailly, fq. 30 (neni 53).

*) Mervan b. Muhammed (744-750) erdhi në pushtet kur shtetin emevitë e kanë copëtuar rruynuat dhe kundërthëniet politike, fetare dhe nacionale të grumbulluara në kohën e pararendësve të tij. Lufta qytetare e kaploi vendin dhe Mervani II sa do që është shquar me guxim, durim dhe vendoshmëri nuk ka arritur të vë rend në shtet. Vetë ra në fushëbetejë në luftë me fuqinë konkurrente abbasite.

Hasan, J. H., Tarihu-l-islam, en-Nahda, Kairo, 1964, botim VII, vëll. I, fq. 335-342; Hiti, F., Istorija Arapa, V. Maslesha, Sarajevë, 1967, fq. 261-267, (Sh.N.)

10) Severus, fq. 191 (rreshti 21-22).

**) El-Mutevekkil (847-861) është halifi i dhjetë abasit. Me të fillon shkatërrimi i shtetit abasit. Vendi është gjind në çarje të elementit persik, turk e arab i cili atëherë ishte në tërheqje. Madje edhe fronti është translokuar nga Bagdadi në qytetin e posaformuar Sumerra në vitin 836, që të shpëtohet nami i hilafetit dhe integriteti i vendit. Halifeja Mutevekkili edhe vet ka ra sakrificë e thyerjeve të atëhershme shoqëro-politike. Tërë kjo është reflektuar edhe në mënyrën e qeverisjes së tij.

Hasan, I.H., po aty, vëll. III, fq. 3-6.

18

Hiti, F., po aty, fq. 423-424 (Sh.N.)

***) Ebu Ali el-Mensur el-Hakim është sunduesi i gjashtë fatimit (996-1021). Erdhi i ri në sundim, sundimi i tij është karakterizuar me thyerje e oshilime të vazhdueshme prej maturisë deri te animi ekstrem ndaj mësimiit shiit. Kulminacionin e ekstremitetit të tij e kanë ndier shtetasit e tij jomuslimanë ehlu-dh-dhimme (të krishterët e Hebraikët), por edhe muslimanët sunnitë. Ka treguar edhe shenja të çrregullimeve mentale, që në fund solli deri te revolti ipërgjithshëm, dhe deri te atentati në të.

Hasan, I.H., Tarihu-d-devle el-fatimiyye (Historia e shtetit fatimit), en-Nahda, Kairo, 1964, botimi III. fq. 164-168; Hiti, F., po aty, fq. 560-561.

(SH.N.).

(FOTOGRAFIA E MEKKES DHE MEDINES)

KAPTINA II

JETA E MUHAMMEDIT A.S. -

MISIONARIT TË ISLAMIT

Muhammedi a.s. - shembull i misionarit islam

Në këtë kaptinë nuk mendohet të shtohet edhe një jetëshkrim i

Pejgamberit a.s. atyre biografive të tij të shumënumërta, por qëllimi është të

studiohet nga fazat e jetës së tij një, dhe atë: jetën e Pejgamberit a.s. si

përhapës i fesë dhe pejgamber i fesë. Shpresojmë, natyrisht, se jeta e

themeluesit të islamit dhe propagandës së tij do ta zbulojë esencën e këtij

aktiviteti. Deri sa jeta e Pejgamberit a.s. shërbe si shembull në veprimin e një

muslimani të rëndomtë, duhet po ashtu ta shërbejë edhe misionarëve islamë.

Prandaj, jeta e Pejgamberit a.s. është shembull; në bazë të kësaj shpresojmë

të njoftojmë shumë sosh që ka të bëjë me ata që veprimin e vet e kanë

përshtatur sipas këtij shembulli, dhe në frymën entuziazmuere dhe me

metodën e pritur të atyre që i nënshtrohen. Në paraqitjen vijuese dëshirojmë

të prezentojmë se si fryma e misionaritetit prej vetë fillimit të depërtojë në

fe, sepse ai nuk është diç i ri, i imagjinuar në islam, dhe në ç'mënyrë

Pejgamberi a.s. është bërë shembull i misionarit islam. Prandaj, nuk kemi për

qëllim ta shkruaj më historinë e tij dhdha ta përshkruajmë ndikimin që e ka

pasur deri në kohën e vet burrërore, as ta paraqesim si shtetar ose komandant

lufte. Ai na intereson vetëm si përhapës i fesë.

Përpjekja e parë në thirrjen në Islam

Pas luftërave të gjata të brendshme Pejgamberi a.s. fitoi bindjen në

detyrën me të cilën është frymëzuar. Së pari u orvat ta bind familjen e vet në

mirëfillësinë e fesë së vet. Njësia e Zotit, urretja ndaj idoleve, detyra që e

19

obligon njeriun për shkak të përkushtimit të tij vullnetit të Krijuesit, është

ajo në çka ai ka dëshiruar t'i bind, në çka thjeshtë ka dëshiruar që ta ndjekin.

Personi i parë i kthyer qe shoqja e tij besnike e jetës, Hatixheja.

Hatixheja qysh para 15 vitesh atij, i cili si i autorizuar i saj me sukses ka bërë

tregti, i ofroi martesë me fjalët: "Unë të dua, sepse më je i barabartë sipas

gjakut, dhe fisit, dhe bota të respekton dhe për shkak të moralit tënd dhe

altruizisë tënde.:1

Hatixheja e shpëtoi nga mjerimi dhe i dha mundësi që të mund të jetojë

në pozitën sociale që i përket sipas lindjes. Por kjo mbështetje materiale e

Hatixhes r.a. s'është asgjë në krahasim me mbështetjen shpirtërore dhe

bashkëpjesëmarrjen në preokupimet e tij, dhe ndaj ndjesive të saj të

ngushëllimit në çastet e tij të dëshpërimit.

Hatixheja vdiq më 619, tre vjet para Hixhretit. Deri në këtë moment

Hatixheja r.a. gjithnjë ka qenë e gatshme gjatë 25 vjetëve të jetës martesore

t'i ofrojë ngushëllim dhe përkrahje kur armiqët e tij e persekutonin dhe dyshimet

e mundonin. Ibn Is'haku, një nga antarët e biografisë së Pejgamberit a.s.

thotë: "Ju kështu Hatixheja r.a. besonte në frymëzimet, që vinin prej Zotit,

dhe duke e deklaruar vërtetësinë e tyre, e ndihmonte në veprën me ç'ishte ai i obliguar, dhe ka dëshiruar t'ia lehtësojë punën; sepse kur kthehej pa sukses i dëshpëruar nga predikimet e veta, ajo e ngushëllonte dhe ia lehtësonte përgjegjësinë."2

Ndër të parët që e kanë pranuar fenë kanë qenë fëmijët e tij shpirtëror Zejdi dhe Aliu dhe shoku i tij besnik Ebu Bekiri, për të cilin Pejgamberi a.s. ka thënë: "Gjatë shumë viteve të thirrjes sime në fe nuk kam gjetur kënd që nuk ka dëftuar çudi, hamendje dhe dyshim pos Ebu Bekirit. Kur kam folur për islamin, as është çuditur as i është shmangur obligimeve". Ebu Bekiri merrej me tregti. Për shkak të moralit, fuqisë dhe kthjelltësisë së tij, bashkëqytetarët e tij mjaft e kanë vlerësuar. Pasi e pranoi islamin, pothuaj gjithë pasurinë e shpenzoi duke i blerë robërit, të cilët, duke e pranuar islamin, qenë të ekspozuar mundimeve të zotërinjve të tyre.

Ndër të kthyerit e parë pesë janë që janë kyqur me besimdrejtët me ndikimin e tij dhe atë: pushtuesi i ardhshëm i Persisë, Sa'd b. Ebi Vekasi, Zubejr b. Avami, grueja e të cilit ishte në lidhje gjinie në Pejgamberin a.s., me gruen e vet; më vonë, me trimërinë e vet Talkau me famë; tregtari i pasur Abdurrahman b. Avfi dhe halifi i tretë Osmani. Osmani i pari i qe ekspozuar dhunës, xhaxhai i tij e ka kapur e lidhur duke i thënë: "Vallë po e lë ti fenë e babajëve tu dhe asaj po ia paraprinë këtë të renë? Betohem se nuk do të lëshoj deri sa nuk e lëshon këtë fenë e re"! Në çka iu përgjegj Osmani: "Betohem në All-llahun se asesi nuk do ta lëshojë këtë fe"! Kur xhaxhai e pa se kaq është i fortë dhe i përkushtuar fesë së vet, e lëshoi.

Muhammedi a.s. vitin e tretë të pejgamberisë së tij ka aritur të grumbullojë rreth vetes një grup ithtarësh, robërish dhe varfanjakësh të 20

pastër. I trimëruar me këtë sukses, ka ndërmarrë hapa të rinj dhe filloi publikisht ta predikojë islamin. Duke i ftuar kushërinjtë në një mbledhje, iu tha: "Askush popullit ti vet nuk i ka sjellë principe më të vlefshme se unë juve. Ju sjell atë që do t'ju lumturojë në këtë dhe në atë botë. A ka ndonjë nga ju që në këtë do t'më ndihmojë?" Këto fjalë shkaktuan qeshje ironike të të pranishmit, dhe menjëherë filluan të shpërndahen. Muhammedi a.s. nuk hoqi dorë nga qëllimi i vet për këtë mossukses, por u drejtohej kudo që i paraqitej rasti, por shpalljet dhe vërejtjet e tij, pos shtrembërimeve dhe nënçmimeve, nuk rezultuan me asgjë tjetër.

Terrori ndaj muslimanëve të parë

Kurejshitët shumë herë i janë drejtuar Ebu Talibit që ai, si kryepar i Hashimitëve, ta kthejë nga predikimi i mëtejshëm kundër fesë së të parëve të tyre, duke ia tërhequr vërejtjen që, në rastin e kundërt, do të ndërmarrin hapa të rreptë. Në këtë Ebu Talibi personalisht e ka lutur djalin e vëllaut së vet që mos të shkaktojë fatkeqësi të vetes dhe të fisit të vet. "Sikur të ma vënë Diellin në të djathtë, e Hënën në të majtë, çka Zoti nuk do të ma lejonte, nuk do të heqsha dorë nga predikimi, ndërmjet shkatërrimit dhe kësaj sikuri të mund ta zgjedhë njërin, do ta zgjidhje shkatërrimin tim, e nuk do ta lëshoja thirrjen time", iu përgjegj Pejgamberi a.s. Kjo e preki Ebu Talibin,

dhe thërriti: "Folë ç'të duash, unë kurrë nuk do të dorëzojë armiqëve tu." Kurejshitet me pakëndje dhe pa tolerancë e kanë përcjellur përhapjen e shkallërishtme të fesë së re. Herë tmerroheshin, e herë e nënçmonin, herë sërish ia kanë premtuar nderin dhe lumturinë e kësaj bote. Të gjitha masat e mundshme i kanë marrë Kurejshitet që ta kthejnë Pejgamberin a.s. nga rruga që është nisur. Ky sulm mbi të ka qenë shkak që axha i tij h. Hamza kaloi në anën e tij. Kur h. Hamzës i tregonin të gjitha ato nënçmime të cilave iu është ekspozuar djali i vëllaut të tij dhe durimin me të cilin i ka bartur, shpirti iu mbush me aq dhembshuri sa u bë nga kundërshtari i thtar i zellshëm. Shumë pa dyshim e pranuan fenë e re, por nuk e kanë deklaruar publikisht deri te fitorja e saj e plotë.

Sa më shumë që rritej numri i ithtarëve të kësaj feje, armiqësia e Kurejshitëve ka qenë më e rreptë. Suksesi i fesë së re ka pasur kuptim të shkatërrimit të kultit nacional, por edhe humbja e fuqisë dhe pasurisë për rojtarët e Ka'bes. Muhammedi a.s. i mbrojtur nga Ebu Talibi dhe Hashimitët, ka qenë në pozicion të sigurtë. Realisht, ndonëse ata nuk kanë ndier dashuri ndaj fesë që e ka shpallur një Hashimij, megjithatë e kanë mbrojtur nga të gjitha sulmet për shkak të ndjenjave të fuqishme fisnore (gjinore). Ndër muslimanët kanë pësuar rëndë vetëm të varfërit e të vetmuarit të cilët i kanë munduar e burgosur, mos po i kthejnë nga feja e re. Ja në këtë kohë h. Ebu Bekiri r.a. e bleu bilalin dhe e liroi.3

21

Për Bilalin, i cili ka qenë skllëvë abesinas, Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ose do të mbesish në këtë gjendje, deri sa nuk vdesë, ose lëshoje Muhammedin dhe adhuroj idolet", e ai vetëm e përsëriste kelimeishehadetin. Dy muslimanë në vështirësi i lanë shpirtërat. Ndonëse disa prej tyre janë hamendur në qëndrueshmëri, këto vuajtje të tjerët kanë nxitur edhe më tepër entuziazëm, sikur që është te Abdullah b. Mes'udi, i cili filloi rreth Ka'bes të lexojë disa ajete nga Kur'ani, që deri atëherë askush s'ka marrë guxim. Kurejshitet, që ishin të tubuar aty, e atakuan atë dhe e kanë rrahur deri sa nuk pushojë të këndojë. Ai iu kthye shokëve të vet. Ditën vijuese në mënyrën e njëjtë dashti ta manifestojë fenë e vet, por shokët e tij nga ky qëllim e kthyen duke thënë: "Ti edhe këtë e ke mjaft, sepse ua ke cituar që aspak nuk dëshirojnë të dëgjojnë."

Pejgamberi a.s. me siguri e ka lëshuar banesën e et dhe u shpërngulë në shtëpinë e Erkamit, njërit prej simpatizuesëve të tij të parë, për shkak të sjelljes rrëmbyese të Kurejshitëve ndaj tëij. Pasi që shtëpia e tij (Erkamit) ka qenë në qendër, shumë të huaj dhe pelegrinë kanë kaluar atypari.

Kalimtarëve, që e kanë pyetur, Pejgamberi a.s. ka mundur këtu në qetësi pa ndërprerje t'u predikojë dhe rregullat islame t'ua shpjegojë. Të banuarit e Pejgamberit a.s. në këtë shtëpi paraqet periodë me rëndësi të përhapjes së islamit në Mekke sepse shumë kanë pranuar islamit prej kur Pejgamberi ka filluar të këshillojë në shtëpinë e Erkamit.

Pasi Pejgamberi a.s. nuk ka mund t'i merrë në mbrojtje ata që u ishin të ekspozuar vuajtjeve, iu ka rekomanduar që të strehohen në Abesini. Në vitin

e pestë të peygamberisë së tij (615) njëmbëdhjetë mashkuj dhe pesë femra kaluan në Abesini, ku hasën në pranim të mirë nga ana e mbretit të atjeshëm të krishterë. Ndër këta ishte edhe Mus'ab b. Umejri, kthimi i të cilit meriton kujdes sepse ka përjetuar mundime të rënda dhe ka qenë i nënshtruar armiqësisë së atyre që i ka dashur dhe të cilët dikur e kanë dashur. Duke i dëgjuar predikimet e Pejgamberit a.s. në shtëpinë e Erkamit, ai e dashti islamin, vetëm u frikësua që kjo mos të dëgjohet, sepse anëtarët e fisit të tij dhe gruaja e tij, të cilën me kujdes e ka dashur, kanë qenë kundërshtarë të rreptë të islamit. Dhe njëmend, posa dëgjuan se e ka pranuar islamin, e kapën dhe e mbyllën, por, duke u shpëtuar, disi iki në Abesini.

Armiqësia e Kurejshitëve i përcolli të shpërngulurit madje deri në Abesini. E dërguan të deleguarin mbretit të atjeshëm të kërkojë dorëzimin e muslimanëve, por mbreti, duke mësuar prej muslimanëve ç'u ka ndodhur, nuk ka mundur e mos t'i mbrojë. Në pyetjen për fenë e tyre mori përgjegjjen vijuese: "Mbreti i lartëmadhërishëm, na është zënë fryma në terrë të mosdijes, kemi lutur putat, kemi bërë mbrapshtira të ndryshme, kemi shkelur lidhjet farefisnore, u kemi shkaktuar dëm fqinjve, të fortit ndër ne kanë dashur t'i gëlltisnin të dobët. Ja, në gjendjen e këtillë kemi qenë deri sa i Gjithlartësuarin ndër ne nuk e dërgoi peygamberin. Sa e dimë drejtësinë, 22

besnikërinë dhe pastërtinë e jetës së tij, aq dimë edhe prejardhjen e tij. Neve na ftoi që ta adhurojmë të vetmin Zot në vend të putit, që i kanë adhuruar të parët tanë. Na ka urdhëruar të jemi të singertë në të folur, besnik në premtim, të mëshirshëm ndaj prindërve, të mirë ndaj fqinjve, që të ruhami nga krimet dhe gjakderdhjet, e na ka ndaluar ligësitë, rrenën, shkeljen e të drejtave të varfanjakëve dhe shnderimin e femrave. Na ka obliguar vetëm me adurimin e Zotit të Madh, me agjërim dhe dhënien e sadakës (zekatit). Ne i kemi besuar dhe filluam ta ndjekim atë që Zoti na ka shpallur nëpërmjet Feshpallësit, por bashkëqytetarët tanë u ngritën kundër nesh dhe filluan të na dëmtojnë, mos po kthehemi në idhujtari dhe çoroditjet e jetës tonë të deritashme. Ja, për shkak të sjelljeve të tyre të dhunshme me ne dhe mundimeve të rënda që kemi duruar dhe për shkak të përzierjes në fenë tonë ne e kemi lëshuar vendlindjen tonë dhe u strehuam në endin Tuaj. Pasi që jemi mbështetur në drejtësinë Tuaj, shpresojmë se nuk do të na dorëzoni dhunës së armiqëve tonë". Pas këtyre fjalëve iu pranuan lutjet, kurse i deleguari i Kurejshitëve u kthye prapa i turpëruar.⁴ Ndonëse në po këtë kohë në Mekke është ndërmarrë që Pejgamberi a.s. të bindet që të heq dorë nga aktiviteti i vet predikues, si kompenzim iu premtua pasuri dhe nderë, megjithatë çdo gjë mbeti pa sukses.

Në atë kohë, kur me shpresë të madhe pritej në Mekke rezultati i misionit që shkoi në Abesini, një personalitet u kthye, por personaliteti i tillë i cili më vonë fazës së parë të islamit i ka dhënë formën më madështore, ndërsa i cili deri në kthimin e vet ka qenë armiku më i pezmatuar i Pejgamberit, i cili me fanatizmin dhe kryeneqësinë skajore i është kundërvënë islamit, dhe me të drejtë ka merituar që muslimanët ta konsiderojnë armikun e vet më të rreptë.

Ky personalitet ka qenë Omer b. Hattabi.

Një ditë vrapoi me shpatë në dorë, i përshkuar me ndjenjën e vrullshme të zeërimit, që ta mbysë Pejgamberin a.s. Duke e takuar në rrugë në këtë disponim, një nga kushërinjt e tij e pyeti se ku po shkon. "Po shkoj ta gjejë Muhammeidn, dua ta heq qafe këtë heretik, që futi çarje ndër Kurejshitët, i cili i konsideron budallenjë dhe i cili dëshiron që t'ua shtrembërojë fenë, dhe ta rrënojë autoritetin e putave të tyre", iu përgjegj Omeri. "A nuk do të ishte më mirë ta kthesh kushëririn tënd?" në këtë i tha ai që e pyeti. "Cilin kushërir timin?" "Dhëndrri yt Seidi dhe motra joe Fatima e kanë pranuar islamit!" Posa dëgjoi Omeri për këtë lajm, menjëherë u nis drejt shtëpisë së motrës. Motra e tij dhe dhëndrri janë ulur në shoqërinë e një ithtari të Pejgamberit. Ky ithtar me emrin Habbab e ka mësuar Fatimen dhe burrin e saj nga një kaptinë e Kur'anit. Posa u vërsul Omeri, i pyeti për atë që i ka dëgjuar se po lexojnë. U përgjigjen ata: "Asgjë"! "Si? Unë u dëgjova, madje kam mësuar se jeni bërë ndjekës të Muhammedit". Duke e thënë këtë e sulmoi Seidin dhe filloi ta rrahë. Në atë kohë mes tyre hyri FATIMA me fjalët: "Po, jemi muslimanë dhe besojmë në Zotin dhe në të Dërguarin e Tij! Nëse 23

don, na mbytë të dyve!" Kur pa Omeri se po rrjedh gjaku nga fytyra e motrës së tij, e cila qe lënduar, iu zgjua ndjenja e dhembsurisë. Dëshironte të shoh çka kanë lexuar. Më në fund motra, duke u hamendur, ia zgjati faqen në të cilën ishte kaptina e njëzet e Kur'anit "Talia". Pas Omeri e lexoi, bërtiti: "Oh! sa e mirë është kjo, sa e lartësuar!" Derisa e lexonte këtë, bindja e fitoi dyshimin, dhe thërriti: "Më çoni deri te Muhammedi, që t'ia deklaroj kthimin tim."⁵

Kalimi i Omer b. Hattabit në islam paraqet kthesë në historinë e islamit. Pas kësaj muslimanët qenë në gjendje të marrin qëndrim më të guximshëm. Pejgamberi doli nga shtëpia e Erkamit, kurse muslimanët filluan rreth Ka'bes të falen. Mund të provohet se fisnikët e Mekkes qenë brengosur për sjelljet e këtilla, sepse duhej të preokupoheshin me këtë grup që jetonte në pafuqi, por i cili, duke lidhur aleancë jo vetëm me të huajt e shkelur, por edhe me sunduesit, ka mund ta rrezikojë ekzistimin e udhëheqjes ekzistuese e të forcohet me hyrjen e njerëzve të dalluar në te.

Në pajtim me këtë, Kuejshitët fuqishëm kanë synuar ta ndalin përhapjen e mëtejme të kësaj lëvizjeje në qytetin e vet. Hashimitët që për shkak të lidhjeve të gjakut e mbronin Pejgamberin kanë qenë pastër të ekskomunikuar (përgjashtuar), për ç'arsye Kurejshitët tjerë kanë vendosur t'i prejnë të gjitha lidhjet tregtare dhe martesore me ta. Thuhet se Hashimitët, pos muajve të bekuar (eshhuri hurum), kanë mbetur tre vjet të izoluar. Gjatë këtyre muajve të jashtëzakonshëm në Arabi pushonin të gjitha përleshjet, në mënyrë që pelegrinët e të gjitha fiseve të mund ta vizitojnë Ka'ben e shenjtë, e cila ka qenë qendër e kultit nacional.

Muhammedi a.s. i shfrytëzonte këto periode, jepej në predikimet fetare ndër anëtarët e fisit të cilët sikur vërshimi mblidheshin në Mekke dhe në panaiet në rrethinën e saj. Por as në këtë nuk pati shumë sukses, sepse axha

e tij Ebu Lehebi hap pas hapi e përcillte dhe me tërë zërin bërtiste:
“Mashtgues, don që me disa rregulla të rrejshme t’u kthejë nga feja e të parëve tuaj. Mos e dëgjoni! Shmangujuni atij! “Pas ksëaj pjesëtarët e fiseve të ndryshme e pritnin me fjalët: “Populli dhe kushërinjt tu të njohin më mirë, përse ata nuk po të besojnë?” Pejgamberi a.s. me shokët dhe kushërinjt e tij aq ka duruar sa që kjo te shumë Kurejshitë ka nxitur dhembisuri, dhe e kanë anuluar këtë ekskomunikim dhe bojkot.

Po këtë vit Pejgamberin a.s. e ka goditur dhe pothuaj në pashpresë e hodhi humbja e shoqes së sinqertë gjatë njëzet vjetëve të tij të jetës martesore, këshilltares dhe ndihmëtares h. Hatixhes. Pak më vonë vdekja e mbrojtësit më të madh e më të përhershëm Ebu Talibit sërish e ekspozoi nënçmimeve dhe sulmeve.

Pejgamberi a.s. i qe nënshtruar nënçmimit të bashkëqytetarëve të vet, ndër të cilët dhjetë vjet, pa ndonjë sukses të madh, ka predikuar, dhe vendosi të kërkojë njerëzit të cilët më lehtë do t’i përvetësojë që ta dëgjojnë dhe

24

vendin i cil do të jetë më i frytshëm për farën e religjionit të ri. Me këtë shpresë u nis për Taif, i cili është larg Mekkes rreth 120 km. Në këtë vend në tubimin e banorëve të tij Pejgamberi, si Pejgamber i Zotit, e shpalli njësinë e Zotit dhe e shpjegoi mësimin e vet, e në kohën e njëjtë ka kërkuar prej tyre mbrojtjen nga ato që e kanë persekutuar në Mekke. Joproporcionaliteti ndërmjet pohimeve të mëdha, të cilat parimisht kanë qenë të pakuptueshme për idhujtarët e Taifit, dhe mjerimit dhe pafuqisë në këtë aspekt ka qenë shkak që e kanë ofenduar dhe me gurë e kanë përzënë nga qyteti. Pas kthimit nga Taifi edhe pak ka pasur gjasa për sukses.

Muhammedi a.s. ka qenë i dëshpëruar për këtë dhe në pozicionin e ngjashëm sikur edhe feshpallësi Nuhi, për të cilin në Kur’an qëndron: “...”.
(Nuh, 5-6).

Pararendësja e emigrimit - hixhretit në Medine

Pejgamberi e kishte bërë zakon çdo vit gjatë kohës së haxhit t’i vizitojë vend tubimet e fiseve të ndryshme arabe e të hyjë me to në bisedë për pyetjet fetare. Disa nga ata me indiferencë e kanë dëgjuar fjalimin e tij, e disa edhe e kanë ofenduar. Por atij i erdhi ngushillimi nga ana e papritur, me fjalë tjera kur u takua me shtatë-tetë njerëz të cilët e njoftuan se vijnë nga Medineja, që mëherët quhej Jethrib. “Nga cili fis jeni?” i pyeti ata. “Nga Hazrexhi”, ishte përgjegjja. E në pyetjen: “Nga ata që janë mikë të Hebraikëve?”, mori përgjigjen: “Po.” “Atëherë a nuk do të uleni pak? Do të doja me ju të bisedojë pak”, iu tha Pejgamberi. Ata u dakorduan dhe u ulën së bashku.

Pastaj u predikoi për islamin dhe u mësoi diç nga Kur’ani. Në këtë mënyrë I Gjithëmadhërishti i shprehi kujdes të jashtëzakonshëm islamit, pasi, derisa sa ata ende ishin në idhujtari, në viset e tyre kanë banuar Hebraikët, të cilëve u qe shpallur Libri dhe të cilët qenë të udhëzuar në urti. Hebraikët nga ata kanë pësuar shumë. Kur lindte kontesti ndërmjet tyre, Hebraikët do t’u thoshin: “Së shpejti do të paraqitet një feshpallës dhe ne do t’u bashkangjitemi, dhe me ta së bashku juve do t’ju shkatërrojmë siç janë

shkatërruar popujt Ad dhe Irem." Dhe deri sa Muhammedi a.s. folte me ta, duke u përpjekur t'i bind në njësinë e Zotit, ata ndërmjet veti u përshpëritën: "Nuk ka dyshim, ky është ai feshpallës që Hebraikët me të na kërcënohen. Ejani që para tyre t'u bashkohemi: Në këtë mënyrë e pranuan islamit dhe iu drejtuan Pejgamberit me fjalët: "Bashkëqytetarët tanë ka herë tmerrshëm rrahen e prehen. A nuk do t'i pajtojë e bashkojë All-Ilahu me udhëzimin dhe ndihmën e mësimin tënd! Në pajtim me këtë, ne do t'i udhëzojmë në fe të vërtetë, dhe atë që tash e pranuan nga ti ata do t'i mësojmë." Kështu me besim të plotë u kthyen në viset e tyre.

Këto janë hollësitë e asaj ndodhie që zënë fill në traditë. Kjo ndodhi paraqet kthesë në pejgamberinë e Muhammedit a.s. Më në fund hasi në 25

njerëzit që ishin të gatshëm t'i pranojnë idetë e tij dhe pejgamberinë e tij për shkak se gjendja e tyre e atëhershme ka qenë në pajtim me atë qëllim të cilit ai i ka shërbyer.^{6*})

Qyteti Jethribi ka herë ka qenë në sundim të Hebraikëve. Ata janë vendosur aty pasi që, për shkak të fatkeqësisë së popullit të vet, e ka mundësi edhe për shkak të dhunës së cilës i qenë nënshtruar gjatë kohës së imperatorit Hadrianit, e kanë lëshuar Palestinën. Pjesëtarët e fisit nomad Avs e Hazrexh, pasi u bënë fqinjë me ta, iu përshtaten Hebraikëve. Më vonë, sa më tepër që rriteshin numerikisht, aq më shumë e grabitnin sundimin nga Hebraikët ashtu që drejtimi i qytetit në fund të shekullit të pestë plotësisht kaloi në duart e tyre.

Disa Arabë kanë pranuar fenë hebraike nga ish zotërinjt e qytetit, ndërsa edhe dija Hebraikë, duke mbetur në shërbim të ngadhnjyesit, aty kanë banuar. Në këtë mënyrë Jethribi, kur Muhammedi a.s. erdhi atje, ka pasur bashkësi mjaft të madhe hebraike, prandaj banorët e atjeshëm qenë të përudhur në ardhjen e Mesiut të ri (Mesihut).

Prandaj, kjo botë ka mundur më lehtë se sa idhujtarët e Mekkes ta kuptojnë kërkesën e Muhammedit a.s. që ta pranojnë për pejgamber të Zotit. Kjo ide për idhujtarët ka qenë krejtësisht e huaj, e veçanërisht ka qenë irituese për Kurejshitët, sepse fati dhe supremacioni i tyre i kësaj bote mbi të gjitha fiset tjera arabe ka rezultuar nga ajo që ata kanë qenë rojtarë trashëgues të putave nacionalë, të depozituara në brendinë e Ka'bes.

Njëkohësisht Jethribin e ka fatkeqësia edhe për shkak të mospajtimeve të gjakut ndërmjet fiseve Hazrexh dhe Avs. Popullata e tij, për shkak të gjendjes së tyre të parregulluar e të paqëndrueshme, ka konsideruar për begati çdo rast i cili do t'i pajtonte grupet e përçara për një të mirë të përgjithshme. Dhe sikur që në mesjetë republikat e Italisë Veriore, që ta vënë baraspeshën ndërmjet partive të përçara dhe që, nëse është e mundur, t'u japin fund kryengritjeve të brendshme që i kanë dëmtuar tregtisë dhe mirëqenies së përgjithshme kanë zgjedhur të huajt në vendet drejtuese në qytete, kështu edhe Jethribasit pa kurrfarë dyshimi e kanë pranuar ardhjen e të huajve në vendin e tyre.

Që Muhammedi a.s. është pritur me aq entuziazëm në Medine shkaku

është ky: sipas botëkuptimit të shumicës si popullatës së saj, pranimi i islamit për fe personale ka qenë mënyrë se si t'i evitojë mundimet që i duron rendi i tyre shoqëror. Sipas mendimit të tyre, islami me principet e veta jetësore dhe me fuqinë, e cila është supra të gjitha intereseve personale, ka qenë në gjendje t'i kyq e disa ligje të caktuara të disiplinës.⁷ Këto fakte mjaftojnë që të na shpjegojnë se si Muhammedi a.s. pas tetë vjet sipas Hixhretit është në krye të forcës prej 10.000 njerëzve ka mundur të hyjë në Mekke, deri sa angazhimi i tij dhjetëvjeçar në të rezultoi me rezultate të dobëta.

26

Ndonëse Hazrexhitët e posakthyer i ofruan Muhammedit a.s. që të shkojë me to tok në në Jethrib, ai nga kjo i kthei, deri sa nuk pajtohen me fisin Avs. "Ne këtë të lutemi", i thanë ata. "Kur të kthehemi te të tonët, nëse Zoti don të na pajtoje", ne sërish do të vijmë dhe për këtë arsye ta caktojmë mbledhjen gjatë kohës së haxhit tjetër". Duke u kthyer në vendlindje të vet, kërkuan nga bashkëqytetarët e vet që edhe ato ta pranojnë fenë e re. Shumë prej tyre edhe e pranuan. Aq u bë i famshëm Pejgamberi a.s. në Medine sa që nuk kishte familje ku nuk përmendej emri i tij.

Në vendin që e ka caktuar Muhammedi a.s., kur u bë sezoni i haxhit, u takua deputacioni prej dhjetë Hazrexhitëve e dy Avsitëve me Pejgamberin dhe ka dhënë fjalën se do t'i nënshtrohen udhëzimeve të tij. Kjo quhet "**Marrëveshja e parë në Akabe**", e cila u quajt sipas vendit në të cilin fshehtas janë takuar. Kyfjalim është: "Nuk do të adhurojmë tjetër përveç Zotit. Nuk do të vjedhim. Nuk do të bëjmë prostitucion. Nuk do t'i mbysim fëmijët tanë. Do t'i shmangemi shpifjes. Në gjërat e arsyeshme do t'i nënshtrohemi urdhëresave të Pejgamberit." Pastaj këta të dhjetët janë kthyer në Jethrib si misionarë islamë. Trolli qe përgatitur. Ata me aq zell e kanë kryer detyrën e vet sa që feja e re prej shtëpisë në shtëpi, prej fisit në fisë shpejtë përhapej.

Gjatë kthimit të tyre iu bashkagjitë Mus'ab b. Umejri, e sipas një versionit atë e dërgoi Muhammedi a.s. Ky njeri i ri, i cili qe ndër të kthyerit e parë, porsa u kthye nga Abesinia. Ka pasur mjaft përvojë sepse jo vetëm që leksionët që i ka pranuar gjatë kohës së dhunës së të flliqurve e kanë forcuar në zellshmëri, por njëkohësisht ka mësuar se si do ta pengojë dhunën dhe si do të veprojë me ata që bëjnë të dyshimtë dhe e njollosin islamin, e nga të cilët nuk ka shpresë se do ta njoftojnë esencën e tij. Për këtë arsye Muhammedi a.s. ka mundur me siguri të plotë t'ia besojë këtij personaliteti detyrat e rënda siç janë edukimi dhe aftësimi i të kthyerve të rinj dhe kujdesi që fara e mbjellur e entuziazmit fetar dhe devotshmërisë të jep fryte. Mus'abi u vendos në Medine në shtëpinë e Es'ab b. Zuraretit. Duke i tubuar të kthyerit nganjëherë këtu e nganjëherë në anën tjetër të qytetit ku banonte familja e Abdul-Eshhelit në shtëpinë që i takonte familjes së Benu Dhuhr, ua mësonte namazin (lutjen) dhe Kur'anin.

Kryeparët e atëhershëm të familjes së Abdul-Eshhelit qenë Sa'd b.

Mu'adhi dhe Usejd b. Hudajri. Një ditë rastësisht Sa'd b. Muadhi e gjeti

Mus'abin së bashku me Es'adin n'ështëpinë e fisit Benu Zuhr, ku i mësonte të kthyerit. Sa'di që të dijë se ku gjinden ata, hyri brenda. Pastaj iu drejtua Usejd b. Hudajrit: "Largoji këta vagabondë. Këa vijnë këtu, dhe në shtëpitë tona na konsiderojnë për budallenjë. Sikur ndërmjet meje dhe Es'adit mos të kishte afërsi, e cila nuk më lejon që t'i bëjë diç të keqe, unë do të kurseja nga ky angazhim". Es'adi ishte djali i Sa'dit. Në këto fjalë Ibn Hudajri e morri naxhakun e vet dhe u drejtua atje ku gjendeshin Es'adi dhe Mus'abi.

27

"Ç'bëni këtu? Marroç, don t'i mashtron në humbje? Nëse e don jetën, ik nga këtu", murmuroi ai. Në këto fjalë qetësisht iu përgjegy Mus'abi: "Ulu pak e dëgjo. Çka të dëgjosh, nëse të kënaq, pranoje, e nëse jo, t'i hedhe", ibn Hudajri, duke e ngulitur naxhakun, u ulë dhe filloi të dëgjojë se si Mus'abi i komendon parimet themelore të islamit dhe i citon ajetet (citatet) nga Kur'ani. Diç më vonë, pasi që kjo e mallëngjeu, ka thënë: "Ç'duhet të bëjë e që të hyjë në këtë fe? Pastroje trupin tënd me ujë dhe deklaro se nuk ka zot tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është Pejgamber i Tij", iu përgjegy Mus'abi. Ibn Hudajri menjëherë veproi sipas udhëzimit dhe disa herë cekti kelimeit-shehadetin. Pas meje ka edhe një person të cilin duhet bindur. Nëse ai bindet, të gjithë të tjerët për tij do të shkojnë. Tash do t'ua dërgojë", i tha këto fjalë me të cilat aludoi në Muadh ibn Hudajrin dhe shkoi.

Pasi që Ibn Hudajri me këto fjalë u nda, pak më vonë erdhi edhe Sa'd b.

Mu'adhi. I zemëruar në Es'adin që u ka ofruar mbështetje misionarëve islam, hyri brenda. Mus'abi e ka lutur që mos ta njollosë fenë e re para se të dëgjojë e kuptojë. Ai këtë lutje ia pranoi. Pas kësaj fjalët e Mus'abit aq kanë ndikuar në të sa u bind dhe u bë musliman. Me entuziazëm të zjarrtë iu kthye të vetëve dhe iu drejtua: "O fëmijët e Abdu-l-Eshhelit, ç'jam unë për ju?" Në këtë ata iu përgjigjen: "Ti je zotëriu ynë; ti ndër ne je më i ndershmi dhe më dinjitari." "Kur është kështu, nuk dua të flasë me asnjë nga ju deri sa nuk beson në të Gjithlartësuarin dhe në Pejgamberin e Tij Muhammedin", ua tërhoqi vërejtjen Sa'di. Nga ajo ditë fëmijët e Abdu-l-Eshhelit kanë qenë muslimanë."8

Është çështje e propagandës fetare që të udhëhiqet me aq entuziazëm dhe sinqeritet që gjatë vitit nuk ka pasur asnjë familje që uk ka dhënë për rritjen e islamit nga ndonjë anëtar. Përrjashtim i vetëm ka qenë një degë e fisit Benu Avs, e cila ka qenë nën ndikimin e poetit Ebu Kajs el-Eslatit.

Vitin tjetër, kur erdhi koha e haxhit, iu bashkangjitë aradha prej 70 të kthyerve bashkëqytetarëve të tyre që shkonin nga Jethribi në Mekke. Këta kanë shkuar që të betohen se Muhammedin a.s. si udhëheqës dhe Pejgamber të Zotit do ta ndjekin. Po ashtu iu është urdhëruar që t'i propozojnë që nga shqetësimet e armiqëve të tij të strehohet në Medine. Ndër ta ishin edhe të kthyerit të parë që janë takuar me Pejgamberin a.s. haxhin e kaluar, në krye me mësuesin e tyre Mus'abin. Posa arriti atje, Mus'abi nxitoi te Pejgamberi që ta njoftojë për suksesin e misionit të tij. Kur nëna e tij mësoi se ka ardhur në Mekke, i porositi: "Bir i panështruar, po vjen në një vend ku të banon nëna, e nuk dëshiron ta vizitosh." Në këtë Mus'abi u përgjegy: "Ashtu është!

Para Pejgamberit a.s. nuk do ta vizitojë askend." Pas bisedës me të Dërguarin, shkoi ta shoh nënën, e ajo e priti me këto fjalë: "Vallë duhet barabartë të të konsideroj për heretik?" E i biri: "Unë ndjek Pejgamberin e Zotit: besoj në fenë e vërtetë". "Pas rrugës në Abesini, apo pajtohesh me jetën e rrugaçit në Jethrib?" - e pyeti e ëma. Pas kësaj Mus'abi që i sigurtë se 28

e ëma do t'ia dorëzojë armiqëve, dhe shtoi: "Ç'do të thotë kjo? A don ti një njeri me dhunë ta ktheshë nga feja e tij? Nëse dëshiron të më mbyllish në burg, jij e bindur se do ta mbysë të parin që afrohet të më kap." "Shporru nga unë"! Me këto fjalë nëna e tij filloi të qajë. Pasi kjo e preki Mus'abin, i propozoi: "Nëna ime, për hirë të dashurisë të madhe ndaj teje, të ta jap një shembull: deklaro se nuk ka zot tjetër pos All-Ilahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij". "Me hyrjen në fenë tënde nuk dua të bëhem budallaqe. Nuk dua të kam punë as me ty as me punët tua. Unë mbetem e paluahatshme në fenë time", me këto fjalë nëna e tij e ndërpreu bisedën. Që mos ta shkaktojnë dyshimin te Kuejshitët, që mos t'i ekspozohen rrezikut të tyre, sërish kanë caktuar mbledhjen e fshehtë në Akabe, në endin e njëjtë në të cilin janë takuar të kthyerit vitin e kaluar. Pejgamberi a.s. në prani të axhës Abbasit ka ardhur atje. Vërtet, Abbasi atëherë ende ka qenë idhujtar, por megjithatë në këtë takim të fshehtë e kanë pranuar. Abbasi e hapi mbledhjen me ceremoni të veçantë dhe e prezantoi djalin e vëllaut si djalin më fisnik të fisit të cilit i takon. Ndonëse Abbasi i ka refuzuar udhëzimet e Pejgamberit, megjithatë nuk ia munguar mbrojtjen e tij. Pasi që tashmë flitej se Muhammedi a.s. do të strehohet te banorët e Jethribit Abbasi ua sqaroi se ai do të jetë si emanet tek ata dhe, para se ta pranojnë, le të mendojnë për detyrat që me atë rast bien mbi ta, dhe se do t'u mbahen premtimeve, e në rast se nuk do ta mbajnë fjalën e dhënë, se përgjegjësia bie mbi ta. Pas kësaj Berra b. Ma'rus nga fisi Hazrexh tha se ata kanë konkluduar ta mbrojnë Pejgamberin dhe e luti që të deklaroj e shpjegoj ç'dëshiron.

Muhammedi a.s. e filloi fjalimin e tij nga Kur'ani dhe u këshilloi që t'i jenë lojal fesë që e pranuan në praninë e Pejgamberit të All-Ilahut. Pastaj kërkoi prej tyre që atë dhe shokët e tij t'i mbrojnë siç i mbrojnë gratë dhe fëmijët e tyre. Në këtë Berra b. Ma'rusi ka thënë: "Betohem në Ato, i cili si pejgamber të ka dërguar dhe i cili nëpërmjet teje të vërtetën na thotë, se do të mbrojmë ashtu si e mbrojmë vetëveten. Ty do të ndjekim si kryepar tonin. Ne jemi fëmijë të shtizës e shpatës dhe këtë nga të parët tanë si fëmijë të ndershëm e kemi trashëgaur." Në këtë mënyrë të gjithë, duke e kapur Pejgamberin për dorë, ia dhanë besën.

Posa mësuan Kurejshitët për këtë mbledhje të fshehtë, filluan sërish t'i keqtrajtojnë muslimanët. Muhammedi a.s. vetëm tash iu preferonte muslimanëve ta lëshojnë qytetin duke iu thënë: "Shkoni në Jethrib! I Gjithëmadhërishmi atje ju ka dhënë shumë vëllezër, atje do të gjeni vend ku do të strehoheni". Prej atëherë ata nga një, nga dy pa u hetuar e kanë lëshuar Mekken dhe shkonin në Jethrib. Bashkëbesimtarët e tyre të atëhershëm kanë

garuar që të kenë nderin që t'i pranojnë e t'i furnizojnë me gjësende. Në këtë mënyrë masa muslimane prej 200 njerëzve gjatë dy muajve u largua atje dhe u shpëtua. Vetëm të mbyllurve dhe të ndalurve nuk iu dha rasti. Ndër ta ishte 29

njëfarë me emrin Suhejb, për të cilin Muhammedi a.s. ka thenë se është "fryti më i mirë i Grekëve" (Bizantinëve). Për të flitet se ka qenë ësllav grek, e pasi që zotëriu i tij e liroi, filloi të merret me tregti dhe u bë mjaft i pasur. Kur dëshironte të shpërngulej, Mekkasit kanë thënë: "Ti ndër ne ke ardhur nevojtar e i varfër. Në mesin tonë deri në këtë shkallë e ke shtyrë kapitalin tënd, e tash nuk don të shkohësh vetë, por don ta marrësh edhe pasurinë e grumbulluar. Kjo është e pamundur." Në këtë Suhejli ua shtroi një pyetje: "Nëse unë ua lë tërë këtë pasuri, a do të më lëshoni që papengesë të shkoj?" Mekkasit pranuan dhe ai shkoi. Kur kjo ndodhi iu rrëfye Pejgamberit, kaa thënë: "Suhejli ka bërë tregti të majme".

Pa dyshim, Muhammedi a.s. e ka shtyrë emigrimin e tij që shkuarja e shokëve të tij mos të nxisë dyshim dhe këtë deri atëherë sa nuk është njoftuar se qëndrimi i mëtejshëm në Mekke e rrezikon jetën dhe se është planifikuar atentat ndaj tij. Më në fund në këtë vërejtje edhe ai e përgatiti se si do të shpëtojë dhe u largua.

Qyteti Jethribi, që prej atëherë quhet "Medinetu-n-nebi", ende nuk kishte faltore muslimane. Posa arriti atje Muhammedi a.s., punën më të rëndësishme e ka pasur ta ndërtojë xhaminë për lutje të përbashkëta, e edhe për kuvendime. Deri atëherë muslimanët tuboheshin në banesën herë të një personi e herë të tjetri. Sigurisht për shkak që t'i përvetësojnë Hebraikët, në fillim gjatë namazit janë drejtuar me fytyrë drejt Jerusalemit. Muhammedi a.s. në shumë mënyra është orvatur t'i kënaqë Hebraikët, ka dëftuar në librat e tyre të shenjta, ka siguruar lirinë e besimit dhe barazinë politike, por këto përpjekjet e tij të afrimit kanë hasur te Hebraikët në ironi e përbuzje. Pasi ishte e kot të shpresohet në afrim me Hebraikët dhe pasi ishte e qartë se ata do të jenë kundërshtarë të pejgamberisë së tij, Pejgamberi iu shpalli ithtarëve të vet që gjatë namazit duhet të drejtohen drejt Ka'bes dhe ka cituar me këtë rast ajetin e shpallur.9 (II, 144). Ky ndryshim është shumë më i madh se sa që duket në shikim të parë. Dhe realisht, kjo gjendje ka qenë fillim i jetës së një populli. Ka'ba, e cila ishte vend i pelegrinazhit të të gjitha fiseve arabe ende deri sa kanë munguar të dhënat historike, sërish u bë qendër e muslimanëve. Për çdo muslimanë, i cili është në gjendje ta kryej këtë pelegrinazhë së paku njëherë në jetë, kjo është bërë detyrë fetare.

Islami - fe universale

Në Kur'an ka shumë citate që e përbëjnë esencën e ndiesisë së një populli, që na shpjegon esencën e karakteristikës e cila i është dhënë popullit arab: që Shpallja e shenjtë të shpallet në gjuhën e tij dhe nëpërmjet njeriut nga ai popull. Ja disa nga ato citate:

"...". (Ez-Zuhruf, 3)

"...". (Esh-Shura, 7)

"...". (Fussilet, 44)

Islami nuk i është shpallur vetëm Arabëve. 10 Pasi Zoti është një, duhet unjësuar tërë njerëzinë në këtë fe. Se islami do të jetë fe universale dhe se vendimet e tij do të aplikohen mbi të gjithë popujt, esencën për këtë na dëftojnë mesazhet të cilat Muhammedi a.s., si thuhet, në vitin 668 (vitin e 6 Hixhrij) ia ka dërguar pushtetmbajtësve dhe sovranëve të kohës së vet. Tregohet se shkresa, që atë vit ia dërgoi imperatorit Herakliusit (Iraklios), sovranit të Persisë dhe mëkëmbësve të Jemenit dhe Egjiptit, është shkruar në këtë kuptim:

"Në emër të Zotit... imperatorit Romak. Paqa u qoftë atyre që ndjekin rrugën e vërtetë. Pas asaj që kemi për detyrë... ju thërras në islam. Pranone e i Gjithëlartësuarit dyfishë do t'ju shpërblejë. Nëse ju ngurreni në këtë afertë, mëkatet e popullit tuaj do të bien në qafën tuaj. O kitabi (njerëzit që besojnë në librat e shpallura prej Zotit), hyni në fe, e cila është më e mirë edhe për ju edhe për ne, e kjo është: të besosh vetëm në All-llahun dhe mos t'i shoqërosh në hyjni askend, jashtë Tij tjetër kush mos të quhet All-llah. O kitabi! Kini kujdes dhe mos u ngurroni. Ne jemi muslimanë dhe fenë tonë e quajmë islam...".

Sado që kjo thirrje atëherë ka nxitur habi tek ata që e kanë pranuar, megjithatë koha ku dëftuar se nuk është shkruar ashtu nga dëshira e shkretë. 11 Pas këtyre esazheve, të cilat shprehimisht shpjegojnë pretendimet e islamit në universalitet, edhe këta citate nga Kur'ani këtë e argumentojnë:

"..." (Jasim, 69-70).

"..." (El-Enbija, 106).

"..." (El-Furkan, 1)

"..." (Sebe, 28)

"..." (Saff, 9).

Krahas citateve të cekura në të cilat kërkohet që tërë njerëzia ta pranojë islamin, dëftohet edhe ajo që Muhammedi a.s. e ka thënë për Bilalin, se është "fryti më i mirë i Abesinisë", e për Suhejllin se është "fryti më i mirë i Greqisë" si aluzion i veçant i Pejgamberit në këtë. Robi persian Selman Farisiu, i cili ka qenë i krishterë, pasi që vitin e parë sipas Hixhretit u kthye në islam, është quajtur "fryti më i mirë i Persisë".

Ja kështu, qysh para se është marrë si metodë e pushtimit, Pejgamberi shprehimisht është përcaktuar që islami nuk do të mbetet i rrethuar vetëm në popullin arab. Është me rëndësi të ceket si predikohet se janë dërguar lajmëtarët me qëllim që t'ua shpallin islamin të gjithë popujve. "Nesër herët më eni të gjithë", kështu u ka bërë vërejtje Pejgamberi i Zotit shokëve të vet. Pas namazit të sabahut dhe madhërrimit të rëndomtë të Zotit, duke u kthyer me fytyrë kah ata, e dërgoi njërin në një anë, e tjetrin në anën tjetër. "Behuni të drejtë në veprimet tuaja me robët e Zotit, sepse Zoti do t'i mbyllë dyrt e xhennetit para atij që nuk sillet drejt në punët që i janë besuar, e të cilat kanë 31

të bëjnë me njerëzinë. Mos u bëni si shokët e Isaut, të birit të Merjemes (Jezusit), sepse ata u shkonin vetëm të afërmve, kurse të largët it i kanë

mospërfillur", iu tha me atë rast Pejgamberi. Për të deleguar që Muhammedi a.s. i ka dërguar kanë qenë të zgjedhur ata që kanë zotëruar me gjuhën e popullit të cilit i janë dërguar. Kur Pejgamberit ia cekën këtë gjë, ai u ka thënë: "Kjo është, për shkak të punëve të njerëzve, një detyrë e madhe ndaj Zotit."12

Kërkesa e islamit për univiersalitet dhe të bëhet fe e të gjithë popujve zë fill në atë që ai sipas fuqisë së vet të shenjtë i është i destinuar të gjithë njerëzve dhe që është i shpallur nëpërmjet Pejgamberit të Zotit të fundit Muhammedit a.s. sikur që në kohët e shkuara edhe pejgamberët tjerë të Zotit kanë pranuar Shpalljen. Këtë e dëftojnë citatat vijuese nga Kur'ani.

"..." (Junus, 19).

"..." (El-Bekare, 213).

"..." (En-Nisa, 125).

Muhammedi a.s. - themelues i sistemit shoqëroro-politik

Të kthehemi sërish në kohën deri sa Muhammedi a.s. ishte në Medine.

Që të mundemi si duhet të vlerësojmë pozicionin e tij pas emigrimit

hixhretit), fakt me rëndësi është të përmendim rrethonat e veçanta të gjendjes

sociale të Arabëve - nëse asgjë së paku gjendjen sociale të siujdhesës Arabe,

e cila varej nga këto vise. Organizimi i judikaturës dhe administrimit, të cilat

janë në raport të ngushtë me pikëpamjet tona të reja të nocionit të shtetit, atje

plotësisht kanë munguar. Çdo fis ka prezentuar individualitet të veçant dhe

plotësisht të pavarur. Kjo pavarësi shtrihej edhe në çdo pjesëtarë të një fisi.

Secili prej tyre ka pranuar komandimin e kryeparit të vet vetëm për atë shkak

sepse ai ka qenë komentues dhe përfaqësues i mendimit të përgjithshëm, në

të cilin edhe ai ka qenë pjesëmarrës, por megjithatë shpesh e ka shkelur

vendimin unanim të fisit të vet. Njëkohësisht edhe zgjedhja e kryeparit nuk

ndodhte sipas një rregulli të përhershëm, por vetëm duhet të ishte në fisin

prej familjes më të pasur e më të fortë anëtarë më i vjetër, i cili personalisht

më së shumti e siguronte autoritetin e vet. Në rast se fisi numerikisht rritej,

degëzoheshin në degë të shumta. Çdo degë veçan dhe mëvetshëm ekzistonte,

vetëm bashkoheshin me rastin e mbrojtjes së përbashkët ose me rastin e

ndonjë fushate të jashtëzakonshme luftarake. Ja në këtë mënyrë e kuptojmë

se si është sendërtuar e Muhammedi a.s. - në krye të masës së të gjithë

ithtarëve, të cilët në të shikonin liderin dhe prijatarin e vet, e të cilët gjithnjë

e më shumë shumëzoheshin - u vendos në Medine, e që kjo vendosje e tij

mos të zgjojë ndjenjën e pakëndshmërisë as të dalë kundër pushtetit

ekzistues, siç ndodhte kjo në qytetet e Greqisë së vjetër dhe në rastet e

ngjashme me këto, ku pushteti themelor është në mjedisin tjetër shoqëror. Në

32

këtë mënyrë Muhammedi a.s. ndaj ithtarëve të tij kishte fuqinë materiale, të

ngjashme me atë që e kanë muslimanët në vend të lidhjeve farefisnore është

vënë lidhja fetare. Prandaj islami, së paku teoretikisht, ka marrë parimin që

është edhe fetar edhe politik, dhe kështu ka mbetur gjithnjë.

Një dijetar thotë: "Muhammedi ka dëshiruar ta themelojë një fe, që i

shkoi për dore. Por në të njëjtën kohë ka vënë me karakteristikë të re parim

politik. Në fillim dëshira e tij e vetme ka qenë që boshkëqytetarët e tij t'i fusë në monoteizëm, por me këtë së bashku e ka shkatërruar në vendin e vet të lindjes rendin e vjetër drejtues, në vend të sundimit të vjetër feudal, ka themeluar teokratinë me vetëveten si pejgamber të Zotit në krye."

Përhapja e islamit pas Hixhretit në Medine

Para vdekjes së Pejgamberit pothuaj të gjitha viset e Arabisë e kanë ndjekur. Ajo Arabi, që deri atëherë kurrë nuk i është nënshtruar një sovranit, për një çast dëftoi unitetin e vet politik dhe këtij udhëheqësi absolut ia dha fjalën. Me qindra fise sa më të vogla e sa më të mëdha, të cilat kanë jetuar në antagonizëm të vazhdueshëm, u bashkuan në fjalët e Muhammedit a.s. dhe u bënë popull unik. Nën drejtimin e kryeparit të përbashkët në suaza të fesë së përbashkët i lidhi ai fiset e përçara njëra me tjetrën në formë të organizmit politik ashtu që kjo na zbulon në mënyrë të mrekullueshme disa veçori të tij të veçanta. Ja kësi rezultati ka mund të jep ideja e madhe, e kjo në Arabinë idhujtare është principi i jetës popullore. Puna e madhe pati sukses. Dhe kur Muhammedi a.s. vdiq, në pjesën më të madhe të Arabisë ka mbretëruar njëfarë qetësie hyjnore, i cili deri atëherë ka qenë plotësisht i panjohur për Arabët, lakmia e të cilëve për grabitje, luftime e hakmarrje ka qenë e njohur. Ajo që e krijoi këtë disponim, ky është islami.¹³

Madje edhe me rastin e vdekjes e drejta e farefisit është mënjanuar, kurse "vëllezëria" ka trashëguar pasurinë në tërësi të vëllaut të vdekur. Pas betejës në Bedr, pasi që ndër ithtarët e Muhammedit a.s. u ndie tepërsia e kësaj lidhjeje artificiale, ajo u anulua. Nuk ka dyshim se ka pasur nevojë për një rregullim të këtillë deri sa ende numri i muslimanëve ka qenë i vogël dhe derisa jeta individuale e islamit ka qenë diç e re. Përveç kësaj, Muhammedi a.s. - para se zbatimi i këtij rregullimi shoqëror "komunist", për shkak të rritjes së ithtarëve të tij, u bë pathuaj i pamundur - edhe një kohë të shkurtër ka jetuar në Medine.

Gjithësesi ishte të shpresohet se rrita e shkallërishtme e masës politike, e cila përbëhej prej nacionalistëve mekkasë dhe e cila u vendos në qytet, e keqe principiele të disponuar ndaj Kurejshitëve, do të lind më në fund me autogenizëm. Dhe si është e njohur, veprat e atyre, që kanë shkruar mbi biografinë e Muhammedit a.s., shumica janë të përmbushura me këto përleshje të vogla të muslimanëve dhe Kurejshitëve mekkas. Ky

33

autagonizëm bëri që muslimanët më 630 (më 9 sipas Hixhretit) triumfalisht të hyjnë në Mekke dhe se deri në vdekjen e Muhammedit a.s. më 632/12 sipas H.) kanë qenë në gjendje lufte me shumë fise.

Të përshkruhen hollësisht këto konflikte nuk është në program të kësaj vepre, vetëm është gjë me rëndësi të drejtohet se Muhammedi a.s., si besojnë disa, nuk është fanatik i transformuar, i cili, më shumë se sa si misionar, në krye të luftës së armatosur të ithtarëve të vet me shpatë në dorë është përpjekur ta imponojë fenë e vet secilit që e takon.¹⁴

Shpesh shkrimtari evropian pohon se Muhammedi a.s. është dëftuar me natyrë tjetër, prej kur u shpërngul në Medine dhe prej kur rrethanat e

atjeshme jetësore filluan të ndërrohen. Sipas këtyre shkrimtarëve, më nuk ka qenë këshilltar, peygamber i Zotit dhe predikues, që përpiqet ta bind njerëzinë se fe e mirëfilltë është ajo me të cilën është frymëzuar, por përkundrazi është treguar si fanatik guximtar i cili e shfrytëzoi fuqinë me të cilën dispononte dhe të gjitha mjetet drejtuese që t'i sendërtojë idetë e veta. Është gabim të supozohet se Muhammedi a.s., duke qëndruar në Medine, e la detyrën e misionarit të islamit dhe shpallësit të fesë, ose se ka pushuar t'i thrrasë mosbesimtarët kur e mori në disponim ushtrinë. Ibn Sa'di thekson se muhammedi a.s. ka dërguar nga Medineja mesazhe të ngjashme me ato që dikur ua patë dërguar sunduesëve t'ëhuaj, e në të cilat i ka ftuar në fe. Se iu ka dërguar kryeparëve të fiseve arabe, do të shihet nga faqet vijuese të këtij libri. Përveç emisarëve ka dërguar edhe predikues atyre fiseve që nuk ishin kthyer. Edhe në ato raste kur këta predikues nuk kishin sukses, kurrë nuk është shërbyer me mejte detyruese, që dëshmon se orvatja e tij në këtë pikëpamje ka pasur karakteristika më të sinqerta të misionaritetit. Vitin e katërt të Hixhretit mossuksesit i ekspeditës misionariste të dërguar fisit Benu Umejr b. Sasa-i paraqet shembull të veçant për këtë. Udhëheqësi i këtij fisi e vizitoi Muhammedin a.s. në Medine dhe i dëgjoi predikimet e tij, por megjithatë nuk kaloi në islam, ndonëse ka marrë qëndrim miqësor ndaj islamit e madje ka kërkuar prej Muhammedit a.s. t'i dërgojë disa njerëz në Nexhd për të predikuar. Në këtë Muhammedi a.s. si ekspedicion ka dërguar atje dyzet djelmosha, shumica nga Medineja, që ishin të shkathtë në leximin e Kur'anit dhe të cilët, duke i vizituar ligjëratat e natës, kanë mësuar të falin, por përkundër garancionit të dhënë nga ana e liderit të këtij fisi Ebu Berrit, tinëzisht janë mbytur, dhe vetëm tre prej tyre kanë shpëtuar dhe janë kthyer.¹⁵

Megjithatë suksesi i armës islame çdo ditë, duke i tërhequr shumë sosh, e ka rritur numrin e ithtarëve të Pejgamberit, e sidomos ndër fiset të banuara në rrethinën e Medinës. "Deputacionet, që vinin nga fiset e ndryshme, kur kanë parë sjelljen e tij të butë me ta, kujdesin e tij ndaj dhembjeve të tyre, largpamësinë e tij që e ka dëftuar në zgjidhjen e kontesteve të tyre, politikën e tij të mençur në shqiptimin e denimit, ia ka siguruar atë miratimin e tyre të 34

përgjithshëm, dhe kjo ka qenë shkak që si sundues të madhërishtëm lavdia t'i përcillet nëpër tërë siudhesën Arabe."¹⁶

Nuk ka ndodhur rrallë që anëtarët e disa fiseve, individualisht ose disa prej tyre, të vijnë në Medine ta shohin Muhammedin a.s. dhe, pasi që e shihnin, të kthehen në cilësi të misionarëve islamë vëllezërve të vet fisnor që edhe ata t'i kthejnë. Si shembull për këtë lloj të kthimit do ta cekim ndodhinë vijuese.

Demam b. Selebe nga fisi Benu Sa'd i është dërguar Pejgamberit si i deleguar i fisit të vet. Kur arriti atje, zbriti nga deveja para xhamisë dhe ia lidhi këmbët. Pastaj hyri në xhami, në të cilën ishte Pejgamberi me shoqërinë e vet. Kur iu afrua krejtësisht, i pyeti: "Kush është ndër ju fëmija i Abdullahut?" Në këtë Muhammedi a.s. u përgjegj se ai është ky. "Njëmend,

a ti je Muhammedi?" "Po", mori përgjigjen. "Nëse nuk e konsideroni të papërshtatshme, unë do t'ju pyes edhe shumë sosh. Betohu në të Adhuruarin tënd dhe ata që janë pranë teje dhe ata që do t'ju bashkangjiten më vonë, a të ka dërguar Zoti neve si të dërguarin e vet", i tha Demani. "Për Zotin, po", mori përgjigjen. "Po ashtu betohu a të ka dërguar Zoti urdhëresë, që ta adhurojmë vetëm Ate, që pjesëmarrës në hyjmi mos T'i vëmë dhe mos t'i adhurojmë putat, që të parët tonë i kanë adhuruar." Ju përgjegj: "Për Zotin, po". Pastaj ky njeri ka pyetur ende për institucionet islame siç janë namazi e agjërimi, dhe më në fund ka thënë: "Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos Allllahut dhe se Muhammedi I është peygamber. Detyrat islame do t'i plotësojë, e nga gjërat e ndaluara do të shmangem, e jashtë këtyre as që do të shtoj diç, as do të mungoj diç." Pasi i përshëndeti, iu kthye deves, të cilën e liroi dhe iu kthye fisit të vet.

Duke i tubuar anëtarët e fisit të vet, iu drejtua me këto fjalë: "Besimi në putat Lat e Uzfaat është i shtrembër." Posa e tha këtë, të pranishmit i bërtitën: "Heshtë, që lepra dhe çmenduria mos të të kapin? Me këtë dashtën t'ia bëjnë me dije se mundet t'i ndodh fatkeqësia, që bëri mëkat me mosbesim ndaj zotërave. Ai në këtë iu tha: "Turp ju qoftë! Për Zotin, këta puta as mund t'ju vyejnë as t'ju dëmtojnë, sepse Zoti e ka dërguar një peygamber me Librin që nga mashtrimi t'ju nxjerrë. Betohem se ka Zot, se nuk ka zot tjetër pos Tij, se Muhammedi është shërbëtor i Tij dhe peygamber i Tij. Ju kam sjellë lajme për atë ç'është e ndaluar për ju dhe ç'jeni të urdhëruar." Rrëfjet se atë natë në llogarin e tyre nuk ka mbetur as mashkull as femër e që nuk e ka pranuar islamin.¹⁷

Amr b. Murre, i cili i përkiste fisit Benu Xhuhejne, të banuar në vendet ndërmjet Medines dhe bregut të detit të Kuq, është një prej këtyre misionarëve. Ky personalitet që para Hixhretit u kthye në islam, në vitin e pestë të Hixhretit i ka dhënë këto të dhëna: "Kam qenë rojtar i tempullit të një puti, që që ne e adhuronim. Kur dëgjova për shfaqjen e Peygamberit, e kam copëtuar këtë put. Pastaj shkova te Muhammedi a.s. dhe, duke e pranuar

35
peygamberinë e tij, e përqafova islamin. Kam besuar në atë që Muhammedi ka urdhëruar dhe ndaluar, që tregojnë këto dy strofat e mia: "Dëshmoj se Zoti është i vërtetë. Unë jam prej të parëve që i lënë putat e sajuar prej gurit. Duke e mbështjellur rreth vetes çemerin tim, kam kaluar kodra e fusha ty të të vij. Vetën, i cili jam i ndershëm edhe sipas fisit edhe sipas vetes, e lidhi për Muhammedin, i cili është peygamber i Zotit të lartësuar, fuqia e të cilit është mbi retë". Amrin Muhammedi a.s. ia dërgoi fisit Xhuhejne që ta predikojë islamin ndër ta. Orvatja e këtij misionari është kurorëzuar me aq sukses sa të gjithë e kanë pranuar islamin përveç një të vetmit person nga fisi i tij që nuk pranonte udhëzime e këshilla fare.¹⁸

Kontraat për arpushim në Hubejbij (viti i 6 sipas Hixhretit) ka mundësuar marrëdhënie miqësore me banorët e Mekkes. Për këtë arsye shumë banorë të saj, kur dëgjuan për predikimet e Muhammedit a.s., erdhën madje deri në Medine ta pranojnë islamin.

Për shkak të luftërave të përhershme me banorët e Mekkes, viset në jug prej saj qenë jashtë ndikimit të fesë së re, por pas këti armpushimi edhe pjesa jugore e Arabisë ka mund të vijë në kontakt me islamin, dhe një grup nga fisi Benu Devs erdhi nga malet, që e përbëjnë kufirin verior të Jemenit, dhe iu bashkua Pejgamberit. Për më tepër, para paraqitjes së Muhammedit a.s. në këtë fis ka pasur njerëz që nga larg i kanë vërejtur rrezet e një feje më të lartësuar se që është idhujtaria, e cila që rrënjosur ndër ta. Ndërmjet veti kanë polemizuar kush është Ai. Posa u paraqit Muhammedi a.s. si pejgamber i këtij Krijuesi, njëri, me emrin Tufejl b. Amr, u nisë në Mekke të mësojë kush është Krijues.

Kurejshitet vërtet u lëshuan në bisedë me Muhammedin a.s. e pasi ishin të vetëdijshëm se ai do të ndikojë mjaft në Tufejlin, ia tërhoqën vërejtjen. Por Tufejli, duke e parë një ditë Pejgamberin e ndershëm të prekupuar me namaz rreth Ka'bes, por kumdrimit të vëmendshëm, e ka përcjellur deri në shtëpi. Kur kanë hyrë në shtëpi, Muhammedi a.s. ia shpjegoi institucionet e islamit. Ai u kthye prej Mekkes i entuziazmuar me fenë e re. Pas kthimit në vendlindjen e vet, edhe pse arriti të kthejë babain dhe gruan e vet, megjithatë ka parë se fiset e tij nuk do ta lëshojnë fenë e vjetër në idole. Duke ra për shkak të mospjesëtimin të vet në dëshprim, iu kthye Pejgamberit dhe e luti atë që të kërkojë mallkimin e Zotit në fisin Benu Devs. Muhammedi a.s. i ndershëm, që ta këndellë në orvatjen e tij, e përcolli me këto fjalë: "Ktheju popullit tënd dhe sërish thirri, por me ta sillu mirë!" Pastaj vazhdoi me këtë lutje: "O Zot, bënu pris në rrugë të drejtë fisit Benu Devs". Këtë herë udhëzimet e Tufejlit qenë aq produktive sa që vitin e shtatë sipas Hixhretit erdhi në Medine me grupin e të kthyerve rishtazi, i cili numronte sipas të gjitha gjasave 70 apo 80 njerëz, kurse pas hyrjes triumfale të Muhammedit a.s. në Mekke, publikisht e ndezën putin të cilin deri atëherë e kanë adhuruar anëtarët e fisit të tij.¹⁹

36

Me Muhammedin a.s. u bashkangjiten në vitin e tetë Hixhrij edhe pesëmbëdhjetë fise. Në vitin e tetë pas dorëzimit të Mekkes iu siguroa supremacioni islamit. Dikur fiset, që qëndronin larg islamit, flisnin: "Leje, le të provojë Muhammedi me fiset që e ndjekin, me ne, e nëse fiton, do ta pranojmë si pejgamber të mirëfilltë të Zotit",²⁰ kurse tash janë ofruar që t'i nënshtrohen. Pas ramjes së Mekkes ndër ata, të cilët iu drejtuan, ka pasur edhe njerëz që në fillim të pejgamberisë e kanë munduar më së shumti, por me shpirtmadhësinë e Muhammedit a.s. dhe me faljen e tij fisnike gjeten edhe për veti vende në vëllazërinë islame. Vitin vijues vdiq Urve b. Mes'udi me vdekje martiri nga ana e banorëve të Taifit, ku muslimanët dikur me pasukses ndërmarrën. Me fjalë tjera, ai gjendej në Jemen. Kur u ndërpre rrethimi i qytetit, ai atje u takua me Muhammedin a.s. Në zemër iu zgjua ndaj tij ndjenja e respekt frikës. Që t'hyjë në fenë e re, u drejtua këtë herë madje në Medine. I ndjekur me zellin fetar, dëshiroi t'u kthehet bashkëqytetarëve të vet dhe t'u ofrojë që të kthehen.

Përkundër përpjekjeve të Muhammedit a.s. që ta kthejë nga ky triumf i

rrezikshëm, ai u kthye në vendin e vet të lindjes dhe publikisht u ka thënë që ta lëshojnë idhujtarinë dhe që të kthehen sikur edhe ai në islam. Gjatë kohës së predikimit të tij një shtizë e goditi për vdekje. Mirëpo, ai duke marrë frymën e fundit iu falënderonte Zotit që i ka caktuar që të vdesë me vdekje martiri.

I kemi këto të dhëna në veprimtarinë predikuese, e cila dy vjet pas kësaj ndodhie ka dhënë sukses më të madh në Jemen, kurse e ka zhvilluar një ithtar tjetër i Pejgamberit. Mesazhi i Pejgamberit të Zotit e dërguar në Himjer Nime b. Abdulkelalit fillon kështu: "Derisa besoni në Zotin dhe në të Dërguarin e Tij, nuk do t'ju mungojë mëshira e Zotit. Zoti është një. Nuk ka pjesëtar në hyjni. Me udhëzimin e et e ka dërgaur Musaun, me fjalën e Vet hyjnuese e krijoi isaun dhe... etj." Duke ia dhënë këtë mesazh Ajash b. Rebi El-Mahzumit, Muhammedi a.s. i ka thënë: "Nëse vjen natën në qytet, ku banojnë ata, mos hynë! Prite mëngjesin, pastaj merrë abdest, fali dy rekate deh lute Zotin që ata të të presin mirë dhe të ta lehtësojë suksesin. Letrën time merre në dorën e djathtë dhe dorëzoja atij njëjtë në të djathtën. Pas Besmeles citoje kaptinën "El-Bejjine", e kur ta kryejshë këtë, thuaju atyre që t'i besojnë Muhammedit dhe se ti je një prej të parëve që i kanë besuar atij. Pastaj, nëse arrinë të përgjigjesh në të gjitha kundërshtimet, të gjitha librat e dekoruara, që do t'i cekin, do ta humbin rëndësinë e vet. Nëse të drejtohen në gjuhë të huaj, kërko që kjo të të përkthehet. "Mua më mjafton Zoti. Besoj në Librin që e ka dërguar Ai. M'është urdhëruar ta shpalli të vërtetën ndër ju. Zoti i madhëruar është zotëriu juaj dhe i joni. Neve me ju do të na bashkojnë dhe të gjithë do të kthehemi para hyjnisë së Tij" - pasi t'ua thua këtë, nëse e pranojnë islamin, kërkoji ata tre shkoptha që ata para vetes i vënë që t'u fallen. Nga këta njëri është me lara të verdha, i dyti është , kurse

37

i tretë është nga abanozi i zi, Merri dhe ndezi në shesh...". Pasi i mori këto udhëzime, Ajash b. Rebia rrëfen se u nis për në rrugë. Kur arriti atje, njerëzia për shkak të festës qenë të stolisur. Që t'i sheh më mirë, iu ofrua qytetit. Në të tri dyert ishin të varura perdet e mëdha. U çue perdje nga dera e mesme dhe ai hyri. Atëherë e vërejti publikun e tubuar në një shesh në mes të shtëpive. Pasi iu prezentua se është lajmëtar i Pejgamberit të Zotit, is dj;krhpo Dj;sëëkrm r zok. E dëgjuan. Çka tha Pejgamberi, ashtu ndodhi."21 Vitin e nëntë sipas Hixhretit nga fisi Bena Kilab, që është degë e fisit Benu Umejr b. Sa'sa'it, erdhi deputacioni prej dhjetë njerëz të Pejgamberit. Ithtari i Pejgamberit Dahhak b. Sufjani filloi me ta që t'i përudhë në parimet islame. Pohohet se të gjithë pjesëtarët e këtij fisi në predikimin e tij u kthyen në fenë e re.22 Gjithashtu pjesëtarët e fisit Benu Reas b. Kilab, degës tjetër të po këtij fisi, nga një prej tyre që ka shkuar në Medine dhe u kthye në fenë e re, janë drejtuar në rrugë të drejtë.23

Gjatë po atij viti pasi që Vasil b. El-Aska u takua me Muhammedin a.s. dhe u orvat fisin e vet ta tërheq në suaza të fesë, që ai e patë përqaftuar, megjithatë nuk ka mundur të ketë sukses. Edhe babai i tij me përbuzje e ka larguar me këto fjalë: "Për Zotin, më kurrë nuk do të flasë me ty". Ibn El-

Aska, pasi nuk mund ta gjejë askend përveç motrës së vet kush do të shkojë pas tij, filloi të sigurojë mjete për rrugë të Pejgamberi i Zotit në Medine.²⁴ Ky viti i nëntë i Hixhretit për këtë shkak quhet, "Viti i Pejgamberit", e edhe për shkak se shumë fise arabe gjatë këtij viti i kanë dërguar përfaqësuesit e vet të Pejgamberi i Zotit që ta pranojnë fenë e tij.

Konstituimi i rendit të ri shoqëror në formë të vëllazërisë islame nga vetë fillimi e ka lëkundur fuqinë e lidhjes së unitetit të gjakut, i cili sipas mbikqyrjes së vjetër fisnore ka qenë themel i llojit të tyre social. Kthimi i një personi dhe kuqja e tij në rendin e rishoqëror ka pasur kuptim të rrënimit të njërit prej principeve kryesore të jetës arabe. Kalimi i vazhdueshëm me fe të re ka ndikuar në institucionet fisnore si njëfarë fuqie destruktive, sepse të gjitha këto institucione janë të paafta ndaj jetës së paorganizuar të mallëngjyer popullor, deri te i cili kanë arritur muslimanët. Motra që i ka udhëhequr fiset arabe që në këtë mënyrë të hyjnë në fenë e Pejgamberit, nuk është ai që Muhammedi a.s. erdhi në pozitë të udhëheqësit të një fuqie të pastër ushtarake, por që ai u bë shpallës i teorisë së jetës së re sociale, e cila i zbrapsi dhe i pamundësoi të gjitha (teoritë) tjera.²⁵ Muhammedi a.s. i dha rendit social, i cili në kokën e tij është në gjendje anarkike, ndjenjë të unitetit popullor, në të vërtetë iu dha ndjenjën e detyrave dhe të drejtave reciproke, të cilën deri atëherë Arabët nuk e kanë ndier.²⁶ Fiset, të cilat deri atëherë qenë të preokupuara me derdhjen e gjakut, islami në këtë mënyrë i bashkoi, dhe sa më shumë zgjerohej rrethi i tij, kjo më tepër i tërhiqte vetes fiset e vogla arabe. Gjatë kthimit të fiseve arabe me çdo rast Muhammedi a.s. u premtonte se nën patronatin e tij do të jenë të sigurtë nga armiqtë e vet. Kur 38

dëgjoi për vdekjen e Pejgamberit, një prej kryeparëve klithi: "I mjeri unë, deri sa ai ishte gjalë, kam mundur të jetojë në paqë nga armiqtë e mi!" Nuk ka dyshim se klithmat e këtilla në atë kohë kanë mund të dëgjohen në viset më të largëta të Arabisë.

Kuptohet nga renegatja, pasi mori dimensione të mëdha menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit, se ka qenë kthim sipërfaqësor i fiseve arabe. Duket se e kanë pranuar islamin nga shkaqet politike. Ata janë nga ai lloj që i tërhoqi rryma, e cila më vonë morri formën e një lëvizje të madhe popullore. Entuziazmi i zjarrit dhe zellaria e të kthyerve të parë nuk mund të gjendet në atë masë në qëndrimin e kujdesshëm e tendencioz të atyre që më vonë janë kthyer. Megjithatë edhe ndër ta ka pasur shembuj sikur ata nga ditët e para të islamit, që kanë ardhur t'i madhërojnë radhët e muslimanëve dhe të cilët kanë qenë të përshkuar me mallëgjim të singertë dhe të gatshëm të sakrifikohen për përhapjen e fesë ndër bashkëfistarët e vet.

Këta kanë qenë trashëgimtarë të vërtetë shpirtëror të Pejgamberit, apostuj të islamit dhe rojtar besnik të gjerave të shpallura prej Zotit nëpërmjet Pejgamberit. Këto personalitete për shkak të kontakteve të përhershme me Pejgamberin e dërguar dhe për shkak të lidhjes së tyre zemrore me të nga ajo që prej tij e kanë parë, dhe shqisave dhe mendimeve që prej tij i kanë mësuar, i kanë përhapur nëpër popullatë mendime e shqisa të reja me të

kulturuara e të lartësuar dhe vërtetë bënë progres në çdo aspekt. Ato kështu lartësisht kanë provuar, që është e pamundur të përgënjeshtrohet, se ka dhënë fryt toka që Muhammedi a.s. në cilësi të shtetasit dhe komandantit, madje edhe në kohën më të rëndë të pushtimit shkallëzohet luftarak, e ka mbjell dhe se ka dhënë majft njerëz të vlefshëm. Ata kanë qenë rojtarë të Sektit të shenjtë kur'anor dhe vetëm ata e kanë ditur përmendsh. Gjithashtu, ata me kujdes të madh, që kalon në xheloz, e kanë ruajtur çdo fjalë të Pejgamberit, çdo këshillë të tij dhe e kanë përmbushur obligimin e rojtarit të trashëgimisë së tij shpirtërore. Këto personalitete e përbërjnë kapitalin e shenjtë islam, nga i cili në ardhmëri ka dashur të delë grupi i njerëzve të vlefshëm sikur janë juristët, dijetarët, dhe njohësit e traditës.²⁷ Duhet falënderuar asaj se personalitetet e këtyra janë gjetur që të mund të mbahet lëvizja aq e gjërë, pasi ishte i lidhur dhe i rregulluar. Edhe sikur të mos ishin gjetur ata, nuk do të mundej lehtë të shpëtohej kjo lëvizje nga ato çarje që u krijuan me vdekjen e Muhammedit a.s. sepse islami ka qenë, që duhet patur parasysht, një lëvizje plotësisht e re në Arabinë idhujtare, në të cilën faktorët e rendit të ri e të vjetër social janë plotësisht të kundërt njëri me tjetrin,²⁸ dhe sepse konstituimi i islamit në rendin shoqëror të Arabëve nuk ka dashur të thotë vetëm çrrënjosjen dhe refuzimin e disa veprave të egra johumane, por ka pasur kuptim të kthimit të koncepteve kaheerë të përqëndruara mbi jetën. Ja në këtë gjë më provën më të fortë se porosinë e Muhammedit a.s. principiellisht kanë përmbajtur karakteristikat e misionaritit ashtu që ai u 39

paraqit para botës si shpallës i parimeve të fesë së re, sipas të cilave ka kërkuar që të nivelizohet bota. Sado që kushtet kohore janë konsideruar të favorshme për krijimin e formacioneve të reja politike, megjithatë rendi shoqëror në kohën e Muhammedit a.s. nuk ka qenë në gjendjen e atillë se ka qenë i përgatitur të pranojë udhëzimet e fesë së re, dhe ta presë vetëm zërin që do të shpjegojë qysh në zemra dëshirat e pazbuluara. Ja ky është dispozicioni psikik, d.m.th. shpirti i pritjes u ka munguar Arabëve, e sidomos në Arabinë e meset, për të cilën triumfi i Muhammedit a.s. më së shumti ka qenë i lidhur. Këtu nuk kanë qenë as më së paku të gatshëm që t'i pranojnë lajmet e një përudhësi (murshidi), e sidomos përudhësin i cili ka pasur emër për ta të pakuptueshëm "Pejgamber i Zotit".

Idealet e islamit dhe idealet e xhahilijetit - epokës paraislamike

Ka qenë plotësisht e kundërt me ndjenjat fisnore arabe edhe ajo që të gjithë besimtarët janë konsideruar të barabartë në islam dhe që të gjithë këta kanë qenë në një vëllazëri të përbashkët. Ofsë dikush Arab apo jo-Arab, njeri i lirë apo rob, ndër muslimanët nuk ka pasur mundësi të merrë ndonjë pozitë të privilegjuar. Arabët pohimet e tyre i kanë formuar në bazë të gjykimit personal, të cilat sërish janë bazuar në lavdinë e të parive të tyre. Të udhëhequr me këtë kanë zhvilluar grindje të pafund gjahësore, me të cilat ëmbëlsohej shpirti i tyre. Dhe vërtetë principet bazore të mësimin të Muhammedit a.s. kanë qenë protest kundër atyre gjërave që deri atëherë Arabët i kanë konsideruar mjaft të vlefshme. i kthyeri i ri - musliman është

këshilluar të pranojë për virtytë ato cilësi të cilat ai dikur me përbuzje i ka shikuar.

Sipas mendimit të Arabëve idhujtarë, si miqësia ashtu edhe armiqësia është kuptuar sikur njëfarë borxhi, të cilin përpiqeshin ta kthejnë me kamata. Krenoheshin kur të keqen me të keqe e kthenin, e kur dikush të keqen me të ëirë e kthen, e kanë konsideruar për të dobët e të poshtër. Ja njerëzve të këtilë Muhammedi a.s. iu ka urdhëruar që të keqen me të mirë ta kthejnë, sepse këtë e ka nxjerrë nga Kur'ani:

"..." (El-Mu'minun, 96).

"..." (En-Nur, 22).

"..." (Ali Imran, 133).

Arabët, gjatë shpalljes së parë të Muhammedit a.s., me ironi kanë pranuar themelimin e lutjes. Prej anëve më të rënda për sendërtimin e veprës së Muhammedit a.s. ka qenë: të binden, si mëson këtë islami, më raportin nënshtrues të robit (njeriut) ndaj Krijuesit të tij. Pikëpamja e tillë ka qenë plotësisht e panjohur për Arabët idhujtarë. Vetëbesimi i tyre dhe mungesa e gfrymës religjioze i ka bërë të papërgatitur t'i pranojnë fjalët: "Më fisniku në mesin tuaj është ai që është më i devotshmi në mesin tuaj". (El-Huxhurat, 13, 40

ver N.I.). Po ashtu këta Arabët idhujtarë nuk kanë mund ta durojnë as përpjekjen e islamit të kalojë jashtë kufinjve të lirisë së tyre dhe ta kufizojë mënyrën e tyre të jetës. Në kohën e xhahilijetit (paraislamike) për zemrat e Arabëve kanë qenë më të dashura: pijet dehëse, femra e kënga, kurse Muhammedi a.s. më së shumti ka bërë orvatje të urdhërojë ato që kanë të bëjnë me këto gjëra.*)

Shkurtimisht, islami nga vetë fillimi i shfaqjes së vet ka bartur vulën e religjionit misionarist. Dëshiroi t'i përvetësojë zemrat e njerëzve dhe t'i tërheq në rrethin e vëllazërisë fetare. Në këtë aspekt përpjekjet e tij çfarë kanë qenë në fillim, të atilla janë edhe sot e kësaj dite, që faqet vijuese të kësaj vepre do të tregojnë.

1) Ibn Is'haq, fq. 120.

2) Ibid., fq. 155.

3) Në botën muslimane jihat simuezini i parë.

4) Ibn Is'haq, fq. 219-220. Taberiu nuk e cek këtë mision, kurse Caetani (I, fq. 278) konsideron se më vonë është trilluar.

5) Ibn Is'haq, fq. 225-226.

6) Ibid. fq. 286-287.

*) Muslimanët e ri nga Jethribi (më vonë Medineja) kështu e kanë shprehur pajtimin e dëshirave të veta me misionin e Muhammedit a.s.: "Populli ynë është së tepërmi i copëtuar me konfliktet e brendshme; askush nuk mund ta shpëtojë veçse Zoti, e nëpërmjet teje. Premtojmë se do të përpiqeni në këtë kuptim të veprojmë dhe se do ta ftojme popullin ta pranojë atë që edhe ne e kemi pranuar". (Hamidullah, M., Muhammed a.s., përktheu, N. Smailagiq, Zagreb, 1977, I (Jeta), fq. 148). (Sh.N.),

7) Caetani, vol. I, fq. 334-335.

8) Ibn Ishaq, fq. 291, sq.

9) Përcaktimi i agjërimit në muajin Ramazan (Kur'ani, II, 179-184) pa dyshim është aspekti tjetër i ndërprerjes me Hebraikët, sepse është anuluar agjërimi i Ditës së pendimit (Ashura).

10) Shpallje e Zotit nuk është e kufizuar vetëm në Arabët, pas vullneti i Zotit i përfshinë të gjitha krijesat, që do të thotë dorëzimin dhe dëgjueshmërinë e plotë të njerëzisë.

Muhammedi, si i dërguar i All-llahut, ka pasur të drejtë të kërkimit të kësaj dëgjueshmërie dhe ai këtë është dashur ta bëjë. Kjo, prej fillimit, ka qenë pjesë që nuk ndahet nga tërësia e asaj që ka dashur ta sendërtojë në principe." (Sachau, fq. 203-204).

Goldziher (Vorksungen über alen Islam, fq. 25, sqq.). Mendim të ngjashëm shpreh edhe Noldeke (WZKM, vol. XXI, fq. 307-308).

41

11) Mbi dyshimin për vërtetësinë e këtyre letrave shihe Caetani, vol. I, fq. 725 sqq.

12) Ibn Said, 10. Është e mundur që ky tregim të jetë apokrif, por ai në fund tregon se pararendësit kanë kuptuar karakterin misionarist të islamit.

13) A. von Kremer (3), fq. 309, 310.

14) Këtë duhet se ndër të parët e ka shprehur prof. Muiri, kur flet për Masakrin e Benu Kurejdhes që ndodhi në vitin e 6 të Hixhretit. Ai thotë: "Bazat nga të cilat është nisur Muhammedi kanë qenë pastër politike, sepse ai deri atëherë nuk ka përdorë metodën e detyrimit të botës për pranimin e islamit ose të ndëshkimit nëse e refuzojnë". (Muir /2/ voll. III, fq. 282).

15) Ibn Ishaq, fq. 648 sqq.

16) Muir (22), vol. IV, fq. 107-108, po ashtu shih Caetani, vol. I, fq. 663.

"Rritjes së numrit të besimtarëve duhet falënderuar sukseseve luftarake më tepër se thirrjes së Pejgamberit dhe kualitetit të mësimin islam."

Shpejtësia e përhapjes së islamit u bë e qartë për shkak të autoritetit të vetë Pejgamberit, frymës së tolerancës dhe lirisë dhe shfrytëzimit të rrethanave të volitshme në raporte me ata që e kanë pranuar islamin.

17) Ibn Sa'd, 118.

18) Ibn Is'haq, qq. 943-944. (Tregimi bazohet në burimet e dyshimta.

Shih Caetani, vol. I, fq. 610).

19) Ibid. fq. 252-254.

20) Caetani, vol. II, fq. 341.

21) Ibn Sa'd, 56.

22) Ibid., fq. 85.

23) Ibid., fq. 86.

24) Ibid., fq. 91.

25) Shih Spenger, vol. III, fq. 360-361.

26) Caetani, vol. II, fq. 433.

27) Ibid., fq. 429.

28) Këtë pyetje më së miri dhe më gjithanshëm e ka përpunaur prof.

Ignaz Goldziheri në veprën e vet shkencore (Muhammedanische Studien, vol. I), nga kam marrë të dhëant që do t'i cekim.

*) SHihet edhe nga këto të dhëna e citate të autorit Sir-Arnoldit, se Muhammedi a.s. e ka formësuar mjedisin në të cilën është paraqitur islami, e jo, si pohojnë shumë autorë joobjektivë evropianë, se midisi dhe rrethanat e kanë formësuar Muhammedin a.s. Me fjalë tjera, sikur as mos të ishte lajmëruar Muhammedi a.s., midisi i pjekur do të qitite dikë tjetër. Këto pohimet e tyre tendencioz shkojnë kah ajo që ta zvogëlojnë rëndësinë e kësaj kthesës më të madhe sociale në historinë njerëzore. Kjo mu'xhize (mrekulli) sociale, sikur mos të kishte fare tjetër pos saj, është provë e mjaftueshme e vërtetësisë së pejgamberisë së tij, e sidomos nëse e marrim parasysh se e ka 42

aplikuar një bari bonjak, i pambrojtur. Që ta shohim pathemelësinë e këtyre pohimeve, njofton të kujtohem se Arabia pas paraqitjes së islamit për një kohë të shkurtër, pasi e kreu misionin e vet të madh kulturor, ka filluar shkallërisht t'i kthehet, ndonëse jo në përmasën e dikurshme, mënyrës shkretinore nomade të jetës. (Vër. e përkthyesit Sh.N.).

KAPTINA III

PËRHAPJA E AZISË PERËNDIMORE

Pushtimet arabe dhe përhapja e elementit arab pas vdekjes së Muhammedit alejhis-selam

Muhammedi a.s. e patë përgatitur ushtrinë për Siri. Këtë ushtri pas vdekjes së tij e mori për në Siri Ebu Bekiri. Edhe këtë e bëri përkundër kundërshtimeve të disa muslimanëve: Përse dërgohet atje ushtria kur gjendja në Arabi është rebeluese? Qortimet e tyre Ebu Bekiri i preu me fjalët: "Nuk mund të heq dorë nga urdhëri që Pejgamberi bujar e dha. Medineja mund të shndërrohet në strehimore të bishave të egra, por ushtria është e detyruar ta kryej dëshirën e Muhammedit a.s. "Kjo fushatë ushtarake, e cila është e para prej fushatave mallëngjyese ushtarake, që Arabët në mënyrë sulmi i bënë në Siri, Persi e Afrikën Veriore, e rrënoi shtetin e lashtë persik, kurse Mbretërinë Romake lindore e privoi nga krahinat më të bukurat. Të ndiqet rrjedha e këtyre fushatave të shumënumërta nuk bënë pjesë në lëmin e këtij libri tonë. Për ne është e rëndësishme aq që të orvatemi t'i zbulojmë rrethanat që kanë mundësuar përhapjen e vrullshme të fesë islame kurse e cila ka pasuar menjëherë pas pushtimit.

Një historian i madh¹ me vend na shtroi këtë pyetje: "A mos ky pastër njëfarë entuziazmi fetar - fuqia fetare, që për herë të parë me të gjitha format e veta të jashtme manifestohet - i ka dhënë armës arabe në të gjitha betejat fitoren dhe ka shkaktuar për një kohë të pabesueshme të shkurtër që të formohet në botë një imperatori e madhe ende e paparë?" Sikur në esencë kjo të ishte kështu, për këtë na mungojnë provat.

Numri i atyre që qartas dhe përzemërsisht kanë ecur hapave të Muhammedit a.s. është shumë i vogël, deri sa numri i atyre që kanë hyrë për ndonjë shtrëngesë ose që ta arrijnë ndonjë të mirë të kësaj bote është mjaft i madh. Bie në sy njëfarë gjendje që përbëhet prej nevojës dhe bindjes gjatë

kthimit si të Halid ibn Velidit, që më vonë e fitoi ofiqin Shpata e Zotit, kurse i cili për veten thotë: "Zoti më kapi për zemër e për flokë e më nisi drejt Pejgamberit," ashtu edhe të shumë Kurejshitëve me të të ngjashëm. Në mënyrë të sigurtë të fitosh pre (luftë) të madhe, duke luftuar për fenë e Zotit në vend të shkretëtirës së thatë e gurore, të vie në pronësi t tokës së Sirisë, 43

Persisë e Egjiptit të pllëshëm dhe gjëra joshëse të ngjashme me këtë, janë një nga motivet më të forta (të kthimit të tyre).

Këto pushtime të jashtëzakonshme, që kanë sendërtuar formimin e Mbretërisë Arabe, nuk dalin sigurisht nga përpjekja për përhapjen e islamit.

Vetëm që qëllimi është: lëshimi i krishterizmit, kurse madhërimi i

kthimtarëve në islam, që lind pas këtyre pushtimeve, zgjoi për pushtimet mendimin e këtillë. Për këtë arsye historianët e krishterë kanë marrë se shpata është mjet (instrument) i propagandës islame. Në pajtim me këto, për shkak të shkëlqimit të suksesit që i përshkruhet atij, janë hedhur në hije provat e të dhënat e veprimtarisë në aspekt të misionaritetit të pastër islam. Por në frymën që i ka lëvizur forcat e invazionit arab, që sikur vërshimi ka depërtuar nëpër kufijt e Imperatorisë Bizantine e Persike, nuk ka sigurisht entuziazëm mallëngjyes prozelit.² Ky ekspansion arab në të shumtën do t'i përshkruhet synimit të popullit të zjarrtë, i cili i lëshon djerrinat e veta, në të cilat ka pësuar nga uria e mospasja, për tokat e fqinjëve të vet më të lumtur e më të pasur.³ Megjithatë parimi unjësues i kësaj lëvizjeje ka qenë një shtet patriarkal, që është themeluar në Medine, kurse organizimi i tij është sendërtuar nëpërmjet zbatuesëve të porosive të Muhammedit, domethënë nëpërmjet shokëve të tij besnikë ashtu që ndikimi dhe entuziazmi i tyre ka mundur ta mbajë islamën si fe zyrtare përkundër indiferentitetit të shumë Arabëve,⁴ të cilët për të kanë qenë të lidhur sipërfaqësisht. Për këtë shkak përhapjen e shpejtë të islamit nuk duhet kërkuar në analet e ushtrive pushtuese, të cilat ia hapën dyert kësaj përhapjeje, por më me dëshirë në rrethanat që kanë mbretëruar ndër popujt e ngadhnjyer.

Kalimi i Beduinëve - të krishterëve në islam

Kjo lëvizje popullore, që ka pasur karakteristik të pastër arabe, gjatë kohës i ka tërhequr kah forca e përmendur invaduese edhe ata pjesëtarë të larguar të popullit arab. Për këtë shkak nuk duhet çuditur që shumë beduinë arabë - të krishterë iu bashkangjiten vërshimit të kësaj lëvizjeje të madhe, që shumë fise që me shekuj kanë qenë të krishterë dhe e përqaftuan islamën. Ndër to ka qenë edhe fisi i Gassanitëve, që kanë sunduar në shkretëtirë në lindje prej Palestinës e nga jugu prej Sirisë. Anëtarët e këtij fisi janë konsideruar "zotërinjë të kohës xhahilite (paraislamike), kurse ujjë të islamit".⁵

Në vitin e katërbëdhjetë të Hixhretit, pas humbjes së plotë të ushtrisë persiane, shumë të krishterë që i kanë takuar Arabëve të banuar në brigjet e Enfratit erdhën te komandanti musliman dhe deklaruan: "Fiset që para nesh e përqaftuan islamën qen ëmë të mençur se ne. Rustemi vdiq; më në fund edhe ne e pranojmë fenë e re".⁶ Po ashtu, pas pushtimit të Sirisë Veriore shumica e

fiseve beduine, pasi treguan njëfarë hamendjeje, iu bashkangjiten ithtarëve të 44

mësimit të Muhammedit a.s.7 Se fuqia nuk ka qenë faktor ndihmës gjatë kthimit të fesë, mund të konkludohet në bazë të atij raportit miqësor ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve Arabë. Muhammedi a.s. personalisht, duke lidhur kontratë me fiset e shumta të krishtere, ka premtuar mbrojtje dhe iu ka siguruar se munden lirisht t'i kryejnë rregullat fetare dhe se klerikët e tyre munden pa pengesa të shërbehen me të drejtat dhe privilegjet e veta të vjetra.8 Ja, me rrethanat e ngjashme me këtë i kanë lidhur me lidhje vëllezërore muslimanët dhe ata që para tyre janë grupëzuar në ithtarë të shpalljes më të hershme të Zotit. Sikur që shumë këso jomuslimanësh, kitabijë, vullnetarisht i kanë ndihmuar muslimanët në sukseset luftarake, ashtu kanë mbetur për shkak të ndjenjave të veta miqësore neutral në atë lëvizje çarëse e cila pas vdekjes së Muhammedit a.s. ka nxitur që të ngritet flamuri i kryengritjes në tërë Arabinë.9 Thuhet se të krishterët Arabë, të cilëve u qe besuar detyra e ruajtjes së kufirit të Bizantit, i cili është krahas shkretëtirës, pasi që mbreti Heraklie ua ndërpreu kompetencat (pagat), i kanë kontribuar fatit luftarak të muslimanëve.10 Vitin e trembëdhjetë të Hixhretit në luftën "Xhisr" (Ura), kur aritej humbja e tmerrshme, kur Arabët e shastisur qenë shtrënguar ndërmjet Euftratit dhe ushtrisë persiane, atëherë një prijatar i krishterë nga fisi Gaj iu ofrua komandantit arab se vetë do ta mbrojë urën dhe kështu do ta mundësojë tërheqjen normale të ushtrisë. Që ta shpëtojnë situatën, nga të gjitha anët sikur vërshimi vinin forca të reja, ndër të cilat ishte edhe fisi i krishterë Benu Numejr, që ka jetuar në kufijnjt e Imperatorisë Bizantinase. Më vonë, në një përleshje tjetër, kur para atakut të fundit fati i luftës ishte në anën e Persianëve, komandanti arab e drejtoi kalin në drejtim ku ishte sunduesi i krishterë dhe e thërriti: "Edhe ju jeni gjysmë kanë mbetur në fenë e vetë të vjetër. Halifi Mehdiu, i cili ka sunduar ndërmjet vitit 158 dhe 169 të Hixhretit,*) kur mësoi për ta dhe për banorët në rrethinë të Halepit, të cilët njëjtë pedikojnë krishterizmin, u zemërua dhe urdhëroi se duhet të kthehen në islam. Në këtë pesë mijë njerëz kaluan në islam, deri sa vetëm një për fenë e dha jetën.17 Na mungojnë të dhënat e hollësishme historike për zhdukjen e krishterizmit ndër fiset e krishtere arabe të Arabisë Veriore. Si merret vesh, ata i ka gëlltitur rendi social islam, i cili i ka rrethuar me fuqinë e një rruyme reformiste. Sikur pushteti islam me forcë t'i kthente shtetasit e vet të ri në islam, është e pa mundur që këta do të mund të ekzistonin deri në kohën e halifëve të Abbasitëve.18

Banorët e Hirasë u bënë të shurdhër në rekomandimin e Halid b. Velidit që ta pranojnë islamin. Kjo qytezë ka zënë edhe vend të shkëlqyeshëm në historinë e Arabisë. Sipas mendimit të këtij luftëtari të rreptë islam do të mjaftonte popullatës së atjeshme t'i përkujtosh se domareve të tyre qarkulon gjaku arab, dhe të hyjnë në radhët e simpatizuesëve të Pejgamberit. Halidi të deleguarit, që është dërgaur nga ana e këtij vendi të bisedojë për kushtet e 45

dorëzimit të qytetit, ia shtroi pyetjen: "Kush jeni ju, ose jeni Arabë ose Persianë? bashkëbiseduesi nga deputacioni u përgjeggj: "Ne jemi Arabë të pastër, e sa u përket të tjerëve, ata do të hynin në popullin arab". Halidi në këtë tha: "Sikur të ishte e vërtetë ajo që po thuani, neve nuk do të na kundërshtoni as do të frikësoheshi nga qëllimet tona". Bashkëbiseduesi: "Të folurit tonë të pastër arab është provë se ç'jemi". "Të vërtetën e fletë," tha në këtë Halidi. "Tash nga tri solucione duhet të përcaktoheni për një: ose pranone fenë tonë, dhe se jemi të lirë të mbetemi këtu ose të shkoni tjetërkah, e të drejtat dhe detyrat tuaja do të jenë plotësisht sikur edhe tonat; ose ta paguani xhizjen, ose luftën. Për Zotin, unë këtu kam ardhur në shoqëri të njerëzve për të cilët vdekja është aq e dashur sikur juve jeta!"

Bashkëbiseduesi: "Ne parashtrijmë xhizjen". "Ju qoftë turp", shtoi në këtë Halidi, "Pafeja është shkretëtirë pa rrugë; në atë shkretëtirë Arabi i vërtetë sikur t'i takonte dy udhëheqës, prej të cilëve njëri është Arab e tjetri jo Arab, e sikur ta merrje për udhëheqës jo-Arabi, a nuk do të ishte turp."?19

Janë bërë përgatitjet e nevojshme për mësimin e kthimtarëve, sepse ka pasur nevojë të pengohen devijimet që kanë lindur qoftë në besim qoftë në rituale, për shkak të kalimit të hovshëm të të gjitha këtyre fiseve. Në bazë të kësaj halifi Omeri r.a. ka caktuar mësuesit në të gjitha viset, që do t'ua mësojnë Kur'anin dhe të cilët do të mbikqyrin aplikimin e dispozitave të fesë së re. U ka dhënë urdhër kadive që t'i mbikqyrin të gjithë muslimanët, qofshin ata të vjetër, qofshin të ri "e veçan gjatë ditëve të xhumasë dhe ramazanit, a do të prezantojnë rregullisht në namazin e përbashkët ose jo. Mund të konkludohet (sipas historianit Mes'udit) se çfarë rëndësie i është dhënë këtij mësimi që këtë detyrë në Kufe e ka kryer arkëtori shtetëror.²⁰ Me lehtësitë e cekura lartë, të cilat fituesit muslimanë në shekullin e parë edhe më tej ia jepnin të krishterëve arabë, mund të argumentojmë se fiset e krishtere vullnetarisht dhe krejtësisht lirisht e përqaftuan islamin.²¹ Se edhe sot e kësaj dite vërehen midis popullatës muslimane të krishterët Arab, kjo paraqet në këtë aspekt argument të mishëruar të tolerancës islame. Sir Henry tyard në një vepër të vet thekson se është takuar me Arabët të krishterë në Karaki, në lindje prej detit të Vdekur, dhe se këto as me rroba as me tradita nuk dallohen nga muslimanët Arab.²² Autori Burckhardti për këto në udhëpërshkrimin e vet thotë, deri sa ishte në malin e Sinaït, është takuar me një kallugjer, sipas fjalëve të të cilit deri në shekullin e fundit (dmth. i 18-i) kanë ekzistuar familjet e krishtere dhe se kurrë nuk kanë dashur ta pranojnë islamin.²³

Shumë pjesëtarë të fisit Gassau, në damarët e të cilëve është gjaku më i pastër arab, teh në shekullin e katërt siaps Isaut e kanë pranuar krishterizmin. Këta barabartë e ruajnë fenë e tyre të krishterë. Ato, si duhet, para dyqind viteve, i janë bashkuar kishës romake dhe njëjtë e përdorin gjuhën arabe gjatë lutjes.²⁴

46

Nëse i hulumtojmë qytetet në të cilët banojnë bediunët arabë ose jo Arabët dhe qëndrimin e tyre ndaj fesë së re, do të shohim se kthimi i tyre në

islam nuk ka pasuar shpejt pas pushtimit arab. Qartë shihet se në qytetet e viseve lindore të Imperatorisë Bizantine shumica e popullësisë krishterë ka mbetur besnik fesë së stërgjyshërve të vet. Që të mundemi ta vlerësojmë atë ndikim që ka nxitur ndërrimin e fesë së tyre, që aty këtu kanë ndodhur rastësisht, duhet shkurtimisht ta përshkruajmë gjendjen e Mbretërisë Bizantinase, e cila gjithnjë zbrapset para armës arabe.

Mossuksesi i Herakliut që t'i pajtojë e tubojë sektet e krishtera

Njëqind vjet para kësaj Justiniani i ka dhënë pamje unike Imperatorisë Romake, por pas vdekjes së tij, kur u bënë copëtimet e kësaj Imperatorie, janë zhdukur plotësisht ndjenjat e përbashkëta nacionale ndërmjet qendrës së shtetit dhe provincave. Herakliu, që sërish ta lidhë Sirinë me sundimin qendror ka dëftuar disa orvatje, pjesërisht të suksesshme, por masat e marra për pajtim, në vend që t'i zvogëlojnë kontestet, i kanë zmadhuar ato. Këto ndjenja nacionale ka mund t'i zëvendësojë vetëm dashuria fetare. Me manifestimin fetar si mjet për pajtim ka tentuar t'i mënjanojë kontestet ndërmjet partive kundërshtare dhe sundimit qendror me anë të kishës ortodokse t'ia bashkojë ata që janë konsideruar përçarës. Por Herakliu ka ndarë fatin edhe të shumë të tjerëve, që dëshiruan të jenë "pajtues", sepse diskutimet janë ndezur me flakë edhe më të gjallë. Njëherit ka dhënë shkas që, si i pafe, të mallkohet, dhe ashtu kundër vetes ka nxitur mllëfin e dy palëve kundërshtare.

Dhe realisht, ndjenjat që i ka zgjuar kundër vetes kanë qenë aq të rrepta sa ka mjaft arsye të besojmë se shumica e besimtarëve ortodoksë në viset, që atëherë qenë pushtuar, kanë shkuar aq larg sa që u dëshironin sukses Arabëve. Këta ortodoksë në imperatorin shihnin të pafeun dhe druanin që mos t'ua imponojë pikëpamjet e veta në aspekt të esencës unike të Jezusit.²⁵ Në pajtim me këtë, ata, edhe sikur mos të ishin në rrezik të afërt, kanë qenë të gatshëm t'i pranojnë zotërinjt e ri, të cilët u premtorin tolerancë fetare dhe të cilët kishin prirje që t'ua pajtojnë pikëpamjet fetare me mëvetësinë nacionale.

Në një vepër që e ka shkruar në gjysmën e dytë të shekullit dymbëdhjetë patriku jakobit në Antiohi (Anataki), Mihaili i Madh, lejohet vendimi i ri i të krishterëve dhe, natyrisht, përkundër përbejes, që e ka arritur kisha lindore gjatë pesë shekujve të sundimit isla, konsideron pushtimin Arab kujdes të veçant të Gjithëhartësuarit, dhe, duke theksuar veprimet e këqia të Herakliut, thotë: "... Ja për këtë shkak hakmarrje e të Gjithëmadhërishmit i cili është i gjithëmundshëm, i cili ia jep kujt të dojë mbretërinë për të cilët frikësohen kalimtarët, i cili e ngre të rrëzuarin, i cili i sheh të këqiat e Bizantinasëve të 47

cilët, duke na akuzuar pa mëshirë, kanë atakuar në kishat tona në të gjitha viset, që kanë re nën sundimin e tyre, ka tërhequr nga viset jugore bijtë e Ismailët që të na shpëtojnë nga duart e Bizantinëve. Ndonëse ne kemi pësuar disa dëme, sepse nga ne i kanë marrë kishat katolike, u ua kanë dhënë Kaldeasëve, pasi ata ua jepnin kishat atyre ithtarëve të sekteve të ndryshme në duart e të cilëve gjendeshin me rastin e dorëzimit të qytetit, megjithatë

nuk është dobi e vogël që na kanë shpëtuar nga dhuna dhe të këqijat e Bizantinëve, dhe nga mllefi i tyre, që e kanë shprehur ndaj nesh nesh në veprimet e veta agresive.”²⁶

Pushtimi Arab i Sirisë dhe Palestinës

Kur ushtria islame arriti deri te fushëgropa Esh-sheria (Jordania) dhe kur Ebu Ubejde u llogorua në Fejhel, të krishterët e atjeshëm në letrën që ia dërguan Arabëve e thanë këtë: “O muslimanë, ndonëse Bizantinët i përkasin fesë tonë, ne megjithatë juve iu japim përparësi ndaj tyre, sepse besnikërisht i janë përbajtur fjalës së dhënë, ndaj nesh janë më të mëshirshëm se ata; po përpiqeni që të bëheni të drejtë. Nuk ka dyshim, sundim juaj është më i mirë se i tyre. Ata na kanë grabitur pasuritë dhe shtëpitë.”²⁷

Banorët e fartifikatës Emsa i kanë mbyllur portat e mëdha (dyert e altarit) para ushtrisë së Herakliut dhe u kanë thënë muslimanëve se tërësisht i japin përparësi drejtësisë së shtetit (sundimit) të tyre ndaj padrejtësisë së Bizantit.²⁸

Gjatë kohës së luftërave që janë zhvilluar ndërmjet ushtrive islame e bizantinase prej vitit 633 deri 639 (12/17 sipas Hixhretit), gjendja e këtillë ka qenë në Siri. Kur Damasku në vitin 638, që vetes t’i sigurojë ca dobi materiale dhe që të kursehet nga plaçkitjet, u pajtua me muslimanët, as qytetet tjera në Siri nuk vonuan të shkojnë pas tij. Madje edhe patriku i Jerusalinut me kushtet e njëjta e dorëzoi qytetin. Për shkak të tmerrit të torturës sektashe që e ka zbatuar një mbret përçarës, kuptohet se toleranca islame ka qenë më tërheqëse (për ato treva) nga lidhja që i ka lidhur me Imperatorinë Bizantinase dhe sundimin e krishterë. Kur u heshtë ai tmerrri i parë, që e ka bërë në kalim ushtria invaduese, u krijua kthesë e thellë në ndjenjat në dobi të pushtuesëve arabë.²⁹

Toleranca e Arabëve dhe obligimet e tyre

Dhe njëmend, popullata e këtyre trevave të Imperatorisë Bizantinase, së cilës i ishte plotësisht e panjohur toleranca fetare, për shkak se ka qenë nestoriane dhe që ka besuar në “vetëmsinë e esencës së Jezusit”, kanë gëzuar tolerancën fetare, pasi që muslimanët me trimërinë e vet i kanë pushtuar. Ju ofrua rasti që lirisht, përveç disa klauzulave, dhe pa pengesa t’i kryejnë

48

ritualet e veta fetare. Edhe ato klauzula janë kyqur që t’i pengojnë kontestet ndërmjet sekteve që kanë garuar, e edhe që mos të jep shkak zgjimit të fanatizmit në theksim pompoz të atyre karakteristikave që i fyejnë ndjenjat fetare të muslimanëve.³⁰ Mund të konkludohet për përgjithësinë e këtyre privilegjeve, që në shekullin e shtatë sipas Isaut bie në sy, nga kushtet që ijan ëdhënë popullatës së krahinave të pushtuara. Me fjalë tjera, këta kushte përbëhen në këtë: ramja nën pushtetin islam, për sigurinë personale dhe pasurore pagesa e xhizjes (tatimit) dhe respektimi i fesë.³¹ Nuk është lehtë të jepen të dhënat e vërteta mbi kontratat e dorëzimit nga ai kaosi i versioneve që me atë rast janë krijuar. Megjithatë është me rëndësi që historianët islamë nga burimet e sigurta si traditë historike në shekullin e dymbëdhjetë e kanë marrë këtë në shqyrtim. Sikur të kishin ekzistuar provat që kanë pohuar të

kundërtën, tradita nuk do të zinte rrënjë as do të zgjerohej. Si shembull të kontratës dorëzuese³² do ta theksoj në këtë drejtim kushtet të shkruara halifit Omer b. Hattabit me rastin e dorëzimit të Jerusalemit:

“Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit”. Kjo është fjala e dhënë dhënë popullit të këtushëm nga Omeri, robit të Zotit dhe sunduesit të besimdrejtëve. Sunduesi i besimdrejtëve, qoftë i sëmurë, qoftë i shëndoshë, iu premtonte siguri të gjithë njerëzve në aspekt të personalitetit dhe pasurisë së tyre ose në aspekt të gjërave që kanë të bëjnë me tempujt e tyre dhe fenë e tyre. Kishat nuk do të rrënohen, nuk do të shndërrohen në banesa; as që do t’ju zvogëlohen të drejtat e arritura’ as që do t’i shkaktohet dëm pasurisë së tyre. Ndaj tyre nuk do të bëhet presim në aspekt të fesë, as që fare ndonjë dëm do t’u shkaktohet”.³³

Është caktuar haraxhi (tatim, N.I.) në popullatën e pasur nga pesë dinarë për kokë, për popullatën mesatarisht të pasur nga katër, e për të varfërit nga tre. Pastaj Omer b. Hattabi së bashku me patrikun i vizitoi të gjitha vendet. Deri sa ishin në kishën e “Ringjalljes”, ndonëse patriku me ton shakaje i ofroi Omerit r.a. të falet në të, Omeri, duke ngurruar nga kjo, me njerëzi e falënderoi duke thënë se shkak i ngurrimit të tij nga falja është ajo që ata që ishin në përcjelljen e tij, kur ta shihnin atë, këtë kishë do të mund ta konsideronin xhami.

Është shkruar se si Halifi ka pasur shumë mëshirë ndaj shtetasve të vet që i përkëtinin fesë tjetër. Kështu ka urdhëruar që të krishterëve të sëmurë nga epidemia “xhuzum” t’u jep mbështetje në të holla e ushqim.³⁴ E edhe në çastet e vdekjes ndër detyrat që ia ka caktuar trashëgimtarit të vet, e të cilat zënë vend të lartësuar në testamentin e tij, nuk i ka harruar dhimmitë (shtetasit jomuslimanë pjesëtarë të librave qiellore, vër. N.I.) e vet. Për ta ka thënë: “Dhimmitë që kanë qenë të denjë për kujdesin e All-llahut dhe mbrojtjes së Pejgamberit të Tij, i lë në mbrojtjen e tij. Le të këtë kujdes e ta respektoj përmbajtjen e kontratës, mos t’i ngarkojë ato me detyrat që ata nuk janë në gjendje t’i bartin.”³⁵

49

Kontrata e Omerit

Nga ata që kanë ardhur pas halifit Omerit në shumë breze megjithatë përshkruhet se ka vënë disa urdhëresa që kufizojnë të krishterëve lirinë e kryerjes së ritualeve. Mirëpo, Dehoje,³⁶ Caetani³⁷ dhe autorë të ngjashëm me këta në mënyrë të pakontestueshme kanë dëshmuar se këto janë versione më vonë të rregulluara. Megjithatë, pasi që juristët e epokave të mëvonshme urdhëresat e ngjashme kufizuese i kanë marrë për të vërteta, për këtë shkak urdhëresat e këtuja janë të rëndësishme për shqiptimin e gjuhimit mbi gjendjen e pyetjeve kishtarë të të krishterëve që kanë rënë nën pushtetin islam. Këto urdhëresa, që i atribuohen halifit Omerit, argumentohen më përmbajtjen e letrës vijuese:

“Në emër të Zotit! Kjo letër! Kjo letër iu dërgua halifit Omer b. Hattabit nga popullata e këtij qyteti. Kur jeni nisur për te ne, kërkojmë nga ju që neve, pasardhësit tonë, bashkëbesimtarët tonë dhe pasurinë tonë ta mbron,

kurse ne obligohemi t'ua plotësojmë këto kushte. Në vendin tonë as në rrethinë nuk do të ndërtojmë kisha manastire të reja, dhe qeli eremitësh.³⁸ Nuk do t'i riparojmë ato tashmë të rrënuara as t'i riparojmë ato që do të mbesin në ekuartet islame. Nuk do t'ua pengojmë muslimanëve që dëshirojnë, qoftë ditën qoftë natën, të hyjnë në kishë. Udhëtarëve muslimanë deri në tri ditë do t'u japim strehim dhe furnizim. Në shtëpitë dhe kishat tona nuk do t'u ofrojmë strehim spiunëve as që do t'i fshehim armiqët e islamit; as që do t'i kryejmë manifestimet e fesë së krishterë; as që do t'u bëjmë pengesa atyre që nga ne dëshirojnë ta përqafojnë islamin. Muslimanët do t'i nderojmë. Kur ndonjë prej tyre të hyjë në shoqërinë tonë, do të ngritemi në këmbë. Nuk do t'i imitojmë në rroba, në mbulimin e kokës, në mbathje, as në rregullimin e flokëve. Gjatë përshëndetjes nuk do t'i përdorim shprehjet siç është "selamun alejkum" me të cilin shërbehen muslimanët. Nuk do t'u hipin kafshëve bartëse të shaluara as që do ta bartin shpatën. Në unazat tona nuk do t'i graverojmë tekstet arabe. Nuk do të shesim pije dehese. Nga balli do t'i qethim flokët. Rreth vetes nuk do të vënë qemer. Në kishë nuk do ta ekspozojmë kryqin, as që do t'i bartim sikur as librat e shenjta rrugëve dhe çarshisë (tregjeve) muslimane.³⁹ Kambanat e kishave tona lehtë do të çingërrojnë. Në procesione nuk do të bartim fotografi dhe degë bredhi. Në përcjelljen funerale nuk do të lutemi tepër shumë zëshëm as që do të ndezim qirinj deri sa kufoma të kalojë rrugëve muslimane. Në shtëpitë tona nuk do të marrim robër që kanë qenë pronë e muslimanëve, nuk do ta rrahim asnjë musliman. Ja, me këto kushte obligohemi si në emrin tonë ashtu edhe në emër të bashkëbesimtarëve tanë, e në ndërrsa për këtë kërkojmë nga ju mbrojtjen. Nëse njeriu prej këtyre kushteve e thejmë, nga ne mbrojtja e kërkuar do të bjerë, dhe në këtë rast me ne jeni të lirë të veproni si me armiqët dhe kryengritësit."⁴⁰

50

Personi i parë që ka folur për këto letra ka qenë Ibn Hazmi, i cili vdiq kah gjysma e shekullit të pestë sipas Hixhretit. Përmbajtja e tyre e kufizon lirinë, që në realitet ka filluar të ndodhë shumë kohë më vonë. Dhe njëmend, këto urdhëresa kurrësesi nuk janë aplikuar në një mënyrë të rregullt, sepse për aplikimin e tyre është dashur të priten kohët, kur fanatizmi përgjithësisht, do të vlojë. Përkundrazi, ka prova të pakontestueshme që dëftojnë se ka pasur fare pak akuza për pengimin e lirisë fetare të të krishterëve në ditët e para të ekspansionit islam. E vërteta, lojaliteti i tyre krishterizmit ka pasur për pasojë pagesën e "xhizjes". Xhizje janë quajtur të gjitha ato të dhëna që i kanë dhënë shtetasit muslimanë të Imperatorisë Arabe. Më vonë, gjatë kohës së sunduesve të ri, kur është futur metoda e administrimit financiar, ky emër i jepej haraxhit. Por kur kjo xhizje nivelizohet me atë obligim të detyrueshëm ushtarak i cili ishte për detyrë vetëm për popullatën islame, del se për njeriun që e ka ndërruar fenë vetëm për këtë shkak që të fitojë të drejtën e mospagesës së xhizjes tepër pak ka ndikuar feja e tij paraprake. Përveç kësaj, kthimtarit i ri është dashur të jep në vend të xhizjes një lloj të lëshueshëm ligjorë, të quajtur "zekat", që është marrur për luajtshmëritë dhe

paluajtshmëritë e tj.42 Kur merret parasysh se në fund të shekullit të parë sipas Hixhretit shteti arab nga arsyerat finansiare i ka detyruar kthimtarët, madje edhe pas praimit të tyre në bashkësinë islame që ta paguajnë xhizjen, kjo atëherë edhe më pak e zvogëlon mundësinë se atraksioni me para, siç është shpëtimi prej të dhënave të mëdha, është mjet dhe shkasë i ndërrimit të fesë.43 Nga ana tjetër, kur shteti ndien nevojën të gjejë burim të ri të të ardhurave, duhet pasur parasysh se edhe popullata nga radhët jomuslimane ka qenë e ekspozuar rrezikut që të detyrohet në tribute plotësisht të reja.

Xhizja

Në shekujt e parë të erës islame në aspekt të sasisë së përcaktimit të xhizjes nga ana e sunduesëve muslimanë nuk ka pasur unitet.44 Përfaqësuesi i madh juridik imam Ebu Hanife dhe imam Maliku, në disa elemente lidhur me hxizjen nuk janë pajtuar.45

Mund të merrensi shembull metodat drejtuese islame gjatë kohës së Abbasitëve dispositat vijuese, të marra nga libri "Kitabu-l-haraxh", të cilën e hartoi imam Ebu Jusufi me kërkesë të Harun err-Reshidit (786-809, 170-194 H.): "Është marrë në vit: nga të pasurit 48, nga të mesmit 24, e nga të varfërit 12 dirhemë. 46 Kjo e dhënë është marrë nga mashkujt e shëndoshë të rriteve, deri sa fëmijet dhe gratëkanë qenë të liruar.47 Në rast se dikush është martuar, kjo dhënie merrej në naturë. Është marrë në vend të parave pasuri me vlerë, artikujt tregtarë, orënditë, natyrisht edhe puna e dorës (tegeli). Kjo dhënie nuk merrej në derra, verë dhe kafshët e cofura. Ata varfanjakë që për shkak të furnizimit janë të detyruar të pranojnë lëmoshë, ose pleqtë, që për shkak të 51

pleqërisë janë të paaftë të punojnë, dhe të gjithë ata që kanë falimentuar materialisht, kanë qenë të kursyer nga kjo dhënie. Nga dhënia qenë përjashtuar edhe punëtorët, të çabët, të sëmurët kronikë, të çmendurit, përveç nëse nuk konstatohet se edhe ata janë kapitalistë. Në këtë përjashtim hyjnë edhe ata spiritualistë dhe eremitë që jetojnë nga ndihma e pasanikëve, përveç nëse arrijnë pozitë dhe mënyrën më të këndshme të jetës. Janë dhënë urdhëresa dhe udhëzime të veçanta për ekzekutorët që të sillen butësisht gjatë grumbullimit të këtyre të dhënave dhe në rast të mosdhënies mos t'i përvishen ndëshkimeve fizike."48

Qëllimi i xhizjes

Ky tatim nuk është, siç e pohojnë këtë disa, denim që është caktuar në elementin e krishterë për shkak se nuk e kanë përqafuar islamin. Ky tatim jepej për mbrojtjen, që e kanë gëzuar shtetasit dhimmitë (jomuslimanë), pasi kanë qenë të papërshtatshëm për shfrytëzim në ushtri. Kur popullata e Hires pajtoi ta paguaj xhizjen e kërkuar, kanë shtruar kushtin: "Këtë xhizje do ta japim nëse muslimanët dhe udhëheqësit e tyre do të na ofrojnë mbrojtje nga shkeljet eventuale të ligjit, qofshin ato nga ana e muslimanëve ose nga ndonjë anë tjetër."49 Kur banorët e disa vendeve nga rrethina e Hires e nënshkruan këtë kontratë, Halid b. Vehidi ka shtuar: "Nëse ju mbrojmë, kemi të drejtë në këtë xhizje; e nëse jo, nuk kemi as të drejtë".50 Nga ndodhia vijuese, që ka ndodhur në kohën e halifit Omrit r.a., mundet të kuptohet se sa

i kanë respektuar muslimanët kushtet e parapara: Imperatori Herakliu ka formuar ushtri të madhe që t'i zbrapë e shkapërderdh fuqitë e invazionit islam. Rezultat i kësaj ka qenë se muslimanët kanë dhënë tërë angazhimin në përgatitjet për konfliktin e pritur. Komandanti islam Ebu Ubejde me këtë rast ka urdhëruar në udhëzime, që i ka përgatitur për mëkëmbësit e qyteteve të pushtuara në Siri, që të kthehet xhizja e marrur atyre nga të cilët është marrë. Në njoftimin për popullin gjenden këto të dhëna që kanë të bëjnë me këtë pyetje. "Pasi jemi informuar se fuqia e madhe armike është nisur kundër nesh, po ua kthejmë xhizjen tuaj. Sipas hollësive tona, për këtë xhizje ne do të ishim të obligueshëm që të ju mbrojmë, por sipas gjendjes sonë të tanishme, pasi e kemi të pamundur t'ju ofrojmë këtë mbrojtje, ne ju kthejmë tërë paratë që nga ju i kemi marrë". Sipas këtyre udhëzimeve është dhënë sasi e madhe e parave nga arka shtetërore. Për këtë të krishterët i drejtoheshim Zotit për fatin dhe suksesin e sunduesëve muslimanë me lutjen: "Zoti përsëri për sundues tonit ju dërgoftë, dhe ju bëftë fitimtarë ndaj Bizantinasëve. Sikur në vend tuajin të ishin Bizantinasit, jo vetëm që nuk do të na merrnin edhe pjesën e mbetur".⁵¹

Kush obligohet ta paguaj xhizjen?

52

Pasi xhizja është marrë vetëm nga personat e rritur mashkuj, sigurisht, sikur këtë të ishin muslimanë, në vend të atyre parave do të ishin të ftuar ta kryejnë obligimin e tyre ushtarak. Është me rëndësi të theksohet se të krishterët, sikur të shërbenin në ushtri, do të kurseheshin nga dhënia e xhizjes. Për këtë është shembull veprimi i fisit Xheraxhime, që banonte në rrethinë të Antiohisë. Këta kanë nënshkruar kontratë me muslimanët sipas të cilës kanë premtur se do të luftojnë në radhët e muslimanëve me kusht që mos t'u merret xhizja dhe nëse edhe ata një pjesë të presë do ta marrin.⁵² Vitin e njëzet e dytë të Hixhretit, kur pushtuesit arabë kanë përparuar drejt Iranit Verior, me kushtin e mosdhënies së xhizjes, edhe fiset kufitare kanë bërë kontrata të këtilla.⁵³

Shembull të mosdhënies së tatimit kemi edhe në ushtrinë turke dhe në marinë: të krishterët arbanas me emrin Megaris kanë qenë të kursyer nga dhënia e tatimit me kusht që t'u jepen armë për t'i mbrojtur grykat e maleve që arrijnë deri te malet korintase në Greqi. Të krishterët që i kanë rregulluar urat në rrugët të cilave kalonte ushtria turke dhe të cilët kanë kryer detyrën e udhëheqësit, kanë qenë pa ashtu të kursyer nga haraxhi dhe nga të gjitha tatimet në pasuritë që u janë dhuruar për këto shërbime.⁵⁴ Popullata e krishterë e Hidrës, në vend të dhënies së tatimit në arkën shtetërore, ka dhënë për marinën turke dyqind e pesëdhjetë marinarë të zgjedhur, kurse shpenzimet e tyre mbuloreshin nga të ardhurat lokale.⁵⁵ Ushtria, të cilën e kanë dhënë të krishterët të quajtur Armatulët,⁵⁶ që jetojnë në viset jugore të Rumunisë, ka paraqitur në shekullin e XVI e XVII element me rëndësi të fuqisë ushtarake turke. Po ashtu sikur këta të kursyer nga haraçi kanë qenë edhe Grekët, të cilëve u qe besuar ruajtja e akueduktit (qemerit të ujës-jellësit) që mundësonte ardhjen e ujit në Stamboll.⁵⁷ Po ashtu kanë qenë

të liruar nga tatimet të krishterët të cilëve u qe besuar ruajtja e depove të barutit në Stamboll,58 deri sa prej popullatës fshatare egjiptiane, ndonëse ka qenë muslimane, është marrë tatimi sikur edhe prej të krishterëve.59

Të krishterët nën sundimin musliman

Në kohët e halifëve të dikurshëm të krishterët, e sidomos ata që kanë banuar nëpër qytete, për shkak të sigurisë personale e pasurore kanë arritur edhe më shumë pasuri.

Muaviu (661-680, 41-61 sipas H.) ka angazhuar në punë shumë të krishterë, prandaj edhe shumë sundues të tjerë nga dinastia Umevite dhe Abbasite kanë ndjekur atë në këtë aspekt.60 Te krishterët në pallatin e tyre kanë zënë pozita me rëndësi. Poet të pallatit e patë emëruar poetin e krishterë me emrin Ahtal. Gjatë kohës së halifit Mutessim (833-842, 218-226 H.) dy vëllezër të krishterë patën fituar besim te sunduesi i besimdrejtëve. Një prej tyre, me emrin Salmavejh, ka qenë në shërbim i ngjashëm me shërbimin e 53

sotshëm të ministrit të punëve të jashtme dhe asnjë dehet i sunduesit nuk konsiderohej i vlefshëm pa nënshkrimin e tij. Vëllai i tij Ibrahim (Abraham) ka qenë rojtar i vulës (muhyrit) së sunduesit dhe ka mbikqyr arkën shtetërore. Nuk ka qenë jo e rëndomtë t'i besohet vendi i këtillë i rëndësishëm, ku disponohej me finansat shtetërore dhe me shpenzimin e tyre, një jomuslimani. Aq ka qenë miqësia e Halifit ndaj Ibrahimit sa që personalisht gjatë kohës së sëmundjes së tij e ka vizituar dhe aq ka qenë i mërzhitur me sëmundjen e tij që ka urdhëruar që në pallat sipas ritualeve të krishtere t'i bëhet përcjellja e funeralit.61

Abdulmeliku ka porositur që vëllaut të tij mësues t'i bëhet dijetari i krishterë me emrin Atanasiusi. Kur Abdulazizi u emrua mëkëmbës në Egjipt, Atanasiusi atje e ka përcjellur nxënësin e vet të vjetër, dhe në Egjipt ka fituar pasuri shumë të madhe. Rrëfëhet se Atanasiusi ka pasur rreth katër mijë robë, shumë fshatra, shtëpi, kopshte, ari e argjend. Bijtë e tij, duke paguar racionin e ushtarëve, kanë marrë nga çdo ushtar nga një dinar. Kur merret parasysh se në atë kohë në Egjipt kanë qenë rreth tridhjetë mijë ushtarë, atëherë mundemi vetes t'ia paraqesim se çfarë pasurie ka fituar Atanasiusi gjatë njëzet e dy vite qëndrimi në Egjipt.62 Kah fundi i shekullit të nëntë sipas isaut i krishteri me emrin Ebunnuh Enbari, deri sa ishte shkruer i Ebu Musa b. Elmusahut, ka përdorur ndikimin e vet të madh në dobi të besimtarëve të vet.63

Gjatë kohës së Mutemidit (892-902, 279-290 sipas Hixhretit) mëkëmbësi Enbar b. Jusufi ka qenë i krishterë. Halifi ka thënë se ekzistojnë shkaqet për ç'arsye ia ka parashtruar një të krishterë muslimanëve, Hebraikëve dhe ithtarëve të fesë së Zoroastrës në këtë pozitë kaq të rëndësishme.64

Mueffiku, i cili gjatë kohës së vëllaut të vet mutemidit ka pasur aq ndikim sa që ai ka qenë sundues i vërtetë, ia ka besuar drejtimin e ushtrisë të krishterit me emrin israil. Gjatë kohës së Muktedirit në krye të drejtimit luftarak ka qenë i krishteri.65

Nasr b. Harimi, i cili ka qenë sekretari kryesor i Adudud-devletit nga

dinastia e Buvejhdevë (Buisdëve), që ka sunduar me jugun e Iranit dhe Irakut, ka qenë i krishterë. Gjatë kohë sektoret shtetërore, e veçant ajo finansiare, ka qenë përplotë adhurues të zjarrit e të krishterë, që kanë punuar bashkë.⁶⁷ Edhe në kohët më të vonshme në Egjipt të krishterët kanë depërtuar deri atje sa që kohë pas kohe pathuaj ekskluzivisht në duart e veta kanë mbajtur kompetencat zyrtare.⁶⁸ Të krishterët, e sidomos në cilësi të mjekut, kanë arritur kapital të madh dhe shkathësia e tyre që pranuar në shtëpitë e shkëlqyeshme islame. Mjeku personal i Harun err-Rreshidit ka qenë i krishterë me emrin Xhebrail (Gabriel) të ardhurat e të cilit nga pasuria private kanë qenë tetëqind mijë dirhemë përveç asaj që nëpërmjet mjekësisë, që ka shërbyer te Halifi, ka fituar dyqind mijë dirhemë.⁶⁹

54

Të krishterët edhe në tregti janë bërë pasanikë të mëdhenj. Fanatikët, në mënyrë tendencioze duke i shfrytëzuar ndjenjat e masës së thjeshtë, që është zgjuar nga urrejtja ndaj të krishterëve të pasur, atyre u kanë bërë dhunë. Nëse përjashtohen këto raste, bashkësia e krishterë ka pasur administrimin e pastër autonom, sepse shteti ua ka lënë këtyre bashkësive që pavarësisht të drejtojnë me punët e tyre të brendshme. Liderët e tyre në pyetjet që u përkasin besimtarëve të tyre kanë kryer detyrën e gjyqësorëve dhe kanë vënë dëgjuesin

Mu Nuk ka pasur përyjeperdnë manastiret e kishat e tyre. Jyjetëm disa në vendet më të mëdha janë shëndruar në xhamia. Deri te shëndrimi i kishave në xhamia ka ardhur për shkak të ramjes numerike të të krishterëve dhe rritjes së jashtëzakonshme të muslimanëve, prandaj kësaj nuk mund t'i bëhet vërejtje.

Ndër tregimet që kanë të bëjnë me Damaskun është edhe kjo që flet se Arabët, kur e kanë pushtuar këtë vend, i kanë ndarë për gjysmë midis muslimanëve dhe të krishterëve kishat që gjendeshin aty dhe se një komandant me shpatë në dorë ka hyrë në qytet në dyert lindore, kurse tjetri ka hyrë në ato perëndimore me kontratën dorëzuese. Se këto rrëfime janë të pasakta është provuar me hulumtimet e mëvonshme kritike. Po ashtu me kërkimet detaje dhe me topografinë e kishës së madhe Saint Jean (Shën Gjoni) është provuar pamundësia e versionit të disa historianëve arabë se kjo katedralë është përdorë si tempull i përbushët i muslimanëve e i të krishterëve (d.m.th. se muslimanët në një pjesë të kësaj kisha i janë lutur Zotit.⁷¹ Megjithatë besimi i historianëve të cekur se sistemimi i këtillë ka zgjatur tetëdhjetë vjet është dëshmi i lirisë së krishterëve në vetë fillimin në aspekt të kryerjes së ritualeve religjioze.

Në këtë pyetje shumica e juristëve islamë është kundër gjykimeve të drejtimit (medhhebit) në liberal-hanefit. Dhe njëmend, sipas gjykimeve hanefite, brenda kufijve islam, ndonëse nuk lejohet të ndërtohen kisha e sinrgoga (havra) të reja, megjithatë lejohet të ndërtohen aty ku kanë qenë më parë, por që janë rrënuar. Lejohet të riparohet ajo që është në gjendje rrënuese. Mundet përndryshe të ndërtohet kisha ose havra në fshatra ku nuk ka simbole islame. Sipas drejtimit fanatik hanbelist, nuk lejohet ndërtimi i

kishave e havrave në atë vend ku janë prishur, as që lejohet të dëmtuarat të riparohen. Sipas disa juristëve, privilegjet në këtë aspekt janë të ndryshme sipas kontratave të lidhura me dhimmitë. Në vendet që me forcë janë marrë absolutisht nuk u lejohet dhimmive të ndërtojnë tempull. Vetëm nëse ekziston në këtë aspekt kontratë, janë të lirë të ndërtojnë qoftë kisha qoftë havre (sinagoga).⁷² Mirëpo, juristët islamë, duke u marrë me këtë në skuta dhe duke shtuar shqyrtime të ngjashme, sikur edhe dispozitat e tyre në këtë aspekt, kanë pasur pak lidhje me gjendjen e vërtetë të gjërave.⁷³ Ulemaje është pajtuar në mendimin që në një vend që e kanë themeluar muslimanët nuk u lejohet dhimmive të ndërtojnë tempull, kurse në qytetin Kahire

55

(Cairo), që e ndërtuan muslimanët, bashkësia fetare e kobtëve ka ndërtuar kisha.⁷⁴ Ashtu edhe në shumë vende tjera që i kanë themeluar muslimanët, të krishterët kanë ngritur kisha, e madje edhe manastire. Për kisha kështu rishtas të ndërtuara ka shumë shembuj, që i cekin si historianët islamë ashtu edhe ata të krishterë. Për shembull, gjatë kohës së Abdulmelikut (685-705 sipas Hixhretit) pasaniku Atanasisu ka dhënë që në qytetin e tij të lindjes në Odes të ndërtohet kisha, të cilën ia përkushtoi shën Marisë, dhe kryqtarja, të cilën ia përkushtoi Jezusit. Skica e tyre, si tregohet, i është dërguar mbretit Abgarit. Ky njeri ka lejuar që të ndërtohen shumë kisha në Egjipt, nga të cilat më të bukurat janë ato dy që gjenden në Fustat.⁷⁵ Disa të krishterë ndërmjet dinjitarëve të mëkëmbësit egjiptian Abdulazizit, vëllaut të Abdulmelikut, kanë lejuar që në Heluan të ndërtohet kisha e përkushtuar shën Gjonit.⁷⁶ Këtë vend e kanë themeluar muslimanët.

Në vitin 711, me pëlqimin e halifit Velidit (705-715, 86-97 sipas Hixhretit)⁷⁷ është ngritur në Antiohi kisha për të krishterët jakobitët. Janë kryer ceremonitë e veçanta me rastin e hapjes solemne të kishës, të cilën e kanë ngritur vetë në vitin e dytë të sundimit të Jezidit II (720, 102 sipas Hixhretit) patriku jakobit në Antiohi Maraliasi me priftërinjt dhe monakët. Vitin vijues në fshatin Sermada n ërrethinë të Antiohisë me rastin e kryerjes së ceremonive për hapjen solemne të kishave, dinjitarët kishtarë qenë të ekspozuar protestit, por ky protest ka ardhur nga ana e ithtarëve të një sekti tjetër të krishterë që garonte me këtë.⁷⁸ Halid el-Kasri, i cili ishte mëkëmbës i Irakut arab e persian prej vitit 724 deri më 738 (106-121 H.) ka lejuar të ndërtohet një kishë e veçantë për nënën e et, e cila ka dashur të mbetet në krishterizëm.⁷⁹ Gjatë sundimit të halifit. Mehdiut (775-785/106-121 H.) është ndërtuar kisha në Bagdad për të krishterët, që kanë ra në robëri në luftërat e shumta që janë zhvilluar me Imperatorinë Bizandinase.⁵⁰ Gjatë sundimit të Harun err-Rreshdit (786-809/170-195 H.) për shkak të sigurimit të protektoratit është ndërtuar nga ana e popullatës së Semavës një kishë.⁸¹ Gjatë sundimit po këtij të halifit patriku nestorian në Basra ka marrë lejen që në të të ndërtojë kishë,⁸² kurse themelet e saj (Basrës) janë vënë në vitin 638 /17 H.) në kohën e halifit Omer r.a. Është ndërtuar edhe kisha e shkëlqyeshme në Babilon, ku gjenden varret e pejgamberëve Danielit dhe Zekerias (Zakorij).⁸³ Halifi Me'muni (813-833, 198-218 H.), kur shkoi në

Egjipt, i dha autorizim dy dinjitarëve të vet, që në kodrën Mukattam në rrethinë të Kahires të ndërtojnë kishë.⁸⁴ Patriku nestorian Timotensi, që vdiq në vitin 820 sipas Isaut, ka lejuar që të ndërtohet kisha në Tekrit, kurse në Bagdad manastiri.⁸⁵ Gjatë kohës së sundimit të halifit të pestë fatimit në Egjipt zahirit (1020-1035/411-427 H.) është ndërtuar kisha edhe në vetë Xhidden.⁸⁶

Me konstituimin e pushtetit islam tolerimi i kishave të krishtere nuk është shkelur, por përkundrazi: nestorianët, sipas të dhënave që janë marrë 56

nga veprat e tyre historike, kanë reguar zgjim dhe aktivitet të jashtëzakonshëm në jetën religjioze dhe zelltari prej kur kanë ra nën pushtetin islam.⁸⁷ Sunduesit e Persisë, ku ky sekt i krishterë ka qenë i shtrirë, herë i mbronin, e herë i ekspozonin presionit. Kur fillonte lufta ndërmjet persisë dhe Imperatorisë Bizantinase, ata gjendeshin në situatë tejet të rrezikshme. Për shkak të simpatisë së tyre ndaj armikut, Persianët me ta mjaft vrazhdë sillleshin. Por gjatë sundimit shtetëror të halifëve, siguria e tyre, që e kanë arritur brenda krahinave të tyre, ka shkuar deri aty sa u është mundësuar që nga krahinat e tyre të dërgojnë misionarë fetarë. Misionarët e tyre, që i kanë dërguar në shekullin e tetë sipas Isaut në Indi dhe Kitaj, kanë arritur madje në pozitat e peshkopëve. Pasi filluan e u forcuan në Egjipt, e kanë përhapur ende krishterizmin edhe në Azinë Qendrore. Në shekullin e njëmbëdhjetë madje shumë tatarë i kanë kryquar.⁸⁸

Përse bashkësitë tjera të krishtere nuk kanë dëftuar kaq veprimtari, për këtë nuk duhet akuzuar udhëheqjen islame. Udhëheqja qendrore islame ka qenë për të gjithë njëloj, për më tepër, ka penguar sulmet e njëres ndaj tjetres.⁸⁹ Në shekullin e pestë sipas Isaut, peshkopi nestorian me emrin Bar-Suma, që të mundet rreptë t'i persekutojë ithtarët e kishës ortodokse, e bindi sovranin e Persisë se Nestoriusi u është mik dhe si dëshmi i ka krahasuar dispozitat e veta fetare me rregullat fetare të Persianëve. Tregohet si janë pre (therë) në këto-persekutime 7800 persona, sa klerikë ortodoksë, sa të tjerë.⁹⁰ Dhumë është bërë ndaj ortodoksëve edhe gjatë kohës së Kosroesit II (Hosrevit), pasi Herokliu hyrinë tokën persinae. Por edhe kjo dhunë u bë për shkak se një ithtar i sektit jakobit të krishterë ka arritur ta bind sunduesin e Persisë se ortodoksët kanë simpati ndaj Bizantit.⁹¹ Vetëm islami me rregullat e veta mbi tolerancën pengon veprat e këtilla që e rrënojnë drejtësinë.

Përkundrazi, është e qortë se është orvatur të silllet drejtë me mbarë popullatën e krishterë. Duke e shfrytëzuar këtë veprim të drejtë të barabarësisë, jakobitët janë ngutur që pas pushtimit të Egjiptit, kur kanë parë se nëpunësit bizantinas janë larguar, t'i përvetëspjnë kishat ortodokse, por, gjatë konstatimit të pranësisë, është urdhëruar nga ana e muslimanëve që ato t'u kthehen pronarëve.⁹²

Shkaqet e kalimit të të krishterëve në islam

Duke e marrë parasysh këtë liri të rrëfimit të besimit, e cila përgjithësisht i është dhënë të krishterëve në fillim të islamit, del se është absolutisht e pamundur të pranohen supozimet, që përgjithësisht janë përhapur, se shpata

është faktor në ndërrimin e fesë në islam. Në pajtim me këtë, jemi të obligueshëm të kërkojmë shkaqe tjera të kthimit jashtë detyrimit. Për fat të keq, pasi na mungojnë të dhënat në këtë aspekt, kemi nevojë t'u drejtohem supozimeve.⁹³ Në kohët kur shqyrtimet teologjike kanë qenë më tepër në 57

modë ka pasur shumë mendimtarë të cilët kanë qenë të gatshëm për pranimin e mësimin islam. Të ngjashëm me mësimin islam kanë pasur pikëpamje anëtarët e klasës shehrikan (çifligarët) në shekullin e tetë sipas Isaut. Ata, edhe vetë të krishterë, e kanë konsideruar Isaun (Jesusin) e lartë njeri, vetëm që e kanë konsideruar peygamber.⁹⁴ Ata, herë pas here, i kanë shkaktuar shumë kokëçarje klerikëve nestorianë të cilët përpiqeshi t'i fusin në një sekt shprehimisht të krishterë,⁹⁵ por pasi ishin më tepër kah islami se kah krishterizmi, është majft e besueshme se kanë hyrë në radhët e atyre që e kanë rritur numrin e muslimanëve pasi që Arabët e pushtuan Persinë. Sipas supozimeve të shumë teologëve të krishterë,⁹⁶ ramja e atëhershme morale e kishës lindore dhe nënçmimi shpirtëror ka nxitur kundër vetes zemrat e të shumtëve dhe i ka nxitur të kërkojnë atmosferë më të pastër shpirtërore në islam, i cili ka ardhur në fuqinë e plotë të entuziazmit të ri fetar.⁹⁷ Në këtë aspekt shembulli i ithtarëve të këtij mendimi gjendet në shpjegimet vijuese të dinjitarit të madh kishtar Milmenit (Millman)⁹⁸: "Në çfarë gjendje gjendej krishterizmi në ato vise të cilat të parat i qenë ekspozuar pushtimeve muslimane? Një sekt fetar ka qenë kundërshtar i tjetrit, grupi i klerikëve ka qenë kundër grupit tjetër në ato dispozita të paqarta fetare dhe pyetje metafizike; ortodoksët, nestorianët, jakobitët në antagonizmin e vet të pashterrshëm e mundonin njëri tjetrin. Shumë prej tyre, në vend që të bashkohen që ta mbrojnë krishterizmin e përbashkët, kanë shkaur aq larg sa kanë dëshiruar të shohin kundërshtarët dhe rivalët e vet nën sundimin e muslimanëve. Tërë kjo, sado rreptë të luftohet, është pak. Kush di sa ka në mesin e tyre ku këto diskutime të pafund i kanë lëkundur themelet fetare. Mirëpo, është e çuditshme se si me mijëra të krishterë të shastisur nuk janë strehuar tek e vërteta e unitetit të thjeshtë të shenjtë, qoftë edhe me pranimin e peygamberisë së Muhammedit, që të shpëtojnë nga ato diskutime të pafund. Autori italian Caetani shtronë se largimi i ndjenjave nga dogmat labriniane, që kanë futur në krishterizëm nëpërmjet frymës bizantinase, është shkak i përhapjes së islamit ndër pjesëtarët e kishës lindore; dhe në këtë drejtim shqyrton: "Për Lindjen, e cila ka pasur më tepër prirje drejt të kuptuarit të thjeshtë e të kuptueshëm, ndriçimi i kulturës greke ka qenë, nga aspekti fetar, shkatërrim, sepse shkenca e thjeshtë dhe e lartësuar e Jezusit (Isaut) u shndërrua në sekt plotë pasiguri dhe dyshim. Kjo, megjithatë, rezultoi me ndjenjën e indiferentitetit dhe nga themeli e ka tronditur besimin. Derisa gjendja e gjërave ishte e këtillë, më në fund filluan të depërtojnë lajmet nga shkretëria për Shpalljen e re. Atëherë ky lloj i degjeneruar i krishterizmit në Lindje, i kaosuar me mospajtimet e brendshme, e qëlluar në vetë esencën e besimit, me frikë qëndronte në dilemë. Më nuk i kundërvihet tërheqshmërisë së fesë së re, por fesë së atillë

që me një goditje do t'i të gjitha ato dyshimet dhe dilemat e mjera, dhe me besim të thjeshtë, të qartë e të pakontestueshëm do të ofronte edhe 58

shumë profite materiale. Ja kështu Lindja e lëshoi Jezusin dhe u hodh në përqaftim të peygamberit që vinte nga Arabia.⁹⁹

Për islamin teologu Taylar thotë¹⁰⁰: "Është lehtë të kuptohet se si është përhapur shpejtë në Azi e Afrikë kjo formë e mojsieizmit të reformuar. Dijetarët afrikanë e sirianë kanë vënë në vend të fesë së Jezusit besime misterioze e metafizike; dhe në luftë kundër shturjes morale të kohës së vet kanë proklamuar celibatin (mosmartesën, vër. N. I.), duke e konsideruar virtyt të parajsës, si ilaq kundër saj. Rruga drej shenjtshmërisë që në tërheqshmëri (kallugjerizëm), kurse karakteristika kryesore e kallugjerizmit ka qenë në papastërti. Masa e rëndomtë ka qenë ajo që me gjithë shpirt i ka adhuruar martirët, të shenjtit dhe engjëjt sikur politeistët. Shtresat e tij të larta kanë qenë me moral perverz; të mesmit kanë qenë të shtrënguar me tatime, robët kanë qenë të privuar nga çdo shpërsë në shpëtim.¹⁰¹ Si mjet pastrues, i dërguar nga ana e Zotit, erdhi islami, dhe, duke i ndërruar ato besime të shtrembëta dhe ato keqpërdorime, i ka shkatërruar. kjo gjendje ka qenë një lloj revolte kundër atyre diskutimeve të kota teologjike dhe pretest burror kundër respektimit të celibatit si kurorë të devotshmërisë. Islami ka vendosur për themel të fesë madhërinë dhe unitetin e Zotit; ka shpallur nënshtrimin vullnetit të Zotit të lartë, i cili është i drejtë e i mëshirshëm, përgjegjësinë personale, Ditën e gjykimit, denimin e rreptë për gabim, dhe ka përcaktuar detyrën e namazit, agjerimit, sadakës dhe kryerjen e punëve të mira. I ka hedhë në prapavijë virtytet artificiale, fdredhitë të bëra në emër të fesë, me dhe të folurit e shtrembëruar mbi fenë. Në vend të monakisë ka konstituar detyrat e burrisë. Robërve u dha shpërsën e lirisë, e njerëzisë ndjenjën e vëllezërisë, dhe ka konfirmuar të vërtetat themelore të natyrës njerëzore.

Islami nga një anë dëftohet si shfaqje e reaksionit kundër klerit bizantinas.¹⁰² Ky kler për imperatorin (cariu) dhe pallatin e tij ka qenë ajo ana tjetër e shenjtërisë të lartësuar që gjendej në pozitën më të lartë. Imperatori jo vetëm që është konsideruar për sundues më të lartë të krishterizmit por edhe si pontifex maximus (klerik suprem, papë).¹⁰³ Pranimi i këtij parimi nga ana e klerit dhe klasës jashtë tij është rrënjësuar në formë të despotizmit, i cili me peshën e barabartë i ka shtypur besimtarët e rëndomtë gjatë kohës së car Justinionit. Kundër shtetit të Justinianit në Stamboll në vitin 532 shpërtheu kryengritje e rreptë, e cila ishte manifestim i pakënaqësisë si kundër shtetit ashtu edhe kundër Kishës, e të cilën kanë mundur ta ngulfatin vetëm pasi i mbytën tridhjetë e pesë mijë njerëz. Të pakënaqurit, që quheshin të gjelbër, kanë protestuar rreptë dhe publikisht. Kanë brohoritur kundër pushtetit të imperatorit: "Është humbur drejtësia dhe më nuk do të gjendet. Do të hebraikizohemi, ose, që është më lehtë, do të kthehemi në idhujtari!¹⁰⁴ Nuk kanë mund të zhduken as njëqind vjet më vonë shkaqet e pakënaqësisë që ishin shkasë për deklaratat ashtu të rrepta.

59

Goditja e rëndë e dorës së shtetit bizantinas nuk ka dhënë rast që të përsëritet kjo kryengritje dhe se të pakënaqurit janë dezorganizuar. Por megjithatë në vitin 560 janë kapur në Carigrad dhe janë internuar ata që fshehtë kanë rrëfyer idhujtarinë.¹⁰⁵

Mirëpo, të pakënaqurit kanë mundur papengesa të jetojnë në krahinat kufitare, të larguara nga kryeqendra e mbretërisë. Heretikët, të cilët kanë qenë të ekspozuar vështirësive, me të pakënaqurit tjerë janë strehuar në viset lindore. Pasardhësit shpirtëror të atyre që para njëqind vitesh dëshiruan ta ndërtojnë krishterizmin me ndonjë fe tjetër, dëshiruan t'i dalin në ndihmë ushtrisë islame.

Në Imperatorinë e Hilafetit, e sidomos në qytete, pasi që gjuha arabe është pranuar për gjuhë të përgjithshme, gjatë dy shekujve viset e pushtuara shkallërisht kanë marrë qëndrimin dhe traditat e popullit sundues, që domosdo ka dashur të nxisë përshtypje të thellë në jetën fetare dhe intelektuale të ithtarëve të feve tjera, që kanë hyrë në domenin e saj. lëvizja intelektuale, në shumë çka materialiste, që prej shekullit të pestë të Hixhretit ka ndikuar majft në teologjinë islame, duhet se ka ndikuar mjaft dhe në mendimtarët e krishterë, dhe se e kanë lëshuar fenë në të cilën atëherë ka dominuar prirja e besimit në gjërat e pamundura. Një autor islam nga shekulli i katërt Hixhrij e cek bisedën me një të kirhsterë (Kobt). Kjo bisedë mund të merret si shembull të mënyrës së përgjithshme të të kuptuarit edhe të kishave tjera të atëhershme:

“Se krishterizmi nuk është fe e mirëfilltë, do t'i cekim për këtë pyetje këto dëshmi: shpalljet e kësaj feje i rrënojnë rregullat e një tjetre; shumë urdhëresa janë kundërthënëse njëra tjetrës dhe realisht për shkak të palidhshmërisë dhe kundërthënshmërisë së tyre arsyeja i refuzon, dhe e shtynjë mendjen në revolt. Kurrfarë përsiatjeje nuk mund t'i ndihmojë, kurrfarë diskutimi nuk mund t'i argumentojë. Sa do t'i hulumtojmë (verifikojmë), nuk mund të theksojmë provë as për arsyen as për ndjenjat që për ta do të bindte. Megjithatë, përkundër kësaj, kam parë shumë sundues dhe popuj me dije dhe gjykim të shëndoshë që kanë mbetur te fjala e dhënë krishterizmit. Prandaj gjykoj se këta kanë përqaftuar krishterizmin përkundër të gjitha këtyre kundërthëniesve, sepse kanë qenë të detyruar t'i pranojnë argumentet që ua kanë dëftuar në formë të çudive dhe simboleve”.¹⁰⁶

Depërtimi i racionalizmit dhe mohimi i Shpalljes

Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se ata që nën ndikimin e prirjeve materiale e intelektuale kaluan nga krishterizmi në islam, në fenë e re gjetën mendimin e “parandjenjës” të teologëve islamë të mutezilitëve dhe shumë gjëra tjera të përbashkëta të dy anëve. Në pajtim me këtë, nga arsyeja e qëndrimit të tyre shkencor ndaj përmbajtjes së fesë dhe shumë pyetjeve

60

teologjike, kjo kthesë nuk u krye me forcë, siç supozohet kjo. Është e qartë madje edhe për ata, që sado pak janë të udhëzuar në fe që e shpalli Muhammedi a.s., se ekziston lidhja e fortë e krishterizmit dhe islamit, duke

mos i marrë parasysh parimet themelore, për ç'arsye gjatë kohës së halifeve të Umevitëve, natyrisht edhe më vonë, ka ardhur deri te pajtueshmëria në shumë pika ndërmjet teologëve islamë e të krishterë. Për këtë arsye pohohet se gjatë shpjegimit, sipas një sistemi, të pranimi dhe të kuptuarit të qëndrimeve themelore islame, vërehen gjurmat e ndikimit të teologëve bizantinas. Forma dhe sistemi i parimit më të vjetër fetar në gjuhën arabe përkujton në krahasimin me veprën e shën Gjonit (Jahja-ut) nga Damasku dhe me veprat e disa të tjerëve të shenjtëve të krishterë me të të ngjashëm.¹⁰⁷ Një rend mistik më i vjetër arab, që kishte afinitet kah asketizmi, buras nga ndikimi i pikëpamjes së krishterë.¹⁰⁸ Gjurmata e këtij ndikimi kryesisht gjenden në besimin e disa mut'tezilitëve.¹⁰⁹

Ata gjykimin e vet e kanë përshtatur plotësisht në mënyrën e rëndomtë të teologëve bizantinas. Ithtarët kaderitë e kanë marrë principin e vullnetit të lirë pikërisht nga krishterizmi. Ithtarët e sektit murxhitë në pyetjen e mohimit të denimit permanent, që është në kundërshti me pikëpamjen e përgjithme të muslimanëve, pajtohen me mësonin e kishës lindore.¹¹⁰ Por megjithatë edhe ndikimi i imanëve të devotshëm islamë manifestohet në kalimin në islam të 20,000 sa Hebraikë, sa të krishterë, sa adhurues të zjarrit me rastin e vdekjes së Ahmed Ibn Hanbelit.¹¹¹ Juristi i medhhebit hanbelit, Ebu I-Ferexh b.

Xhevziu i cili është dijetari, predikuesi më i madh dhe autori më produktiv i kohës së vet (1115-1201), 509-598 H.), me krenari cek se numri i njëjtë, si i është e njohur, është kthyer.¹¹²

Nota e tërheqshmërisë së kulturës islame

Suksesi i pashembullt i armës islame e tronditi besimin në krishterizëm të atyre që ranë nën sundimin islam, sepse kanë filluar ta shohin fuqinë hyjnore në pushtimet islame.¹¹³ Ata e kanë ngatërruar lumturinë botërore me mëshirën e shenjtë (kujdesin e Zotit), dhe filluan të besojnë se Zoti i luftës ia jep fitoren atyre robërve që I janë më të dashur. Në pajtim me këtë, shihet se është bërë përpjekje që mirëfillësia e islamit është orvatur të argumentohet me suksesin islam.

Ideali i vëllezërisë në islam ka qenë atraksion i fuqishëm për ta. Dhe njëmend, kronaria arabe në gjiri dhe në privilegjet e popullit dominues, të shtrira edhe në kthimtarët, u bënë pas disa brezeve pengesë për ndërrimin e fesë, por gjatë kohës është konfirmuar pozita e barabartë në rregullimin shoqëror të atyre që në cilësi të muslimanëve u kanë takuar fiseve të ndryshme, dhe në fund të shekullit të parë të Hixhretit synimit të theksuar të

61

vëllezërisë në besimin islam i kanë gjetur pozitë të denjë dhe arritën të jenë në shtetin e tyre, së paku teoretikisht, të pranuar.¹¹⁴

Persekutimet së cilave më herët u qenë ekspozuar të krishterët

Vetëm gjatë kohës së halifëve të parë gjendja e të krishterëve nuk ka qenë tepër shumë e durueshme. Nganjëherë janë marë masa të rrepta kundër dhimmive në ëdobi të muslimanëve. Sipas kësaj shpresohet se muslimanëve do t'ua sigurohen përparësitë shoqërore. Janë ndërruarrë masa nga ana e shumë halifëve që dhimmitë mos të pranohen në pozitat shtetërore, për kjo

nuk ka mund të rezultojë me sukses. Në këtë aspekt janë marrë vendimeve nga ana e Mensurit (754-770/137-159 H.), Mutevekkilit (847-861/233-247 H.), Muktedirit (908-932/296-310 H.), në Egjipt nga ana e halifit fatimit Amirit (1101-1130/495-57 H.) dhe në shekullin e katërmbëdhjetë nga ana e sulltanëve memelukas.115 Mirëpo, marrja e vendimeve në mënyrë operative që dhimmitë mos të pranohen në punët shtetërore, është shenjë se gajtë aplikimit të masave të këtilla hegjemoniste nuk ka pasur uniformitet dhe permanencë. Dhe njëmend, shkaqet e këtyre urdhëresave duhet kërkuar ose në mllëfin e publikut në veprimin e vrazhdë e të pacipë të nëpunësve të krishterë,116 ose në fanatizmin vlues që nxiti veprimin plotësisht të kundërt udhëheqjes islame.

Veprimi më i rreptë kundër shtetasve të krishterë ka filluar gjatë kohës së halifit Harun err-Rreshidit (786-809/170-199 H.). Ai ka urdhëruar se do të veshen në mënyrë tjetër dhe do t'i lëshojnë shërbimet shtetërore në dobi të muslimanëve. E para nga këto urdhëresa na dëfton se sa i janë përmbajtur atyre rekomandimeve që i atribuohen Omerit r.a. dhe se ato urdhëresa nuk rezultojnë nga ndjenjat religjioze, por nga rrethanat politike të asaj kohe. Vuajtjet që i kanë pësuar të krishterët në të shumtën janë krijuar për shkak të qëllimeve të këqia që kanë ushqyer shtetet e krishtera kundër sunduesëve islamë. Se Harun err-Rreshidi i mori mëri të krishterët, shkak është në atë që imperaton bizantinas Nicefari (Nikifar) në emër të të krishterëve e nënçmoi.117 Shkas për veprim kundër të krishterëve duhet kërkuar ose në pabesi, që lindi për shkak të përzierjes dhe intrigave të armiqëve islamë, të krishterëve të huaj me të vendit, ose në shqetësimin që ka buruar nga nënçmimi dhe fuyerja e muslimanëve nga ana e të krishterëve. Mirëpo, shpesh edhe fanatizmi ka qenë shkas i konflikteve, siç ka qenë rasti gajtë kohës së Matevekkilit. Ky sundues u dëftua si mbrojtës i palës muslimane të devotshme, e cila fitoi rastin të bëjë reaksio nkundër rrymave materialise dhe tendencave liberale, të cilat janë krijuar nën sundimin e pararendësve të tij. Kjo ishte partia e masës së thjeshtë, e cila ishte në kundërshti me shtresat më të larta.118 Duhet se kjo parti ka lakmuar drejt hakmarrjes për ato vuajtje të

62
cilat i ka pësuar gjatë kohës së pararendësve të Mutevekkilit.119 Ai ka dëshiruar që rreptësinë e tij ta shfrytëzojë në ndëshkimin e mitezillitëve. Ka ndaluar çdo diskutim komentues mbi Kur'anin, kurse shkallën mu'tezilite e ka shpallur heretike. i ka rrahur e mbyllur të gjithë ata që e kanë konsideruar të shenjtë Aliun r.a., e rrënoi turben e h. Husejut në Kerbela dhe ka ndaluar vizitën pelegrinuese varrit të tij. Edhe të krishterët janë denuar së bashku me ato që janë konsideruar heretikë. Për këtë shkak strikt është kujdesur në aplikimin e vendimit mbi tjetërllojësinë e veshjes së muslimanëve dhe dhimmive, i cili është marrë para Mutevekkilit. Ka urdhëruar që të mos punësohen të krishterët në detyrat të cilat kujdesen për mirëqenien e përgjithshme dhe që t'u dyfishohen tatimet. U ka ndaluar dhimmive të punësojnë shërbëtorin musliman dhe që të lahen në hamamet (banjat) muslimane.

Është me vlerë të hedhet shikimi në atë se historianët e kishës nestoriane, e cila më së shumti pësoi për shkak të urdhëresave, e shpjegojnë këtë gjendje me gjerat e reja të cilat janë të lidhura me personalitetin e Mutevekkilit, dhe se kjo është zhdukur me vdekjen e tij.¹²⁰ Një nga trashëgimtarët e tij, Muktediri, i ka përsëritur urdhërat e tij. Diku pas nje pesëdhjetë vjet më vonë, edhe ato kanë ra.

Vlimi i fanatizmit ka nxitur edhe rrënimin e kishave dhe sinagogave.¹²¹ Kjo shfaqje është shkak që është rritur numri i atyre që janë larguar nga kisha e krishterë,¹²² ndonëse këto persekutime janë në kundërshti me frymën tolerante të islamit dhe thëniet¹²³ që i atribuohen Muhammedit të ndershëm. Së kati palafanatike është orvatur që vazhdimisht t'i aplikojë këto masa dranokike. Nënçmimi i jomuslimanëve ndër ulemanë është bërë objekt i diskutimit. Ata në tërheqshmërinë e vet janë ankuar dhe kënë bërë kundërshtime, por pushtetmbajtësit, kur iu jepej rasti, nuk kanë çarë kokën për këtë.¹²⁴ Rregullat që janë vendosur nga disa spiritualistë fanatikë me qëllim që t'i çrrënjosin jomuslimanët, nuk mund të konsiderohen kritere të veprimeve të qeverisë shtetërore. Ceket se shkas për këtë janë keqpërdorimet e jomuslimanëve që kanë qenë në pozitat më të larta zyrtare. Nëpunësit e këtillë të krishterë me shkeljen e të drejtës së ndonjë muslimani kanë nxitur urrejtjen. Si pohohet, disa, duke i shfrytëzuar pozitat e veta të larta, i kanë munduar dhe keqpërdorur muslimanët, dhe se kanë shkruar aq larg sa që i kanë privuar nga pronësia. Në këtë aspekt janë dërguar ankesa gjatë kohës së halifëve: Mensurit (754-775/137-159 H.), Mehdiut (755-785/159-169 H.), Me'munit (815-833)/200-218 H.), Mutevekkilit (847-861/233-247 H.), Muktedirit (908-932/296-320 H.) dhe shumë trashëgimtarëve të tjerë të tyre.¹²⁵ Disa nëpunës të krishterë kanë nxitur ndjenjën e përbuzjes për shkak të veprimeve të veta siç është spiunimi i Abbasitëve që ka rezultuar me ndëshkimin e muslimanëve, simpatizues të Emevitëve.¹²⁶ Më vonë, gjatë kohës së kryqtarëve janë akuzuar se këtyre u kanë dërguar lajme,¹²⁷ dhe se,

63
në një mënyrë që nuk është e denjë që të konsiderohet si persekutim fetar, kanë dhënë shkas që kundër tyre të ndërmerren masat kufizuese drakonike. Sa bëhej më i padurueshëm fati i popullatës së viseve të pushtuara, kjo në atë masë pa rezistencë rritej numri i atyre të cilët me fjalët. Nuk ka zot tjetër pos All-llahut, Muhammedi është i dërguar i Tij" kanë kërkuar shpëtim prej mjerimit. Kur në shtet ndihej nevoja për para, kurse kjo gjithnjë e më shpesh ka ndodhur, atëherë rriteshin tatimet ndaj popujve të nënshtruar. Sa zgjatte kjo gjendje e padurueshme e jomuslimanëve, aq rritej numri i të kthyerve në islam. Sipas hulumtimit të këtyre dhe rrëfimeve të ngjashme me këto mbi vrazhdësitë, me të cilat janë të mbushura faqet e historisë së historianëve të kohëve më të vonshme të krishtera, kishat e krishtera nuk kanë mundur të zbulojnë ndonjë mjet të majftueshëm rezistent shpirtëror kundër presionit të gjendjes së përmendur. Shkaqet e ndërrimit të fesë dhe largimit nga krishterizmi, që i kanë ndjekur këto persekutime fetare, si thekson historiani i kishës nestoriane mari b. Sulejman, duhet kërkuar në

indiferentitetin në kryerjen e detyrave fetare dhe në jetën jomorale të priftërisë.128

Nga shkaqet e kërkuara të ramjes së popullatës si krishterë është edhe ai që fëmijët e grave të robëruara, të sjellur në harem, kanë ndjekur fenë e babajve të vet. Ofrimi i lirisë robërve të krishterë nga ana e zotërinjve të tyre të sjellshëm si shpërblim për konversionin e tyre është një prej atraksioneve që shpesh janë paraqitur. Por nuk është e njohur se muslimanët në ndërrim të fesë, as që kanë bërë dhunë që nga ndonjë vend ta çrrënjosin krishterizmin. Sikur edhe halifët të kenë lejuar aplikimin e njërit nga dy mënyrat e ndërrimit të fesë, siç ka bërë Ljudeviti XIV me protestantizmin në Francë, duke e konsideruar atë për punë të keqe, siç janë persekutuar Hebraikët nga Anglia plotë 300 vjet, ashtu edhe ate lehtë kanë mund ta çrrënjosin krishterizmin nga Mbretëria e vet. Pasi që kisha lindore ngurronte nga pjesëmarrja në aksionin e botës tjetër të krishterë, kjo as në atë botën e krishterë nuk është ndërmarrë asgjë që të ndihmohet krishterizmi, i cili është konsideruar heretik në ato vise. Në pajtim me këtë, një prej provave më të fuqishme se shtetet islame përgjithësisht kanë qenë tolerante ndaj të krishterëve është edhe kjo se edhe sot një mend ekziston kisha lindore.129 Gjatë kohës së pushtimit islam, nga ithtarët e kishave që ende kanë mbetur, kanë qenë në Azinë perëndimore 150.000 nestorianë.130 Sikur ithtarët e kishave tjera mos të kishin marrë masa që t'i tërheqin në suaza të sektes së vet, numri i tyre do të ishte me i madh. Kaldejë të cilët iu bashkangjiten kishës romake kanë qenë 70.000. Peshkopi nestorian Mar Xhunani me shokët priftër të shumtë dhe me 15.000 ithtarë të sektit nestorian iu bashkangjitë në vitin 1898 kishës ortodokse ruse. Patriku Jakobit në Antiohi ka kryer pushtetin shpirtëror mbi 85.000 ithtarë të këtij sektit të vjetër. Nga ana tjetër 25.000 besimtarë, që përbëjnë bashkësinë kompakte 64

jabokite, iu bashkangjiten patriarkisë siriane katolike.131 28.000 e diç më shumë ithtarë të kishës lindore ortodokse kanë qenë nën qeverisjen shpirtërore antiohiane, e 15.000 të patriarkisë jerusalimase.132 Numri i ithtarëve të kishës katolike delte në 13.000 frymë.133 Kisha masonite e cila prej vitit 1182 sipas Isaut është bashkuar me atë romako-katolike, ka 300.000 ithtarë.134

Është çudi e jashtëzakonshme se si kanë mundur gjatë kohë të ekzistojnë këto bashkësi të copëtuara të ekspozuara shkatërrimit të luftës, epidemive dhe urisë,135 në krahinat të cilat me shekuj kanë qenë epiqendra të luftës dhe të cilat me radhë i kanë shkelur Turqit, Mongolët dhe kryqtarët,136 përkundër ligjit që e patën vendosur muslimanët se nuk guxohet të ndërrmiret asgjë në drejtim të tërheqjes së ithtarëve të një bashkësie, e cila ke qenë në gjendje të ramjes numerike. Parandjehet se shkakut i ramjes së tyre numerike është mohimi, i cili është synim në lindje ku është e shtrirë shumësia, parimi i rëndomtë i monogramisë, i ndjenjave që rrjedhin nga pasiguria dhe pozita skllëvëruese.137

Përpjekjet e bëra në përhapjen e islamit ndër të krishterët

Të dhëna të hollësishme për konvertimin e këtyre të krishterëve nuk kemi. Kuptohet se shumë prej këtyre e përqafuan islamin në kohën e invazionit të parë. Që ta fitojmë njëfarë pasqyre, duhet theksuar se gjatë kohës së Omerit r.a. është marrë fatim persona (haraç) 120 milionë, kurse gjatë kohës së Abdulmelikut sasia ka ra në 40 milionë. Shkaku i kësaj ramjeje të të ardhurave mund t'i përshkruhet shkretërimin i cili është pasojë e luftërave dhe kryengritjeve, por edhe më tepër mund t'i përshkruhet konvertizmit të masave, për shkak të të cilës shumë prej tyre kanë shpëtuar nga dhënia e tatimit për kokë.¹³⁸

Në ato kohë është vërejtur kthimi i të shumtëve, që mund të kuptohet nga letra e bashkëkohësët të patrikut nestorianas Ishajabit (Jeshib), të cilën së bashku me eklerikun kryesor në Persi Rordeshirin ia ka shkruar mitropolitit Simenunit. Mjaft pak janë ruajtur dokumente të shkruara të krishtere nga shekulli i parë Hixhrij. Pandaj, pasi kjo letër aq në mënyrë drastike dëshmon se kjo feja e re është përhapur në mënyrë paqëndrueshme, dhe pasi pak është marrë parasysh nga ana e historianëve të mëvonshëm, e konsiderojmë të përshtatshme që pjesërisht ta përcjellim "... Arabët, të cilëve i Gjithëlartë atëherë ua dhuroi sundimin imperialist, tash gjenden në mesin tonë. Ata nuk atakojnë në fenë e krishterë, por, përkundrazi, e përkrahin. Të shenjtit dhe priftërit tonë i nderojnë. Kishave dhe manastireve tona u japin dobi të mëdha. Përse atëherë banorët tuaj në Mervi e kanë lëshuar nëpërmjet Arabëve fenë? Njëkohësisht, sipas fjalëve të vetë popullatës së Mervit, ndonëse Arabët nuk i kanë detyruar ta lëshojnë fenë, ndonëse u kanë

65
premtuar siguri nëse e japin gjysmën e pasurisë së tyre, megjithatë e ndërruan fenë. E shitën fenë e cila u sillte shpëtimin amshues për gjysmën e pasurisë të kësaj bote kalimtare, e lëshuan fenë e atillë të cilën popujt me gjah e kanë blerë dhe njëjtë e blejnë, dhe me të arrijnë miraz (trashëgimi) të ekzistencës së amshueshme".¹³⁹

Konvertimet e shumënumërta, që kanë ndodhur gjatë halifatit të Omer b. Abdulazizit (717-720/99-102 H.) meritojnë vëmendje. Ky halif ka organizuar lëvizje intenzive misionare. Që ta tërheq popullatën e viseve të pushtuara në suazën islame, e ka stimuluar në të gjitha mënyrat, madje edhe të holla ka ndarë.¹⁴⁰ Për më tepër, ka anuluar urdhëresën që është lëshuar në vitin 700/81 H. nga shkaqet financiare. Sipas kësaj urdhërese nuk kanë qenë të liruar nga dhënia e xhizjes të kthyerit e ri.¹⁴¹ Që t'i jep impuls konvertimit, ka ndër marrë këto masa: nga pronarët muslimanë të tokave nuk ka marrë haraç, por ata i ka ngarkuar me të dhjetën (ushrin). Këto masa nga pikëpamja financiare kanë qenë rigorozë, por nga pikëpamja që e ka përfaqësuar halifi i devotshëm kanë rezultuar me sukses të madh dhe jomuslimanët e shumtë i kanë kategorizuar në radhën e muslimanëve.¹⁴²

Mirëpo, nuk duhet supozuar se vetëm shkaqet e kësaj bote kanë qenë fuqia e vetme që i ka shpjerë të krishterët në islam. Si kuptohet nga vepra e Shën Gjorit nga Damasku, që ka të bëjë me diskutimet fetare, një musliman i zellshëm, bashkëkohës i tij, ka dëshiruar që me argumente shkencore dhe

prova t'i tund themelet e krishterizmit. zhvillimi i diskutimit duket kështu: "Nëse muslimanët pesin... Nëse muslimanët e thonë këtë... ju pergjigjuni kështu...", dhe ka paje të realitetit. Shihet se kjo është hartuar me qëllim që të jepen përgjigje të gatshme në kundërshtimet e ndryshme të fqinjëve muslimanë kundër krishterizmit.¹⁴³ Qëndrimi agresiv i polemistëve islamë në këto dialogje është i theksuar mjaft, përndryshe do të ishte i paqëllimtë të përzihen argumentet e pohimeve muslimane në veprën që e ka shkruar ky dijetar i krishterë. Peshkopi Teodor Ebukra, një nga nxënësit e Shën Gjonit nga Damasku, ka shkruar diç për diskutimet që i ka zhvilluar me muslimanët. ky traktat përmbanë të gjitha pyetjet kontestuese ndërmjet dy palëve.¹⁴⁴ Muslimanët, sikur edhe më parë, edhe këtë herë kanë pranuar ftesën për diskutim, dhe kjo paraqet një shembull që jep pasqyrë të vërtetë mbi veprimtarinë e muslimanëve, e cila i ka shpjerë vërtet caqeve të tyre. "Të gjitha idetë dhe orvatjet e kundërshtarëve tanë shpjerën në mohimin e shenjtërisë së shkronjës së Zotit (fjala, logosi)", ka thënë peshkopi.¹⁴⁵ Patriku nestorianas Timotiusi në praninë e halifit Hadiut dhe Harun err-Rreshidit ka hyrë në diskutim mbi pyetjet fetare dhe sipas të gjitha gjysave vepra, në të cilën, si thuhet, është shkruar kjo trajtesë, është humbur.¹⁴⁶ Timotiusi është zgjedhur për patrik, përkundër klerarkisë kompetente kishtarë. Kundërshtari më i madh i tij, mitropoliti meroit, në bashkëpunim me halifin Hadiun, ka intriguar kundër tij. Ky më në fund, në rekomandim të

66

Halifit, e pranoi islamin dhe si shpërblim për konvertimin e tij mori dhurata të çmueshme dhe u emërua nëpunës në Basra.¹⁴⁷

Hollësitë mbi konvertimin në islam

Këto të dhëna nga shekulli i parë Hixhrij janë shumë të paqarta dhe nuk janë të mjaftueshëm. Më shumë na përkujtojnë në përpjekjet rreth thirrjes në fe, se që i shtrojnë faktet e caktuara e të pakontestueshme.

Të dhënat e shkruara deri sot të ruajtura, që në vete bartin karakteristikën e misionaritetit të pastër, bëjnë pjesë në kohën e Me'munit (813-833/198-218 H.), e kjo është një shkresë që e ka shkruar i biri i ungjit të Halifit një fisniku të krishterë, i cili ka pasur pozitë të lartë në pallatin e Halifit, respektin e të cilit personalisht e ka arritur.¹⁴⁸ Mënyra e shprehjes së autorit të kësaj shkrese, në të cilën butësisht e ketë mikun e vet të krishterë ta pranojë islamin, është pasqyrë e shkëlqyeshme që ua pasqyron qëndrimin tolerant që muslimanët atëhere e kanë marrë ndaj kishës së krishterë. Ky traktat sipas vlerës së vet zënë gati vend të pashembullt në historinë e misionaritetit islam.¹⁴⁹ Sipas kësaj letre, në të cilën është fjala, që e ka mbajtur Halifi në mbledhjen me njerëzit e shquar, shihet se Halifi i nderuar ka folur me përbuzje të madhe për ata që, për qëllime dhe vetjakësi të kësaj bote, e kanë përqaftuar islamin. Ai i ka nivelizuar me ata shumëfytyrisë (munafikë) të cilët Muhammedit a.s. i dëftoheshin për miqë, e fshehtas punonin ta zhdukun.¹⁵⁰ Këto vërejtje të Halifit meritojnë vëmendje, sepse dëshmojnë se prej kthimtarëve të ri në islam është kërkuar besimi i sinqertë, pa kurrfarë fitimesh të ulta, dhe se leverdia personale dhe caqet e ngjashme

jo të denja si shkas të ndërrimit të fesë kanë nxitur mospajtimin e tyre të rreptë.

Me'muni personalisht ka shpenzuar angazhim të madh në përhapjen e islamit. Madje u ka dërguar ftesë në islam të pafeve në krahinat më të largëta të mbretërisë së vet, siç është Fergana,¹⁵¹ por kurrë nuk e ka keqpërdorur fuqinë e vet sunduese që t'i detyrojë të tjerët që ta pranojnë islamin. udhëheqësi i sektit maniheist Jozdanbaht ka vizituar Bagdadin¹⁵² dhe ka hyrë në diskutim me dijetarët muslimanë, por para argumenteve të forta të tyre u detyrua të heshtë. Në këtë Halifi i rekomandoi ta përqafojë islamin, por Jezdanbahti, në shenjë mospranimi, u përgjegj: "O sunduesi i besimdrejtëve, fjalët tuaja u dëgjuan, këshillat tuaja u miratuan, por ju nuk jeni nga ata që i detyrojnë njerëzit ta lëshojnë fenë e tyre". Halifi jo vetëm që nuk u zemërua për shkak të mossuksesit të vet, por madje ka caktuar rojtarë gjatë kthimit të tij që ta ruajnë nga nënçmimi eventual nga ana e masës fanatike.¹⁵³ Historianët e krishterë japin të dhëna të mëngëta për konvertitët nga shtresat e larta të priftërisë. Kështu kah mesi i shekullit të nëntë peshkopi në Bahreju Gjergje, pasi për disa arsye kishtarë që përmbysur nga ajo pozitë,⁶⁷

kaloi në islam.¹⁵⁴ Mitropoliti në Taris Gabrieli me vëllaun e vet e përqafoi islamin kah mesi i shekullit të dhjetë. Ceket se ka konvertuar për atë shkak që nuk është zgjedh për patrik të nestorianëve.¹⁵⁵ Në shekullin e njëjtë Teodori, peshkopi nestorian në Bet Gorem, kaloi në islam. Historianët kishtarë asgjë nuk shkruajnë se këto kthime kanë qenë me dhunë.¹⁵⁶ Sikur të ishin kthyer me dhunë, ata, pa dyshim, këtë do ta theksonin. Ndërmjet vitit 962 dhe 966 në islam u kthye edhe peshkopi jakobit në Azerbejxhan Filokseni.¹⁵⁷ Mitropoliti jakobit në Tekrit Ignaciu,¹⁵⁸ i cili në këtë pozitë ishte 25 vjet, me emër tjetër si Mark Barkiki, më 1016 ka shkuar në Bagdad dhe duke e përqaftuar islamin në prani të halifit, ka marrë emrin Ebu Muslim.¹⁵⁹ Kronistët e krishterë theksojnë se këto tri konvertime kanë qenë për shkak të moralit të dobët të tyre, por këto theksime i nënshtrohen dyshimit, pasi nuk janë provuar me argumente tjera.¹⁶⁰ Sikur për shembull një katolik të pohonte ngjashëm për një prift i cili do të kalonte në protestantizëm, që do të ishte arsye për dyshim. Nuk ka dyshim se kthimi i priftërve të përmendur, që i përkasin dy sekteve kundërshtarë çfarë janë ajo jakobite dhe nestoriane, është ruajtur nëpërmjet historisë për shkak të pozitës së tyre të lartë, por asgjë nuk përmendet në konvertimin e priftërve tjerë më të ulët. Kronisti Bar Hebrosi, duke e shkruar historinë deri në ditët e tij, për këto konvertitë na jep të dhëna më të gjëra. Për shembull, kah mesi i shekullit të 12 sipas Isaut, një nga peshkopët jakobit publikisht e ka pranuar islamin dhe kjo është shkruar nëpër libra, sikur që më vonë peshkopi horosanas Haruni, pasi që për shkak të jomoralit të vet është gjykuar nga kisha, e ka përqaftuar islamin. Pastaj, duke u penduar për shkak të aktit të vet, ka dëshiruar sërish të vjen në pozitën e vet të vjetër shpirtërore, por pasi është refuzuar kjo dëshira e tij, shkoi në Stamboll dhe e lëshoi fenë jakobite në "unitetin e esencës". Mirëpo, pasi nuk ishte i kënaqur me pritjen në Stamboll, sërish iu drejtua patrikut jakobit. Dhe

më në fund, pasi që përsëri pa shkak e përqafoi islamin dhe sërish u pendua, e përfundoi fundin e jetës ndër aronitët libanonas.161 (marunijje), Bashkëkohësi i këtij kronisti, peshkopi haburas Danieli, i cili është i njohur edhe me shkencës botërore, ka synuar që të emërohet për kryepeshkop të Halepit, dhe pasi nuk arriti, e lëshoi krishterizmin dhe për shkak u të turpit dhe depresionit shpirtëror që u bë musliman, I Gjithëlartësuari i ka dhuruar ngushullim kësaj krijese dëshpruese, sepse disa muaj më vonë ky "heretik i mjerë" në një karavansaraj i pakujdes vdiq. Emri i është zhdukur, e nuk dihet as ku është varrosur.162

Se këto konvertime nuk janë të rralla dhe raste pastër të vetmuara, dëshmon peshkopi i Akres. (St. Jean d'Acres), Jaques de Vitru. Duke folur për atë çka ka parë në Palestinë prej vitit 1216 deri më 1225, kështu i shtronë mendimet e veta për kishën lindore: "Është dobësuar dhe mjerisht është ngatërruar në kurthra ose, , rrezikshëm është lënduar me tundje
68

epsharake dhe me rekomandimet e rrejshme të profetit të ashtuquajtur, qe rrakulisur. E zbuluar në purpur, është zhytur në baltinë."163

Rastet e kalimit në islam në mesin e kryqtarëve

Kishat e krishtera, që gjendeshin në territoret e ndikimit islam, janë ortodoksizmi lindor, dhe nga ai janë degëzuar dhe janë ortodoksizmi lindor, dhe nga ai janë degëzuar dhe janë konsideruar heretike sektet, por kah fundi i shekullit 11 të krishterëve sirian dhe palestinez iu bashkangjite element i ri, e këta janë grupe të kryqtarëve që ndjekin ritualet latine. Kanë mundur ta ruajnë ekzistencën e vet të tronditur të banuar në mbretërinë jerusalemase dhe krahinat tjera rreth 200 vjet. Këta të shpërngulur në kohën e cekur janë kthyer në islam. Për shembull, gjatë kryqzatës së parë një pjesë, që përbëhej prej Gjermanëve dhe Lambardianëve nën udhëheqjen e princit Reymundit, u shkëput nga karvani i madh i kryqtarëve, dhe në një fortifikatë e nguaji sulltani selxhukas Arslani. Reymaudi, me pretekstin se po depërton nga qyteti, me personalin e vet kaloi në anën e Turqëve dhe e përqafoi islamin.164 Historia e kryqzatës së dytë të pafatshme cek një ndodhi të ngjashme dhe meritore për vëmendje. Një prift, monak i manastirit Saiut Denis, ka marrë pjesë si sekretar i Ludevinit VII në fushatën e përmendur kryqtare. Ja, do t'i përciell citatet që e pasqyrojnë luftën e përmendur:

"Luftëtarët e kryqzatës, në orvatje që të depërtojnë nëpërmjet Azisë së Vogël deri në Jerusalem, janë sulmuar nga ana e Turqëve në grykat e malit Frigite dhe pësuan humbje të rëndë, por me mundime të rënda arritën në bregun e qytetit Antalia. Ata që kanë mundur të paguajnë çmimin e pandërgjegjshëm, që e kanë kërkuar tregtarët bizantinas, kanë mundur të gjejnë barkë e të kalojnë në Antiohi, deri sa të sëmuret, të plagosurit dhe grupet e pelegrinëve kanë qenë të detyruar të mbesin në mëshirën dhe pamëshirën e aleatëve të vet tradhtarë grekëve. Grekët kanë marrë nga Ludeviti i VII 500 marka me kusht që pelegrinëve frankovite t'i japin ushtri, e cila do t'i mbrojë dhe do të kujdeset për të sëmuret deri sa t'u vijë ndihma e parë, e cila shkon pas tyre. Por posa u nisë ushtria kryqtare, Grekët i

informuan Turqit se pelegrinët gjenden në gjendje pa rrugëdalje, dhe derisa sëmundja, uria dhe shtizat armiqësore nxitnin rrënim të tmerrshëm dhe shkreti në llogarinë e këtyre të mjerëve, Grekët këtë e kanë soditur në qetësi. Një grup i kryqtarëve prej tre-katër mijë njerëzve dëshpërueshëm ka provuar që të shpëtojnë. Turqit i rrethuan por edhe i therrën. Pasi Turqit ngadhnyen, filluan ta ngushtojnë edhe vetë llogarin. Sikur zemrat e muslimanëve Turqë, duke pasë mjerimin dhe fatkeqësinë kaq të madhe, nuk të dhembeshin, edhe pjesa e mbetur e kryqtarëve do ta gjente vdekjen. Turqit këtyre fatkqinjve ua kanë shëruar plagët, e të varfërit me bujarinë e vet nga mjerimi i kanë shpëtuar. Për më tepër, disa muslimanë kanë blerë paratë frankovite, që

69

Grekët, diç me forcë, e diç me mashtrim, i kanë marrë nga pelegrinët dhe ua kanë dhënë kryqtarëve të varfër. Ky veprim i dhembshurisë duhet të ketë qenë shkas për krahasim në sytë e pelegrinëve dhe veprat dhe veprimet e bashkëbesimtarëve të tyre Grekëve, të cilët i kanë detyruar në punë sikur të dnuarit, i kanë rrahur e mashtruar, dhe shumë prej tyre vullnetarisht dhe sinqerisht kanë përqafuar islamin. Ai kronisti i vjetër Andonin de Diclee me këtë rast shpjegon: Ndonëse janë shmangur nga të pafetë, të cilët zemërmirësi dhe dhembshuri u kanë dëftuar, siç kemi dëgjuar, gjatë tërheqjes së Turqëve u janë bashkangjitur rreth tre mijë kryqtarë. Ah, moj mëshirë, je tirani (dhahim) më e madhe se çfarëdo nënçmimi. Muslimanët u kanë dhënë bukë, por ua grabitën fenë. Dhe njëmend, muslimanët për shërbimet e veta të bëra askend nuk e kanë detyruar ta lëshojë fenë e vet".¹⁶⁵

Rrethanat siç janë kontaktet më të shpeshta ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve, arritja e mendimit të ri nëpërmjet kryqtarëve mbi virtytet e kundërshtarit - të cilat te historianët më të vonshëm të krishterë¹⁶⁶ qartë dallohen nga të vjetrit - dhe imitimi i shumë Fraukovitëve, të banuar në Jerusalem, i qëndrimit dhe mënyrës së jetës së Lindjes, barabartë të gjitha këto kanë ndikuar edhe në mendimet fetare. Ndër shfaqjet më të rëndësishme të këtij ndikimi bënë pjesë edhe ajo që shumë kryqtarë kanë pasur qëndrim të favorshëm ndaj islamit. Këtë qëndrim të tyrin Kisha rreptë e ka atakuar. Kryepari sirian usame b. Munkidhi ka shkuar në Jerusalem gjatë kohës së paqes. Atëherë Mesxhidu-l-Aksa ka qenë nën mbikqyrjen e rendit kalorsiak të templarëve, që ka qenë përzierje e monakisë dhe ushtrisë. Këta ia kanë përcaktuar usames një galeri në tempull që të mund të falet në të. Duke e konsideruar këtë përzierje të një musafiri - muslimani në pyetjet fetare, ka qenë shkas i kundërshtimit të rreptë të kryqtarëve rishtas të ardhur.¹⁶⁷ Pasi është dëshmuar se feja është shkak që i ka tërhequr kryqtarët në Jerusalem, dhe në pajtim me këtë edhe luftimet e përhershme, nuk duhet habitur se kryqtarët kanë hyrë në diskutime fetare kur iu paraqitej rasti të vijnë nëkontakt miqësor me muslimanët. Në këto rrethana teologët e krishterë, që të vijnë deri te supozimet e mirëfillta mbi islamin, kanë rënë në lidhje personale me muslimanët, dhe kanë përvetësuar mënyrë krejtësisht të re të gjykimit, që është shkak që mendjet janë tronditur, se janë paraqitur grupe të skizmatikëve. Për këtë arsye nuk duhet të shprehim habi që prej tyre shumë

sosh drejtpërdrejt janë tërhequr në rreth të islamit.168 Në shekullin e 12 janë rastet e shpeshta të renegatjes, të cilët janë zbatuar nëpër regjistrat tabelare të gjyqit kryqtar në Jerusalem, ashtu që bien në sy.169

Është interesant të mësohet kush janë këta muslimanë që kanë qenë të preokupuar me përvetësimin e këtyre konvertitëve të rinj. Mirëpo, këta misionarë nuk kanë lënë asgjë për veprimtarinë e vetë personale. Megjithatë dijmë se në krye të këtyre ka qenë Salahudini i madh, të cilin biografët e tij e 70

kanë përshkruar sikur “ai që i ka tërhequr kryqtarët në islam duke i dëftuar virtytet islame ndaj musafirëve të krishterë”.170

Është e qartë se jeta e Salahuddinut dhe vlerat e tij kalorsiake kanë qenë tërheqëse për mendjet e të krishterëve. Madje disa kalorsë kryqtarë kanë qenë aq të magjepsur sa e kanë lëshuar fenë e vet dhe shoqërinë e vet dhe iu bashkangjiten muslimanëve. Shembull i kësaj është rasti i kalorësit templar Anglezët Robertit. ky kalorës, duke e lëshuar krishterizmin në vitin 1185/581 H., u bë musliman i fortë, natyrisht u kurorëzua me mbesën e Salahuddinut.171 Dy vjet pas kësaj Salahudini e pushtoi Jerusalemin. Ndër robërit pas humbjes së ushtrisë së krishterë në Hattin ka qenë edhe mbreti i Jerusalemit Ludeviti. Gjatë kohës së rrëmujes luftarake gjashtë kalorës - si e cek këtë një kronistë - “të përshkruar me frymën satanike”, e lëshuan mbretin dhe kaluan në kampin e Salahuddinut, dhe vullnetarisht e përqaftuan islamit.172 Atëherë hyri në bisedime me Salahuddinin edhe grofi nga Tripoli (Tarablusi-Sham), Reymondi, dhe se, si u dëgjua, i ka rekomanduar ta pranohë islamit me suitën e vet, por vdekja e papritur e grofit e pengoi këtë synim.173

Ramja e Jerusalemit dhe sukseset e Salahuddinut e nxitën Evropën për kryzatën e tretë, ngjarje më e madhe e së cilës është rrethimi i Akres.

Vuajtjet e tmerrshme së cilave u qe ekspozuar ushtria e krishterë për shkak të urisë dhe sëmundjeve, kanë qenë shkas që shumë prej tyre, që të shpëtojnë prej kthetrave të urisë dhe vdekjes, u strehuan në kampin muslimanë. Më vonë disa nga këta kryqtarët janë kthyer, te disa kanë dëshiruar t’u bashkangjiten muslimanëve. Ndonëse disa, nga këta të fundit, si tregohet, u kanë bërë shërbime armiqëve të vet të dikurshëm, megjithatë kanë mbetur besnik fesë së vet dhe të pakënaqur me sunduesit e vet të ri, por është e njohur se shumica janë kthyer në islam. Për konvertimin e tyre vullnetar një kronist, i cili ka marrë pjesë në ekspeditën e përmendur me Rikardin, shkruan këtë: “Disa nga këta të ikur, fati i të cilëve as nuk mund të përshkruhet as të dëgjohet pa ndiesinë e dhembshme të pikëllimit, duke mos mundur ta durojnë trishtimin e urisë, që t’i shpëtojnë trupat, nxitën mallkimin në shpirtërat e tyre. Pasi kaluan në anën e Turqëve shumë më vonë, pas fatkeqësive të kaluara u bënë edhe heretikë. Që ta vazhdojnë një hap jetën e vet materiale, për mosbesimin nevoritës kanë blerë vdekjen e amshueshme. Ah, akt i paturp, që meriton të gjitha denimet e mundshme! Ah, të marrët njerëz, që u gjasojnë kafshëve që nuk kuptojnë! Duke u orvatur të shpëtojnë nga vdekja momentale, nuk ruhen nga e amshueshmja”.175 Duke

filluar nga kjo kohë, shpesh hasim në të dhënat e udhëtarëve që kanë udhëtuar nëpër Palestinë dhe vendet tjera islame për këta "heretikë". Pasi muslimanët e kapën shën Ludevitin, që detyruar të obligohet se do ta jep shpagimin. Në atë kohë e ka përgatitur betimin, të cilin dukej ta jepte një i kthyer para muslimanëve, prifti i dikurshëm.¹⁷⁰ Deri sa kryhej procedura e 71

pagimit të shpagimit (për krim nga robëria, N.I.), një konvertit nga Provansa ka ardhur atje t'i ofrojë dhurata mbretit. Ky Francez para kësaj në shoqëri të mbretit Gjonit në vitin 1219 u nisë për fushatë në Dimjat (Damiette). Në fund u vendos në Egjipt ku arriti pasuri të madhe dhe u martua me muslimane.¹⁷⁷ Qartë kuptohet nga libri "Kujtimet", që e ka shkruar në vitin 1266 një udhëheqës i kalorësve francezë, Amory de Rache, se sa janë frikësuar që pelegrinët e krishterë, të cilët shkojnë në Jerusalem, mos të kalojnë në islam. E ka lutur papën dhe nuncët e tij që mos të japin leje për rrugë nëpër det në Palestinë të varfërve dhe pleqëve, që nuk mund të bartin armë, duke cekur si shkak se të tillët muslimanët ose i mbysin, ose i robërojnë ose më në fund renegaten nga krishterizmi.¹⁷⁸ Rudolf de Zucham, i cili në perioden prej vitit 1336 deri 1342 ka udhëtuar nëpër Palestinë, rrëfeu se ka takuar tre persona që e kanë pranuar islamin. Këta të kthyer, që kanë rrjedhur nga qarqet priftërore, kanë qenë në shoqëri të kalorësve vestfalstas, që kanë fituar respektin e sulltanit dhe udhëheqësve tjerë islamë.¹⁷⁹ Nuk ka dyshi se këto lajme të shkapërderdhura paraqesin dëftues se kalimet nga krishterizmi në islam kanë kapur dimensione më të gjëra, porse nuk janë ruajtur deri sot të dhënat për ta. Përmendet se në fund të shekullit 15 në Kasire kaluan në islam 25.000 konvertitë.¹⁸⁰ Është mjaft e besueshme se ka pasur shumë konvertitë në qytetet palestineze pas ramjes së Principatës Latine në Lindje, por që historianët islamë, të cilët atëherë kanë qenë aq të historianët islamë, të cilët atëherë kanë qenë aq të preokupuar me fatin dhe madhërinë e dinastive islame dhe me avaturat e njerëzve të rëndësishëm, as nuk kanë vërejtur në kthimin e personave jo fort të rëndësishëm. Si kuptohet: këto historianë islamë, pasi nuk kanë pasur vëmendjen në konvertimin në islam, ashtu nuk kanë pasur as për rastet e renegatjes, të cilët do të paraqiteshin në mesin e bashkëbesimtarëve të vet. Kështu jemi të detyruar të kënaqemi me të dhënat e autorëve të krishterë edhe në rastet e konvertimit edhe në rastet e renegatjes. Autorët e krishterë japin të dhëna të hollësishme e të vlefshme për ata që i kanë tërhequr në fenë e vet, kurse në ngjyrën sa më të zeze i paraqesin caqet dhe synimet e atyre që kalojnë prej fesë së tyre në islam. Duhet se në mendjet e këtyre autorëve të krishterë nuk ka mundur të gjejë vend mundësia se një i krishterë sinqerisht dhe me nderë, për shkak të besimit, ka mundur të kthehet në islam. Madje nëse edhe u binte në mend kjo mundësi, ato nuk e përmendnin nga frika që mos të nxisin mbivete vetëtimat e qortimit kishtar.

Si shembull rasteve të ngjashme të kthimit, të cilët saktë janë shënuar - që është përjashtim i rrallë-ceken të dhënat për F. von Heimendorfin, i cili në vitin 1565 ka qenë në Kairo. Thuhet në një vepër latine se ky dijetar

gjerman, i cili i ka kryer studimet e veta në Leipzig, singërisht është kthyer në islam.181

72

Ja, nga burimet e përmendura historike pak të dhëna mund të grumbullojmë për kthimet e singërtë dhe për ndërmarrjet misionariste që i kanë shtyrë që ta ndërrojnë fenë. Më së shumti si shkak i konvertimit ceket se më ndërrimin e fesë dëshirohet të shpëtohet nga denimi me vdekje. Veprat e udhëtarëve evropianë flasin shumë për këtë. Shembull për këto rrëfime janë të dhënat, të shkruara me gjuhë të dekoruara, të njëjzë, nga të cilët zgjidhet ky: - Nje Kobt i krishterë, pak nga mllefi pak për shkak të zellit fetar pakujdesshëm të deklaruar e ka mbytur vëllaun e vet, sepse ky, që të shpëtojë nga persekutimi turk, me qyqëri e lëshoi Jezusin dhe kaloi në islam. Ai është parë pikërisht duke e kryer krimin dhe është kapur. Me guxim ka pranuar se i është mbytur vëllai dhe se ai e ka mbytur, sepse ka rënë, që emrin e tij e ka njoollorur të cilën është dashur ta lajë me gjakë. Atëherë i kanë cekur kriminelit, se nëse e ndërron fenë, se do të shpëtojë nga denimi(?). Ndonëse iu tha se ka vendosur të vdesë si i krishterë, vendimi i tij u dobësua, kur gjakatarët, për shkak të ekzekutimit, kanë filluar ta mundojnë, dhe se në çastin e fundit ka qenë i detyruar të deklarojë se e ndërron fenë. Kjo gjendje e pafatshme në një çast e ka shndërruar nga pjesëtarë i zellshëm në renegat, nga martiri në jobesimtar, prej fëmijës në të mallkuar, nga engjëlli në Lucifer të vërttë. Në mënyrën islame e ka theksuar "deklaratën islame" (kelime-i shehadetin, vër. N.I.), ose më drejtë: ka shqiptuar deklaratën e nënçmimit të vet. Në këtë është lëshuar në liri, por jo në lirinë e të dashurve të Zotit, por në lirinë e njerëzve të shkatërruar. Diç më vonë, për shkak të brejtjes së ndërgjegjjes, është kthyer në fenë e vjetër, dhe se muslimanët, në bazë të kësaj, e kanë mbytur.182

Në një vepër, që e ka shkruar apati Burghardt183 në vitin 1283, domethënë kur kryqtarët janë persekutuar nga fortifikata e fundit, kur u zhduk sundimi latin nga Lindja, pohohet se në të gjitha vendet, që konsiderohen islame, dominon numri i të krishterëve përveç në Arabi dhe Egjipt dhe se përqindja e muslimanëve ndaj të tjerëve është 3% ose 4%: Është e qartë se ky flet hiperbollikisht. Ky opat i ndershëm ka qenë i pakujdesshëm, dhe se sipas gjendjes që e ka parë në Mbretërinë e vogël Armene, e cila edhe me vende të tjera ka rënë nën kryqtarët, ka përfunduar edhe për viset tjera lindore. Por nga fjalët e tij mund të përfundohej se nuk ka pasur konvertime të dimensioneve më të gjëra gjatë sundimit të kryqtarëve, dhe se muslimanët, pasi sërish e pushtuan Palestinën, ua kanë dhënë të krishterëve privilegjet e vjetra dhe se këta janë pajtuar që ta blejnë për xhizjen paqën dhe shpëtimin.

Pa dyshim të krishterët vendas ia kanë parashtruar sundimin islam atij kryqtar. Është e qartë se të krishterët e Palestinës, kur Jerusalemi për herë të fundit ra në duart e muslimanëve, mirë i kanë pranuar zotërinjtë e vet të ri dhe me kënaqësi u janë bashkangjitur administratës së tyre.

73

Kjo ndjenjë e sigurisë fetare nën administrimin islam i ka shtyrë po ashtu të krishterët e Azisë së Vogël që singërisht t'u dalin përpara Selxhukëve, të cilët atëherë posa filluan të përparojnë. Këta të krishterë janë frikësuar nga fryma ndjekëse e kishës lindore. Madje gjatë sundimit të Mihajlos së VII (1261-1282/660-681 H.) banorët e qyteteve të vogla në Azi të Vogël, me qëllim që të shpëtojnë nga despotizmi bizantinas, i ftuan Turqit që t'i pushtojnë. Për më tepër, shumë banorë, të varfër e të pasur, kanë dëshiruar të ikin në territoret turke.¹⁸⁴

Kisha armene dhe gjeorgjite

Duhet të japim të dhëna edhe për dy institucione kishtare në Azinë perëndimore, atë armend dhe gjeorgjiane. Kisha që më së paku i ka shërbyer përhapjes së islamit është ajo armene. Do të kënaqemi në këtë pjesë me disa fjalë mbi raportet e Armenëve dhe muslimanëve gjatë historisë.

Duke iu falënderuar rezistencës kapricioze të këtij populli dhe lojalitetit të tij krishterizmit, përkundër luftërave shekullore, sulmeve dhe persekutimeve, përkundër tronditjeve të sulmit arab, mbretëria ermenase është ruajtur. Madje edhe në shekullin e IX ka zënë pozitën e shtetit të rëndësishëm. Gjatë kohës së shkatërrimit të hilafetit të Bagdadit ku fituan shumë lehtësi, por në shekullin e XI ka qenë e ekspozuar invazionit të Selxhukëve. Ndonëse disa ikacakë ermenas kanë arritur ta formojnë Armeninë e Vogël, edhe kjo në shekullin e XIV u zhduk. Armenët, ndonëse e humbën pavarësinë e tyre, e kanë ruajtur vetëdijen e vet nacionale. Në sundimin e Turqëve kisha armene ka qenë burim i frymëzimit dhe i përtëritjes së patriotizmit të qëndrueshëm armen, sikur ka qenë edhe në Greqi - thotë autori Tavernieri.¹⁸⁵ "Mund të gjenden Armenë që e kanë përqaftuar islamit për shkak të dobive materiale, por Armenët janë njerëzit më inatçi në botë", sepse fuqishëm i janë lojal disa parimeve popullore.

Kisha gjeorgjiane (Kirkoriane) osegjurgjiane, si fëmijë i kishës lindore, është themeluar kah fillimi i shekullit IV sipas Isaut, dhe se lidhja e saj me kishën lindore ka qëndruar gjatë kohë. Por dyqind vjet më vonë, patrikana gjeorgjiane (katogigosluk*) u nga nga rrethi sektash bizantinas dhe e shpalli pavarësinë e vet.

Historia e këtij populli luftarak, të copëtuar me mospajtimet e brendshme, vazhdimisht të ekspozuar sulmeve të Bizantinasëve, Persianëve, Arabëve, Turqëve dhe Mongolëve, gati pa ndërprerje përbëhet prej luftërave me armikun e huaj dhe mospajtimeve të egra ndërmjet sunduesëve të tyre. Fryma liridashëse e Gjeorgjianëve, që nuk ka mundur ta durojë sundimin e askujt mbi vete, shpesh deri në stërkeqje i hidhëronte muslimanët fqinjë të cilët nuk kanë mundur t'ua imponojnë as sundimin shpirtëror as botëror. Momenti se ndërrimi i fesë është kuptuar me humbjen e pavarësisë politike,⁷⁴

shpjegohet si shkak që në kronikën e kishës gjeorgjiane janë shënuar shumë emra të martirëve, deri sa analet e të njëjtës kohë të kishës lindore nuk mund të lavdohen me shënimet aq krenare.

Hordhitë mangole, të cilat pas vetes kanë lënë kishat e manastiret e

rrënuara dhe piramidat e kafkave të njeriut, e zvogëluan numrin e priftërisë, dhe pasi gjatë kohë pas kësaj fatkeqësie populli nuk ka plotësuar nevojat e veta shpirtërore, filloi edhe krishterizmi në Gjeorgji të zhduket.186 Madje edhe disa që i kanë mbetur besnikë krishterizmit, ua kanë rritur mjerimin dhe fatkeqësinë priftërisë, duke i përvetësuar të ardhurat e tempujve dhe duke i plaçkitur pasuritë e kishave dhe manastireve, dhe në këtë mënyrë e kanë ndihmuar gjykimin me vdekje të krishterizmit në vendin e vet.187

Invazion i Timurlenkos më 1400/803 H. i shtoi vuajtjeve të Gjeorgjisë tmerre të reja. Në kohën e Aleksandrit I u shpëtuan në zgjedhën e huaj dhe i larguan muslimanët, por pas vdekjes së tij Gjeorgjia sërish u copëtua në principata të vogla ashtu që Turqit dhe Persianët, duke e shfrytëzuar këtë, i çrrënjosën edhe mbeturinat e fundit të pavarësisë së Gjeorgjisë. Mirëpo, muslimanët e kanë konsideruar Gjeorgjinë vend të pafatshëm, dhe në çdo rast, e edhe më të voglin të gatshëm për kryengritje. Si Turqit, ashtu edhe Persianët janë orvatur ta sigurojnë nënshtrimin e popullatës së atjeshme me anë të konvertimit. Me ramjen e Stambollit, prandaj edhe me forcimin e ndikimit turk në Azinë e Vogël, popullata e Ahashes dhe të rrethinës së saj kaluan në islam.188 Në Stamboll kanë ardhur në vitin 1579 si deputacion dy vëllezër nga princat gjeorgjian me suitën prej edhe dyqind njerëzve. I riu kaloi në islam me suitën e tij gjoja me qëllim që të kalojë në pozitë të vëllaut të vet.189 Pak më vonë pas kësaj date pushtimi turk u shtri deri te vetë zemra e Gjeorgjisë, dhe se popullata e saj e përqafoi fenë e pushtuesit.190 Prej atëherë pjesa perëndimore e Gjeorgjisë është bërë krahinë turke. Megjithatë kanë mbetur shumë Gjeorgjianë vazhdimisht lojal krishterizmit, por pasi atje shtëpia sunduese në vitin 1625/1035 H. kaloi në islam, shumë princa dhe fisnikë shkuan pas tyre.

Krishterizmi edhe gjatë kohë ka sunduar në fshatra. Pasi disa priftër nuk pajtuan me patrikun (katogikosin) në Samcih (Samcikhe), nuk janë kujdesuar për nevojat shpirtërore të popullatës. Fisnia, e cila para kalimit të vet në islam ka grabitur të mirat kishtare, pas konvertimit të vet natyrisht ka pushuar të jep lëmoshë ("lëmoshinën") dhe përkrahje, dhe se kishat dhe manastiret janë shndërruar në egërmathe, kurse vendet e tyre i kanë zënë xhamitë.191

Pas tyre shkuan edhe pjesët tjera të Gjeorgjisë (Gjurgjistanit). Tavernieri i përmendur lartë, kur kah gjysma e shekullit XVII i vizitoi këto vise, pohon se në pjesën që i ka takuar Persisë kanë sunduar dy princa, të cilët, para se të kenë ardhur në pozitë të tyre zyrtare, janë kthyer në islam.192 Ata janë edukuar në pallatin persian. Tavernieri i ka përshkruar Gjeorgjianët sikur

75
mjaft të paarsimuar në aspektin fetar. Thotë se priftërit u dijnë të lexojnë, por jo edhe të shkruajnë. Ka konstatuar se disa autoritete kishtare ua kanë shitur djelmohat dhe vashat Turqëve dhe Persianëve.193 Duke filluar nga atëherë, u rritë numri i konvertitëve në islam, e sidomos në mesin e shtresave të larta, të cilët dëshironin ta fitojnë simpatinë e pallatit persian.194 Vahtangu IV, i cili në vitin 1701, sundoi në Gjeorgji, ishte i krishterë. Shtatë vitet e para të

sundimit të vet i kaloi në Isfahan. Deri sa ishte atje, iu rekomandua ta përqafojë islamin. Iu tha se dëshiron ta ruaj pozitën, qoftë me çmimin e "renegatjes". Sipas një versioni shihet se madje vëllau i tij i ri, i cili më parë ishte patrik gjeorgjian, u obligua ta përqafojë islamin nëse i jepet kjo pozitë. Pas Vahtangut Persianët ia dhanë atë pozitë, por pasi që Gjeorgjianët nuk deshën ta pranojnë, e larguan nga aty.¹⁹⁵

Kah fundi i shekullit XVIII mbretëria gjeorgjiane me popullatën e vet ra nën protektoratin rus. Pasi që Gjeorgjia që nën sundimin e të huajve muslimaneve, ndjenja e thellë nacionale deri atëherë ka qenë mbështetje shpirtërore dhe mjet ringjalles i fesë. Por tash shteti, që përgatitej ta grabisë pavarësinë e tyre, ishte i fesë së krishterë, dhe se kjo rrethanë rezultoi përshtypjen në viset veriore të Kavkazit në dobi të islamit. Njëfarë dervishi Mensur u orvatë t'i bashkojë fiset e ndryshme në Dagestan kundër Rusëve. Me predikimet e veta mbi islamin ka arritur të kthejë në islam shumë bujarë dhe kryeparë të Dagestanit dhe Ubyhistanit. Shumë Çerkezë në predikimet e tij janë kthyer në islam, dhe se kanë dëshiruar të shkojnë në internim se sa të mbeten nën sundimin rus.¹⁹⁶ Por në vitin 1791-1806 H. edhe Mensuri ra në robëri Vitin vijues edhe Gjeorgjia ra nën sundimin rus.

Nuk është orvatur vetëm dervish Mensuri t'i kthejë Çerkezët në islam.

Pas marrëveshjes në Küçük Kajnarxhi (1774-1813 H.) kur është miratuar klauzula për mëvetësinë e Krimin, domethënë kur i është mundësuar dalje e lirë marinës ruse në Detin e Zi, shteti Osmanli është frikësuar duke parandier se Rusët do të luftojnë edhe në drejtim të bregut lindor të detit të Zi, prandaj i ka nxitur Çerkezët në rezistencë. Është dërguar oficeri me emrin Ferah Ali që ta formojë në Anap një koloni ushtarake. Detyra e parë e Ferah Aliut, pasi ra në kontakt me Çerkezët, ka qenë ajo që e ka kërkuar vajzën e një begu çerkes, duke i falë shumë armë dhe pasuri. Pasi Ferah Aliu solemnisht e kaloi gostinë, i mallëngjei edhe ushtarët të cilët ishin nën komandën e tij, dhe edhe ata shkuan pas tij. Madje u obligua vetë Ferah Aliu të gjitha shpenzimet e tyre t'i bartë. Rezultat i kësaj ishte se shumë Çerkezë hynë në koloninë e vogël turke dhe e përqafuluan fenë e burrave të tyre, dhe me zelltari mallëngjyese, që është karakteristike për të kthyerit e rij, kanë arritur për islam kthimtarë të rinj ndër vëllezërit dhe babajt e vet. Duke filluar prej atëherë ka mugulluar në mesin e tyre lëvizja aktive misionariste. Ashtu, duke e lëshuar idhujtarinë, Çerkezët nga kolonia turke dhe ata që kanë ardhë në kontakt me ta e pranuan Kur'anin. Hoxhët e atjeshëm me

76

entuziazëm të madh janë orvatur t'i mesojnë me rregullat fetare. Është kërkuar ndihma nga Stambolli që t'u lehtësohet veprimi i tyre me kthimtarët, numri i të cilëve gjithnjë e më shumë rritej,¹⁹⁷ por jeta aktive e Ferah Aliut ka qenë e shkurtë, sepse në vitin 1785/1800 H. vdiq. Atëherë varri i tij u bë vend pelegrini sikur varri i ndonjë njeriu të shenjtë. Mirëpo, puna të cilën ai e nisi me të u zhduk. Anapa në vitin 1812/1827 H. kaloi në duart të Rusëve, kurse në vitin 1864/1881 H. Rusët e thyen rezistencën e Çerkezëve. Pas kësaj, si rrëfëhet, gjysmë milioni Çerkezë janë shpërngulur në territorin turk.

Nën sundimin rus ka qenë i ndaluar konvertimi në cilën do fe përveç në ortodoksizëm. Në pajtim me këtë, kjo e ka penguar përhapjen e mëtejme të islamit deri më 1905, deri sa nuk u dha proklamata për tolerancën fetare. Një nga rezultatet e kësaj proklamate është ky se Abazët, të cilët sa për sy e faqe ishin kthyer në krishterizëm, filluan në grupe të kalojnë në islam ashtu që për këtë shkak kierarkia kishtare ortodokse u tmerrua, dhe se kundër ndikimit islam ka formuar këshillin me qëllim të propagandës ndër ta.¹⁹⁸

- 1) Dollinger, fq. 5-6.
- 2) Caetani, Studi di Storia Orientale, I, fq. 365, (Milano; 1911).
- 3) Caetani plotësisht drejt e ka komentuar se këto pushtime arabe kanë qenë shpërngulja e fundit e madhe e Semitëve, vol. II, fq. 831-861.
- 4) Caetani, vol. II, fq. 455 (Në Medine është formuar shoqëria fetare e përbërë nga elementet e ndryshme. Shumicën megjithatë e kanë përbërë Medinasit të cilët fuqishë mdhe përkushtueshëm e kanë pranuar islam. Mësimin e ri e kanë mbajtur, fortë të bindur se me këtë e kënaqin vetëveten dhe e respektojnë vullnetin e Pejgamberit).
- 5) Mas'udi, bleni IV, fq. 238.
- 6) Muir's Chaliphate, fq. 121-122.
- 7) Caetani, vol. III, fq. 814 (323).
- 8) Caetani, vol. II, fq. 260, 290, 351.
- 9) Caetani, vol. II, fq. 792-793, vol. III, fq. 253 (8).
- 10) Caetani, vol. II, fq. I/12-15.
- 11) Muir's Chaliphate, fq. 90-94.
- 12) Caetani, vol. II, fq. 299, Welhausen, IV, fq. 156 (not. 5)
- 13) Tabari, Prima Series, fq. 2482.
- 14) Për shkak të studimit të hollësishëm mbi xhizjen, të krijuar në organizimin e shkëlqyeshëm dhe hulumtimin kritik të tërë materialit disponues historik, shih: Caetani, vol. V, fq. 329 e më tej; Për Egjiptin gjatë kohës së shekullit të parë të sundimit islam shih: Bell, fq. 167 e më tej dhe Becker, Beiträge zur Geshichte Aegyptens unter dem Islam, fq. 81 e më tej.
- 77
- 15) Caetani (vol. IV, fq. 227) konsideron se kjo tregim është çpikje e periodës së mëvonshme, që ta shpjegojë veçanësinë e këtij fisi të krishterë në mirësjellje meta sikur me muslimanët.
- 16) Caetani, vol. II, fq. 1180.
- *) El-Mehdin është halifi i tretë abasitë, kurse ka sunduar në vitin 775-785. Ka zhvilluar luftëra të shpeshta me Bizantin, gjatë kohës së sundimit të tij ushtria muslimane ka rrethuar Stambollin nën udhëheqjen e të birit Harun err-Rreshidit, Hiti, vep. e cituar, fq. 278-279. (SH.N.)
- 17) Barhebraeus (3), fq. 134-135.
- 18) Caetani, vol> ii, fq. 828.
- 19) Tabari, I, fq. 2041.
- 20) Mas'udi, bleni IV, fq. 256.
- 21) Arabët në vitet e parë askend nuk e kanë terrorizuar për shkak të

fesë, as që kanë punuar në tërheqjen me forcë në fenë e vet. Për këtë shkak të krishterët Semitë kanë gëzuar nën sundimin islam në pushtimet e para liri të tilla, çfarë me gjenerata nuk kanë pasur më herët". (Shih: Caetani, vol. V, fq. 4).

22) Sir Henry Layard, *Early Adventures in Persia, Susiana and Babylonia*, vol. I, fq. 100 (London, 1887); R. Hartmann, *Die Herrschaft von al-Karak*. (Der Islam, vol. II, fq. 137).

23) Burckhardt (@), fq. 564.

24) W. G. Palgrave, *Essays on Eastern Questions*, fq. 206-208 (London, 1872).

25) Kjo drojë do të ishte e pabazuar sikur mos të merret parasysh mosdurimin e imperatorit që e ka treguar ndaj sektit të jakobitëve, në kohën e përparimit të tij nëpër Siri, pasi që i fitoi Persianët në vitin 627. (Shih: Michael the Elder, vol. II, fq. 412; dhe Caetani, vol. II, fq. 1049). Për tmerrt që i kanë bërë ushtarët bizantinas ndaj bashkëbesimtarëve të vet gjatë sundimit të Konstantinit II (642-66*) shih: Michael the Elder, vol. II, fq. 443.

26) Michael the Elder, vol. II, fq. 412-413; Barhebracusi një shekull më vonë ka shkruar me tonin e njëjti (*Chronicon Ecclesiasticum*, ed. 7. B. Abbeloos et Lamy, fq. 474).

27) Azdi, fq. 97.

28) Balazuri, fq. 137.

29) Caetani, vol. III, fq. 813, vol. V, fq. 394. (Popullata me kënaqësi të qartë ka pranuar ndërrimin e pushtetit, sepse kanë mësuar se Arabët do t'i plotësojnë të drejtat e tyre personale dhe se do t'ua lënë lirinë e plotë në kryerjen e ritualeve fetare. Në Siri tërë qytetet e krahinat kanë nxituar që të merren vesh me Arabët, madje edhe para humbjes përfundimtare bizantinase. Në Sevdë janë nënshtruar pa rezistencë dhe kanë pranuar pushtetin e ri pa kurrfarë kushtesh.

78

Ka mundësi që kjo të ketë ndodhur edhe në Siri, sikur edhe në viset e shumta të largëta nga rrugët kryesore.

30) Gottheili ka tubuar përbledhje të vlefshme të evidencës së dokumentuar, që ka të bëjë me popjt që kanë hyrë nën sundimin muslimanë, në veprën e vet "Dhimis and Moslems in Egypt" (Jomuslimanët dhe muslimanët në Egjipt).

31) Balazuri, fq. 74, 116, 121.

32) Mbi hulumtimin kritik të këtij dokumenti shih: Caetani, vol. III, fq. 952 e më tej.

33) Tabari, I, fq. 2405.

34) Balazuri, fq. 129.

35) Ibn Sa'd, III, pjesa I, fq. 246.

36) *Memoire sur la conquête de la Syrie*, fq. 143 e më tej.

37) *Anali dell'Islam*, vol. III, fq. 957.

38) Disa autoritete në të drejtë islame konsiderojnë se ky rregull nuk ka

- të bëjë me fshatrat dhe fshatrat e vogla ku ndërtimi i kishave nuk është penguar (Hidayah, vol. II, fq. 219).
- 39) Ebu Jusufi (fq. 82) thotë se nuk ka pengesa që të krishterët të dalin në procesion një herë në vit me kryqat, por jo me flamurat, dhe këtë jashtë qytetit e jo brenda ku janë muslimanët dhe xhamitë e tyre.
- 40) Gottheil, fq. 382-384, cek versione të ndryshme të tekstit të këtij dokumenti.
- 41) Ekzistojnë provat që dëftojnë në atë se pushtuesit Arab, në tokat e pushtuara nga Bizantinët, kanë ruajtur sistemin finansues aktual pa ndonjë ndryshim në të dhe komentimi i xhizjes si haraç për kokë konsiderohet si novatori e juristëve të mëvonshëm, të cilët nuk e kanë njohur esencën e gjërave nga koha e islamit të hershëm. (Caetani, vol. IV, fq. 610 (231); vol. V, fq. 449, H. Lammens, Ziad ibn Abihi (Rivista degli Studi Orientali, vol. IV, fq. 215).
- 42) Goldziher, vol. I, fq. 50-57, 427-430; Caetani, vol. V, fq. 311 e më tej.
- 43) Caetani, vol. V, fq. 424 (752), 432.
- 44) Balazuri, fq. 124-125.
- 45) A. von Kremer, (I), vol. I, fq. 60, 436.
- 46) Një dirhem për afërsisht është 5 pensa ose gjysmë shilingu.
- 47) Bell, fq. XXV, 173.
- 48) Abn Yusuf, fq. 69-71.
- 49) Tabasi, Prima Series, fq. 2055.
- 50) Tabari, Prima Series, fq. 2050.
- 51) Abu Yusuf, fq. 81.
- 52) Balazuri, fq. 159.
- 53) Tabari, Prima Series, fq. 2665.
- 79
- 54) Marsigli, vol. I, fq. 86 (ai i quhan "Musellim").
- 55) Flinlay, vol. VI, fq. 30, 33)
- 56) Lazar, fq. 56.
- 57) Thomas Smith, fq. 324.
- 58) Dorosta mus, fq. 326.
- 59) De La Jonyuiere, fq. 265.
- 60) Lammens, fq. 13.
- 61) Ibn Abi Usaybi'ah, vol. I, fq. 164.
- 62) Michael the Elder, vol. II, fq. 475.
- 63) Mari b. Sulayman, fq. 71 (L. 16), Abu Nuh al-Anbari ka shkruar veprën kundër Kur'anit dhe punimeve tjera teologjike islame. (Wright, fq. 191, not. 3).
- 64) Mari b. Sulayman, fq. 84.
- 65) Hilalas-Sabi, fq. 95.
- 66) Ibn al-Athir, vol. IX, fq. 16.
- 67) Von Kremer, (I), vol. I, fq. 167-168; Lammens, fq. 11.
- 68) Renaudot, fq. 430, 540.

- 69) Von Kremer, (I), vol. II, fq. 180-181.
- 70) Von Kremer, (I), vol. I, fq. 183.
- 71) Caetani, vol. III, fq. 350 e më tej, 387 e më tej.
- 72) Gottheil, fq. 360-361; Goldziher, Zur Literatur des Ichtiauf almadahib, ZOMG, vol. 38, fq. 373-374.
- 73) Për këtë aspekt teoretik të literaturës juridike islame shih: Snonck Hungonje, Mohammedanisches Rexht in Theorie und Wirklichkeit.
- 74) Gottheil, fq. 363.
- 75) Michael tha Elder, vol. II, fq. 476; Renaudot, fq. 189.
- 76) Eutyclus, II, fq. 41; Severus (fq. 139) thotë se këto janë dy kisha".
- 77) Von Kremer (I), vol. II, fq. 175.
- 78) Michael the Elder, vol. II, fq. 490, 491.
- 79) Ibn Khallikan, vol. I, fq. 485.
- 80) Yaqut, vol. II, fq. 662.
- 81) Yaqut, vol. II, II, fq. 670.
- 82) Mari b. Sulayman, fq. 73.
- 83) Ishak of Romgla, fq. 266.
- 84) Eutychius, II, fq. 58.
- 85) Von Kremes (I), vol. II, fq. 175-176.
- 86) Renoudot, fq. 399.
- 87) Monaku dominikanas nga Floreuca me emrin Ricoldus de Monte Crucis e ka vizituar Lindjen kah fundi i shekullit XIII dhe fillimi i shekullit XIV, dhe ka folur për tolerancën që nestorianët e gëzojnë nën sundimin musliman, në kohën e tij. Në lidhje me këtë thotë: "Kam lexuar në kronikat e 80 vjetra dhe në veprat e Arabëve, të cilat janë të sigurta, se nestorianët kanë qenë miqë dhe aleatë të Muhammedit".
"Vetë Muhammedi i ka porositur trashëgimtarët e vet që ta ruajnë këtë miqësi me nestorianët, së cilës Arabët deri më sot i kushtojnë kujdes të veçantë." (Laureut, fq. 128).
- 88) F. Labourt, De Timotheo I, Nestorianorum Patriarcha, fq. 37 e më tej, (Paris, 1904).
- 89) E. von Dobschutz, fq. 390-391.
- 90) Michael the Elder, vol. II, fq. 439-440.
- 91) Makin, fq. 12, F. Labourt, Le Xhristianisme sous la dynastie sassanide, fq. 539 e më tej, (Paris, 1904).
- 92) Renoudot, fq. 169.
- 93) VOn Kremeri mirë e ka vërejtur: "Atë që e kemi mësuar për historinë politike dhe luftarake të atyre shekujve ua kemi borgj historianëve arabë të cilët nuk kanë ditur për lodhje dhe barrë në grumbullimin e lajmeve dhe të dhënave. Ndërmjet nesh dhe asaj historie qëndrojnë dymbëdhjetë shekuj. Për këtë shkak, krahas të gjitha problemeve, është i nevojshëm preciziteti. Historia e brendshme e kësaj periode sikur edhe historia e luftës ndërmjet fesë së re të thjeshtë dhe religjioneve të vjetra në të cilat janë krijuar sektet e komplikuara, për të cilat dijmë vetëm përgjithësisht". (Van

Kremer (2), fq. 1-2).

94) Thomas of Marga, vol. II, fq. 309 e më tej.

96) Përveç teksteve që janë përcjell këtu shih: "M'Clutach i Strong's n
ëEncyclopedia (Enciklopedia) me njësinë Mohammedanism, vol. VI, fq. 420.
James TrecmanClarke: Ten Creat Religions, pjesa II, fq. 75 (London, 1883).

97) Këtë e shprehi edhe imperatori Heraklie me gjuhën e historianit
musliman me fjalët: "Feja e tyre është fe e re që u jep hov të ri". (Tabari, fq.
2103).

98) History of Latin Christianity, vol. II, fq. 216-217.

99) Caetani, vol. II, fq. 1045-1046.

100) Teksti është lexuar para Chureh Congress at Wolverhampton
(kongresit kishtar në Veloerpton), October 7-th 1887.

101) Mbi sistemin e padurueshëm financiar nën imperatorinë bizantinase
shih: Gforver, Byzantinische Geschichten, vol. II, fq. 337-339, 389-391,
450.

102) "Islami ka qenë reaksion në sjelljen e keqe të Justinianit ndaj
njerëzisë. Veçanërisht ky ka qenë ndaj krishterizmit i cili e ka konsideruar
Justinianin për prisë të vetin shpirtëror dhe botëror.

Meritë të madhe për suksesin e Arabit Muhammedit, të lindur në vitin
571, domth. gjashtë vjet pas vdekjes së Justinianit, në misionin e tij të
pashembullt ka pakënaqësia dhe antipatia që e kanë ndier popujt që kanë
qenë në kufijt e Imperatorisë Bizantinase, sikur edhe ata që kanë qenë në
81

fqinjësi të saj, për shkak të tmerreve që i ka bërë Vasilija. (Glarver,
Byzantinische Geschichten, vol. II, fq. 437).

103) Gforver, vol. II, fq. 296-306, 337.

104) Gforver, vol. II, fq. 442-444.

105) Gfarver, vol. II, fq. 445.

106) Mas'udi, vol. II, fq. 387.

107) Von Kremer (2), fq. 8.

108) VOn Kremer (2), fq. 54 dhe (3), fq. 32, Nicholson, fq. 231.

109) Rrëfëhet se Muhammed b. Hudhejl, filozofi dhe edukatori
ma'tezilit i halifit Me'mun, ka kaluar në islam më shumë se tre mijë persona
(Ahmed b. Jahja b. el-Murteda, fq. 26, 27).

110) Von Kremer (2) fq. 3,7-8; C.H. Becker, Christilche Polemik und
islamische Dogmen bildung (Zeitschrift fur Assyriologic, XXVI, 1912).

111) Ibn Khallikan, vol. I, fq. 45.

112) Wustefeld, fq. 103.

113) Michael the Elder, vol. II, fq. 412-413; Caetani, vol. V, fq. 508:

"Fitorët që muslimanët i patën ndaj Bizantinasëve dhe Persianëve nuk kanë
qenë vetëm fitoret e Arabëve ndaj popujve të krahinave të nënshtruara, por
në sytë e Lindasëve të cilët në çdo ndodhi shohin fuqinë e Zotit, kanë qenë
edhe fitoret e mësimin islam kundrejt krishterizmit dhe mazdaizmit, e veçuan
fitoret ndaj krishterizmit".

114) Goldziher, vol. I, kaptina 3 dhe 4.

- 115) I fundit nga këta ka zbuluar tentimin e të krishterëve që ta djegin qytetin Kairo. (De Gignes, vol. IV, fq. 204-205). Gottheil, fq. 359, Journal Asiatique, IV, seria, bleni XVII (1851) fq. 454, 455, 463, 484, 491).
- 116) Assemani, bleni III, pars, 2, p.c., Renaudot, fq. 432, 603, 607.
- 117) Muir, the Caliphate, fq. 475.
- 118) Von Kremer, (3), fq. 246.
- 11) Muir (1), fq. 508, 516-517.
- 120) Mari b. Sulayman, fq. 79 e më tej; Saliba b. Yuhanna, fq. 71.
- 121) Gottheil, fq. 364 e më tej.
- 122) Mari b. Sulayman, fq. 114 (LL. 14-16).
- 123) Duhet se ky hadith transmetohet në disa versione, për shembull:
"Kush i bënë padrejtësi atij me të cilin është bërë kontratë (dhimmiu) dhe e ngarkon mbi mundësitë e tij, unë do t'i bëhem paditës. (Balazuri, fq. 162) (Yahya b. Adem, fq. 54 i shtonë fjalët: "deri në ditën e Gjykimit"). "Kush e shqetëson dhimmiun që e paguan xhizjen dhe e dëfton nënshtrimin e vet - ky është armik i imi". (Usudu el-Gaba, cituar sipas Goldziherit në Jewish Encyclopedie, vol. VI, fq. 655). Historiani i krishterë Al-Makin (fq. 11) e cek në versionin: "Kush e shqetëson dhimmiun, më shqetëson edhe mua".
- 82
- 124) Journal Asiatique, IV serie, bl. XIX, fq. 109 (Paris, 1852). Shih gjithashtu R. Gatheil, A Fetwa on the appointment of Dhimmis to office (Zeitschrift fur Assyriologie, vol. XXVI, fq. 203 e më tej.)
- 125) Belin, fq. 435-440, 442, 448, 456, 459-461, 479-480.
- 126) Belin, fq. 435, not. 2.
- 127) Belin, fq. 478.
- 128) Mari b. Sulayman (fq. 115, reshti 1-2) ofron shpjegim të këtij gabimi me persekutime që ndodhin në fillim të shekullit të dhjetë dhe thotë: "Shumë kanë kaluar në islam, kurse shkak i kësaj është shkapërderdhja në fe dhe sjellja e keqe e priftërve në oltar, tempull dhe vende të shenjtë.
- 129) Halifi egjiptian Al-Hakimi (996-1020) ka urdhëruar që të gjithë Hebraikët e të krishterët ta lëshojnë Egjiptin e të shpërngulen në territorin bizantinas. Në lutjen e tyre e tërhoqi urdhëresën e vet. (Makrizi, (I), fq. 91). Sidoqoftë, halifi ka pasur mundësi që këtë ta zbatojë me dhunë, siç e ka kryer këtë Sultan Selimi I i rreptë (1512-1520), i cili me qëllim që t'i përfundojë çarjet religjioze në vendin e vet ka shkaltuar masakrin ndaj 40.000 shi'itëve. Politikën e planifikuar ka menduar ta mbarojë me çrrënjosjen edhe të krishterëve.
- Duke i lejuar vetes abstenim nga ky kurs, pa dyshim e ka bërë këtë në pajtim me politikën e përgjithshme të cilën sunduesit islamë e kanë pasur ndaj shtetasve të vet të krishterë. (Finloy, vol. V, fq. 29-30).
- Shkasë mendimeve të tij disa ia atribuojnë inkuizicionit në Spanjë, që në atë kohë zbatohet, dhe se sulltan Selimi si ndëshkim për torturat të zbatuara ndaj muslimanëve në Spanjë, dëshiroi t'i detyrojë të krishterët ta pranojnë islamin. Por kur t'i marrim parasysh idetë dhe synimet e këtij sunduesi e politikani të madh, janë të arsyeshëm theksimet e autorit Arnoldit. Si kishte

dëshirë, sulltan Selimi iu drejtua Meshihatit që në këtë aspekt të jep lejen (fatvanë) sipas të gjitha gjasave duke cekur si shkak veprat e inkuizicionit. Shejhu-l-islami i atëhershëm, Zambil-li Ali efendiu, shembull i vetëdijes fetare e qytetare, iu përgjegj se nuk mund t'ia jap, sepse kjo kundërshtohet me rregullat e islamit mbi dhimmitë. Kur sulltan Selimi iu kërcënua se do ta heqë nga pozita, ai iu përgjegj se do ta jep vendimin mbi shkarkimin e tij. (Sh.N.)

130) Silbernagl, fq. 268.

131) Silbernagl, fq. 307, 360.

132) Silbernagl, fq. 25-26.

133) Ibid, fq. 335.

134) Ibid, fq. 384.

135) Shih: A. von Kremer, (I), vol. II, fq. 490-492.

136) Shkretërimi i Stambollit nga ana e kryqtarëve në vitin 1204 mund të merret si model i sjelljes së Latinëve me të krishterët e kishës lindore.

Barhebraeusi ankohet se manastirin Harran e ka sulmuar kont Goscelini, 83

zotëriu i Emessit (Homsit në Siri) dhe në vitin 1184 i ka shkaktuar dëm të atillë sikur të ishte Saracen (Arab) ose Turk (Barhebraeusi (I), vol. II, fq. 506-508).

137) H. H. Milman, vol. II, fq. 218.

138) A. von Kremer (I), vol. I, fq. 172.

139) Assemani, bl. III, Paris Pria, fq. 130-131.

140) Ibn Sa'd, Tabaqat, vol. V, fq. 259.

141) Ibn Sa'd, tabaqat, vol. V, fq. 262.

142) August Müller, vol. I, fq. 440.

143) Migne, Potr, gr. bl. 96, fq. 1336-1348.

144) Migne, Port, gr. bl. 97, fq. 1528-1529, 1548-1561.

145) Migne, Port, gr. bl. 97, fq. 1557.

146) Amr b. Mattai, fq. 65.

147) Amr b. Mattai, fq. 72.

148) Risala 'Abdullah b. Ismail al-Hashimi ila 'Abd al-Masih b. Ishaq al-Kindi, fq. 1-37. (London, 1885). (Trajtesa e Abdullah b. Ismail el-Hashimij Abdulmesih b. Ishak el-Kindiut).

149) Shtojca I. Shih edhe Shtojca II për shikim në literaturën polemizuese muslimane.

150) Kindi, fq. 111-113.

151) Balazuri, fq. 430.

152) Ka mundësi që shkasi i vizitës së Jazdeubahtit Bagdfadit është ftesa e Me'munit që të mbahet tubimi i madh i liderëve të të gjitha bashkësive fetare të asaj kohe, kur erdhi deri te veshi i halifit se kundërshtarët e islamit deklarojnë se islami sukseseve të veta duhet falënderuar shpatës (forcës) e jo fuqisë së argumenteve.

Në këtë tubim dijetarët islamë e kanë mbrojtur fenë e vet nga akuzat e paarsyeshme. Thuhet se kundërshtarët kanë pranuar se muslimanët u kanë

ofruar prova të mjaftueshme. (Ahmad b. Yahya b. al-Murtada, Al-manyah wa l'amal fi sharh kitab al-milal wa n-nihal, British Museum, Or. 3937, fol. 53 (b), L. 9-11).

153) Kitab al-Fihrist, vol. I, fq. 338.

154) Barhebraeus (I), vol. III, fq. 194.

155) Mari b. Sulayman, fq. 101 (L. 3-4).

156) Barhebraeus (1), vol. III, fq. 230.

157) Barhebraeus (I), vol. III, fq. 248.

158) Të gjithë patrikët jakobitë marrin emrin Ignacie. Para shugurimit është quajtur Mark bar Qiqi.

159) Barhebraeus (I), vol. III, fq. 288-290. Elios of Nisibis, fq. 153-154.

Me atë që është kthyer në krishterizëm para vdekjes, që i ka ndodhur njezet vjet më vonë.

84

Dy raset të ngjashme janë regjistruar në analet e patrikëve jakobitë të Antiohisë në shekullin e XVI. Një prej tyre është rasti Jasen, i cili u bë musliman në vitin 1517, por më vonë bëri renegatje dhe iku në Qipro (i cili atëherë ishte në duart e Venedikasëve), ku ra në ëgjunjë pendueshëm para dyerve të një kisha dhe lejoi që mbi trup t'i kalojnë ata që hynin dhe dilnin nga ajo.

I dyti është Ni'metullahi, që jetoi rreth vitit 1560, kurse i cili pasi e la islamin dhe sërish kaloi në krishterizëm dhe fitoi faljen prej papës Grgurit XIII në Romë. (Barhebraeus (I), vol. II, fq. 847-848).

160) Në realitet Eliosi nga Nisebia, kronisti bashkëkohor i kalimit të patrikut jakobit në islam nuk e përmend çoroditjen e tillë. Këtë nuk e bënë as Mari b. Sulayman (fq. 115-116), historian i kishës rivale nestoriane, ndonëse ai e akuzon për grabitjen e enëve të shenjta dhe fotografive kishtare. Po ashtu Wright (Syriac Literature, fq. 192) thotë sipas fjalvëe të Jozefit patrikut të Mervas: "Nuk kemi nevojë të besojmë në çdo gjë që për këtë njeri të shkretë thotë Barhebraeusi".

161) Barhebraeusi (I), vol. II, fq. 518.

162) Barhebraeus (I), vol. II, fq. 712 e më tej.

163) Historia Orientalis, e 15 (fq. 45).

164) De Guignes, bl. II (Seconde Partie), fq. 15.

165) Odo de Diogilo (De Ludovici VII, Intinere, Migne, Potr. Lot. bl. X XCV, fq. 1243).

166) Guizot: Histoire de la civilization en Europe, fq. 234 (Paris, 1882).

167) Usama b. Munqidh, fq. 99.

168) Prutz, fq. 266-267.

169) Asises de la Cour des Bourgeois (Reueil des historieus des Croisades, Assies de Jerusalem, bl. II, fq. 325).

170) Baha al-Din, fq. 25.

171) Roger Hoveden, vol. II, fq. 307.

172) Benedier of Peterborough, vol. II, fq. 11-12.

173) Benediet of Peterborough, voll. II, fq. 20-21, Roger Hoveden, vol.

II, fq. 316-322.

174) Abu Shamah, fq. 150.

175) Itinerarium Petergrinorum et Gesta Regis Richardi, fq. 131.

(Chronicles and Memorials of the reign of Richard I, Edited by William Stubbs) (London, 1864).

176) Joinville, fq. 238.

177) Joinville, fq. 262.

178) Mas Latrie, (I), vol. II, fq. 72.

179) Ludolf de Suchem, fq. 71.

180) Libonordo Freschobaldi, quted inthe preface of Defremery and Sauguinetti's edition of the Batutah, vol. I, fq. XL.

85

181) Christophori Füreri ab Haimendarf Itinerarium Aegypti, fq. 42 (Norimbergae, 1620).

182) Le Vogage en Ethiopie entrepris par le Pere Aymard Querin (Rabbath, fq. 17-18).

183) "Me të vërtetë vlen të përmendet se disa njerëz besojnë në kundërshti me këtë dhe anojnë të pohojnë diç që realisht nuk e kanë parë, e kjo është se tërë lindja pas detit, Indisë dhe Etiopisë e pranon Jerusin dhe thërret në emër të tij pos Arabëve dhe një pjese të Turqëve që qëndrojnë në Kapadoki.

Unë që personalisht kam parë e dëgjuar prej të tjerëve pohoj se gjithnjë dhe në çdo vend, pos Egjiptit dhe Arabisë që i banojnë Arabët e shumtë dhe ithtarët e Muhammedit, do të gjeshë se përqindja e të krishterëve në krahasim me muslimanët është 30:1 e më shumë. Të gjithë të krishterët përtej detit janë, në realitet, të huaj, sepse rrjedhin nga Lindja, ndonsëe janë të krishterë. Duke e marrë parasysh se nuk kanë përvojë në përdorimin e armëve, shpejtë u nënshtrohen pushtuesëve arabë, tatarë ose të tjerë, kur i sulmojnë dhe e blejnë paqën dhe sigurinë me pagesën e xhizjes (haraçit për kokë). Arabët ose të tjerët që sundojnë mbi ta i emërojnë mbikqyrësit dhe grumbulluesit e tatimit në ato vende.

Kështu këto vende quhen vende arabe, ndonëse tërë popullata u është e krishterë, përveç drejtuesit, tubuesit të tatimit dhe ndihmësave të tyre.

Këtë personalisht e kam parë në Kiliki (Cilicia dhe në Armeninë e Vogël, ku sundojnë Tatarët" (Burchardi de Monte Sion Descriptio Terrae Sanetare, fq. 90).

184) Finlay, vol. III, fq. 358-359, J. H. Krause, Dei Byzantiner des Mittela (ters, fq. 276 (Halle, 1869).

185) Tavernier (I), fq. 174.

*) Fjala katogigos (katoghighos) është forma e armenizuar e fjalës greke "Kathohikos", e këtë emër Armenët e besimit gregorian ia kanë dhënë patrikut të vet kryesor, i cili ka rezidencën në Eemiadzin (në Kavkaz).

186) Joselian, fq. 125. Në këtë periudë krishterizmin e kanë lëshuar fiset Abkoza, Xhihtesa, Oseta, Kabarea dhe Kistesa.

187) Joselian, fq. 127.

- 188) Joselian, fq. 143.
189) David Chytraeus, fq. 49.
190) Joselian, fq. 157.
191) Brosset, II e portic, i re livrosion, fq. 227-235, Description géographique de la Georgie par le Tsarevitch Wahhaucht, fq. 79 (St. Petersburg, 1842).
192) The Six Vojages, fq. 123.
193) Travernier (I), fq. 125, 126. Ai e vlerëson numrin e muslimanëve në dymbëdhjetë mijë, (I bid, 123).
86
194) Brosset, II, partie livarosion, fq. 85, 181).
195) Documents originanx sur les relations diplomatiques de la Georgie avec la France vers la fin du regne Laouis XIV, recuellis par M. Brosset jeune. (J. A. 2 me serie, bl. IX (1832), fq. 187, 451).
196) Machenzie, fq. 7, Garnett, fq. 194.
197) Barbier de Meynard, fq. 45 e më tej.
198) R. du M. M. VII, fq. 320 (1909).

KAPTINA IV

PËRHAPJA E ISLAMI NË MESIN E POPULLATËS SË AFRIKËS

Pushtimi arab i Egjiptit dhe mirëseardhja e Kobtëve për shkak të çlirimit nga sundimi bizantinas

Për herë të parë islami arriti në Afrikë me ushtrinë arabe, e cila nën udhëheqjen e Amr b. Asit mësyri në Egjipt. Tri vjet më vonë pas këtij invazioni ushtria bizantine, duke ia lënë popullatën e shumtë të krishterë të Egjiptit pushtueseve ishim, u largua. Suksesi i shpejtë i pushtuesëve zë fill më së shumti në disponimin e mirë të të krishterëve ndaj tyre, sepse kjo popullatë jo vetëm që ka ndier barrë për shkak të sundimit mjaft mizor ti Bizantinëve, por kjo është disponim dhe fryt i urrejtjes fetare. Jakobitët, të cilët kanë prezentuar shumicën e popullatës së Egjiptit, nuk i kanë harruar nënçmimet dhe ashpërsitë, të cilave u qenë ekspozuar në pallatin bizantinas nga ana e ortodoksëve. Madje as pasardhësit e tyre këtë deri sot nuk e kanë harruar.¹

Gjendja e Kobtëve nën sundimin muslimanë

Disa prej tyre janë munduar, disa janë hedhur në detë, e disa kanë ikur në dhe të huaj, deri sa një pjesë fshehtas është dashur ta rrëfejë fenë e vet.² Popullata Kobte, që quheshin të krishterë, me shekuj nuk ka pasur liri fetare, dhe se tek muslimanët e sollën. Pas dhënies së haraçit Amr b. Asi ua ka dhenë lirinë e plotë të zotërimit me kishat e tyre dhe të gjitha gjërat kishtarë ia ka lënë autonomisë kishtarë, dhe se ata në këtë mënyrë kanë shpëtuar nga përzjerja e ambshueshme të ish-administratës, e cila u ka shkaktuar dhembje të mëdha. Po ashtu nuk i ka lejuar askujt me kurrfarë arsyeje t'i përvetësojë të mirat kishtarë.³ Në fazat e para të sundimit islam në Egjipt gjendja e të krishterëve Kobtë ka qenë e favorshme, dhe nuk ka kurrfarë prove se janë bërë çfarëdo dhune ose shkelje të padrejta me dëshirë të kthimit të njerëzve në islam. Madje deri sa të gjitha pjesët e Egjiptit nuk kanë qenë as të

pushtuara, derisa ende qendra e Egjiptit, Aleksandria, rezistonte, shumë njerëz kaluan në anën islame,⁵ dhe se shumë të krishterë pas disa vjetësh
87

shkuan pas shembullit të treguar të tyre. Gjatë kohës së hilafetit të Osmanit r.a. (643-655?23-24 H.) të ardhurat nga haraçi egjiptian ishte dymbëdhjetë milionë. Diç më vonë, me fjalë tjera gjatë Muaviut (661-679/42-60 H.), për shkak të rritjes së pazakonshme të konvertimit, këto të ardhura ranë në pesë milionë. Më në fund, pasi të ardhurat ranë edhe më, mëkëmbësi egjiptian⁷ propozoi që mos t'i lirojë nga tatimi konvertitët e rinj, por halifi duke thënë: "Zoti xh.sh. nuk e dërgoi Muhammedin të tubojë tatim por ta shpallë të vërtetën dhe t'ia thërret njerëzinë asaj."⁸

Njëkohësisht mund të ceket si shkas për konvertim edhe kjo që krishterizmi, i cili u manifestua në teori, që përbëhet në mposhtjen e vrazhdë të të gjitha dëshirave,⁹ ka qenë në krahasim me parimet morale njerëzore të islamit atraksion i dobët.¹⁰ Pasi që nga koha në kohë kanë kaluar në islam në numër gjithnjë e më të madh, për këtë muslimanët i kanë konsideruar Koptët me prirje më të madhe kah islami nga ithtarët e sekteve tjera të krishtera. Ndonëse Koptët kanë qenë shumë herë të ekspozuar kundëravajtjeve dhe demimeve, megjithatë numri nga kjo arsye të konvertuar të krishterëve Koptë ndaj numrit të atyre që vullnetarisht e kanë ndërruar fenë, është mjaft i vogël.¹¹ Madje edhe në shekullin e XIX nga shtetet islame Egjipti ofron më shumë lehtësi fetare - që i pranohet, - dhe sërish për çdo vit shumë kalojnë në islam.¹² Megjithatë dhuna dhe delikt, qoftë nga ana e ithtarëve të sekteve tjera të krishtera, qoftë nga ana e sunduesëve të mevonshëm islamë, mjaft i kanë kontribuar romjes numerike të të krishterëve Koptë, dhe se historia e vuajtjeve të këtyre jakobitëve është mjaft pikëlluese.¹³ Shumë prej tyre, që të shpëtojnë nga tatimet e padurueshme, e kanë lëshuar fenë e stërgjyshërve. Shpjegimi i dallimit të madh ndërmjet gjendjes së Koptëve të krishterë dhe të krishterëve të Palestinës, Sirisë dhe Andaluzisë kërkohet në natyrën e tyre konfliktuoze. Duhet se despatizmi bizantinas, kishtar dhe ai admimistrativ, që ka zgjatur gjatë kohë, ka bërë prej Koptëve, të frymëzuar me zelltari fanatike, parti nacionale, e cila nuk ka mund lehtë të dëftojë kënaqësi me sundimin e huaj së pari të Bizantinasëve, e pastaj të Arabëve. Në një kryengritje, që u ndezë në vitin 646 (26 H.) kundër qeverisjes së re, Koptët për një kohë i larguan Arabët nga Aleksandria, dhe natyrisht ua kapën dyert e qytet ushtrisë bizantinase, deri sa Bizantinët, pasi nuk patën harruar se si përzemërsisht i pritën Arabët, kur hynë brenda, janë sjellur në mënyrë armiqësore me Koptët e mjerë.¹⁴ Kjo kryengritje, e cila u lind për shkak të tatimeve të rënda, është rebelimi i parë që i ekspozoi Koptët hakmarrjeve, dhe se ka qenë shkak që si të krishterët jakobit në Egjipt, ashtu edhe sektet tjera të krishtera, që në vendet tjera kanë ra nën pushtetin islam, t'i kaplojë fat më i rëndë. Por versionet më shumë bëjnë pjesë në histori, që merren me dhunën e muslimanëve, se sa në këtë libër. Mirëpo, duhet thënë se Koptët nuk kanë qenë gjithnjë në gjendje të shtypur, por, përkundrazi, në mesin e tyre vërehen shumë që kanë fituar pozita zyrtare me ndikim e para. Në zyret

88

shtetërore i kanë mbushur shumë vende të shkruesve dhe shefave.15 Shpesh ata e kanë pasur për detyrë caktimin e tatimit.16 Nganjëherë kanë arritur sukses të fitojnë kapital të madh.17 Kemi shembuj ku sunduesit muslimanë me shumë priftërinj kanë sjellur mjaft përzemërsisht.18 Gjatë kohës së këtyre sunduesve kanë gëzuar lirinë e plotë. Ja, kjo ka qenë në atë kohë të qetë e të lirë kur kisha gjendej në situatën e atillë e cila shumë të krishterë i ka përzier me individualitetin shpirtëror të muslimanëve.

Korrupcioni dhe anarkia e klerit të krishterë si një prej shkaqeve të kalimit në islam

Gjatë kohës së sundimit të Salahuddin Ejjubit në Egjipt (1169-1193?565-590 H.) të krishterët nën mbrojtjen e tij kanë jetuar mjaft të lumtur. Disa tatime, që u janë caktuar atyre, janë anuluar plotësisht, e disa janë zbritur. Të krishterët kanë vërshyer në institucionet publike pozitat e regjistruesëve, shkruesëve, kontabilistëve etj. Gjatë kohës së trashëgimtarëve të tij ata edhe njëqind vjet kanë shfrytëzuar lehtësitë dhe prudencën e njëjtë dhe në asgjë nuk kanë mundur të ankohen përveç në keqpërdorimet e klerarkisë së vet priftërore, e cila kishte rënë poshtë. Kjo klerarki ka qenë edhe së tepërmi e preokupuar me tregtinë shpirtërore, sepse pozitat priftërore iu shiteshin injorantëve dhe tipave të prishur, kurse kandidatët në pozitat për personalitet më të lartë, në rast se nuk depononte para për emërim - përkundër sigurisë së dinjitetit të tyre dhe të drejtës më të lartë në këtë - do të largoheshin me fyerje. Një nga rezultatet e kësaj gjendjeje është ky se aftësimi shpirtëror i popullit ka qenë lënë pas dore krejtësisht, dhe se jeta fetare fatkeqësisht zhdukej.19 Rrethanat kishtarë u shndërruan në çoroditje të atillë sa që luftërat e pandryshueshme e të rrepta, që lindën pas vdekjes (më 1261) si patrikut jakobit të shtatëdhjetë e katërt Johanit, ndërmjet partive rivale për shkak të kandidatëve të tyre, kanë zgjatur njëzet vjet. Gjatë kohës së këtyre luftërave kundërshtarët më tepër i kanë kushtuar kujdes pasioneve partiake se sa pasojave të dëmshme të këtyre luftërave të paskrupullta. Sulltani i atëhershëm egjiptian ka provuar disa herë të ndërmjetësojë ndërmjet rrymave në konflikt, dhe refuzoi miton së pari prej 5000, pastaj prej 7000 e më në fund prej 15.000 dukatëve - që ia kanë ofruar që ai me anë të ndikimit zyrtar ta shtyjë kandidatin e dëshiruar. Për më tepër, ai ka shkaur aq larg se ka premtuar ta lirojë patrikun nga pagimi i taksës së rëndomtë, në rast se i kalojnë mospajtimet dhe dakordohen në zgjedhje, por këto përpjekje qenë të pasuksesshme. Në po at kohë shumë peshkopë qenë shkarkuar nga detyra, e edhe vendet e atyre popave që në ndërkohë kanë vdekur nuk kanë gjetur ndërrimet e tyre. Të krishterët nga territori i peshkopatit perëndimor, pasi ishin kështu të lënë, e përqaftuan islam.20 Nuk kemi të dhëna për arritjen e pakontestueshme të muslimanëve që t'i tërheqin të krishterët e

89

Egjiptit në fenë e vet, të cilën do t'ia shtonim shpjegimit të këtij historiani, i cili na ofron të dhëna të qarta për kishën kobte. Nuk ka vend për dyshimin për angazhimin e tyre të dhënë, e sidomos në atë se publikisht janë zhvilluar

diskutimet mbi përparësitë e dy religjioneve rivale, dhe për atë që kjo ka qenë shkas që pohimet e tyre të shkruhen, është pa dyshim, se përpjekje të atilla konvertuese kanë ndodhur.²¹ Kuptojmë pikërisht prej dëshmisë historike se këto konvertime nuk kanë rezultuar nga shkelja baloze. Kështu, për shembull, në erën e shkatërrimit të patrikanës së përmendur ka ekzistuar liria e plotë e lutjes së përbashkët, iu lejohet të meremetojnë kishat, madje edhe të reja të ndërtojnë, iu është anuluar edhe ndalesa e dikurshme e kalërimit; kontestet e tyre janë zgjidhur në gjyqet e tyre speciale; monakët qenë liruar nga tatimi, për më tepër, u janë dhënë disa privilegje.²² Lidhjet e Nubisë me vendet muslimane

Vështirë është kategorikisht të shpjegohejt se sa kanë ndihmuar ndodhitë sipër të cekura në përhapjen e konversionit ndër të krishterët kobtian.

Për këtë neglizhencë kishtarë theksojnë gjendjen e ngjashme dy misionarë të rendit të krishterë kapucinias, të cilët në shekullin e XVII kanë udhëtuar nëpër Egjiptin Verior. Për shembull, ata nuk kanë parë në Luksor asnjë pop ndër Kobtët, dhe se kanë mësuar se pesëdhjetë vjet nuk janë rrëfyer as që kanë kryer ritualet fetare të kungatës. Kur t'i marrim parasysh këto rrethana, lehtë do të kuptojmë shkakun e ramjes numerike të Kobtëve në Egjipt.²³

Duhet se mospërfillja e ngjashme ka ndihmuar edhe zhdukjen e kishës në Nubij (d.m.th. në viset berbere), e cila e ka njohur, sikur që këtë edhe sot e pranon Abesinia, supremitetin e patrikanës jakobite të Aleksandrisë.

Berberët kah mesi i shekullit të VI janë kthyer në krishterizëm. Ata e kanë ruajtur mëvetësinë e vet edhe pas pushtimit arab të Egjiptit. Berberët kanë lidhur kontratë me pushtuesit arab, sipas të cilit janë obliguar t'i dërgojnë çdo vit mëkëmbësit egjiptian katërqind robë, e për këtë Arabët janë obliguar të japin gjalpë, drithë dhe rroba.²⁴ Gjatë kohës së Mutesimit (833-842?218-228 H.) është dërguar një delegacion, dhe e ka përtërirë kontratë e cekur. Kur mbreti nubias e vizitoi kryeqendrëne hilafetit, është pritur me shkëlqim të madh, dhe duke marrë dhurata të çmueshme, u kthye në vendin e vet.²⁵ Berberët ishin qysh në shekullin e XII sipas Isaut në krishterizëm,²⁶ dhe e kanë ruajtur, përkundër ekspeditave ushtarake që kundër tyre janë dërguar nga Egjipti, pavarësinë e vet.²⁷ Mbreti Berber ka marrë nga sulltani i ri egjiptian ndihmë ushtarake dhe u nisë në xhaxhain e vet. Duke iu falënderuar kësaj ndihme e rrëzoi xhaxhain, dhe se për këtë shkaksi kthim dhurate viset më veriore të shtetit të tij iu bashkangjiten Egjiptit, por pasi që popullata e atjeshme ka dëshiruar të mbetet në krishterizëm, është marrë për çdo kokë 90

mashkulli në vit nga një dinar²⁸ haraç. Mirëpo, pushteti islam nuk zgjati shumë dhe Berberët sërish e arritën pavarësinë e vet.²⁹

Shpërngulja e Arabëve në Nubi

Në viset berbere disa shekuj më herët janë vendosur disa fise arabe, edhe Arabët të banuar në rrethinë të Nilit të Bardhë në shekullin X sipas Isaut, numerikisht janë rritur aq dhe aq pasuri kanë arritur që më në fund në kryeqendër të mbretit të krishterë,³⁶ Sobit 31 arritën ta ndërtojnë xhaminë.

Në shekullin e XIII, e sidomos në fillim të shekullit XIV, ndodhi lëvizja e shpërnguljes së përgjithshme të Arabëve në Nubi. Sidomos, pasi që fisi Xhuhejne u vendos në atë vis, shumë anëtarë të tij janë martuar me gratë e vendasëve dhe shkallërisht aq janë forcuar sa që e thyen fuqinë e sunduesit të atij visi.³² Ibn Batuta³³ na njofton se Berberët në shekullin e XIV njëjtë kanë qenë të krishterë, por se mbreti në Dongol 34 gjatë kohës së sulltanit mamelikas Nasir Kalaunit e pranoi islamin. Asnjë prej fushatave të shumta luftarake që janë dërguar nga Egjipti në shekullin e XV sipas Isaut, nuk ka depërtuar në pushtim në jug më thellë se katarakti i parë i Nilit.³⁵ Krishterizmi është përhapur në rrethinë të Sinurit në Nilin e Epërm.

Zhdukja e shkallërishtme e krishterizmit

Mbretëria nubike e krishterë është shkatërruar diç për shkak të mospajtimeve të brendshme, diç për shkak të sulmeve të Arabëve dhe Zenxhive (Zezakëve).³⁶

Gjatë kësaj kohe tregtarët dhe vizitarët islamë e kanë sjellur islamin në brendi të këtij visi. Në një pjesë, që e ka shkruar Makrizi në shekullin e XV, që është gjë e rrallë te historianët arabë, flitet edhe për misionaritetin. Një rrëfim, që e ka rrëfyer Ibn Salim Azuvani, është e denjë për vëmendje për shkak të prezentimit të aktivitetit të propagandës islame. Vërtet, kthimtarit, që është lëndë e këtij versioni, sikur që nuk është me prejardhje Berber, nuk është as i krishterë, por megjithatë tregimi i përcjellur na zbulon llojin e misionaritetit islam, që është kryer në shekullin e XV në Berberi. Ibn Salimi e ka takuar në pallat një sundues nubian në Mekar, njeriu që ka banuar në visin që është larg Nilit tre muaj ecje. Kur e ka pyetur për fenë, ai iu ka përgjigjur: "Krijuesi im, i yti dhe i tërë njerëzimit është Zoti, i cili është në qiej." Kur iu paraqitet uria ose thatësia, dalin në një vend të lartë, ku e lusin Zotin e lartësuar. Lutjet e tyre janë pranuar, edhe para se të zbresin nga kodra, dëshirat e tyre do të plotësoheshin. Në pyetjen tjetër, ky njeri e pranoi se nuk u është dërguar asnjë pejgamber. Kur Ibn Salimi i tregoi për Musaun (Mojsien), Isaun (Jezusin), Muhammedin dhe për pejgamberët e ngjashëm të lartësuar edhe për çuditë, të cilat me frymëzim i kanë bërë, ai ka thënë:

91

"Nëse atë e kanë bërë ata, atëherë e vërteta dhe drejtësia është meta, dhe unë besoj në ata."³⁷

Popullata nubiane shkallërisht është kaluar drejt nga krishterizmi në islam dhe është zhdukur.³⁸ Pasi që kisha shpirtërisht ka rënë në shkallën më të ulët dhe pasi që ndër ekleziastikët nuk është paraqitur asnjë lëvizje reformatore, dhe pasi është humbur çdo kontakt me kishat tjera të krishterea, është e natyrshme që në islam kanë kërkuar plotësimin e aspiratave të veta shpirtërore. Muslimanët ka herë kanë treguar fuqinë jetësore dhe qysh atëherë ua kanë imponuar disave fenë e vet. Ndërmjet vitit 1520 dhe 1527 (927-934 H.) një klerik portugez, që ka udhëtuar nëpër Abesini, e ekspozon në mënyrën vijuese formën e kthimit në të cilën kanë qenë Berberët: "Berberët atëherë nuk kanë qenë as ithtarë të Musaut, as të krishterë, as muhammedanë. Ata gjendeshin në pafe pa kurrfarë ligji. Mirëpo, dëshiruan

të jetojnë në krishterizëm". Dhe në realitet, Berberët, për shkak të mëngësisë se klerikëve të vet, kanë jetuar në padijen e zezë. Ndër të fundit nuk ka pasur asnjë peshkop, madje asnjë pop. Për këtë në Abesini ka ardhur i deleguari që të kërkojë nga këtu ppapa, por në këtë mbreti abesinas, pa lejen e patrikut të Aleksandrisë, iu përgjegj se nuk do t'i dërgojë këta mësues të fesë.³⁹ Pas kësaj rreth nja njëqind vjet, "pasi nuk kishte priftëri", krishterizmi nga Nubia u zhduk platësisht. Në të gjitha anët e kësaj mbretërie kishat kanë qenë të mbyllura.⁴⁰ Nubitët i kaploi rryma e islamit e cila depërtonte nga të gjitha anët.

Rrymës islame pa dyshim mjaft i ka ndihmuar përpjekje konvertuese e muslimanëve, të cilët me shekuj para kësaj kanë udhëtuar vepër Nubi. Ka pasur fise arabe që kanë ardhur dhe kanë vendosur pushtetin e vet në viset në veri në afërsi të brigjeve të Nilit.⁴¹ Sa u përket fqinjve në Jug, Nubitët ng Abesinia i ka ndarë fisi Belus.

Ndërmjet Abesinisë dhe Nubisë

Në fillim të shekullit XVI anëtarët e fisit Belus, pasi ishin muslimanë, i kanë dhënë mbretit të krishterë të Abesinisë tatim (haraç).⁴² Pasi kjo popullatë mund të llogaritet në Belijunë, e ata historiani Idrisi i përmend si të krishterë,⁴³ kjo, duke e marrë parasysh këtë, është sigurisht se ky fis, pak para kohës së përmendur e përqafoi islamin. Ata qysh atëherë Sinarin, i cili ishte qendër sundimi, ia kanë bashkangjitur një shteti të fortë islam. Ushtria e tyre, e cila nën udhëheqjen e Ahmed Garanit në vitin 1634 (941 H.) duke mësyre Abesininë ka përparuar, u bashkua me ushtrinë e sulltanit nga Maroko, i cili ka dhënë tatim (haraç), edhe pse ka sunduar me visin ndërmjet Sinarit dhe Abesinisë. Fuqia ushtarake e këtij sulltani kishte 15.000 Nubij, të cilët sipas të dhënave ekzistuese kanë qenë muslimanë.⁴⁴

92

Ndonëse të dhënat për konvertimin e Nubijëve kështu janë të pamjaftueshme e të shpërndara, megjithatë mund të argumentojmë sipas natyrës së tyre liridashëse dhe sipas qëndrimit të tyre të gjatë në krishterizëm, se ai ka ndodhur me anë të evoluimit gjatë shumë shekujve. Tash të kalojmë në historinë e përhapjes së islamit në Abesini.

Ndonëse Abesinasit sikur Nubijët i përkasin kishës jakobite, e kanë pranuar krishterizmin dy qind vjet para tyre. Islamin nuk e sollën valët e shpërnguljes arabe që i patën vërsulë brigjet e Abesinisë qysh para konvertimit të Arabisë, por ai disa shekuj më vonë ka filluar të hyjë. Deri në shekullin e X në vendet bregdetare kanë qenë të vendosur vetëm disa familje muslimane. Kurse në fund të shekullit XII, me rastin e formimit të një dinastie arabe, disa vise bregdetare janë shkëputur nga mbretëria abesinase. Një misionar islam me emrin Ebu Abdullah Muhammed ka hyrë në vitin 1300 (700 H.) në brendi të Abesinisë dhe ka filluar ta ftojë njerëzinë në ndërrim të fesë. Vitin vijues ky njeri ka mundur të grumbullojë rreth 200.000 njerëz. Pastaj, duke mësyre në principatën Amhara, disa herë është ndeshur me ata.⁴⁵ Mbreti abesinas Sifa Erad, që ka sunduar nga viti 1342 deri më 1370 (743-772 H.), ka ndërmarrë hapa të shpejtë kundër muslimanëve, dhe

se ndaj atyre që nuk kanë dashur ta pranojnë krishterizmin ka bërë masakër të përgjithshëm ose i ka internuar nga shteti.⁴⁶ Pikërisht kah fundi i shekullit XIX për shkak të joqetësisë së brendshme dhe anarkisë iu është mundësuar fiseve të banuara në bregdet ta hedhin zgjedhën dhe t'i shtyjnë Abesinasit në brendi të vendit. Tregohet se mbreti BAida Marjami ka kaluar një pjesë të mirë të kohës të sundimit të vet në luftë me Arabët të banuar në kufirin lindor të shtetit.⁴⁷ Deri sa shteti i fortë islam Adal, që është themeluar kah fillimi i shekullit XVI në viset jugore ndërmjet Abesinisë dhe detit të Kuq, dhe disa fise tjera islame haptazi kanë vepruar kundër këtij shteti të krishterë, disa fise arabe nënshtruashëm kanë dhënë tatimin, kurse në viset Masaua (Masavuah) Arabët e banuar kanë ruajtur pasurinë e kryeparëve abesinas, duke jetuar në mënyrë nomade në grupe prej 30-40 njerëz, të cilët i komandante nga një eprar i krishterë.⁴⁸ Disa muslimanë në shërbim të mbretit të krishterë kanë zënë pozita të rëndësishme.⁴⁹ Disa prej tyre i kanë mbetur besnik islamit, kurse disa e kanë pranuar fenë dominuese (krishterizmin). Çdo të thotë dhënia e tatimit të këtyre muslimanëve negusit (nexhashiut - mbretit) abesinas, është rëndë të përcaktohet. Muslimanët e Hadisë krahas haraçit është dashur çdo vit t'i japin mbretit edhe një vashë të re, e cila duhej ta pranonte krishterizmin. kjo traditë është caktuar sipas një kontrate të vjetër me Arabët, e cila është zbatuar kur ndonjë sundues abesinas dëshironte ta theksojë fuqinë dhe pushtetin e vet. Përveç kësaj, Arabët e përmendur e kanë pasur të ndaluar të bartin armë për luftë dhe të ecin në kuaj të shaluar. Duke shpjeguar shkaqet e nënshtrimit të vet urdhrave të cekur, në fillim thonë: "Që mbreti mos të na mbysë, që mos të na i rrënojë xhamitë, kur i dërgon njerëzit

93

ta tubojnë haraçin dhe ta marrin vashën, ne e pastrojmë, e veshim dhe e vëmë në shtrat dhe pranë kohës së saj, lutemi për shpirtërat e të vdekurve tanë, dhe ua dorëzojmë atyre."⁵⁰

Invazioni i Ahmed Granit dhe kalimet në islam në kohën e tij

Këta muslimanë, mbi të cilët është caktuar haraçi, kanë banuar në kufirin verior që shtrihet prej anës perëndimore të Abesinisë drejt Sinarit,⁵¹ dhe në viset e kësaj mbretërie në jug dhe juglindje,⁵² Të flitet se çfarë ndikimi kanë bërë muslimanët, duke jetuar përziëshëm, mbi të krishterët, a kanë arritur në atë shekull konvertitë apo jo, ky është vetëm supozim. Mirëpo, është e sigurtë se sunduesi i pavarur musliman në viset Adal, Ahmed Garan, i biri i një kleriku, i cili e lëshoi vendit e babait të vet dhe u vendos në Adal⁵³ ndërmjet vitit 1528 dhe 1543 (935 dhe 950 H.), mësyri nga atje në Abesini, në çka shumë udhëheqës fisnorë të krishterë me fiset e veta u janë bashkuar ushtrisë ngadhënjimtare islame dhe kaluan në islam. Por një kronist bashkëkaluar musliman i këtyre ndodhive⁵⁴ cek se ka pasur disa konversione nga frika dhe se është dyshuar në sinqeritetin e deklaratave të disa konvertiteve të rinj. Mirëpo, dyshimi në këto kthime nuk është e përgjithshme, përkundrazi, në viset e shumta kthimet, të cilat kanë marrë dimensione të gjëra, na shtijnë të mendojmë se kjo ka qenë lëvizje e përgjithshme.

Udhëheqësit fisnor, që kaluan në islam, personalisht me rekomandim kanë bërë ndikim në ushtarët e bindur që edhe ata të shkojnë pas tyre. Ata udhëheqës fisnorë muslimanë të cilët dikur ishin në shërbim të mbretit abesinas, dhe të cilët, duke e konsideruar sulmin e ushtrisë ngadhënjimtare islame rast të mirë, kanë ndërpresë lidhjen me krishterizmin dhe kanë lëshuar përkatësinë mbretit të krishterë, dhe kanë deklaruar se janë muslimanë, kanë prerë mjetin e veçant të këtyre konversioneve.⁵⁵ Një prej tyre në letrën që ia ka shkruar më 1531 (938) Ahmed Garanit, thotë: "Unë dikur kam qenë musliman dhe jam bir i muslimanit. Të pafetë më kanë robëruar dhe me forcë më kryquan. Mirëpo, në zemër kam mbetur me fenë e vërtetë. I mbështetem Zotit, pastaj Pejgamberit të Zotit dhe miqësisë tënde. Nëse e pranuan pendimin tim dhe nuk më denon për atë që kam bërë, do të kthehem në fenë e vërtetë të All-llahut dhe do të gjejë mjete ta kthejë në islam edhe atë ushtri mbretërore që është nën "komandën" time. Dhe njëmend, shumica e ushtrisë të bindur atij shkuan pas tij. Tregohet se numri i tyre me gratë dhe fëmijët ka qenë 20.000 njerëz.⁵⁶

Përparimi i islamit pas vdekjes së Garanit

94

Abesinasit patën sukses të shpëtojnë nga zgjedha e pushtuesve islamë me ndihmën e Portugezëve. Në një betejë që ndodhi në vitin 1544/950 H. u vra Ahemed Grani. Megjithatë islami në brendi të këtij visi ka zënë rrënjë të tilla që ka kontribuar vazhdimin të gjatë të kryengritjeve, që u lajmëruan në shekullin e XVI në Abesini, sepse dy kishat rivale të krishtera kanë qenë aq të preokupuara me luftë reciproke sa nuk kanë pasur kujdes në gjendjen e armikut të përbashkët. Njëkohësisht, sukseset e jezuitëve dhe misionarëve të tjerë katolikë në arritjen e ithtarëve për fenë e vet dhe përzjerja e Portugezëve në çështjen e brendshme qeverisëse të Abesinisë zgjoi te të krishterët e Abesinisë lëvizje kundërshtarë. Dhe njëmend, këto ndjenja armiqësore aq u rritën, sa që disa krerë abesinasë haptas kanë folur se do të dëshironin t'i dorëzohen islamit se sa të mbetën në aleancë me Portugezët.⁵⁷ Kjo lëvizje gjysmëfetare gjysmëpatriatike marri përmasa të tilla të gjëra, sa në vitin 1632/1042 H. plotësisht i kanë larguar nga vendi i vet Portugezët me të huajt tjerë - të krishterë. Pas kësaj Abesinia ka rënë në anarki të thellë. Fiset që i përkasin popullit Gاليا, duke e shfrytëzuar këtë gjendje, janë futur në vetë midisin e këtij vendi, ku deri më sot kanë mbetur.

Sa ka përparuar islami në atë kohë mund të supozohet sipas dëshmisë së një udhëtari nga shekulli XVII. Ky udhëtar ka shkruar se ithtarët e islamit në çdo anë të këtij vendi po rriten dhe se paraqesin një të tretën e tërë popullatës së tij. Njëqind vjet më vonë numri i ithtarëve të Muhammedit me anë të rasteve individuale të kthimit, që ndodhnin aty këtu, shkallërisht rritej. Pasi në shtet nuk ka pasur administratë të fuqishme qendrore, disa udhëheqës së vegjël, por të pavarur fisnor, që kanë pasur simpati të madhe ndaj islamit, janë nxitur në kryengritje. Kjo ka ndodhur përkundër ligjit që ka përcaktuar se krerët abesinas duhet të jenë të krishterë. Disa muslimanë, që të zënë pozita, bëheshin sikur t'i kishin prerë lidhjet me islamin dhe përqafuan

krishterizmin, dhe në këtë mënyrë në krahinat në të cilat vinin si mëkëmbës, kanë shfrytëzuar ndikimin e vet në përhapjen e islamit ndër të krishterët e atjeshëm.⁵⁹ Vërehet nga vetë fillimi se një nga shkaqet e përhapjes së kësaj feje është ky që muslimanët ndaj të krishterëve abesinasë kanë qenë normalisht superior.

Islami në shekullin e XVIII dhe XIX

Udhëpërshkruesi gjerman Eduard Ruppel shkruan se shumë herë ka vërejtur gjatë rrugës për në Abesini "... kur dëshirohet të emërohet në ndonjë pozitë shtetërore njeriu i sigurtë e i ndershëm, zgjidhja rëndom binte mbi muslimanin". Në këtë shtonë: "Muslimanët janë të zellshëm. Çdo muslimanë e mëson të lirin e vet ose bijtë e vet të lexojnë dhe shkruajnë, deri sa të krishterët i mësojnë fëmijët e vet vetëm nëse dëshirojnë t'i bëjnë popa."⁶⁰ 95

Na mjafton të shpjegojmë shkakun e përhapjes së islamit qoftë të shkallërisht, por të vazhdueshë deri ku ka arritur në shekullin e XIII dhe XIX. Mjerimi dhe letargjia e klerikëve të krishterë, mospajtimet e pafund të udhëheqësve fisnorë të krishterë kanë prezentuar krahas epërsisë morale të muslimanëve garancë të veprimit të sigurtë të ndikimit islam. Plovdeni, i cili ka qenë ndërmjet viteve 1844 dhe 1860/1260 dhe 1277 H. konsul britanik në Abesini, shkruan: "Fisi Habab, i banuar në viset veriperëndimore të Masuit, vetëm në 100 vitet e fundit kaluan në islam dhe barabartë bartin emrat e krishterë. Shkaku i parë i islamizimit të tyre ka qenë ky që kanë qenë në kontakt të përhershëm me muslimanët, të cilët atje vinin për shkak të tregtisë. Përveç kësaj, këto treva i kanë mospërfillur udhëheqësit fisnorë abesinas, të cilët kanë qenë të preokupuar me luftërat ndërmjet vetë."⁶¹ Sipas traditës është konstatuar se një sundues abesinas me emrin Xhavuxh e lëshoi krishterizmin dhe e pranoi islamin për shkak se ka konsideruar se islami u sjellë fatin njerëzve dhe zgjatë jetën. Pas kësaj një prifti të bindur i ka urdhëruar.

"Këtë arkë përgjiruese thyeje!" Në çka kleriku u përgjegj: "Nuk kam mguxim ta copëtoj arkën e Maries së lartë." Atëherë Xhavuxhi personalisht e morri sopatën dhe e copëtoi në copa. Pas kësaj të gjithë popat e atjeshëm kaluan në islam, e edhe sot pasardhësit e tyre janë udhëheqës të fiseve.⁶² Në atë periode edhe popullata e pjesëve tjera në viset veriore të shtetit të Abesinisë kaloi në islam, sepse nga këtu popat janë larguar, kurse kishat e lëshuara shkallërisht rrënoheshin. Kthimet e atëhershme janë bërë pastër për shkak të ligështimit të të krishterëve, sepse edhe muslimanët e atyre viseve janë të njohur për miqësinë e vet ndaj të krishterëve, por nuk janë fanatikë.⁶³ Një udhëtar tjetër dëshmon se kthime të ngjashme kanë ndodhur në fillim të shekullit XIX.⁶⁴ Ai thotë se ka parë shumë njerëz ku njëri pas tjetrit bëhen muslimanë. Ras Aliu, i cili një kohë ka pasur ndikim mbretëror dhe i cili është konsideruar zëvendës i sulltanit, i ka përmbajtur muslimanët: shumë vende nëpunësish u ka dhënë muslimanëve, dhe madje nga kisha gjërat e grabitura ua ka falë. Në kohën e tij pothuaj gjysma e popullatës së Abesinisë së mesme e kanë përqaftuar islamin.⁶⁵ Kjo fe aq thellë i lëshoi rrënjët në

Abesini sa që gati tërë tregtinë, sidomos zejet e vogla, muslimanët i kanë marrë në duart e veta, janë bërë pronarë të pasurisë, dhe në qytete, tregje e panairë janë bërë urdhërdhënës dhe në këtë mënyrë kanë ndikuar në tërë popullatën. Më tej, një misionar i cili atje ishte 35 vjet, pohon: "Duke i marrë parasysh sukseset dhe zellturinë e propaganduesve jo muslimanë, sikur të paraqitet edhe një Ahmed Garan dhe ta shpalojë flamurin Muhammedan, tërë Abesinia do ta pranonte islamin."60) Kontesti, që u krijua ndërmjet Egjiptit dhe Abesinisë, që në vitin 1875 rezultoi me luftë, ka nxitur ndjenajt në dëm të islamit. Pasi qenë të detyruar të luftojnë me një shtet të huaj islam, kjo nxiti reaksionin kundër besimtarëve të njëjtë të atij shteti në Abesini.

96

Negusi (nexhashi) abesinas Johani e themeloi një kuvend shpirtëror, të cilit në aspekt të fesë i dha pushtetin kyç, kurse ky dha urdhërin se në shtet mund të jetë vetëm një fe. Muslimanëve u dha tre vjet afat që t'i bashkangjiten kishës popullore. Për ta në ato vende ku paraqitet nevoja kanë dhënë të ndërtohen kishat. Popave të krishterë janë detyruar t'u paguajnë të dhjetën. Muslimanët që ishin në shërbime shtetërore morën vërejtjen ose të kryqohen ose të japin dorëheqje. Natyrisht se ka qenë i kufizuar ndikimi i kësaj metode detyruese. Nga ana tjetër, krishterizmi formal nuk i ka penguar muslimanët që fshehtas ta predikojnë fenë e vet. Madje janë hetuar shumë persona të cilët, pasi janë kryqar në kishë, direkt i janë drejtuar ndonjë imami dhe kanë kërkuar që t'u gjejë ilaq në mënyrë që të pastrohen nga kryqimi.67) Pasi që kjo urdhëresë befasuese shtrihej vetëm në mashkujt, kjo nuk ndikoi mjaft. Sa u përket muslimanëve, në aspekt të përhapjes së islamit në Abesini, misionari italian Massagia përmend aktivitetin e tyre të rëndësishëm në propagandë.68) Tregohet se mbreti Johan në vitin 1880 ka urdhëruar me dhunë të kryqohen 50.000 muslimanë.69)

Mirëpo, këto masa detyruese në dobi të krishterizmit nuk e kanë penguar fuqinë e përhapjes së islamit në shekullin e XIX. Fiset siç janë Tekles (dmth. druri i Jezusit), Itebtës (dhurata e Jezusit), Temarijam (Ipushqeshi i Maries), të cilat edhe sot i bartin emrat e këtyllë në buzë të çkahit dihet se dikur kanë qenë të krishterë, plotësisht janë bërë muslimane. Dy degë të fisit Meuza pjesërisht në gjysmën e shekullit të kaluar, e pjesërisht në fillim të këtij shekulli plotësisht kanë përqafuar islamin. Mosdija e klerit të atjeshëm të krishterë, mjaft e ka lehtësuar zellshmërinë e propaganduesëve muslimanë, të cilët e kanë entuziazmuar në konvertim.70)

Si u përhapë islami në Afrikën veriore?

Tash do të kalojmë në historinë e Afrikës, nëpër bregun verior të së cilës nga Lindje në Perëndim ka kaluar pushtimi arab në shekullin VII sipas Isaut. Lehtë ndodhi pushtimi i Egjiptit me ndihmën e popullatës së saj, e cila përpiquej t'i jep fund sundimit bizantinas. Por prej Egjiptit deri te bregu i oqeanit Atlantik luftërat e përgjakshme dhe rezistenca e gjatë (ka zgjatur më fjalë tjera 50 vjet për konstituimin e pushtetit arab) nuk mund të nivelizohen me Egjiptin. Para ramjes së Kartagjenës në vitin 698/79 H. nuk që fshirë aristokracia romake në Afrikë. Që të nënshtrohen Berberët në ato vise dhe të

dominojë pushteti i Arabëve, është dashtur pra rreth pesëdhjetë vjet. Nuk kemi për qëllim të japim të dhëna për ato suksese luftarake, vetëm kemi për qëllim ta hulumtojmë mënyrën në të cilën ka ndodhur përhapja e islamit në mesin e të krishterëve të atyre viseve. Fatkeqësisht, materiali që do të mund të na shërbente për këtë qëllim, është i shkapërdherdhur dhe i mangët. Ç'patë ndodhur me atë kishën afrikane e cila ka dhënë aq teologë e të shenjtër botës

97
së krishterë? Kisha e Tertullianit, shën Cuprianit, shën Augustinit, të cilët emrin e fesë së vet edhe pas mundimeve të duruara me sukses e kanë dëshmuar dhe të cilët kanë qenë paraprijës të guximshëm të krishterizmit të vjetës, sikur menjëherë u heshtë dhe prej atëherë shihet se po zhduket. Për tërheqjen e krishterizmit nuk është shkak anësia muslimane Zhdukja e popullatës së krishterë saudejmi, si rëndon - për shkak të mungesës së të dhënave në këtë aspekt - iu përshkruhet dhunave fanatike, që u qiten në shpinë muslimanëve. Por për këtë mënyr të rreptë dhe plotësuese të zgjidhjes së kësaj pyetjeje ka shumë vërejtje zbutëse. E para: për pohimin e tillë nuk ka dëshmi të sigurt. Betejat, shkretërimet dhe gjerat e ngjashme, të cilat janë pasojë e luftës së gjatë, paraqesim shumë të tmerrshme, por në vetë çështjen, tiranitë fanatike në raport kundër tyre bijnë në minimum. Nga fillimi i pushtimit arab e gajtë tetëqind viteve shumë kisha të krishtere kanë ruajtur ekzistencën e vet. Shkaku që e ka mundësuar të ekzistuarit e tyre dëshmon për tolerancën fetare.

Shkaqet që kanë sjellë deri te shkatërrimi i krishterizmit në Afrikën veriore nuk duhet kërkuar në fanatizmin e krerëve islamë por gjatë. Para pranimit të këtyre shkaqeve është e rrugës të konstatohet sa pak të krishterë ka pasur kah fundi i shekullit të shtatë. Ja kjo rrethanë është më e rëndësishme në aspekt të qëndresës së kësaj popullate nën sundimin islam dhe konvertimit të padhunë, dhe lënë më pale mundësi për supozimin se atje para pushtimit arab ka qenë mjaft e përhapur një kishë e krishterë: Krishterizmi kurrë nuk është përhapur më tej drejt jugut nga provincat romake në Afrikë, në të cilat ka pasur vende me popullatë të krishterë. Sahara paraqiste barrikadë, dhe se dukej e pamundur të depërtohet më shumë se 100 mila nga bregdeti.71) Vërtet, pak para sulmit të Vandalëve atje ka pasur afër 500 peshkopë, por pasi ka qenë traditë që peshkopatat të formohen edhe në pallanga (fshat i madh me treg, vër. N. I.), e madje edhe në fshatra që nuk vërehen,72) prandaj sipas numrit të tyre nuk mund ta çmojmë fuqinë numerike të të krishterëve. Sidomos është i dyshimtë versioni se krishterizmi është përhapur ndër fiset berbere të vendosur në brendi të tokës.73) Kur në shekullin e V filloi dekadencia e Imperatorisë Romake, fiset e ndryshme berbere nga viset jugor e kanë ndërmarrë sulme, dhe i kanë shkretëruar e plaçkitur vendet bregdetare, të cilat kanë qenë të pasura. Nuk ka dyshim se këta luftues kanë qenë zjarrputiste (mexhusijë). Ky popull, që i përket një pjese të Libisë - si ka vajtuar për këtë Sinesiusi, i cili me prejardhje ka qenë nga vendi Sirena (sot Bengazi) - i ka plaçkitur kishat, pastaj i ka djegur, kurse reliktet i ka marrë me vete që ti përdorë në ritualet e veta

zjarrpustiste.74) Këto vise të Bengazit kurrë nuk janë shëruar nga shkretërimi i përmendur dhe se krishterizmi, sipas probabilitetit të vet, qysh para 98

invazionit islam është zhdukur sandues marakoien ka luftuar me mbretin vandalian Turismundin, që ka sunduar prej vitit 496 deri 524 sipas Isaut, ai ka ndaluar të atakohen kishat ortodokse dhe klerikët, të cilët përndryshe qenë nënshtruar persekutimeve dhe keqtrajttimeve të Vandalëve. Ndonëse ky sandues nuk deshë ta përqafojë krishterizmin, por publikisht ka predikuar idhujtarinë, megjithatë kështu u përgjegj: "Nuk e di kush është Zot i të krishterëve, por nëse ky Zot, si thuhet, ka fuqi, do t'u hakmerret atyre, që po E nënçmojnë, e do t'i ruaj ato që E adhurojnë."75)

Sado i madh të jetë rrethi i ndikimit të kishës së atjeshme të krishterë, megjithatë nuk ka mund të përmirësohet nga goditja vdekjeprurëse të shkaktuar gjatë sulmit të Vandalëve. Natyrisht, Vandalët, që e kishin sektin e krishterë të Ariusit, rreth njëqind vjet me rreptësi kanë tiranizuar mbi ortodoksët. Peshkopët e tyre i kanë persekutuar, ua kanë ndaluar publikisht t'i kryejnë lutjet dhe i kanë munduar ata që nuk kanë dëshiruar ta përqafojnë fenë e tyre.76) Kur Belizariusi (Velizariusi) në vitin 534 ka thyer fuqinë e Vandalit në Afrikën veriore, dhe kur ky vis sërish iu kthye Imperatorisë Romake (Bizantinase), në Kartogjenë u thirrë sinodi (kuvendi, kocili)77) në të cilin janë tubuar, për shkak të marrjes së qeverisjes së punëve kishtarë, dyqind peshkopë. Pasi kanë qenë të ekspozuar sulmeve ashtu të rrepta është e natyrshme që numri i besimtarëve të krishterë ka rënë shumë. Përveç kësaj, rreth 100 vjet para ardhjes së muslimanëve këtu, fiset barbare, duke i shtyrë Grekët në qytete, i kanë detyruar të mbesin aty, deri sa rrethina ka qenë në sundimin e tyre.78)

Trazirat, udhëheqje e keqe, i sidomos murtaja, që atje kah fundi i shekullit VI ka bërë kërdi, kanë ndikuar në zvogëlimin e numrit të të krishterëve. Tregohet se lufta, që e ka hapur imperatori Justiniani, ka zhdukur pesë milionë të popullatës afrikane. Këto vise, ku dikur ka lulëzuar tregtia dhe bujqësia, e të cilat janë shndërruar në gërmadha të parregullueshme, ka herë janë lëshuar prej pasanikëve të tyre. Në këtë pikëpamje historiani Gibboni na jep përshkrimin vijues: "... E këtillë ka qenë pamja e shkretërimit në Afrikë. Në shumë vise, kur udhëtari të kalojë ditën, as që do ta takonte mikun as armikun. Fiset Vandale, numri i të cilëve, duke mos i kyqur fëmijët dhe gratë, ishte 160.000 luftëtarë të përgatitur për luftë, u zhdukën nga fushëbeteja. Popullata e Afrikës, të cilën vandalët e kanë dëmtuar tmerrshëm, në krahasim me ta ka qenë shumë më e madhe. Shkretërimet e njëjta janë kryer mbi Grekët dhe aleatët e tyre. Edhe ata janë shkatërruar diç për shkak të klimës, diç për shkak të kontesteve reciproke dhe dhunës së Barbarëve."79)

Në vitin 642/26 H., domethënë një vit para përparimit triumfal të Arabëve nga Egjipti për shkak të pushtimeve të viseve perëndimore, kisha afrikane, e cila aq me zell ka pajtuar me krishterizmin, është zhytur në ombis të diskutimeve kundër dogmës "unitetit të esencës së Jezusit". Por priftëria e

99

lartë, që gjendej në shërbim në territoret e katër peshkopatave që i përkitnin krye peshkopatës në Kartagjenë ku bëjnë pjesë Mauritania, Numidia, Bizanti dhe prokonsulati Afrikan bizantinas, është orvatur ta bëjë të dyshimtë dogmën e uniteti i esencës së Jezusit”, dhe e thirri kuvendin (sinodin) kishtar dhe ia përgatiti letrën papës dhe imperatorit në emër të sinodit. Kur e shpallën mbledhjen e përgjithshme, në të erdhën 60 anëtare nga prokonsulati Afrikan, kurse 42 nga Bizanti. Është i panjohur numri i delegatëve nga dy krahiant; është e njohur se popullata e tyre e krishterë në vendet që kanë qenë afër qendrës së sundimit, ka pësuar më shumë dëme se sa popullata nga dy trevat e sipërme shpirtërore.⁸⁰) Duke i marë parasysh raportet e cekura, të cilët aq i kanë alarmuar ndjenjat, ka mjaft pak mundësi se ka pasur anëtarë që nuk janë përgjigjur dhe ardhur në mbledhje, sepse është e pamundur që të përmbahen në çastin e një ndodhie me rëndësi, ku u takua zelltaria e përparimit të dispozitave të krishtera me xhelozinë në Imperatorinë Bizantinase. Sipas kësaj, numri i vogël i peshkopëve dëfton rënien numerike në dimensionet më të gjëra të popullatës së krishterë. Përveç kësaj, kaqerë nuk ka nevojë të ndalemi në numrin e priftërve që kanë prezentuar në sinod, pasi ka edhe shumë shkaqe tjera, të cilat duhet hulumtuar, dhe kanë të bëjnë me rënien numerike, sepse gjatë kohë janë emëruar popat edhe në ato peshkopate në të cilat popullata e krishterë gati apo tërësisht është zhdukur. Mundet natyrisht të dëshmohej që nga shkaqet lartë të përmendura popullata e atjeshme para invazionit islam kurrësesi nuk ka qenë e shumënumërt. Shkretërimet, me çka kanë rezultuar kontestet pesëdhjetë vjeçare për sigurimin e rezultatit të fitores arabe, edhe më tepër e kanë zvogëluar numrin e popullatës së krishterë. Tripolisi pas kundërvënies gjashtëmujore të rrethimit, duke mos mundur t’i përballojë sulit, i qe nënshtruar plaçkitjes, kurse popullata pjesërisht është mbytur, pjesërisht si robër janë dërguar në Egjipt.⁸¹) Një vend tjetër afër Sahares, që ka qenë nën sundimin e një grofi romak, për shkak të ekuipazhit të shumënumërt ka rezistuar një vit, por më në fund rezistenca e tij është thyer, e luftëtarët janë mbytur, kurse gratë dhe fëmijët janë dërguar në robëri.⁸²) Tregohet se në këtë mënyrë numri i robërve patë hipur në dhjetë mijë.⁸³) Shumë të krishterë u shpëtuan.⁸⁴) Disa të ngjuar arritën të ikin në Itali, e disa edhe në vende më të largëta.⁸⁵) Dhe njëmend, disa qytete më të mëdha të Bizantinasëve kaqerë janë zbrazë, dhe më në fund janë shndërruar në gërmadha,⁸⁶) kurse pushtuesit, ku zgjidhnin vende të përshtatshme, kanë ngritur qytete të reja.⁸⁷) Sa i përket pjesëve aty këtu të shkapërderdhura të kishës së krishterë, e cila njëjtë deri në fund të shekullit VII sipas Isaut ka qëndruar, e madje një kohë ka përparuar dhe lulëzuar, është vështirë të supozohet se persekutimet fetare janë shkak i zhdukjes së institucioneve kishtarë, kur merret parasysh se bashkësitë vendëse të krishtera kanë ekzistuar periodë aq të gjatë, madje deri pas shekullit të XVI. Tregohet se Idrisi, themeluesi i dinastisë idrisite në

100

Maroko, në kohët e para, d.m.th. në vitin 789/173 H., kur ka filluar të merret

me formimin dhe rregullimin e shtetit, i ka detyruar Hebraikët dhe të krishterët ta përqafojnë islamin,88) pas ndodhi e ngjashme më nuk është gjetur në kronikat kishtare të të krishterëve, vendasve të Afrikës veriore.89) Dobësimi suksesiv i kishës së krishterë si provë e tolerancës muslimane Madje edhe shkatërrimi suksesiv i kësaj kishe dëshmon mbi dashamirësinë dhe tolerancës e muslimanëve ndaj saj. Nja treqind vjet pas pushtimit islam kanë qenë rreth 40 funksione peshkopate.90) Në vitin 1053 sipas Isaut papa Teoni IX duke vajtuar ka cekur se kisha afrikane,91) e cila dikur me aq lumturi zhvillohej, ka rënë në pesë peshkopata. Historiani Latry, që cek versionin e parafundit, megjithëse fol për konvertimin e detyrueshëm gjatë kohës së pushtimemve të Abdulumunit të Tunisisë në vitin 1159/554 H., megjithatë krahas kësaj vëren se këto të dhna janë të dyshimta. Shkak i nënçmimit që e ka pësuar kisha sigurisht se është në anarki, në të cilën e kanë shtyrë këtë vis fiset arabe, që sikur vërshimet kanë tepërtuar në brendi të këtij vendi dhe është shpërndarë në të gjitha anët.92) Kisha Afrikane nuk ka mundur në vitin 1076 t'i gjejë tre kandidatë për peshkopë, të cilët është dashur sipas ligjit kishtar të vendosen në pozitën e peshkopit, dhe papa Gregorie VII që i detyruar t'i vendosi në kryepeshkopatë vetëm dy ndihmësa. Mirëpo, popullata e krishterë që e amdhe, dhe ka pasur nevojë për numër më të madhë peshkopësh, kurse ceremoni shpirtërore ka pasur aq sa që barrën e tyre nuk kanë mundur ta bartin tre priftërinj të mëdhenj.93) Pas dyqind vjetësh kisha e krishterë edhe më ka rënë, dhe më 1246 nga drejtimet shpirtërore të kishës së vendit ka ekzistuar vetëm edhe peshkopati morakien.94)

Megjithatë deri në këtë kohë vërehen gjuramt e krishterizmit ndër fiset algjeriane.95) Ndonëse disa nga fiset e Kabilëve kanë pranuar lajmëtarët e Islamit, megjithatë kjo feja e re mjaft pak ka mund të ndikojë në ta. Madje gjatë kohës edhe ata që janë konvertuar kanë harraur atë që kanë mësuar për detyrat fetare islame. Kabilët janë tërhequr në vendbanimet e fortifikuara në kodrat e larta. Derisa sa me xhelozie kanë ruajtur pavarësinë e vet, kanë arritur t'i kundërvihen depërtimit të elementit arab në mesin e tyre. Prandaj, ata ka qenë mjaft rëndë të kthehen. Edhe pse dervishët e rendit kaderit nga Sakijjetl-I-hamraa kanë mbajtur predikime në mesin e tyre, përpjekjet e tyre në këtë aspekt nuk dhanë rezultat. Por më në fund patën nderin që islamit t'ia hapë dyert në mesin e tyre në vitin 1492/898 H, disa të shpërngulurve andaluzias, të cilët pas rënies së Granadës u internuan nga Spania. Këta Andaluziasë u strehuan në zavinë (tekinë) e përmendur kaderite. Shejhu i tekisë, përkundër orvatjes së zellshme që kanë ndërmarrë muridët (ithtarët) e tij, këta emigrues i ka konsideruar të përshtatshëm për vazhdimin e

101

angazhimeve joproduktive konvertuese. Duke i kyqur në këtë detyrë fetare, shejhu i tekisë ua ka dhënë udhëzimet vijuese: "Mbi ne bie detyra që ta fusim pishën e udhëzimit hyjnor në popull, të cilit do t'i shkoni ju, kurse i cili e ka humbur çdo gjë që e ka trashëguar nga lumturia fetare. Këta Kabilë të pafatshëm nuk kanë kurrfarë misionari me anë të të cilit do t'i mësonin

fëmijët e vet me principet morale dhe virtytet islame. Duke mbetur kështu pa besim në Zotin, jetojnë sikur shtazët që nuk kuptojnë. Kam vendosur që të mbështeten në dijen tuaj dhe zellin tuaj fetar që ta mënjanoni këtë gjendje mjeruese. Ju nuk pajtoheni që kjo popullatë kodrinore për shkak të mosnjohjes së të vërtetave të larta të fesë sonë të mbetet në humbje dhe të shkatërrohet. Shkoni dhe frymëzoni ndjenjën e tyre fetare që po fliket me flakë të re. Evitoni të gjitha të metat në mesin e tyre që rrjedhin nga besimi i mëparshëm i krishterë. Papastërtia sipas mësimit të Muhammedit a.s. nuk konsiderohet, siç është kjo në krishterizëm, te Zoti e falshme. Nuk do t'ua fshehë se detyra juaj është plotë vështirësi, por vullneti juaj i pathyeshë dhe entuziazmi juaj fetar, me ndihmën e Zotit, të gjitha këto vështirësitë do t'i mposhtë. Shkoni, fëmijët e mi, dhe nxirrni atë popull të mjerë nga balta e mosdijes dhe pafeja dhe sillne përsëri në shtegun, me të cilin janë të kënaqur Zoti dhe Pejgamberi i Tij.

Shkoni, o pëllumbat e mi, dërgonjau lajmin e shpëtimit. Zoti ju ndihmoftë dhe mbrojtë! "Duhet shpjeguar fjalët "papastërtia e krishterë", në të cilën në këtë deklaratë aludohet. Me fjalë tjera, në vitin 1566 mbajti mbledhje kuvendi i lartë në Madrid, i cili ka dhënë urdhëria sipas të cilit ndër "reformat" tjera në aspekt të mbeturinave andaluziase nuk guxon askush as në shtëpi as jashtë saj të pastrohet, e banjat duhet të rrënohen.⁹⁶) Këta misionarë që u jan ëdërguar Kabilëve, të veshur me atë (zhgu, N.I.) të vjetër dhe me shkop në dorë, ata nga pesë-gjashtë, janë shpërndarë në të gjitha anët. Ata kanë zgjedhur vendet e vetmuara dhe pothuaj të papërshtatshme në shpellat dhe në grykat e maleve të larta dhe u vendosën aty. Asketizmi i tyre në kuptim të vetëmohimit, vazhdimësia e tyre në lutje gjatë një kohe të shkurtër e zgjoi kureshtjen e Kabilëve, dhe filluan të vijnë me ta në kontakte miqësore. Pasi ishin të udhëzuar në medicinë, mjetet teknike dhe të arriturat tjera kulturore, këta misionarë filluan shkallërisht të arrijnë ndikimin e dëshiruar ndër ta. Strehimoret e këtyre misionarëve u bënë qendrat për mësimin fetar islam. Të arriturat shkencore të këtyre ardhacakëve tërhoqën rreth tyre rreth të madh dëgjuesish, ashtu që nxënësit, tyre tash si misionarë islamë ktheheshin në mesin e vendasve të vet dhe në këtë mënyrë islamit e kanë përhapur në të gjitha anët e kolonisë kabilliane madje deri te shkretëtira e Algjerisë.⁹⁶)

Kjo ndërmarrje misionariste tregon se në çfarë mënyre i është afruar islami fiseve të këtyre viseve. Vetëdija mbi krishterizmin tek anëtarët e këtyre fiseve suksesivisht humbej, dhe më në fund është shpjerë në disa

102
paragjykime,⁹⁸) sepse këta kanë qenë plotësisht të ndarë nga bota tjetër e krishterë dhe sepse kanë qenë të privuar nga udhëzimet e mësuesve të krishterë. Prandaj, ata kanë pasur shumë pak besim të krishterë, që do t'i mbante kundër mësimit fetar dhe propagandës së misionarëve muslimanë. Mjaft pak janë ruajtur shënime në analet që do të mund t'i shtoheshin këtij ekspozit mbi zhdukjen e kishës së krishterë në Afrikën veriore. Një udhëtar musliman.⁹⁹) që në filli mtë shekullit XIV e vizitoi vendin Xherid, që

gjendet në jug të Tunizisë, cek se atje barabartë kanë ekzistuar, ndonëse gjëmadha, kishat e lashta dhe se pushtuesit muslimanë nuk i kanë rrënuar, por drejt çdo kisha kanë ndërtuar xhami. Ibn Halduni na njofton se kah fundi i shekullit XIV ka pasur fshatra në rrethin e Kastilijinës¹⁰⁰) me popullatë të krishterë që atje ka jetuar pa pengesa qysh prej pushtimit islam.¹⁰¹) Në fund të shekullit XV në Tunizi ka qenë bashkësia e krishterë e banorëve vendas, anëtarët e së cilës kanë jetuar plotësisht të ndarë nga tregtarët e huaj të krishterë në kuartin e veçant dhe me jetë të veçant. Ata jo vetëm që nuk i janë nënshtruar dhunës, por madje kanë dhënë ushtarë në gardën e sulltanit të atjeshëm.¹⁰²) Nuk ka dyshim se anëtarët e kësaj bashkësie kanë rrojtur, pasi që Karlo V, kur më 1535 e pushtoi Tunizinë, iu ka uruar që e kanë ruajtur krishterizmin e vet.¹⁰³) Ekzistenca e gjatë e kishës së krishterë vendëse në Afrikë plotësisht e thenë gjykimin që është krijuar nga supozimi se muslimanët me rrugë të dhunës kryejnë konvertimin, e madje edhe kur nuk do të kishte mjaft prova për frymën tolerante, që e kanë dëftuar sunduesit e shteteve të ndryshme arabe. Këta sundues muslimanë i kanë shfrytëzuar të krishterët si ushtarë¹⁰⁴) dhe u kanë dhënë lirinë e predikimit të fesë të krishterëve që do të vinin nga jashtë për shkak të tregtisë dhe shkaqeve tjera dhe të vendosen.¹⁰⁵) Madje papët¹⁰⁶) të krishterëve të atjeshëm, për shkak të mbrojtjes së tyre, u kanë sugjeruar t'u jenë besnikë sunduesve muslimanë.¹⁰⁷)

1) Amelineau, fq. 3. Caetani, vol. IV, fq. 81 e më tej. Thuhet se Justimani ka urdhëruar që të mbyten 200.000 Koptë në Aleksandri. Tiranitë e trashëgimtarëve të tij i kanë shtyrë shumë sosh të kërkojnë strehim në shkretëtirë (Wasleben, The Present State in of Egypt, fq. 11) (London, 1678).

2) Renandot, fq. 161; Severus, fq. 106.

3) John, Jacobite bishop of Nikin (gjysma e dytë e shekullit VII), fq. 584; Caetani, vol. IV, fq. 515-516.

4) Bell, fq. 38. Padrejtësitë dhe vështirësitë, që, sipas Makrizit, i kanë pësuar Koptët diç rreth shtatëdhjetë vjet pas pushtimit, vështirë se mund të pohohet se janë vazhduar. Kështu thotë edhe Von Rauke: "E di sipas të 103

dhënave më të sakta se popullata e Egjiptit ka jetuar nën sundimin arab në ëgjendje të kënaqshme." (Weltgeschichte, vol. V, fq. 153, 4 th ed.).

5) John of Nikin, fq. 560.

6) John of Nikin, fq. 585.

"Shumë egjiptianë të cilët kanë qenë të krishterë të rrejshëm, e kanë mohuar krejtësisht fenë e shenjtë dhe kryqimin që është dhuratë e jetës dhe kaluan në fenë e muslimanëve, armiqtë e Zotit, dhe pranuan drejtimin që e solli kjo krijesë Muhamedi. Morrën pjesë në mashtrimin e këtyre paganëve dhe farkuan armë kundër të krishterëve."

7) Duket se Qurra b. Sherik (gubernator i Egjiptit 709-714) ose pasarendësi i tij ka insistuar që konvertitët e ri t'ë vazhdojnë pagimin e

xhizjes. (Beckes, Papuri Schott - Rcinhardt, fq. 18).

8) Ibn Sa'di Tabaqat, vol. V, fq. 183.

9) Amelineau, fq. 53-54, 69-70.

10) Abu Salihi na informon për disa monakë që e kanë pranuar islamin.

Ka mundësi që ky numër të jetë edhe më i madh, sepse ky historian ka lënë pa cekur emrat e tyre për shkak të mungesës së të dhënave sepse manastiri ka pësuar ose për shkak të interesimit të dobët vetjak për këto shfaqje (fq. 128, 142).

11) Lane, fq. 540, 549.

12) Luttker, (I), vol. I, fq. 30, 35. Dr Andrew Watson shkruan:

“Nuk ka kaluar asnjë vit në qëndrimin tim dyzetvjeçar në luginën e Nilit, e që nuk kam dëgjuar për shumë raste të renegatjes nga feja.

Në të shumtën shkaqet janë shpresa në arritjen e caqeve të ndryshem të kësaj bote, ndjekja e vazhdueshme e rëndë, ekspozimi ashpërsisë dhe grabitçarisë së fqinjëve muslimanë, ofendimi personal sikur edhe paaftësia politike gjithfarëshe” (Islam in Egypt, Mohammedan World, fq. 24).

13) Seversa, fq. 122, 126, 143. Rasti i parë në të cilën janë ankuar ka qenë për shkak të humbjes së tmerrshme kur Menosi, më këmbësi i krishterë, i Egjiptit të Poshtëm i nxorri nga qyteti Aleksandria 32.057 copë ari, në vend të 22.000 sa Amri kishte urdhëruar që të tubohen (John of Nikin, fq. 585).

Renoudot, (fq. 168) thotë se, pas përtëritjes së klerarkisë ortodokse kishtarë, diç rreth 70 vjet pas pushtimit të muslimanëve, Kobtët kanë pësuar prej tyre aq sa edhe prej vetë muslimanëve.

14) Makrizi përmend edhe pesë kryengritje tjera të Kobtëve, të cilat janë thyer me fuqi ushtarake gjatë kohës së shekullit të parë të sundimit arab. (Makrizi, (2), fq. 76-82).

15) Renaudot, fq. 189, 374, 430, 540.

16) Renaudot, fq. 603.

17) Renaudot, fq. 432, 607; Nasir-i Khusrau, Safarnameh, ed. Schefer, fq. 155-156.

18) Renaudot, fq. 212, 225, 314, 474, 540.

104

19) Renaudot, fq. 388.

20) Wansleben, fq. 30. Finslibeni përmend një rast tjetër në rrethanat krejtësisht tjera të shkatërrimit të kishës kobte në ujdhesën e Qipros, e cila më më herët ka qenë nën juridiksionin e patrikut kobt.

Terrori i priftërisë ortodokse, që e kanë gëzuar mbrojtjen e mbretërve bizantinas, ka qenë i atillë që patriku nuk ka mund t'i bindë klerikët e vet që të shkojnë atje.

Pasoja ka qenë e atillë që të gjithë Kobtët që kanë jetuar atje e kanë pranuar islamin, ose e kanë pranuar koncilin Kalkedonas, ose i kanë mbyllur të gjitha kishat e veta. (Ibid., fq. 31).

21) Renaudot, fq. 377.

22) Renaudot, fq. 575.

23) Relation du voyage du Sayd ou de be Thebayde fait en 1668, par les

- PP. Protais et Charles - Fraucois d'Orleans, Capuchins Misionaires, fq. 3, (Thevenot, vol. II).
- 24) Caetani, vol. IV, fq. 520.
- 25) Ishak of Romgla, fq. 272-273.
- 26) Idrisi, fq. 32.
- 27) Maqrizi (2), bl. 1,2 me partie, fq. 131.
- 28) Maqrizi, fq. 128-130.
- 29) Burchhardt (I), fq.393.
- 30) Artin, fq. 62, 144.
- 31) Gjendet rreth 12 mila nga Kartumi i sotshëm.
- 32) Backer, Geschachte des ostilchen Sudan, fq. 160.
- 33) Vol. IV, fq. 396.
- 34) Slatin-pasha e ka shënuar legjendën që qarkullon ndër Arabët e Dangolës, e ajo është:
Stërgjyshi i tyre Dangalli e ka themeluar këtë qytet, i cili më vonë është quajtur me emrin e tij. Ky mendim është i papranueshëm sepse Dangala ka ekzistuar qysh në kohën e Egjiptianëve të vjetër dhe ceket në mesin e përmendoreve. Shih: Vivien de Saint - Martin, vol. II, fq. 85).
Legjenda flet se ky Dangal, edhe përveç asaj se ka qenë rob, arriti të bëhet sundues i Nubisë. I ka paguar tribut Bahnesit, peshkopit kobtas për të gjitha territoret që shtrihen ndërmjet Safas dhe Debbas së sotshme. (Fire and Swardin the Sudan, fq. 13). (London, 1896).
- 35) Ibn Salim al-Aswani, përcjellur prej Maqrizit, Kitab al-Khitat, vol. I, fq. 190 (Cairo, A.H. 1270).
- 36) Budge, vol. II, fq. 199, Ardin, fq. 144.
- 37) Budge, vol. II, fq. 199. Artin, fq. 144.
- 37) Maqrizi, Kitab al-Khitat, vol. I, fq. 193.
- 38) Marie, vol. I, fq. 417-418.
- 105
- 39) Lored Stonley nga Alderleu në përkthimin e vet të librit të Alvarzit "Rrëfimet" nga origjinali portugalisht, sjell përgjigjen vijuese të mbretit: "U ka thënë se nga vendet berbere ka fituar peshkopin, që do të thotë nga patriku aleksandrian, e si mundet atëherë të tjerët t'i ndihmojë me klerikë e monakë kur atë në ketë e ndihmojnë të tjerët t'i ndihmojë me klerikë e monakë kur atë në ketë e ndihmojnë të tjerët" (fq. 352, London, 1881).
- 40) Wanslebeu, fq. 30. Mbi përshkrimin e mbeturinave të këtyre përmendoreve shih: Budge, vol. II, fq. 299 e më tej dhe G. S. Nileham, Clurches in Laver Nubia (Philadelphia, 1910).
- 41) Burehkardt (I), fq. 133.
- 42) Alwarez, fq. 250.
- 43) Idrisi, fq. 32.
- 44) Arabfaqih, fq. 323.
- 45) Makrizi (2), bl. II, 2 më partie, fq. 183.
- 46) BAsset, fq. 240.
- 47) Basset, fq. 247.

- 48) Alvarez (Ramuslo, tom I, fq. 218, 242-249).
- 49) Arabfaqih, fq. 83, 191.
- 50) Arabfaqih, fq. 275-276.
- 51) Arabfaqih, fq. 319, 324.
- 52) Arabfaqih, fq. 28, 129, 275.
- 53) Plowden, fq. 36.
- 54) Arabaqih, fq. 175, 195, 248.
- 55) Arabfaqih, fq. 34-35, 120-121, 182-183, 244, 327.
- 56) Arabfaqih, fq. 181-182, 186.
- 57) Jobi Ludolfi ad suam Historiam Ethiopicam Commentarius, fq. 474, Frankfurt a. M. 1691.
- 58) Historie de la Haule Ethiopic, par le R.P. Manoel d'Almeida, fq. 7 (Thevenot, vol. II).
- 59) Massarja, vol. II, fq. 205-206. "Është e qartë se kjo renegatje ka pasuar nga dëshira për pushtet dhe ka qenë vetëm vegimisht, sepse këta renegatë nga feja kanë qenë muslimanë të vërtetë në zemër dhe sjellje. Kur arrinin në pozitën e "ras'it", rrethoheshira me muslimanë, duke iu dhënë detyrat, titujt, pasuritë dhe të mirat më të larta. Kështu Abesinia e krishterë, e shkretëruar dhe e banuar me këtë element të keq, ka hyrë nën flamurin e islamit: (Ibid., fq. 206).
- 60) Ruppel, vol. I, fq. 328, 366.
- 61) Plowden, fq. 15.
- 62) Littmann, fq. 69-70.
- 63) Plowden, fq. 8-9.
- 64) Beke, fq. 51-52, Isenberg, fq. 36.
- 65) Reclus, vol. X, fq. 247; Massaja, vol. XI, fq. 125.
106
- 66) Massaja, vol. XI, fq. 124.
- 67) Massaja, vol. XI, fq. 77-78.
- 68) Massaja, vol. XI, fq. 124-125.
- 69) Opper, fq. 307; Reclus, tome X, fq. 247.
- 70) Litmann, fq. 68-70; K. Cederquist, Islam and Christianity in Abyssinia, fq. 154. (The Moslem World, vol. II).
- 71) Gibbon, vol. I, fq. 161.
- 72) Giblon, vol. II, fq. 212.
- 73) C.O. Castiglioni, Recherches sur les Berberes atlantiques, fq. 96-97, (Milan, 1826).
- 74) Synesii Catastasis (Migne Patr. Gr. tome LXVI, fq. 1569).
- 75) Neander (2), fq. 320.
- 76) Gibbon, vol. IV, fq. 331-333.
- 77) Gibbon, vol. V, fq. 115.
- 78) Tijani, fq. 201; Gibbon, vol. V, fq. 122.
- 79) Gibbon, vol. V, fq. 214.
- 80) Neander (I), vol. V, fq. 254-255. J. T. Wiltsch, Hand-book of the geography and statistics of the Chvich, vol. I, fq. 433-434 (London, 1859), J.

Bournichan: L'Invasion musulmane en Afrique, fq. 32-33 (Tours, 1890).

81) Leo Africanus, (Ramusio, bl. I, fq. 70, D.).

82) Denseni është qytet i vjetër. E kanë ndërtuar Romakët në kufirin e mbretërisë Buggia dhe shkretëtirës Numidie (Leo Africanus, bl. I, fq. 75, F).

83) Pavg, vol. I. fq. IV.

84) "Të gjithë ata që nuk janë kthyer në islam dhe që kanë mbetur lojal besimit të vet dhe kanë refuzuar ta paguajnë xhizjen kanë qenë të detyruar të ikin para ushtrisë islame." (Tijani, fq. 201).

85) Leo Africanus (Ramusio, bl. I, fq. 7).

86) Leo Africanus (Ramusio, fq. 65, 66, 68, 69, 76).

87) Kajruvani është themeluar në vitin 50 H., Fesi 185 H., Al-Mehdiya më 303 H., Masiali më 315 H., Marakeshi më 424 H., (Abu'l-Fida, bl. II, fq. 198, 186, 200, 191, 187).

88) Ibn Abi Dhar, fq. 16.

89) Ekziston rasti i dyshimtë i konvertimit të detyrueshëm që i përshkruhet Abd al-Mu'minit, i cili e ka pushtuar Tunizinë në vitin 1159. Shih De Mass Latrie (2), fq. 77-78: "Ekzistojnë dy autorë arabë, një prej të cilëve është Ibn al-Thir, i cili ka qenë bashkëkohës. Ka jetuar në Damask, në entuziazmin fetar të nxitur me fitoret e Salahuddin.

Autori i dytë është Tijaniu (Tixhaniu) i cili e vizitoi Afrikën në shekullin XIV. Këta të dytë kanë shkruar se sunduesi i Tunizisë i ka detyruar të krishterët dhe Hebraikët, të banuar në këtë qytet, ta pranojnë islamin, dhe se të padëgjueshmit pamëshirshëm janë mbytur.

107

Ne dyshojmë në këto masa të marra, sepse sikur urdhëresa të ishte dhënë nga sulltani, në entuziazmin e fitores, me qëllim të plotësimittë disa dëshirave të përkohshme, ka qenë e domosdoshme që më vonë ta ndërrojë ose tërheq, sepse çështja kundërshtohet me principin e lirisë fetare që është respektuar nga të gjithë sunduesit magrebit deri në atë kohë. Ajo që është e sigurtë është ajo se të krishterët dhe Hebraikët nuk u paraqitën më në Tunizi. Madje i shohim të krishterët se e banojnë para përfundimit të sundimit të Abdulmu'minit, dhe se kënaqen sikurse edhe para kohës së tij në lirinë e kryerjes së punëve tregtare dhe manifestimit të ritualeve fetare... Një shkrimtar klasik arab thotë se Abdulmu'mini ka kaluar viset e Zabes në Afrikë, i përkrahur prej All-Ilahut në pushtimin e ndërmarrë të vendeve e qyteteve. I ka dhënë siguri dhe mbrojtje atij që i kërkon, dhe ka luftuar kundër atij që i kundërvihet."

Këto fjalët e fundit i përmbajnë mendimet tona për atë që është ndërmarrë ndaj të krishterëve të cilët kanë pranuar vendimin me vdekje, të cilin ua ka caktuar fati."

90) De Mas Lotrie (2), fq. 27-28.

91) S. Leonie IX, Papae Epist LXXXIII (Migne Patr, Lat, bl. CXLIII, fq. 728). Objekt i kësaj letre është konflikti i prioritetit ndërmjet peshkopit të Gummes dhe Kartagjenës.

Është e mundur se gjendja e anarkisë, që atëherë ka mbretëruar në

Afrikë, ka sjell deri aty që peshkopët e Afrikës nuk dinë asgjë për peskkoopët tjerë, përveç për ata që u janë dhënë në administrim.

Sipas informatave të dhëna papës numri i peshkopëve është dukur më i vogël se që është në realitet.

92) A. Müller, vol. II, fq. 628-629.

93) S. Gregorü VII, Epistola XIX (Libertertius), (Migne Lat. bl. CXLVIII, fq. 449).

94) De Mas Latrie, fq. 220. Një numër i të krishterëve spanjoll të parët e të cilit janë internuar në Maroko në vitin 112 kanë qenë atje deri në vitin 1386, kur iu lejua që të kthehen në Sevihje, me mirësinë e sulltanit marokien (Whishaw, fq. 31-34).

95) C. Trumelet, Les Saintes de l'Islam, fq. XXXIII (Pariz, 1881).

96) F. Morgan, vol. II, fq. 256.

97) C. Trumelet, Les Saints de l'Islam, fq. XXVIII-XXVI.

98) Leo Afrikani thotë, në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë, që të gjithë malësorët e Algjerisë dhe Buggisë, ndonëse janë muslimanë, e tatuazhojnë në fytyrat e veta dhe në shuplakat e duarve kryqin e zi (Ramusio, I, fq. 61). Të ngjashëm mjanë edhe Benu Mirab të cilët deri sot i kanë ruajtur disa tradita fetare të lidhura për anatemën dhe rrëfimin (Oppel, fq. 299). Disa fise nomade të Sahares kryejnë praktikimin e një lloj kryqimi dhe e përdorin kryqin për dekorimin e gjërave të veta dhe armëve (De Mas Latrie (2), fq. 8).

108

99) Tijani, fq. 203.

100) Ky është Tonzeri bashkëkohas në Tunizi.

101) Tarih al-duwel al-islamiyye bi-l-maghrib, I, fq. 140 (botues De Slane, Algen, 1847).

102) Leo Africanus (Ramusio, bl. fq. 67).

103) Powy, vol. I, fq. VII.

104) De Mas Latrie (2) fq. 61-62, 266-267. L. del Marmol-CAravajal: Del-Afrique, bl. II, fq. 54 (Paris, 1667).

105) De Mas Latrie (2), fq. 192.

106) Rsh. Inoçenti III, Grguri VII, Grgusi IX dhe Inoçenti IX.

107) De Mas Latrie (2), fq. 273.

KAPTINA V

PËRHAPJA E ISLAMIT NË MESIN E TË KRISHTERËVË TË

SPANJËS

Krishterizmi në Spanjë para pushtimeve islame

Arabët në vitin 711/93 H. e sollën islamin në Spanjë, kurse feja islame në mbretërinë Spanjolle me dekretim e Ferdinandit dhe Izabels më 1502?908 H. është abroguar. Gjatë shumë shekujve të kësaj periode muslimanët kanë lënë faqet më të mbritshme historike në mesjetë. Ja, ky ndiki i muslimanëve spanjoll ka kaluar nëpërmjet Provancës edhe në viset tjera të Evropës, dhe se janë zgjuar ndjenja të reja dhe është krijuar shkencë e re. Shkenca dhe filozofia, e cila dijetarëve evropianë ua ka freskuar veprimtarinë shkencore deri në renesansë (renaissance-rilindja) u lind nga Spanja. Por pasi lënda e

kësaj veprë nuk është të flitet për jetën kulturore, domethënë për të arriturat e artit, shkencës, filozofisë, për këtë do të kthehemi në gjendjen fetare në Spanjë nën sundimin e muslimanëve.

Kur muslimanët e sollën islamin në Spanjë, atje katolicizmi i krishterë, pasi ngadhëjeu ndaj sekti arijevit, u forcua. Në kancelinë e gjashtë, që është mbajtur në Toledo; është vënë ligji se do të betohen të gjithë mbretërit që vijnë në fron se nuk do të lejojnë fe as sekt tjetër pos atij katolik dhe është konkluduar që ligji do të zbatohet strikt mbi ata që do të jenë kundërshtues të fesë katolike. Ligji më vonë i shtruar ka përcaktuar burgun e përhershëm dhe konfiskimin e pasurisë për atë që tregon dyshim ose kundërshti mnunciatës së shenjtë kishtarë, institucioneve evangjeliste katolike, rekomandimeve të etërve kishtarë dhe traditave të shenjta. Kleri, për shtresën e vet, ka zënë në administratën shtetërore ndikim dominant.1) Peshkopët dhe dinjitarët tjerë kishtarë kanë pasur vendet në Kuvendin popullor, i cili ka rregulluar punët e rëndësishme shtetërore, ka lejuar zgjedhjen e mbretit dhe i cili, në rast se nuk

109
shkonte sipas vendimeve të tij, e shkarkonte. Kleri i krishterë, duke e grabitur këtë influencë dhe duke e shfrytëzuar, i ka nënshtruar mundimeve të mëdha Hebraikët e shumënumërt spanjoll. Kanë ndërmarrë masa drakonike kundër atyre që nuk kanë dëshiruar të kryqohen.2) Ja, pasardhësit e këtyre Hebroikëve me hare të sinqertë i kanë pritur shpëtuesit e vet, pushtuesit arab, dhe s'enë qytetet e pushtuara në emër të tyre kanë formuar gardën, kurse në vendet e fartifikuara i kanë hapur dyert.3)

Muslimanët në Spanjë janë pritur me gazmend edhe nga ana e robërve.

Gjendja e këtyre robërve nën sundimin gotik, të cilën më herët e kanë themeluar dy popuj gjermanë, ka qenë e pafatshme dhe e mjerë. njohja e tyre e krishterizmit, në atë kohë kur i janë bashkangjitur fatit të islamit, e që ka ofruar lirinë dhe dobitë tjera, ka qenë aq e ciptë dhe në shkollë aq të ulët sa nuk kanë pasur aftësi gjykimi. Konvertitet e parë në Spanjë kanë qenë këta robët e shtypur. Deri në vitin 6934) sipas Isaut numri i caktuar i adhuruesëve të zjarrit ka shkuar pas shembullit të konvertionit të këtyre robërve. Pastaj shumë bujarë të krishterë, ose nga ????????? ose për ndonjë shkak tjetër, e kanë përqafuar islamin.5) Shumë sosh nga shtresa e mesme dhe e ulët, jo vetëm formalisht, por edhe nga bindja e pastër u kthyen në islam, ashtu që ia kthyen shpinën fesë klerikët e së cilës i kanë lënë në padije dhe pakujdesi që nga shkaqet materiale i ka ekspozuar grabitjes dhe shkeljes.6) Këto konvertitet spanjollë pasi e pranonin islamin, bëheshin ithtarët më të zellshëm. Ata kanë ndjekur si vetë ashtu edhe familjet e tyre, në kundërshtim me mënyrën e jetës luksoze e të shfrenuar të aristokracisë arabe, mënyrën e jetës së muslimanëve të sinqertë dhe thellë të devotshëm.7)

Historianët e krishterë shkruajnë se gjatë kohës së pushtimeve islame patën ra virtytet e vjetra gotike, sa që dashuria e tepruar ndaj femrave patë zënë vendin e këtyre cilësive të urta në sjelljen e njerëzve, dhe janë nisur rrugës së keqe, për çka pushteti islamm është përjetuar si denim i të Gjithëartit,8) par këto shpjegime të historianëve kishtarë sipas dëshimit të

historisë së re nuk mund të pranohen.9)

Njëmend, gjatë kohës nuk janë vërejtur gjurmat e përmirësimit të gjendjes së tyre. Atëherë peshkopët kanë prezentuar në ceremonitë e veçanta në pallatet e sunduesve; pozitat e tyre janë shitur në ankand. Janë vendosur në pozita të larta shpirtërore, të jenë udhëheqës të njerëzisë, personalitetet të dyshimtë për heretizëm, kurse ata i kanë caktuar në pozita më të ulta popat e thjeshtë e jo të virtytshëm.10)

Personat që kanë hequr dorë nga feja,

sikur historianët kishtarë të dëshironin t'i shënojnë në librat e veta, do të gjenim numër të madh shembujsh në Spanjë të atyre të cilët për shkak të 110

veprimet jomoral të popave e kanë lëshuar kishën. Bandoti, i cili gjatë kohës së Ludevrit të Devotshëm ka zënë pozitën zyrtare të klerikut të lartë në pallatin francez, ka kaluar në vitin 838/224 H., në hebraizëm që të mundetsipas fjalëve të tij - duke lëshuar mënyrën gabuese të jetës, suksesivisht të nivelizohet sipas ligjeve hyjnore.12) Peshkopi Egila i cili është dërguar kah fundi i shekullit VIII në mesin e të krishterëve në Spanjën jugore ta ndalojë veprimin e influencës islame, i ka pandehur popat spanjoll për kanbubinat (ruajtja e kurtizaneve).13)

Sekti i krishterë arianizmi në formën e veçant, që ende ka ekzistuar te Gotët e vjetër, është ringjallur sipas kishës spanjolle diç para sulmit arab dhe ka filluar në vepër të aplikohet.14) Nuk ka dyshim se ky sekt i ka përgatitur njerëzit ta pranojnë fenë e re, mësimi i të cilës në aspekt të krishterizmit ka qenë më afër atij se krishterizmit.15) Mund të vërehet se në Evropën perëndimore deri në invazionin arab ky ka qenë rasti i parë i konvertimit. Kështu është konvertuar një Bizantinas (Teodosiklos) i cili erdhi në vitin 636/15 H. në pozitën e peshkopit në Seville në vend të shën Isidorit. Pasi ai ka besuar se Jezusi i bashkuar me Atin dhe Shpirtin e Shenjtë nuk paraqet Zotin, por se vetë mZoti e ka bërë bir të Vetën, është shkarkuar nga pozita shpirtërore. Në këtë Teodosiku ka heq dorë dhe iu është bashkangjitur Arabëve, dhe se në mesin e tyre edhe konvertoi.16)

Ndikimi i tolerancës së Arabëve në të krishterët

Në filli më pushtimit islam nuk është dëgjuar asnjë rast të atakut në fe as konvertimit të detyrueshëm. Dhe njëmend, një rrethanë, e cila më së shumti ka ndikuar në pushtimin e Spanjës, është ajo që pushtuesit arabë kanë marrë qëndrim tolerant ndaj krishterizmit. Të krishterët të vetmen kanë mund të ankohen në zotërinjt e ri, që me ta kanë vepruar në aspekt të marrjes së tatimit, domethënë që kanë marrë haraçin nga pasanikët 40, nga t ëmesmit 20, e nga shtresa zejtare 12 dirhemë. Pasi këtë tati me kanë tubuar si zëvendësim për detyrën ushtarake, këtë e kanë marrë nga mashkujt plotësisht të shëndoshë, deri sa fëmijët, gratë, varfanjakët, kallugjret, të çalët, të së murit dhe robërit kanë qenë të liruar nga dhënia.17) Pasi këtë tatim e kanë tubuar nëpunësit e krishterë, këtë ata nuk kanë pasur aq mundime e vuajtje.18) Në kontestet që nuk kanë shkuar në dë më të ligjeve islame, kur edhe paditësi edhe i padituri kanë qenë të krishterë, i ka gjykuar gjyqtari i po asaj

feje sipas ligjeve të tyre,19) dhe askush nuk u është perzier në punët fetare.20) Rituali i sakrificës së pagjakë, i cili është një prej ritualeve të apstra katolike, kryhej me temjanikët e ndezur dhe me cingërrimën e kambanës, Edhe predikime kanë mbajtur, poezi fetare kanë kënduar, shkurtimisht, ritualet kishtarë sipas traditës i kanë kryer. Është e qartë se të detyruar nuk kanë qenë, siç ka qenë kjo në Siri dhe Egjipt, për shkak të nënçmimit të shtresës 111

së tyre, të veshin rroba tjetërfare. Gjithësesi se të krishterët në shekullin IX janë veshur, përveç priftërisë, sikur edhe Arabët.21) Nganjëherë merrnin leje të ndërtojnë kisha të reja.22) Lexojmë në veprat historike të atyre kohëve se nëpunësit muslimanë nuk janë perzier në atë që të krishterët sërish kanë formuar manastire për monakët dhe kallugjeret.23) Në vendet publike shiheshin monakët në mantelët (habitët) e leshta sipas rregullave të rendit të tyre, ndërsa priftërinjt nuk kanë ndier nevojën t'i fshehin shenjat e besimit të tyre.24) Njëkohësisht, nuk i kanë mospërfillë të krishterët duke i marrë në shërbim në pallatë dhe në pozita të larta.25)

Për të krishterët, që janë pajtuar me atë që e kanë humbur fuqinë politike, duhet se nuk ka pasur shkas për ankesë. Është me rëndësi edhe rrethana se gjatë tërë shekullit të XVIII është organizuar vetëm një trazirë dhe këtë në vendin BExha (Beja) në veprimin e një kryepari arab.26) Në gjendje më të mirë nuk gjendeshin as bashkëbesimtarët e tyre të cilët janë shpërngulur brenda kufirit francez me dëshirë që të jetojnë nën sundimin e krishterë. Natyrisht, kur Karlo i Madh u kthye nga Spanja në vitin 812, emigrantët e krishterë që kanë ndjekur ushtrinë e tij aq janë keqtrajtuar nga ana e oficerëve të tij, sa ka qenë i detyruar për shkak të mbrojtjes së tyre të intervenojë. Ludeviti I i Devotshmi (le Debomair) i cili pas tij ka ardhë në sundim, ka dhënë urdhëresa të veçanta në dobi të të shpërngulurve, pasi që aristokracia ka grabitur pasuritë që u janë dhënë refugjatëve të cekur, në çka këta kanë qenë të detyruar sërish të ankohen. Kjo tirani, edhe pse për një kohë është ndërprerë, megjithatë më vonë është paraqitur. Irdhëresat që janë dhënë në dobi të të ngujuarve, e kanë bërë gjendjen e tyre edhe më të padurueshme. Këta fatkeqë, të cilit, duke i ikur nën pushtetit islam, janë hedhur në përqaftim të dhembshurisë së vëllezërve të vet të krishterë, edhe njëherë i shohim të ekspozuar keqtrajtimit dhe të nënçmuar.27)

Qëndrimin tolerant që e ka marrë shteti islam në Spanjë dhe kontaktet e lira të ithtarëve të të dy feve kanë bërë që deri diku këto dy bashkësi janë perzier. Izidari nga vendi Bexha, që hedhë gur e dru kundër pushtuesëve muslimanë, pa kundërshtim ka shënuar kurorëzimin e të vejës së mbretit Roderiko me Abdulaziz b. Mu'adhin.28) Shumë të krishterë kanë marrë emra arab, dhe, madje kjo qoftë edhe formalisht, kanë ndjekur disa tradita të fqinjve të vet muslimanë. Për shembull, disa i kanë bërë synnet (cirkumizuar) fëmijët e tyre.29) Shumë sosh që kanë bartur emrin "paganë të pakryqar" i kanë imituar muslimanët në ushqim e pije.30) Shprehja "Muzarab" - e shtrembëruar prej "musta'reb" (i arabizuar) - me të cilin kuptohen të krishterët spanjoll nën sundimin arab, me ballafaqimin e vet

dëfron në rrethanat në të cilat është jetuar, përmbanë në vete rëndësinë mbi prirjet në atë aspekt. Mësimi i gjuhës arabe, shpejt e zuri vendin e mësimit të gjuhës latine në tërë Spanjën.³¹) Kështu gjuha latine, gjuhë e teologjisë së krishterë, shkallërisht është harruar ashtu³²) që madje janë turpëruar klerikët 112

nga pozitat e larta për shkak të mosnjohjes së tyre të gjuhës latine. Natyrisht se nuk ka mund të pritet më shumë kujdes dhe orvatje për këto gjëra nga ata që nuk kanë qenë figura shpirtërore. Një autor spanjoll për këtë shkak në një vepër të shkruar në vitin 854 i qarton bashkëqytetarët e vet të krishterë: "Deri sa ne i studiojmë doktrinën e shenjtë të muslimanëve, deri sa takohemi me ta t'i mësojmë drejtimit filozofike, ose, më drejtë, lavdërimin e tyre filozofik, derisa ne këtë e bëjmë, jo me qëllim t'i përgënjeshtrojmë mashtrimet e tyre, por të entuziazmuar me bukurinë e gjuhës së tyre dhe tërheqshmërinë e elokuencës së tyre, e mospërfillim Evangjeljen. Ku mundemi tash të gjejmë njeri të ditur që do t'i përkushtohet studimit të veprës latine të etërve të cilët janë zhytur në studimin e shkresave librave tona të shenjtë. Rinia jonë e krishterë e pasur me fjalët dhe qëndrimin zotërues, po krenoset me shkencën e huaj. Janë dehur me elokuencën arabe. Me kënaqësi i studiojnë librat muslimane, pikërisht e gëlltisnin përmbajtjen e tyre. Deri sa ata nuk kanë lidhje mbi letërsinë kishtarë ose, më saktë, deri sa me përbuzje shikojnë në valët kishtarë, që rrjedhin nga parajsa, i lavdojnë me elokuencë bombastike veprat islame. Të krishterët aq dobët i njohin ligjet e fesë së vet, aq pak kujdes i kushtojnë gjuhës së vet latine që mezi në mesin e tyre është një nga njëmijë që do të mund të shkruaj, e që të kuptohet një letër më e rëndomtë: që të pyes për shëndetin e mikut të vet. Mirëpo, ka nga të gjitha shtresat për shkak të ndarjes të përzierit ndër retoristët arabë. Ata mund të shkruajnë poezi arabe, vargjet e të cilave mburojnë me të njëjtën shkronjë, dhe se në këtë janë bërë të njohur më tepër se tëhuajt (Arabët).³³) Pasi ishin së tepërmi të preokupuar me dritën e letërsisë arabe, e cila i tërhiqte fuqishëm, pak kanë pasur material libror ata që kanë dëshiruar të njihen me veprat e krishtera. Madje mësuesit me vështirësi kanë gjetur të dhënat e rëndomta. Gjatë kohës këto nevoja pedagogjike janë rritur. Ky popull i arabizuar në një lutje, të dërguar mbretit aragonas Alfonsit, thotë: "Ne sikur edhe të vjetrit tonë deri sot jemi edukuar ndër të huajt. Pasi jemi të kryqar, i përmbushim urdherat fetarë të krishterë, por që të aftësohemi me mësim të denjë për fenë tonë të shenjtë, kjo gjithnjë nuk varet nga fuqia jonë, sepse u takojmë jobesimtarëve të cilët na bëjnë dhunë. Nuk kemi pasur guxim të kërkojmë mësues nga papa ose nga Franca, kurse mësuesit e atjeshëm përsëri nuk kanë mund të na vijnë vetëvetiu, duke u frikësuar nga të pafetë, të cilëve jemi të detyruar t'u nënshtrohemi."³⁴)

Si kuptohet, për shkak të kontaktit kështu të ngushtë me muslimanët, dhe për arsye të studimit të madh të letërsisë së tyre (arabe), madje Elvira,³⁵) kundërshtari fanatik i islamit, pranon bukurinë dhe çudibërjen retorike të Kur'anit, dhe këtë se të krishterët, duke e lexuar, nuk mund të përmbahen. Për këtë arsye është e natyrshme që këtu të vërehen gjurmat e ndikimit të

fesë të cilat ne i kemi hulumtuar dhe, njëmend, ato gjurma ekzistojnë. Është e njohur se prifti Elipandosi në vitin 810, peshkopi i Toledos, kamentues i 113

sektit heretik "mutehazin" dhe dijetar që ka besuar se Jezusi, i cili është njeri, nuk është përkah natyra i biri i Zotit, por sipas asaj që e ka ndjekur rrugën e Zotit - e ka përvetësuar këtë ide heretike për shkak të kontaktit të shpeshtë me muslimanët.36) Ky sekt i ri u zgjerua në shumë pjesë të Spanjës, dhe madje ka filluar të shtrihet, sipas udhëzimeve të peshkopit katalanas Feliksit, deri në Septimani, e cila ka qenë nën mbrojtjen franceze.37) Peshkopi Feliksi është çitur para gjyqit shpirtëror të cilit vet i ka kryesuar Karlo i Madh, dhe është detyruar që të heqë dorë dhe të pendohet për shkak të mashtrimit të vet, por posa është kthyer në Spanjë, ka ra sërish në herezën e vjetër. Kjo, sipas pohimit të papës së atëhershëm Leonit III, ka ndodhur për shkak të kontaktit me mosbesimtarët që kanë besim të ngjashëm.38) Kur ndikimi i kontaktit me muslimanët ka qenë aq i rëndësishëm në dinjitarët e mëdhenj kishtarë, mund të konkludojmë se ka qenë mjaft i madh edhe në të krishterët tjerë të Spanjës. Dhe vërtetë, koncili, që u forua në vitin 936 në Toledo, ka shqyrtuar se çfarë mjetesh duhet ndërmarrë kundër përzjerjes që do ta prishë pastërtinë e besimit të krishterë.39)

Kuptohet se këto ndikime të besimit dhe veprimit muslimanë - krahas disa sukseseve të caktuara të konvertimit40) - përveç përzjerjes së shpeshtë dhe kontakteve do të rezultojë me fryte edhe më të mëdha, dhe se do ta rrisin numrin e muslimanëve të gjakut joarab të quajtur "muvel-ledi". Nuk kaloi shumë kohë, e pasardhësit e këtyre muvel-ledëve kanë formuar partinë e rëndësishme në shtet.41) Madje merret vesh se më në fund këta muvel-ledë, të cilët e përbëjnë shumicën e popullësisë, qysh në fillim të shekullit IX, janë orvatur ta trondisin pushtetin arab, dhe se shkallërisht, duke formuar ndër muslimanët e Spanjës parti nacionale, njëmend treguan se ekzistojnë. Duket se nuk ka të dhëna për historinë e konvertimit të këtyre muslimanëve të rinj. Shembujt e këtyre konvertimeve janë vërejtur deri në ditët e fundit të pushtetit islam. Madje në vitin 1487/893 H. kur ushtria e Ferdinandit dhe Izabeles e pushtoi Malagën, ka mbytur, duke i torturuar me shkopa të hollë me maje, ata që kanë rënë nga krishterizmi. Pas kësaj nja dy vjet me marrëveshjen dorëzuese të Porgeues është marrë premtim i veçant se nuk do të detyrohen ata që e kanë lëshuar që sërish të kthehen në krishterizëm.42)

Disa nga konvertitët e kanë lëshuar islamin që të shpëtojnë nga gjoba në të holla, në të cilat janë gjykuar nga ana e gjyqeve.43) Shumicën e ka përvetësuar supremacioni shpirtëror i ndikimit islam.

Përzemërsia bujare me virtytet tjera humane e të larta, që i kanë treguar pushtuesit arabë, kanë krijuar fushë të hapur të zhvillimit të këtij ndikimi. Jeta e këtillë ka qenë e mbyllur për Spanjollët jomuslimanë. Kur krahasohet shkenca dhe letërsia e muslimanëve me shkencën dhe letërsinë e të krishterëve, kjo e dyta duket majft e varfër. Islami në fushën e shkencës dhe letërsisë, si lëvizës dhe faktor entuziazmues, ka kryer shërbim special për

114

ithtarët e vet. Përveç kësaj, Islami në Spanjë ka treguar tërheqshmëri të fisnikëruara të grupit religjioz, energjik të njerëzve të pastër moral, në krye të të cilëve kanë qenë teologët e devotshëm. Ky grup i sinqert e religjioz ka zhvilluar ndikim dominues në punët shtetërore, dhe se sinqerisht ka luftuar për zbatimin e reformave fetare dhe morale.

Kur merren parasysh ndjenjat e zjarra fetare të muslimanëve të spanjës, dhe intrigat e popullatës së krishterë, të cilëve në marrëveshje me bashkëmendimtarët jashtë kufirit e kanë revoltuar dhe zemëruar sundimin islam, mundemi përkundër të gjitha këtyre të vërejmë se Spanja ka qenë kursyer - pos rasteve përjashtuese - nga persekutimet fetare nën sundimin arab. Kur të përjashtohen tre-katër raste të zbatimit të denimit me vetëdashje të atyre që kanë dëshiruar që në emër të fesë të bëhen gjoja martirë, nuk mund të gjendet gjatë gjithë kohës së sundimit islam gjendja për të cilën do të mund të thuhet se është atak i pastër në fe. Pushteti islam ka ndërmarrë masa rigoroze që ta pengojnë marrëzinë e "çfilitjes vullnetare" që është lajmëruar në shekullin e IX në Kardovë (Cordoba). Atëherë në këtë anë të Spanjes në mesin e të krishterëve është përhapur grupi fanatik pjesëtarët e së cilës, pa arsye, publikisht kanë ofenduar fenë e muslimanëve dhe e kanë sharë Pejgamberin e tyre, dhe që të prodhojnë rrumën endacake të fanatizmit të krishterë, qëllimisht kanë tentuar të nxisin mbi vete denimin me vdekje.

Vetëflijimi i disa të krishterëve

Ky sprovim i çuditshëm i flijimit ime vetëdashje është vërejtur sidomos prej vitit 850 deri 860/236-246 H. në mesin e popave, monakëve dhe eremitëve. Atyre që u ka shmangur kurora e çfivitjes - për shkak të tolerancës së pushtetit në aspekt të lirisë së besimit - duke përsiatuar në qetësi nën kupolat e manastirit galas se si po zhduket influenza e krishterizmit dhe si po dobësohet zelli i tyre fetar, janë orvatur që sërish të arrihen me sulme të rrepta në islamin dhe Pejgamberin. Një nga të ngjashmit, njëfarë monaku Isak, erdhi para kadiut, dhe u shtirë sikur dëshiron t'i fitojë disa të dhëna për islamin. Pasi kadiu i ka dhënë njoftim për dispozitat e islamit, ky menjëherë ka atakuar me këto fjalë: "Muhammedi juve u ka sugjeruar rrena! Ooftë mallkimi i Zotit mbi të! Pasi ka qenë përplotë me të liga, e ka mashtruar njerëzinë në humbje dhe e ka tërhequr në greminë të skëterrës. Satana ka hyrë në të dhe satanisht duke iu magjepsur që t'u krijojë sëmundje te ju, ju ka dhënë gotën e pijes vdekëse. Për krimin e vet do ta bartë mallkimin amshues. Pasi jeni i arsyeshëm, përse nuk orvateni të shpëtoni nga këto rreziqe? Përse nuk do ta shkëputnit këtë besim të sëmurë dhe të kërkoni shpëtim në Evangjeliën e fesë së Jezusit?"⁴⁴)

Me një rast tjetër dy fanatikë të këtillë të krishterë hynë në xhami dhe krahas sharjeve nisën të thërrasin mallkim mbi islamin, duke pohuar se ai do

115

të tërheq mbi ithtarët e vet shkretinë e zjarrit të madh.⁴⁵) Njëmend, fanatikë të ngjashëm nuk ka pasur shumë.⁴⁶) Mirëpo, shteti islam u frikëzua nga kjo, sepse nënçmimi i udhëheqjes së saj ka tërhequr vërejtjen me mundësinë e

pakënaqësisë ndër muslimanët, e edhe nga kryengritja e përgjithshme. Prandaj, Muhammedi I*) e dërgoi në vitin 853/239 H. ushtrinë që t'i fusë në mend të krishterët e Toledos.47) Ndonëse, sipas një versioni, ky sundues patë urdhëruar që të kryhet masakër i përgjithshëm ndaj të krishterëve, megjithatë, kur iu shpjegua se në mesin e të krishterëve ka njerëz të kuptueshëm, që me këtë s'kanë asgjë të përbashkët,48) ka urdhëruar që strikt të aplikohet ligji mbi sharjen (blasfeminë). Rryma e matur ndër ithtarët e kishës ka miratuar vendimin e shtetit, kurse edhe peshkopët i kanë përjashtuar nga kisha fanatikët,49) të cilët ishin shkas për keqësimin e gjendjes së tyre. Që të përkujtojë në këto masa të marra, sidomos është thirrur Koncili në vitin 983/371 H. Pas këtij, ndonëse edhe aty-këtu janë vërejtur rastet e "çfilitjes me vetëdashje", megjithatë këto ngjarje nuk janë përsëritur gjatë kohës së sundimit të mëvonshëm arab.50)

Devijimi i disa muslimanëve nuk e mohon idenë e tolerancës islame. E vërteta, gjatë kohës së dinastisë së Almoravidëve (murabitun) dhe në fillim të shekullit XII u paraqit në mesin e teologëve të entuziazmuar muslimanë rryma e fanatizmit. Nga kjo lëvizje e ndezur kanë pësuar të krishterët së bashku me Hebraikët, e madje edhe liberalët muslimanë sikur poetët dhe filozofët. Mirëpo, ndodhitë e këtilla paraqesin përjashtime të rralla nga parimi tolerant, që e kanë përvetësuar sunduesit islamë të Spanjes ndaj popullatës së krishterë.

Një nga muslimanët andaluzias të quajtur "Moriskos" (Mariscos), duke protestuar në vitin 1610/1019 H. kundër vrazhdësisë së inkuizionit, i cili atëherë tashmë i kishte persekutuar muslimanët e përmendur, iu përkujton të krishterëve tolerancën liridashëse të cilën dikur ua kanë treguar bashkëbesimtarët me këto fjalë:

"Deri sa fuqia ka qenë në duart e gjyshërve tonë ngadhnjimitarë, a kanë dëshiruar kurdoherë ta çrrënjosin krishterizmin nga Andaluzia? Derisa sa të parët tuaj kanë qenë nën sundimin e tyre, a nuk ua kanë dhënë ata lirinë e plotë të besimit dhe lirinë e kryerjes së liturgjive të krishtera? A nuk ka urdhëruar Pejgamberi jonë që të ruhen besimet e vejtra, qofshin ato edhe të shtrembëra, me çmimin e dhënies së tatimit (haraçit) të matur vjetor për çdo pjesëtarë të popullit, cili do qoftë e edhe me anë të shpatës islame, është futur në rrethin e të pushtuarve? Nëse atëherë ka pasur raste të konvertimit me dhunë, ata janë aq të rrallë sa që nuk mbahen mend, e madje edhe ato janë bërë nga ata në zemrat e të cilëve nuk ka pasur frikë as nga Zoti as nga

116

Pejgamberi i Tij. Ata i kanë tiranitë duke e ditur se kjo është plotësisht në kundërshtim me parimet dhe rregullat islame. Nuk mund të pohoni se te ne ka, për shkak të tjetërllojësisë në besim, ndonjë gjyq zyrtar sikur inkuizioni juaj i përgjakshëm. Pa dyshim, atoqë dëshirojnë ta përqafojnë fenë tonë, gjithnjë e gjejnë të hupur përqafimin tonë vëllezëror, por Kur'ani kerimi nuk na lejon të bëjmë presion në ndërgjegje. Njerëzit që fusim në fenë tonë do t'i arrijnë të gjitha përkrahjet e mundshme. Posa e deklaron besimin në njësinë e Zotit dhe në pejgamberinë e Pejgamberit tonë, ne pa kurrfarë

kushtesh e konsiderojmë tonin; ne pa kurrfarë kushtesh e konsiderojmë tonin; kurorëzohet me vajzat tona dhe gjenë punë në profesionet e larta të dobishme, ku kërkohet besnikëria. Ne kënaqemi me atë që do të trajtohet sikur edhe ne dhe që nga jashtësia, e duke mos e verifikuar ndërgjegjen e tij - do të duhet musliman, vetëm me atë kusht nëse haptas nuk e qorton fenë dhe nuk e vë në tallje. Në rast se dikush bënë kështu, ne të tillët njëmend do t'i denojmë, sepse vullnetarisht e kanë përqaftuar fenë, e jo me dhunë.51)

Në një memorandum që ia shtroi mbretit Filipit III kryepeshkopi i Valencisë, e të cilën e ka hartuar në vitin 1602/1011 H., me qëllim që ta rekomandojë internimin, nënçmimin dhe konvertimin e muslimanëve spanjollë, theksohet në një pikë në fillim në këtë frymën tolerantë të islamit. Me këtë rast në memorandumun e njëjtë pranohet se Turqit dhe muslimanët tjerë i kanë dhënë nënshtetasve jomuslimanë lirinë e ndërgjegjes.52)

Pasi islami ka lëshuar thellë rrënjët në zemrat e popullit spanjoll, mund të gjykojmë sipas kësaj gjendjeje kur është larguar grupacioni i fundit i muslimanëve vendas, i quajtur "Moriskos", në vitin 1610/1019 H., këta të mjerë, ndonëse janë detyruar që pas 100 vjet formalisht të tregohen të krishterë, kanë dëftuar se kanë mbetur besnikëfese së të parëve. Përkundër emigrimeve, që kanë ndodhur pas rënies së Granadës, numri i grupacionit të fundit të internuar ka qenë pesë qindë mijë.53) Qytetet dhe fshatrat janë shkretuar, kurse shtëpitë janë shndërruar në gërmadha, dhe nuk kanë gjetur banorë të ri të cilët do t'i riparonin.4) Në damarët e këtyre Moriskosëve ka pasur shumë pak gjakë arabi. Të cekën provat për këto shpjegime do të ishte edhe së tepërmi gjatë. Vetëm që në këtë aspekt ta përmendim një pikë, e ajo është nxjerrë nga një letër që është shkruar në vitin 1311/711 H. Sipas saj prej 250.000 muslimanëve, të banuar në Granadë, kanë qenë vetëm 500 të gjakut arab. Të tjerët të gjithë kanë qenë pasardhës të konvertitëve spanjollë.55) Në përfundim ta shënojmë edhe këtë se islami deri në ditët e fundit të ekzistencës së vet në Spanjë ka fituar konvertitë të ri. Për këtë arsye një historian, duke shkruar për ndodhitë që kanë ndodhur në vitin 1499/905 H. d.m.th. shtatë vjet pas rënies së Granadës, tërheq vëmendjen në këtë fakt, d.m.th. se madje edhe në kohën e tillë disa të krishterë që jetojnë në mesin e Marokienëve kanë hyrë në shtegun fetar të të ndershmit Muhammed.56)

117

1) Baudissin, fq. 22.

2) Helfferich, 68.

3) Makarri, vol. I, fq. 280-292.

4) Baudissin, fq. 7.

5) Dozy (2) bl. II, fq. 45-46.

6) A. Müller, vol. II, fq. 463.

7) Dozy (2), bl. II, fq. 44-46.

8) So St. Boniface (A. D. 745, Epist. LXII). "Siç u ka ndodhur edhe fiseve tjera në krahinat e Spanjës dhe popullatës së Burgundiso, e cila ka bërë mëkat të madh duke u larguar nga Zoti, kështu Gjyqtarë Suprem ka

vendosur t'i denojë dhe t'iu hakmerret nëpërmjet Arabëve, për shkak të mëkateve të bëra dhe mosnjohjes së ligjit të Zotit". (Migne, Patr: Lat. bl. LXXXIX, fq. 761).

9) Dozy (3), bl. I, fq. 15-20; Whishaw, fq. 38, 44.

10) Samson, fq. 377-378, 381.

11) Dozy (2), bl. II, fq. 210.

12) Alwari Corduben-sis. Epist. XIX "Unë pa dyshim i dorëzohem Ligjit të Zotit, me shumë mallëngjim sepse meritoj denimin e amshueshëm." (Migne, Patr. Lat. bl. CXXI, fq. 512).

13) Helfferich, fq. 83.

14) Helfferich, fq. 79-80.

15) "Nëse njeriu do të mendonte se deri në çfarë mase është dëgjuar ehoja e idesë së profecisë të marrë nga Besëlidhja e vjetër në krishterizmin e fiseve gjermane ariane, madje nsëe do të mendonte për mbajtjen e kësaj ideje te Gotët perëndimor pas pranimit të drejtimit katolik - nëse për të gjitha njeriu mendon mirë, do ta kam të qartë se si, pas ardhjes së Arabëve, te popujt e nënshtruar të krishterë janë shfaqur pikëpamjet e ngjashme me islamin." (Helffenich, fq. 82).

16) Lucae Diaconi Tudensis Chronicon Mundi, (Andreas Schottus: Hispaniae Illustratae, bl. IV, fq. 53) (Francefurti, 1603-1608).

17) Dozy (2), bl. II, fq. 41; Whishaw, fq. 17.

18) Dozy (2), bl. II, fq. 39.

19) Baudissin, fq. 11-13, 196.

20) Eulogius: Mem. Sanet. lib. I, 30. "Jetojmë në mesin e tyre pa urrejtje fetare" (fq. 761). "Nuk i ka detyruar kurrfarë fuqie e sunduesit ta mohojnë fenë e vet, as i ka larguar nga adhurimi i fesë së shenjtë" (fq. 751).

Johni nga Gorzi (që e vizitoi Spanjën kah gjysma e shekullit të dhjetë, fq.

124 thotë: "Të krishterët gjatë kohës së sundimit të tyre lirisht disponojnë me pasuritë e veta dhe i vizitojnë vendet e shenjtja."

Përshkrimin e tillë të gjendjes të të krishterëve e ka dërguar edhe peshkopi spanjoll Johni nga Gorzi dhe në të thotë:

118

"Në këtë gjendje kemi ardhur për shkak të mëkateve tona. I jemi nënshtruar fuqisë së jobesimtarit dhe jemi të paaftë t'i kundervihemi sundimit të tyre. Në këtë situatë nuk mund të ankojemi përveç në atë që të krishterët që janë në shërbim i përshëndesin (muslimanët) që i takojnë, kurse ata në këtë i përmbajnë. Nuk na pengojnë në përdorimin e ligjeve tona. Janë të kënaqur, njëkohësisht, me jetën e tyre shoqërore.

Deri sa nuk largohemi prej fesë sonë, duhet për kohësisht të tregojmë pranimin e politikës ndaj nesh. I nënshtrohemi dhe u bindemi urdhërave të tyre, deri sa politika e tyre nuk bëhet pengesë e besimit tonë." (fq. 302).

21) Baudissin, fq. 16-17.

22) Eulogius, vdiq në vitin 859 (Mem. Sanet. lib. III, C. 3) flet për kishat e posandërtuara. Kjo ndodhi historike gabimisht i është përshkruar Luitbraudit në lidhje me ndërtimin e kishës në Kordobë në vitin 895 (fq.

1113).

23) Eulogius, Mem. Sanet. lib. III, c. II. (fq. 812).

24) Baudissin, fq. 16).

25) Baudissin, fq. 21 dhe John of Garz, 128 (fq. 306).

26) Dozy (2), bl. II, fq. 42.

27) Baudissin, fq. 96-97.

28) Isidori Pacensis Chronicon, 42 (fq. 1266).

29) Alvar: Indic. Lum. 35 (fq. 53); John of Garz, 123, (fq. 303).

30) Letter of Hadrian I, fq. 385; John of Garz, 123. (fq. 303).

30) Letter of Hadrian I, fq. 385; John of Garz, 123, (fq. 303).

31) Ekzistojnë ende vargjet arabe të një poeti të krishterë që dëftojnë në shkathtësinë e shkëlqyeshme në zotërimin me gjuhën e metrin (Von Schack, II, 95).

32) A. Samson na jep shembuj të stilit të dobët latin, me të cilin shkruajnë disa teologë në kohën e tij, dhe thotë: "Sepse jemi kënaqur me krishterizmin e thjeshtë, pas përmirësimit të tij u bë më i keq se ai më parë. Qemë kënaqur për shkak të thjeshtësisë së krishterë." (fq. 404, 406).

37) Alvar: Indc. Lum. 35 (fq. 554-556).

34) Orderic Vitalis, fq. 928.

35) Alvar, Ind. Lum. 29: "Me sytë tonë lexojmë në librat e tyre. I miratojmë të gjitha tekstet e frazave dhe lutjeve me të cilat luten ndihmuesit e kësaj feje - dhe të cilat për çdo ditë formohen me shkathtësi të shkëlqyeshme dhe elokuencë tërheqëse." (Migne. Patr. Lat. bl. CXXI, fq. 546).

36) Enhueber, 26, fq. 353.

37) Helfferich, fq. 88.

38) "Pak më vonë ka thyes ligjin e Zotit, iku te jobesimtarët me të cilin është pajtuar posa ka thyer zotimin e vet".

119

Frobenii dissertatio de hacresi Elipandi et Felicis, XXIV. (Migne. Patr. Lat. bl. CI, fq. 313).

39) Pseudo-Luitpraudi Chronicon, 341 (fq. 1115) "Basiliusi ka thirrur koncilin e Toledos dhe me të ka kushtëzuar që mos të denohen të krishterët për shkak të përzierjes me muslimanët".

40) Ekzistojnë pak tekste që shpjegojnë këta faktorë dhe orvatje. Mirëpo, ato vërehen nga fjalët Eulogiusit (Liber Apologeticus Martyrum, 20) për Muhammedin: "Pa dyshim do të kenë sukses ata katolikë që dëshirojnë ta njoftojnë marrëzinë e këtij mëkati, çmendurinë e këtij misioni dhe mashtrimin e novatarisë pa shenjtëri, shumë më qartë se vetë anëtarët e këtij sekti, nëse i mësojnë. Janë me bindje se janë në diç të shenjtë, besojnë në të dhe thërrasin në fenë e Pejgamberit të vet jo vetëm në fshehtësi, por madje edhe në folurit publik." (Magne: Patr. lat, bl. CXV, fq. 862).

41) Dozy (2), bl. II, fq. 53.

42) Lea, The Moriseos, fq. 17, 18.

43) Samson, fq. 379.

44) Eulogius, Mem. Sanet. prof. 2 (Migue. bl. CXYV, fq. 737).

35) Eulogius, e XIII, (fq. 794).

46) Thuhet se numri i martirëve nuk ka qenë më i madh se katërdhjetë (W. H. Prescott, History of the Reign of Ferdinand and Isabella, vol. I, fq. 342, n.) (London, 1846)

*) Muhammedi I i biri i Abdurrahmanit II, është sunduesi i pestë i halifëve umevit në Spanjën muslimane. Ka sunduar në vitin 852-886. Është orvatur ta ndjek rrugën e babait të vet në punën për mirëqenien dhe jetesën tolerante të shtetit multikonfesional dhe shumënational. Trazirat, kryengritjet e brendshme, përzjerja e sunduesve përreth të krishterëve dhe ndërsimi i popullatës së krishterë në pushtetin muslimanë, pastaj sulmet e Normanëve nga jashtë, i kanë shkaktuar këtij emiri vështirësi të shpeshta. Në krye të këtyre trazirave më së shpehti ka qëndruar kryeqendra e dikurshme mbretërore dhe qendra e pushtetit kishtar qyteti Toledo.

Inan, M. A., Devletü I-islam fi I-Andalus (Shteti islam në Andaluzi/Spanjë), Kairo, 1960, (bot. III), voll. II, fq. 284-312.

Hiti, vepra e cituar, fq. 466-467,; Gomez, E. G., Mavarsha Shpanija, Svijet islam, fq. 229-232 (SH. N.)

47) Dozy (2), bl. II, fq. 161-162.

48) Eulogius: Mem. Sanet, J. III > C. VII (fq. 805) "Fakti i qartë flet se ndër të krishterët nuk ka njeri të mençur e të edukuar, as liderë që do të bënte diç të tilë."

49) Alvar, Ind. Lum, 14 (Migue, bl. CXXI, fq. 529).

50) Baudiosin, fq. 199.

51) Morgan, vol. II, fq. 297-298, 345.

52) Morgan, voll. II, fq. 310.

120

53) Lea, The Moriscos, fq. 259.

54) Morgan, vol. II, fq. 337.

55) Morgan, vol. III, fq. 289.

56) Stirling - Maxwell, vol. I, fq. 115.

KAPTINA VI

PËRHAPJA E ISLAMIT NË MASIN E TË KRISHTERËVE TË

TURQISË EVROPIANE

Raporti i Turqëve ndaj shtetasve të krishterë ka qenë në shenjë të tolerancës fetare

Per herë të parë emri i Turqëve osanlinj është dëgjuar në Evropën perëndimore kah fillimi i shekullit XIII. Ata - atëherë kanë qenë pesëdhjetë mijë - kanë ikur para Mongolëve. Më në fund i erdhën në ndihmë sulltanit të Konjës, dhe i kanë kryer shërbime në luftë kundër Mongolëve Bizantinas. Për këtë arsye iu janë dhënë disa vise në anën veriperëndimore të Azisë së Vogël. Ja këtu ka qenë boshti i shtetit i cili në ardhmëri ka marrë formën e Mbretërisë Osmane, e cila, duke i gëlltitur një nga një shtetet e vogla të Turqëve Selxhukë, është hedhur në anën evropiane dhe deri sa në vitin 1683/1090 H. para Vienës nuk i është vënë pengesa shtrirjes së saj të

mëtejme, ia ka bashkangjitur shtetit të vet mbretëri pas mbretërisë.1) Qysh nga koha e shtrirjes së osmanlinjve në Azinë e Vogël ata i kanë arritur shtetasit e krishterë dhe kanë sunduar me ta, por deri në vitin 1453, kur kryeqendra e lashtë e Imperatorisë Lindore ra në duart e tyre, nuk ka pasur ndërmjet shtetit të tyre dhe kishës së atjeshme marrëdhënie të qëndrueshme të zëna fill në marrëveshjet e caktuara. Japat e parë të sulltanit Mehmetit II pas pushtimit të Stambollit dhe pas vënies së rendit kanë qenë se është shpallur mbrojtës i kishës lindore dhe e përmbushi fjalën e dhënë të krishterëve. Shpesh është ndaluar prekja në të drejtat e të krishterëve. Fermani që është shpallur për patrikun e posazgjedhur, ka garantuar - si atij ashtu edhe trashëgimtarëve të tij me klerarkitë e tyre shpirtërore-privilegjet dhe të ardhurat e vjetra, madje edhe të gjitha ato privilegje të jashtëzakonshme që i kanë gëzuar gjatë kohës së shtetit të rënë. Pas pushtimit turk sulltan Mehmeti personalisht ia dorëzoi Genadosit spektrin (i cili është simbol i nderit patricit, si dhuratë qesën plotë dukatë, atin me përgatitjen e dekoruar, me të cilin patriku, kur mbreti shkonte me suitën e vet, ka pasur privilegj të kalërojë krahas tij.2) Ky kryepar kishtar, të cilit nderimi i rëndomtë i është bërë nga ana e imperatorëve të krishterë, këtë e ka pasur edhe më vonë. Përveç kësaj, atij i është dhënë njëfarë sundimi drejtues. Gjykata patrikane tubohej që t'i zgjedh të gjitha pyetjet kontestuese të cilat

121 kanë qenë çështje e pastër e brendshme e të krishterëve. Kjo gjykatë, përveç asaj që ka mundur ta caktojë gjobën, fajtorët ka mundur t'i mbyll në burg, të cilin e ka pasur në disponim; madje kur dikend e gjykonte me vdekje, nëpunësit kompetent shtetëror këtë e zbatonin. Mbikqyrjen mbi sundimin shpirtëror e kishtar - në të cilën turqit, përkundër metodës së shtetit bizantinas, nuk janë përzier - është lënë në duar të sinodit, i cili takohej me ftesë të patrikut. Kështu është konkluduar që shteti mos të përzihet në lëndët që kanë të bëjnë me fenë dhe besimin. Ka pasur dobi kur të shkelurit për t'i zbutur vuajtjet intervenonin te sulltani. Kështu e tërhiqnin vëmendjen në dhunën që do t'i bënin disa nëpunës shtetëror. Peshkopët grekë edhe në provincë kanë gëzuar autoritet të madh, dhe shumë pasuri të mëdha u janë lënë atyre. Këta deri në kohët më të reja mbi popullatën ortodokse, e cila ka qenë në viset e tyre shpirtërore, kanë kryer një lloj administrimi sikur mëkëmbësi, dhe kështu zunë vendin e aristokracisë, të cilën pushtuesi e shkatërroi. Priftërit në pozitat e larta të klerarkisë kishtarë përgjithësisht kanë qenë në aktivitetin e vet më shumë agjentë turqë se sa priftër grekë, dhe shihet se popullatës ortodokse i kanë sugjeruar se sulltani ka pranuar lejen e shenjtë të jetë mbrojtës i kishës. Më në fund, fermani që është shpallur që sërish t'u kthehen në disponim të lirë ortodoksëve ato kisha që kanë qenë të konfiskuara, që të kthehen në exhamia, i ka shkuar për shtati zbatimit të lirë të ritualeve sipas traditave nacionale.3)

Pasi Grekët në pjesën evropiane të Mbretërisë kanë qenë më të shumtë se Turqit, privilegjet e tyre fetare, dhe mbrojtja personale dhe pasurore kanë treguar (kurse shpesh iu ndërroheshin komandantit) se qeverisja e sulltanit

ka qenë më e mirë nga qeverisja e shteteve të krishtere. Duke njëmend, pasi Grekët i mundonin me veprime tiranike Frankët, të cilët, duke dëshiruar të sundojnë me viset që kanë qenë me Greqinë, u nisën kundër bizantit, kurse nga ana tjetër Mletasit, për këtë ato në shumë vende u kanë dalur në ndihmë pushtuesëve osmanlinj si mbrojtësve dhe shpëtuesëve të vet. Këto shtete të krishtero, pasi e përvetësuan sistemin e vjetër feudal të Evropës në Greqi, e shtynë popullatën në gjendje robërie, dhe pasi ata ishin të huaj duke e marrë parasysh edhe gjuhën, edhe gjakun, edhe fenë, fituan urrejtjen e tyre.4) Për ta fitimi i zotërinjve të ri është konsideruar jo vetëm mundësi që të bijnë në gjendje më të keqe por, natyrisht, rast që t'u përmirësohet gjendja. Shpëtuesit njëmend të pritur për ta ende kanë qenë të huaj, vetëm që ata Turqit, të cilët i përkitnin fesë krejtësisht tjetër, ua parashtronin katolikëve, të cilët ata i konsideronin për heretikë.5) Pikërisht për grekët, që kanë jetuar në drejtimin e pallatit bizantinas, nuk ka qenë e padëshirueshme ndërrimi i zotërinjve të vet. Tirania dhe mjerimi që e ka shkaktuar Paleologu, ka qenë aq tmerruese sa nuk mundemi as ta përfytyrojmë. "Aristokracia e shkatërruar moralisht, priftëria e shumënumërt dhe despotike, ligjet dhe dekretet, të cilët i qenë të ekspozuar interpretimit të tensionuar, shteti që vazhdimisht e rjepte 122

popullin dhe, që është më keq, ata grumbullues të të ardhurave shtetërore që ishin të shumtë si ushtri, te populli i mjerë nuk kanë lënë asnjë shenjë shprese në përmirësimin e gjendjes, në shpëtim."6) Pasi ka mundësi që kjo mënyrë e gjykimit të konsiderohet subjektiv, ta shikojmë edhe burimin tejtër të të dhënave që ka lindur në kohën e ndodhive të përmendura. Një kronist i vjetër rus, duke shkruar për rënien e Stambollit, në mënyrën e njëjtë e gjykon pushtetin e rënë dhe thotë: "Mbretëria në të cilën nuk ka frikë nga ligji është e ngjashme me vagabondin e shfrenuar. Konstantini dhe pararendësit e tij të ndershëm mua kanë lënë sunduesëve krahinor duart e lira që ta shkelin popullin. Qysh në gjykata ka munguar drejtësia, kurse në zemra guximi. Gjyqtarët i kanë mbushur arkat në llogari të lotëve dhe gjakut të të pafajshmëve. Ushtarët bizantinas kanë mundur të krenohen vetëm me shkëlqimin e uniformave të veta. Tashmë qytetarët nuk turpëroheshin të jenë tradhtarë të atdheut, kurse ushtarët të ikin nga beteja. Më në fund jehoi bumbullima e mllefë të Gjithëllartësuarit bi këtë shtet jo të denjë. Krijuesi i vasionës e qiti në fushëbetejë sulltan Mehmedin II, ushtria e të cilit është entuziazmuar me luftën gjyqtarët e të cilës nuk kanë qenë të pabesueshëm ndaj drejtësisë së besuar."7) Pa dyshim çuditshëm jehon mirënjohja8) në këtë pasusin e fundit në veshët e pjesëtarëve të një gjenerate politike e cila ia ka përvetësuar vetes të drejtën e protestimit të amshueshëm kundër tiranive të turqëve, por megjithatë është dëshmuar me argumenttë e shumënumërta e shprehimor të historianëve të asaj kohe. Sipas asaj çka kemi mësuar prej historianëve që na flasin për rënien e Stambollit, madje edhe sulltan Bajazidi, i cili është i njohur me rigorozitetin e vet, është dëftuar zemërgjërë dhe tolerant ndaj shtetasve të krishterë, dhe, duke i pranuar në audiencë, i ka fituar simpatitë e tyre.9) Murati II shquhej me përpjekjet në aspekt të

drejtësisë dhe çrrënjësjes së keqpërdorimeve që ishin rrënjësuar nën sundimin bizantinas dhe në zbatimin e reformës, dhe se pamëshirshëm i ka ndëshkuar nëpunësit e vet të cilët do të bënin padrejtësi ndaj shtetasve.10) Pasi është vënë administrata e sigurt dhe e rregullt, e cila pas pushtimit të Stambollit ka zgjatur së paku 100 vjet, dhe janë vënë një varg nëpunësish të aftë, në shtet ka mbretëruar në të gjitha anët rendi e paqja dhe është konstituuar administrata shtetërore dhe juridike e denjë për lavdatë. Ndonëse këta nuk kanë siguruar edhe për muslimanët edhe për të krishterët sistem juridik krejtësisht jjoanues, megjithatë kanë vënë rregullim i cili as për së afërmi nuk mund të krahasohet me ish-rregullimin e Bizandinasëve. Në aspekt të kryerjes së punëve të rënda, Bizantinasit ka herë pakë e kanë ndier presionin. Tatimet e jashtëzakonshme, në krahasim me të parët shumë rrallë janë tubuar, kurse tatimet e rëndomta në krahasim me të dhënat e pafund të feudalëve frankovitë dhe në marrjen e detyrueshme të të hollave në mënyrë të pakufizuar nga ana e komanduesëve bizantinas kanë qenë mjaft të lehta. Atëherë në turqi është qeverisur sado kudo më mirë se në shumë shtete të

123
krishtera të Evropës, dhe se ka mbretëruar mirëqenie dhe lumturie e vërtetë. Sa u përket të të krishterëve, të cilët më së shumti janë marrë me bujqësi, nën udhëheqjen e padishahut (sulltanit) në krahasim me shtetasit e sunduesëve të atëhershëm të krishterë, kanë pasur më shumë liri personale dhe kanë mundur më shumë të disponojnë me frytet e angazhimit të vet.11) Në shtet është zhvilluar edhe veprimtaria tregtare. Sulltanët e vjetër gjithnjë kanë qenë të gatshëm t'i marrin në mbrojtje angazhimet tregtare dhe ndërmarrjet tjera ekonomike të shtetasëve të vet. Shumë vende të mëdha, të çliruara për shkak të pushtimit turk, nga sistemi financiar tiranik i Bizantit, kanë hyrë në erën e bollëkut dhe aktivitetit produktiv. Turqit osmanlij sikur Romakët e vjetër kanë treguar shkathtësi të madhe në ndërtimin e rrugëve dhe urave, që e ka lehtësuar tregtinë në Mbretëri. Tregtarët grekë gjatë kohës së Imperatorisë Bizantine kanë qenë të ndjekur nga portet e huaja, e pasi u bënë shtetas të Osmanlinjve, është bërë presion në ato shtete të huaja të cilave u kanë takuar ato porte që ata të munden sërish nën flamurin turk në të tregtojnë. Kurse këta kanë pranuar rrobat dhe traditat e Turqëve, dhe kur dilnin me atë flamur në udhëtimet detare, në këtë mënyrë katolikët, të cilët dikur ua kanë penguar qëndrimin ithtarëve të kishës lindore, kanë mund t'i konsiderojnë popull perëndimor.12)

Haraçi për kokë - përjashtim i jotolerancës

Përjashtim nga kjo sjellje e mirë me të krishterët bënë marrja e fëmijëve të krishterë nga familjet e tyre. Këta fëmijë si mjaft të vegjël me forcë janë marrë nga prindërit dhe janë edukuar të bëhen të kategorizuar në radhët e famshme të ushtrisë mbretërore. Ushtrinë jeniçere më së pari e organizoi në vitin 1330/731 H. sulltan Orhani, dhe më vonë ka ekzistuar gjatë disa shekujve si mbështetje despotizmit të mbretërve turqë. Oxhaku jeniçerë ka mundur të ekzistojë në bazë të haraçit për kokë (tatimit fëminor) i cili me forcë dhe rregullisht çdo të katërtin vit është tubuar.13) Në kohën e caktuar

një oficer turk delte në terren, i cili nënshtrohej këtij haraçi, dhe i zgjidhte fëmijët nga shtatë vjet dhe i ndante ata na prindërit e tyre. Disa juristë islamë këtë taim johuman e kanë shpjeguar shtrirë se ky është ajo e pesta të cilën Kur'ani a.sh.14) ua caktoi sunduesëve. Edhe pse këta kanë konstatuar se rregullat e shenjta mbi ndalesën e konvertimit të dhunshëm¹⁵⁾ kuqin edhe fëmijët e këtillë, megjithatë, duke ua lënë fëmijët, në moshën më të ndijshme, edukimit të mësuesëve muslimanë, kanë lënë zbatimin e urdhërave të përmendur sikur ato edhe nuk ekzistojnë.¹⁶⁾ Sëkëndejmë janë shfaqur ndjenjat e neverisë ndaj kësaj marrjes barbare të tatimit, dhe se udhëtarët e krishterë në mënyrë sentimentale i kanë treguar prindërit, si lëshojnë lotët për shkak të marrjes së fëmijëve nga çerdhet e tyre të rrënuara. Mirëpo, në fillim të themelimit të oxhakut jeniçer, ai është rritur në atë mënyrë që

124

prindërit me vetëdashje i kanë dhënë fëmijët e tyre.¹⁷⁾ Ky tatim në fillim të themelimit të tij shpjegohet me indeferentitetin që kanë treguar në këtë pikëpamje Grekët. Njëmend, popullata e këtyre viseve që kanë qenë të shkretuar me ushtarët paraprakë ka qenë e ekspozuar vdekjes nga uria. Ndër këta kandidatë për jeniçerë ka pasur shumë bonjakë të cilët, mund të jetë, do të vdisnin sikur mos të merreshin për jeniçerë. Pasi ka pasur mundësi që sikur dikur në kohët e vjetra të kapen të krishterët dhe t'i shesin si robër, kjo metodë e grumbullimit ka qenë nga dy të këqia më pak. Njëherit, nuk duhet harruar se ky sistem i grumbullimit është vazhdim i të ngjashmit me këtë që ka ekzistuar në kohën e sundimit bizantinas.¹⁸⁾ Oficerëve që u është besuar grumbullimi i fëmijëve rrallë herë ka ndodhur se është dashur ta përdorin forcën, në të shumtën prindërit vullnetarisht kanë dhënë fëmijët në këtë shërbi mdhe në shumë raste, duke u mbështetur në karrierat e tyre të shkëlqyeshme, kanë jetuar në shpresë. Gjithësesi është marrë parasysh se me fëmijët, që janë konsideruar si bir adoptiv, thjeshtërit e sulltanit me kujdes do të veprojnë dhe se bukur do të edukohen.¹⁹⁾

Nëse është i vërtetë versioni se fëmijët kanë munduar me një sasi të hollash të nxirren nga oxhaku jeniçerë, institucionin e përmendur duhet paraqitur më pak barbar se që është supozuar.²⁰⁾ Në një vepër që e ka shkruar në vitin 1625 Mitrofnis Kirijakopulos (Metrophanes Kyriakopoulos), i cili qe patrik së pari në Stamboll, e pastaj në Aleksandri, ceken dallavere të ndryshme që janë shërbyer të krishterët që të shpëtojnë nga ky sistem i grumbullimit. Për shembull, e blenin në skllëv musliman dhe si të vetin ua dorëzonin nëpunësve që i grumbullonin fëmijët. Këtyre nëpunësve, të cilët ishin të korruptuar, i jepnin mito, dhe kështu i shpëtonin fëmijët.²¹⁾ Thomas Smith, një nga autorët e vjetër, në librin që e botoi në vitin 1680, duke shkruar për fëmijët që janë shpëtuar me mito, thotë: "Disa fetare që fëmijët mos t'u merren dhe kështu të privohen nga feja e krishterë, kanë shfrytëzuar pangopësinë e Turqëve dhe u jepnin prej 50 deri 100 dollarë."²²⁾ Të krishterët nga disa vende dhe nga ujdhesa siç është Stambolli me rastin e dorëzimit të tyre Turqëve kanë detajzuar që të përjashtohen nga dhëmia e këtij, siç konsiderohet, tatimi drastik për kokë. Ky ka qenë si koncesion i

blerë.23)

Tatimi personal / Xhizja

Shtetasit e krishterë të Imperatorisë Turke kanë paguar tatimet personale si obligime os esi kompenzim (bedel) për obligimin ushtarak ose si shpërblim për mbrojtjen e ofruar. Sasia e këtyre tatimeve, që e kanë caktuar ligjet osmane, ka qenë sipas fitimit të individëve dy e gjysmë, pesë dhe dhjetë groshë, kurse edhe kjo është marrë vetëm nga madhorët,24) deri sa gratë dhe klerikët kanë qenë të kursyer.25) Kjo në shekullin e XIX doli në 125

15,30 dhe 60 groshë.26) Autorët e krishterë nga shekulli XVI dhe XVII, siç janë Martin, Crusiusi, Sansovino, Gjorgjeviqi, Schaeferi e të tjrët, cekin se ky tatim (haraç) ka qenë nga një dukat për krye27) Që të mundet saktë të vlerësohet barra e këtyre tatimeve për të tatimuarit, duhet themelësisht të hulumtohet fuqia blrëse parasë së atëhershme. Por në asnjë rast vlëra e parasë nuk mund të konsiderohet arsyetim miratues në aspekt të konvertimit. Thornforth, duke folur për konversionin e Kandianëve (Kandiotëve) në veprën që e ka shkruar në vitin 1700, thotë: "Duhet pranuar se këta të mjerë e kanë shitur ndërgjegjen e vet për pesë, dhjetë para. Kundërvlerën për ndërrimin e fesë e kanë marrë në atë që janë përjashtuar nga dhënia e tatimit personal, që përpiquej ta dëftonte se më të zezë gjendjen e të krishterëve në sundimin turk, megjithatëpranon se një dukat për krye sigurisht është sasi e vogël. Për këtë shkak, ai tatimin e jashtëzakonshëm, që e kanë dhënë të krishterët, e konsideron obligim ushtarak.20) Tatimi për tundshmëritë ka qenë i barabartë edhe për muslimanët edhe për të krishterët.30) Dallimin e vjetër ndërmjet të dhjetës (ushrit) që e kanë dhënë pronarët e tokës muslimanë dhe haraxhit, që e kanë dhënë jomuslimanët, Osmanlinjt nuk e kanë marrë parasysh.31) Nëse të krishterët edhe kanë pësuar, kanë pësuar për arsye se disa nëpunësia, që të grabisin para, e kanë shfrytëzuar pozitën e tyre zyrtare dhe kanë bërë tirani. Përndryshe veprat e këtilla tiranike rrallë janë vërejtur, pasi janë në kundërshtim me sheri'atin islam, derisa sa administrata qendrore u dobësua dhe ka lejuar që nëpunësia e saj të mbetet e pandëshkuar për deliktet dhe shpërdorimet.32) Vërehet dallimi që meriton vëmendjen në pikëpamje të pozitës së krishterëve gjatë kohës së dy shekujve të parë të sundimit turk dhe pozitës së të krishterëve kur Mbretëria Turke ka mësyre rrugës së shkatërrimit, me fjalë tjera, në ato kohë kur gjendja e tyre ka qenë më e keqe, atëherë më së paku ka patur raste të konvertimit në islam. Në shekullin e XVII, kur gjendja e të krishterëve ka qenë më e rëndë, nuk ka asnjë shënim për konvertim; përkundrazi, Turqit e atëhershëm janë treguar si indiferentë ndaj përparimit të fesë së vet, të preokupuar me skepticizëm e shfrenim.33) Vuajtjet që i kanë bartur të krishterët më tepër kanë qenë për shkak të administratës së keqe se për shkak të persekutimeve fetare. Për këtë do të cekim si shembull edhe atë që ato tirani i kanë përjetuar muslimanët sikur edhe të krishterët,34) vetëm se të krishterët kanë qenë më tepër të ekspozuar grabitjes, dhunës dhe abuzimeve, sepse në kërkim të drejtësisë kanë pasur para vetes më shumë vështirësi. Për këtë arsye është e bazuar të konsiderohet

se disa të krishterë mjaft të varfër kanë gjetur shpëtim në ndërrimin e fesë. Kur të përjashtohet çështja e dhënies së fëmijëve, të cilën Grekët pas pak kundërshtimi e kanë pranuar, kurse e cila është anuluar jo me trazira e revolucione, por në bazë të rritjes numerike të Turqëve dhe konvertitëve që kanë hyrë në ushtrinë mbretërore,³⁵ veprimi i mbretërve osmanë me shtetasit e krishterë - gjithësesi pas pushtimit të Greqisë nja dyqintë vjet - është aq i 126

favorshëm që në këtë nuk ka shembull në Evropën e krishterë. Kaherë ithtarët e sektit të Kalvinit (Calvin) në Hungari dhe ithtarët e monoteizmit në Transilvani (Erdelj) kanë dëshiruar të bëhen shtetas turk se sa të bien në kthetrrat e dinastisë Habsburgiane.³⁶ Gjithashtu protestantët nga Shlezia kaherë i kanë drejtuar shikimet në turqi, dhe kanë dëshiruar lirinë e besimit, e qoftë edhe me çmimin e sundimit islam.³⁷ Hebraikët spanjoll që në fund të shekullit XV kanë qenë të ekspozuar dhunës, janë strehuar në grumbuj vetëm në Turqi.³⁸ Kozakët të cilët u ishin shtruar persekutimeve të kishës zyrtare ruse, e të cilët i kanë takuar sektit të quajur "ortodoks" (starovjerci, N.I.), kanë gjetur në shtetin e padishahut lirinë e besimit të cilën bashkëfisisësit e të njëjtës fe na kishin penguar.³⁹ Ka pasur të drejtë patriku antiohias në shekullin XI Makariosi kur i ka shqiptuar këto fjalë me rastin e dhunës së tmershme që e kanë kryer Polakët ndaj Rusëve ortodoksë: "Kemi qajtur për humbjen e mijëra martirëve që i kanë mbytur ata të mjerë të pafe. Numri i të mbyturve ku dalur në shtatëdhjetë, e ka mundësi edhe në tetëdhjetë mijë. Ah, të pafetë, ah, paganët! Ah njerëzit mme zemër guri! Ç'fjai kanë kallugjerët dhe gratë?! Ç'të keqe u kanë shkaktuar djelmoshët dhe vashat? Përse unë këta i quaj të mallkuar? Sepse ata me dhunën që ua kanë bërë të krishterëve me qëllim që ta fshijnë emrin ortodoks nga toka, kanë rënë shumë më poshtë se idhujtarët. Zoti e ruajt me shekuj e shekuj Imperatorinë Turke! Sepse Turqit, pasi e marrin tatimin, askuht në emër të fesë nuk do t'i shkaktojnë të keqe qoft ai musliman, qoft i krishterë, qoftë Hebraik. E këta të mallkuar nuk u kënaqën me marrjen e tatimit dhe të dhjetës nga vëllezërit e vet të krishterë, por i nënshtruan sundimit të Hebraikëve despotë, armiqëve të Jezusit. Hebraikët nuk u lejonin të ndërtojnë kisha, as u lejonin t'i gjejnë vetes klerikë, të udhëzuar në fshehtësitë e urtësisë."⁴⁰ Këta të krishterë, duke e humbur shpresën se do ta gjejnë tolerancën fetare nën sundimin e shtetit të krishterë, i kanë drejtuar shikimet e veta mallëngjuese në Turqi me dëshirë që ta pranojnë shtetësinë e tyre.⁴¹ Njëmend, nëse edhe ka ndonjë nëpunës i vrazhdë dhe i padrejtë në erën e dekadencës së Imperatorisë Osmane, i cili ka mund të jetë shkak që disa të krishterë, për shkak të përmirësimit të gjendjes së vet, kanë ndërruar fenë, megjithatë është e qartë se islami nuk është përhapur me shpatë në shtetin e mbretërve turqë. Shumica e rasteve të konvertimeve kanë ndodhur në dy shekujt e parë të sundimit turk. Është e denjë për admiri mqë zelltaria në përhapjen e fesë, që atëherë është vërejtur tek Osmanlinjt, nuk i ka shtyrë aspak ta kalojnë kufirin e tolerancës fetare, të cilën ua kanë caktuar ligjet e tyre. Një person që ka qenë 22 vjet në robërinë turke dëshmon që Turqit nuk

e kanë detyruar askend ta lëshojë fenë e vet.42) Në këtë pikëpamje ka ende shumë edhe prova të tejtra. Për shembull, një Anglez që në shekullin e XVII e vizitoi Turqinë ka thënë: "Diç më e rrallë që këtu mund të vërehet, kjo është se çfarë presioni është bërë në ndërgjegje."43) Rreth tridhjetë vjet pas kësaj

127
date, d.m.th. në vitin 1663, edhe autori gjerman Schaefer44) në veprën e vet "Tureken-Schrift" cek këto fjalë: "Ata fitojnë konvertitë me tepër me shkathtë se sa me forcë; prandaj, ata e nxjerrin nga zemrat e njerëzve Jezusin me shkathtësi (prestidigitation). Dhe njëmend, ata tash ansjë krahinë nuk e detyrojnë me forcë në konvertizëm, por i përdorin mjetet tjera, ashtu që krishterizmin nga rrënja pahetueshëm do ta shkulë dhe hedhë jashtë.

Ç'ndodhi me të krishterët nga këto krahina? Ata nuk janë persekutuar nga krahinat e veta, as nuk janë detyruar ta përqafojnë fenë turke. Në pajtim me këtë, duket se këta të krishterë vetëvetiu janë transferomuar në Turqë".

Angazhimin që Turqit e kanë dhënë në përhapjen e islamit

Sipas mendimit të turqëve, mëshira më e madhe që mund t'i bëhet një njeriu është që të inkuadrohet në rrethin e islamit.45) Për këtë qëllim nuk e lëshojnë asnjë mënyrë të provuar të bindjes. Një prej udhëtarëve holandez nga shekulli XVI rrëfen se, derisa me admirim e ka soditur Aja Sofinë, iu ka afruar një Turk që dëshiroi të ndikojë në te, natyrisht i cili ka dashur ta prekë në afinitetin e tij estetik ndaj arteve të bukura, dhe i ka thënë: "Nëse e përqafon islamin, mundesh gjatë gjithë jetës këtu çdo ditë të vjen". Nja njëqind vjet më vonë ngjashëm i ka ndodhur edhe një udhëtar anglez.46) Ky udhëtar, me emrin Thomas Smith, në udhëpërshkrimin e vet thotë:

"Ngonjëherë turqit nga prozelitizmi i vet butësisht kështu i pyesin të krishterët: "Duke e përqaftuar islamin, përse nuk do të ishe një nga ne?" Një pyetje e këtillë edhe mua më është shtruar para dyerve të Aja Sofisë. Sipas haresë që e tregojnë Turqit kur ia urojnë dikujt kalimin në fenë e tyre, mund të konkludohet se entuziazmi i tyre i zjarrtë në përvetësimin e shpirtërave i kategorizon ndër misionarët e zellshëm. Muslimanin e ri e hipin në kal dhe e shetisin triumfalisht rrugëve. Nëse ato binden se muslimani i ri vullnetarisht dhe sinqerisht është kthyer në islam, ata kthimin e tij e përjetojnë me respekt të madh. Nëse konvertiti i ri është i mjerë, ata e sigurojnë."47) Autori anglez në shekullin XVIII Aleksander Rosi kështu e shkoqitë: "Turqit janë mjaft të zellshëm mnë aspekt të fitimit të konvertitëve, më saktë t'i kthejnë nga feja e vërtetë në fenë e vet. E lusin Zotin në tempujt e vet që të krishterët ta pranojnë Kur'anin, dhe që këtë qëllim ta realizojnë, shërbehen me të gjitha mjetet e provuara si me kërcënimin dhe ofrimin e shpërblimit."48)

Faktorët që ndihmojnë në përhapjen e islamit

Aktiviteti i zellshëm në arritjen e konvertitëve ka marrë, për shkak të rrethanave që janë karakteristike për rendin social të krishterëve, formë më influencuese. Një nga rrethanat kryesore është ajo që kisha lindore ka rënë në autoritet. Krahas despotizmit administrativ të Bizantit është zhvilluar

128
njëkohësisht despotizmi kishtar, i cili i ka ndaluar të gjitha diskutimet për

çështjen e moralit dhe fesë, dhe me barrën e dogmatizmit të vet i ka ndrydhur të gjitha synimet shkencore. Në këtë pikëpamje, nëse diçka e ka vënë në lëvizje nga lodhje e tij, kjo është jotoleranca nacionale dhe fushata oratorike që është zhvilluar rreth diskutimeve teologjike kundër kishës latine. Ndjenja fetare e popullit përbëhej në përkrahjen e vazhdueshme të formaliteteve dhe në adhurimin e paqëndrueshëm të Maries, të shenjtëve dhe ikonave. Ka pasur shumë persona që kanë dashur ta kthejnë kryet nga kisha, jeta shpirtërore e të cilëve ka rënë në këtë ammbis të nënçmimit. Pasi që personat e tillë qenë bezdisur me stërhollimet e imta, siç janë diskutimet e pafund mbi pikat deliakte të kalimit të Shpirtit të Shenjtë nga ati në të Birin, pastaj a është buka, që përdurohet gjatë shërbimit fetar, me kare apo patë, kanë pranuar me kënaqësi shpalljen e qartë dhe të përshtatshme të monoteizmit. Një autor për këtë thotë: "Është vërejtur se në isla mjanë kthyer jo vetëm ata nga shtresat e ulta, por edhe shumë intelektualë nga të gjitha shtresat, dhe se Turqit ua siguronin mjetet jetësore klerikëve dhe monohëve që do ta përqafonin islamin, dhe në pajtim me këtë, këtë edhe të tjerët i trimëronin që të shkojnë pas gjurmave të tyre."49)

Deri sa ende Edirna (Adrianopoja) ka qenë kryeqendër e Turqisë, me fjalë tjera para vitit 1453, datës së pushtimit të Stambollit, pallati mbretëror i atëhershëm ka qenë plotë konvertitë madje flitet se këta konvertitë kanë paraqitur shumicën e fisnikërisë dhe dinjitarëve.50)

Disa princa bizantinas dhe krerë të tjerë kanë kaluar në anën e muslimanëve, dhe në mesin e muslimanëve kanë gjetur pritje madhështore. Një nga shembujt më të vjetër është ai nga viti 1140/533 H., kur u kthye në islam nipi i imperatorit Ivan Komnenit dhe kur është kurorëzuar me vajzën e sulltan Mes'udit, sunduesit të Konjes.51)

Pas pushtimit të Stambollit njerëzit nga shtresat e larta shoqërore të krishtero kanë qenë më afër islamit se sa pronarët e rëndomtë. Në mesin e konvertitëve shumica kanë bartur emrin e dinastisë së imperatorit të rën ëPaleologut. Dijetari nga Trapezunti Jorgi (Georgios) Amirotzes kah fundi i jetës së tij e lëshoi krishterizmin dhe e përqafoi islamin. Edhe shumë personalitete të ngjashëm me këta janë evidentuar në regjistrin e konvertimeve.52)

Feja e re, që u është propozuar, u ka konvnuar me fjalët e saj të thjeshta. Këto fjalë: "Nuk ka zot tjetër pos All-llahut; Muhammedi është i Dërguari i Tij" i ka kritikuar me këtë rast një autor i vjetër i krishterë,53) emrin e të cilit e përmendëm lartë: "Të gjitha vështirësitë përbëhen në këtë deklaram fetar. Prandaj, kur dikush të bindet se e adhuron të vetmin All-llah, atëherë helmi i herezës i cili fshehet në formën e besimit fillon të depërtojë në shpirtin e tij. Ja në këtë grykë mali të harresës shumë nejrëz kanë dështuar dhe me humbjen e shpirtit kanë rënë në kurtha. Ja ky është guri i mullirit i cili

129
shumciës i është vënë në qafë, dhe i ka tërheq në greminë të dëshprimit. Kur këta të çmendur të dëgjojnë se Turqit i mallkojnë idhujt dhe shprehin tmerrim në çdo fotografi dhe statujë sikur është zjarri përveëlues kur

dëgjojnë se besojnë në ekzistimin e të vetmit All-Ilah dhe kur dëgjojnë predikimet e tyre, atëherë në kokat e tyre nuk mbetet vend për dyshim.”

Kisha greke

Më në fund islami është bërë strehim për ata, të cilët kanë dëshiruar ta përtërijnë para kësaj disa shekuj të shtypur me masa drakonike sektin heretik të paulicianëve (bogumilëve), i cili është quajtur sipas apostullit Palit, kurse e cila, pasi i është bashkangjitur kishës lindore, është persekutuar për shkak të përpjekjeve të veta që të kyqë dogma më të thjeshta. Në esencë, kjo lëvizje ka qenë protest kundër doktrinės së kishës ortodokse dhe adhurimit të figurave dhe objekteve, dhe ndërmarrje me qëllim të futjes së jetës religjioze nëpërmjet fesë së thjeshtë. Pushtuesit muslimanë në shekullin e XVII kanë hasur në bullgari shumë ithtarë të kësajhereze,⁵⁴) që nuk janë pajtuar në veprat dhe dogmën e kishës lindore. Pasi këtu nuk ishin pjekur rrethanat që kanë qenë në favor të formimit të kishës protestante në vendet perëndimore, prandaj ithtarët e ideve opozicionare kanë ndier në territorin e islamit atmosferë më të përshtatshme. Për mosesin e ndërmarrjes për reformimin e kishës lindore, që kanë ndodhur në shekullin XVII, ka mjaft arsye të mendohet se kjo ka ndodhur për shkak të përparimit të islamit. Udhëheqësi shpirtëror i kësaj lëvizjeje ka qenë Ciril (Kyirillos) Lokarisi, që ndërmjet vitit 1621 dhe 1638 pesë herë ka qenë i zgjedhur për patrik të Stambollit. Në rini ka qenë në universitetet në Wittenberg dhe Gjenevë, Holandë dhe Angli, por as dispozitat e kishës protestante as anglikane nuk kanë marrë aq dashurinë e tij siç është mësimi i Kalvinit.⁵⁵) Për këtë arsye ka bërë përpjekje ta fusë mësimin e Kabrinit në kishën lindore. Këto përpjekje me entuziazëm i kanë përmbajtur ithtarët e Kalvinit në Gjenevë. Për më tepër, e kanë dërguar në Stamboll një profesor të ri të teologjisë me emrin Legea (Lezhe), që t'i ndihmojë gjatë përkthimit të veprave të teologëve të Kalvinit në gjuhë greke.⁵⁶) Krijakosi ose Ciril Lokarisi ka gjetur për vete miqë në delegacionet e vendeve protestante në Stamboll, e sidomos e kanë ndihmuar të deleguarit anglezë dhe holandezë. Nga ana tjetër jezuitët e atjeshëm, me rekomandim të të deleguarëve të shteteve katolike, i kanë përdorur të gjitha mjetet e mundshme që ta pengojnë inkuadrimit të kalvinizmit në kishën lindore, dhe madje njëmend i kanë përkratur intrigat e rruymës opozitare në kishën lindore kundër Lokarisit. Më në fund këta kundërshtarë kanë shkuar aq larg sa kanë dëshiruar të kryejnë atentat në patrikun. Lokarisi në vitin 1629 ka publikuar një deklaratë dogmatike caku kryesor i së cilës ka qenë ta tregojë kontradiktoritetin e dispozitave të kishës lindore dhe katolike, dhe në pajtim

130

me këtë të tregojë harmoninë e domosdoshme të mësimin protestant.⁵⁷)

Patriku Lokarisi ka huazuar nga kalvinizmi pyetjen e fatit dhe dispozitën që falja e denimit mund të arrihet vetëm me anë të fesë, kurse ka mohuar pacenueshmërinë (pagabueshmërinë) e kishës dhe të drejtën në komentimin e Shkrimit të Shenjtë kishtarit dhe njëkohësisht ka gjykuar adhurimin e figurave. Në komentimin e vullnetit të lirë dhe pyetjeve tjera më shumë ka anuar kah sektin e Kalvinit se sa shkencës së kishës lindore.⁵⁸) Deklarata e

përmendur fetare, që është publikuar si urdheresë e kishës, udhëheqës shpirtëror i të cilës ka qenë ai, e ka catur klerarkinë e klerikëve grekë në opozitë të rreptë, dhe, në sinodin që është thirrë disa janë pas vdekjes së tij, janë gjykuar idetë e cekura, kurse ai është shpallur renegat. Sërish në vitin 1642 me të njëjtin qëllim është thirrë sinodi, në të cilin çdo pikë e deklarimit fetar të Kirijakos Lokarisit hollësisht është refuzuar, kurse mbi është në këtë mënyrë është hedhur mallkim i zjarrtë.

“Me dëshirë pajtuese dhe rreptësi të pashprehur, me fjalë e gjykojmë dhe i qartojmë të gjitha “deklaratën fetare për shkak se është përmbushur me herezë dhe që është kundërthënëse ortodoksizmit tonë. Njëherit shpallim që personi që i ka tubuar rregullat e deklarimit nuk ka asgjë të përbashkët me fenë tonë, por vetëm ka dëshiruar në mënyrë shtrembëruese të mos imponojë kolvinizmin. Të gjithë ata që trillimet e tij do t’i lexojnë ose ruajnë, duke i konsideruar vepra të pastra e të mirëfillta, ose ata që do t’i mbrojnë gojarisht ose me shkrim, do të ekskomunikohen nga bashkësia fetare si pjesëmarrës të tij, si ithtarë të skizmës dhe si mashtrues të kishës së krishterë. Sado e lartë të jetë pozita e tyre, me do t’i konsiderojmë idhujtarë. Të ngjashmit kanë qenë renegatë gjatë shekujve! Është ndërprerë çdo lidhje ndërmjet tyre dhe Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë qoftë në këtë, qoftë në atë botën amshuese! Qofshin të numruar ndër të lëshuarit dhe të mallkuarit! Të dëshpruarit dhe privuar qofshin në Ringjallje dhe mos shpëtofishin nga denimi i anshueshëm!”59)

Në vitin 1672 është mbajtur edhe sinodi i tretë në Jerusalem që ta përgënjeshtrojë përmbajtjen përçarëse të kësaj deklarate fetare dhe ta konfirmojë ortodoksinë e kishës greke, e cila sipas mendimit të disave, është njollosur me mësimin kalvinist. Duket se në këtë mënyrë edhe janë pamundësuar të gjitha punët për riafirmimin e kishës lindore. Dhe njëmend, shkenca e Kalvinit është krejtësisht kundërthënëse shkencës së kësaj kishe. Mësimi i tij, duket se, ka qenë më afër dispozitave të islamit, ashtu që teologët e kishës së përmendur, duke hyrë me muslimanët në diskutime, kanë hasur në rregulla të ngjashme. Për shkak të kësaj ngjashmërie me mësimin e islamit kjo lëvizje, që ka dëftuar afinitet drejt kalvinizmit, gjënë në historinë e përhapjes së islamit vend të favorshëm. Me siguri, një njeri që e gjykon adhurimin e figurave, i cili e mohon lirinë e pakufizuar të vullnetit njerëzor, i cili është ithtar i frymës kalviniste, në harmoni me Besëlidhjen e 131

Vjetër e të Re, në parë do të mund të gjejë në fushën e islamit atmosferë të përshtatshme se sa në kishën lindore të shekullit XVII.

Duket se nuk ka dyshi më atë se shumica ndër konvertitët e shekullit XVII janë ata që, për shkak të afinitetit ndaj kalvinizmit, janë ftohur ndaj fesë së të parëve të vet.60) Nuk ka të dhëna të pakontestueshme për numrin e ithtarëve të Kirjakos Lokarisit as për gjërësinë e ndikimit që e ka bërë kalvinizmi në kishën lindore. Kisha, që me mburrje mbronë ortodoksinë e vet dhe pastërtinë nga hereza, dhe e cila me xhelozë e ruan autoritetin e vet, prandaj edhe klerikët pastër nga dyshimi i kalvinizmit, e hedhë në tërësi

vetëm në kohën e patrikut përçarës,61) por Lokarisi duhet të ketë pasur edhe ithtarë të tij. Madje një antisinod, që është përbërë nga persoant të ekskomunikuar për shkak të çarjes nëpër sinodet të mbajtura në Stamboll dhe Jerusalem, publikisht e ka lejuar “deklaratën fetarë të Lokarisit.62) Është absurde të pohohet, pasi është deklaruar ekskomunikimi i ithtarëve të Lokarisit, se ai fare as nuk i ka pasur. Nga historia pararendësve tonë u qenë të njohura emrat e disave nga ithtarët e tij.63) Ndër këta është mitropolitin athinas Sofronosi, i cili si monak ka sjellur nga Londra në Stamboll aparaturën për shtypshkronjë dhe i cili i ka publikuar broshurat skizmatike,64) dhe më në fund Nikodemos Metarasi, i cili pë rshërbimet e bëra e ka emëruar Lokarisin mitropolit,65) filozofi Koridaleosi i cili në Stamboll ka hapur fakultetin teologjik, Gerganosi, i cili ka hartuar katekizmin e veçantë, me qëllim që ta kyqë ndër bashkëqytetarët e vet kalvinizmin,66) Teofitasi II, i cili ka kryer detyrën e patrikut, deri sa Lokarisi ka qenë në internim në ujdhesën Rodos dhe në dobi të të cilit me kthimin e tij ka dhënë dorëheqje, dhe shumë të tjerë.67)

Lokarisi në letrën që në vitin 1636 ia dërgoi Universitetit në Gjenevë njofton se shumë të konvertuar në kalvinizëm të Legerit,68) të cilin universiteti i përmendur e ka dërguar në Stamboll në cilësi të përfaqësuesit dhe komentuesit Patriku, trashëgimtari69) i Lokarisit, është internuar në Tunis dhe ithtarët e atjeshëm të Lokarit e kanë mbytur (në ujë). Kalvinistëve, të cilët shumë shërbime i kanë pritur nga zëvendësi i Lokarisit, patrikut të njohur Parteniosit I, u dështoi shpresa kur ky ose u helmua ose, në lajmin e pashpresuar për internimin, vdiq.70) Parteniosi II, i cili qe patrik në Stamboll prej vitit 1644 deri 1646, ndonëse në shpirt ishte ithtarë i kalvinizmit, nuk ka guxuar haptas t'i rrëfejë parimet e tij. Megjithatë ky ka qenë shkaku i shkarkimit të tij, e pastaj edhe i internimit dhe përmbytjes së tij.71) Ja kështu është zgjeruar ndikimi i kalvinizmit më shumë se që këtë e pranojnë kundërshtarët e Lokarisit. Ithtarët e Lokarisit, të cilët nuk dëshiruan ta ulin kokën para ekskomunikimit të atyre sinodeve që e kanë gjykuar udhëheqësin e tyre, qartë kanë pasur më tepër bashkëdhembje me fqinjët e vet muslimanë se sa me klerikët ortodoksë, të cilët shtireshin sikur nuk i njohin ata. Njëmend, nuk ka provë të pakontestueshme se kalvinizmi 132

ka ndikuar në përhapjen më të lehtë të islamit,72) vetëm se, për shkak të mungesës së shkaqeve shprehimisht të cekura, mund të parashtrohet me siguri, se edhe ai është një nga faktorët e konvertimeve të shumta që janë bërë në shekullin e XVII nga marrëdhëniet e përzemërta ndërmjet muslimanëve dhe Grekëve. Nuk ka dyshim se konvertimet, që atëherë janë vërejtur në shtresën e mesme dhe në masën e rëndomtë, janë më të shpeshta nga konvertimet në kohët tjera.73) Flitet për “renegatjen”, që gjithnjë ka ndodhur ndër klerikët grekë, natyrisht edhe në mesin e atyre që kanë qenë në pozita të larta, siç është rasti i mitropolitit në ujdhesën Roda (Rodos).74) Madje janë akuzuar që në krahinën e Korintit në Greqi në vitin 1676 çdo ditë nga disa të krishterë fundosen në “mashtimin turk”, ndër të cilët natyrisht

edhe tre klerikë kanë ndërruar fenë.75) Kur sulltan Mehmedi IV në vitin 1675 bënte gazmendin me rastin e synetimit të djalit të vet Mustafës, që ke zgjatur 13 ditë, në të kanë qenë të pranishëm së paku 200 konvertitë.76) Po ashtu, në veprat që janë shkruar në atë kohë, takojmë shumë shembuj të konvertimit. Një nga autorët e asaj kohe e përshkruan në këtë mënyrë gjendjen shpirtërore të konvertitëve në vitin 1664: "Duke u përzier me Turqit dhe duke ardhur me ta në rrethanat jetësore në kontakte të rëndomta, panë ndër liturgjitë e tyre fetare edhe psalmet e Davidit (Davudit, a.s.). Turqit japin lëmoshë dhe vepra të tjera humane bëjnë. Respektimi i tyre i jezusit (Isaut a.s.) është i madh. Edhe Evangjeljen e respektojnë. Përveç kësaj, sikur ndonjëfarë horri si gomar t'i ofronte dhuratë pashait të asaj ane, do të mund të emërohej për papë të asaj ane. Sa i përket njeriut të këtillë, ai nuk do të kujdesej shumë për nevojat e amullisë së vet. Prandaj, filloni të besoni, nëse turqizoheni, se do ta gjeni rrugën për në shpëtim. Ja kështu nga mendja juaj del trinia e shenjtë. i biri i Zotit, që pësoi në kryq, dhe fshehtësitë tjera fetare, të cilat mendjes së paarsimuar i duken mashtrime, deri sa krishterizmi juaj në mënyrë të pahetueshme plotësisht nuk zhduket. Pas kësaj filloni të bindeni se për ju nuk ka dalli më jesh i krishterë ose Turk.77) Pas kësaj epoke rrallë vërehen rastet e konvertimit, por megjithatë, një autor francez përshkruan se shumë të krishterë në vitin 1703 kanë ndërruar fenë dhe se në mesin e këtyre pos disa katolikëve është edhe një klerik francez. Shkruan se në Izmir edhe disa klerikë e përqaftuan islamin.78)

Një nga faktorët që ka shkaktuar rënien numerike të ithtarëve të kishës lindore është edhe ky që predikuesit, e sidomos dinjitarët e lartë kishtarë, kanë kaluar jetë mjaft të shfrenuar. Janë qitur në ankand peshkopatat dhe kryepeshkopatat dhe u është dhënë atyre që japin më shumë. Ata që i fitonin, që të arrijnë deri te paratë që për ta kanë dhënë, i janë përveshur të gjitha mjeteve të mundshme që t'i nxjerrin nga bashkësitë e veta. Këta kanë vënë fatime të rëndomta dhe të jashtëzakonshme në popullatën e pafatë të krishterë dhe kanë caktuar se duhet me shuma të mëdha t'i paguajnë ritualet e shenjta të rëndomta sikur që janë: kryqimi, rrëfimi, kungimi, asketizmi, 133

varrimi etj. Disa popa kanë lidhur me jeniçerët një lloj të aleancës botërore. Madje emrat e shumë personave, që kanë qenë në suitë të peshkopëve, janë gjendur në listat e jeniçerëve dhe nën mbrojtjen e kësaj bashkësie ushtarake, e cila patë grabitur fuqi të madhe në shtet, për shkak të shfrenimit të krerëve osmanlinj, këta persona janë siguruar se nuk do të denohen për krimet dhe deliktet e veta.79) Disa autorë të asaj kohe, dëshmitarë, kanë paraqitur problemet që të krishterët e atëhershëm i kanë bartur nga veprimet që të krishterët e atëhershëm i kanë bartur nga veprimet kriminele të popave grekë. Një nga këta autorë, me emrin Thornfarth, duke folur për zgjedhjen e patrikut që është kryer në vitin 1700 thotë:

"Nuk dyshojmë se koha e patrikut do të kalojë mirë. Do ta ndjek despotizmin e tij dhe krimin e simonisë (tregtim se gjësendet e funksionet fetare kishtarë, vër. N. I.). Puna e parë që e kryen patriku është komunikimi i

vullnetit të sulltanit vlladikane, peshkopëve dhe klerikëve tjerë. Një nga detyrat e tij më të mëdha është të njohfotet me të ardhurat e të pozitave të larta të popave. Për secilin do t'i caktojë tatimet dhe në letrën e veçantë strikt t'u tërhiqet vërejtja se duhet të dërgohen. Pasi që klerikët e lartë janë mësuar në këtë tregti, as ata nuk do të mbesin nën këtë presion; edhe ata do t'i shtypin popat në pozita më të ulta, e këta do t'i drejtohen popullatës së famullisë së vet, dhe nëse kjo nuk iu paguhet, nuk do ta spërkasin asnjë pikë të ujit të shenjtë. Nëse patrikut i duhen më tepër të holla, ai ua beson Turqëve që këta t'i tubojnë. Deri sa rëndom klerikëve u paguajnë 20.000 kruna, Turqit marrin 22.000, dhe nga kjo e paguajnë angazhimin e vet, dhe sipas kontratës, të lidhur me patrikun, i shqetësojnë peshkopët që ngurrohen nga dhënia e kryerjes së detyrës fetare.80) Madje rrëfëhet se disa popa, që të grabisin para, për këto simoni kishtarë, kanë joshur fëmijët e famullitarëve të vet dhe i kanë shitur si robër.81)

Kjo mënyrë e nxjerrjes së parave, që është zbatuar në shekullin e XVII, është përsëritur edhe në shekullin e XIX në Bosnje dhe Hercegovinë para okupimit austriak. Mitropoliti sarajevës ka realizuar nga bashkësia e vet e mjerë në vit aq para - 10000 lira - sa ka pasur dy herë më shumë se sa janë të ardhurat e përgjithshme të mëkëmbësit turk. Që të vihet deri te kjo shumë e madhe është aplikuar presion në anëtarët e bashkësisë, kurse nëpunësit turqë kanë marrë urdhër që në këtë aspekt t'u ndihmojnë popave. Fshatrat që nuk kanë dashur ose nuk kanë mundur të japin para, që prej tyre i kanë lypur klerikët e lartë, duke iu bashkangjitur fatkeqësisë së qyteteve të grabitura, kanë duruar vështirësi.82) Këto vështirësi të padurueshme nga klerikët, të cilët për çdo rast janë të obligueshëm mta mbrojnë popullatën e krishterë, madje e kanë ngritur popullatën në trazira.83) Në pajtim me këtë, nuk duhet çuditur se shumë të krishterë kanë kaluar në anën e muslimanëve me qëllim që të shpëtojnë nga ky veprim i dhespotit.84)

134

Lloji tejtër i tiranive kishtarë ka ndodhur në krahinën selanikase në vendin Nuanti. Tregohet se tiranitë që kanë ndodhur atje kanë qenë shkak të konvertimit të të parëve të një bashkësie vlllehe, që numron rreth katër mijë anëtarë. Sipas traditës së tyre gojore, një nga patrikët stambollas nga shekulli XVIII e ka bindur sulltanin e atëhershëm se, ndër shtetasit e krishterë, shtetit i janë lojal vetëm ato që flasin greqisht, dhe sulltani urdhëroi që shtetasit e krishterë do të flasin vetëm greqisht, e në rastin e kundërt gjuha do t'u preket. Kur ky lajm erdhi deri te popullata e Nuantit, disa nga frika u strehuan në emale dhe atje kanë qenë të detyruar të ndërtojnë sërish fshatra, e ata që nuk kanë ikur kanë ikur kanë përqafuar islamin dhe në këtë mënyrë kanë mundur ta ruajnë gjuhën e vet amtare.85)

Njëmend, klerikëve të fshatërave dhe rrethinës nuk u janë përshkruar vepra të këqia që u janë atribuar eprorëve të tyre,86) por këta sërish kanë qenë injorantë të zi dhe mund të thuhet se nuk kanë ditë të lexojnë e shkruajnë. Thuhet se kah fundi i shekullit XVII në mesin e klerikëve grekë, vetëm dymbëdhjetë faqebardhë e kanë njohur gjuhën klerike greke. Të dijë të

lexojë për popat është konsideruar aftësi e madhe; këta nuk e kanë kuptuar domethënien e shumë fjalëve dhe shprehjeve të librit të tyre të lutjeve.87)

Superioriteti moral i Turqëve

Deri sa në rregullimin e atëhershë shoqëror të të krishterëve ka pasur shumë gjëra jotërheqëse, në jetën e Turqëve ka pasur shumë veti interesante dhe të pranueshme. Në pajtim me këtë, kur të nivelizohet kisha e krishterë me udhëheqjen dhe mësuesit e saj theksohet epërsia e Turqëve, e cila natyrisht shumë ka ndikuar në njerëzit e devotshëm të cilët, për shkak të abuzimeve të kishës lindore, për shkak të bastisjes në emër të fesë dhe për shkak të synimeve të saj egoiste, e kanë lëshuar krishterizmin. Autorët e vjetër të krishterë, pothuaj në çdo rast, e lavdojnë përkushtimin dhe sinqeritetin turk në jetën fetare, mallëngjimin e tyre në kryerjen e detyrës, që feja ua imponon, njerëzshmërinë e tyre që e dëftojnë në mënyrë e vet të jetës dhe veshjes, dlijësinë e tyre etj.88) Kronisti Gaultier de Leslie, të cilin mbreti Leopoldi I ia ka dërguar delegacionit të vet të Porta e Lartë në vitin 1665, duke i lavduar Turqit, sidomos zellin e tyre gajtë lutjeve, thotë: "Duhet pranuar diç që do të nxisë habinë e të krishterëve: Turqit në veprimet e veta fetare tregojnë më tepër mallëngjim se të krishterët. Tek ata vërehet gjithë ajo që do të mund të pritej se do të shihet te të devotshmit e krishterë: gjatë kohës së lutjes sytë e asnjërit prej tyre nuk do të kthehen në asnjë anë; jashtë devotshmërisë nuk do ta lidhë zemrën për asgjë tjetër, nuk do të shihet asnjë krijesë që ndaj Krijuesit nuk do të dëftojë përunjtësi skajore, që prej tij është pritur.89) Një pjesë e këtyre falënderimeve e ka kapur natyrisht edhe ushtrinë për shkak të qëndrimit dhe veprimit të saj. Sipas të dhënave të sekretarit të 135

delegacionit të Karlos II, në Portën e Lartë kurrë nuk ka ndodhur diç e atillë sikur grabitja, dhunimi, që do të ishte motiv i ankesave të popullatës, kur ushtria turke kalonte. Mejhanet dhe toçitoret tjera të alkoholit, që janë në rrugë, ku kalon ushtria, janë të mbyllura e të mylyrosura tri ditë para kalimit. Është e ndaluar shitja e alkoholit ushtrisë me kërcënim të denimit me vdekje.90)

Madje autorët e krishterë, që nuk kanë pasur as shenjë të dashurisë ndaj Turqëve, shumë i kanë çmuar virtytet turke. Një nga antarët e tillë, duke ushqyer për fenë turke mendim të keq91) megjithatë thotë: "Megjithëse Kur'anin nuk e konsideroj të vlefshë m'për ta pranuar, megjithatë e di se në të ka gjurma të substancës si krishterë. Njëmend, sikur të krishterët me vëmendje studiojnë historinë dhe ligjet e muslimanëve, do të hasnim në shumë gjëra para të cilave veten do ta konsideronim cikërrime. Këto gjëra janë: kujdesi dhe sinqeriteti në veprat e nënshtrueshmërisë, kryerja e të mirave dhe kultivimi i devotshmërisë, pastërtia, qëndrimi i respektimit të plotë në tempuj, dëgjueshmëria dijetarëve fetarë. Madje edhe sunduesi i tyre, nëse nuk merret vesh me muftiun, nuk do të bëjë asgjë. Çfarë kujdesi kanë ndaj lutjes së tyre: kudo qofshin dhe nuk e di me çfarëdo pune qofshin të preokupuar, ata pesë herë në ditë do të luten. Me çka zelltarie agjërojnë tërë muajin nga agimi deri në muzg! Sipas islamit të tyre, ata janë mirëbërës ndaj

njëritjetrit. Ata me kujdes i kurrojnë në spitalet e tyre të huajt, qofshin ata të varfër ose udhëtarë. Sikur ta hedhnim shikimin në drejtësinë e tyre, në kthjellshmërinë e tyre dhe në virtytet tjera morale, duke parë qëndrimin tonë të ftohtë qoftë në devotshmëri qoftë në humanitet, ne do të ndiznim turp. Nuk ka dyshim se islami është shkaktar për shkallën e tyre më të lartë në veprat e devotshme dhe humane. Një historian i kohës më të re në këtë aspekt erdhi deri te rezultati i njëjtë.⁹²) Ai thotë: "Sipas asaj, sa kemi mundur ta kuptojmë, shumë Grekë të aftësive të larta dhe me virtyte morale ashtu edhe e kanë ndier prioritetin e muslimanëve sa që madje shumica, që i shmangeshin shërbimit mbretëror, në vend të dhënies së tatimit, e pranonin vullnetarisht islamin. Pa dyshim rregulimi shoqëror i Osmanlinjve dhe superioriteti i tyre moral kanë pasur ndikim të fortë edhe në individët nga shumë raste të konvertimit, që kanë ndodhur në shekullin XV.

Vërtet, për një brez, që është dëshmitar i dekadencës turke në Evropë dhe ngushtimit të vazhdueshëm të kufinjve të saj, është mësuar të dëgjojë se individualiteti shpirtëror turk, si "i sëmurë", është gjykuar në zhdukje jo të largët, është vështirë që të kutojë aktivitetin që Imperatoria Osmane e ka kryer në Evropë në kohën e progresit të vet.

Sukseset e armëve turke, që ndodhën përnjëherë dhe epokalisht, kanë nxitur në mendjet njerëzoro admirim dhe tmerr. Mbretëritë e krishtera njëra pas tjetrës binin në duart e tyre. Bullgaria, Serbia, Bosnja, Hungaria, ia dorëzonin mëvetësinë e vet. Republika e fuqishme e Venedikut shikonte se 136

si i dalin nga duart shumë pjesë të vendit të saj. Madje pas rënies së Otrantit ka qenë i ekspozuar rrezikut edhe qyteti i amshueshëm Roma. Kah fundi i shekullit XV dhe në shekullin XVI veprat e publikuara të shkruara të krishterëve janë të përmbushura - deri sa nuk u ndal marshimi triumfues i Turqëve - me paralajmërimin e fatkeqësive, që e kanë rrezikuar fatin e Evropës së krishterë. Turqit janë prezentuar si shkop Zoti, me të cilin Ai i ndëshkon, për shkak të mëkatimit dhe jomoralit, robërit e vet,⁹³) ose janë konsideruar si forcë e Luciferit (Jblisit) së cilës i është dhënë liria që hipokrizisht dhe me diskriminimin e fesë të përpiqet të rrënohet krishterizmi. Por këtu është një pikë që meriton vëmendje, e kjo është se vetëvetes disa njerëz ia kanë shtruar këto ypetje: "Sikur mos të kishte shkaqe të arsyeshme, a do të pranonte i Madhërishtmi që numri i muslimanëve të zmadhohet kaq shumë? A mund ta pranojë arsyeja që me mijëra njerëz si një person të jenë mëkatarë dhe të mallkohen? Kur është kaq e shumënumërt, si është e mundur që kjo bashkësi njerëzore të jetë në kundërshti të fesë së vërtetë (d.m.th. sipas botëkuptimit të krishterë)? Pasi e vërteta është më e fortë se mashtrimi, dhe pasi këtë të gjithë njerëzit e manifestojnë, vallë a ka mundësi që këta pasardhës të shumë të Ademit të luftojnë kundër saj? Pasi që i Gjithëharti e ndihmon dhe e rekomandon të vërtetën, si është e mundur atëherë që të vërtetën ta marrin Turqit? Nëse feja turke është vënë, si thuhet, në themele të kalbura të mashtrimit, përse atëherë ajo në këtë mënyrë e shpejtë mrekulluese është përhapur?"⁹⁴)

Si mund të kuptohet nga kjo, vërejtjet të ngjashme me këtë kanë gjetur vend edhe në mendjet e të krishterëve që kanë jetuar nën sundimin turk; e sidomos kjo më fuqishëm është rrënjësuar në mendjet e të krishterëve të varfër, të cilët, duke rënë në robëri, dhe duke e humbur shpresën se do të shpëtojnë nga mjerimi të cilit i janë ekspozuar dhe do të thithin ajër të lirisë, kanë shikuar në fatkeqësi se si kalojnë vitet. Pra, nuk duhet çuditur që një nga këta robër kështu i drejtohet vetëvetes: "Shpirti im, sikur Zoti të ishte i kënaqur me fenë që e ndjek ti, nuk do të lëshonte në këtë gjendje; përkundrazi, do të ndihmonte që të çlirohesh dhe të kthehet feja jote; por pasi Ai i ka mbyllë të gjitha rrugët e shpëtimit, sigurisht është e vendosur që t'i ta lëshosh këtë fe dhe sigurisht ka dashur Zoti të shkosh rrugës së fesë e cila do të nxjerrë në rrugën e shpëtimit."95)

Kalimi i popullatës së krishterë në islam

Dyshimi, të cilin në këtë mënyrë e përshkruan robi i krishterë, kurse i cili ka lindur për shkak të viteve të ngadalshme e të gjata, të cilat nuk i ofronin mjete për shpëtim, është bërë interpretues i vërejtjeve të cilat vazhdiisht u imponoheshin mendjeve edhe të robërve tjerë të krishterë, dhe më në fund i kanë ndërprerë lidhjet me fenë e vet të vjetër dhe e kanë përqaftuar islamin. 137

Edhe ata persona që menjëherë në emër të krishterizmit i fitonin vdekjen martire, sikur të gjendeshin para zgjedhjes së imagjinuar ndërmjet Kur'anit dhe shpatës, do të fillonin pas shumë vite robërimi të ndiejnë rritjen e ndikimit të mendimit dhe veprimit islam, dhe aty ku nuk mund të triumfojë dhuna të fitojë konvertitë, do të kishte sukses sjellja humane.96)

Vërtetë, fati i shumë robërve të krishterë ka qenë i hidhur, por disa prej tyre kanë zënë vende me rëndësi në pallate. Pa dyshim, gjendja e tyre nuk ka qenë më e keqe nga gjendja e shërbëtorëve në viset tjera të Evropës. Si është përcaktuar me sheri'at, robëria në Turqi është kursyer nga mënyrat johumane. Gjithësesi, atje nuk ka pasur barbari dhe tirani siç ka qenë në shtetet pirate të Afrikës veriore. Robërit e atjeshëm kanë pasur të drejtë sikur edhe njerëzit e vendit. Madje flitet për një rob se zotëriun e vet për shkak të keqtrajtimit ka mundur ta thërret para kadiut dhe kadiu ka mundur pronarit të tij t'i urdhërojë", kur të konstatohej se ata nuk po mundën të pajtoheshin për shkak të traditave dhe karaktereve të ndryshme, që t'ia shesë tjetrit.97)

Gjendja e robërve të krishterë, natyrisht, ka qenë e llojllojshme sipas rrethanave të vendit ku kanë jetuar dhe sipas aftësive të tyre të adaptimit jetës së re. Pleqtë, klerikët, monakët dhe bujarët kanë pësuar më shumë, deri sa mjekët dhe zejtarët kanë qenë në pozitë shumë më të mirë, sepse denjësisht ua kanë kthyer për paratë që janë shpenzuar për ta.98) Robërit që janë përdoruar në gali më së shumti kanë qenë të ekspozuar fatkeqësive dhe mundimeve. Një autor duke shkruar për ta thotë: "Jeta e këtyre robërve të mjerë, t lidhur për barkat luftarake turke, nuk ka qenë as më i mirë as më i keq nga jeta e robërve në gali, të cilat nën simbolin e kryqit janë marrë me tregtinë me robër. Në të dy rastet robërve u janë caktuar punë të rënda, fatkeqësia dhe goditjet e hidhura. Ka mundësi që burgjet, për shembull turk

ose algjerian, duke i pasur parasysh terrin dhe fëlliqëtinë, për shëndetin kanë qenë më katastrofik se ata të Barcelonës dhe Napolit, por në det, nëse mjerimin duhet ndarë në kategori, gjendja e robërve të lidhur për barkat turke prej dy të këqijave është më e vogël.⁹⁹)

Ka qenë traditë t'u lejohet të burgosurve që pa pengesa t'i kryejnë rregullat e veta fetare. Në burgun shtetëror në Stamboll gjendeshim popat e robërve dhe tempujt special për ta. Popave iu lepej leja që robërve në gali të mund t'u japin ngushullim dhe t'u predikojnë fenë.¹⁰⁰) Është shumë i madh numri i robërve të krishterë që e kanë përqaftuar islamin. Historikisht është evidente se tirania është shkas i lënies së fesë së vjetër, por komisarët (të besueshmit) sipas metodës së rëndomtë nuk i kanë detyruar robërit në fenë e turkut. Në vitet e para të robërisë, ndonëse atëherë do të kishte presione,¹⁰¹) shkallërisht do t'i lëshonin robërit ta ndjekin fenë e vet.¹⁰²_ Në pajtim me këtë, shumë robër të konvertuar vullnetarisht e kanë ndërruar fenë. As delegacionet e shteteve të krishtera, që shkonin në Stamboll, nuk kanë qenë

138
të sigurtë se shërbëtorët, që i kanë pasur atje, nuk do ta përqafojnë një ditë islamin.¹⁰³)

Është e qartë se robërit, të cilët plotësisht e kanë humbur shpresën se do të kthehen në vendin e vet, të cilët janë marrë në rini, të cilët kanë shumë pak rast që të forcohen në ëmësim-besim dhe të qëndrojnë në kryerjen e ritualeve të fesë së vet, do t'i nënshtrohen ndikimit të ekspozuar dhe se nuk do të gjejnë pengesa hyrjes në fe të re dhe në rregullim të ri shoqëror. Udhëtari Anglez në shekullin e XVII,¹⁰⁴) Thomas Smithi, në veprën e përmendur, duke shkruar për persoant e tillë, thotë: "Shumë pak njerëz të këtyllë kthehen në atdhe të vërtetë. Mësimin, që kanë mund ta marrin, është majft sipërfaqësor; baza e diturisë që e kanë poseduar është mjaft e dobët. Në pajtim me këtë, disa nga frika dhe padurimi, e disa në depresion nga puna e robit janë bashkuar me Turqit. Disa përsëri janë përvetësuar me tërheqshmërinë e tolerancës shëriatike ose, që ta përmirësojnë pozitën e vet, e kanë ndërruar fenë. Posa ta humbin shpresën në shpëtim, e kapërcenin ndërmjetësuesin, d.m.th. Jezusin dhe krishterizmin, dhe shpejtë e harronin atdheun e mirëfilltë. Tashmë këta më nuk konsideroheshin të huaj por vendas."

Përcaktimi për fenë e re në të shumtën varet nga qenësia individuale e robit. Një autor, nga vepra e të cilit kemi marrë deri tash shumë të dhëna dhe i cili, duke mbetur gjatë kohë në robëri, ka fituar të drejtën të na shpejtojë shumë gjëra, i ndanë këta robër në tre grupe: **Grupi i parë** është i atyre që kanë kaluar jetë të thjeshtë, dhe nuk kanë dashur të angazhohen të mësojnë asgjë për fenë e zotërive të tyre. Për këta, sipas mendimit të tyre, ka mjaftuar të dijnë se Turqit janë të "pae". Për këtë arsye, nëse robëria u lejonte, u shmangeshin Turqëve dhe nuk interesoheshin me lutjen e tyre, dhe në këtë mënyrë i kanë ruajtur mashtrimin të ndërrimit të fesë dhe sipas dijes dhe mundësisë së tyre janë përpjekur të kryejnë ritualet e krishtera. **Grupi i dytë** është i atyre që i ka përshkuar kureshtja që t'i hulumtojnë veprat dhe punën e Turqëve. Nëse këta me ndihmën e Zotit kanë pasur aftësi t'i studiojnë

sekretet turke, nëse kanë pasur dritë të arsyes që atë që e studiojnë hollësisht ta shpejtojnë, atëherë jo vetëm m që kjo u bënte dëm, por kjo për më tepër do t'i forconte në fenë e tyre. **Grupi i tretë** është i atyre që janë lëshuar në hulumtimin e islamit pa kujdesin e nevojshëm. Të këtillët jo vetëm se nuk arritën të depërtojnë deri te gremina e tyre, por, për më tepër, edhe janë mashtruar. Këta gabimin turk në besim e kanë konsideruar të vërtetë, fenë e vet e kanë humbur dhe janë bërë ithtarë të fesë së shtrembër islamit, dhe në këtë mënyrë jo vetëm që e kanë shkatërruar veten, por edhe për të tjerët kanë qenë shembull i keq. Të këtillë ka pasur numër të madh të panumërt."105) Konvertimi në islam, si këtë e pohojnë disa, nuk ka liruar nga robëria,106) sepse pyetja e lirimit ka qenë në dorë të pronarit; Ata rdom premtorin se robin pa kurrfarë kompenzimi do ta lirojë nëse e pranon islamin.107)

139

PërveçPërveç robërve të krishterë ka pasur edhe shumë persona që janë ndarë nga midisi dhe udhëheqësia e vet ashtu që i kanë ndërprerë lidhjet kryesore, kurse edhe vetë janë hedhur midis rregullimi shoqëror të lëvizur në mënyrë krejtësisht tejter me synime fetare dhe shoqërore. Masat e krishtera pa vend dhe punë nga viset të cilat Turqit i kanë pushtuar janë ngritur në shekullin e XV dhe duke bredhur kanë arritur deri në Edrene dhe vendet tejsra të mëdha turke, dhe kanë kërkuar që të punësohen. Ata lehtë kanë mund të binden që të banojnë aty dhe ta përqafojnë islamin.108) Kështu edhe familjet e krishtera, të cilat sulltan Mehmedi II ka lejuar të transferohen nga vendet e pushtuara në Evropë në Anadoll,109) pandieshëm janë përzier me popullatën islame dhe u humben. Kështu ka bërë edhe me Ermenët shah Abbasi I (1587-1629/996 - 1039 H.) duke i hedhur në brendi të Iranit. Ky grumbull në brezin e dytë u kthye në islam dhe u zhduk.110)

Vërtet se në shekullin e XVIII dhe XIX në mesin e Turqëve po humbet fryma misionariste. Mirëpo, është vërejtur në vitet e fundit të sundimit të sulltan Abdulhamidit II se në njëfarë mase sërish është paraqitur propaganda islame dhe se gazetat turke filluan me kujdes t'i shtrojnë rastet e konvertimit. Një nga rastet e ndërrimit të fesë në atë kohë, kurse i cili është konsideruar më i vlefshmi për vëmendje, është konvertimi i 18 princave nga familja libanonase Shihab, e cila njëqind vjet ka qenë në krishterizëm. Pasi flitej se familja Shihab rrjedh nga pasardhësit e Kurejshitëve, Turqit janë orvatur shumë që t'i kthejnë në rrethin e bashkësisë fetare islame. Anëtarët e kësaj familjeje janë vënë në shërbimin shtetëror turk në vendet me të ardhura të mëdha.111)

Pushtimi turk i Shqipërisë

Duam të japim të dhëna të hollësishme e të veçanta mbi mënyrën e përhapjes së islamit ndër popullatën e krishtere të Shqipërisë, Serbisë, Bosnjes dhe Kretës, sepse secili nga këto vise, pasi është pushtuar nga Osmanlinjt, ka rëndësi të posaçëm në historinë e përhapjes së islamit. Shqiptarët, përveç një pjesë që është i popullëzuar në Greqi,112) banojnë në viset malore të bregut lindor të detit Adriatik, që shtrihet ndërmjet Malit të Zi dhe gjirit të Nardes ose Prevezës. Ata i përkasin nga popujt më të vjetër

të Evropës, dhe se llogariten në fisin arianit, degë e Pellazgëve. Invazioni i parë i Turqëve në Shqipëri ka qenë në vitin 1387/789 H., por pak më vonë forcat turke nga këtu janë tërhequr. Shqiptarët për herë kanë pranuar sundimin e sulltanit në vitin 1423/827 H. Shqipëria nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, i cili është i njohur me emrin musliman Iskender-beg (Skenderbeu, vër. N.I.), për një kohë e ktheu pavarësinë e vet. Tregimet për atë se si ende në fëmijëri është marrë si peng në turqi, se si është edukuar ndër muslimanët dhe se si e ka tërhequr mbi vete vëmendjen e sulltanit, 140

hulumtimet historike i kanë zbuluar si të trilluara. Këto janë në këtë pikëpamje faktet e verifikuara: Iskender-beu e ka kaluar rininë e vet në viset malore të banuara me Shqiptarë. Luftërat që i ka zhvilluar kundër Turqëve filluan me fitoren e tij në vitin 1444/848 H. Pasi që rreptësisht dhe me sukses i është kundërvënë më shumë se njëzet vjet fuqisë së tyre invaduese, Turqit, pas vdekjes së tij në vitin 1467/872 H., sërish filluan ta pushtojnë Shqipërinë. Njëmbëdhjetë vjet më vonë edhe Kruja, e cila ka qenë qendër e shtetit të fisit Kastriot, ka rënë në duart e Turqëve. As më vonë Shqipëria nuk është nënshtruar krejtësisht, kryengritjet paraqiteshin, por as nuk ka pasur një rezistencë më të fortë. Mirëpo, disa vende bregdetare gjatë kohë nuk kanë dëshiruar të dorëzohen. Durrësi është marrë vetëm në vitin 1501/907 H., kurse limani Tivari (Antivari),* pika më veriore ku ka pasur Shqipëtarë, është dorëzuar vetëm më vitin 1571/979 H. Këto janë kushtet e dorëzimit të tij: që të ruhen ligjet e vjetra dhe gjykatat e vendit, që të krishterët të munden lirisht dhe botërisht t'i kryejnë rregullat fetare, dhe kishat dhe kapelat të ruhen nga sulmet, e në rast se ndonjë rrënohet, që sërish të mund të ngritet, që populli të disponojë me pasurinë e tundshme e të patundshme dhe që ndaj saj mos të caktohen mbitaksa.

Vetitë e popullit shqiptar

Kuptohet se Shqipëria nën sundimin turk gjithnjë ka pasur një lloj të qeverisjes gjysmëautonome dhe se e kanë ruajtur mëvetësinë; sikur që e kanë pasur disa fise para pushtimit. Ndonëse kanë qenë nën sundimin e sulltanit, megjithatë besa e tyre në lojalitet nuk ka shkuar aq larg që të pranojnë që nëpunësit turqë të përzihen në çështjet e tyre të brendshme. Ka mjaft shkaqe të arsyeshme që të mendohet se Turqia nuk ka caktuar asnjë nëpunës që nuk është autokton i vërtetë, e madje nuk ka caktuar as Shqiptarin për mëkëmbës ose kryeshef të rrethit në atë vis që nuk është bërë i famshëm me armën e vet ose nuk ka pasur lidhje të forta farefisnore. 113) Krenaria popullore e Shqiptarit është majft i madh. Kur dikush një Shqiptar e pyet ç'është para se t'i përgjigjet se është musliman ose i krishterë, do të thotë se është Shqiptar. Kjo shprehje, duke e marrë parasysht kuptimin e saj, do të mund të shpjegohej se ai është banor i shkëmbit. Kjo mënyrë e manifestimit të individualitetit është shkak i veçantë i ndjenjave nacionale, sepse mënjanojnë atë përçarje e rreptë që sundon në viset tjera të Imperatorisë Osmane ndërmjet ithtarëve të këtyre dy feve.

Shqiptarët, muslimanët dhe të krishterët flasin me gjuhën e njëjtë, i kultivojnë traditat e njëjta dhe kanë qëndrimin dhe zakonet e njëjta.

141

Mburrja e përbashkët nacionale është aq e fortë saqë nuk i ka dhënë vend ndikimit kundërshtues religjioz, që i ka ndarë anëtarët e këtij populli.114) Në radhët e ushtrisë së çrregullt, në të cilën në aspekt të ruajtjes së rendit dhe sigurimit të administrimit, u mbështet në fillim të invazionit turk, është themeluar shteti, kanë shërbyer paralelisht muslimanët Shqiptarë me të krishterët Shqiptarë. Pasi që Shqiptarët e të dy feve janë numruar brenda Mbretërisë Turke ndër më të guximshmit, për këtë gjithnjë janë gjetur në shërbim të pashait në Shqipëri. Të krishterët shqiptarë kanë kryer shërbimin ushtarak në ushtrinë turke gjatë kohës së luftës të Krimit.115) Njëmend, të krishterët edhe pse janë më të qetë se muslimanët dhe kanë më tepër prirje për bujqësi, megjithatë në mesin e tyre ka fare pak dallim. Të krishterët shqiptarë i kanë ruajtur armët e tyre dhe traditat militante dhe gjithnjë kanë dëftuar frymën nacionale të lirë, krenare dhe të rreptë. Kanë qenë të frymëzuar me ndjenjën nacionale sa edhe bashkëfisorët e tyre që e kanë përqafuar islamin.116)

Dobësimi i shkallërishtëm dhe tërheqja e krishterizmit

Për studimin e përhapjes së islamit në Shqipëri është me rëndësi e theksuara lartë, sepse kjo përhapje është sendërtuar suksesivisht në mesin e popullatës vendëse ashtu që nuk ka qenë e ekspozuar kurrfarë presioni nga jashtë. Në këtë aspekt të dhënat mbi aktivitetin misionarist, që i kemi në disponim, janë majft të kufizuara, sepse faqet e historisë shqiptare prej shekullit XV e deri në paraqitjen e Ali-pashë Tepelenës, gjatë treqind viteve duket se kanë mbetur pothuaj të zbrazëta.117) Prandaj, të dhënat që kemi mund të vijmë për kalimin në islam, që në ëkohën e përmendur ngadalë, por në ëkontinuitet është kryer, janë marrë nga kronikat e qarqeve të ndryshme kishtarë dhe nga projektet, që kokë pas kohe i janë dërguar papës. Mirëpo, që vetë vetin kuptohet, esenca e këtyre burimeve u jep të dhënave, që merren nga këta, karakteristikë të mëngët, e sidomos në aspekt të atij cakut të lartësuar konvertimit. Madje asnjë prijës kishtarë i asaj kohe nuk ka mundur vetes t'ia paraqesë qëllimin e sinqertë gjatë pranimit të islamit, e sidomos ka qenë rëndë të kuptohet se ata kanë mund ta shpejtojnë mendimin e vet për ekzistimin e qëllimit të sinqertë. Vërtetë, ndonëse në shekullin XVI atje lindi rryma e prozelitizmit, megjithatë duhet se islami mjaft pak ka përparuar. Numri i të

142

krishterëve në Shqipëri në vitin 1600/1019 H. ka qenë dhjetë herë më i madh se i muslimanëve.119) Fshatrat me shumicë kanë qenë të banuara me të krishterë, në mesin e të cilëve ka qenë ndonjë musliman.120) Duke e marrë këtë parasysh, kuptohet se më të shpeshtë kanë qenë rastet e konvertimit në qytet. Për shembull të krishterët e vendit Tivur

(Antivar) që kanë mbetur nga ata që janë shpërngulur në vendet fqinje të krishtere, qoftë nga shtresat e larta qoftë nga shtresat e ulta, shumica kanë kaluar në islam. Në këtë mënyrë, popullata e atjeshme e krishtere ka rënë.121) Pasi numri i muslimanëve është rritur, disa kisha janë shndërruar në xhamia. Ndonëse, në fakt, kjo gjendje ka qenë në kundërshtim me kushtet e shtruar të dorëzimit, popullata e atjeshme vendase, duke e ndërruar fenë, e ka konsideruar të arsyeshme t'i shndërrojë edhe tempujt e vet. Sipas versionit të autorit Ferlatit, pasi kanë prekur edhe në pullatin e kryepeshkopatës, ky ka qenë shkas për ankesën e tij. Kurse këtu ky pallat tetë vjet ka qëndruar i zbrazët, sepse kryepeshkopi Ambrosiusi duke ikur jashtë kufijëve turk rreptë ka vepruar kundër islamit i ka blasfemuar Pejgamberin e Zotit, natyrisht ka marrë guxim ta quaj fenë e tyre "dispozita satanike", dhe për këtë arsye ikjen e ka konsideruar më të përshtatshme. Në vitin 1610 kanë mbetur vetëm dy kisha, që u kanë shërbyer për shkolla, kurse edhe këto kanë kaluar në duart e kishës latine perëndimore, por megjithatë i kanë plotësuar nevojat e bashkësisë së krishterë, që ka mbetur atje.123) Çfarë rëndësie kanë këto rrëthana mund të dëshmohet pak a shumë me fjalët e autorit Mark Bizit: "Atje ka pasur gjashtë qind shtëpi të cilat janë banuar pa dallim nga muslimanët, latinët dhe ortodoksët grekë. Muslimanët numerikisht kanë dominuar ndaj katolikëve dhe ortodoksëve."

Duke i marrë parasysh të dhënat që i kemi për lidhjet sociale ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve dhe për atë se ndërmjet këtyre dy bashkësive nuk ka kurrfarë vije që do t'i ndante, mund të mësojmë se si islami i ka arritur ithtarët në atë përmasë në të cilën ka rënë zelli dhe jeta shpirtërore e kishës.

Shpesh ka ndodhur që prindërit e krishterë e kanë kurorëzuar vajzën e vet për muslimanin dhe nuk u kanë penguar të krishterëve këtë martesë.124) Nga këto martesë të përziera fëmijët mashkuj janë edukuar si muslimanë, deri sa fëmijëve femra u është lejuar të rriten në fenë e krishterë,125) vetëm që kjo leje nuk merrej parasysh për shkak se krerët kishtarë femrave të këtilla ua kanë ndaluar pjesëmarrjen n 143

ëritualet e shenjta dhe i kanë mbajtur jashtë kishës.126) Njëmend, disa popa në vendet më të vogla nuk i kanë zbatuar saktë urdhërat e eprorëve të vet, por megjithatë veprimi i tyre me femrat i ka shtyrë shumicën që ta përqafojnë fenë e burrave të vet. Megjithatë disa gra të krishtera kanë kultivuar disa besime zanafillore në aspekt të kryqimit dhe kanë dëshiruar t'i kryqojnë fëmijët e vet, duke parashtruar se ky është ilaq i suksesshëm kundër leprës, magjive dhe sulmit të ujqëve.127) Popat e krishterë kanë qenë të gatshëm t'i përforcojnë gratë muslimane që u vinin t'i kryqojnë fëmijët në atë besim të shtrembër.128)

Ndjenjat fisnike ndërmjet ithtarëve të këtyre dy feve129)

manifestohen në prezencën e muslimanëve në ceremonitë fetare, të cilat janë organizuar për nder të ndonjë të shenjtë të krishterë. Me këtë rast autori Marko Bizi ka thënë: "Për shëngjergj, të cilin Shqiptarët sidomos e nderojnë, në këtë ka pasur më shumë muslimanë se të krishterë. 130) Sipas një versioni muslimanët shqiptarë edhe sot e konsiderojnë të shenjtë Marien (h. Merjemen), i respektojnë të shenjtët e krishterë dhe i vizitojnë varrezat e tyre. Po ashtu nga ana tjetër të krishterët u drejtohen me përgjërime turbeve të evliave (njerëzve të mirë) muslimanë me qëllim që t'ua shërojnë sëmundjet. 131) Në vendin Kalevaki, ku banojnë 60 familje të krishtera kurse 10 muslimane, shumica e muslimanëve të martuar me të krishtera kanë marrë pjesë në mbajtjen e popit të atjeshëm. 132) Marko Bizi këto të meta ka dëshiruar t'i shpjegojë në tri mënyra: me joshjen e dobive të kësaj bote, dëshira për shpëtim nga haraçi, mungesa e klerikëve të aftë që në masë të mjaftueshme do t'i plotësojë nevojat shpirtërore të popullatës. 133) Shumica e konvertimeve i atribuohet barrës së padurueshme të tatimit, që caktohet ndaj të krishterëve, dhe ceket se tërë fshatrat, që të shpëtojnë nga ky tatim, kanë bërë "renegatje". Është e paundur të konkludohet, për shkak të ankesës e cila këtu u bë, që kjo anë nuk është e ndriçuar sa duhet, se për këtë vërtet ka mjaft arsye; ose që ky është interpretim i tensionuar i atyre që do të donin të gjenin arsyetim për konversionin e bashkëbesimtarëve të dikurshëm të vet, ose se kjo përbëhet prej pohimit hiperbollik të krishterëve se absolutisht është e pamundur të përqafohet islami nga bindja. Me siguri se njerëzit, të cilët pastër vetëm për t'i shpëtuar tatimit ose, me shprehje tjetër, nga gjopa kanë ndërrur fenë e parë, ata pak janë të lidhur për fenë e vet. Njëkohësisht, ekzistimi aktual i popullatës së 144

shumënumërt të krishterë në Shqipëri dëfton se këto tatime nuk kanë qenë aq të rëndë që t'i detyrojnë në ndërrimin e fesë. Sikur të mund të gjenim diç më tepër nga ato ankesa, përgjithësisht të papërcaktuara, për "despotizmin turk", do të mund të caktonim sa ka pasur pjesë ai në këtë, por provat e versioneve verbale nuk duket se lehtë do ta sigurojnë rezultatin e këtillë. Tradita e keqe e Imperatorisë Osmane si shitja e pozitave provinciale atij që jep më shumë, dhe pacaktueshmëria e zgjatjes së këtyre pozitave, në të shumtën do të rezultonin me atë që nëpunësit, që do t'i zënin ato, do të përpiqen me të gjitha mejtt e mundshme që me nxjerrjen e parave të bëjnë kapital sa më të madh. Mirëpo, është e njohur se kjo barrë e rëndë është ngarkuar jo vetëm mbi të krishterët por në masë të njëjtë edhe mbi muslimanët. 134) E vërteta, për nëpunësin lakmues e të padrejtë sigurisht më lehtë e ka pasur t'i bëjë të padrejtë të krishterët se sa uslimanit, e sidomos të krishterët janë akuzuar se kanë qenë në spiunazhë tradhtarë me Venedikun dhe me shtetet tjera të krishtera dhe pjesëmarrës në komplotet e ndryshme rebeluese.

Nëse gjendje ka qenë e këtillë, megjithatë nuk mund të dyshohet në ndikimin që e ka kryer aktiviteti i zellshëm për islamin në klerarkinë e atillë apatike të krishterë. Sikur islami të kishte në Shqipëri me tepër hoxhë - duke folur për pyetjet fetare, e lavdon sinqeritetin, butësinë dhe miqësinë e tyre Marko Bizi - do të nxiste progres të madh në të.135) Shumica e klerikëve të krishterë kanë qenë të paditur. Nëse disa prej tyre kanë ditur të lexojnë, më tepër kanë lexuar përmendsh se sa nga Shkriemt. Këta kanë qenë aq pakë të udhëzuar në detyrën e vet fetare që shumica nuk kanë ditur madje as përmendsh ta citojnë lutjen murgëtare.136) Edhe pse disa kanë ditur t'i citojnë lutjet në ëshërbimet e përbashkëta, të cilat janë të zakonshme dhe të caktuara që të citohen në gjuhën latine, megjithatë ka qenë rëndë në mesin e tyre të gjeshë ata që e kanë kuptuar atë gjuhë. Ata nuk kanë pasur dije tjetër mbi esencat e fesë së vet deri te ato të dhëna të papërcaktuara që janë mbështetur në traditën gojore.137) Autori i përmendur mendon se për këto të meta përgjegjës janë ata që kanë qenë në pozitat peshkopike. Ai po ashtu i konsideron përgjegjës edhe për numrin e pamjaftueshëm të klerikëve, për mosdijen e atyre që kanë qenë në detyrat shpirtërore, për jetesën dhe vdekjen e shumë të krishterëve e që nuk e kanë mësuar as "Besojnë",138) për "renegatjet" të cilat

145
ndodhnin kudo. Ai parashtrohet se atje do të zhduket krishterizmi nëse kësaj nuk i gjendet ilaqi.139)

Me këtë rast është me rëndësi të përendet se klerikët shqiptarë nuk kanë qenë, sikur kanë qenë këtë ortodoksët në viset tejra të Mbretërisë Turke, ruajtës të vetëdijes dhe synimit nacional. Ndonëse edhe në mesin e popave tjerë ortodoksë ka pasur të padijshëm, megjithatë atame përkushtim e kanë ruajtur detyrën e lojalitetit krishterizmit që është themel i jetës nacionale, si për shembull të Grekët.140) Te Shqiptarët, përkundrazi, ndjenjat nacionale janë plotësisht të ndara nga besimet religjioze. Sa i përket qëndrimit ndaj Turqëve, ata kanë qenë të bindur, që rrjedh nga besnikëria ndaj frymës së vjetër feudale, se duhet t'u nënshtrohen urdhërave të tyre, pasi ata janë zotërinj të vendit.141)

Nuk ka pasur raporte miqësore ndërmjet klerikëve dhe popullatës. Këtë e konfirmon një rast i çuditshëm mi konversionit: Në kohët e vejtra, deri sa ende tërë Shqipëria ka qenë e krishterë, në Shkodër gjendej fotografia e bukur e Maries. Në mauzoleun, ku ishte e vendosur kjo fotografi, vinin me mijëra njerëz nga të gjitha viset, kanë dhënë dhurata, përunjtur luteshin dhe për hallet e veta ilaq kërkonin. Për shkak të diçkahit është krijuar armiqësi jo e qetë ndërmjet popullit dhe klerikëve. Një ditë janë futur me forcë në kishë dhe kanë deklaruar se, nëse klerikët nuk i plotësojnë dëshirat e tyre, të gjithë tokë do ta lënë Jezusin dhe do ta përqofojnë Muhammedin. Pasi klerikët me këmbëngulësi ka mbetur në ëvendimin e vet, qoftë ajo

drejtë ose shtrembër, populli ka shqyer e thyer nga dyert çdo gjë që kanë qenë rruzare e kryqore dhe në mllef me këmbë i ka shkelur, dhe shkuan drejt deri te xhamia më e afërt, ku imami i ka prituri si muslimanë të vërtetë.142)

Për shkak të neglijencës dhe pakujdesjes së klerikëve të krishterë në shoqërinë e krishterë u krijuan shumë keqpërdorime dhe parregullësi. Një nga këto shfaqje të kundërta me rregullat kishtare është edhe martesat civile, që është lidhur pa lutje zyrtare dhe pa leje të klerikut, kurse i cili duket i afërt me besimin islam. Që kësaj t'i dilet në fund, bashkëshortët janë përjashtuar nga bashkësia deri sa nuk fillojnë të veprojnë sipas kanoneve kishtare dhe rregullave bazore.143) Rrethanat shoqërore të shekullit XVII dhe faktorët tjerë, në të cilët dëftuam më lartë, i treguan me bollëk rezultatet e veta: numri i popullatës së krishterë ka filluar në mënyrë rapide të bjerë. Për 146

periodën prej tridhjetë vjet, që mendohet i shkurtër për popullin e vogël, d.m.th. prej vitit 1620 deri më 1650 /1030-1060 H. tregohet se islamit e kanë pranuar deri në 300.000 Shqiptarë.144) Në tërë dioqezën tivarase në vitin 1624 kanë qenë vetëm dy mijë katolikë. Në vetë qytetin ka mbetur vetëm një kishë dhe para fundit të atij shekulli kisha erdha në gjendjen e atillë sa nuk është përdoruar për liturgjitë e krishtera, sepse në qytet nuk ka pasur të krishterë pos vetëm dy familje.145) Diç ë vonë, më 1651/1062 H., marrë në përgjithësi, shumicën e kësaj ane e përbënin femrat. Shkallërisht gjendja e krishterizmit bëhej gjithnjë e më dobët. Katolikët numerikisht filluan të humbin: proporcioni i njëjës palë pothuaj dyfishë ka rënë. Mashkujt e krishterë me turma e lëshonin krishterizmin dhe e pranonin islamit.146) Kurse 100 vjet para kësaj të krishterë ka pasur dhjetë herë më tepër se sa muslimanë.147) Të krishterët e kryepeshkopatës së Durrësit numerikisht kanë rënë në gjysmë.148) Krishterizmi i dioqezës së Krujës gjatë tridhjetë vjetëve e përqafoi islamit.149) Klerikët e ulët, në kundërshtim me udhëzimet e eprorëve të vet, deri sa masës ia lexonin meshën nga një anë, nga ana tjetër nëpër gishta ka shikuar se si kjo të gjithë njëri pas tjetrit deklaronte konvertizmin e vet në islam. Rezultat i kësaj ka qenë ky që fëmijët e tyre përgjithmonë kanë qenë të humbur për kishën e krishterë.150) Edhe popat e fshatrave, të cilët nëpër gishta shikonin se si prindërit e krishterë po i kurorëzojnë vajzat e tyre për muslimanët, iu kanë ndarë kungatë këtyre grave,151) dhe kjo gjendje, përkundër mallkimeve të klerikëve të lartë, sipas dëshirës së klerikëve ka vazhduar.152) Shumica e klerikëve të ulët janë akuzuar për jetë të pamoralshme. Rrallë shkonin në ritualin e rrëfimit, madje në banesat, veçan të caktuar për popat, janë organizuar gosti. I kanë shitur pasuritë kishtare dhe, duke i lëshuar detyrat e veta shpirtërore, tërhiqeshin në skaj. Kur merrej vesh për ata që për këtë gjendje kanë mund të thirreshin në përgjegjësi, këta strehoheshin nën patronazhin e

Turqëve.153) Edhe françeskanët e arsimuar, që ishin dërguar në plotësimin e nevojave shpirtërore të popullit, nuk kanë ngecur në grindje dhe luftëra, të cilat shpesh vinin edhe deri në gjyq, kurse kjo ndodhte para përbuzjes popullore me çmimin e mospërfilljes së detyrave.154) Famullia Pullati vetëm njëherë ka mund ta sheh fytyrën e peshkopit në tridhjetë vjet, kurse atje kanë banuar rreth 6000 të krishterë.155) Madje ka pasur famulli në brendi që nga 40 vjet nuk kanë pasur asnjë klerikë. Më në fund janë dërguar katër françeskanë që të

147
ndërmarrin masat e nvojshme kundër kësaj gjendjeje. Këta në raportet e veta zyrtare, të drejtuara qendrës shpirtërore, kanë njoftuar se nuk kanë pasur kurrfarë pengese nga ana turke deri sa e kanë vizituar atë anë dhe e kanë kryer misionin e vet.156) Peshkopi shkodran, i cili ka qenë despot edhe më sytë e klerikëve të nënshtruar edhe në sytë popullit, është orvatur me anë të Turqëve të mbahet në këtë pozitë.157) Kuptohet sedinjitarët kishtarë, sipas fermanit mbretëror, kanë tubuar të ardhurat nga populli në famullitë e veta.158) Kryepeshkopi në Tivar, i cili ishte në atë pozitë ndërmjet vitit 1599 dhe 1607, ka marrë haraçin nga çdo familje e krishterë nga 2 aspra, nga çdo kurorë e parë nga 12, në rast të kurorës së dytë 24, e nga i treti nga 40. Për arritjen e këtij haraçi në të gjitha famullitë, në rst nevojë, iu drejtoheshin nëpunësve turqë për ndihmë.159)

Në brendi të tërë Shqipërisë nuk ka pasur madje asnjë shkollë të krishterë.160) Edhe vetë popat dobët kanë lexuar e shkruar. E vërteta, disa prej tyre janë dërguar në Itali për studime, por shkuarja e tyre në këkë të vend rezultonte me dë, sepse ata popa që atje shkuan për shkak të shkencës, duke u mësuar në jetë më komode, nuk dëshironin të kthehen në vendlindje. Deri sa klerikalizmi ishte në mosdijen e këtillë dhe deri sa kështu letargjisht ishte në kryerjen e detyrave, nuk është për t'u çuditur që bota e rëndomtë nuk ka ditur as principet themelore të fesë. Prandaj, për shkak të abuzimeve dhe prishjes është kryer-sipas fjalëve të një kleriku të lartë të këtushëm - "plaçkitja më e madhe e kopshtit hyjnor".161) Shumë të krishterë me vite kanë jetuar në konkubinatat, e nganjëherë e kanë aplikuar edhe poligaminë.162) Përkundër këtyre rrethanave, popat njerëzit e tillë i kanë pranuar në kungatë.163) Në aspekt të poligamisë të krishterët dhe muslimanët aq janë përzier sa që për shkak të kësaj përzierjeje, i kanë marrë muslimanët pë rrunë me rastin e kryqimit të fëmijëve dhe veçanërisht ndaj besimit të vjetër të shtrembër i janë adaptuar kryqimit të fëmijëve muslimane.164)

Ja, e këtillë ka qenë gjendja e kishës së krishterë kah fundi i shekullit XVII në Shqipëri. Madje edhe shkasi më i vogël ka mjaftuar për ndërrimin e fesë. Edhe nënshtrimi i katolikëve, të cilët në shekullin e njëjtë kanë organizuar kryengritje, është një nga faktorët e mjaftueshëm mpër forcimin e afinitetit drejt islamit, kurse largimit nga

kisha. Kryengritja në të cilën aludohet këtu është ajo që e ka organizuar kryepeshkopi tivaras Gjorgji, që gjendej në atë pozitë 148

shpirtërore ndërmjet vitit 1635 dhe 1644. Gjorgji u përpoq me ndihmën e peshkopit në Durrës, Shkodër dhe Alsonë t'i trazojë krerët e krishterë kundër pushtetit turk dhe t'u rekomandojë që t'i bashkangjiten Venedikut (Mletasëve). pasi atëherë Republika Mletase ka qenë në paqë me Turqinë, për sendërtimin e kësaj kryengritjeje është ofruar rasti vetëm në vitin 1645/1055 H., kur lindi lufta ndërmjet Turqisë dhe Venedikut. Venedikasit u përpoqën ta kthejnë Tivarin, të cilin para pushtimit turk e kanë mbajtur 300 vjet në duart e veta, por fushata nuk u pati sukses. Shqiptarët e krishterë, pasi pajtoheshin me armiqtë e Turqisë dhe fshehtas i ndihmonin, patën merituar denimin, dhe i humbën privilegjet e veta të vejtra. Kurse ortodoksët - pasi janë frikësuar që atje sërish mos të vëndoset pushteti venedikas, dhe në pajtim me këtë pasi i kanë mbetur lojal Turqisë - kanë fituar autoritet dhe mirënjohje të veçantë që kanë mbetur besnikë. Me këtë rast shumë katolikë kanë përqaftuar islamin ose i janë bashkangjitur kishës lindore. Bashkangjijtja e tyre kishës lindore është me rëndësi. Kjo dëfton se anëtarëve të një populli nuk i është bërë dhunë për shkak se kanë qenë të krishterë as qëishte ndërmarrë diç me dhunë që me forcë të kthehen në islam. Katolikët, që e përqaftuan islamin, e kanë ndërruar fenë që të shpëtojnë nga pozita e keqe, në të cilën kanë rënë për shkak të mossuksesit të ndërmarrjeve të tyre kryengritëse. Këta do të mund ta arrinin qëllimin e njëjtë sikur t'i bashkoheshin kishës lindore, autoriteti i të cilëve në Tivar atëherë edhe më tepër u rritë. Sikur mos të kishin vepruar në këtë mënyrë, kjo dëshmon se ata mjaft dobët kanë qenë të përkushtueshëm ndaj krishterizmit. Vërejtja e njëjtë vlen edhe për ata të krishterët e shumënumërt të cilët në vitet e fundit e kanë përqaftuar islamin. Zmajeviqi i cekur shkruan se këta kanë ndërruar fenë që të shpëtojnë nga haraçi, por, si e shpjegojmë këtë më lartë, duket se ka pak mundësi se këtë e kanë bërë nën presion. Një kryengritje u paraqit edhe në vitin 1646. Nismëtar i saj ka qenë kryepeshkopi me emrin Jozef Bonaldo. Ka konkluduar fshehtas me krerët e Tivarit, Shkodrës dhe vendeve të tjera që t'i hapin dyert e qyteteve të veta Venedikasve, por megjithatë as atëherë nuk u sendërtua qëllimi i kryengritësve. Ushtria turke e shtypi kryengritjen, kurse në këtë e kanë ndihmuar edhe ata nga popullata e krishterë që kanë qenë kundër kryengritjes. Shumë Shqiptarë, ndikimi i të cilëve do të mund të ishte i rrezikshëm, janë internuar në brendi të Turqisë. Rreth tre mijë kanë kaluar edhe në tokën venedikase. Të tjerët kanë 149

rënë në frikë dhe kanë qenë të detyruar të paguajnë për jolojalitetin e tyre gjoba të rënda të caktuara për të rriturit.165)

Është e mjerueshme ajo që autorët e krishterë, që flasin se

Shqiptarët me presion të dhunës dhe haraçeve të paligjshme janë detyruar në ndërrimin e fesë,166) i përdorin shpesh shprehjet e përsëritura. Këta autorë nuk na ofrojnë të dhënat se ankesat e tyre a janë të provuara me fakte apo jo. Zmajeviqi i fillon shpjegimet e veta mbi konversionin e dy mijë njerëzve me numrimin e tatimit dhe të dhënave tjera, me të cilat kanë qenë të ngarkuar të krishterët, por pranon se edhe muslimanët i kanë dhënë tatimet e njëjta përveç tatimit personal (xhizjes). Shkruan se ky tatim personal ka qenë 6 talira në vit për personin mashkull,167) dhe shpjegimet e veta kështu i përfundon: "Populli ka qenë i plagosur me këto tatimenë vendin më të ndieshë, d.th. në interesin e kësaj bote. Marrja parasysht e këtij interesi rrjedh nga nevoja ose nga instinkti i jashtëzakonshëm natyror, dhe këta 2000 njerëz, që hoqën dorë nga feja e vet, që t'i shpëtojnë haraçit, ka pasur të drejtë të heq vështirësi.168) Në theksimet e këtij autori pohohet se shumë kanë kaluar në islam për të shpëtuar nga haraçi, e megjithatë nuk shihet asnjë provë për padurimësinë aq të madhe të tatimeve që i kanë paguar katolikët që të detyrohen ta ndërrojnë fenë.

Nuk mund të priten në raportet e një kleriku shpjegimet për riniciativat e ndërmarra të muslimanëve për arritjen e konvertitëve të krishterë. Vetëm në një krahinë, për shkak të kontakteve me Turqit (muslimanët), shihet aluzioni në atë "se i ka kapluar e keqja e pabesimtarëve". Njëkohësisht veçan ceket shkaku se këty janë larguar nga krishterizmi që të mund të martohen me Turkeshat.169) Nuk ka dyshim se këtu ka qenë majft i fuqishë mndikimi islam. Po ashtu ka aluzione se të krishterët kanë qenë të ekspozuar rrezikut të ndërrimit të fesë për shkak të mungesës së udhëheqësve fetar, popave, në vendet të quajtura Biskashi dhe Bazi, ku ka pasur rreth 1000 banorë të përzier.170)

Zmajeviqi thekson se në krye të një familjeje bujare të banuar në rrethinë të Tivarit, kanë qenë dy vëllezër dhe se më të vjetrin kushërinjt e tij muslimanë nga ky vend e kanë lutur ta ndërrojë fenë. Në fillim cek se më i riu ka pasur afinitet dhe aftësi për profesionin e popit. ("Pasi Turqit familjen e tij e kanë konsideruar me ndikim, si pop ka mundur shumë shërbime t'ua bëjë të krishterëve, ndonëse nuk ka qenë i pasur.")171) Pa dyshim, edhe këto fjalë dëshmojnë se

150
muslimanët - shpesh për shkak të krishterizmit të tyre - nuk kanë vepruar keq me të krishterët, përveç nëse të krishterët nuk tregoheshin politikisht të dëmshëm. Zmajeviqi me prejardje është shqiptar. Për dallim nga peshkopët tjerë nuk është vendosur në dheun venedikas por, duke u kthyer në vendlindje, atje ka jetuar.172)

Deri sa ka qenë atje, vetëm që është pranuar mirë nga ana e nëpunësisë turke, por edhe nga ana e pashës më të lartë në Shqipëri. Pasha në divanin e vet i ka dhënë vend të posaçëm, dhe kur përndryshe e vizitonte, ai e përcillte deri te dyert.173) "Ky barbar, që

nuk i gjason Turkut por të krishterit bujar", ky pasha musliman, në lytjen e kryepeshkopit duke dhënë urdhër që të kthehet të merrë tatimin për vitin vijues popullatës së përzier të katër qytezave, 174) ka treguar me këtë mirëkupti mkundruall gjendjes materiale të të krishterëve. Nëse është vepruar keq me ndonjë klerik, kjo në ëtë shumtën e rasteve ka ndodhur për shkak të dyshimit të letërkëmbimit tradhtues dhe ndërsimit (nxitjes) me armiqtë e Turqëve. Udhëtimi i shpeshhtë i klerikëve në Itali, me arsye i ka dhënë vend këtij dyshimi, përndryshe duket se nuk ka shkaqe të sigurta për ankesat e klerikëve në vepriemt e këqia të muslimanëve me ta. Zmajeviqi thotë se madje edhe kishtarët e imtë kanë gëzuar së tepërmi dashuri dhe konsideratë të dinjitarëve të lartë turqë. 175) Shembull i ngjashëm është parë edhe në Bosnje, në famullinë zenicase. Një klerik, që ka qenë atje në shekullin XVIII, për shkak të shoqërimit të vet intim me muslimanët ka nxitur dyshimin se synon ta përqafojë islamin, dhe për këtë arsye peshkopi i tij kompetent nën mbikqyrje e ka dërguar në Romë. 176) Konvertimet e shumta në historinë e Shqipërisë, që kanë ndodhur në shekullin e XVII, nuk janë vërejtur në kohët e mëvonshme. Mirëpo, edhe sot e kësaj dite ndodhin rastet individuale të konversionit. Epërsia numerike e muslimanëve në viset e Toskëve, në Shqipërinë jugore, ka shpjerë deri te cungimi i interesit të popullatës së krishterë. Kara-murtatët (tradhtarët e zi), të cilët e përbënin bashkësinë prej nga 30 fshatrash në rrethinën e Pogomnjanit, kanë qenë deri në shekullin XVIII në krishterizëm. Pasi nuk kanë pasur fuqi të mjaftueshme që t'u kundërvihen sulmeve të përhershme të fqinjve të vet muslimanëve, banorëve të Leskovikut, janë grumbulluar në kishë dhe filluan t'i lusin shpirtërat e të shenjtëve të krishterë që t'i shpëtojnë. Janë zotuar se do të agjërojnë deri sa nuk u vjen ndihma shpirtërore, më së largu deri në ëKërshëndella. Më në fund erdhën edhe Kërshëndellat, kurse çudia e

151
pritur nuk ndodhi. Për këtë janë zemëruar dhe, duke e lëshuar krishterizmin, e kanë pranuar islamin, dhe duke i kapur armët pas konvertimit të tyre, kanë mësyre në armiqtë e vet të vjetër, i kanë mbytur dhe i kanë konfiskuar pasuritë e tyre. 177) Duket se feja e përbashkët nuk ka mundur të ëndikojë në çështjen e gjakmarrjes ndërmjet fiseve arbanase. Madje deri në shekullin e XIX shumë fshatra e fise për shkaqe të vogla kanë ndërruar fenë. Disa fise të krishtera kanë përqafuar islamin, sepse popi, që atje punonte në shërbim shpirtëror, ka insistuar, që në kohë të papërshtatshme, shumë herët, të vijnë në lutje të përbashkët. 178)

Në kohët më të vonshme llogaritet se në Shqipëri ka një milion muslimanë, e të krishterë gjysma, vetëm se ky numër nuk është aq i sigurtë. Tërë fisi Mirëditë është katolikë. Këta i kanë dhënë fjalës sulltanit me kusht që asnjë muslimanë nuk guxon të banojë në territorin e tyre, por ithtarë të këtyre dy religjioneve ka pathuaj në të

gjitha fiset tjera. Mund të thuhet se gati tërë Shqipëria e mesme është muslimane. Muslimanët në Shqipërinë e veriut paraqesin 60% të popullësisë së atjeshme. Sa i përket popullësisë së krishterë, me përqindje janë më të fortë në Shqipërinë jugore, e sidomos në viset kufitare me Greqinë.*)

Islam në Serbi

Për herë të parë Serbia në vitin 1375/777 H. ka filluar të paguaj haraç, kurse në vitin 1389/792 H., pas humbjes së tmerrshme në Kosovë, e ka humbur mëvetësinë e vet. Në fushëbetëjën e Kosovës i kanë lënë jetat edhe mbreti serb edhe sulltani. Trashëgimtarët e këtyre sunduesëve kanë lidhur marrëveshje. Princi i ri serb Stevani e pranoi protektoratin turk mbi Serbinë. Edhe motrën e vet e martoi për sulltan Bajezidin, dhe në pajti me këtë u lind njëfarë vëllezërie ndërmjet tyre. Në përlëshjen e Nikopojës (1394/787 H.) që iu siguroi Turqëve sundimin në siujdhesën Ballkanike pos Stambollit, fati i luftës i luhatur i fuqive ndihmëse serbe patë anuar në anën turke. Në përlëshjen trimërore në fushën e Angorës (1402/805 H.), kur Timurlenku e shkatërroi fuqitë turke dhe e robëroi Bajezidin, ka qenë i pranishëm Stevani me forcat serbe dhe ka qenë dëshmitar i shkatërrimit të dhëndërrit të vet. Stevani, në vend që ta shfrytëzojë humbjen e Turqëve, i ka mbetur besnik fjalës së dhënë, dhe ka qenë në 152

miqësi me bijtë e Bajazidit deri sa nuk e kthei fronin e humbur të babait të vet. Nën Gjorgje Brankoviqin, i cili e trashëgoi, Serbia ka pasur një lloj të gjysmëpavarësisë, por ky njeri e ngriti masën në kryengritje në vitin 1438, dhe Turqia për së dyti e shkeli Serbinë. Diç më vonë Serbia që e detyruar ta pranojë protektoratin hungarez, por pas humbjes së Ivan Hunuiadit në vitin 1444 në Varna, Serbia edhe njëherë ra nën haraç dhe më në fund në vitin 1459/864 H. u bë krahinë e Imperatorisë Turke.

Ata Serbë që janë konvertuar paj betejës në Kosovë duket se kanë ditur për fatin e bashkësisë së vogël islame, e cila para kësaj nja 100 vjet ka jetuar në Hungari dhe plotësisht që çrrënjosur, sepse duket e pamundur që kjo njohje nuk ka pasur ndiki në prioritetin e tyre Turqisë kundruall Hungarisë. Fati i kësaj bashkësie islame është ky: Në vitin 1228/626 H. Jakut Hameviu, duke qëndruar në Halep, është takuar me disa që i kanë takuar kësaj bashkësisë së vogël të Evropës së mesme. Sipas të dhënave në këtë pikëpamje flokët dhe fytyra e këtyre muslimanëve janë të kuqrrrema. Quhen pjesëtarë të fisit Bashkir. Në Hakep i dëgjonin ligjëratat e fikhut (të drejtës) së drejtimit të Ebu Hanifes. Jakuti, duke e cekur kuvendimin me ta, thotë: "Njërin nga ata, që më duhej inteligjent, e kam pyetur për shumëçka për vendin e tij. Ai m'i ka dhënë njoftimet vijuese: - Vendi ynë atje më tej pas Stambollit i përket mbretërisë së popullit që quhen Hungarezë. Ne jemi muslimanë dhe jemi shtetas të mbretit të tyre.

Viset ku jetojmë gjenden afër kufirit të mbretërisë. Kemi 30 fshatra, që sipas madhësisë do të mund të quheshin qyteza. Por mbreti nuk na lejon që rreth tyre të ndërtojmë mur, duke iu frikësuar mundësisë që mos të ngritemi në kryengritje. Gjendemi në gjendje të ngushtë në mesin viseve të krishtera. Nga veriu i kemi Sllavenët, e nga jugu papatin, ajo papëri që është kryeparë i të gjithë Frankovitëve*) dhe, në sytë e tyre, zëvendës i Mesiut. Në perëndim i kemi viset që janë të ngjitura me Andaluzinë, kurse në lindje i kemi krahinat e Bizantit. Gjuha jonë është nga gjuhët frankovite. Edhe veshemi sipas mënyrës së tyre. SHërbejmë me te së bashku në ushtri dhe sulmojmë së bashku në armiqtë e tyre, sepse edhe armiqët e tyre janë kundërshtarë të islamit. - Pas kësaj e kam pyetur se si ata, kështu të ngushtuar ndër të krishterët, e kanë përqaftuar islamin. Ai m'u përgjeggj: - Sipas gojëdhënës sonë, kanë ardhur shtatë muslimanë nga viset e Bullgarisë dhe u vendosën në mesin tonë. Këta me mjaft butësi dhe njerëzi na

153

kanë tërhequr vërejtjen në mashtrimet tona dhe na treguan rrugën e drejtë të islamit. Më vonë i Gjithëhartësuar i na ka qenë udhëheqës, na ka hapur zemrat drejt fesë së lartësuar. Të gjithë kemi ndërruar fenë. Kemi ardhë në këtë vend që ta mësojmë mësim-besimin. Kur të kthehemi në vendin tonë, neve populli do të na konsiderojë. Ata do të na besojnë udhëheqjen fetare."179)

Islami ka mundur të ekzistojë në mesin e këtyre Bashkirëve në Hungari deri në vitin 1340/741 H. Atëherë mbreti hungarez Karlo Roberti i ka detyruar shtetasit e vet, që nuk kanë qenë ende të kryqar, që të kryqohen os eta lëshojnë shtetin e tij.180)

Muslimanët në Serbi, sikur edhe vendasit e tyre të krishterë, shpëtuan nga sundimi hungarez. Kështu kur u gjetën para alternativës: ose sundimin e Hungarezëve katolikë ose sundimin e muslimanëve Turqë, këta i kanë dhënë prioritet - pasi Serbët i janë fuqishëm lojal kishës lindore - sundimit tolerant musliman ndaj sundimit të Latinëve (katolikëve), e cila është e pashoqërueshme dhe plotë frymëzim të konvertimit tiranik. Një tregi mi vjetër në këtë aspekt na paraqet ndjenjat e atëhershme kështu: "Gjatë kohës së luftës ndërjet Hungarezëve dhe Turqëve sunduesi serb Gjorgje Brankoviqi e pyeti Huniadin: - Nëse fiton, si do të sillësh me ne? - në çka mori përgjigjen: Do ta konstituojmë katolicizmin. Pastaj iu drejtua sulltanit. - Nëse e arrini fitorën, ç'do të ndërmerrni kundër fesë tonë? - Pranë çdo xhamie do të mund të gjendet nga një kishë; sido kush dëshiron do të mund të lutet - mori përgjigjen.181) Një kohë pas kësaj garnizoni i kalasë së Beogradit nga intrigat e popave serbë ka qenë e detyruar t'ia dorëzojë turqëve.182) SHumë më vonë popullata e Smederevës në Danub i ka dalur përpara ushtrisë turke, dhe Turqit i shpëtuan nga sundimi i fqinjëve të tyre katolikë.183)

Përhapja e islamit në mesin e serbëve fillon pas betejës në Kosovë.

Një pjesë e konsiderueshme e atyre nga familjet e vjetra feudale, që e kanë mbijetuar betejën e Kosovës ose që nuk janë shpërngulur në shtetet fqinje të krishtera, vullnetarisht e ka përqafuar fenë e Muhammedit a.s. që t'i ruaj të padëmtuara privilegjet e veta të veçanta.184) Mirëpo, sulltanët në këta bujarët, që në mënyrën e tillë janë konvertuar, kanë gjetur propaganduesit më të zellshëm për përhapjen e islamit,185) por megjithatë shumica e popullësisë në Serbi, përkundër fatkeqësive, i ka mbetur besnike fesë së vjetër. Në mesin e popullësisë së Serbisë së vjetër186) që për turqit paraqiste pjesën lindore 154

të Shqipërisë - të shpeshta kanë qenë rastet e konvertimit. Islami në këto vise shkallërisht ka përparuar deri në shekullin e XVII. Në atë kohë Austrianët i kanë nxitur Serbët në kryengritje, por pasi Turqit e shkelën këtë trazirë, kaluan në Hungari me patrikun Arsenije Çarnojeviqin III rreth 40.000 familje serbe. Grupa tjetër i refugjatëve prej 15.000 familjeve u shpërngulë në vitin 1729, dhe në këtë anë kanë mbetur shumë pakë autoktonë.187) Kolonistët shqiptarë, që vinin nga jugu, filluan t'i popullëzojnë këto anë të lëna. Gjatë kohës së popullëzimit të këtyre Shqiptarëve, ata pothuaj të gjithë ishin katolikë, por pasi u vendosen në Serbi, shkallërisht e kanë pranuar islamin. Ndonëse në kohët e fundit pjesa e mbetur e katolikëve Shqiptarë paraqet pakicë të vogël, megjithatë numri i tyre është rritur me shpërnguljen e atyre nga kodrat e larta. Mirëpo, edhe këta shkuan pas shembullit të Shqiptarëve të krishterë që erdhën para tyre, dhe shkallërisht u islamizuan.188)

Pas shpërnguljes së Shqiptarëve islami shpejtë u përhapë në mesin e popullësisë së mbetur serbe. Përndryshe, popat serbë kanë qenë mjaft të paarsimuar. Me shumë vështirësi i kanë lexuar librat e lutjeve. Duhet se të arsimuar pothuaj nuk ka pasur. Ata nuk kanë mundur t'i predikojnë popullit, kurse as katekizmin nuk kanë dijtë t'ua mësojnë të tjerëve. Për këtë shkak madje ka qenë vështirë të gjeshë një të vetmin njeri në tërë fshatin që e ka ditur lutjen "Ati ynë" ose numrin e urdhërave të shenjtë.189) Për shkak të kryengritjes, që filloi në vitin 1689/1101 H., Porta e Lartë e emëroi në Pejë patrikun e ri serb, por për shkak të kryengritjes së sërishme në vitin 1737/1140 H. tërësisht është hequr patrikana e Pejës, kurse kisha serbe i është bashkangjitur patrikanës greke.

Pas kësaj filluan t'i mbushin kishat serbe me popa grekë, të cilët së bashku se bejlerët dhe pashatë filluan t'ua thithin gjakun popullatës së mjerë të krishterë Serbëve u qe ndaluar gjatë lutjes të shërbehen me gjuhën nacionale. Librat e vjetra fetare, të cilat kanë qenë të shkruara sllavisht, janë grumbulluar dhe janë dërguar në Stamboll.190) Nuk duhet çuditur se krishterizmi i atjeshëm, duke jetuar në këso rrethanash dhe nën udhëheqjen e popave të këtillë, ka filluar të bjerë. Edhe pse është islamizuar qysh para shpërnguljes (së Çarnojeviqit,

vër. N.I.) ana e Gorës, që i takon Prizrenit, megjithatë familjet e krishtera të mmbetura, të shkapërderdhura, disa herë i janë drejtuar peshkopit grek në Prizren dhe kanë kërkuar , por nuk u është 155

ndihmuar. Kështu fëmijët e atjeshëm kanë mbetur të pakryqar, martesat dhe varrimet e të vdekurve kanë mbetur pa shenjtërim kishtar, kurse vendet e shenjta kanë filluar të shndërrohen në gërmadha.191) Duket se banorët muslimanë të rrethinës së Opojës, që sot janë rreth 9000, shumica janë nipër të popullatës së vjetër sllavene.192) Në fillim të shekullit XVII - shkruan Marko Bizi - në Gjakovë ka pasur rreth 120 familje katolike, 200 greke, e po atë edhe muslimane.193) Njëqind e dhjetë vjet më vonë, popullata e çdo shtëpie është konsideruar islame, sepse eprorët e pranve familjare kanë pranuar islamin, vetëm disa fëmijë dhe gra kanë mbetur me emrin e krishterë. Popullsia e fshatit Leqores kah mesi i shekullit XVIII ka qenë katolike; deri sa në vitin 1863/1280 H., nga 80 familje të tyre kanë mbetur vetëm 25 në krishterizëm. Më në fund, si popullsia e këtij fshati, ashtu edhe e fshatrave fqinje, e kanë lëshuar plotësisht krishterizmin.194) Ndonëse deri para pak kohësh në fshatra janë vërejtur disa nga traditat e vejtra krishtere, siç është ndezja e buzrave, të cilët special i sillnin nga mali, megjithatë edhe këto tradita nga pak po zhduken.

Islami në Mal të Zi

Serbët, që nuk deshën pas thyerjes së mbretërisë në Kosovë t'u dorëzohen Turqëve, dhe të cilët kanë dëshiruar të jetojnë në liri, janë strehuar në viset e egra dhe malore të Malit të Zi. Nuk kemi për qëllim të lëshohemi në studimin e historisë së këtij fisi trim, i cili, duke luftuar me shekuj nën udhëheqjen e kryeparit shpirtëror dhe botëror, 195 është orvatur ta ruaj në male, për kundër furtunave dhe forcës, njëfarë shteti të krishterë, përkundër asaj që bashkëfistarët e tyre kanë rënë nën pushtetin islam. Tek ata themeli i mëvetësisë dhe individualitetit nacional është lojaliteti i fortë fesë së krishterë. Natyrisht, nuk mund të pritet depërtimi i lehtë i islamit në mesin e tyre. Megjithatë shumica të vendosur në kufirin e Malit të Zi në shekullin e XVII kanë kaluar në islam dhe kanë hyrë në shërbim të peshëve nga vendet e afërta. Por në vitin 1703/1115 H., peshkopi Petroviq,*) që ishte në krye të shtetit, i ka ftuar në kuvend anëtarët e të gjitha fiseve dhe u ka thënë që për rekzistencën e shtetit dhe fesë së tyre nuk ka rrugëdalje tjetër pos t'i shkatërrojnë muslimanët, që gjenden në mesin e tyre. Në pajtim me këtë, ata Malazezë që nuk 156

dëshiruan ta lëshojnë islamin dhe të kthehen në krishterizëm, gjakëftohëtishtë gjatë një Kërshëndeje një nga një janë mbytur.196)

Islami në Bosnje dhe Hercegovinë

Kalimi i bogumilëve në islam

Për vëmendje të veçantë janë rrethanat religjioze dhe sociale të këtij vendi para pushtimit turk. Shumica e popullësisë së atjeshme i përkiste sektit heretik të krishterë të bogumilëve. Këta skizmatikë prej shekullit XIII kanë qenë të nënshtruar persekutimeve të papave. Madje papët kundër tyre disa herë kanë rekomanduar luftë kryqtare.197) Papa Ivani XII në një letër mbretit boshnjak shkruan:

“Djali ynë i dashur, princi boshnjak i vlefshmi Stevan! E dijmë, se je bir besnik i Kishës. Për këtë arsye presimm ndërmjetësimin tënd në shkatërrimin e heretikëve në vendin tënd. Presin se do t’i ndihmoshë inkuizitorit tonë Fabiusit, sepse renegatët (heretikët) e konsiderojnë Bosnjën vend të shëndoshë. Janë tubuar nga anët e ndryshme të botës dhe dëshirojnë që atje ta mbjellin farën e mashtrimit neveritës. Këta njerëz, të mësuar në intrigat e Luciferit (Iblisit) të vjetër, të armatosur me helmin e modestisë së rrejshme, nën maskën e krishterizmit përpiqen t’i helmojnë mendjet e katolikëve. Fjalët e tyre futen pors i kanceri. Vegimisht janë të dëlirë, por në fshehtësi janë të gatshëm edhe në mbytje. Këta janë ujqër në formë qengjash. T’i gjuajnë dhe t’i mashtrojnë kopetë me shpirtëra modestë të Jezusit, e fshehin egërsinë e vet.”

Vuajtjet që i kanë pësuar bogumilët në shekullin e XV janë bërë aq të padurueshme sa që për ta shpëtuar veten i janë drejtuar Turqëve për mëshirë, sepse sjelljet dhe presionet e vrazhda të mbretit boshnjak dhe klerikëve kanë qenë të atillë që nuk kanë shembull. Dyzetë mijë prej tyre kanë ikur në vendet fqinje. Ata që nuk kanë ikur janë dërguar në Roë, të pranguar në zinxhirë. Mirëpo, këto masa të tmerrshme pak shërbim i kanë kryer zvogëlimin të bogumilëve në Bosnje, sepse flitet se kjo herezënjëjtë ka qenë e fuqishme edhe në vitin 1462/867 H. Vitin vijues, kur sulltan Mehmedi II e nënshtroi Bosnjën, katolikët e atjeshëm e lëshuan vendin e vet. Çelësat e Bobovcit, kryeqendrës së mbretërve, ia dorëzoi Turqëve mëkëmbësi i tij që ishte bogumil. Pasi që edhe vendet tjera dhe fortifikatat shkuan pas tij, për një javë sulltanit i ranë në duar rreth shtatëdhjetë vende të fortifikuara

157
(pallanga). Mehmedi II ia bashkangjiti edhe Bosnjën viseve të tjera të pushtuara.198)

Pej atëherë më nuk dëgjohet fare për bogumilët. Mendohet se me pushtimin turk me shumicë e kanë përqaftuar islamin. Shumica e katolikëve është shpërngulë në Austrinë dhe Hungarinë fqinje, kurse për të tjerët mendohet199) se shumë prej tyre kanë ndjekurshembullin e konvertitëve purarendës. Disa Evropianë kanë supozuar se konvertimet e shumënumërta të bogumilëve në islam ka qenë në fillim të pushtimit turk me atë qëllim që të kthehen në sektin e vet të veçantë, posa në ardhmëri t’u ofrohet rasti. Si provë për këtë pohim ata cekin se bogumilët, për shkak të pësimit dhe presionit lartë të përmendur, gjetën rrugën të përshtatshme se si qëllimisht do ta

mohojnë fenë e vet të vjetër (katolicizmin), dhe pasi që në të ardhmen nuk iu ofrua rasti i prituri në kthim, më në fund qëllimi i të parëve të tyre është harruar. Rëndom supozimi i këtillë është vetëm hamendje, dhe se në këtë, si provë e pakontesueshme, nuk mund të mbështetet. Ne e konsiderojmë arsye më të fortë atë që bogumilët të përzier me muslimanët kanë anuar kah islami për shkak të shumë pikave në besimin e tyre që i gjasojnë mësimi islam. Bogumilët kanë refuzuar adhurimin e Marves, institucionin e kryqimit dhe të gjitha llojet e klerit.200) Kryqin, si simbol të fesë, e kanë urrejtur. E kanë konsideruar idhujtari drejtimin e lutjeve fotografive dhe statujave të të shenjtërve dhe relikeve (fuqive). Përkundër kishave katolike, të cilat jodenjësisht janë të dekoruara me fotografi, tempujt e tyre kanë qenë modestë dhe të thjeshtë. Sikur edhe muslimanët, kanë pasur mendim të keq për kombanat e kishës, të cilat i kanë quajtur "buria satanike". Kanë besuar se nuk është gozhdur Jezusi personalisht, por se kjo ka qenë ndonjë figurë iluzore, dhe se në këtë aspekt pjesërisht janë pajtuar me Kur'anin.201)

Gjykimi i alkoholit dhe prirja jetës asketike dhe modestisë bëjnë pjesë në ato rrethana që kanë shërbyer afrimit të bogumilëve me islamin.202) Edhe ata luteshin pesë herë në ditë. Shpesh herë binin në gjunjë dhe kanë shprehur mirënjohje Zotit.203) Në pajtim me këtë, për pjesëmarrjen e tyre gjatë lutjes në xhami duhet se nuk është dashur ndryshim i madh.

Këtu i kam grumbulluar disa pika që janë të ngjashme me dispozitat e islamit, kurse të cilat gjenden në sektin skizmatik të bogumilëve. Mirëpo, në besimin bogumil ka edhe pika të atilla që

158
përmbajnë formën e rregullave të krishtera që muslimanët e devotshëm nuk mund t'i konsiderojnë të denja për t'i pranuar. Deri sa pikat e përbashkëta janë kaq të shumënumërta, mund të përfundohet se janë bindur në nevojën e lëshimit të shkallërisht më të atyre besimeve të cilat islami nuk i duron. Besimi i tyre, i ngjashëm me dualizmin e maniheistëve, nuk ka mund të pajtohet me besimin e muslimanëve, por islami gjithnjë ka qenë tolerant ndaj gjykimeve të tilla religjioze, vetëm me atë kusht që ky këto pikëpamje skizmatike mos t'i deklarojë.

Turqit, që t'ua bëjnë më të dashur fenë e vet Boshnjakëve, sipas traditës së vet të njohur iu kanë rekomanduar me ofrimin e të gjitha llojeve të fitimeve materiale dhe shpirtërore. Të gjithë atyre që e përqaftonin islamin ua siguronin pronësinë e tërë pasurisë së tyre, kurse spahitë kanë qenë liruar nga tatimet.204) Është e mundur që shumë prej të islamizuarve i kanë takuar bujarëve dhe kanë qenë zotërinj feudal, dhe për shkak të herezës së vet ndaj katolikëve kanë qenë më parë të privuar nga ato të drejta. Më në fund, duke iu bashkangjitur fesë ngadhënjimtare, kanë gjetur rastin ta kthejnë

pasurinë e vet. Muslimanët boshnjakë e kanë ruajtur nacionalitetin e vet, dhe deri më sot kanë bartur mbiemra të krishterë dhe kanë folur me gjuhën nacionale.205) Njëkohësisht gjithnjë kanë qenë me zell dhe entuziazëm të përkushtuar fesë. Qëndrimi i vjetër kalorsiak i bujarëve muslimanë, lojaliteti i përkushtueshëm islamit, përveç influencës dhe fuqisë së tyre gjithnjë kanë tërhequr vëmendjen e veçantë mbi ata. Disave prej tyre u janë besuar vende të rëndësishme zyrtare. Natyrisht, ndërmjet vitit 1544 dhe 1611/951 dhe 1020 H., kanë zënë nëntë prej tyre kryesinë e qeverisë.

Islami në Kretë

Kjo ujdhesë përfundimisht në vitin 1669/1080 H. ka rënë në duart e Turqëve si rezultat i detyftimit njëzetepesë vjeçar të garuesve të Turqisë dhe Venedikut, pas luftës trevjeçare dëshpruese dhe rrethimit të Kandisë.

T'ia hedhim një vështrim ujdhesës Kreta.

Me këtë rast Kreta nuk ka rënë për herë të parë në duart e muslimanëve. Në fillim të shekullit IX këtë ujdhesë e ka pushtuar një grup avanturierësh që kanë ardhur nga Andaluzia. Pas kësaj ka mbetur 159

rreth 100 vjet206) në duart të muslimanëve, dhe pothuaj tërë popullsia e saj e ka përqafuar islamin. Kishat u qenë rrënuar ose janë shndërruar në xhamia. Por Kretasit, pasi vendlindja e tyre sërish është kthyer nën sundimin e Imperatorisë Bizantine, për shkak të predikimeve bukur të përshtatura të një monaku Armen, iu kthyen fesë së vet. Pas kësaj në Ujdhesë nuk ka mbetur fe tjetër përveç krishterizmit.207) Pas ndarjes së Imperatorisë Bizantine Kreta ra në pjesën e dukës mont-ferratas Bonifacit. Në fillim të shekullit XIII Venedikasit e blenë këtë ujdhesë dhe me dorë hekuri kanë sunduar me te. Dukej se prona e tyre e atjeshme u ka shërbyer vetëm interesave të administratës qendore dhe popullatës vendëse. Pasi udhëheqja e tyre ka qenë majft tiranike dhe despotike, për këtë ka rezultuar me kryengritje të shumta. Këto kryengritje me rreptësi të pamëshirshme janë shkelur. Për shkak të një prej këtyre persekutimeve rrethina e Lasitet dhe Sfakisë (Sphakia) është shkretuar. Në këto anë ka qenë e ndaluar të mbillet gruri me kërcënim të denimit me vdekje, dhe kjo tokë ka mbetur 100 vjet e papunuar.208) Që ta shuaj një nga kryengritjet, që shpërtheu në filli të shekullit XVI, veprimi drastik i senatit venedikas solli lemeri dhe fatkeqësi të re edhe ashtu Kretasëve të shkelur. Sa i rëndë ka qenë fati i tyre mund të kuptohet nga raporti i komisionit hetues të cilin e dërgoi në Ujdhesë senati venedikas. Si përmendet në këto raporte, bujarët venedikas nën presionin e vet despotik dhe të balozit i kanë shfrytëzuar fshatarët. Në cilësi të feudalëve këta zotërinj i kanë mbajtur në gjendjen më të keqe se që është robëria. Fshatarët, që kanë qenë sikur robërit të ekspozuar padrejtësive, janë gjendur në atë pozitë që nuk kanë pasur nga askush të kërkojnë mbrojtje. Çdo fshatar ose

punëtor ka qenë i detyruar në vit 12 dite të punojë angari pa pagesë zotëriut të vet, e pastaj ka mundur edhe çdo zotëri tjetër ta detyrojë që të punojë sa të dojë - sipas çmimit të tashëm për mëditjen prej nja gajshtëdhjetë-shtatëdhjetë para. Çdo pronar i vëreshtës ka marrë si denim të tretën e të ardhurave nga vëreshtat e fshatarëve. Megjithatë, diç me mashtrim, diç me kartel, nga prona e tyre dilte dy të tretat nga këto të ardhura. Feudali i tij i përdorte qetë e tij, mushkën e tij. Shkurtimisht, feudali i tij gjente një mijë mënyra se si fshatarin e varfër do ta eksploatojë.209) Protestat, që i ka dërguar komisioni hetues senatit venedikas që ta përmirësojë gjendjen e Kretasëve të pafatë dhe t'i jep fund dhunës së bujarëve, qenë të kota. Sa i përket Senatit, ai ka parashtruar rekomandimin e nëpunësit të veçantë të republikës në 160

Kretë, që ky e ka dërguar në vitin 1615 në lidhje me këtë koloni, domethënia e të cilit është kjo: "Nëse pronarët e kësaj kolonie sundojnë mbi fshatarët e pronës së vet, pasi nuk ka dhemburi ndërmjet tyre dhe bujkrobëve të tyre, rruga më e mirë për ta zgjidhur është të mbyllen sytë.210) Nuk duhet çuditur që të merret vesh nga të dhënat tjera të shkruara, që na vijnë nga burimet e njëjta, se Grekët nga Kreta fuqishëm kanë dëshiruar për ndërrimin e zotëriut, se nuk e kanë konsideruar kurrfarë dëmi të bëhen shtetas turqë, sepse mirëqenia e bashkësive të ngjashme të bashkëfiseve të tyre nën turqinë si shembull ka qenë para syve. Njëmend, Kretasit, sikur herë pas here kur iu paraqitej rasti, kanë ikur në Turqi.212) Ajo që veçan i ka impresionuar Kretasit, ky është posedimi i klerikëve latinë me pasuritë kishtarë të kishës lindore dhe që klerikët e përmendur i kanë nënçmuar liturgjitë fetare të popullatës greke, të cilët kanë prezentuar nëntë të dhjetat e popullatës së Ujdhesës.213) Turqit në viset tejra, duke ia kthyer klerarkisë kishtarë greke vetëadministrimin, i kanë fituar simpatitë e tyre, kurse kjo - sipas deklaratave të një Venedikasi bashkëkohor - kështu ka ndodhur: "Një pop nga Hani (Kanca), duke iu drejtuar komandantit turk Kasimit, ka thënë: - Nëse doni t'i përvetësoni Kretasit dhe ta nderoni urrejtjen ndaj Venedikasëve, duhet të dini se feja është lidhja më e fortë që e ruan një bashkësi kulturore nga shkatërrimi, dhe se ju duhet tjetërfare të silleni me ne se si janë sjellur Venedikasit". Venedikasit kanë dëshiruar me rrënjë ta shkulin ortodoksizmin, e në vend të tij t'i konstituojnë rregullat e kishës romake. Me këtë qëllim është konkluduar që në Ujdhesë mos të ngelë asnjë peshkopë grek. Duke e persekutuar bariun e dashur popullor, dëshiruar vetes t'ia tubojnë kopenë e shkapërderdhur. Ky veprim ka nxitur te Kretasit pikëllim të atillë sa që dëshironin me përujje dhe kënaqësi ta presin çfarëdo qoftë sundimi që do t'ua kthejë institucionin e klerarkisë së kaluar shpirtërore, sepse konstituimi i këtij rregullimi ka qenë për ta i domosdoshëm që të mundin denjësisht ta kryejnë shërbimin fetar. Popi i Hanisë, që ti fitojë simpatinë e

popullit, jo vetëm që orvatej t'ua sigurojë privilegjet e vjetra, por në rekomandimin e vet ka gjetur të përshtatshme që t'i shtojë provat e reja, që i ka cekur popi. Kasimi këtë e ka konsideruar të arsyeshme, dhe menjëherë shkroi në Stamboll. Pushteti i atjeshëm, duke e lejuar këtë, i ka urdhëruar në një shkresë patrikanës Greke që të dërgohet një kryepeshkop në Kret, të cilit i qe caktuar si famulli Kandia mme 161

rrethinë. Nën drejtimin e këtij mitropoliti janë konstituar shtatë peshkopë.214)

Pas pushtimit turk vërehen rastet e shpeshta e të shumta të konvertimit në Kretë. Me siguri, Kretasit, që treguan aq zelltari fetare nën sundimin e huaj të Venedikasëve, që prej tyre janë ftohur dhe kanë konsideruar nënçmim të pafalshëm të përzihen me ata,215) dhe të cilët si të eksploatuar gjithnjë janë orvatur t'ua mbjellin ndjenjën e inferioritetit, nuk e kanë përmbajtur simpatinë e vet ndaj fesë së zotërinjve të ri. Zotërinjt e ri janë sjellur me Kretasit jo sikur me shtetasit por sikur me të barabartit me veten, dhe në viset e tyre kanë thelluar një lloj veprimtarie në jetën politike dhe sociale. Çkado që të jenë shkaqet e paraqitjes së fenomenit të kalimit në islam në mesin e Kretasëve, megjithatë nuk mund të besohet se ashpërsia dhe fuqia kanë mund të ndikojnë në ndërrimin e fesë të atij populli i cili, përkundër sulmeve të bëra në emër të fesë së huaj kundërshtare, ka mbetur me shekuj lojal ndaj fesë së vet. Çfarëdo qoftë shkaku i rretjes së radhëve të muslimanëve, ceket se, për afërsisht deri në tridhjetë vejt pas pushtimit, shumica, e popullësisë së Ujdhesës e kanë prezentuar konvertitet muslimanë me fëmijët e tyre.216) Vërtet, njëqind vjet më vonë gjysma e popullësisë së Kretës ka qenë islame. Muslimanët jo vetëm që janë vendosur nëpër qyteza, por edhe në fshatra, e madje edhe në male të larta, dhe se në fizionomi dhe zakone fare nuk janë dalluar nga Grekët. Natyrisht, edhe disa persona me prejardhje turke e kanë mësuar gjuhën e vjetër greke, dhe madje qe bërë traditë të përkthehen në greqishte fermanët dhe vendimet shtetërore dhe pastaj i shpallëshin njerëzve.217)

“Antagonizmi fetar ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve ka dhënë fotografinë dëshpëruese të historisë të shekullit XIX të ujdhesës kreta. Mirëpo, para kryengritjes dhe pavarësisë së Greqisë ndër ithtarët e këtyre dy feve fare nuk kanë qenë, siç e kemi parë këtë, marrëdhëniet e tendosura,218) Përkatësia shoqërore ndërmjet anëtarëve të këtyre dy bashkësive vetë mpak në rroba është manifestuar, ashtu që Grekët që vinin nga jashtë i ndërronin njërin me tjetrin.219) Më vonë ngjarjet politike qenë shkahtarë të rënies së madhe të popullësisë islame në Kretë. Numri i tyre në vitin 1881 ka qenë afër 74.000, deri sa për shkak të shpërnguljes së vazhdueshme numri i muslimanë ka rënë në vitin 1909 në 33.000 banorë.220) *)

162

1) Këtu nuk është vendi që të jepet pasqyra historike e vendeve që i kanë pushtuar Turqit. Shkurtimisht ajo do të mund të prezantohet kështu:

Turqit Osman për herë të parë kaluan në trollin evropian në vitin 1353 dhe vetëm disa vite më vonë Edreneja (Adrianopoja) u bë kryeqendra e tyre evropiane.

Në kohën e Bajazidit (1389-1402) sundimi i tyre shtrihet nga deti Egje deri në Danub, duke përfshirë tërë Bullgarinë, Maqedoninë, Thesalinë dhe Thrakinë, duke përjashtuar Kalkidikinë dhe viset të lidhura drejtpërdrejt me Stambollin.

Murati II (1421-1451) e pushtoi Kalkidikinë dhe me pushtimet ka filluar drejt Adriatikut. Mehmedi II (1451-1481) u bë zoëriu i Stambollit, Shqipërisë, Bosnjes dhe Serbisë, gati tërë Siujdhesës juglindore, me përjashtim të pjesëve bregdetare që i kanë mbajtur Veneidku dhe Mali i Zi.

Sulejmani II (1520-1566) ia ka shtuar ende Hungarinë, kurse deti egje u bë osman.

Në shekullin e shtatëmbëdhjetë kanë sunduar me Kretën, kurse Polonisë ia shkëputën Podolinë.

2) Phrantzes, fq. 305-306.

3) Finlay, vol. III, fq. 422. Pitzipias, seconde partie, fq. 75 M. d'Ohsson, vol. III, fq. 52-54. Arminjon, vol. I, fq. 16.

4) Një udhëtar i cili në vitin 1508 e vizitoi Qipron në mënyrën vijuese e përshkruan dhunën e Venedikasve në pronat e tyre të huaja: "Të gjithë banorët e Qipros janë robër të Mletasëve pasi që janë të detyruar të japin 1/3 e të ardhurave ose të hyrave shtetit, barabartë nga prodhimet bujqësore, drithërat, vera, vaji, ose kafshët ose çka do qoftë tjetër.

Përveç kësaj çdonjëri prej tyre është i detyrueshëm të punojë argatë pa pagesë shtetit dy ditë në javë, kudo që ta caktojnë.

Çdonjëri prej tyre kush mungon nga puna për shkak të ndonjë preokupimi personal ose sëmundje trupare është i obligueshëm të paguaj kompensim për ditët e lëshuara në punë.

Ajo që edhe më shumë e ashpëson gjendjen janë tatimet vjetore e të tjera të caktuara, që popullin e mjerë e ekspozonte plaçkitjes, ashtu që vështirë e kanë pasur ta mbajnë shpirtin dhe trupin së bashku." (The Travels of Martin Banungurten, fq. 373). Po ashtu shih tekstet

163

të cilat Hajketi (Hackett) i ka përcjell në History of dhe orthodox Church of Cypros, fq. 183.

5) Finlay, vol. III, fq. 502.

6) Urquhart. quoted by Clark Races of Evropean Turkey, fq. 82.

7) Karamsin, vol. V, fq. 437.

8) Martin Crusius shkruan në frymën e njëjtë: "Është e çuditshme

se fare nuk dëgjojmë se kanë ndodhur çfarë krimesh dhe padrejtësisht ndërmjet barbarëve (Turqëve) dhe të tjerëve; në këtë qytet të madh drejtësia i është garantuar çdo personi. Për këtë arsye Stambolli e sulltanit e ka përshtetur si qendër të mbarë botës. Aty të gjithë të rrezikuarit jetojnë në siguri. Drejtësia shtrihet në të gjitha njerëzit, barabartë në më të dobëtin sikur edhe më të fuqishmin sipas ndikimit, në të krishterët dhe pabesimtarët barabartë." (Turcograecia, fq. 484) (Basileae, 1584).

9) Phrantzes, fq. 81.

10) Phrantzes, fq. 92.

11) Finlay, vol. V, fq. 5, 123, Adeney, fq. 311. Gerioh shkruan në vitin 1577 dhe thotë: "Nëse Hebraikët ose të krishterët (në Lindje) kanë jetuar në vendet në të cilat kanë ekzistuar kaditë dhe subashët, ashtu që Turqit e rëndomtë nuk kanë mund të bëjnë me te ç'të dëshirojnë, ata (d.m.th. Hebraikët e të krishterët) kanë ndër se jetojnë nën sundimin e krishterë - Shkaku është ky që nuk kanë qenë të shqetësuar, derisa ta paguajnë xhizjen. Sa u përket shteteve të krishtera, nuk ka kufijë për tatimet të cilat tërë vitin kanë paguar shtetasit e tyre." (Tage-Buch, fq. 413).

12) Finlay, vol. V, fq. 156-157.

13) Kjo periudë kohore nuk ka qenë e përcaktuar. Në fillim grumbullimi është bërë çdo të shtatin apo të pestin vit. Mirëpo, në periodat e mëkonshme ka qenë në distanca më të shkurtëra, sipas nevojës së shtetit. (Meuzel, fq. 52).

Metrophanes Kritopoulos ka shkruar në vitin 1625 se tubuesit kanë ardhur në qytete çdo të shtatin vit dhe çdo qytet është dashur t'i dhurojë tre ose katër, ose më së paku nga dy djelmosha." (fq. 205).

14) Kur'ani, VIII, 42.

15) Kur'ani, X, 99, 100.

16) "E edhe epërkundër kësaj djelmoshat e krishterë nuk janë detyruar në ndërrimin e fesë së vet. Principet e pushtetit nganjëherë i kanë kundërshtuar principeve të Kur'anit.

164

Nëse këta nëpunës e përdornin ndonjë detyrim nga fanatizmi i vet fetar, ka qenë kjo nga defekti i komandave të tyre, deri sa ky detyrim nuk ka qenë fare i lejuar nga eprorët." (M. d'Ohsson, bl. III, fq. 397-398).

17) Hertzberg, fq. 472.

18) "Është e mjerueshme ajo që ka ndodhur dikur, që mbretërit e krishterë kanë sjellur nga çdo qytet numër të caktuar djelmoshash, të cilët fuqia natyrore ka ardhur më tepër në shprehje se te të tjerët. U kanë shërbyer nevojave të përgjithshme, civile dhe ushtarake. Kur e pushtuan Mbretërinë Bizantine, turqit ia dhanë vetes të drejtën e ngjashme, që nga familjet të marrin fëmijët, të cilët natyra u ka dhuruar fuqi dhe aftësi të jashtëzakonshme." (David Chytracus, fq.

12-14).

19) Creassy, fq. 99. M. d'Ohson, bl. III, fq. 397. Mukel, fq. 53.

Thomas Smithi, flet për familjet e tilla dhe thotë: "Të tjerët që i ka përcjellur nënçmimi i fesë dhe turpi, të krishterët vetëm sipas emrit, me ta lirisht dhe me kënaqësi të madhe janë përshëndetur për lamtumirë.

Këtë e kanë bërë jo vetë me qëllim të lirohen nga barre dhe shqetësimi, por edhe me shpresë se këta fëmijë kur të rriten do ta arrijnë ndonjë pozitë me rëndësi në pushtet." (An Account of the Greek Church, fq. 12 (London 1680).

Gjatë sundimit të Muratit I është përdorur ushtria e krishtesë në tubimin e këtij tatimi - fëmijëve të krishterë. (Finlay, vol. V, fq. 45).

20) "Prindërit vërtet kanë mundur t'i shpëtojnë fëmijët e tyre duke sakrifikuar diç para." (David Chytraeus, fq. 13). De la Guilletiere përmend në vitin 1669 këtë privilegj të Athinasëve. (An Account of a late Voyage to Athens, fq. 272, London, 1676).

21) Confessio, fq. 205.

22) An Account of the Greek Church, fq. 12 (London, 1680).

23) Meuzel, fq. 52. Thomas Smith: De Moribus ac Institutis Turcarum, fq. 81 (Oxonii, 1672).

24) Joseph von Hammer (2), vol. II, fq. 151. Hans Schiltberger, i cili ka qenë i robëruar nga Turqit në vitin 1396, dhe pas tridhjetë e dy vjet robëri është kthyer në shtëpi në Munihi, pohon se tatimi, të cilin të krishterët është dashur ta paguajnë, nuk ka qenë më shumë se dy shillingë në muaj. (Ressebuck, fq. 92).

165

25) Ua kanë falë tatimet shërbyesëve të fesë së krishterë, sikur që këtë Zoti e ka urdhëruar. Këtë e kanë bërë nga respektë ndaj pozitave të shenjta, që i kanë zënë. Femrat, po ashtu, i kanë falë nga ky tatim." (De Graecae Hodierno Statut Epistola anthore Thoma Smitho, fq. 12) (Trajecti ad Rhenum, 1698).

26) Silbernagl, fq. 60.

27) Martin Crusius, fq. 486, Sarsovino, fq. 67, Georgieviz, fq. 98-99. Scheffler, 56, Hertzberg, fq. 648, De la Jonquiere, fq. 267. Vepra është botuar në Londër në vitin 1595 me titull "The Estate of Christians living under the subjection of the Turke" (Pozia e të krishterëve që jetojnë nën sundimin e Turqëve), në të cilin pohohet se tatimi për kokë për fëmijët mashkull është tetë shillingë (fq. 2). Mixhel Baudin thotë se është një sequin (cekin-dukati) për çdo kokë mashkulli (Histoire de Serrail, fq. 7, Paris, 1662).

28) Tournafort, vol. I. fq. 91.

29) Scheffler, 56 "Sa u përket këtyre dukatëve që i paguajnë, rëndë mashtroheni me ta. Është e saktë se mbreti turk rëndom për gjizjen merrë nga një dukat, por ku janë doganat dhe tatimet e jashtëzakonshme? A nuk marrin të autorizuarit dhe mëkëmbësit e

sulltanit asgjë? A nuk jeni në kohën e luftës të obliguar të paguani tatime të jashtëzakonshme? Sa u përket tatimeve të jashtëzakonshme, ata rriten dhe bien varësisht nga rrethanat e këqia. Është e domosdoshme që shtetasit e sulltanit t'i paguajnë këto tatime sikur që edhe ne i paguajmë."

30) Finlay, vol. V, fq. 24-25. H. von Moltke: Brief über Zustände und Bege - Benheiten in der Türkei aus den Jahren 1835, bis 1839, fq. 274, 354 (5 th ed> Berlin, 1891).

31) Hammer (2) vol. I, fq. 346.

32) "Vështirësitë që i kanë ndier shtetasit e krishterë të sulltanit, në të gjitha kohët, kanë ardhur për shkak të faktit se pushteti qendror në Stamboll ka pasur ndikimin e vet të dobët të njëmendët në të gjitha viset e shtetit turk.

Është e padrejtë e vogël e pushtetit fshatar. Rrjedh nga urrejtja personale që ka nxitur në veprime të vrazhda më herët ose sot kur këto veprime duken edhe më të vrazhda. Të krishterët në Turqi nënshtrohen.

Në kohën e ngritjes së një populli, drejtësia dhe respektet kudruall shtetasve janë krejtësisht të mundshëm, por është e rrallë të

166
gjenden të populli që niset drejt teposhtëzes." (Rev. W. Denton, Servia and the Servians, fq. 15, London, 1862), Gerlaxh, fq. 49,52.

33) Businello, fq. 43-44.

34) Ka qenë e rëndomtë që administrata qendrore e sulltanit të silllet vrazhdë dhe pa të drejtë ndaj shtetasve muslimanë, sikur edhe ndaj të krishterëve të nënshtuar.

Vështirësitë e Grekëve janë shkaktuar me mospërfillshmërinë dhe shkeljen e klasës sunduese dhe me korrupcion që ka dominuar në administratën osmane, më shumë se që është rezultat i ndikimit direkt të sulltanit.

Në punët private Greku ka pasur rast më të mirë që të vijë deri te drejtësia te patriku i vet dhe kompetentët në nahinë e vet, se që këtë Turku ka mundur ta arrijë te kadiu ose te duka." (Finlay, vol. VI, fq. 4-5).

Është gabim të mendohet se vetëm të krishterët janë pjesë e popullësisë e mjerë dhe e rrezikuar. Administrata e keqe turke ka qenë gjithpërfshirëse, nën barrën e saj ka vuajtur tërë populli.

Mbase në disa pjesë të Mbretërisë varfëria e muslimanëve ka qenë më e madhe se mjerim i krishterëve, por gjendja e tyre ka nxitur më shumë dhembshuri të udhëpërshkruesve." (William FArtsyth. the Slavonic Provinces South od Danube, fq. 157-158, London, 1876).

"Tërë kjo varfëri dhe mjerim në veri të Azisë së Vogël ka rënë barabarësisht në popullësinë muslimane dhe të krishterë." (James Bryce: Transcallcasia and Ararat, fq. 381).

"Evropës po i imagjinohet se vetëm të krishterët në turqi janë të

eksponuar diktaturës, denimit dhe nënçmimit me tiraninë e krijuar. Kjo fare nuk është e saktë. Cila fuqi e huaj është interesuar për muslimanët?

Ndoshta padrejtësia ekzistuese ndaj tyre është më e madhe, ndoshta janë të ekspozuar durimit të zulumit më shumë se ata që nuk besojnë në Pejgamberin." (De la Jonquiere, fq. 507).

"Nëse gjykojmë për atë që e kemi vrotuar më herët, do të vërejmë se klasa më e ulët e krishterëve në Azinë e Vogël nuk ka qenë në situatë më të keqe me Turqit e ngjashëm me ata.

Nëse të krishterët e Turqisë evropiane kanë shrytëzuar ato privilegje të dala nga numri i tyre më i madh se i Turqëve, atëherë të krishterët e Azisë kanë qenë të qetë, duke shikuar se si edhe Turqit janë të ekspozuar terrorit të pushtetmbajtësve, nën të cilin edhe vetë

167
kanë qenë. ju mjafton të bashkëpunojnë me atë lloj të muslimanëve të cilët përgjithësisht janë më të matur, më të devotshëm dhe më principiell prej atyre në Evropë. (w.M.Leake, Journal of a Tour in Asia Minos, fq. 7, London, 1824). SHih po ashtu i Laurence Oliphaut, The Land of Gilead, fq. 320-323, 446) (London, 1880).

35) Në shekullin XVI tatimi për kokë ka filluar të humb, i fundit ka qenë në vitin 1676.

36) De la Jonquiere, fq. 333, Scheffler, 45-46, Gasztovott, fq. 51.

37) "Me shqetësim dëgjojmë se çështja nuk shpjeret vetëm në thashethemet të përkapura në mesin e botës së zakonshme se jeta në sundimin turk është e pranueshme. Konsiderohet se kur njeriu e paguan një dukat, e kjo është xhizja, se pas kësaj nuk i shtrohet kokëçarjeve dhe se Turqit përgjithësisht njerëzinë e lënë të lirë në fe dhe se të krishterëve do t'ua kthejnë kishat e të ngjashme me këtë. Ekzistojnë edhe të tjerët (në mesin e të krishterëve), që do të duhej të kuptonin korrektësisht çështjen, të gëzohen me atë që u thuhet (për mirësitë e Turqëve) dhe ta celeburojnë fatkeqësinë në të cilën janë! Të krishterët e tillë jo vetëm që janë shkatërruar, por janë edhe mëaktarë. Mosbesimtarët mendjehetë kanë mbirë nga trolli ateist, që ka prirje drejt herezës dhe çrrënjësjes së krishterizmit." (Scheffler, 48).

38) Hertzberg, fq. 650.

39) De la Jonquiere, fq. 34. Krahasim të ngjashëm ka bërë në vitin 1605 richard Staper, tregtar anglez, i cili në turqi ka qenë dikund rreth vitit 1578. "Përveç asaj që populli turk, përgjithësisht, është një prej më të rrezikshmëve në punët e errta... u kanë lejuar të gjithë të krishterëve, Grekëve dhe Latinëve, të jetojnë duke e ruajtur religjionin e vet dhe që lirisht ta shprehin ndërgjegjen e vet, në atë mënyrë që ua kanë lënë kishat dhe ritualet e shenjta. Në Stamboll dhe në vendet tjera të tillë ka mjaft shumë.

Përkundër kësaj, krahas provës prej dymbëdhjetë vjet të kaluara në

Spanjë, mundem me të vërtetë të pohojë, jo që kemi qenë të detyruar t'i vështrojmë cereonitë e tyre popiane, por i kemi pasur të rrezikuara jetën dhe farefisin." (M. Epstein, *The Early History of the Levant Company*, fq. 57, London, 1908).

40) Macarious, vol. I, fq. 183, 165. Cf. the memorial presented by Polish refugees from Russia to the Sublime Porte, in 1853 (Grosztowtt, fq. 217).

168

41) "Disa kanë shikuar në lirinë e caktuar, që përmbanë mrrëzi, kur kanë humbur shpresën se këtë liri do ta arrijnë nën sundimin e ndonjë qeverie të krishterë; kanë konsideruar se është më mirë të jetojnë nën turqit, sikur këto të jenë më të mëshirshëm në sigurimin e kësaj lirie nga sunduesit e krishterë." (Joannis Ludovici Vivis *De Conditione Vitae Christianorum sub Turca*, fq. 220,225) (Basileae, 1538).

"Disa njerëz flasin se feja është e lirë nën sundimin turk". (Othonis Brunfelsii *ad Principes et Christianos omnes Oratio*, fq. 133) (Basileae, 1538).

Ubertus Folieta, bujar nga Gjenova, shkruan në vitin 1577:

"Shpesh kam pyetur veten, si ndodh që një numër i madh i njerëzve tonë vazhdimisht strehohet tek ata, e mohojnë enë e krishterë dhe vëhet nën flamurin e ligjit islam." (De Causis Magnitudinis Turcorum Imperii, Col. 1209). (Thesaurus Antiquitatum et Historiarum Italiae, cura Joannis Georgii graevii, bl. I, Lugduni Botavorum, 1725).

42) Turchica e Spurcitiae Suggillatio, fol. XVII (a).

43) Blount, vol. I, fq. 548.

44) Scheffler, 51, 53.

45) Dousa, fq. 38, Busbecq, fq. 190.

46) Thomas Smith, fq. 32.

47) Thomas Smith, fq. 42; Blount, vol. I, fq. 548; Georgieviz, fq.

20; Schiltberger, fq. 83-84; Auder, fq. 149, 313.

48) Alexander Ross, fq. IX; Baudier, fq. 317; Cf. also Rycant, vol.

I, fq. 276. "Njeriu beson se është meritë e madhe dikend ta ktheshë në islam. Secili që ka çfarëdo pasurie dëshiron ta ketë robin, djaloshin që është i fuqishëm dhe i aftë t'i durojë të gjitha llojet e vështirësive.

Ai person që mund të lavdohet se robin e ka kthyer në isla mme këtë meriton nder të madh, sepse e ka rritur numrin e besimtarëve."

Thamas Smithi tregon se si shejhu, i cili na ka treguar varrin e Orhanit në Brus "e ka ngritur shikimin drejt qiellit me lutje Zotit që të mëshirohet dhe që neve gjatë kohës së tij të na kthej në islam. Kjo, pa dyshim, është prova më e madhe e dashurisë së tij ndaj nesh, që del nga dëshira e zbrazët dhe mosdija e dëshmuar."

(Epistola duae quarum altera De Maribus ae Institutis Turcarum agit, fq. 20) Oxonii, 1672).

169

- 49) E marrë nga autori anonim që ka qëndruar në Turqi prej vitit 1436 deri 1458. Turchicae Spurciciae Suggillatio, fol. XVII (a).
- 50) Turchicae Spureitiae Suggillatio, fol. XI (b) Lionarodo of Scio, kryepeshkopi Mutylene, që ka qenë dëshmitar i rënies së Stambollit, flet për numrin e madh të konvertitëve në ushtrinë që e ka rrethuar qytetin: "Kush e ka rrethuar qytetin? Kush i mësoi Turqit me organizim pos renegatët e krishterë. Kam parë se grekët, Latinët, Gjermanët, Hungarezët dhe të gjithë të krishterët tjerë që janë përzier me Turqit kanë mësuar sjelljen e tyre dhe besimin e tyre. Ata që e kanë harruar fenë e vet të krishtere e nënshkruan qytetin me forcë. O renegatë (pjellë e keqe, vër. N.I.) që e mohuat Krishtin! O antikrishtë, që u është gjykuar skëterra, kjo është dita juaj e gjykimit!" (Sansovino, fq. 258).
- 51) J. H. Krause, Die Byzantiner des Mittekaters, fq. 385 - 386. (Halle, 1869).
- 52) Hertzberg, fq. 616. Finlay, vol. V, fq. 118.
- 53) Thurchicae Spureitiae Suggillatio, fol. XIX (a).
- 54) Rycant. vol. I., 710-711; Bizzi, fol. 49 (b).
- 55) Pichler, fq. 164, 172.
- 56) Pichler, fq. 143.
- 57) Pichler, fq. 148. Dyshohet se Cirili ka qenë autori i vërtetë i këtij dokumenti që mbanë emrin e tij (Kyriakos, fq. 100).
- 58) Pichler, fq. 226.
- 59) Pichler, fq. 226.
- 60) Sa u përejt robërve të krishterë ndër Turqit, protestantët kanë gëzuar namin më të mirë, sepse kanë qenë me prirje më të mirë për rkonvertizëm se katolikët. (Gmelin, fq. 21).
- 61) Pichler, fq. 221, 227.
- 62) Pichler, fq. 181, 228.
- 63) Pichler, fq. 222, 226.
- 64) Pichler, fq. 177.
- 65) Pichler, fq. 128, 132, 143.
- 66) Pichler, fq. 143.
- 67) Le Quien, bl. I, col. 334.
- 68) Pichler, fq. 172.
- 69) Ky është Curil II nga Berhoci.
- 70) Le Quien, bl. I, vol. 336.
- 170
- 71) Le Quien, bl. I, col. 337.
- 72) Mjaft herët ka ndodhur edhe përpjekja e teologëve protestantë nga Tübingeni (1573-1577) që t'i fusin idetë reformiste në kishën lindore ortodokse. Një nga dijetarët Quarquar nga Samtskhethi në Gjeorgji u konvertua në konfesionin e Augsburgëve, por në vitin 1580

ka kaluar në islam. (Joselian, fq. 140).

73) Schoffler, 53-56; Finlay, vol. V, fq. 118-119.

74) Hammer (I), vol. VI, fq. 94.

75) Spon, vol. II, fq. 57; Hamer (I), vol. VI, fq. 364.

76) Early Voyages and travels iu the Levant, edited by F. Theodor Bent, fq. 210 (London, 1823). Ngjashëm e përfundon Michal Bandier përkthimin e celebrimeve në Stamboll me rastin e synetimit të mehmedit III kah fundi ishekullit XVI me raporti mbi konvertimin e një numri të madh të të krishterëve në islam. "Gjatë kohës së pamjes të të gjitha ceremonieve Grekët e mjerë në grupe nxitonin drejt vendit ku e pranonin islamin. Disa e kanë lëshuar krishterizmin që t'i shpëtojnë zulumit turk, deri sa të tjerët këtë e kanë bërë me shpresë që ta arrijnë ndonjë fitim të ngjashëm. Numri i këtyre të mjerëve ka kaluar katër mijë frymë." (The History of the serrail, and of the Court of the Grand Seigneur Emperour of the Turkes, fq. 93-94, (London, 1635). History generale du Serrail, et de la Cour du Grand Seigneur, Empercur des Tures, fq. 89-90. (Paris, 1631).

77) Scheffler, 55.

78) A. de la Motraye, Voyages en Evrope, Asie et Afrique, vol. I, fq. 306, 308. (La Haye, 1727).

79) Pitzipios, Seconde Partie, 83-87; Pichler, fq. 29.

80) Tournefort, vol. I, fq. 107. Spon më së shpeshti përdor fjalët e njëjta, vol. I, fq. 56.

81) Gaultier de Leslie, fq. 137.

82) A. J. Evans, fq. 265. Ngjashëm thonë Macken de dhe Irby: Në shumë pjesë të Serbisë së vjetër kemi ndeshur mendimin sipas të cilit mitropolit është personi që e ka marrë atë pjesë të vogël të mbetur të parave që e kanë Turqit (fq. 258).

Një autor cek përkthimin tejtër të klerikut të kishës greke në Revue des Deus Mondes (bl. 97, fq. 336) dhe tregon si vijon: "Në fillim të këtij shekulli, në tërnovë njëfarë popi Joakimi, i cili ishte i daashur te ithtarët e vet, por i padëshiruar te patriku, një ditë mori urdhërin që ta caktojë tatimin për kuajt për shtallën kishtare, por ai 171

nuk e pranoi. Atëherë ne të u sulën shërbetorët duke e goditur me tërfurqë. Mirëpo, popi qe ifortë dhe iu kudnërvu atyre. Iku te kadiu pasi që rrobat i la si garancë. Nuk doli as dielli, e tashmë është bërë musliman i mirë."

83) Pitzipios, Seconde Partie, fq. 87; Pichler, fq. 29.

85) Lazar, fq. 223.

86) Finlay, vol. IV, fq. 153-154.

87) Tournefort, vol. I, fq. 104. Of. Pichler, fq. 29, 31; Spon, vol. I, fq. 44.

88) Turchicae Spurcitiac Sugyillatio fol. XIII (b), fol. XV (b); fol. XVII (b); fol. XX (a); Veniero, fq. 32, 36; Busbecy, fq. 174.

89) Gaultier de Leslie, fq. 180, 182.

90) Rycant, vol. I, fq. 689; shih po ashtu Georgieviz, fq. 53-54 dhe Menavino, fq. 73.

91) Alexander ross, fq. IX.

92) Finlay, vol. V, fq. 29.

93) Schiltberger, fq. 96.

94) Thurchicae Spurciciae Suggillatio, fol. XII (b), XII (a).

95) Thurchicae Spurciciae Suggillatio, fol. XXVII (a).

96) "Nga shkaku i kujdesit dhe brigimit Turqit nuk ua kanë prishur trupin, me polltronerinë e vet satanike, kanë vendosur t'ua mbysin shpirtin duke i lënë pa fe.

Këtë fakt mund ta dëshmojnë grupe të besimtarëve, numri i të cilëve nuk dihet. Ndonëse shumë prej tyre kanë qenë të gatshëm të vdesin për fenë e krishterë dhe për Kristin. Që t'i shpëtojnë vdekjes fizike, pasi janë robëruar, gjatë kohës Turku i ka mbyllur dhe i ka prishur dhe i ka sjellë deri aty që ta mohojnë besimin në Krishtin. (Turchicae Spurciciae Suggillatio, fol. I, ef. fol. VI (a).

97) Menavino, fq. 96. John Harris: Navigatium atque hincorantium Bibliotheca, vol. II, fq. 819 (London, 1764).

98) "Duhet të konstatojmë se Turqit janë sjellur mirë me shërbëtorët dhe robërit e vet, me aftësitë e të cilëve kanë mund të shërbehen më mirë, se sa që të krishterët janë sjellur me shërbëtorët dhe robërit. Shërbëtori i shkathët, në ndonjë profesion, është shërbyer me të gjitha ato me çka shërbehet edhe i biri. I ka munguar vetëm liria. (G. C. von den Driesch, fq. 132).

99) Sir William Stirling - Maxwell, (Vol. , fq. 102-103).

100) Gmelin, fq. 23.

172

101) John Harris: Navigatium atque Itinerarium Bibliotheca, vol. II, fq. 810.

102) Për këta të mjerë vitet e para kanë qenë më të rëndat në jetë, veçan nëse nuk kanë qenë të ri, sepse Turqit janë orvatur që me sjellje të mirë ta kthejnë botën në fenë e vet. Nëse kjo nuk vlente, atëherë me dhunë. Kur kalonin të gjitha vitet e mundimshme, robërimi ndër Turqit ishte me i durueshëm se të tjerët. G. C. von den Driesch, fq. 132).

Kësaj mund t'i shtohet edhe kjo që thotë Georgieviz: se ata që kanë mbetur të fortë në krishterizëm kanë qenë të liruar pas njëfarë kohe.

"Nëse mbeteshin të pathyeshëm në krishterizëm, ia caktohej njëfarë periode për shërbim pas skadimit të të cilit bëheshin të lirë. Sa u përket atyre që e mohojnë fenë tonë, kanë kohë të kufizuar për shërbim dhe të drejtë kthimi në vendlindje. Shpresa në liri është e lidhur përvullnetin e mirë të ezotëriut." (fq. 87).

Shih po ashtu: Menavino, fq. 65. Cantacuzenosi thotë se kjo

periodë kohore është shtatë vjet: "Me robërit e tyre veprohet mirë, sepse këtë ua ka urdhëruar Muhammedi, sikur edhe atë që robi mos të mbetet në robëri më shumë se shtatë vjet. Për këtë askush nuk provon, ose këtë rrallë e bëjnë, që ta thojë këtë urdhëresë." (fq. 128).

103) Të krishterët lojalë, që kanë shkuar në Turqi ose në vendet tjera islame, kanë pasur mjaft arsye për dëshpërim për shkak të renegatjes së shumë bashkëbesimtarëve të tyre. Librat e kryeparëve të rendeve manakiste janë përplotë me ankesa në këto raste. Kur janë në pyetje robërit, përzihet ndjenja e dhembjes për shkak të pozitës së tyre me ndjenjen e vajtimit për shkak të gjendjes së tyre. Shpesh i krishteri ka ndier dhembje kur shihte që të lirët e popullit të tij kalojnë në islam. Të deleguarit nuk kanë qenë të sigurtë, asnjë ditë, për përcjelljen e vet." (Gmelin, fq. 22) Cf. Von den Diresch, fq. 161.

104) Thomas Smith, fq. 144-145.

105) Turchicae Spurcitiae Suggillatio, fol. XXXV (a).

106) M. d'Ohsson, vol. III, fq. 133; Georgieviz, fq. 87 (quoted abor); Menavino, fq. 95.

107) Von den Driesch, fq. 250.

108) Turchical Spurcitiae Suggilatio, fol. XI.

109) Hertzberg, fq. 621.

173

110) Me vdekjen e pleqëve, rinia më së shpeshti ka kaluar në islam. Kështu që tash (1655) mundesh vështirë të takohesh me dy të krishterë Armenë në të rrafshinën pjellore, ku prindërit u janë dërguar që ta punojnë." (Tavernier, (I), fq. 16).

111) H. H. Jessup: Fifty - threeyears in Syria, vol. II, fq. 658 (New York, 1910).

112) Për emrat e këtyre shih: Finlay, vol. VI, fq. 28-29.

*) I mashtruar me faktin që qyteti i vjetër Tivari (Antibari) pas rënies nën sundimin osman në vitin 1571 ka hyrë në përbërje të sanxhakut shkodran, Arnoldi gabimisht e vendos në Shqipërinë veriore. E vërteta, në shekullin IX Tivari kishërisht i ka takuar dioqezës së Durrësit, që qysh më 1022 ka qenë në drejtimin kishtar të Dubrobnikut. Mitropoli e mëvetshe është bërë në vitin 1089. Ka qenë në pronësi të Bizantit, princave duklian, dhe sunduesve gjerman. Turqit e kanë pushtuar nga Mletasit nën drejtimin e të cilëve ka qenë nga viti 1442. Me vendimin e kongresit të Berlinit më 1878 ka hyrë në përbërje të shtetit malazias.

(Enciklopedija Leksikografshog zavoda, Zagreb, 1955, vëll. I, fq. 386 - Sh.N.).

113) Leake, fq. 250.

114) Një nga ata, Shqiptar i krishterë, duke folur për armiqtësinë që ekziston ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve të Bullgarisë, thotë: Sa i përket Shqipërisë, situata është krejtësisht tjetërfare. Muslimanët Shqiptarë sikur edhe të krishterët flasin me një gjuhë, kanë zakonet

- dhe moralin e njëjtë, dhe shkojnë sipas një zakoni tradicional. Ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve fare nuk ka urrejtje, sepse me gjenerata nuk ka pasur armiqësi. Faktori fetar nuk ka qenë shkak për përçarje. Me përjashti mtë disa rasteve, njëjtë kanë jetuar duke i shfrytëzuar të drejtat e njëjta dhe barabartë duke i kryer detyrat. (Wassa Effendi, Albanien und die Albanesen, Berlin, 1879).
- 115) Flinlay, vol. V, fq. 46.
- 116) Clark, fq. 175-177. Mirëditasit të cilët janë romano-katolikë fanatikë (të vendosur në krahinën Alessio) kurrë nuk i kanë pranuar muslimanët të jetojnë në kodrat e tyre, as që dikush nga fisi i tyre ta pranojë islamin. Sikur edhe një mirditas ta provonte këtë, pa dyshim do ta mbytnin, përveç nëse arrinte të ikë nga Shqipëria. (Herquard, Histoire de la Hante Albanie, fq. 224).
- 117) E botuar në Farlatis Illyricum Sacrum.
174
- 118) Alessandro Comuleo 1593. Bizzi, 1610; Marco Crisio, 1651. Fra Bonaventura di S. Antonio 1652; Zmaievich 1703.
- 119) Bizzi, fol. 60 (b).
- 120) Bizzi, fol. 35 (a).
- 121) Farlati, vol. VII, fq. 104, 107.
- 122) Disa janë ankuar se muslimanët kanë dominuar me palatin e kryepeshkopit. Mirëpo, pallati ka qenë lëshuar qysh tetë vjet më herët, pasi që kryepeshkopi Ambrozio (1579-1598) ka parë se e ka më mirë të shkojë në ikje, pasi që rreptë e sulmoi islamin me mprehtësinë që e kalon kufirin e kujdesit e ofendoi Muhammedin dhe mësimin e tij djallëzor". (Farlati, vol. VII, fq. 107).
- 123) Bizzi, fol. 9, thotë: "E kam shenjtëruar atë mengjes për afërsisht tërë bashkësinë e krishterë latine". Nëse këtë do ta krahasonim me statistikën që e cek Zmajeviqi (Zmaievich - fol. 227), mund të parashtroj se bashkësia latine e krishterë, në atë kohë, ka numruar diç më shumë se njëmijë frymë.
- 124) Bizzi, fol. 27 (b), 38 (b).
- 125) Veniero, fol. 34. Tradita e tillë ka vazhduar në disa fshatra shqiptare deri në vitet e vonshme përkatësisht deri në fillim të shekullit XIX. Shih: W. M. Leam: Travels in Narthem Greece, vol. I, fq. 49. (London, 1835): "Në disa fshatra muslimanët i marrin Greket, djemt edukohen në frymën turko-islame, kurse vajzat në frymën e krishterë. Kështu që gati derri dhe qengji hahen në tavolinën e njëjtë."
- 126) Bizzi, fol. 38 (b); Farlati, bl. VII, fq. 158.
- 127) Bizzi, fol. 10 (b); Veniero, fol. 34.
- 128) Shkurt pasi që Marko Bizzi arriti në Antivari (Tivar), një muslimane nga shoqëria e lartë ka dëshiruar që femijën t'ia kryqojë vetë kryepeshkopi, që na njofton se kjo femër rreptë është ankuar për një prijës të krishterë në qytet. Më tej thotë: "Nuk kam gjetur kush do të më ndihmoj në kungatë, kurse kjo është çështje që klerikët e mi e

- kryejnë çdo ditë, çdokujt prej popullit kush e kërkon këtë." (fol. 10-b).
- 129) Për marrëdhëniet e mira, në kohën e sotshme (shek. XIX - vër. përkthyesit) ndërmjet ithtarëve të të dy feve, që jetojnë në fshatin e njëjtë, shih: Hyacinthe hecquard, Histoire et descriptions de la Hante Albanie (fq. 151, 162, 200) (Paris, 1858).
- 130) Bizzi, fol. 38 (a).
- 131) Garnett, fq. 267.
- 132) Bizzi, fol. 35 b (b).
- 175
- 133) Bizzi, fol. 38 (b), 61 (a), 37 (a), 33 (b).
- 134) Bizzi, fol. 12-13; Zmaievich, fol. 5.
- 1350 Bizzi, fol. 10-11.
- 136) Bizzi, fol. 13 (b).
- 137) Bizzi, fol. 60 (b).
- 138) Bizzi, fol. 66 (b).
- 139) "Nëse Shqipërisë nuk i ofrohet ndihmë më e madhe, do të keqësohet gjendja e shumicës së krishterëve për pak vite, për shkak të numrit të vogël të peshkopëve dhe klerikëve që janë inteligjentë." (Bizzi, fol. 61 (a).
- 140) Finlay, vol. V, fq. 153-154, Clark, fq. 290.
- 141) "Këta të mjerë kanë qenë fuqishë mtë bindur që mos të bëjnë kurrfarë mëkati me martesën (siç është martesë e të krishteres me muslimanin), duke e marrë parasysh se Turqit janë zotëri të vendit, dhe është e pamundur të mos përgjigjesh kur të urdhërohet diçka". (Bizz, fol. 38 (b).
- 142) Garnett, fq. 268.
- 143) Bizzi, fol. 38 (b), 63 (a).
- 144) Kyriakas, fq. 12.
- 1450 Frlati, bl. VII, fq. 124, 141.
- 146) Marco Crisio, fq. 202.
- 147) Bizzi, fol. 60 (b).
- 148) Zmaievich, fol. 137.
- 149) Zmaievich, fol. 157.
- 150) Zmaievich, fol. 11, 159.
- 151) Zmaievich, fol. 13.
- 152) Bizzi, vol. 38 (b), Farlati, vol. VII, fq. 158.
- 153) Zmaievich, fol. 13-14.
- 154) Informatione circa la missione d'Albania, fol. 196.
- 155) Crisio, fol. 204.
- 156) Fra Bonaventura, fol. 201.
- 157) Marko Crisio, fol. 205.
- 158) Zmaievich, fol. 13.
- 159) Farlati, bl. VII, fq. 109; Bizzi, fol. 19 (b).
- 160) Marco Crisio, fol. 205.
- 161) Zmaievich, fol. 11.

- 162) Marco Crisio, fol. 204.
163) Zmaievich, fol. 32.
176
164) Zmaievich, fol. 11; Farlati, vol. VII, fq. 151.
165) farlati, vol. VII, fq. 126-132; Zmaievich, fol. 4-5, fol. 20.
166) "Numër i madh e ka lëshuar krisherizmin shkallërisht që të shpëtojë nga tatimi dhe taksat tjera të imponuara." (Farlati, bl. VII, fq. 311).
167) Zmaievich, fol. 5.
168) Zmaievich, fol. 5.
169) Zmaievich, fol. 149.
170) Zmaievich, fol. 143-144.
171) Zmaievich, fol. 22.
172) Farlati, bl. VII, fq. 141.
173) Zmaievich, fol. 7, 17.
174) Zmaievich, fol. 9.
175) Zmaievich, fol. 141.
176) Farlati, vol. VI, fq. 317.
177) Eliot, fq. 401.
178) Eliot, fq. 392.
*) Sipas Viksit, në vitin 1977 Shqipëria ka pasur 2.5 milionë banorë. Nga ky numër muslimanë ka pasur 1.750.000 apo 70%. Weekes, po aty, fq. 19-22,500 (vër. Sh. N.).
*) Këtu mendohet në të krishterët përkatësisht për Evropianin, si është traditë në mesin e muslimanëve t'i quajnë. Vetë infinitivi (të evropeizohet - se - teferenche) ka lindur nga fjala Frenxh (Frenk) Frankovit. (D.A.K.).
*) Mendohet, mbase, në Bullgarinë në Vollgë (D.A.K.) (Megjithatë, mendojmë se fjala është për Bullgarinë në Evropë, ku muslimanët kanë qenë të pranishëm qysh në shekullin VIII-IX. Shih: N. Ibrahim, Muslimanët në Balkan në periodën paraosmane, separat, Psieren, 1414/1992, fq. , Vër. N. I.)
179) Yaqut, vol. I, fq. 469 sq.
180) Geographie d'Aboulfeda, trodrite par M. Reinand, bl. II, fq. 294-295).
**) Mbi kontaktet e mundshme të popullësisë së trevave tona me islamin para pushtimeve osmane (sheh. XIV) nëpërmjet fqinjve verior, në gjuhën tonë (boshnjake, vër. N.I.) kanë shkruar:
- Sikiriq, Shaqir, Ismailije u Ugarshoj, kalendar "Pravda", Sarajevo, 1923.
177
- Bazhoviq, Rade, Arapi u pismenoi narodnoj pesmi i pripoveci na srpskohrvatskom jeziku podracju, Filoloshki fakultet, Beograd, 1977, fq....
- Haxhijahiq, M. e të tjerët, Islam i muslimani u BiH, Kryesia e BI

- në SRB dhe H., Sarajevë, 1977, fq. 24-25. (Sh.N.).
- 181) Enrique Dupuy de Lome: Los Esclavos y Turquía, fq. 17-18 (Madrid, 1877).
- 182) De la Jonquiere, fq. 215.
- 183) De la Jonquiere, fq. 290.
- 184) Kanitz, fq. 37.
- 185) Kanitz, fq. 37-38.
- 186) Hartën e këtyre vendeve e jep Mackenzie dhe Irby, fq. 243. Ato përfshijnë Prizrenin, kryeqendrën e Serbisë së vjetër, Ipekin (Pejën), selinë e patrikut serb, dhe fushëbetejën Kosova.
- 187) Kanitz, fq. 37.
- 188) Mackenzie and Irby, fq. 250-151.
- 189) Farlati, vol. VII, fq. 127-128.
- 190) Mackenzie and Irby, fq. 374-375; Kanitz, fq. 39.
- 191) Kanitz, fq. 39-40.
- 192) Kanitz, fq. 38.
- 193) Bizzi, fol. 48 (b).
- 194) Kanitz, fq. 38.
- 195) Me Malin e Zi kanë sunduar peshkopët e vladikës prej vitit 1516 deri 1852.
- *) Vlladikën Danillo Shçepçeviqin (më vonë Petroviqin) gojëdhëna (e amshuar me Kurorën e maleve) e konsideron për nismëtar të luftës së armatosur kundër pushtetit turk në Mal të Zi në shekullin XVIII. Në rrugën e sendërtimit të çlirimit të malit të Zi në mbështetje të fiseve të krishtere malaziasë dhe hercegovase përbrenda, sikur edhe në Mletasit dhe Rusët nga jashtë, vlladika Danillo ka konsideruar ekzistimin e muslimanëve vendas të a.q. poturët (turkoshakët-poturica, N.I.) si pengesë të madhe. Natyrisht, zhdukja e këtyre poturëve nuk ka ndodhur në një "Natë të kolendrave", si e thotë këtë gojëdhëna, por ky është proces që ka zgjatur më gjatë. Në gjërësisht për luftën e Malit të Zi për çliri nga Turqit shih Historija naroda Jugoslavije, Zagreb, 1960, II, fq. 1252-1280 (Sh.N.).
- 196) E. L. Clark, fq. 362.
- 178
- 197) Për ata kanë ftuar papa Honarus III 1221, Gregori IX 1238, Imocent IV 1246 dhe Benedict XII 1337. Inkuizicioni është themeluar në vitin 1291.
- 198) Asboth, fq. 42-95, Evans, fq. XXXVI-XLII.
- 199) Asboth, fq. 96-97.
- 200) "I kanë atakuar ceremonitë kishtare dhe prijësit e tyre. Popat ortodoksë i kanë quajtur farise të verbër dhe kanë lehur pas tyre sikur që qentë lehin pas kuajve."
Për Darkën e Zotit (Darkën e fundit) kanë pohuar se ajo nuk është e urdhëruar prej Zotit dhe se ky nuk është trup i Zotit, por bukë e rëndomtë." (Kosmas, quoted by Evans, fq. XXX-XXXI).

- 201) Pohimi i tyre është: "Ne e kemi mbytur Mesinë Isaun, të birin e Merjemes, të dërguarin e Zotit. As nuk e kanë mbytur, as kryquar, por u ka gjasuar ashtu." (En-Nisa, 157).
- 202) Krahasoje habinë që e kanë dëftuar Turqit ndaj mbretit suedez Karlit XII: "Abstenimmi i tij nga alkoholi, zbatimi publik i lutjes dy herë në ditë, ka ndikuar tek ato të thonë: - Ai njëmend është musliman". (C. Enorres de Voltaire, bl. 23, fq. 200, Paris, 1785.
- 203) Asboth, fq. 36. Vetzter and Welte, vol. II, fq. 975.
- 204) Olivier, fq. 17-18.
- 205) Olivier, fq. 113.
- 206) Amari, vol. I, fq. 163, vol. II, fq. 260.
- 207) Cornaro, vol. I, fq. 205-208.
- 208) Perrot, fq. 151.
- 209) Pashley, vol. I, fq. 30; vol. II, fq. 284, 291-292.
- 210) Pashley, vol. II, fq. 298.
- 211) Pashley, vol. II, fq. 285.
- 212) Pashley, vol. I, fq. 319.
- 213) Perrot, fq. 151.
- 214) Charles Edwardes: Letters from Crete, fq. 90-02 (London, 1887).
- 215) Pashley, vol. II, fq. 151-152.
- 216) Pashley, vol. I, fq. 9.
- 217) Perrot, fq. 159.
- 218) Pashley, vol. I, fq. 10, 195.
- 219) T.A.B. Spratt, Travels and Teseaches in Crete, vol. I, fq. 47 (London, 1865).
- 220) R. du M.M., VII, fq. 99.
- 179

*) Në studimin për Muslimanët e Evropës jugore (Greqisë) M. Ali Kettani sjell të dhënat në tabela në të cilat shihet rënia e popullatës muslimane në Kritë në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Sipas tij deri në vitin 1921 në kritë kanë qenë 27.852 ose 8.3% muslimanë prej gjithsej 336.181 numri të banorëve. Vetëm dy vjet më vonë në vitin 1923 fare nuk ka atje sepse janë shpërngulur. Me bashkimin e Kretët me Greqinë në vitin 1912 dhe me kontratën e Turqisë dhe Greqisë në vitin 1923 mbi ndërrimin e popullësisë, ka pasuar shpërngulja nga Kreta dhe këtë jo vetëm në turqi, por edhe në vendet fqinje arabe e muslimane.

Sipas Kettanit, muslimanet e Kretit në vitin 1971 në diasporë kanë qenë si vijon:

Turqi 200.000

Libi 100.000

Egjipt 100.000 dhe në vendet tjera 50.000.

(Kettani, M.A., Muslims in Southern Evrope (Muslimanët në Evropën jugore).

JOURNAL, Institute of Muslim Minority Affanes,
Jeddah/Xhedda/, 1980, vëll. II, fq. 151-153.(SH.N.).

KAPTINA VII

PËRHAPJA E ISLAMIT NË PERSI DHE AZINË QENDRORE

Gjendja fetare e Persisë në kohën e pushtimit arab

Nëse dëshirojmë ta përcjellim rrugën e përhapjes së islamit në

lindje, në Azinë Qendrore, duhet shkurtimisht t'u kthehemi

pushtimeve të para arabe. Nuk ka kaluar as pjesa e parë e shekullit

VII, kurse tashmë dinastia e fuqishme sasanidase është përmbysur.

Imperatoria që katër shekuj me sukses i është kundërvënë romës dhe

Bizantit u bë trashëgimi e islamit.

Kur u shpërnda ushtria e shtetit persian, muslimanët nuk hasën në

rezistencë më të rëndësishme në popullin persian i cili, në kohën e

fundit, ka rënkuar nën diktaturën e rëndë të dinastisë sasanidase.

Ajo që veçan ka nxitur pakënaqësi dhe urrejtje ndaj këtyre

pushtetmbajtësve ka qenë ajo që e kanë shtrirë fenë e Zoroastros, në

popull qysh më herët antipatike. Ajo ka qenë fe qiellore dhe klerikëve

180

të saj u janë dhënë autorizime të gjëra. Më këtë u patë rritur fuqia dhe

ndikimi në këshillin mbretëror. Vend me rëndësi, nëpërmjet kësaj,

kanë zënë edhe në administratën civile. Ndikimin e vet e kanë

shfrytëzuar në shtypjen e feve rivale, të cilat ishin disa.

Përveç shumë grupacioneve të Persisë së vjetër të përfaqësuara

kanë qenë edhe ato të ëkrishtera, hebraike, sabeje sikur edhe një numër

i caktuar i sekteve fetare të krijuara nën ndikimin e mësimit të

gnosticizmit*), maniheizmit**) dhe budizmit.

Persokutimet dhe terrori të populli kanë krijuar neveri edhe ndaj

fesë së imponuar e edhe ndaj dinastisë që e ka për mbajtur. Kjo fe ka

qenë një nga shkaqet që fitorja dhe pushtimi arab të shihen në dritën e

shpëtimit nga gjendja e këtilë.1)

Pas gjithë laramanisë në fe, populli u lirua nën sundimin që ka

garantuar lirinë e besimit dhe e ka liru nga shërbimi ushtarak me

pagimin e tatimit minimal.

E drejta islame e garanton lirinë e besimit jo vetëm të krishterëve

dhe Hebraikëve por edhe zoroastrianëve dhe sabejëve, idhujtarëve,

adhuruasve të zjarit dhe totemeve,2) me kusht që ta paguajnë

xhizjen.***)

Thuhet se Pejgamberi i Zotit ka rekomanduar sjellje të mirë me

zoroastrianët sikur edhe "me pjesëtarët e Librit" d.m.th. të krishterët

dhe Hebraikët, dhe që prej tyre të merret xhizja si kompenzim për

mbrojtjen e ofruar.3)

Ka mundësi që ky hadith ka qenë i përhapur në shekullin e II pas

Hixhretit kur muslimanët kanë kërkuar veprimin e Pejgamberit që

lejon tolerancën fetare në mirësjellje me pjesëtarët e feve të ndryshme,

të cilat Arabët i kanë takuar në viset e pushtuara, pa marrë parasysh a

Ilogariten këta në "bartësit e Librit" apo jo.4) Ndryshimi në pushtet solli deri të çlirimi edhe i kishës së krishterë në Persi, e cila ka qenë e shtypur nga ana e mbretërve sasanidas. Ata kanë ngacmuar trazirat e tmershme të jakobitëve dhe nestorianvëe dhe i kanë rritur konfliktet e sekteve në konflikt. Më herët kemi dëftuar në shtypjet fetare,5) e tash do të përmendim se në kohën e agonisë në të cilën është gjetur dinastia e Sasanidëve gjatë kohës së Husrevit II se terrori është forcuar. Urrejtja pas humbjes që e ka përjetuar nga sunduesi i krishterë Heraklin u derdh mbi të krishterët të cilët ishin nën sundimin e tij. Këtë e kanë ndier të gjitha sektet e krishtera. Ndoshta pikërisht gjendja e këtillë e ka 181

përgatitur psikën e njerëzve për ndërrim rapid, që e ka lehtësuar edhe ndryshimin e bindjes fetare.

"Përveç kaosit politik në vend, u paraqit edhe anarkia morale, që e përmbushi shpirtin e të krishterëve. Kanë qenë të ballafaquar me vështirësitë e rritura dhe agoninë morale dhe me konfliktet e nxitura të mësimeve të ndryshme fetare. Prandaj kanë synuar drejt këtij sistemi të çuditshëm më harmonizimit racional, në të cilin feja e re lehtë mungullon dhe para vetes merrë të gjitha të tjerat duke u orvatur ta vëjë fenë dhe shoqërinë në fundament të ri.

Thënë tejtërfare, popullata e Persisë, veçan grupet semite, intelektualisht ka qenë në nivel të tillë që kjo i ka ndihmuar që të kalojë në fe të re. Është mallëngjyer me pranimin e saj për shkak të simplifitetit me të cilën shquhet islami.

Islamit, kështu, i qe gjykuar që me një lëvizje t'i evitojë të gjitha negativitetet, që para botës t'i hapë rrugët e qarta të shpresave të mëdha dhe t'i premton, çlirimin e shpejtë nga robëria dhe mjerimi.6) Islamin mezi e kanë pritur dhe me entuziazëm e kanë pranuar shuica e popullësisë qytetare. zejtaret, ndërtuesit dhe punëtorët tjerë. Sipas fesë së Zoroastros, zejet e tyre i kanë bërë të ndytë, sepse e kanë ndotur zjarrin, tokën dhe ujin.

Për këtë arsye tek ata shikohej me sytë e ligjit, me nënçmim dhe përbuzje. Të pranohet islami për ta ka pasur domethënie të bëhesh i lirë dhe i barabartë në fe."7)

Nuk qe e rëndë ta lëshojnë fenë e Zoroastros. Me rënien e dinastisë sasanidase, erdhi deri të kriza edhe e kishës nacionale nga arsyeja se ithtarët e saj nuk kanë pasur qendër rreth të cilës në të ardhmen do të tubohen. Për këtë kanë gjetur rrugë të lehtë të kalimit në islam. Aq më parë kur ndërmjet fesë të vetë të vjetër dhe të resë kanë gjetur një varg ngjashmëri.

Persiani në Kur'an ka gjetur mjaft mësimme themelore të besimit të hershëm, por në varianta shumëfarëshe. Thënë më mirë, ai në vend të Ahuramazdës dhe Ahrimanit në religjionin e vet të vjetër takon në Kur'an emrin e All-Ilahut dhe Iblisit dhe krijimin e botës në gjashtë

perioda kohore. I takon engjëjt (melekët dhe demonët) shejtanët, dhe tregimin për njeriun e parë të pagabueshëm, ringjalljen e sërishme të trupit pas vdekjes dhe besimin në Xhennet (parajsë dhe Xhehennem) shëterrë.8)

182

Njëfarë ngjashmërie e gjejmë madje edhe në detajet e lutjeve të ditës. Kështu sipas mësimit të fesë së re duhet të kryejnë, brenda ditës, pesë herë lutjen, sikur e kanë bërë këtë më herët sipas udhëzimit të Avestës.90

Fiset që kanë qenë të banuara në Persinë veriore me kryeneqësi dhe vazhdimisht i janë kundërvënë organizimit kishtar të religjionit shtetëror. Në atë anë pothuaj çdo person ka qenë klerik në shtëpinë e vet dhe nuk ia është dashur asnjë predikuesi. Njeriu i tillë ka besuar në ekzistimin e qenies mbinatyrore dhe në përhershshmërinë e shpirtit. Ka dijtur se fqinjët të vet duhet dëshiruar mirë, se duhet zbutur epshet dhe pasionet e veta, të bëhet i durueshëm dhe të luftojë për jetën e cila do të jetë më e mirë nga ajo që e jeton tash.

Nuk është atëherë e çuditshme që këtë popull nuk është dashur ta bindë shumë që ta provojë islamin.10) Islami ka pasur mjaft pika prekëse edhe me besimet e disa sekteve heretike në Persi të cilat kanë qenë nën ndikimin e krishterizmit.

Përveç faktorëve tashmë të përmendur të cilët kanë shkaktuar përhapje mahnitëse të shpejtë të islamit në Persi, ka ekzistuar edhe një shkak. Është i manifestuar në ndjenjën politike dhe nacionale të këtij populli të ngadhnyer. Ai do të sjellë deri aty që të vëhen nën flamurin e fesë së re me anë të martesës së Husein b. Aliut me Shahbanen, një nga të bijat e Jezderxhidit, sunduesit të fundit sasanidas.

Në fëmijët e Shahbanës dhe Huseinit Persianët kanë parë trashëgimtarët e mbretërve të vet të hershëm dhe trashëgimtarët e traditave nacionale.

Kjo ndjenjë patriotike na shpjegon lojalitetin e madh të Pesianëve për partinë e Aliut sikur edhe shfaqjen e parë të shiizmit si parti të ndarë.11)

Fuqia dhe dhuna nuk kanë qenë shkak të kalimit të gjerë të botës në islam. Dëshmi për këtë është raporti tolerant i muslimanëve ndaj atyre që kanë mbetur në fenë e vet të vjetër. Ende në Persi ekzistojnë grupet e vogla të adhuruesve të zjarrit.12)

Deri sa në kohën e re këta kanë pasur presione të caktuara dhe persekutime, pararendësit e tyre, në shekujt e hershëm të tixhretit, janë kënaqur në tolerancë dhe liri fetare. Faltoret u janë respektuar. Kështu lexojmë se një komandant musliman (në kohën e sundimit të halifit abasit El-Mu'tasait 833-842) ka urdhëruar që të kamxhikon imamin

183

dhe muezinin për arsye se kanë marrë pjesë në rrënimin e një tempulli zjarrputist në qytet dhe në vendin e tij kanë ndërtuar xhaminë.13)

Në shekullin X, tre shekuj pas pushtimit të Persisë, tempujt zjarrputist kanë mund të gjenden në Irak, Persi, Kirman, Sixhistan, Horasan, Klu'bal, Azerbejxhan dhe Aran, ose thënë më mirë në çdo skutë të Persisë.14) Pothuaj se asnjë qytet ose krahinë nuk kanë qenë pa adhurues të zjarrit dhe tempujt e tyre.15)

Esh-Shehrestani (që ka shkruar kah fundi i shekullit XII) po ashtu përmend tempullin zjarrputist në Isfani, në fqinjësi të vetë Bagdatit.16) Nga shkaqet tashmë të shtruara, të ndryshme, sigurisht numri i konvertitëve Persianë në islam në vitet e para të sundimit arab ka qenë i madh. Qëndresa e fesë së tyre të vjetër dhe gjurmat e lënies së saj të shkallërishtme në shekujt që kanë pasuar konfirmojnë bindjen dhe supozimin tonë dhe pranimi i tyre i islamit ka kaluar krejtësisht vullnetarisht, në atmosferën e paqës dhe zgjidhjes së lirë.

Kah fundi i shekullit VIII, Samani, fisniku nga Belhi, e lëshon fenë e Zoroastros dhe e pranon islamin, me ndihmën e Esad b. Abdullahut, mëkëmbësit të Horasanit. Sipas emrit të guvernatorit, nën sundimin e të cilit erdhi, ia ka dhënë emrin edhe djalit të vet Esad. Nga ky kalim në islam kjo dinasti ia ka dhënë emrin vetes Samonitët (sundon 873-999).

Në filli mtë shekullit IX Kerib b. Shahrijari ka qenë sunduesi i parë i dinastisë Kabusijë që e ka pranuar islamin. Me aktivitetin e Nasirulbakk Ebu Muhammedit në vitin 873 numër i madh i zjarrputistëve nga Dejlemi ka pranuar islamin. Në shekullin vijues, rreth vitit 912, pasardhësi i familjes së Aliut Hasan b. Aliu, i cili është përforcuar në bregun jugor të detit Kaspik dhe ka qenë mjaft i ditur, inteligjent dhe njohës i mirë i mësimi fetar të sekteve të ndryshme religjioze, e ka ftuar në islam popullësinë e Taberistanit dhe Dejleit, që ka qenë idhujtare zjarrputiste dhe magi. Shumë prej tyre i janë përgjigjur thirrjes së tij deri sa disa edhe më tej kanë mbetur në mosbesim.17)

Në islam ka kaluar në vitin 394/1003-1004 poeti i njohur Ebu l'Hasan Mihjar nga Dejlemi. Më parë ka qenë zjarrputist. Në islam ka kaluar nën ndikimin e mësuesit të vet në poezi Sherif err-Rridasë, poetit të njohur.18)

Disi në të njëjtën kohë në islam ka kaluar edhe gjyshi i Ibn Hordazbihut, gjeografit të famshëm. Kjo ndodhi nën ndikimin e një 184

Bermekiu19) gjyshi i të cilit po ashtu ka qenë ithtar i Manit dhe një nga klerikët e lartë të tempullit të madh zjarrputist Nevbuhar në Belh. Përveç të dhënave pak të ruajtura që depërtojnë deri te ne për kalimet e këtij populli në islam, na duhet se kalimi ka qenë çështje e zgjidhjes së pastër personale.

Po ashtu është e qartë se ithtarët e mësimi të Zoroastros përgjithësisht kanë gëzuar lirinë e plotë fetare deri në fund të periodës abasite. Me pushtimin mongol filloi epoka e dhembshme në historinë

e tyre. Duket se gjendja dëshpëruese në të cilën janë gjetur muslimanët persianë, ka krijuar tek ata frymën e mosdurimit fetar që, nga koha në kohë, ka ditur të manifestohet në vrazhdësi dhe jotolerancë ndaj ithtarëve të fesë së Zoroastrës.20)

Sekti ismailit

Kah mesi i shekullit VIII Persia bëhet djepi i lëvizjes që do të ketë ndikim dhe interes të caktuar në historinë misionariste të islamit. Këta janë ismailitët. Nuk është vendi të flasim për historinë dhe mësimin teologjik të ithtarëve të saj as për faktorët politikë dhe shoqërorë që kësaj sekte i kanë ndihmuar të forcohet. Në fakt, vëmendjen na tërhoqi organizata e saj e çuditshme misionariste me anë të të cilës është kryer propaganda.

Abdullah b. Mejmun ka qenë ai që, në shekullin e IX, i ka frymëzuar jetë të re në shpirtin e ismailitëve në aspekt të përhapjes së mësimin të drejtimit të tyre. Me precizitetin e vet në njohjen e natyrës njerëzore, ata mjaft shkathtësisht e mësojnë njerëzinë me principet e sektit të vet sipas fuqisë dhe synimit të çdo individi. Në këtë e kanë tejkaluar madje edhe metodën e jezuitëve.

Propagatorët e vet Abdullah b. Mejmuni i ka dërguar në të gjitha drejtimet të shëndrruar në sufi, tregtarë e të ngjashme. Kanë qenë të ushtruar të sundojnë me njerëzit dhe që prijësit të propaganduesve ismailitë t'ia tërheqin njerëzit e të gjitha shtresave shoqërore. Mësimet e tyre ia kanë adaptuar gjuhës, perceptimit dhe nivelit intelektual të çdo dëgjuesi.

Këta propagandues kanë arritur të zotërojnë me masën me anë të makinacioneve jo të rëndomta të cilat, në sytë e botës së rëndomtë, dukeshin si vepra të mbinatyrshme - mu'xhize, duke nxitur te kjo botë kureshtjen.

185

Ndaj të devotshmëve kanë dëftuar respekt frikë dhe zjarr fetar. Njëjtë kanë bërë edhe ndaj asketëve, duke theksuar si ideal virtytin dhe devotshmërinë. Sufive u kanë ekspozuar domethënie të fshehta të mësimëve popullarizuese. Për ata që i kanë kyqur në mësimin e vet kanë caktuar shkallë të ndryshme, varësisht nga niveli i tyre intelektual.

Simpatizuesve të vet, që i përkitnin feve të ndryshme të asaj kole, ia profetizonin ardhjen e shpëtuesit.

Muslimanëve ua shpallnin ardhjen e shpejtë të imami të pritur - Mehdiut, hebraikëve ardhjen e Mesiut, kurse të krishterëve Ngushulluesin. Mirëpo, ata ua kanë mbushur mendjen se si askush, kush dëshiron të arrijë diç, këtë nuk mund ta arrijë pa kthimin e Aliut, shpëtuesit kryesor.

Propaganduesi ismailit është treguar plotësisht lojal doktrinës shiite, duke theksuar gjatë kësaj vazhdimësinë dhe padrejtësinë e sunnitëve ndaj Aliut dhe bijëve të tij. Lirisht i ka sharë halifët sunnitë.

Kur në këtë mënyrë e ka përgatitur rrugën lucidisht është përcjellur prej mësimit preciz shiit fetar, në mësimin e zoterik, të fshehtë të sektit ismailit.

Gjatë konvertimit të Hebraikëve i nënçmonte të krishterët dhe muslimanët. Me të konvertuarit pajtohej për shfaqjen e shpejtë të Mesiut. Shkallërisht e shpiente në besimin se ky mesi nuk është tjetër kush pos Ali b. Ebi Talibi, Mesi i madh në sektin ismailit.)*

Kur orvatej ta përvetësonte të krishterin, e atakonte mendjemadhësinë Hebraike dhe mosdijen muslimane. I shtronte respektin e vet ndaj parimeve themelore të fesë së krishterë, por me kujdes tregonte në atë se ky besim është në shenjë simbolesh dhe domethëniesh më të thella deri te të cilat mund të vihet vetëm me anë të mësimit ismailit. Ai me shumë kujdes ka dëftuar edhe në atë se të krishterët deri diku keq e kanë interpretuar idenë e Mesiut të pritur, Parakletit, i cili, në realitet, shfaqet në personalitetin e Alij b. Ebi Talibit.

Në këtë mënyrë misionarët ismailit kanë gjetur rrugën në Indi dhe kanë provuar Hindusët t'i përvetësojnë në pranimin e mësimit të tyre duke e treguar Alij b. Ebi talibin si Aratar Vishnen e dhjetë**), që duhet të vijë nga Perëndimi, d.m.th. nga Allamuti.***)

Kanë shkruar, po ashtu, për Mehdi Purana****) dhe kanë hartuar poezi duke imituar në këtë Vamacarius ose dorën e majtë Saktas. Jeta 186

asketike e Hindusëve i ka përgatitur mendjet e tyre në pranimin e doktrinave ezoterike ismailite.21)

Me metodat e këtilla një numër i madh i njerëzve të besimeve të ndryshme është bashkuar në realizimin e programit caqet e të cilave i ka ditur vetëm një numër i vogël njerëzish.

Duket se ambiciet e Abdullah b. Mejmunit kanë qenë ekskluzivisht politike, por mjetet me të cilat është shërbyer në sendërtimin e tyre kanë qenë fetare. Kështu, nën një flamur, ka tubuar mjaft popuj. I ka bashkuar pritja e shfaqjes së shpejtë të imam Mehdiut, Mesiut të pritur.

Aktiviteti i misionarëve dhe historia e këtij sektit kanë kërkuar që shkurtimisht të përmenden në këto faqe.22)

Islami në Azinë qendrore dhe Afganistan

Historia e përhapjes së islamit në vendet e Azisë qendrore, drejt veriut të Persisë, dëfton në aktivitetin e dobët misionarist. Kur Kutejbe b. Muslimi arriti në Samerkand, ka gjetur shumë idhuj. Respektuesit e tyre kanë besuar se çdokush kush i ofendon i ekspozohet vdekjes.

Mirëpo, pushtuesi musliman nuk ka përfillur frikësimet me ato bestyttni, por i ka nderur idhujt. Pasojë e kësaj ka qenë që shumë njerëz kanë kaluar në islam.23)

Të dhënat e pakta, që i kemi para vetes, dëftojnë se kalimi në islam, edhe përkundër të gjithave, ka qenë i parëndësishëm në fillim të

depërtimeve muslimane në Azinë qendrore. Më tej, duket se popullsia e këtyre viseve shpesh është treguar se e ka pranuar islamin, për një kohë, pastaj së shpejti e hiqnin maskën dhe tregonin padëgjueshmëri ndaj halifit posa ushtria e pushtuesit tërhiqej.²⁴) Vetëm kur Kutejbe për së katërti herë e nënshtroi Buharën, arriti ta detyrojë popullësinë që të pajtohet me fenë e pushtuesit të et. Kundërshtimi i popullësisë së Buharës dhe Semerkandit të islamit është dëftuar me mjaft vrazhdësi dhe kryeneqësi, deri në atë masë sa ka qenë e ndaluar bartja e armëve pos atyre që e kanë pranuar këtë fe. Gjatë kohë muslimanët nuk janë paraqitur pa armë në xhamia dhe vendet tejsra publike. S'ka pasur rrugëdalje tjetër pos që konvertitët të mbahen në sy. Pushtuesit kanë dhënë tërë angazhimin që popullin ta përvetësojnë në islam. Kanë provuar me para t'i përvetësojnë që të premtën të marrin pjesë në namazin e xhumasë. E kanë pasur të lirë. U 187

që lejuar që ta citojnë edhe Kur'anin në gjuhën persishte, në vend të arabishtes, në mënyrë që të gjithë sa më lehtë të mund ta kuptojnë dhe marrin vesh.²⁵)

Përparimi i islamit në Transoksani, qartë, ka qenë i ngadalshëm.

Një pjesë e popullësisë i është përgjigjur - thirrjes së halifit Omerit II (717-720) dhe e kanë pranuar islamin.²⁶) Numër i madh është konvertuar nëpërmjet Ebu Sajdes, i cili me misionin e vet ka filluar në Semerkand në kohën e halifit Hishamit II (724-743).²⁷) Mirëpo, pjesa më e madhe e popullësisë të këtyre regjioneve e ka pranuar islamin²⁸) vetëm në kohën e El-Mu'tesimit (833-842). Një nga shkaqet është edhe ky që në këtë kohë kanë qenë lidhjet mjaft të mira me Bagdadin, kryeqendrën e botës muslimane në atë kohë.

Ndër faktorët më të rëndësishëm të përhapjes së islamit në këtë hapësirë bëjnë pjesë Turqit të cilët në numër të madh janë shpërngulur dhe masovikisht i janë bashkangjitur ushtrisë së halifit.²⁹)

Duket se islami, i cili në këtë mënyrë ka marrë hovë në mesin e fiseve turke, është përhapur ngadal deri në shekullin e X kur në këtë fe kanë kaluar krerët e tyre fisnor. Pikërisht sikur që janë shembullin e Klovisit (Clavis) dhe disa mbretërve tjerë barbarë të Evropës veriore, kur e kanë pranuar krishterizmin, e kanë ndjekur shumë fise të cilëve u kanë takuar.

Në atë kohë janë paraqitur shumë legjenda dhe tregime fetare, të cilat kanë zënë vendin e fakteve serioze në aspekt të kalimit të njerëzisë në islam. Për shembull, qyteti Hiva ka celebruar si të shenjtë nacional mundësin musliman Pahlavanin i cili ka qenë në shërbim të sunduesit pagan të Havarizmit. Kur sunduesi i Indisë ka dëgjuar për formën e Pahlavanit, e dërgoi një mundës të vetin të pallatit në pallatin e mbretit havarizmat që ta provokojë në dyluftim. Që caktuar dita kur këta dy njerëz do të provojnë forcën. Janë ftuar shumë autoritarë dhe masë e rëndomtë të Hivës. Të humburit koka i fluturonte nga supet.

Një-ditë para luftës, deri sa i shenjtë Pahlavani është falur në xhami, ka dëgjuar se një plakë e luten Zotin: "O Zot, mos lejo që i biri të humb në luftë me Pahlavanin, sepse nuk kam fëmijë tjetër pos tij" Pahlavani u mëshirua, e tronditi gjendja e kësaj nëne. I mundësoi mundësit të Indisë që ta fitojë. Mbreti urdhëroi që t'i prehet koka sepse e ka kapluar zemërii i madh. Në atë çast kali që ka qenë nën mbretin me shpejtësi nxitoi drejt rrëpira së rrezikshme. Pahlavani vrapoi përpara dhe e kapi kalin për frerë dhe kështu e shpëtoi mbretin 188

nga vdekja e sigurtë. Nga falënderimi mbreti e pranoi fenë e vërtetë islamin. Mundësi i shenjtë atëherë shkoi drejt shkretëtirës plotë gëzim. U dha pas ashetizmit dhe devotshmërisë.30)

Rreth gjysmës së shekullit X tregohet legjenda e çuditshme për islamin e Satuk Bugra-kanit, themeluesin e dinastisë muslimane të Ilhanive në Kashgar. Një nga princat e dinastisë samanidase, Hoxha Ebu Nasr Samani, ka qenë njeri i devotshëm dhe me karakter përunjtes. Ka dëshiruar t'i ndihmojë aftësisë së vet udhëheqëse dhe e zgjodhi tregtinë për profesion. Dëshira në këtë ka qenë që fenë e të vërtetës ta përhap në viset jobesimtare. Në vend që me punët tregtare të grumbullojë sa më shumë pasuri, ai tërë fitimin e shpenzon në rrugën e përfitimit të njerëzve në fenë e re.

Një natë, në ëndër, iu paraqit Pejgamberi (a.s.) dhe i tha: "Zgjohu dhe shko në Turkestan, ku princi Satuk Bugra-kani pret ardhjen tënde që të kalojë në islam." Po ashtu, ky princ në ëndërr ka parë se si e pretë personin që do t'i bëhet mësues më fe. Kjo, pas disa vjetësh, e takoi Ebu Nasr Samanin, ai tashmë ka qenë e gatshëm ta pranojë mësimin e tij dhe të bëhet musliman.

Duket se kjo legjendë është bazuar në faktin historik se islami është shtrirë nga vendi i Samanitive deri në viset fqinje të Turkestanit. Me fjalë tjera, shtetasit turqë të shtetit të Bugra-kanit, duke ndjekur shembullin e tij, shumica e pranuan islamin, sepse në vitin 960 islami e kanë predikuar mbi 200,000 familje turke që kanë jetuar nën tenda.31)

Legjendat i kanë dhënë fuqi amagjike në luftëra, që i ka zhvilluar kundër armiqëve. Kështu rrefehet se vravashka e ndezur i delte nga goja, kurse shpatën që e ngjeshte ka qenë e gjatë dyzet këmbë (një këmbë = 30 cm. SH. N.)

Tregohet se Satuki nuk i kishte mbushur as 69 vjet kurse prej shpatës së tij janë frikësuar jobesimtarët, të cilët kanë banuar në brigjet e lumit OXUS në jug, deri në Karakurum në veri, dhe janë konvertuar në islam. Thuhet se pikërisht para vdekjes së tij ushtritë e tij ngadhnjimtare kanë hyrë në Kinë dhe e kanë përhapur islamin madje deri në turfan.32)

Paraqitja figurative e luftës së kësaj dinastie me mbretërinë budistike Hotan e ka mbështjellur këtë trim në mantelë e suksesit që në të vërtetë kanë ardhur tek në shekullin XVI.

Sa realisht ka qenë i kufizuar suksemi i Satuk Bugra-kanit mund të shihet nga kjo e dhënë. Kur trashëgimtarët nga dinastia e Ilhanitëve 189

kanë dëshiruar në vitin 1026 që të martohet me princeshat e dinastisë së Mahmud Gazneviut, Mahmudi u është përgjigjur se ai është musliman, e ata nuk janë dhe se nuk është traditë e muslimanëve që motrat dhe vajzat e veta t'i martojnë për jobesimtarët. Problemi do të shqyrtohet nëse kalojnë në islam.33)

Një kohë të shkurtër pas kësaj, pra ndërmjet vitit 1041 dhe 1042, disa Turqë që ende kanë qenë paganë, të banuar në territorin e Tibetit, kanë kërkuar nga Arslan-kani b. Kadr-kani që të vendoset në shtetin e tij, sepse kanë dëgjuar për drejtësinë, zemërgjerësinë dhe sundimin e butë të tij. Mirëpo, kur iu afruan Balasaganit,34) ua dërgoi porosinë në të cilën i thërret në islam, por ata këtë e kanë refuzuar. I ka lënë në gjendjen e tyre, sepse janë treguar paqëndashës dhe të dëgjueshëm. Nuk kemi të dhëna për atë sa e kanë pranuar islamin. Sipas të gjitha gjasave kjo ka ndodhur gjatë kohës.

Është vështirë të identifikohen me grupin prej 10.000 familjeve turke që kanë kaluar në islam, i kanë sulmuar dhe plaçkitur muslimanët.35)

Sulmi i Kara Hitajit në Turkestan36) ka qenë goditje e rëndë për forcën islame. Raportet e udhëpërshkruesve evropianë deri në shekullin e XIII dëftojnë në atë se në ato vise kanë qenë grupe më të rëndësishme të budistëve, maniheistëve dhe të të krishterëve.37)

Me rëndësi të madhe për islamin ka qenë konvertimi i turqëve Selxhuk në islam, par për këtë nuk kemi tekst të shkruar përveç raportit të kahershëm se në vitin 956 është shpërngul Serxhuhit me fisin e vet nga Turkestani në krahinën Buhara, ku ai dhe populli i tij e pranuan islamin dhe u bënë ithtarët e tij të zjarrtë.38)

Kjo është prejardhja e Turqëve Selxhuk të njohur, të cilët me fitoret dhe pushtimet e veta e kthyen lavdinë e humbur të ushtrisë muslimane dhe i kanë bashkuar në një imperatori të shtetit musliman të Azisë perëndimore. Kah fundi i shekullit XII shteti selxhuk e humb fuqinë e vet çdokund përveç në Azi të Vogël.

Në kohën kur Muhammed el-Guri i zgjeron kufinjt e imperatorisë së vet, nga Harasani në lindje e deri në Indinë veriore, e ka ringjallë lëvizjen e përhapjes së islamit në mesin e Afganistanezëve. Vendi i tyre ishte përplotë misionarë Arabë dhe Indusë, që kanë kaluar në islam dhe me entuziazëm janë dhënë në përhapjen e mësimin të kësaj feje.39)

Tradita afganistaneze flet për atë se islami në këto treva ka hyrë krejtësisht në mënyrë paqësore. Po ashtu përmendet se Arabët, në 190

shekullin e parë pas Hixhretit, i kanë marrë tokat e Gurëve deri në Herat në lindje dhe se Halid b. Velidi ka arritur atje duke e bartur lajmin e islamit. E ka ftuar popullësinë e këtyre viseve që të vëhen nën

flamurin e Pejgamberit (a.s.), pastaj iu kthye Pejgamberit në shoqëri të deputacionit prej gjashtë ose shtatë personash, që e kanë përfaqësuar popullin afganistanez. Kur këta janë kthyer në vendlindje, filluan t'i kthejnë në islam anëtarët e fiseve të veta.⁴⁰) Ky tregim është pa kurrfarë baze historike.

Lajmi më i rëndësishëm autentik i shënuar për kalimet në islam në mesin e Afganistanezëve mund të jetë teksti i lidhur për kalimin e mbretit të Kabulit në islam në kohën e halifit El-Me'munit.⁴¹)

Duket se trashëgimtarët e këtij mbreti kanë konvertuar në budizëm, sepse kur Jakub b. Lejth, themeluesi i dinastisë saffarite, pushtimet e veta i vazhdoi edhe në Kabul në vitin 811, gjenë se sunduesi i këtyre trevave është idhujtar. Nga kjo kohë Kabulit për herë të parë bëhet plotësisht trevë muslimane.

Nuk është e përjashtuar se Afganistanezët e kanë përshëndetur dhe shërbimin në ushtri të pushtuesit aq të suksesshëm mçfarë ka qenë Jakub b. Lejthi.⁴²) Ende nuk patën përfunduar pushtimet e Sabaktekinit dhe Mahmud Gazneorut, kurse islami tashmë është forcuar gjërë e gjatë Afganistanit.

Për historinë e mëtejme të islamit në Persi dhe Azinë qendrore do të gjenden disa detaje edhe në kaptinat vijuese.

*) Drejti mfantastiko-spekulativ në kohën e krishterizmit të hershëm. Ka synuar kah sinteza e mësimit fetar të krishterë me filozofinë pagane. (vër. përkth.)

**) Sekt pagano-e krishterë që e ka themeluar Persiani Manes. (vër. e përkth.).

1) Cactani, II, fq. 910-911, A. de Gobincan, I, fq. 55-56.

2) Abu Yusuf, Kitab al'Harag, fq. 73.

***) Tatimin që në shtetin islam e kanë paguar jomuslimanët për krye të personit mashkullor të aftë për ushtri.

3) Abu Yusuf, vepra e cituar, fq. 74; Balazuri, fq. 71, 79-80.

4) Cactani, V, 361 (611 e.r.), 394-395, 457.

5) SHih fq. 83.

6) Cactani, II, fq. 910.

7) A. de Gobincan (2), fq. 306-310.

191

8) Dozu, I, fq. 157.

9) Haneberg, fq. 5.

10) Dozy, I, fq. 191, dhe A. de Gobincan, I, fq. 55.

11) Les croyances Mazdeennes dans la religion chiite, por Ahmed-Bey Agaef (Transactions of the Ninth International Congress of Orientalists, vol. II, London, 1893, fq. 509-511). Për pikat tjera prekëse shih: Goldziher, Islamisme et Parsisme (Revue de l'Histoire des Eligions, XLIII, fq. 1 sqq).

12) Dosabhai Franji Karaka, History of Paris, (London, 1884), I,

fq. 56-59, 62-67.

Nicolas de Khanikaff thotë se kah fundi i shekullit XVIII kanë qenë 12.000 familje zjarrputistash në Kirman. (Momoire sur la partie meridionale de l'Asie centrale, Paris, 1861, fq. 193).

13) Chowolsolhn, I, fq. 287.

14) Mes'udi, IV, fq. 86.

15) Istahri, fq. 100, 118 dhe Ibn Hawqul, fq. 189-190.

16) Kitab al'milal wan'nihal, botim Cureton, I, fq. 198.

17) Mas'udi, VIII, fq. 279; IX, fq. 4-5.18) Ibn Halikan, III, fq. 517.

19) Kitab al'Fihrist botim Flügel, fq. 19 (1,2).

20) Për pozitën e tyre nën sundimin musliman përgjithësisht shih: D. Mennant, Les Zoroastrius de Perse (R. du M.M., III, fq. 1943 dhe 421 dhe më tej.

*) Kjo nuk pajtohet me fundamentin e drejtimit fetar ismailit që rekomandon udhëheqjen-imametin e Ismail b. Xhafer es-Sadikut, dhe paraqitjen e shpejtë të njërit prej bijëve të tij. Pa këtë nuk do të mund t'i dallojmë ismailitët që besojnë në imametin e ismailit dhe bijëve të tij dhe shi'ave duodecimalist - ithna asheriyya, që besojnë në imametin e Muso el-Kadhizmit dhe bijëve të tij, dhe zejditëve dhe grupeve tjera shiite, që besojnë në imametin e Alij b. Ebi Talibit. Sa i përket grupës së nusajritëve, ata besojnë në hyjninë e Alij b. Ebi Talibit. (vër. përkth.).

**) Fjala me prejardhje sanskrite, e d.m.th. personalitetin e hyjnizuar që krijon qenie të gjalla. (vër.për).

***) Fortifikata ismailite në male në veri perëndim nga Teherani. (vër.përkth.).

****) Komentit që e ka shkruar Mehdiu.

192

21) Khoja Vritant, fq. 141-148. Për shkak të shpjegimit më të mirë në lidhje me misionarët ismailit në Indi, shih sidomos kaptinën IX të këtij libri.

22) Le Bon Süvestre De Socy, Expose de la Religion des Druzes, I, fq. LXXVI, CXLVIII - CLXII.

23) Belazuri, fq. 421.

24) Narshahi, fq. 46.

25) Njëjtë, fq. 47.

26) Belazuri, fq. 426.

27) tabari, II, fq. 1507 sqq.

28) Belazuri, fq. 431.

29) Angust Müller, I, fq. 520.

30) Cahun, fq. 150.

31) Ibn al'Asir, VIII, fq. 396 (II. 19-20); dhe Grenard, fq. 7, sq. 42-43.

32) Grenard, fq. 9-10. Nga kjo luftë ambicioze tradita ka thurur tregimin për luftën e shenjtë. Legjenda i përshkruan Satuk Bugra-kanit

pushtimin që e ka kryer tek trashëgimtari i tij i dymbëdhjetë. Është absurd i qartë edhe ajo që ky tregim ia përshkruan këtë edhe xhaxhait të Satuk Bugra-kanit, i cili ende ishte idhujtar. Është gabim edhe se ky tregim nga dy personalitete e bënë një. Sulmi mbi Turfanin, tokën e Ujgurëve, i përshkruhet këtij princi, e në realitet e ka kryer personi krejtësisht i treti (burimi i njëjtë, fq. 50.)

33) Raverty, fq. 905.

34) Kjo ka qenë kryeqendra e kanëve të Turkestanit në shekullin X dhe XI. Mirëpo, pozita e saj e vërtetë është e paqartë.

35) Narshahi, fq. 234-235.

36) Raverty, fq. 925-927.

37) Grenard, fq. 76.

38) Raverty, fq. 117.

39) Bellow, fq. 96.

40) Bellow, fq. 15-16.

41) Belazuri, fq. 402.

42) August Müller, II, fq. 29.

KAPTINA VIII

193

PËRHAPJA E ISLAMIT NË MESIN E MONGOLËVE DHE

TATARËVE

Përshkrimi i pushtimeve mongole

Në historinë e vet islami nuk ka përjetuar katastrofë dhe terror më të madh se pushtimet mongole. Sikur orteqet e barës nga malet e larta u sulen hardhitë e Xhingis-kanit në qendrat e kulturës dhe civilizimit islam. Pas vetes kanë lënë shkretirë dhe gërmadha në vendet ku dikur kanë qenë pallatet e dinastive sunduese, të rrethuara me kopshtet e pasura dhe fushat e gjelbëra.

Kur ushtria mongole e lëshoi qytetin Herat, dyzet banarë të saj kanë dalë nga strehimaret e veta dhe me koka të përlurura kanë filluar të qajnë mbi gërmadhat e qytetit të vet. Ka qenë kjo një pjesë prej rreth 100.000 banorëve të këtij qyteti.

Në qytetin Buhari, që ka qenë i njohur me njerëz të ditur e të devotshëm, Mongolët i kanë shndërruar xhamitë në shtalla për kuajt e vet. Kur'anët i kanë shqyer dhe i kanë vënë nën kafshët e veta kalëruese. Një pjesë të popullësisë, që i është shmangur masakrës, e kanë marrë në robëri, deri sa qyteti u është shndërruar në hi, të cilin era e ka shpërndarë. Fatin e ngjashëm e kanë pasur edhe Semerkandi, Belhi dhe shumë qytete tjera të Azisë qendrore të cilët më herët kanë qenë krenari të civilizimit islam, vende të njerëzve të dashur të Zotit - evlijave dhe qendra të diturisë. Këtë fat e ka përjetuar edhe Bagdadi, i cili shumë shekuj ka qenë kryeqendër e dinastisë abasite.

Kronistëve muslimanë nga të gjitha tmerret lëkura u tërqethet dhe tmerrohen kur përmenden sulmet mongole në vendet islame. Kjo pikërisht i ndodh Ibn Ethirit kur i përshkruan sulmet e Mongolëve dhe

thotë:*) "Gjatë kohë kam ngurrar ta përmendi këtë ndodhi për shkak të madhërisë së tij dhe neverisë sime nga përkujtimi në të. Ja, me mundim dhe padëshirë po i qasem kësaj pune.

Kush e ka lehtë të shkruaj për grahmën e vdekjes së islamit dhe uslimanëve? Kush mundet lehtë gjithë këtë ta shkruaj? Çfarë fati sikur të mos më kishte lindur nëna. Oh, sikur të kisha vdekur para kësaj dhe të kisha ra plotësisht në haresë.1)

Shumë miqë më kanë shtyrë që këtë ta shëngë, e unë qëndroja. E pastaj ka parë se është e padobishme ta lëshë këtë dhe prandaj them: Ky veprim përfshinë ndodhi të tmerrshme dhe fatkeqësi të madhe, të 194

cilën sipas ngjashmërisë nuk e dijnë ditët dhe netët. Këtë e kanë ndier muslimanët më tepër nga popujt tjerë.

Sikur dikush të thoshte se prej krijimit të njeriut - Ademit prej Allllahut deri sot bota nuk ka përjetuar fatkeqësi të ngjashme, do ta thoja të vërtetën. Historia nuk ka shënuar diç që do t'i ishte e afërt ose e ngjashme.

Më së shumti që përmendet janë ndodhitë të lidhura për masakrën e Benu Israilëve (Izraelitëve) dhe rrënimin e Jerusalemit, që e ka kryer Nabukodonosor.

Por, ç'është Jerusalei në krahasim me atë që këta të mallkuar kanë rrënuar në krahinat ku çdo qytet ka qenë shumëfish më i madh se Jerusalemi? Ç'janë Benu Israilët (Izraelitët) në krahasim me ata që i kanë mbytur? Vetëm popullata e një qyteti është më e madhe nga Benu Israilët. Të shpresojmë se bota asnjëherë më nuk do të përjetojë katastrofën siç është kjo."2)

Konkurrenca e religjioneve të ndryshme në përvetësimin e miqësisë së Mongolëve

Nuk ka pasur tjetër pos që islami sërish të ngritet nën gërmadhat e fuqisë dhe lavdisë së vet të dikurshme dhe që me ndihmën e misionarëve të vet (dua'tëve) t'i bind këta pushtues barbarë që ta përqafojnë.

Merita për këtë qëndron në angazhimin e misionarëve muslimanë të cilët kanë qenë të shtrënguar me kokëçarje të ndryshme, prej të cilave më e madhja ka qenë kundërvënia konkurrentëve të fuqishëm, misionarëve të feve tjera në këtë fushë.

Të rrallë janë pa dyshi mpamjet e tilla të çuditshme në historinë e botës siç është lufta që është zhvilluar ndërmjet budizmit, krishterizmit dhe islamit. Çdo religjion i ka konkurruar tjetrit në tërheqjen e zemrave të këtyre pushtuesve të vrazhdë të cilët me këmbët e tyre i kanë shkelë qafat e pjesëtarëve të të gjitha këtyre religjioneve të mëdha. Këto religjione kanë pasur propaganduesit dhe misionarët e vet në të gjitha vendet dhe krahinat.

Para se t'i qasemi pasqyrimin të lajmeve të këtij konflikti, por edhe që ta kuptojmë më mirë, e gjejmë të arsyeshme që shkurt ta hedhim

një shikim mnë katër pjesët të imperatorisë mongole të ndarë katër bijëve të Xhingis-kanit pas vdekjes së tij.

195

E trashëgoi djali i tretë Ogutay*) si kagan (kani suprem).

Atij i takoi pjesa lindore e imperatorisë, të cilës, më vonë, Kubilaji ia ka bashkangjitur edhe tërë Kinën. Me pjesën e mesme të Mbretërisë ka dominuar djali i dytë, Xhagataj, Batuni, i biri i djalit ë të vjetër Dzugjit, ka sunduar me viset perëndimore si kani i hardhive të Arta. Djali i katërt Tuluj ka sunduar me Persinë, të cilën Hulagu, themeluesi i dinastisë së Ilhanive në këto treva, ia ka bashkuar pjesën më të madhe të Azisë së Vogël.

Shamanizmi ka qenë besim primitiv i Mongolëve. Përveç pranimit të hyjit (Zotit) suprem të fuqishëm, megjithatë në lutje nuk i janë drejtuar Atij por disa zotërave të shalitur. Sidomos këtë e kanë bërë ndaj hyjnive të të keqes. Atyre u kanë bërë edhe fli. Kanë konsideruar se këto hyjni kanë fuqi të madhe për shqetësim. Kanë besuar edhe në kalimin e shpirtërave të gjyshërve në pasardhës dhe se ata kanë ndikim në jetën e tyre.

Që ta harmonizojnë fuqinë e qiejve dhe botës së ulët, iu drejttoheshin priftërve Samanëve, fallxhorëve dhe mjekëve. Kanë konsideruar se këta kanë ndikim të fshehtë dhe fuqi çudibërëse në të vdekurit dhe në shpirtërat e tyre.

Së këndejmi religjioni i tyre edhe nuk ka mund të llogarisë në atë se gjatë do t'u kundërvihet orvatjeve të feve të simpatizuesve dhe ndihmuesve të shumtë të asaj teologjie sistematike, që posedon tërë fuqinë e bindjes, argumentet racionale dhe institucionet e organizuara të mësuesve fetarë dhe propaganduesve.

Duke u gjendur në kontakt me popujt e mësimëve më të larta religjioze, Mongolët kanë rënë nën ndikimin e tyre kulturor dhe shkallërisht kanë dalë nga barbaria e vet. Ka ndodhur që në mesin e popujve që janë përzier me Mongolet, pas pushtimeve të tyre, ka qenë numër i madh budistësh, të krishterësh dhe muslimanë.

Besimtarët ekëtyre tre religjioneve misionariste kanë garuar në konvertimin e pushtuesëve në fenë e tyre.

Pasi që u qetësua shtërngata, dhe pasi kanë lënë rrënimet, me çka janë shquar pushtimet e tyre, Mongolët shamanistë në mënyrë tolerante kanë vepruar me pjesëtarët e religjioneve tjera. Klerikët dhe misionarët e tyre i kanë liruar nga tatimi dhe u kanë dhënë lirinë e plotë në kryerjen e liturgjive të tyre fetare.

Në kohën e Xhingis-kanit (1206-1227) klerikët budistë kanë zhvilluar diskutime fetare me klerikët shamanë në praninë e tij.

196

Në pallatet e Mangu-kanit (1248-1257) dhe Kublaj-kanit (1257-1294)³ mbrojtjen e kanë gëzuar klerikët budistë e të krishterë dhe imamët muslimanë.

Në kohën e sundesit të fundit mongol në Kinë në mesin e Mongolëve kanë mund të shihen rezultatet e ndikimit të budizmit, të përhapur rreth tyre.

Qysh në shekullin e XIV besimi budistik gati krejtësisht ka sunduar me shpirtërat e Mongolëve.4) Meritë e madhe në këtë konvertizëm u takon lamave nga Tibeti. Deri më sot populli Mongolisë i takon kësaj feje, sikur edhe Kalnukët, të cilët janë shpërngulur në Rusi në shek. XVII.

Deri sa budizmi i ka krijuar vetes vend të rëndësishëm në pjesën lindore të imperatorisë mongoliane, deri atëherë, në fillim, nuk ka qenë aspak ndikimi më i vogël i kishës së krishterë dhe shpresa dhe dëshira e njerëzve të saj në konvertimin e Mongolëve në fenë e saj. Misionarët nestorian kanë përcjellur mësimin e krishterë në shekullin e VII nga perëndimi në lindje, prej Azisë deri në Kinën veriore. Grupacionet e tyre të shpërndara kanë qenë në ato vise deri në shekullin e XIII.

Disa historianë supozojnë se kleriku Jovani, për emrin e të cilit janë të lidhura shumë legjenda nga mesjeta, ka qenë epror i fisit Karait, Tatarëve të krishterë, fisit që ka jetuar në jug të liqenit të Bajkalit.

Kur e ka pushtuar këtë fis, Xhingis - kani është martuar me vajzën e eprorit të tyre të atëhershëm, kurse nga familja e njëjtë është martuar edhe i biri i tij Ogataji. i biri i Ogatajit Kujki, i cili nuk ishte i krishterë, ka treguar mjaft simpati ndaj këtij religjioni, të cilit i kanë takuar shefi i qeverisë së tij dhe një sekretar.

Simpatinë e tij të lartë në pallat e kanë gëzuar klerikët nestorianë, kurse në kohën e njëjtë ka pranuar edhe deputacionin e papë Inoqentit IV.5)

Këto forca të krishtera nga lindja dhe perëndimi kanë pritur ndihmën e Mongolëve në luftë kundër muslimanëve.

Hajtoni, sunduesi i krishterë i Armenisë, ka qenë faktori ndihmues në përvetësimin e Mongu-kanit (1248-1257) që ta dërgojë ekspeditën ushtarake që e ka rrënuar Bagdadin nën komandimin e Hulagos.6) (1256-1265).

197

Gruaja e tij e krishterë ka pasur mjaft ndikim në atë që ky të tregojë mjaft simpati ndaj të krishterëve, veçon ndaj nestorianëve.

Shumë Mongolë që i kanë pushtuar vendet e Armenisë dhe Khurxhisë e kanë pranuar krishterizmin dhe kanë qenë të kryqar nga ana e e të krishterëve të kësaj ane.7)

Tregime të pabesueshme e të çuditshme janë lindur për madhërinë dhe fuqinë e popë jovanit, që e kanë ndezur imagjinatën e Evropës mesjetare, që ka krijuar bindjen se Mongolët kanë qenë të krishterë. Bindjen e këtillë e kanë forcuar dhe lajmet e rrejshme që kanë depërtuar në Evropë për konvertimit e disa princave mongolë në

krishterizëm dhe për lojalitetin e tyre kësaj feje dhe ndihmës çështjes së saj.

Nën ndikimin e këtyre tregimeve Shën Lluji ka dërguar Viliamin nga Rubruki (William of Rubruck) si ambasador të vetin kanit suprem (kaganit) që ta përkrahë në përpjekjen e tij që ta përhapë krishterizmin.

Së shpejti doli në dritë se të gjitha këto lajmeve kanë qenë pa bazë, ndonëse Viliami nga Rubruku ka konstatuar se krishterizmi është toleruar në pallatin e Mangu-kanit dhe se pranimi i kësaj feje nga ana e një pakice të Mongolëve ka krijuar, te disa klerikë të krishterë, shpresën në përhapjen e mëtejme të kësaj feje.

Paraqitja dhe futja e mospajttimeve teologjike të Latinëve (katolikëve), Grekëve (ortodoksëve), nestorianëve dhe Armenëve dhe në llogarin mongol, ka zvogëluar shpresën në suksesin më të madh se sa që deri atëherë është arritur.

Mosekzistimi i unitetit dhe pajtimit në mesin e misionarëve të krishterë ka shkaktuar sukses të dobët të punës së tyre ndër Mongolët.

Deri sa këto sekte të krishtera ndërmjet veti janë pajtuar, deri atëherë budizmi dhe islami janë forcuar në vendet mongole.

Kërkesat kryelarta të papës romak dhe ndihmtarëve të tij ndaj pushtuesve të gjysmës së botës kanë shkaktuar ndërrimin e simpatisë së parë ndaj misionarëve të tij. Por që veprimi rommako-katolik misionarist të tërhiqet, ka pasur edhe shkaqe tejsa.8)

Sa u përket nestorianëve, të cilët këtu u paraqitën të parët, kanë ra në nivel të atillë të padijes, degjenerimit dhe apatisë sa nuk kanë mundur të shfrytëzojnë rrethanat e favorshme.

Për nestorianët në Kinë Viliam Rubruku thotë⁹⁾ se kanë qenë injorantë të mëdhenj. Nuk kanë kuptuar as librin e lutjeve të tyre të 198

shkruar në gjuhën sirjane. Ai i fajëson për dehje, poligami dhe lakmi duke bërë krahasim objektiv ndërmjet jetës së tyre dhe jetës së klerikëve budistë.

Peshkopi i tyre i vizitonte shumë rrallë, njëherë madje në pesëdhjetë vjet. Kur ndodhte kjo, atëherë i radhiste të gjithë fëmijët mashkuj, e madje edhe ata në djepë. Priftërinjt kanë tregtuar me pozitat fetare duke bërë qarkullim në llogari të liturgjive fetare të kishës, duke e lënë pjesën më të madhe të parave për veti që është grumbulluar për propagandën fetare.10)

Në pjesit perëndimore të imperatorisë perëndimore, ku të krishterët nga kjo forcë në ngritje kanë pritur që t'i ndihmojë në luftërat që i kanë zhvilluar kundër muslimanëve dhe t'ju sigurojë dominimin e Tokës së Shenjtë, ndërmjet të krishterëve dhe Mongolëve ilhanist në Iran ka ekzistuar aleanca e kohës të shkurtër, sepse fitoret të cilat Zahir Bajbarosi, sulltani memelukas i Egjiptit (1266-1277), dhe aleanca e tij me Baraka-kanom (1256-1266)* i kanë detyruar Ilhanitët

që më tepër t'u kthehen intereseve vetjake.

Autoriteti i të krishterëve dhe emrat e tyre në Azinë perëndimore ka rënë edhe për shkak të ekscesit qi të krishterët e Damaskut dhe të disa qyteteve tjera të Sirisë i kanë bërë për një kohë të shkurtër deri sa e kanë gëzuar simpatinë e Mongolëve nga Persia.11)

Pengesat në rrugën e Islamit

Në konfliktin ndërmjet Mongolëve dhe muslimanëve në Siri pjesëtarët e të dy këtyre feve kanë treguar shumë egërsi.

Mund të merret një shembull nga gjysma e shekullit XIII që e shtronë El-Xhuzxhani. Ai pohon se në Delhi ka dëgjuar tregimin nga njëfarë Sejjid Eshrefuddini që ka ardhur nga Semerkandi.

"Sejjidi i respektuar rrëfen se në Semerkand ndonjë i krishterë ka kaluar në islam. Muslimanët e devotshëm të qytetit i kanë kushtuar kujdes dhe respekt dhe e kanë dhuruar me pasuri.

Në ndërkohë në Semerkand ka arritur nga kina një i pafe autoritativ dhe ndikues Mongol, që ka ushqyer simpati ndaj krishterizmit.

Të krishterët e qytetit kanë ardhur tek ai dhe i janë ankuar me fjalët: "Muslimanët i trimërojnë fëmijët tonë në lëshimin e krishterizmit dhe shërbimin Jezusit - paqa qoftë me të - dhe i nxisin në 199

pranimin e fesë së Mustafait (të zgjedhurit, Muhammedit a.s., vër N. I.) - paqa e bekimi qoftë me të. Nëse këto dyer nuk mbyllen para muslimanëve, të gjithë fëmijët do të na lëshojnë krishterizmin. Me autoritetin dhe sundimin e vet e zgjodhi problemin tonë."

Mongoli urdhëroi që t'i silllet djaloshi që është bërë musliman.

U orvaten ta bindin me fjalë të bukura dhe me pasuri që të heq dorë nga feja e re, por ai refuzoi ta bëjë këtë sikur që refuzoi edhe që nga zerma dhe shpirti i vet ta heqë ruhon e ri, besimin islam.

Sunduesi i Mongolëve u sulë mbi djaloshin dhe filloi të fletë për denimin e rreptë. Mbi djaloshin, që nuk dëshiroi ta lëshojë fenë për shkak të dashurisë së zjarrtë për islamin, ka kryer shumë denime dhe ashpërsi të ndryshme.

Goditjet e dorës së këtij pabesimtari kryeneq nuk kanë mundur nga djaloshi ta nxjerrin kafshatën e ëmbël të islamit.

Kur djaloshi ka mbetur i fortë në fenë e vërtetë duke mos i dhënë rëndësi premtimit dhe kërcënimit që vinte nga kjo shoqëri e çoroditur, Mongoli i mallkuar ka urdhëruar që ndaj djaloshit të ekzekutohet denimi me vdekje botërisht. Djaloshi e lëshoi këtë botë në lumturinë e fesë - Zoti e shpërbleftë me bollëk.

Ky ka qenë shkaku i pikëllimit dhe frikës së muslimanëve të Semerkandit. Është ngritur peticioni me dëshmimin e krerëve dhe muslimanëve autoritativ të Semerkandit dhe me te erdhën në llogarin ushtarak të Barako-kanit. Kemi dalë dhe ia kemi përshkruar sjelljet dhe moralin e të krishterëve që jetojnë në atë qytet.

Dashuria e zjarrtë ndaj islamit ka krijuar në mendjet e këtij monarku ndjenjën se kjo është pa dyshi mfeja dieale. Mbrojtja e të vërtetës i është bërë motivacion i fuqishëm.

Pas disa ditësh Barako-kani i ka dhënë nderin Sejjidit dhe ia ka caktuar një grup Turqish dhe personalitetesh të besueshme në mesin e muslimanëve duke iu urdhëruar që t'i mbysin të krishterët që kanë marrë pjesë në krimin e përmendur dhe që t'i dërgojnë në skëterrë. Kur iu është dhënë ky urdhër, e kanë fshehur, deri sa kjo grup e pafatshme nuk u tubua në kishë. Atëherë i kanë kapur dhe i kanë mbytur deri në një, duke i përgatitur për skëterrë, kurse kishën sërish e kanë shndërruar në gërmadha."12)

Duket se fuqia konkurrente e islamit në fillim të sundimit mongol në krahasim me forcat e fuqishme të budizmit dhe krishterizmit kanë qenë e pashpresë dhe e dobët.

200

Muslimanët kanë përsuar shumë më tepë rnga pasojat tjera të invadimeve mongole.

Shumica e qyteteve që deri në atë kohë kanë qenë qendër e fuqisë fetare, Kabe e shkencës së islamit në kontinentin aziatik, janë bërë gërmadha të rëndomta. Juristët islamë, teologët dhe të devotshmit ose janë mbytur ose janë bërë robër.13)

Ka pasur në mesin e udhëheqësve mongolë - të cilët rëndom kanë qenë të njohur sipas tolerancës ndaj të gjitha feve - asosh që veçan kanë treguar durim ndaj islamit.

Xhingis-kani ka urdhëruar që të mbytet çdokush kush therë kafshët sipas dispozitave islame. Drejtimin e njëjtë e ka ndjekur edhe Kubilaji. Ia ka caktuar shpërblimin secilit kush dëfton në atë kush therrë në mënyrën islame. Plotë shtatë vjet tmerrësisht i ka persekutuar muslimanët.

Shumë varfanjakë kanë arritur pasuri gjatë zbatimit të këtij ligji, kurse robërit janë liruar duke i akuzuar zotërinjtë e vet për therjen e këtillë të kafshëve.14)

Persekutimin dhe torturën më të madhe muslimanët e kanë përjetuar gjatë kohës së sundimit të Kujukut (1246-1248) i cili sundimin e brendshëm ia ka lëshuar dy ministrave të vet të krishterë, kurse pallatin e ka pasur përplotë me priftër të krishterë.15)

Historiani bashkëkohor El-XHuzxhani jep pasqyrën vijuese të tretmanit dhe sjelljes me një jurist islam në pallatin e Kujukut.

"Personii besueshëm transmeton se Kujuki ka qenë vazhdimisht i ndërsyer nga klerikët budistë ndaj muslimanëve dhe në maltretimin e tyre.

Në vend atëherë ka jetuar një dijetar islam, Imam Nuruddin el-Havarizmi. Një numër i caktuar i laikëve dhe klerikëve të krishterë, dhe fallxhorëve dhe klerikëve idhujtarë, budistë e kanë lutur Kujukun duke kërkuar ta ftojë atë imam në diskutim dhe kuvendim me ta, dhe

nëse nuk u jep provë bindëse të superioritetit të fesë islame dhe vërtetimin e peygamberisë së Muhammedit (a.s.), që të ekzekutohet. Kani ka plotësuar kërkesën e tyre dhe e ftoi imamin. Diskutimi filloi në temën e vërtetësisë së peygamberisë së Muhammedit, sjelljes së tij në jetë në krahasi me peygamberët tjerë. Pasi provat e këtyre të mallkuerrëve kanë qenë të dobëta, pa fuqinë e të vërtetës, kanë çuar duart nga diskutimet me prova dhe argumente, 201

e kanë skicuar planin e ri të padrejtësisë dhe urretjes në atë anë që kanë dëshiruar ta aplikojnë në vepër.

Kanë kërkuar nga Kujuk-kani që t'i urdhërojë këtij imami që dy herë të bjerë në gjunjë - t'i bëjë dy sexhde-sipas dispozitave dhe mësimit të shariatit, dhe që para tyre dhe Kanit të tregojë jodenjësinë e lëvizjes të ritualit të tyre fetare.

Kujuki i ka urdhëruar imamit dhe edhe një muslimani, që ka qenë me të, që ta kryejnë lutjen (namazin) sipas dispozitave islame. Kur imami i devotshëm dhe ai muslimani tjetër ranë në sexhde (u përulën), Kujuki dhe pabesimtarët, që i patë ftuar, së tepërmi i kanë keqtrajtuar duke i goditur rreptë me kokë për toke, duke iu bërë edhe veprime tjera neveritëse.

Gjithë ky keqtrajtim dhe shqetësim nuk e ka penguar këtë imamm të devotshëm që sipas rregullave ta kryej namazin.

Kur imami e kreu namazin dhe dha selam, fytyrën e kthen kah qielli dhe shqiptoi: "Lutune Zotin tuaj të përulur e në ëheshtë"16), e ka lutur pastaj Kujukin që t'i lejojë të shkojë, pas çkahit u kthye në shtëpi."17)

Arghuni (1284-1291), Ilhani në Persi, i ka keqtrajtuar muslimanët e vendit të vet. I ka hequr nga të gjitha pozitat gjyqësore dhe financiare. Ua ka ndaluar ardhjen në pallatin e tij.

Përveç të gjitha këtyre peripetive, Mongolët dhe fiset barbare18), nëfund, iu nënshtruan fesë së popujve muslimanë, të cilët i kanë nënçmuar dhe i kanë shtruar nën këmbët e veta.

Për fat të keq, historia ka hedhur pahë dritë në përparimin e lëvizjes misionariste islame, me përjashtim të numrit të vogël të hollësive të lidhura për kalimin në islam të disa personaliteteve të rëndësishme.

Pa dyshim, ka pasur shumë ndihmues të Peygamberit (a.s.) të cilët janë shpërndarë anëkënd imperatorisë mongole duke luftuar në fshehje që pabesimtarët t'i tërheqin në gjirin islam.

Në kohën e sundimit të Ogatajit (1229-1241) lexojmë se guvernatori budist i Persisë, i quajtur Kurguz, ka kaluar në islam.20) Gjatë kohës së sundimit të Timur-kanit (1323-1328), Ananda, nipi i Kubilajit, nën mbreti i Kantu-it, ka qenë musliman i zjarrtë. E ka nxitur mjaft popullatën e Tangutit që ta pranojnë islamin, sikur edhe numrin më të madh të ushtrisë që ka qenë nën komandimin e tij.

202

Përveç asaj që është ftuar në pallatin e Timurit që të kthehet në budizëm, ka refuzuar dhe ka mbetur lojal fesë së vet të re. Ka qenë hedhur në burg për këtë shkak, por është liruar nga frika prej kryengritjes së Tangutit, e cila ka qenë mjaft lojale për të.21) Autori i veprës "Muntahab at-tawarih" (Zgjedhje nga historia) pohon se Ananda ka ndërtuar katër xhami në Hanbalig (Pekingin e sotëm) të cilat kanë mund të pranojnë një milion njerëz të xhumanë për namazin e xhumasë. Mirëpo, nuk ekziston baza për këtë dhe tregiemt tjera të autorit në lidhje me përhapjen e islamit në Kinë. Sipas tij, Ananda e ka trashëguar timur-kanin në fronin e imperatorisë mongole. Është legjendë e pastër edhe kjo se pesë trashëgimtarë të Timurit, të cilët kanë ekzistuar vetëm në imagjinatën e këtij autori, e kanë pranuar islamin.22)

Muslimanët e parë (1256-1267)

Baraka-kani ka qenë sunduesi i parë mongol që e ka pranuar islamin. Ka qëndruar në krye të hardhisë së Artë në Rusi ndërmjet vitit 1256 dhe 1267.23)

Sipas Ebu Gaziut, e ka pranuar islamin pas ardhjes në fron. Ai thotë se Kani një ditë hyri në një karavan, që ka ardhur nga Buhara. Kur është vetmuar me dy tregtarë, i ka pyetur për bazat e fesë islame. Ata aq bukur ia shpjeguan që ai pas kësaj sinqerisht e ka pranuar islamin.

Ndërrimin e vet të fesë dhe kalimin në islam msë pari ia zbuloi vëllaut të vet më të ri dhe dëshiroi që edhe ai të shkojë shembullit të tij. Pastaj botërisht e pranoi fenë e vet të re.24)

Por, Xhuzxhani thotë se Barakakani ka pranuar islamin në fëmijëri, kur është vritur për mësim. E mësoi Kur'anin përmendsh para një alimi të qyteti Hoxhand (Hokned).25) Autori i njëjtë (që e ka hartuar historinë e vet gjatë jetës së Baraka-kanit) përmend se e tërë ushtria i është muslimane. "Personat e besueshëm përmendin se çdo kalorës në ushtrinë e tijka bartur me vete sexhaden për namaz, ashtu që kur vinte koha e namazit, secili preokupohej me namaz. Nuk ka pasur askush në ushtrinë e tij që ka pirë çfarëdo pije dehëse. Shoqërinë e tij të lartë e ka bërë ulemajë e njohur e mufessirëve, muhaddithëve, fakihëve dhe mutekellimëve. Ka pasur numër të madh të librave fetarë. Pjesa më e madhe e takimeve dhe debatave ka qenë

203

me ulemanë. Në takimet dhe ndejtet e tij diskutimet dhe polemikat fetare kanë zënë vend kryesor. Në besimin e tij ka qenë, si musliman, strikt dhe ortodoks."26)

Baraka-kani ka hyrë në aleancë me Ruknaddin Bajbarsom (1260-1277), me sulltanin mamelukos të Egjiptit. Iniciativa ka rrjedh nga ky i fundit, që i ka ofruar mbrojtje dhe pritje të mirë një grupi prej 200 ushtarësh, pjesëtarë të hordhisë së Artë: Kur këta ushtarë kanë ndër

armiqësinë ndërmjet kanit të tyre dhe Hulagos, pushtuesit të Bagdadit, në ushtrinë e të cilit edhe ata kanë shërbyer, kanë ikur në Siri.

Saudejmi kanë arritur në Kairo ku janë pritur me të gjitha respektet në pallatin e Bajbarsit, ku i ka disponuar të kalojnë në islam.17)

Bajbarsi ka qenë në luftë me Hulagon. Shkurt para kësaj Bajbarsi e ka vizituar dhe e ka zbrapsur prej Sirisë.

Bajbarsi i ka dërguar dy Mongolë të ikur dhe disa të deleguar tjerë me letrën për Baraka-kanin. Kur këta janë kthyer prapa në Egjipt, kanë njoftuar se çdo princ dhe çdo princezë në pallatin e Baraka-kanit kanë imamin dhe muezinin e vet dhe se fëmijet kanë mësuar Kur'anin përmendsh në shkolla.28)

Rezultati i këtyre lidhjeve miqësore ndërmjet Bajbarsit dhe Baraka-kanit ka qenë që shumë Mongolë të hordhisë së Artë kanë ardhur në Egjipt dhe bëheshin muslimanë.29)

Islami i Mongolëve ilhanitë

Në Persi, në të cilën Hulagu e ka themeluar dinastinë e Ilhanitëve, përhapja e islamit në mesin e Mongolëve ka qenë ëmjaft e ngadalësuar.

Që t'i pengojë sulmet e Baraka-kanit dhe sulltanit egjiptian, Hulagu lidh aleancë me forcat e krishtera në lindje, si psh. me mbretin e Armenisë dhe me kryqtarët.

Gruaja e tij e dashur ka qenë e krishterë. Ajo ka ndikuar në simpatitë e Hulagos ndaj bashkëbesimtarëve të saj. I biri Abaka-kani (1265-128-) është martuar me të bijën e imperatorit bizantinas. Ndonëse Abaka-kani nuk është bërë i krishterë, pallati i tij ka qenë përplotë klerikë të krishterë. Ka dërguar shumë deputacione tek sunduesit evropianë, si Lujit të Shenjtë, mbretit të Francës, Karlit, mbretit të Sicilisë, mbretit të Aragonës Xhemsit, duke kërkuar prej tyre aleancë kundër muslimanëve.

204

Me qëllim të njëjtë në vitin 1274 ka dërguar deputacionin prej 16 anëtarëve koncilin (kuvendit) lionas. Shefi i këtij delegacioni e ka pranuar krishterizmin edhe me disa përcjellës të tij.

Të krishterët atëherë kanë ushqyer shpresa të mëdha në konvertimin e Abaka-kanit në krishterizëm, por shpresat u kanë dështuar.

Vëllau i Abaka-kanit Takudar-Ahmedi30) (1274-1282), i cili e ka trashëguar, ka qenë Ilhaniu i parë Mongol që e ka pranuar islamin (në Persi).

Ai është rritur si i krishterë (si na njofton autori bashkëkohor i krishterë) dhe është kryqar në fëmijëri me emrin Nikola. Kur u bë madhor, e pranoi islamin. Më shoqërimin me muslimanët, të cilët i kanë qenë të dashur, është bërë saraceu musliman i poshtër. Duke e lëshuar krishterizmin, ka dëshiruar të quhet Muhammedkan. Ka dhënë tërë angazhimin që t'i kthejë të gjithë tatarët në fenë dhe drejtimin e Muhammedit.

Kur janë dëftuar të fortë në fenë e vet dhe nuk janë pajtuar në ëpranimin e islamit, ai ka përvetësuar me anë të dhuratave, pozitave të nderit dhe titujve numër të madh të Tatarëve për fenë e saracenëve - muslimanëve."31)

Për kalimin e vet në islam ky sundues ka dërguar shkresën vijuese sulltanit mamelukas (Kaldunit) në Egjipt: "Në emër të All-llahut të gjithmundshëm, sipas urdhërit të Ahmedit, sulltanit të Egjiptit. Allllahu - çdo lavdi I qoftë - me kujdesin e vet dhe me dritën e Udhëzimit të vet neve, në rininë e hershme, na ka udhëzuar në shtegun e vërtetë dhe njohjen në Hyjninë e Tij, në pranimin e njësisë së Tij dhe dëshmimin e vërtetësisë së pejgamberisë së Muhammedit - mbi të qoftë bekimi dhe paqa - prej Zotit dhe mendimi i mirë mbi ithtarët e tij të mirë. "Kënd e udhëzon All-llahu ai ia disponon shpirtin për islam."32)

Synimet tona janë drejt theksimit të fjalëve të fesë dhe përmirësimit të gjendjes së islamit dhe muslimanëve. Në kohën kur e trashëgojmë sundimin (imperatorinë) pas babait dhe vëllaut të lavdishëm, Zoti mbi ne e ka derdhur lavdinë e nderit dhe kujdesit të Vet dhe në bollëkun e dashamirësisë së Tij janë sendërtuar dëshirat tona, duke na ngritur dhe dhuruar këtë shtet si bashkëshokë fisnikë. Në Kuriltaj (Quriltay) ose në Kuvendin e madh takohen vëllezërit tonë, bijtë, bujaria e lartë, komandantët dhe sunduesit e krahinave, 205

oficerët e forcave tona ushtarake, dhe aty e mbajnë kuvendin. Ata janë pajtuar në atë që e ka zbatuar qeveria e vëllaut tim të vjetër në angazhimin e ushtrisë së madhe, nga numri i madh i së cilës është dridhur toka, e mbushur me frikën e forcës së saj, gjatë goditjes së të cilit është rrënuar dhe është zbutur guri, i ka nënshtruar kodrat dhe luginat në të gjitha anët.

Ne e kemi shqyrtuar këtë vendimin e tyre, që e ka shprehur dëshirën e të gjithë atyre, dhe kanë gjetur se vendimi i tillë është në kundërshti me atë që është në shpirtërat tonë sipas të mirës së përgjithshme dhe që është manifestim i forcimit të përcaktimeve të Islamit.

Asnjëherë, deri sa të kemi mundësi, nga ana jonë nuk do të jepen urdhëra pos atyre që do ta pengojnë derdhjen e gjakut dhe heqjes së të keqes nga njerëzit, që në të gjitha vendet të mbretërojë siguria dhe paqa, që sunduesit e vendeve tjera të sillen me mirësi dhe gjithëmire, duke e madhëruar urdhërin e All-llahut dhe mëshirën ndaj krijesave të Tij.

All-llahu na ka inspiruar që ta fiki mkëtë zjarr dhe t'i përfundojmë ato fatkeqësi të rënda duke e shpallur atë kush ka dëftuar në idenë, me të cilën na ka udhëzuar Zoti dhe ka vendosur në zemrat tona, ta ofrojmë ilaqin e pritur e të dëshiruar botës nga sëmundjet, e që t'i shmangemi asaj që do të ishte ilaqi i fundit.

Ne nuk dëshirojmë të ngutemi me ngrehjen e armëve për luftë deri sa paraprakisht nuk e konfirmojmë rrugën e vërtetë, as që i ngutemi luftës deri sa nuk e konfirmojmë të vërtetën e qartë dhe provën. Vendosshmëria jonë është forcuar me atë që e gjejmë si impuls të mirës, dhe kryerja e asaj që na duket e suksesshme sipas këshillës së Shejhu-l-Islamit, shembullit të të devotshmëve, që na ofron shumë ndihmë në punët e fesë.

Ne e kemi caktuar juristin tonë kryesor Kutbuddinin dhe Ata-be Behaiddinin - që të dytë janë personalitete vërtetdashëse të kësaj mbretërie të përparuar - që të ju njoftojmë me drejtimin tonë dhe t'ju dëftojmë në qëllimet tona më të mira për të mirën tonë të përgjithshme të muslimanëve. Ie të dihet se All-llahu na ka ndritur dhe se islami e ka anuluar çdo gjë që ka qenë para kësaj, dhe All-llahu i madhëruar ka mbjellur në zemrat tona ta ndjekim të vërtetën, el-haqq, dhe ata që e praktikojnë. Nëse njerëzit binden në ëprova, i cili është i mjaftueshëm që të jetë shkak i besimit dhe provë në të cilën mund të mbështeten, 206

Ie ta kundrojnë çështjen tonë e cila tashmë është bërë e njohur për të gjithë.

Ne me ndihmën dhe kënaqësinë e All-llahut kemi filluar me manifestimin publik të fesë. Në të gjitha urdhërat dhe rregullat tona ndjekim ligjet e Muhammedit, sipas rregullave të drejtësisë së Ahmedit,*) me plotë konsideratë dhe rrespekt. Kemi futur hare në zemrat e popujve.

Ia kemi falur çdokujt veprat e bëra më herët dhe kemi thënë: "Allllahu e ka falë atë që ka ndodhur më herët!"**)

I jemi qasur reformës dhe përtëritjes së gjendjes të vakufëve muslimane, që janë lënë për xhamia, medrese, institucione bimirëse, dhe sërish kemi ndërtuar karavan-saraje. Ne ua kemi kthyer të ardhurat e tyre ashtu si i kanë kushtëzuar themeluesit e tyre - vakifët. Kemi urdhëruar që të respektohet e nderohet çështja e haxhive, që të përgatiten dhe sigurohen karavanet e tyre dhe rrugët ku kalojnë. U kemi dhënë liri të jashtëzakonshme tregtarëve. Mund të udhëtojnë nga njëra krahinë në tjetrën sipas zgjidhjes së tyre të lirë. Ua kemi ndaluar besimtarëve tanë dhe policisë që të përzihen në mesin e tyre në ardhjen dhe shkuarjen e tyre."

Ka kërkuar aleancën e sulltanit egjiptian "në mënyrë që këto vise dhe qytete sërish të banohen, të qetësohen fatkeqësitë e tmerrshme dhe të kthehen shpatat në mille, popullata të jetojë në qetësi dhe rehati, kurse qafat e muslimanëve të shpëtojnë nga prangat e turpit dhe nënçmimit.33)

Në të vërtetë, ai që e studion historinë e Mongolëve, kur befas kalon, pas tmerreve dhe gjakderdhjeve që i kanë bërë këta, në ndjenjat më të larta njerëzore dhe dashurinë ndaj të mirës, që e shprehë kjo kartë historike, e shkruar nga Takudar Ahmedit sulltanit mamelukas në

Egjipt, nxitë habi të mirëfilltë të njeriu se ka mund ta jep një Mongol i tillë.

Shtypja e të krishterëve nga Takundar Ahmedi i ka hidhëruar Mongolët, të cilët kanë qenë fuqishëm të lidhur për të krishterët edhe përkundër feve të tyre të ndryshme, dhe e kanë demicuar të Kublajkani duke e akuzuar, se me sjelljen e këtillë, i ka thyer ligjet e të parëve të vet.

Kundër tij është ngritur kryengritje, që e ka udhëhequr kushëriri Arqhuni, kurse i cili i ka përpagitur edhe mbytjen që pastaj ta trashigojë në fron.

207

Në kohën e sundimit të shkurtër të Arqhunit (1284-1291) të krishterët e kanë kthyer ndikimin e vet të hershëm, që ka rezultuar me persekutimin e muslimanëve. Janë hequr nga të gjitha pozitat që i kanë zënë në gjyqësi dhe financa dhe iu qe ndaluar paraqitja në pallatin e tij.³⁴)

Trashëgimtarët e Takudar Ahmedit kanë mbetur idhujtarë deri në kalimin në islam të Gazanit (1295-1304), Ilhaniut të shtatë dhe më të fortë. Ai e ka shpallur islamin fe shtetërore në Persi.

Në kohën e sundimit të tre³⁵) pararendësve të Gazanit të krishterët kanë shpresuar se do ta kryqojnë këtë dinasti sunduese të Persisë, e cila ndaj tyre ka treguar aq simpati dhe u ka besuar pozita të rëndësishme shtetërore.

Pararendësi i Gazanit Bajdu-kani, që i ka udhëhequr shumë trazira në Persi, u ulë vetëm disa muaj në fron më 1295. E pranoi krishterizmin. u orvatë me të gjitha forcat ta pengojë përhapjen e islamit ndër Mongolët. I ka ndaluar çdo personi të thërret dhe përhapë mësimin e kësaj feje në mesin e tyre.³⁶)

Gazani para islamit është rritur në budizëm. Ka ndërtuar në territor të Harasanit disa tempuj budistë. Ka dëshiruar mjaft të takohet me klerikët e kësaj feje, që kanë ardhur në Persi në numër më të madh pas forcimit të sundimit mongol në këto vise.³⁷)

Duket se Gazani ka qenë me natyrë të ndryshueshme në aspekt të pyetjeve fetare, sepse i ka studijuar mësimet fetare të shumë feve të ndryshme në kohën e tij. Patë bërë traditë të mbante diskutime me dijetarët e këtyre feve.³⁸)

Reshiduddini, veziri i tij i ditur, dhe kronisti i sundimit të tij, argumentësisht e ka përmbajtur rregullshmërinë e përkatësisë së tij islamit. Ai e ka marrë mbi vete që gjatë gjithë sundimit të vet të kujdesohet për dispozitat islame me zjarr dhe vullnet të fortë. Disa bashkëkohës të tij (sikur edhe disa autorë që kanë ardhur pas tij) e kanë akuzuar se ai këtë e ka bërë duke lëshuar pe para luftjeve të disa emirëve dhe shejhëve.³⁹)

“Mbi të gjitha, cilat motive qenësore”, do të pyesin përkrahësit e tij, “kanë mundur aq fuqimisht të ndikojnë ta ndërrojë fenë e vet?

Motivet aq të parëndësishme për sunduesin të parët paganë të të cilit e kanë pushtuar botën?"

Gazani me pranimin e islamit i ka përvetësuar zemrat e Persianëve gjatë kohës së luftës me Bajdu-kanin për fron. Mongolët muslimanë 208

kanë dezertuar nga ushtria e Bajdu-kanit dhe kanë ndihmuar konkurrentin e tyre, bashkëbesimtarin e tyre. Me këtë u dëftua korrekte pikëpamja e Nevrozit, emirit të muslimanëve, i cili e ka nxitur Gazanin ta pranojë islamin. E ka quajtur Gazanin emir duke i paradëftuar se ai do të shfaqet në këtë kohë me qëllim të mbrojtjes së islamit dhe t'ia kthejë lavdinë e dikurshme. Ka treguar në atë që, nëse e pranon islamin, do të bëhet sundues i Persisë.

Muslimanët me këtë do të shpëtojnë nga shtypjet e Mongolëve paganë, do ta pranojë anën e tij (dhe do të pranojnë se feja e mirëfilltë e ka shpëtuar nga shkatërrimi i sigurtë).

Zoti do ta konsiderojë si shpëtues të fesë së vërtetë nga shkatërrimi i sigurtë dhe ushtrisë e tij do ta shpërblejë me fitore.40)

Diç më vonë Gazani e ka shpallur hyrjen e vet në islam, kurse oficerët dhe ushtria e tij kanë ndjekur shembullin e tij.

U ka ndarë shpërblime njerëzve të rëndësishëm dhe ulemës, i ka vizituar xhamitë dhe tyrbet e njerëzve të mirë, duke u treguar si sundues shembull muslimanë.

Vëllau i tij Ulxhajt (uljaytu), që e ka trashëguar në fron më 1304 me emrin Muhammed Hudabeude,* u rritë në fenë e nënës së vet si i krishterë dhe është kryeqar me emrin Nikolla. Ka qenë ende i ri kur e ka pranuar islamin pas vdekjes së nënës, e me nxitjen e gruas së vet.41) Ibn Betuta dëfton në atë se sjellja dhe shembulli i këtij sunduesi kanë pasur ndikim të madh në Mongolët.42)

Prej kësaj kohe e më tej islami është bërë feja dominuese në shtetin e Ilhanive.

Islami i dinastisë Xhagataj

Të dhënat me të cilat disponojmë mbi depërtimin e islamit në imperatorinë e mesme mongole, e cila i ka takuar Xhagatajit, ende janë të parëndësishme. Shumë sundues nga kjo dinasti janë ndihmuar me ministra muslimanë, e që nuk kanë pasur prirje ndaj islamit.

Xhagataji shtetasit e vet muslimanë i ka munduar me ligjet e ndryshme mbi therjen e kafshëve për ushqim dhe pastrimin obligativ fetar, abdestin. El-Xhurxhani thotë se Xhagatoji ka qenë edhe armiku më i madh i muslimanëve në mesin e të gjithë kanëve mongolë.

209

Islamin e ka urrejtur aq sa nuk ka lejuar që në praninë e tij të thuhet fjala "musliman", përveç nëse me të nuk nënçmohej e përqeshej.43)

Orghana, gruaja e djalit të tij më të vjetër dhe trashëgimtarit të Kara-Hulagos, e ka edukuar djalin e vet si musliman. Ai me emrin

Mubarek-shah paraqitet në vitin 1264 si pretendent në fronin e Xhagatajkanatit, që përndryshe ka qenë objekt i konfliktit në mesin e princave mongolë. Së shpejti e përmbysi kushëriri i tij Burak-kani. Duket se islami i tij nuk ka pasur ndonjë ndikim te Mongolët. Në fakt, nëse i kthehemi emrave të bijëve të tij, nuk do të gjejmë se cilido prej tyre e ka pranuar fenë e babait.44)

Për Burak-kanin tregohet se e ka "ndriçuar drita dhe bekimi i fesë" vetëm disa ditë para vdekjes në vitin 1270, kur e ka marrë edhe titullin Sulltan Gijasuddini.45)

Përveç kësaj, nuk është varrosur sipas rregullave islame por sipas traditës së vjetër mongole. Ata që në kohën e tij e kanë pranuar islamin sërish i janë kthyer paganizmit të vet të mehershëm.

Në imperatorinë e Xhagatajit islami është stabilizuar tek në shekullin vijues, pas Mubarek-kanit, dhe këtë pasi që këtë fe e ka pranuar Tarmashirin-kani rreth vitit 1326. Këtë herë Mongolët, që kanë ndjekur shembullin e tij, kanë mbetur në fenë e re.

Mbi të gjitha, islami nuk është stabilizuar plotësisht në shpirtërat e Mongolëve, sepse Buzani, i cili ishte kan dekaden vijuese, ndonëse saktësia e kësaj date nuk është përcaktuar, e ka përmbysur Tarmashirin nga fronti dhe ka filluar t'i persekutojnë muslimanët.46)

Vetëm pas disa viteve dëgjojmë për sunduesin e parë muslimanë në Kashgar i cili duke iu falënderuar dinastisë së Xhagatajit, arriti të pavarësohet në viset e reja.

Disa historianë thonë se princi Tukluk Timur-kani (1347-1363), sundues i Kashgarit, islamin e ka pranuar nëpërmjet një njeriu të mirë e të devotshëm nga buhara me emrin Shejh Xhemaluddin.

Ky shejh një ditë, në shoqëri të disa udhëtarëve, pa qëllim kaloi nëpër viset që ky princ (emir) i caktoi për gjueti dhe argëtim. Iu ka urdhëruar që t'iu lidhen duart dhe këmbët dhe që të sillen para tij. I zemëruar i ka pyetur se si janë trimëruar të hyjnë në këtë territor. Shejhu u përgjegj se janë të huaj dhe se fare nuk kanë dijtur që po ecin nëpër trollin e ndaluar. Kur sunduesi mësoi se janë Persianë, iu tha: "edhe qeni është më i shtrenjtë se Persiani". "Po", tha shejhu, "sikur 210

mos ta besonim fenë e vërtetë, do të ishim më pak të vlefshëm se qeni."

I befasuar me përgjigjen e shejhut, sunduesi urdhëroi që t'i sillen ky Persian tri mposa ai të kthehet nga gjuetia. Kur u vetmuan, e pyeti shejhun ç'kuptim kanë ato fjalët dhe eç'fe është ajo.

Shejhu ia prezantoi mësimin e islamit me entuziazmin dhe elanin e tillë që zemra e Kanit, që më parë ka qenë e fortë si shkëmbi, është tretur si qiriu. Pabesimin shejhi ia prezantoi ashtu që kani e pa tërë marrëzinë dhe zbrazëtinë e besimit të vetë dhe i tha: "Nëse unë tash do ta pranoja islamin, unë nuk jam në gjendje t'i drejtojë edhe shtetasit e mi në rrugë të drejtë. Më jep pak kohë, deri sa të sundojë me

imperatorinë e gjyshërve të mi."

Në atë kohë mbretëria e Xhagatajit ka qenë e ndarë në disa principata të vogla. Kjo ka qenë shumë vite më herët se kur Tukluk timuri ka arritur ta bashkojë tërë imperatorinë, siç ka qenë dikur. Në ndërkohë shejh Xhemahuddini është kthyer në vendin e vet ku është sëmure për vdekje. Kur ishte në sëmundje të vdekjes, i ka thënë Reshiduddinit: "Tugluk timuri, një ditë, do të bëhet sundues i fuqishëm. Mos harro t'i shkosh dhe t'ia përcjellë përshëndetjen time, selamin, dhe mos u frikëso ta përkujtosh në obligimin dhe premtimin që ma ka dhënë."

Diç më vonë se kjo Reshiduddini i ka shkuar Tugluk Timurit në llogarin e tij ushtarak, pasi që ky arriti ta kthejë fronin e gjyshërve të vet, që t'ia përcjellë dëshirën e fundit të babait të vet. Përkundër të gjitha përpjekjeve, nuk ka mundur të hyjë në audiencë te Kani. Në fund iu dha mashtrimi interesant.

Një ditë, herët në mëngjes, në afërsi të tendës së Kanit u këndua ezani. Zëri i fuqishëm me pengoi gjymin e Kanit dhe e ka nxitur mllefin e tij. Ka urdhëruar që menjëherë t'ia sjellin. Atëherë Reshiduddini ka përmbushur zotimin e babait. Tugluk-kani nuk e patë harruar premtimin dhe tha: "Njemend, këtë e përkujtoj gjithnjë prej kur jam ulur në fronin e gjyshërve, por personit që ia kam dhënë këtë premtim nuk është paraqitur më parë. Tash ti mirë se ke ardhur."

Pastaj i ka shqiptuar fjalët e dëshmimit - kelimei-shehadetin - dhe u bë musliman.

"Dielli i islamit ka shëndrritur dhe e ka shpërndarë me dritën e vet terrin e pabesimit. Që ta përhapë këtë fe në mesin e shtetasve të vet, Tugluk Timuri dhe Reshiduddini janë marrë vesh që sunduesi ta

211
pranojë një nga një princ, emir, dhe t'u ofrojë pranimin e islamit; kush e pranon do të shpërblehet me bollëk, e kush refuzon do të mbytet si pagan dhe idhujtar."

Të parit që i është ofruar ka qenë bujar Emir Tulik, të cilit Kani i ka thënë: "A do ta pranosh islamin?"

Emir Tuliku u qesh deri në lot dhe ka thënë: "Tri vjet më herët unë kam kaluar në islam me ndihmën e një njeriu të mirë nga Kashgari. Jam musliman, por nga frika prej teje këtë nuk e kam shpallur."

Tugluk-kanë atëherë e ka përqaftuar dhe që të tretë janë ulur së bashku. Të gjithë e kanë pranuar përveç njërit, me emrin Xharas, që refuzoi pranimin e kësaj feje.

Ka propozuar, si provim në fuqi, luftën ndërmjet shejhit dhe shërbëtorit të tij, i cili ka qenë me trup të madh, aq i fuqishëm që ka mund ta ngrrejë deven prej dy vitesh.

Shejhu e pranoi këtë dyluftim dhe i tha atij princi: "Nëse nuk e mundi, nuk do të kërkoj ta pranosh islamin. Nëse bëhet vullneti i Allllahut që Mongolët ta arrijnë nderin me bekimin e kësaj feje. Ai, pa

dyshim, do të më jep fuqi me ndihmën e të cilit do ta mundi këtë njeri.”

Tugluk-kani dhe të tjerët që e kanë pranuar islamin tentuan ta kthejnë shejhun e devotshëm nga dylyftimi, por ai ishte i paluhatshtë në vendimin e vet.

“Bota ishte grumbulluar, erdhi edhe ai pabesimtar. Qëndronin njëri para tjetrit. Shërbëtori iu afrua, plotë krenari dhe besim në fuqinë e vet. Shejhu pranë tij duhej mjaft i vogël dhe i dobët.

Vetëm se lufta filloi, shejhu aq fuqishëm e goditi me shuplakë në krahëror pabesimtarin sa që ky ra i alivanosur. Diç më vonë shërbëtori sërish tentoi të luftojë, por vetëm sa u ngritë, sërish ra para këmbëve të shejhut duke i shqiptuar fjalët e pranimit të fesë - kelime-i - shehadetin. Populli aplaudoi dhe e iratoi këtë fitore nga të gjitha vendet. Atë ditë 160.000 njerëz i qetheu flokët e tyre dhe e pranuan islamin. Kani plotësisht qe mahnitur, kurse drita e islamit e ka shpërndarë terrin e pabesimit.”

Nga kjo kohë, islami është bërë fe stabile në krahinat e qeta e të banuara me të cilat kanë sunduar trashëgimtarët e Xhagatajit.47) Duket se shumë namadë mongolë kanë mbetur larg jashtë islamit deri në fillim të shek. XV, që shihet edhe sipas metodave drastike që i ka 212

aplikuar Muhammed-kani, që ka qenë kan i Mugalistanët,48) rreth vitit 1416, në konvertimin e këtyre nomadëve në islam.

“Muhammed-kani ka qenë sundues i pasur dhe musliman i mirë. E ka përfaqësuar drejtësinë dhe barabarësinë në mesin e njerëzve. Nuk ka hequr dorë nga përpjekjet e veta deri sa shumica e fiseve mongole nuk e ka pranuar islamin gjatë kohës së sundimit të tij të fatshëm. Bota ka ditur për kriteret e tij strikte me të cilat i ka përvetësuar Mongolët për islamin. Për shembull, nëse ndonjë Mongol ka refuzuar ta vë turbanin, i ngulej në kokë gozhda e kalit. Veprimi i këtillë i rreptë ka qenë i përhapur. Zoti e shpërbleftë me të mirë.”49)

As masat kaq të rrepta nuk e detyruan mbarë popullin në pranimin e islamit.

Kah fundi i shekullit vijues, të XVI50), u paraqit dervishi i quajtur Ishak Veli, i cili ka gjetur fushë për aksionin e konvertimit në islam në Kashgar, Jarkand dhe Hoton, ku i kaloi 12 vjet në përhapjen e fesë.51) Ka punuar po ashtu edhe në mesin e Kirgizëve dhe Kazakëve. Kështu nëpërmjet tij islamin e kanë pranuar 180 persona dhe janë rrënuar 18 tempuj paganë.52)

Tentuan në të theksuarën të shpjegojmë disa gabime të muslimanëve që i kanë bërë duke i përvetësuar në islam fiset e egra, që i kanë rrënuar qendrat e kulturës së tyre.

Shkallërisht, islami është ngritur nga gërmadhat e lavdisë së dikurshme. Sërish e ka marrë vendin e vet si fe dominuese pas dekurajimit dhe rrënimit më shumë se një shekull.

Në rrugën e luftës me ithtarët e feve konkurrenente në përvetësimin e Mongolëve për mësimin e tyre fetar, interesat e caktuara politike, pa dyshim, kanë pasur meritë në orientimin e kësaj lufte në dobi të anës muslimane.

Komplotet e botës së krishterë në Perëndim kanë hedhur dyshim në të krishterët si në spiunët e ndonjë fuqie të jashtme.

Mirëpo, disa Mongolë, që e kanë pranuar mësimin e sektit të krishterë nestorianë, në fillim kanë pasur shumë më tepër sukses në propagandë se të tjerët. Duku u konsideruar si parti nacionale, kanë mundur më fuqishëm të atakojnë në muslimanët duke parë tek ata bartësit e fesë së huaj.

Ahmed Takudari që akuzuar prej Argunit për tradhtinë e ligjit të gjyshërve për atë shkak se ka ndjekur 'rrugën e Arabëve', të cilën askush nga pararendësit e tyre nuk e kanë njohur.53)

213

Kryengritja me të cilën është përmbysur Tarmashirin dhe është dërguar në internim ka pasur mbështetje në ankesën se ky sundues e ka mospërfillur Jassak-un, kodeksin e ligjeve të vjetra mongole.54)

Ndonëse burimi i konflikteve gjatë kohë ka mbetur burim i dyshimit, islami është forcuar në viset dikur të grabitura prej tij.

Metodat me anë të të cilave kjo fe ka arritur sukses janë pyetjet ende të mbështjellura me veliu e fshehtësisë dhe paqartësisë.

Ndonëse janë ofruar informata të mëngëta, ato i zëvendësojnë shumë hollësi të këtij tregimi. E kemi regjistruar atë që mjaft udhëzon në disa aksione që kanë shpjerë në qasjet individuale drejt kësaj feje.

Ananda e ka pirë shpirtin e islamit,58) e edhe besimtarët tjerë, veçan familjet e vjetra muslimane turke, kanë kryer gjithnjë ndikim të pandieshëm në Mongolët, që kanë ardhur në mjedisin e tyre.

Rëndësi të veçant, në mesin e faktorëve që e kanë ndihmuar përhapjen e islamit, ka ndikimi i pirit dhe nxënësve të tij shpirtëror.

Në midisin e fatkeqësisë së tmerrshme që i ka goditur muslimanët pas vërshimit të madh të pushtimit mongol, strehimin e parë ata e gjejnë në tesaruf.

Piri ose udhëheqësi shpirtëror (murshidi) dhe rendet fetare si psh. ai nakshibendian*) që në shekullin XIV është treguar i fuqishëm dhe ndikues, i kanë dhënë shoqërisë islame jetë të re dhe e kanë frymëzuar zjarr të ri fetar.

Në duart e pirit dhe ithtarëve të tij muslimani në Azi, në fillim mpasiv dhe ndërmjetësues i pavetëdijshëm, është bërë në fund përkrahës aktiv i partisë së fesë nacionale që do t'i vëhet në opozitë sundimit mongol, i cili ishte i huaj, barbar dhe profan.56)

T'i kthehemi tash historisë së përhapjes së islamit në mesin e fiseve Hordhitë e Arta.

Kjo grup e Mongolëve u lëshua në fushën pjellore kryesore të cilën e ujiste lumi Volga. Në një breg të saj e kohë themeluar edhe

kryeqytetin e vet - qendrën Saraj, ku princat rus i kanë tatim kanit. Kalimi në isla i Baraka-kanit, për të cilin ka qenë fjala më herët, kurse i cili ka vendosur lidhje miqësore me Memlukët në Egjipt, mjaft ka ndikuar në përhapjen e islamit në mesin e anëtarëve të këtij fisi. Duket se, shkallërisht, shumë anëtarë të shtresës aristokratike të prejardhjes mongole, udhëheqësit e Hordhive të Arta, kanë ndjekur shembullin e tij.

214

Është fakt, po ashtu, se shumë gjini të tij i janë kundërvënë kësaj feje dhe përhapjes së saj në mesin e tyre, dhe kur Baraka-kani e ka shpallur pranimin e vet të islamit, kanë menduar për përmbysjen e tij nga fronti. Duke e konsideruar jo të denjë, ia kanë ofruar kurorën e Mongolëve rivalit të tij Hulagos.

Kundërshtii ka qenë aq i fortë sa që Mongolët janë ndarë ndërmjet veti. Kështu si fis i veçant u paraqit fisi i Nugojëve. Emrin e kanë marrë sipas Nogait, komandantit kryesor të forcave mongole nën Baraka-kanin.

Kur princat tjerë mongolë të Hardhisë së Artë u bërën muslimanë, Nogaji mbeti shamanist. Mbeti lidhje e përhershme e të gjithë atyre që kanë refuzuar ta lëshojnë fenë e vjetër mongole. megjithatë e bija e këtij udhëheqësi luftarak, e cila u artua për shamanistin, e pranoi islamin drejtpërdrejt pas martesës, dhe i mbeti besnike fesë së re edhe përkundër sjelljes së keqe të burrit të vet dhe nënçmimit që ka përjetuar.57)

Islami në kohën e fisit Hardhitë e Arta

Uzbek-kanit, i cili ka qenë në krye të fisit Hardhitë e Arta prej vitit 1313 deri 1340 dhe ka qenë i njohur me zjarrin e përhapjes së islamit në mesin e bashkëfistarëve të vet, i është thënë: "Kënaqu me dëgjueshmërinë tonë ty, e ç'të indtereson feja jonë? Përse ta lëshojmë fenë e Xhingis-kanit dhe ta pranojmë efnë e Arabit?"

Uzbeku pati sukses në përpjekjet, edhe përkundër rezistencës në të cilën ka hasur, që t'i përvetësojë dhe kthejë shumë në fenë e re, ithtar i fortë dhe i zjarrtë i së cilës ka qenë. Atij duhet falënderuar se ajo i ka lëshuar dhe forcuar rrënjët e veta në vendet që kanë qenë nën sundimin e tij.58)

Ajo që e konfirmon ndikimin e Uzbekëve është edhe ajo që i gjejmë fiset e Uzbekëve në Azinë qendrore, që emrin e kanë marrë sipas tij, edhe nuk përjashtohet se edhe islamin e kanë pranuar gjatë sundimit të tij.

Thuhet se ka pasur në plan ta përhapë islamin në të gjitha viset e Rusisë, por ky plan i tij nuk pati sukses.

Ndonëse sundimi i Mongolëve në Rusi ka zgjatur dy shekuj, nuk ka pasur ndiki më të rëndësishëm në popullësinë e tij, e më së paku në sferën e fesë.

215

Duhet vërejtur edhe këtë se, edhe përkundër lojalitetit të madh, zjarrit dhe entuziazmit për përhapjen e islamit, Uzbek-kani ka pasur mirëkuptim dhe tolerancë t plotëndaj shtetasve të vet të krishterë. Ua ka dhënë lirinë e plotë të kryerjes së liturgjive fetare, e që nuk ka pasur me çka të bëjë keq. Në tolerancë ka shkuar edhe më tej se kjo. Ka lejuar madje ardhjen e misionarëve të krishterë që në shtetin e tij ta përhapin fenë e tyre.

Një nga dokumentet mjaft të rëndësishme të tolerancës islame, që kërkon vëmendje, është dokumenti që Uzbekkani ia ka dhënë mitropolitit Petrit në vitin 1313. Në të qëndron: "Me vullnetin e Allahut, me fuqinë, madhërinë dhe mëshirën e Tij! Nga Uzbeku të gjithë komandantëve tanë, emirëve, të mëdhenj e të vegjël, Askujt nuk i lejohet ta ofendojë kishën e Mitropolitit, së cilës në krey i është Petri, ose shërbetorëve dhe klerikëve të tij, as që çkado të merrë nga pasuria e saj, vlera ose njerëzit, as që të përzihet në punët e saj.

Kushëdo që e thenë këtë urdhërin tonë është mëkatar te Zoti, kurse denimi jonë për të është vdekje. Ta lëmë Mitropolitin të kënaqet në hare dhe siguri. Ta lëshojmë atë (ose përfaqësuesit e tij) të vendos dhe t'i rregullojë pyetjet kishtare sipas vullnetit të vet dhe me shpirt të qetë.

Solemnisht deklarojmë që ne, fëmijët tanë, fisnia e shtetit tonë dhe guvernatorët e krahinave në asnjë rast nuk do të hyjmë në punët e brendshme të kishës dhe Mitropolitit, as në punët e qyteteve, qendrave, fshatrave, vendet e gjakut në tokë dhe det, në vendbletari, kullosa, fusha dhe shkretëtirë, vreshta dhe mullinj, as në çfarëdo të mire dhe pronësi të sajën.

Ta lëmë Mitropolitin të kënaqet në qetësi e rehati larg vështirësive dhe problemeve, ta lëmë të jetë me zemër të qetë e të ndershme, që të mund t'i lutet Zotit edhe për ne, fëmijët tanë dhe për popullin tonë. Nëse dikush e vë dorën në diç të shenjtë dhe vërtetohet akuza e tij, do t'i ekspozohet zemërimin të Zotit dhe denimit me vdekje, kurse fati i tij do të fusë frikë në zemrat e të tjerëve.

Nëse caktohet haraxhi ose tatimet tjera sikur: dogana, tatimi për tokë, rrugë dhe tokën e papunuar, ose nëse dëshirojmë t'i tubojmë ushtarët në mesin e shtetasve tanë, asgjë mos të tubohet me forcë dhe dhunë nga kishat katedrale nën mitropolitin Petrin ose cilitdo prej klerikëve të tij. Çdo gjë që merret me dhunë nga klerikët do të kthehet

216
trefish. E drejta e tyre, kishat, manastiret, kapalat le të bëhen vende respekti.

Kushdo të akuzohet ose gabon ndaj kësaj feje, nuk do t'i pranohet kërkimi i ndjesës ose kërkimi i faljes, por denimi për të është vdekja. VËllëzërit dhe bijtë e klerikëve dhe gjakonët që ulen në tavolinën e njëjtë dhe jetojnë në shtëpinë e njëjtë do t'i gëzojnë të drejtat dhe privilegjet e njëjta.59)

Se këto nuk kanë qenë fjalë boshe dhe se toleranca njëmend është aplikuar në jetë provë është edhe shkresa e Papa Ivanet XII ganga 1318 e drejtuar Kanit ku i falenderohet sunduesit musliman në kujdesin që na ka kushtuar shtetave të vet të rkistherë dhe tretmanin dashamirës që këta e kanë gëzuar tek Uzbek-kani.60)

Deri sa Rusët rregullisht kanë dhënë tatimet kanit, iu patë lënë liria e besimit, sa kanë dashur. Krishterizimi plotësisht ka hyrë në jetë të popullit ashtu që çdo përpjekje që të ndahen nga feja e babajëve ka qenë angazhim i kotë. Shkak është edhe kjo që krishterizmi është bërë fe nacionale të popullit rus gati tre shekuj para se Mongolët janë forcuar në territorin rus.

Duket se trashëgimtarët e Uzbekut nuk e kanë poseduar këtë zjarrë për përhapjen e islamit sikur ai dhe nuk kanë patur sukses në atë para së cilës ai u praps.

Historia e përhapjes së islamit në Rusi

Një popull tjetër shumë vite më parë është orvatur t'i tërheq Rusët në islam, por nuk pati sukses. Kanë qenë këta Bullgarët-muslimanë, të cilët kah shekulli X kanë jetuar në brigjet e Vollgës. Ata islamin e kanë pranuar nëpërmjet tregtarëve muslimanë që kanë tregtuar me gëzofa dhe me mallin tjetër të marrë nga verën.

Kalimi i tyre në islam është dashur të ndodh para vitit 921 kur halifi abasidas El-Muktedari (295-320/908-932) ka dërguar të deleguarit që do të punojnë në forcimin e fesë dhe aftësimin me mësimin dhe rregullat islame.61)

Bullgarët - muslimanë trentuan ta kthejnë në islam Vlladimirin, sunduesi e Rosisë (si na flet për këtë rrëfimi rus), i cili ka konsideruar atëherë se duket zgjedhur besimin më të mirë se ai pagan, të cilit deri atëherë i ka takuar.

217

Synetimi dhe ndalimi i alkoholit kanë qenë pengesa e vetme për atë dhe shtetasit e tij që ta pranojnë islamin nga përdorimi i të cilit, si ka shpallur, Rusët nuk mund të shmangen, sepse kjo është pjesë përbërëse e kënaqësive jetësore.

Mosukses të ngjashëm kanë përjetuar edhe Hebraikët që kanë ardhur nga viset e Kazarit në detin Kaspik dhe arritën ta kthejnë në fenë e Musaut një sundues të atjeshëm.82)

Kur Vlladimiri i ka dëgjuar provat e tyre, e ka pyetur se ku e kanë vendlindjen. "Jerusalemi", janë përgjigjur, "pas Zoti, nga hidhërimi ndaj nesh, na ka shpërndarë nëpë rmbarrë botën." "Pra, ju nga Zoti jeni të mallkuar", bërtiti mbreti, "e doni t'i mësoni të tjerët. Shkoni! Ne nuk duam që sikur ju të mbesim pa vendlindje."

Vlladimirin më së shumti e ka impresionuar ideja që bukur e ka paraqitur kleriku grek. Ai, pas paraqitjes së shkurtër kritike të besimeve tjera, ka dhënë pasqyrë gjithpërfshirëse të mësimin të krishterë duke filluar nga krijimi i botës deri te tregimi mbi

shkatërrimin e njeriut dhe fundit (te botës) duke përfunduar me shtatë tubime ekumenike që i ka pranuar kisha ortodokse greke. Sunduesit ia ka evokuar edhe fotografinë e Ditës së gjykimit, hyrjen e njerëzve të mirë në parajsë dhe hedhja e pabesimtarit në skëterrë. I ka premtuar trashëgimi qiellore, nëse kryqohet.

Por, Vlladimiri nuk ka qenë i shpejtë në zgjidhjes e fesë e cila do ta zëvendësojë atë të tijën pagane; së këndejmi i ka tubuar të gjithë eprorët e shtetit të vetë dhe u ka thënë çdo gjë që ka dëgjuar për fetë e ndryshme duke kërkuar prej tyre këshillë. I kanë thënë: "O sundues, çdo njeri e lavdon fenë e vet. Nëse dëshiron ta zgjedh mmë të mirën prej feve, dëgoji njerëzit e ençur në vendet e ndryshme dhe le të të zbulojnë cili popull e madhëron Zotin në mënyrën që është më e denjë Madhërisë së Tij."

Për këtë qëllim Mbreti ka caktuar dhjetë njerëz të njohur me fortësinë e karakterit dhe mendimit. Këta të deleguar te Bullgarët kanë gjetur vende të ndryshme të pamjes së keqe, lutjet që nxisin pakëndshëri dhe fytyra të zymta. ndër Germanët kanë hapur katolicizmin ritualet religjioze të të cilit kanë qenë pa pompë dhe shkëlqim. Në fund arritën në Konstantinopojë. Imperatori ka thënë: "Lereni le të shohin madhërinë e Zotit tonë!" Pastaj i kanë dërguar në kishën e Shën Sofisë (Aya Sofiya), ku patriku, në petkun solemn, ka shërbyer shërbimin e shenjtë.

218

Madhështia e ndërtesës, petkat e pasura të klerikëve, altarii dekoruar me ornamente dhe aromat mallëngjyese, paqa e botës, të buruar prej respektit dhe devotshmërisë, dhe rituali fetar plotë devotshmëri dhe përunjteshi mistike - e gjitha kjo i kapërbushur Rusët me çudi dhe mendjemadhësi.

Iu është dukur se kjo kishë është vendqëndrim e Fuqisë më të Lartë, e cila madhështinë e vet ka treguar njerëzve në këtë vend. Kur të deleguarit u kthyen në Kiev, ia përshkruan sunduesit rrugën e misionit të vet. Me nënçmim kanë folur për fenë e Pejgamberit dhe shumë pak kanë thënë për kishën romako-katolike.

Me entuziazëm dhe zjarr kanë folur për kishën greke. "Çdo njeri", kanë thënë, "ki që e sjijon gllënkën e ëmbël në të ardhmen do të falet nga çdo gjë e idhët. Për këtë - pasi e njoftuam besimin e kishës ortodokse greke - nuk duam kurrfarë feje tjetër."

Vlladimiri sërish i ka konsultuar eprorët rus të cilët i thanë: "Sikur feja greke mos të ishte më e mira nga të tjerat, nuk do ta pranonte gjyshja jote Olga, krijesa më inteligjente. Pas kësaj Vlladimiri nuk u hamend dhe në vitin 966 u deklarua si i krishterë.

Një ditë pas kryqimit urdhëroi t'i rrënojë idolet që të parët e tij i kanë adhuruar. U ka urdhëruar të gjithë Rusëve, zotërinjve dhe robërve, të pasurve dhe të varfërve, se duhet ta pranojnë kryqimin sipas rregullave të krishtera.63)

Kështu krishterizmi është bërë feja e Rusëve. Pas pushtimeve mongole gjejmë karakteristika të ndryshme nacionale të Rusëve dhe Tatarëve të cilat, deri më sot, kanë mbetur t'i ndajnë këto dy elemente njërin prej tjetrit.

Indiferenca ndaj sundimit tatar, lojaliteti i Rusëve fesë së vet dhe mungesa e zjarrit fetar te një pjesë e Tatarëve - të gjitha këto kanë ndikuar që elementi i nënshtruar të jetë larg nga pranimi i fesë së sunduesit të vendit të tyre. Disa kanë konsideruar se ndalimi i përdorimit të alkoholit sipas rregullave islame ka qenë pengesë serioze për pranimin e kësaj feje nga ana e popullatës ruse.

Duket se në vitin 1905 kur është dhënë komunikata për tolerancën fetare në tërë Risinë Cariste, nuk ka pasur raste të kalimit të rusëve në islam si rezultat i punës më të fortë misionariste muslimane.

Në rastet e kalimit në islam mrol tërëndësishëm ka pasur edhe përkrahja materiale e Tatarëve konvertitëve sikur edhe ndikimi ifugisë morale të vetë muslimanëve.64)

219

Nuk kanë qenë të gjithë Tatarët në Rusi barabartë joaktivë në ndihmesën e përhapjes së islamit në shekujt e kaluar. Tipi helenist i figurave, që është i veçantë në mesin e atyre që quhen Tatarë të Krimesë, i ka shtyrë në mendimin se këta muslimanë i kanë absorbuar në shoqërinë e vet Grekët dhe Halianët, që i kanë takuar banorët në siujdhesën e Krimesë. Në mesin e këtyre i gjejmë edhe pasardhësit e tyre, që e kanë pranuar islamit nga popullata lokale, e edhe kolonistët Gjenovasit.65)

Një udhëtar nga shekulli XVIII na flet se Tatarët e Krimin kanë tentuar t'i përvetësojnë skllëvërit dhe robërit e vet për islam se shumë prej tyre kanë arritur t'i kthejnë në këtë fe me premtimin e lirisë.66)

Thirrja në islam në mesin e Tatarëve krimas veçan është aktivizuar pas proklamimit të lirisë fetare më 1905.67)

Nuk është keq shkurtimisht të tregojmë edhe në Tatarët e Lituanisë, grupet e vogla të së cilës janë vendosur atje qysh në fillim të shekullit XV. Këta të shpërngullur muslimanë kanë arritur ta ruajnë fenë e vet në mesin e popullatës së krishterë, por (mbase nga shkaqet politike) nuk kanë tentuar t'i mësojnë me principet e islame.

Mirëpo, e patën bërë traditë të martohen me Lituanaset dhe Polaket, fëmijët e të cilëve rëndom kanë qenë muslimanë, kurse nuk kanë lejuar asnjë muslimaneje që të martohet për të krishterët. Princat e mëdhenj të Lituanisë kanë përmbajtur martesat e të krishtereve për ushtarët tatarë, të cilëve u kanë dhënë prona tokësore dhe privilegje tjera.68)

Një nga kuriozitetet e historisë së misionaritetit islam është konvertimi i Kirgëzëve të Azisë qendrore nëpërmjet ulemasë tatarë, mullëve, të cilët në mesin e tyre e përhapin islamit në shekullin XVIII si të deleguar të pushtetit rus.

Kirgizët kanë ardhë nën sundimin rus në vitin 1731 dhe për 120 vjet tërë letërkëmbimi diplomatik në mesin e tyre është zhvilluar në gjuhën tatarë duke i konsideruar, gabimisht, se Tatarët etnografik janë nga Vollga. Pjesa e dytë e mashtrimit të pushtetit rus është se Kirgizët kanë qenë muslimanë, deri sa ata qysh në shekullin e XVIII kanë qenë shamanë dhe numri i konsiderueshëm kanë qenë të atillë deri në mes të shekullit XIX.

Në kohën kur rusia Cariste ka anektuar pjesën më të madhe të vendeve të tyre, me përjashtim të numrit të vogël të kanateve dhe sulltanatave, ka pasur pak dije për islamin, por edhe ajo me të madhe 220

ka qenë konfuze dhe e përzier. Nuk ka mundur në tërë hapësirën të stepes të gjendet një mesxhid (xhami) sikur që nuk ka mund të gjendet as mësuesi më i rëndomtë i feqë së Pejgamberit.

Kirgizët ia kanë borgj kalimin në islam faktit që Rusët i kanë konsiderar muslimanë, i kanë trajtuar dhe janë sjellur meta si të tillë. Ju kanë ndarë shuma mjaft të mëdha të hollash për ndërtimin e mexhidet dhe u kanë dërguar mësues fetarë (mulla) për të ndërtuar shkolla dhe për mësimin e të rinjve me principet e islamit. Ulemaja kirgiziane për çdo ditë ka pranuar një shumë të caktuar të hollash të nevojshme për furnizim. Baballarët janë stimuluar me shumë dhurata dhe shpërblime të ngjashme që i dërgonin fëmijët në shkollë.

Është fakt i pamohueshëm se misioni i islamit dhe përhapja e tij në stepet kirgiziane ka aradhur nga ana e cila është deri në Rusi, Është fakt edhe kjo se Kirgizët që kanë ardhur në kontakt me Evropën janë bërë muslimanë para kësaj.

Besimi i vjetër skamanist ngadal ka humbur deri në fund të shekullit XIX në mesin e atyre që kanë lëvizur ndërmjet i viseve fqinje të hives, Buharës dhe Hokandës, ndonsë këto vende kanë qenë tashmë disa shekuj islame.69)

Ky është shembull unikat që një pushtet i krishterë ka pasur pjesë në përhapjen e islamit.

Asgjë më pak nuk është çuditëse nga ajo që pushteti rus, në këtë shekull, ka tentuar ta imponojë krishterizmin shtetasve të vet muslimanë në Evropë, si vazhdim i përpjekjeve të njëjta në shekullin e XVI kur është pushtuar kanati Kazan.

Në fillim të shekullit XIX shumë Kirgizë që kanë banuar stepën e gjërë, që shtrihej nga krahina Tobolsk, në jug deri në Turkestan, kanë qenë ende idhujtarë.

Pushteti rus preokupohej me mendimin që t'i lejojë misionit të krishterë që të vijë në mesin e tyre.

Mirëpo, qeveria megjithatë nuk iu përgjegj kësaj kërkesë me arsyetim se kjo botë është aq barbare dhe e egër sa që tëkuptuarit e tyre të Evangjeliës nuk është i lehtë. Por, së shpejti janë paraqitur misionarët tjerë që nuk janë mbishtetur në qëllimin e mirë të cilit do

pushtet, kurse kanë pasur shumë më tepër zjrr fetar, elan dhe mirëkuptim. E kanë zënë këtë fushë dhe i kanë tërhequr të gjitha fiset kirgiziane në islam.70)

221

Pas pushtimit rus të Kazanit, në shekullin XVI ka pasur okupacioni edhe i kanateve tjera tatarë pas çkahit fillon lëvizja zyrtare e kryqimit. Edhe një pjesë e popullësisë idhujtare në kanate ka qenë kryqar. Këtë aktivitet të klerikëve e kanë mbështetur policia dhe pushteti drejtues civil.

Duke e marrë parasysh se klerikët rusë nuk e kanë njohur gjuhën e kovnertitëve të vet, në fund i kanë mospërfillur. Nuk kanë pasur dalje tjetër pos ta pranojnë që këta që sërish kanë konvertuar "paturpshëm mbajnë shumë zakone neveritëse tatarë dhe nuk i permbahen as që dijmë mësimin e krishterë."

Kur vërejtja shpirtërore nuk pati sukses, qeveria i ka urdhëruar nëpunësve të vet që t'i qetësojnë, t'i mbyllin dhe t'i prangojnë ata që, përkundër kryqimit, nuk i përulën urdhëresave të patrikut, dhe me këtë të paudhëzuarit t'i frikësojnë nga feja tatarë.

Në shekullin XVIII pushteti rus ka bërë shumë angazhim dhe përpjekje që t'i kryqojë fiset idhujtare, dhe Tatarët që kanë renegatur nga feja dhe për këtë qëllim ka dhënë shumë përpjekje të satisfaksionit.

Caresh Katarina II në vitin 1778 ka urdhëruar që secili nga këta konvertitët e ri në krishterizëm ta jep premtimin me shkrim se do t'i "lë në tërësi mëkatet idhujtare, çdo kontakt me pabesimtarët, fuqishëm ta përqafojë krishterizmin dhe dogmat e tij."

Mbi të gjitha, këta që janë quajtur "Tatarë të kryqar" kanë qenë të krishterë vetëm sipas emrit. Së shpejti kanë filluar të çlirohen nga të gjitha ato në çka kisha ortodokse, pravosllave ka dhënë angazhim. E kanë lëshuar krishterizmin dhe e kanë pranuar islamin.

Ky pranim i krishterizmit ka qenë për ta vetëm dërrasa kërcyese përhyrje në fenë e Pejgamberit.

Është e mundur, ndërkaq, që në regjistrat zyrtar të jenë regjistruar si të krishterë, por ata gjithnjë fuqishëm mdhe fortë janë ngritur kundër çdo tentimi të kryqimit të tyre.

Në një artikull gjysmëzyrtar të botuar në vitin 1972 autori pohon: "Fakti që meriton vëmendje është se ekziston zingjir i gjatë i renegatjes evidente, që pajtohet me fillimin e masave të ndërmarra për shkak të stabilizimit të konvertëve në fenë e krishterë. Këtu duhet të ekzistojë shkak krahasues që shpie deri te situatat e këtyre renegatjeve në kohën kur pritet kontribut kundërt."

222

Fkti tregon në atë se tërë kohën këta Tatarë në zmër janë ndier muslimanë. I janë kundërvënë masave të ndërmarra të cilat pranimi i tyre i krishterizmit do t'i bënte realitet në cilin do çast.71)

Në pjesën e dytë të shekullit XIX është bërë përpjekje e kryqimi të këtyre fiseve idhujtare dhe muslimane me anë të hapjes së shkallave në mesin e tyre. Kanë shpresuar se do ta përvetësojnë për vete rininë e asaj gjenerate.

Iu dukej se, nëse nuk veprojnë ashtu, është e pamundur t'i fusin Tatarët në krishterizë. Për këtë një profesor rus thotë: "Është rëndë të përvetësohen për ne popullata e Kazanit, por ne do ta tërheqim numrin më të vogël të popullatës fshatare nga stepet dhe do t'i edukojmë që t'i frikësohen Zotit. Kur njëherë të jenë me ne, kurrë më nuk do tëkthehen prapa."72)

Kodi ndëshkimor Rus ka paraparë denime të rënda për ata që janë renegatur nga kisha ortodokse.73)

Çdo person për të cilin pohohet akuza se e ka kthyer të krishterin në islam, do të privohet nga të gjitha të drejtat qytetare dhe do të ëdenohet me burg me punë të rëndë fizike prej 8-10 vjet.

Përkundër të gjitha urdhërave qeveritar propaganda muslimane ka arritur t'i përvetësojë të gjitha fshatrat për isla, e veçan fiset të banuara në verilindje të rusisë.74)

Qyteti Kazan është qendra kryesore i këtij aktiviteti misionarist.

NË atë vend çdo vit është shtypur numër i madh i publikimeve islame, kurse mullët shkonin nga universiteti në fshat për konvertimin e idhujtarëve dhe kthimin e Tatarëve në islam pasi që kanë qenë të ekspozuar kryqimit.

Rritja e vazhdueshme e numrit të Tatarëve të krishterë që i mbushnin radhët e muslimanëve ka shkaktuar shqetësim të klerikët e kishës pravoslalve ortodokse, por përpjekjet u qenë të kota para suksesëve të nusllëve.75)

Janë shënuar shumë lajme për hyrjen e njerëzve në këto fe grupe grupe, sidoos pas publikimit të ediktit në vitin 1905 për lirinë fetare.

Për konversionin masovik është lajmëruar në vitin 1909 kur 91 familje në fshatin Atomva kanë kaluar në islam,76) kur se në kokën prej vitit 1906 deri 1910 numri i kalimeve në islam ka kaluar në 53.000 persona.77)

223

Thuhet se suksezi i këtij misioni më së shumti qëndron në nivelin e lartë moral të shoqërisë islame, sa edhe në ndjenjat e forta të solidaritetit vëllezëror që kanë dominuar tekata.78)

Me këtë lidhen edhe metodat që i kanë përdorë klerikët rusë të ndihmuar nga pushteti, që këta, që quhen Tatarë të krishterë, ta bëjnë sa më lojal fesë. Ata kanë sjellë deri te ajo që feja e krishterë, në midisin e tyre, të jetë jopopullarizuese.79)

Nga ana tjetër, propaganda e islamit mjaft me zjarr ka ftuar përpara. Çdo musliman i rëndomtë dhe analfabet ka qenë misionarist i fesë së vet; fiset e varfëra, të paarsimuara dhe analfabete të idhujtarëve dhe të ngjashëm me këtë nuk kanë mundur t'i kundërvihen

misionit të tyre.

Nga shumë fshatra në të cilat është kryer kryqimi, njerëzit kanë shkuar si endës (thurës), që në periodën dimrore të punojnë në fshatrat muslimane. Këtu kanë kaluar në islam. Pastaj janë kthyer në fshatrat e veta si bartës të zellshëm të dieve islame, që kanë hyrë në shtëpitë e tyre.⁸⁰⁾

Ndër fiset që më së shumti ka përfshirë ky aktivitet misionarist islam ka qenë fisi i Votiakëve, të cilët në pjesën më të madhe kanë qenë të krishterë. Shumica në shekullin e XVIII dhe në fillim të shekullit XIX janë bërë musliman. Ende islami vazhdon të hyjë në mesin e tyre, si në mesin e atyre të cilët janë të krishterë ashtu edhe në mesin e asaj pjese të mbetur të idhujtarëve.

Shirmisët sikur edhe Votiakët janë fise të Finuseve.⁸¹⁾ Çereku janë ende paganë, por shumica prej tyre tashmë e kanë pranuar islamin dhe nuk është larg dita kur së shpejti edhe të tjerët t'i adaptohen këtij religjioni.

Lëvizje e Shirmisëve drejt islamit është vrojtuar në shekullin XIX kur shumica ende kanë qenë të krishterë. Tërë fshatrat po bëhen muslimane edhe përkundër ligjit që ka ndaluar çfarëdo konversioni, përveç në krishterizmin ortodoks, pravosllav.⁸²⁾

Ata janë bërë muslimanë me kontaktin e drejtpërdrejtë me Bashkirët dhe Tatarët, zakonet familjare dhe shoqërore dhe mënyra e jetës së të cilëve kanë qenë mjaft të ngjashëm me të tyrin.

Nganjëherë ky proces ka filluar me martesën me muslimanët. Për shembull, ndonjë familje e Shirmisëve me anë të martesës me ndonjë Bashkie miqësohet dhe kështu përshtatet me fenë e tyre.

224

Muslimanët e ri qenë ekspozuar përbuzjes si "qentë e cirkumizuar" në fshatrat e veta; për këtë shkak shpërnguleshin në ndonjë vend tjetër, disa kilometra më tej. Disa Bashkirë më të pasur i kanë ndihmuar materialisht.

Nga arsyeja se në protokalet zyrtare janë evidentuar si idhujtarë, nuk kanë mundur ta marrin lejen për ndërtimin e xhamisë. Për këtë shkak familje fqinje bashkirës janë shpërngulur në vendbanim të ri në mënyrë që t'i plotësojnë numrin e kërkuar të vendasve - muslimanëve për arritjen e lejes zyrtare për ndërtimin e xhamisë.⁸³⁾

Proces i ngjashëm është zhvilluar edhe në fshatrat tjera ku kanë banuar muslimanët dhe janë martuar e perzier me Shirmasët.⁸⁴⁾

Edhe në rrethanat tejsa është ndier lëvizje e qartë për përhapjen e misionit. Për shembull, në fillim të shekullit XIX fshati Karakullë ka qenë i banuar me Shirmasët e krishterë. Pas gjysmës së këtij shekulli disa familje kanë kaluar në islam me anë të Shirmasit i cili është bërë mullë. Pas vdekjes së tij në këtë punë e trashëgon Bashkiri nga fshati tjetër. Këta konvertitë shpërngulen në fshatrat tatare dhe bashkire, pasi që Tatarët ua kanë marrë vendet' ashtu, praktikisht, tërë fshati është

bërë tatar.

Vetëm numri më i vogël i Shirmisëve të rinj e ka ruajtur gjuhën e vet dhe janë martuar vetëm me Tatarët.85)

Nëse e lëmë anash këtë aktivitet misionarist, do të gjejmë se ndikimi i Tatarëve në Shirmasët ka qenë i qartë në gjuhë dhe zakone. Gjuha tatarë është përhapur dhe është futur ndër ta nëpërmjet mësimit fetaro-moral të islamit.

Marrja e petkut tatar ka pasur për domethënie edhe supremacionin e caktuar kulturor.

Nëse ndonjë Shirmas nuk do të mbathen tatarisht, do t'i ekspozohet përbuzjes së Tatarit të parë të cilin do ta takonte, dhe bashkëfistarëve të tij Shirmasëve.

Tërë kjo lëvizje kulturore ka synuar drejt përfundimit të fesë së Tatarëve.86)

Flitet se Shirmasët pas pranimit të islamit janë bërë ithtarë të zjarrtë të përhapjes së tij të mëtejme. Në këtë i kanë ndihmuar Tatarët e pasur.87)

Nga ana tjetër, Rusët i kanë shikuar SHirmasët me nënçmim. I kanë konsideruar racë të prapambetur. Kanë përshkruar epitete nënçmuese edhe atyre të krishterëve Shirmasëve që kanë qenë me ta.88)

225

Ende 1/4 e Shirmasëve janë idhujtarë, por ndikimi musliman në mesin e tyre është aq i fuqishëm sa që së shpejti shumica e tyre do të bëhen muslimanë.89)

Çuvashët, të cilët janë 1.000.000, gati të gjithë janë kryqar, deri sa 20.000 prej tyre ende janë idhujtarë. Islami shkallërisht i kyq në rradhët e veta; madje edhe dis ačuvashë - të krishterë janë bërë muslimanë. Të tjerët kanë mbetur nën ndikimin islam.

Për entuziazmin fetar të konvertitëve të rinj flet rasti i një fsahti të krishterë çuvashësh në të cilin popi ke kaluar disa vjet deri sa u grumbulloi 300 rublja të nevojshme për restaurimin e kishës. Kur tetë familje çuvashësh kaluan në isla mnë atë fshat, vetëm për disa muaj muslimanët kanë grumbulluar 2000 rublja për ndërtimin e xhamisë.90)

Ky aktivitet i gjallë mund të shënohet si karakteristikë e misionaritetit islam që ka lulëzuar ndër fiset vendëse të asaj kohe. Çdo familje që e ka pranuar islamin ka qenë e ndihmuar në të holla ose në naturë. Për disa ndërtohej shtëpia, për të tjerët është blerë ara, kafshët etj. Nëse në islam kanë kaluar shumë familje në ndonjë fshat, iu ndërtohej mesxhid dhe u formohej shkolla për fëmijët e tyre.91)

Islami në mesin e Tatarëve të Sibirit

Për përhapjen e islamit në mesin e Tatarëve të Sibirit kemi vetëm disa hollësi. Islami fillon të forcohet në ato vise vetëm në fund të shekullit XVI. Misionarët islamë në Sibir kanë hyrë kohë pas kohe edhe para kësaj periode me shpresë që popullatë e atjeshme pagane do ta përvetësojë për fenë e vet. Shumica e këtyre misionarëve atje kanë

vdekur me vdekje shehidi.

Kur Sibiri ka ra nën sundimin muslimangjatë sundimit të Kuçumkanit, janë gjetur varret e shtatë këtyre misionarëve. I ka zbuluar një shejh i vjetër, që ka ardhur nga Buhara duke i kërkuar ata. Ka ditur diçka për devotshmërinë dhe lojalitetin e tyre fesë. Shejhu i ka përmendur edhe emrat e kësaj grupe të shehidëve. Emrat e tyre, deri në shekullin e fundit, kanë mbetur objekt i përkujtiit dhe respektit të Tatarët në Sibir.92)

Kur Kudum-kani (që ka rrjedhur nga familja Gjugji-kan, djalit më të vjetër të Xhingis-kanit) është bërë kan i Sibirit (rreth vitit 1570) me të drejtë në fron me anë të pushtimeve të atyre viseve ose (sipas versionit tjetër) me thirrje të popullësisë së atyre viseve pas vdekjes së 226

kanit i cili ka mbetur pa trashëgimtar,93) - ka dhënë shumë angazhim në konvertimin e shtetasve të vet në islam. Ka dërguar në Buharë për të gjetur misionarë për t'i ndihmuar në këtë detyrë të devotshme. Një nga misionarët që ka arritur nga Buhara na ka lënë përshkrimin e shkuarjes së vet me një shok të vetin në kryeqendrën e Kudum-kanit në brigjet e lumit Irtish.

Këtu pas dy vjetësh i ka vdekur shoku, kurse ai është kthyer në vendlindjen e vet duke mos i përmendur shkaqet.

Nuk kaloi pak, u kthye sërish në vendin e Kuçum-kanit që ta vazhdojë punën e vet në shoqëri të kolegut tjetër. Këtë e ka bërë në kërkesën e përsëritur të Kuçum-kanit Buharës që ta ndihmojë me misionarë.94)

Misionarët e Kazanit gjithashtu kanë ardhur në Sibir. Pushtimet ruse i kanë ndaluar aktivitetet misionariste të Kuçum-kanit para se në këtë të sendëtojnë rezultatet më të mëdha. Në këtë kuptim ka qenë shkak edhe qëndrimi i kundërshtar të disafiseve nën sundimin e tij që t'i për vetisojë në islam.

Ndonëse pushtimi rus e ka ndaluar këtë angazhim, përparimi i islamit në këto vise kurrësesi nuk është ndaluar.

Mullët nga Buhara dhe qytetet tjera të Azisë qendrore dhe tregtarët nga Kazani e kanë vazhduar aktivitetin misionarist islam në Sibër. Islami ka hyrë herën e parë në vitin 1745 në mesin e fiseve tatarë (të banuar ndërmjet lumit Irtish dhe OB). Shumë prej tyre deri në fillim të shekullit XIX kanë qenë idhujtarë, tash të gjithë janë bërë muslimanë.95)

Për kalimin e Kirgizëve në islam ka pasur fjalë, por historia e shumë fiseve tjera muslimane në Sibir ka mbetur e paqartë dhe është për t'u parashtruar se konvertimi i tyre në islam është i kohës më të re. Në mesin e instrumenteve të rëndësishme të propagandës islame deri në kohën tonë është interesant të cekën këngët popullore që i këndojnë Kirgizianët. Këto këngë përmbajnë shumë parime islame të besimit të dhëna nëpërmjet tregimeve dhe legjendave, që mjaft lehtë

gjejnë rrugën deri te zemra e njerëzve të rëndomtë.96)

*) Nuk është e tepërt të tregosh në dallimin ndërmjet nocioneve "Tatar" dhe "Mongol", sikur edhe ndodhite që kanë shpjerë deri te përzjerja e tyre.

227

Me kuptimin e vet të përgjithshëm fjala "Tatar" gjatë shekujve ka pasur domethënie të llojllojshme. Me këtë nocion janë përcaktuar dy grupe të fiseve tatarë në mbishkrimet turke orhane të gurit, që rrjedhin nga shekulli VIII e.r., sikur që ky emër i është dhënë edhe Mongolëve, përgjithësisht ose disave prej tyre.

Në të gjitha pushtimet mongole në shekullin e XIII këta pushtues janë quajtur Tatarë, si në Kinë ashtu edhe në vendet islame, në Rusi ose në Evropën perëndimore.

Ibn Ethiri, historiani arab, të parët e Xhingiskanit i quan Tatarë.

Këta janë Tatarët e vjetër të njohur qysh te Grekët e Vjetër me emrin "Skitët" (Schthia).

Emri "Mongol" paraqitet vetëm në shekullin X, Ka mundësi që ky emër t'i është dhënë atyre fiseve që janë vënë nën udhëheqjen e njërit prej liderëve fisnor, që është quajtur Mongol dhe i cili më vonë ka sunduar me fiset tjera aleate, dhe kështu emri i njërit është shtrirë në të gjithë. (Lane-Poole; Muh. Dyn. p. 200).

Disa historianë konsiderojnë se emërtimi "Mongol" nuk ka qenë i njohur jashtë vendeve që i kanë banuar fiset nomade në kufirin e shkretëtirës Gobi para shekullit IV të Hixhretit (sheh. X e.r.).

Supozojnë se ky emër i është dhënë të gjitha këtyre fiseve pasi që është shtrirë ndikimi i njeriut me këtë emër në të gjitha fiset aleate. Një formacion luftarak mongol ka kaluar edhe në tokat e Azisë së Vogël, posardhësit e të cilit (pa dyshim janë bërë Turq) janë quajtur Tatarë të Zi (Kara Tatar).

Kanë jetuar jetë nomade, beduine në kohën e ekspeditave luftarake të Timurleukos në viset fshatare që shtrihen ndërmjet Amarisë dhe Kajserisë.

Numri u sillej ndërmjet 3- dhe 40 mijë familje.

Timurlenku i ka persekutuar në Azinë qendrore. Sulltani osman Bajazidi II i ka kolonizuar në disa vende në territoret e Kashgarit dhe Havarizmit. Pas vdekjes së Timurleukos Tatarët e Zi kthehen dhe sërish vendosen në Azinë e Vogël.

Në Rusi dhe në Evropën lindore më së shpeshti emri "Tatar" i jepet të gjithë popujve turqë pos Osmanëve - Disa historianë muslimanë konsiderojnë se Tatarët janë një popull i madh i nacionit turk nga e cila janë degëzuar fiset dhe degët tjera.

228

Te perëndimoret ky emër është sinonim për të gjithë Turqit, ashtu që ata të gjithë Turqit i llogarisin në Tatar, në të cilët bëjnë pjesë

Osmanët dhe Turkmenët.

Ky emër (Tatarët) përfshinë të gjithë Mongolët, veçan "Mankos" (Madehus), siç është rasti në Kinë.

Shprehje "Tatar" në tërë domethënien e vet të veçantë është emër i popullit të caktuar me të cilin quheshin banorët e luginës së lumit Volga në territorin e Koranit dhe Astrahanit, sikur edhe banorët e siujdhesës së Krimit dhe një pjesë e popullatës së Sibirit që flet në gjuhën turke.

Duket se popujt që në esencë kanë qenë Mongolë sipas gjuhës veten e kanë quajtur Tatarë.

Fjala "Tatar" pas XHingis-kanit në Mongoli dhe Azinë qendrore është ndërruar me shprehjen "Mongol" (Moghul). Ky term, Mongol, deri më sot përdoret në territorin e Afganistanit për pasardhësit e Mongolëve të cilët deri sot e kanë ruajtur gjuhën e vet. Këtë emër Xhingis-kani e ka futur zyrtarisht në vendin e vet. Por, teri "Mongol" kurrë nuk ka dominuar në shuicën e viseve perëndimore të imperatorisë mongole edhe përkundër futjes zyrtare në përdorim. Këtë e mësojmë edhe nga udhëpërshkruesit evropianë siç janë John of Diani El Carpini (Gjon Djan el-Karbini) dhe William of Rubruck (Viliem Rubruku) e të tjerët. (Fusnota është marrë nga përkthimi arabisht i veprës së Arnoldit Ed-Da'vetu i be 'l-islam, fq. 248 - vër. e përkthyesit.).

*) Ibn Ethiri këtë e përmend kur flet për ndodhitë nga viti 617/1220. (vër. e përkthyesit).

1) Kur'ani, XIX, 23.

2) Ibn el-Athir, bl. XII, fq. 233-234.

*) Caktimi i Ogutayit (1227-1241) për trashëgimtar të babait të vet Xhingis-kanit ka shkaktuar trazira të ithtarët e vëllaut të tij më të vjetër Xhagatajit duke e marrë parasysh se me këtë është thyer tradita që djali më i vjetër të lihet për trashëgimtar. (vër. e përkthyesit).

3) William of Rubruck, fq. 182, 191. C. d'Ohson, vol. II, fq. 488.

4) De Guignes, vol. III, fq. 200, 203.

5) De Guignes, vol. III, fq. 115.

6) Njëjtë, fq. 125 dhe Cahus, fq. 391.

7) Klaprath, fq. 204.

8) C. d'Ohson, vol. II, fq. 226-227, Cahun, fq. 408 sq.

229

9) Për këtë autor autor Yule thotë: "Na ka ofruar pasqyrë të pakontestueshme të diturisë dhe moralit të priftërisë së tyre. Ai është shumë më i vlefshëm nga gjyqet e atyre që i kanë kundruar si renegatë. Rrëfimi i Rubrukut na shpie në mendimin se ka të bëjë me personin e pjekur dhe inteligjent." (Cathey and the Way Thither, vol. I, fq. XCVIII).

10) William of Rubruck, fq. 158-159.

*) Sunduesi i fiseve Hardhitë e Arta (vër. përkthyesit).

- 11) Macrizi (2), vol. I, pjesa I, fq. 38, 106.
 - 12) XHuzxhani (Juzjani), fq. 448-450. Raverty, fq. 1288-1290.
 - 13) Deri në çfarë mase ka qenë i egër veprimi ndaj këtyre shihet edhe nga kjo që argëtuesit kinezë në teatrin e hijeve triumfalisht përpara kanë theksuar figurën e plakut, mjekër bardhë, të lidhur për qofë, kalit për bishti: Me këtë kanë dëshiruar të tregojnë se si kalorësi mongol është sjellur ndaj muslimanëve. (Howarth, vol. I, fq. 159).
 - 14) Raverty, fq. 1146. Howarth, vol. I, fq. 112, 173. Ky ligj nuk është anuluar deri sa tregtarët muslimanë nuk kanë ngurruar nga ardhja në pallat, kurse tregtia që dëmtuar me këtë ligj.
 - 15) Howarth, vol. I, fq. 165.
 - 16) Kur'an, Al-'Araf, 55.
 - 17) Juzjani, fq. 404-405. Raverty, fq. 1160 e tutje.
 - 18) De Guignes, vol. III, fq. 265.
 - 1) Në shekullin XIII tre të katërtat e Mongolëve kanë qenë turqë (Cahun, fq. 279).
 - 20) C. d'Ohson, vol. III, fq. 121.
 - 21) Rashiduddin, fq. 600-602.
 - 22) Blochet, fq. 74-77.
 - 23) Është interesant të ceket se Nexhmuddin Muhtar el-Zahidi në vitin 1260 ka hartuar për BAraka-kanin risalen, trajtesën, e cila me argumente e konfirmon misionin fetar të Muhammedit a.s. dhe e përgënjeshton tërë atë që e kanë shtruar kundërshtarët e kësaj, duke na njoftuar për disputet, diskutimet shkencore, të zhvilluara ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve. (Steinschneider, fq. 63-64).
 - 24) Abu l'Ghazi, bl. II, fq. 181.
 - 25) Juzjani, fq. 447. Raverty, fq. 1283-1294.
 - 26) Juzjani, fq. 447. Raverty, fq. 1285-1286.
 - 27) Maqrizi (2), bl. I, fq. 180-181, 187.
 - 28) Njëjtë (2), bl. I, fq. 215.
 - 230
 - 29) Maqrizi (2), I, fq. 222.
 - 30) Wassaf (al-Hadra) e ka quajtur Nikudar para, dhe Ahmed pas pranimi të islamit.
 - 31) Hayton (Ramusio, bl. II, fq. 60, e).
 - 32) Kur'ani, VI, 125.
 - *) Ahmed dhe Mustafa janë emra të pejgamberit të Zotit Muhammedit a.s.; i pari përmendet në Kur'an LXI, 8 (vër. e përkthyesit).
 - **) Një pjesë e ajetit kur'anor, V, 95 (vër. e përk.).
 - 33) Wassaf, fq. 231-234.
- Këtë letër e ka letër e ka notuar edhe Kalkashindi (Qalqashindi) "Subhul'a'sha", bl. I, fq. 65, 68, dhe është e datuar me muajin xhumade l'ula 681 (gusht 1282), kurse e kanë dërguar dy të deleguar: Kutbuddin Shirazi dhe Ato-be Pehlivani. Kalavuni, sulltani egjiptian, i

është përgjigjur Ilhamit të Mongolëve me letrën nga 1 ramadan po të atij viti /3 dhjetor 1282). Edhe kjo letër e sjell Kalkashindi, bl. VII, fq. 217-242).

34) De Guignes, vol. III, fq. 263-265.

35) Këta janë araguni (1284-1291), XHihatun (1291-1295) dhe Baydu (prill-gusht 1295 v.).

36) C. d'Chason, bl. IV, fq. 141-142.

37) C. d'Ohason, bl. IV, fq. 148-1.

38) C. d'Ohasan, bl. V, fq. 365.

39) Njëjtë, fq. 148, 354 dhe Cahun, fq. 434.

40) C. d'Ohason, bl. IV, fq. 128, 132.

*) Ibn Batuta thotë se mendimet rreth emrit të tij ndahen (vol. I, fq. 143). Thonë Huda, që në persishte do të thotë Zot, dhe bende që d.t.th. djalosh, shërbëtor. rob. Pastaj thonë Haratbende, që në persishte d.m.th. gomar. E emri do t'i thoshte Abdullah, rob i All-Ilahut, apo Djalosh-gomar.

Flitet se shkaku i emërtimit me këtë erin tjetër është një zakontatar që fëmija, kur të lindet, të quhet me emrin e të parit që hynë në shtëpi. Kur ka lindur, i pari që ka hyrë ka qenë pronari i ngarkesës, sipas gjasave, gomari i ngarkuar, dhe është quajtur për këtë Haratbende. Brauni thotë se Ulxhajtu, kur Gozani ka ardhur në pushtet, ka ikur në internim dhe i ka ruajtur gomarët në territorin e Kermanit dhe Harmesit dhe se sipas saj i është dhënë emri Harabende, rojtar i gomarëve.

231

Tregohet se prindërit i kanë dhënë emër të keq që mos t'i bien mësysh sytë e të këqinjve dhe se për këtë është quajtur Harabende. Ngjashëm kanë bërë Arabët e vjetër duke iu dhënë fëmijëve emrat: Shkëmbi (Fihri), Guri (Sahr), Qeni (Kelb), Çakall (Muavin), me shpresë që fëmija, kur rritet, të bëhet ndaj armikut si gur ose qen. ibn Werdi (Historia e Werdit, fq. 264) thotë se emrin e ka Hudabende dhe se sundimin e ka shtrirë në Irak, Horasan, Azerbejxhan dhe Dijarbekr (vër. përkthyesit).

41) Hammer - Purtgstell Geschichte der Ilahanen, bl. II, fq. 182.

Duket se muslimanët e robëruara kanë luajtur rohin e dalluar në konvertimin e Mongolëve në islam, sepse femra të Mongolët ka pasur vend të nderit e të nderuar.

Mund të cekem shumë shembuj nga të cilët mund të shihet ndikimi i saj edhe në jetën politike. Tashmë kemi shtruar shumë raste ku femrat kanë ndikuar edhe në përcaktimet fetare të burrave të vet. Viliem Rubruku na flet për atë se si vetë ka përjetuar ndikimin e një gruaje muslimane dhe se si qëndrim i saj i është kundërvënë në përhapjen e ideve të tij fetare: "Në ditën e Shpirtërave na ka ardhur një musliman (Saracen). Në bisedë me të kemi filluar ta shpjegojmë mësimin fetar. Kur ka dëgjuar për dhuratat e Zotit njerëzve dhe

personifikimin e tij te njeriu, ringjalljen pas vdekjes, Ditën e gjykimit dhe faljen e mëkateve me kungatë, ka dëshiruar të kungohet. M'u kur jemi përgatitur që ta kungojnë, befaz kërcen nga kali duke thënë se duhet pa tjetër të shkojë në shtëpi dhe të konsultohet me gruen. Ditën vijuese, në bisedë me ne ka thënë ëse nuk mund të kungohet sepse prej atëherë nuk do të mund të pijë më qumshtë të pelës. (Rubruck, fq. 90-91).

42) Ibn Batuta, bl. II, fq. 57.

43) Juzjani, fq. 381, 397. Raverty, fq. 11103, 1145-1146.

44) Rashid al'Din, fq. 173-174, 188.

45) Abu-l-Ghozi, bl. II, fq. 159.

46) Ibn Batuta, bl. III, fq. 47.

47) Abu-l - Ghazi, bl. II, fq. 166-168; Muhammad Haydar, fq. 13-15.

48) Me rënien e fuqisë së dinastisë

.Ky është fis bujqësor që i përgjigjet nomadëve dhe blegtarëve. Sot quhet Turkestani Kinez.

232

49) Muhammad Hayydar, fq. 57-58.

50) Ka qenë kjo gjatë kohës së Abdulkërim, i cili ka qenë kan i Kashgarit (983-1003 H./1575-1594)

51) Martin Hartmann, Der Islamische Orient, vol. I, fq. 203 (Berlin, 1899).

52) Martin Hortmann, Der Islamische Orient, vol. I, fq. 202.

53) Assemani, bl. III, pars. II, fq. CXVI.

54) Rashid al'Din, fq. 600, pasusi I.

55) Rahsid al'Din, fq. 600, pasusi I.

*) Ky rend (tarikati) konsiderohet degë e lëvizjes mistike sunnite në Horasan (Persi) dhe është thirrur me emrin Muhammed b. Muhammed Bekauddin Buhari Nakshibendi (vd. 1389 v.) ndonëse ai nuk është themelues direkt. (Vër. e përkthyesit).

56) Cahun, fq. 410.

57) Howarth, vol. II, fq. 1015.

58) Abu l-Ghazi, bl. II, fq. 184.

59) Karamzin, vol. IV, fq. 391-394.

60) Hammer-Purgstall, Geschichte der Goldenen in Kiptschok, fq. 290.

61) Mbi BAshkardët, që i cekin Ibn Fadlani dhe Yakuti, ka shkruar: C.N. Fraehnió (Memoires de l'Acadei Imperiale des Sciences de St. Petersbourg, bl. VIII, fq. 626, 1822).

62) Abu Ubayd al-BAkri, fq. 470-471.

63) Karamsin, bl. I, fq. 259-271.

64) Bobrovnikoff, fq. 13.

65) Reclus, bl. V, fq. 831, R.du M.M. bl. III, fq. 76, 78.

66) Relation des Tartares, far Jean de Luca, fq. 17 (Thevenot, bl.

- l).
- 67) Isla and Missions, fq. 257.
- 68) Gasztowtt, fq. 321-32. R. du M.M. XI (1910), fq. 287, sqq.,
- 69) The Russidn Policu regarding Ceutrol Asia. An histarical shetch, By prof. V. Grigorief (Eugene Schuyler: Turkistan, vol. II, fq. 405-406, St ed. London, 1876; Frauz von Schwarz, Turkestan, fq. 58. (Freiburg, 1910).
- 70) Islam and Missions, fq. 251-252, 225.
- 71) D. Mackenzie Wallace, Russia, vol. I, fq. 242-244, London, 1877, 4th ed. R. de M.M. vol. IX (1909), fq. 249, Bobrovnikoff, fq. 5 sqq.
- 233
- 72) W. Hepworth Dixon, Free Russia, vol. II, fq. 284, (London, 1870).
- 73) Për shembull, në vitin 1883 janë dërguar fshatarët e fshatit Apozof para gjyqit në Kazan sepse e kanë lëshuar pravoslavljen. Të pandehurit kanë deklaruar se gjithnjë i kanë takuar islamit. Shtatë prej tyre janë denuar në punën e rëndë fizike për shkak të mosbesimit, deri sa shumë që e kanë lëshuar krishterizmit janë internuar në Sibir. Anatole Leroy-Beaulien, L'Empise des Tsars et les Rusees, bl. III, fq. 645 (Paris, 189-1893).
- 74) D. Mackonzie Wallace, Russio, vol. I, fq. 245.
- 75) Palmieri, fq. 85-86. R. de M.M. dhe (1907), fq. 162 sq.
- 76) R. du M.M. IX (1909), fq. 294.
- 77) Ibid. X (1910), fq. 413, Id. I (1907), fq. 273.
- 78) Ibid., X, fq. 252.
- 79) Ibid., fq. 249.
- 80) Bobrovnikoff, fq. 12.
- 81) Këto fise me prejardhje janë tetone dhe kanë qenë të banuar në Evropën veri-lindore.
- 82) Reclus, bl. V, fq. 716, 748.
- 83) Eruslanov, fq. 3, 6.
- 84) Ibid., fq. 7-8.
- 85) Eruslanov, fq. 5-6.
- 86) Eruslanov, fq. 9, 13.
- 87) Ibid., fq. 17, 20, 36.
- 88) Ibid., fq. 38-39.
- 89) Bavrovnikoff, fq. 22.
- 90) Bobrovnikoff, fq. 21-22, 31.
- 91) Ibid., 13, Islam and Missions, fq. 257.
- 91) G. F. Müller, Sammlung Russischer Geschichte, vol. VII, fq. 191.
- 93) G. F. Müller, Sammlung Russischer Geschichte, vol. VII, fq. 183-184.
- 94) Radloff, vol. I, fq. 147.

95) Jadrinzev, fq. 148; Radloff, vol. I, fq. 241.

96) Radloff, vol. I, fq. 472, 497.

KAPTINA IX

234

PËRHAPJA E ISLAMIT NË INDI

Shtrirja e popullësisë muslimane

Shumë historianë klasikë e bashkëkohorë barabartë janë preokupuar me pushtimet muslimane në Indi dhe forcimin e ndikimit të tyre dhe me zhvillimin e islamit në ato vise.

Mirëpo, askush nuk ka tentuar deritash të shkruaj për historinë e përhapjes së islamit në Indi si diç të ndarë nga fitoret luftarake dhe punëve drejtuese të ithtarëve të kësaj feje. Njëmend, ndërmarrja e këtillë i duket i pamundur shumicës së këtyre historianëve.

Shpesh India zgjidhet dhe theksohet si shembull tipik i vendit ku islami i ka borgj ekzistimin dhe qëndresën e vet vendosjes në të të elementit të huaj, pushtues islam që e ka bartur fenë e vet pasardhësve pas tyre. Jashtë rrethit të vet kanë arritur të zgjerohen ekskluzivisht me anë të forcës dhe persekutimit.

Disa kanë konsideruar se fryma misionariste islame po dëftohet në fytyrën e vet të vërtetë nëpërmjet masakrit brutal të Mahmud Gazneviut ndaj brahmanëve, dhe në persekutimet e Aurangzebit, 1) sunetin e detyrueshëm gjatë sundimit të Hajdar Aliut, Tipu-sulltanit dhe të ngjashëm me ta.

Por ne në numrin prej 66 milionë muslimanësh të Indisë²⁾ gjejmë numër të madh të atyre të cilët detyrimi në konvertimin e tyre dhe konvertimin e pasardhësve të tyre nuk ka pasur madje kurrfarë pjesëmarrjeje. Ndikimi i njëmendët në këtë punë ka pasur mësim dhe bindje fetare të misionarëve muslimanë paqëndashës.

Ky lloj i konvertitëve e përbëjnë një grup të veçantë që dallon nga ajo që detyrimisht e ka pranuar islamin dhe grupeve tjera heterogjene që e përbëjnë muslimanët e Indisë.

Tërë bashkësinë e muslimanëve mundemi, për afërsisht, ka ndajmë në ata që i takojnë elementit të huaj dhe në ata që islamit i janë afruar nga njëra prej feve të vjera në vend nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm dhe në periodat e ndryshme historike.

Vendbanimet e huaja në Indi përbëhen prej tri grupeve themelore. I pari, numerikisht më i rëndësishmi, është grupi i ardhacakëve që kanë arritur nëpër kufijt veri-perindimor të Indisë dhe i gjejmë në dy provinca: në Sind dhe Penxhab.

235

Grupi i dytë janë të mbeturit e pjesëtarëve të pallatit ose ushtrisë të disa dinastive muslimane, që janë vendosur në Indinë e epërme, e shumë më pak në rrafelartën e Dekkanit.

Grupin e tretë e të fundit e përbëjnë ata që e kanë banuar bregun perëndimor dhe nuk është e pamundur se me prejardhje janë Arabë.

Themeluesit e këtyre kolonive kanë arritur në Indi me rrugë detare.³⁾ Numri i familjeve të prejrdhjes së huaj që janë banuar në Indi, përveç Penxhabit dhe rrethinës, askund nuk është i madh. Është e saktë se më shumë se gjysma e muslimanëve të Indisë ka marrë shprehimisht emërtime të huaja sikur: shejh, beu dhe kani, e madje edhe sejjid⁴⁾, ndërkaq, shumica e këtyre muslimanëve janë ose popullatë lokale e këtyre viseve ose pasardhësit e tyre që kanë kaluar në islam. Emërtimet e sipërme i merrnin prej personalitetit më të largët ndër ata që i kanë kthyer në islam ose kjo ka rrjedhur me përzierjen me aristokracinë muslimane, e edhe sipas disa motiveve më pak të rëndësishme.⁵⁾

Sa i përket pjesës së dytë të këtij grupi - e kjo është popullata autoktone që ka kaluar në islam -, një pjesë e tyre pa dyshim e ka ndryshuar fenë me dhunë dhe nën presionin e pushtetit zyrtar, por pjesa më e madhe ka hyrë në gji të islamit krejtësisht sipas vullnetit dhe zgjidhjes së vet vetjake.

Historisë së lëvizjeve që muslimanët i kanë zbatuar me qëllim të përhapjes së islamit dhe ndikimet shoqërore që kanë sjellë deri te kalimi i një pjese të popullatës induse në islam, i është kushtuar vëmendje shumë e vogël.

Shumica e literaturës historike në të cilën mund të thirreni kurse e cila flet për muslimanët e Indisë, pa marrë parasysh se autorët u janë Evropianët ose njerëzit e vendit, janë vetëm kronikat (sixhilët) mbi luftërat, fushatat, aksionet e disa sunduesëve, me të dhëna të varfëra të jetës fetare në atë kohë. Nëse diçka edhe është thënë, ka qenë kjo në formë të jotolerancës dhe fanatizmit.

Nga biografitë e njerëzve të mirë (evlijave) muslimanë dhe traditave të vendit mund të mësojmë diç për jetën misionariste të muslimanëve që ka qenë plotësisht e pavarur nga jeta politike në vend. Para se të themi diç për këtë punë, do të jetë mirë të sjellim një shkëputje nga propaganda zyrtare e islamit dhe ta theksojmë rolin që suntuesit muslimanë e kanë luajtur në përhapjen e fesë së vet.

236

Sunduesit muslimanë dhe kontributi i tyre në përhapjen e islamit Pesëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së Pejgamberit, Arabët e kanë përgatitur një ekspeditë (ushtarake) në Sind. Vërsimi pushtues drejt Indisë ka rrjedhur nga ana veriperëndimore, dhe ka vazhduar deri në shekullin XVIII.

Disa nga disa këta pushtues kanë qenë themelues të imperatorisë së fuqishme, deri sa të tjerët kanë qenë avanturier të rëndommtë. Disa kanë ardhur vetëm për shkak të plaçkitjes dhe presë, me të cilin edhe janë kthyer, deri sa të tjerët kanë mbetur dhe themeluar shtete, ndikimi i të cilit është ndier atje deri sot.

Nuk e dijmë se këta të parët a kanë marrë me vete çfarëdo misionarësh dhe propaganduesish të fesë dhe këtë jo për shkak të

indiferentitetit të tyre ndaj fesë.

Shumë prej tyre invadimin e vet në Indi i kanë publikuar në dritën e luftës së shenjtë, xhihadit, që vërehet në idenë që kanë qenë në kokën e Mahmud Gazneviut dhe timurleukos. Ky i fundit, pas marrjes së Delhit, ka shkruar në biografinë e vet si vijon: "Kam qenë pesëmbëdhjetë ditë në Delhi. Kjo kohë më ka kaluar në disponim dhe hare. I kam organizuar këshillimet mbretërore dhe kam dhënë gosti të mëdha. Pastaj jam përkujtuar se kam ardhur në Hindustan për të luftuar me pabesimtarët.

All-llahu e ka bekuar këtë ekspeditë dhe më ka mundësuar të shkojë nga fitorja në fitore. Kam triumfuar ndaj kundërshtarëve të mi dhe kam zhdukur shumë pabesimtarë dhe idhujtarë. Shpatën e ndërrimit të fesë e kam lagur me gjakun e armiqëve të fesë.

Tash, pas fitores së shkëlqyeshme, ndiej se nuk më ka hije që t'i lëshohem qetësisë së përhershme, por që edhe më tej të angazhohem në luftë kundër pabesimtarëve të Hindustanit."6)

Ndonëse Timurlenku flet shumë për shpatën e vet me të cilën është ndihmuar në përhapjen e misionit, duket se ajo nuk i ka shërbyer kurrfarë qëllimi tjetër pos dërgimit të pasbesimtarëve në skëterrë. Duket se shumica e pushtuesëve muslimanë kanë ndjekur pikërisht rrugën e këtillë.

Në emër të All-llahut janë rrënuar idolet, priftërit e tyre kanë ardhur nën shpatë dhe u janë rrënuar tempujt, kurse në vendet e tyre, në të shumten e rasteve, janë ngritur xhamitë.

237

Është e saktë se islami u është ofruar Hindusëve pabesimtarë para se muslimanët t'i atakojnë.7)

Nganjëherë frika e detyronte botën ta pranojë këtë fe. Këto janë faktet të cilat kanë qenë në të shumtën me efekt afatshkurtër, së paku ditëve të para të pushtimit islam, sepse kanë mbetur pa ndikim pas tërheqjes së pushtuesit.

Kjo gjendje na ilustron tregimin për Hardattin, njërit prej kryetarëve (ra'is) të Bulandsharit,* i cili i është nënshtruar Mahmud Gazneviut, që e ka shtruar autori i historisë të pushtimeve të Mahmudit dhe sekretari i tij.

Në fund (rreth 410/1010) Mahmudi arriti deri te kështjella Barba8) në tokën e Hardattëve, i cili ishte njëri prej raisëve, që në gjuhën hindu d.m.th. "mbret". Kur Hardatti ka dëgjuar për këtë sulm që e kryen luftëtarët e All-llahut, e të cilët vinin sikur valet e detit, të rrethuar me melaqe nga të gjitha anët, e kaploi zemërim i madh, këmbët i dridheshin, u frikësua për jetën e vet që do të mund të humbej sipas drejtësisë së Zotit.

Për këtë arsye e ka parë t'ë arsyeshme si mënyra më e mirë që t'ëshpëtojë është nëse pranon ta pranojë islamin, sepse shpata e Zotit që nxjerr nga këllëfi, kurse zëri i denimit tashmë jehonte. Ka hyrë me

dhjetë ijë njerëz duke e manifestuar dëshirën për kthim në islam dhe lënien e idoleve.9)

Këta konvertitë të ri, sigurisht, kanë shfrytëzuar rastin e parë që u dëftohet - pas tërheqjes së pushtuesit - që të renegasin nga feja. Kjo është shfaqje në të cilën ankohen historianët muslimanë të Indisë. Kur Kutbuddin Ujbeku e sulmoi Baranin në vitin 1193, rreptë iu kundërvu Çandraseni, raxha i atëhershëm, që mbanë prejardhje nga dinastia Hardatte. Vetëm emri i tregon në fenë e tij hindu dhe nga atëherë nuk kemi dëgjuar për ekzistimin e muslimanëve nën sundimin e tij.10)

Duket se te këta pushtues ka pasur shumë pak aso që ne e quajmë "dashuri për shpirt", e cila i motivon misionarët e singertë në përhapjen e islamit kurse e cila ka kryer pushtime aq të mëdha për islamin.

Dinastitë e Hilixhive (1290-1320), Tuglukëve (1320-1412) dhe Lodëve (1451-1526) kanë qenë rëndom të preokupuara me luftëra dhe shuë nuk i kanë dhënë rëndësi qëllimeve fetare. Shumë më tepër kanë qenë të preokupuar me vënien dhe grumbullimin e tatimeve se sa me

238
punën në përhapjen e fesë.11) Mirëpo, nuk kanë qenë plotësisht pa zjarr fetar. Për shembull për Xhakherët, popull barbar në viset malore në veri të Penxhabit, të cilët pushtuesëve të parë u kanë shkaktuar shumë kokëçarje, thuhet se kanë kaluar në islam nën ndikimin e Muhammed Gurit në fund të shekullit XII.

Sunduesi musliman e robëroi liderin e tyre dhe e shtyri ta pranojë islamin. Pasi që ia vërtetoi titullin e udhëheqësit të këtij fisi, e ka kthyer që ithtarët e vet t'i kthejë në islam.

Duke e marrë parasysh se shumica e tyre pak kanë dijtur për fenë e tyre të mëparshme, ka qenë lehtë që islam të dominojë tek ata.12)

Sipas fjalëve të Ibn Batutës, Hilixhët e kanë përkrahur botën ti kalojnë në islam. Patën bërë traditë që njeriun që e pranon islamin t'i prezentohet sulltanit, i cili do t'i falte rroba të bukura, unazë dhe bylyzyk prej arit në vlerën që ka qenë proporcionale me pozitën e tij shoqërore.13)

Sunduesit e dinastive të hershme muslimane nuk kanë pasur majft zjarr fetar për përhapjen e islamit. Është vështirë të gjendet, në historinë e tyre, diç të ngjashane me pasusin vijues nga autobiografia e Firus-shah Tuglakut (1351-1388): "I kam nxitur shtetasit e mi pabesimtarë ta përqafojnë fenë e Pejgamberit. Kam shpallur se çdo person që e pranon këtë besim dhe bëhet musliman do të lirohet nga xhizja ose tatimi personal.

Ky lajm u dëgjua në mesin e njerëzve dhe numri i madh i Hindusëve është prezentuar dhe iu lejua që ta arrijnë nderin e islamit. Pas kësaj, nga dita në ditë, kanë ardhur nga të gjitha viset dhe e kanë pranuar fenë. Kanë qenë të falur nga xhizja dhe janë dhuruar me

peshkeshe dhe mirënjohja.14)

Kur ndikimi islam u forcua, veçan në kohën e dinastisë së Mogulëve, ndikimi fetar i islamit, natyrisht, ka qenë më i pranishëm dhe i vazhdueshëm.

Ky ndikim sidomos ka qenë i shprehur në lëvizjet hindu, të cilët flasin për ekzistimin e Zotit, kurse paraqiten gjatë shekullit XV dhe XVI.

Peshkopi Lefroy konsideron që natyra e qartë dhe konkrete e mësimit islam i ka tërhequr mendjet që nuk kanë mundur të kënaqen me idenë e panteizmit,15) që shquhet me paqartësi dhe relativitetet. Kur islami, me lojalitetin e vet të fortë njemendësisë së ekzistencës së Zotit nga e cila rrjedh si natyra objektive e plotë dhe e fuqishme e 239

të vërtetës, erdhi në konflikt me idenë e transcendencës - me panteizmin dhe subjektivizmin e besimit të tij, domosdoshmërisht ka ecur para. Islami nuk fitoi vetëm në konflikt, por ka ardhur edhe si ilaq shpëtimtar për jetën dhe mendimin e Indisë së epërme. Së shpejti i freskoi dhe edhe më shumë i ngjalli shumë shpirtëra që kurrë, vetëvetiu, nuk do të lëviznin intelektualisht.16)

Islami i Raxhaputave dhe të tjerëve

Iniciativa më e fuqishme e kalimit në islam është bërë më e theksuar kur besimi në idhuj bëhet pengesë në rrugën e përparimit në karrierë në pallatin muslimanë, ndonëse fryma e tolerancës, që e ka arritur kulminacionin e vet gjatë sundimit të Ekberit eklebtik,8) është dëftuar ndaj Hindusëve dhe në shumë raste janë respektuar pasuritë e lënë me tertament të kësaj feje.17)

Përveç kësaj që frika (e Ekberit) nga jopopullariteti dhe dëshira për përvetësimin e njerëzve e kanë diktuar politikën e mospërzjerjes dhe gjykimi i veprimeve të dhunës dhe kryengritjes së fanatizmit fetar, që i ka karakterizuar perioda e parë e pushtimit dhe fitores, - përkundër të gjitha këtyre, motivet e interesit personal i kanë tërhequr shumicën nga hinduizmi në besimin islam.

Në këtë mënyrë shumë Raxhaputë janë bërë muslimanë. Deri sot pasardhësit e tyre mund të gjenden në mesin e aristokracisë çifligare. Në mesin e këtyre do të mund të jetë dega më e rëndësishme e muslimanëve që i përket fisit të madh të Bashkotëve, të cilëve në krye u qëndron fisniku Oda, udhëheqësi i parë muslimanë.

Sipas një legjende, imperatori BAbari e ka robëruar të pari e tyre Tilok Çaudën, që lirinë e vet e ka blerë me pranimin e islamit.18) Sipas legjendës tjetër, konversioni i tij ka qenë në kohën e sundimit të Humajunit. Kur ky sundues ka dëgjuar për bukurinë magjepëse të gruas Tiloka Çaudës kur ajo ishte në bazare, iu ka urdhëruar njerëzve të vet që t'ia sjellin.

Në fund ndërgegjja nuk i qe e qetë dhe ai ia ka kthyer burrit të tij. Tilok Çaudi ka qenë i dëshpëruar dhe i bindur se kurrë më nuk do

ta shohë. Nga mirënjohja ndaj kësaj mirësie, edhe ai edhe gruaja e tij e kanë pranuar islamin "i cili njerëzit i mëson në etikën fisnike."19)

240

Raxhaputët që kanë kaluar në islam janë mjaft të përkushtueshëm praktikimit të fesë së vet. Shpesh i kundërvihen fesë së vet të vjetër hindu, dhe këtë në mënyrë të çuditshme.

Për shembull, në krahinën Bulaudshehr e gjejmë familjen e madhe muslimane të njohur me emrin Lalkani Pathan me përjashtim të vogël, e cila ende i ruan emërtimet e vjetra hindu dhe traditat martesore familjare.

Nga po ky fis ekzistojnë degët hindu, të cilët jetojnë njëri pas tjetrit.20)

N krahinën Mirzapur pjesëtarët e fisit Xuhavar Raxhputi, të cilët tash janë muslimanë, ende i kanë mbajtur elementet e të drejtës së vendit hindu, zakonet dhe traditën dhe në emrat e vet muslimanë i marrin titujt e nderit hindu.21)

Kalimet e detyrueshme në islam

Thuhet se detyrimi zyrtar kurrë nuk është përdorur ndaj Hindusëve sikur gjatë sundimit të Aurangzebit.

Në pjesët lindore të Penxhabit ka shumë raste ku i pari i degës muslimane të bashkësisë, si thonë, e ka ndërruar fenë e vet gjatë sundimit të këtij fanatiku "që ta shpëtojë tokën në fshat."

Në qytetin Xhurxhan afër Delhit jeten familja hindu Banjas e cila ende mbanë titullin shejh (të cilën, rëndom, e kanë marrë Hindusët që kanë kaluar në islam), sepse njëri prej anëtarëve të kësaj familjeje, fisi i të cilit ka vdekur, e ka pranuar islamin që ta shpëtojë pasurinë e familjes nga konfiskimi.22)

Shumë Raxhputë, çifligarënë krahinën Kanpur, kanë qenë të detyruar ta pranojnë islamin në këtë mënyrë.23)

Në disa raste tjera thuhet se ky stërgjysh është sjell në Delhi si rob ose peng, ku është synetuar dhe detyrimisht është kthyer në islam.24)

Duhet të vërehet se burimi i këtij konvertimi të detyrueshëm është legjenda familjare ose lokale, dhe kjo nuk përmendet (se kam mundur unë të verifikojë në burimet historike nga koha e sundimit të Aurangzebit.25)

Është pjekur mendimi, pa dyshim, se kthim të detyrueshëm ka pasur nga ana e sunduesve muslimanë. Kjo duket e mundshme për shkak të entuziazmit fetar mirë të njohur të Aurangzebit që ka qenë shkak që shumë familje të Indisë veriore (historia e kalimit në islam e 241

të cilëve kaherë është harruar) ndërrimin e fesë së vet ta lidhin për këtë. Ky shkak është më i afërt supozimit.

Ngjashëm është edhe në Dekan ku Aurangzebi merrë pjesë me Hajdar Alian dhe Tipu-sulltanin (e këta janë sunduesit më të njohur muslimanë në atë kohë), në thashethemet mbi konvertimin e

detyrueshëm të familjeve dhe grupeve tjera të popullatës vendëse konvertimi i të cilëve në islam pa dyshim daton shumë para kësaj date dhe për çka nuk ka shënime historike që këto ndodhi t'i merrë parasysh.26)

Ka mundësi që tipu-sulltani ka qenë ai sundues muslimanë që më tepër sistematikisht është angazhuar në kthimin e detyrueshëm në islam.

Proklamacionin vijues ia ka shpallë në vitin 1788 popullit të Mallabarit: "Pas 24 vjet të kaluara nga nënshtrimi i vendit tuaj, ju ende jeni të padëgjueshëm dhe rebelues. Ende jeni burim i trazirave dhe rreziqeve. Në luftërat që janë zhvilluar në sezonën kishore ju keni qenë shkak i vdekjes së shumë ushtarëve tanë. Le të jetë kjo. Ç'ka qenë - ka kaluar. Jam i gatshëm ta harroj të kaluarën.

Është koha që ta ndërroni sjelljen tuaj, t'i mbaheni rendit e qetësisë dhe t'i paguani rregullisht tatimet siç e bëjnë këtë shtetasit tjerë. Deri sa gruaja juaj nuk kënaqet me një njeri por shoqërohet me dhjetë dhe bëni dashuri me nënat dhe motrat tuaja dhe deri sa të jeni të zhytur në të këqia të ndryshme, për çka të gjithë po lindeni nga adulteria, dhe deri sa raportet reciproke i keni më të mjerë se raportet me bishat e egra, e shoh se jam i detyrueshëm t'ju pengoj nga zakonet më katare, kurse t'ju këshilloj që të jeni si njerëzit tjerë. Nëse gaboni ndaj urdhëresës sime dhe bëheni të shurdhër nga këshilla, sinqerisht ju betohem se do t'ju detyrojë në rrugë të drejtë dhe do t'ju dhurojë të gjithëve me islam. Do t'i sjell të gjithë njerëzit tuaj më të rëndësishëm, të vjetër e të rinj, në qendër të pushtetit tim."

Kjo komunikatë nxiti kryengritje në Malabare. Në filli më vitit 1789 Tipu-sulltani ka përgatitur ushtrinë prej 20.000 ushtarësh që me forcë ta zbatojë këtë komunikatë. Ka dhënë urdhërin e përgjithshëm që çdo person në krahinë, pa dallim, do të nderohet me hyrjen në islam. Shtëpitë e atyre që ikin nga ky nderim do të digjen dhe do të ndiqen deri atëherë kur të gjenden në vende të fshehta. Duhet të përdorohen të gjitha mjetet e sinqeritetit dhe gënjeshtërisë, fuqisë dhe dinakërisë që të detyrohen të gjithë në ndërrimin e fesë.

242

Në bazë të kësaj mijëra Hindusë janë synuar dhe janë detyruar të kanë mish lope. Ushtria britanike, kah fundi i vitit 1790, ka shkatërruar pjesën e mbetur të forcave të Tipu-sulltanit në Mallabar, kurse vet sulltani ka përjetuar fundin e vet në fillim të vitit 1799 kur Anglezët e pushtuan Seringa patemin.*) Shumë brahmanë dhe najasë, që detyrimisht janë konvertuar, më vonë e kanë lëshuar fenë e vet të re.27)

Sa pak efekt ka për përhapjen e islamit me dhunë nga ana e sunduesëve muslimanë mund të gjykohet nga fakti që madje në qendrat ku dominues është ndikimi musliman, siç janë Delhi dhe Agra, muslimanët nuk e përbëjnë, në kohën bashkëkohore, më tepër se

10% të popullësisë në krahinën e parë, deri sa në krahinën e dytë përbëjnë 1/4 e popullësisë.28)

Një shembull i pavlefshmërisë së konvertimit të detyrueshëm dëftohet në rastin e Budh Malit, raxhës nga Maxhhanli në krahinën Gorkapur. Qe mbyllur nga ana e Akbarit për shkak të fshehjes së haraxhit, është sjell në Delhi, është konvertuar në islamm dhe është quajtur Muhammed Salim. Kur është kthyer, gruaja i patë ndaluar të hyjë në kështjellën e të parëve të tij. Ajo simpatitë e shtetaasve të tij si duket i tërhoqi në anën e vet dhe sundoi me vendin, deri sa djali i saj Bhawani Mali ka qenë i mitur, dhe ashtu pa ndryshim ka vazhduar trashëgimia hindu në fronë.29)

Deri sot janë ruajtur disa gjurma të çuditshme të orvatjeve ë ngjashme indolente të konvertimit të njerëzve në islam. Vërehet kjo në disa zakone të sektit hindu që quhet Bishnoi.

Principet themelore të besimit të tyre janë refuzimi i të gjitha hyjnive hindu përveç Vishnes. Në kohën më të re kanë filluar t'i varrosin të vdekurit e vet në vend që t'i djegin.

kanë pranuar emrin Gula mMuhammed, sikur edhe disa emra tejrë muslimanë, dhe përdorimin e përshtatjes muslimane.

Përshtatjen zakoneve muslimane e shpjegojnë me fjalët se njëherë e kanë thënë kadiun i cili qe përzier në zakonin e tyre për djegien e të vejes. Gabimin e berë e kanë përmirësuar me kalimin në islam.

Mirëpo, ata sot kanë hequr dorë nga kjo praktikë në dobi të zakonit hindu.30)

Edhe përkundër të gjithave, disa sundues muslimanë nuk kanë pasur sukses më të madh në detyrimin e shtetasve të vet hindu që ta pranojnë islamin më tepër se në rastet e përmendura.

243

Sa do të vërtetë të mund të ketë në pohimin31) se është "e pamundur t'i afroresh anës fetare të pozicionit të muslimanëve në Indi e që më parë mos të shqyrtohet aspekti i tij politik" me, pa dyshim, konsiderojmë se islami ka arritur fitoren e vet më të madhe dhe suksesin permanent misionarist në kohën dhe vendet ku fuqia e tij politik ka qenë më e dobëta, siç ka qenë kjo në Indinë jugore dhe Bengallin lindor.

Nuk do të ishte keq t'i shtrojmë disa shembuj të lëvizjeve të atilla misionariste, duke filluar me Indinë jugore dhe rrafshëllartën e Dekanit. Pasi që në mënyrë kritike ta shqyrtojmë historinë e Sindit, Kuçit (Cutch) dhe Guxhuratit, do të kalojmë në Bengal dhe, në fund, do të dëftojmë në punën e disa misionaristëve veprimi i të cilëve ka qenë jashtë kufinjve të përmendur gjeografik.

Për këta shumë misionarë historianët kanë dhënë shumë të dhëna, me përjashtim të cekjes së emrave të tyre dhe sferës së punës. Në këtë domen nuk posedoj më me të dhënat detaje për shkak të lajeneve të rralla për misionaritetin përgjithësisht.

Islami në Indinë jugore

Depërtimi i parë i islamit në Indinë jugore na kthenë në shekullin VII kur një grup i të ikurish arriti nga Iraku, u strehua në Mapilla dhe u vendosë në këto vise.32)

Arabët dhe Persianët janë marrë me tregtinë e mëlmesave, eshtrat e elefantëve, gurët e çmueshëm e tjera ndërmjet Indisë dhe Evropës disa qindra vjet. Kjo ka shkaktuar ndiki të vazhdueshëm islam në bregun perëndimor të Indisë jugore. Rezultat i grumbullimit konstant në këtë krahinë është ajo që është krijuar përzjerja e popullësisë, gjysma Hindusë, gjysma Arabë ose Persianë në qendrat tregtare përgjatë bregut.

Janë krijuar edhe marrëdhëniet miqësore ndërmjet këtyre tregtarëve muslimanë dhe sunduesëve indusë, të cilët u kanë ofruar patronatë dhe mbrojtje, duke pasur parasysh aktivitetin e rritur tregtar nga i cili ka rrjedhur mirëqenia e vendit, si rezultat i qëndrimit të këtyre tregtarëve në të.31)

Nuk ka pasur pengesa në rrugën e veprimit misionarist. Ata që e kanë pranuar islamin kanë gëzuar respektin e njëjtë që e kanë pasur 244

edhe tregtarët e huaj, ndonëse para kalimit në islam kanë qenë në shkallën më të fundit të rangut shoqëror.34)

Shpjegimi tradicional për hyrjen e islamit në Malabar, si na jep historiani muslimanë nga shekulli XVI, është që misionarët e parë kanë qenë grup i haxhive që kanë shkuar ta vizitojnë gjurmën e hapave të Ademit a.s. në Cejlon.

Kur kanë arritur në Kranganor, e ka dërguar raxhën tek ata.

Udhëheqësi i këtij grupi, shejh Sherif b. Maliku, në shoqërinë e të cilit ka qenë vëllau i tij Malik b. Dinari dhe i nipi Malik b. Habibi, gjeti rastin e volitshëm që raxhit t'i prezentojë mësimin e islamit dhe pejgamberinë e Muhamemdit a.s. Zoti e futi sinqeritetin e mesimit të Pejgamberit në zemrën e mbretit dhe ai e pranoi. Zemrën ia mbushi me dashuri ndaj Pejgamberit. I urdhëroi shejhut që me shokët e vet të kthehet sërish pas kthimit nga polegrini hapave të Ademit.35)

Kur u kthyen nga pelegrini nga Cejlioni, mbreti jshehtas hypi në barkë, e cila ishte para nisjes në bregun e Arabisë. Mbretërinë na ka në qeverisje zëvendësve.

Atje mbeti një kohë. Kur dëshiroi të kthehet në vendin e vet, me vendosjen që të ndërtojë xhamia dhe ta përkapë islamin, u sëmu dhe vdiq.

Në shtratin e vdekjes i porositi shokët e vet që mos të heqin dorë nga rruga e vet misionariste në Mallabar. Që t'i ndihmojë në punën e tyre, iu dhe rekomendime të shkruara për ndihmuesit e tij në të cilat më së ngrohti i preferon.

Njëkohësisht i luti shokët e tij që ta fshehin të vërtetën mbi vdekjen e tij.

I furnizuar me këto shkresa, Sherif b. Maliku dhe shokët e tij lundruan drejt Kranganorit, ku shkresat e mbretit iu siguruan pritje të mirë dhe dhurimin e trollit në të cilën e ndërtuan xhaminë.

Malik b. Dinari vendosi që të mbetet aty, kurse Malik b. Habibi u nis më tej me qëllim që më tej ta përhapë islamin dhe të ndërtojë xhamia në të gjitha territoret e Malabarit.

Kështu Malik b. Habibi doli në Kuilon me pasurinë e vet, gruan dhe disa fëmijë dhe atje e ndërtoi xhaminë. Pasi që e la gruan aty, shkoi në Hili Maravi,36) ku e ndërtoi xhaminë. Tregimi vazhdohet më tej dhe i cek emrat e shtatë vendeve tjera në të cilat ky misionar i ka ndërtuar xhamitë. Në fund u kthye në Kranganor.

245

Diç më vonë ai sërish i ka vizituar këto vende që në secilin ta fali namazin dhe të kthehet në vendlindje duke iu falënderuar Zotit dhe duke e madhëruar atë për paraqitjen e islamit në vendin përplotë pabesimtarë.37)

Nuk ka provë historike për saktësinë e këtij tregimi sa do që karakterizohet me hollësi. Besimi i zgjeruar e vë datën e kësaj ndodhie të regjistruar në kohën në të cilën ka jetuar Pejgamberi.

Me diç dyshim, Zejnuddini mendon se kjo nuk ka mund të ndodh para shekullit të tretë Hixhri.38) Nuk ka këtu asgjë që do të anonte nga njëra datë ose që do ta përkrahte traditën popullore të Mapilvëe mbi ekzistimin e varrit të një mbreti hindu në Zafar në breg të Arabisë, e në të cilin është i gdhendur emri i Abdurrahman es Samirit, i cili erdhi atje më 212, kurse vdiq në vitin 216 Hixhrij.39)

Xhamia në Madaj, për të cilën thuhet se e ka ndërtuar Malik b.

Dinari, mbanë datën e gdhendur memoriale të ndërtimit të vitit 1124.40)

Në realitet, legjenda në vete përmbanë provën e karakterit paqedashës të përkapjes së mësimit islam, që ka vepruar disa shekuj në bregun e Mallabarës.

Njerëzit që janë marrë me këtë punë së pari kanë qenë tregtarë arabë. Mirëpo, Ibn Batuta përmend shumë alimë që profesionalisht merreshin me aftësimin në fe. Kanë ardhur nga Arabia dhe vendet tjera. I ka takuar në qytetet në bregun e Mallabarës.41)

Zamarimi nga Kalkuta, që ka qenë ndihmuesi kryesor i tregtisë arabe në Kalkutë, i ka nxitur njerëzit në isla në mënyrë që t'i përgatisë anijet arabe në të cilat është mbështetur në zmadhimin e fuqisë së vet. Thuhet se ka urdhëruar që në çdo familje peshkatore në vendin e vet të jetë një ose më shumë anëtarë meshkuj të edukuar në frymën e islamit.42)

Në fillim të shekullit XVI Mapilët kanë përbërë 1/5 e popullsisë së Mallabarit. Kanë folur me gjuhën e njëjtë sikur Hindusët dhe prej tyre janë dalluar vetëm me mjekrat e gjata dhe me kapela të veçanta. Kur arritën Portugezët, ka pasur mundësi që tërë popullësia e këtij bregu të kalojë në islam. numër mjaft i madh i njerëzve ka konvertuar

për shkak të ndikimit të madh që e kanë pasur tregtarët muslimanë, që kanë arritur nga pjesët tjera të Indisë, siç janë Guxharati dhe Dekani, dhe nga Arabia dhe Persia.43)

Duket se nuk ka lajme të regjistruara për personat që kanë marrë pjesë në propagandimin e islamit pos asaj që e përmend historiani 246

Abdurrezaku, i cili e la përshkrimin e misionit të tij të pasuksesshëm në pallatin e mbretit Zamarin në Kalkut.

Ai që dërguar në këtë mision në vitin 1441 nga ana e Timuridëve Shah Ruh Bahadurit me ftesë të një ambasadori, të cilin Zamorini nga Kalkuta i ka dërguar këtij sunduesi. Ambasadori ka qenë musliman.

Ky ambasador sulltanit ia ka prezentuar çështjen ashtu që dërgimi i një delegacioni Zamorinit do të paraqiste rëndësi dhe nder të veçant.

Ka kërkuar që ta ftojë Zamorinin në islam në pajtim me urdhërin e Zotit: "Fto në rrugën e Krijuesit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë"44) hapja zemrën të mbyllur me errësirë dhe mashtrim, dhe lejo që rrezet e dritës së fesë dhe shkëndijat e dritës së diellit të hyjnë në dritaren e shpirtit të tij."

Abdurrezaku që zgjedhur për këtë detyrë. Pas udhëtimit, të lidhur me rreziqet, ka arritur në Kalkutë. Duket se është pranuar ftohtë. Pasi që i kaloi gjashtë muaj, hoqi dorë nga qëllimet kryesore. është kthyer në Harasan pas mungesës prej tri vjetëve.45)

Bashkësia tjetër muslimane në Indinë jugore janë ravuttansi.

Kalimi i tyre në islam lidhet me mësimin dhe punën e grupit të misionarëve varret e të cilit nderohen deri më sot.

ë i njohuri ndër ta ka qenë Seyyid Nasr Shahi46) (969 - 1039). Ai, pas udhëtimeve të gjata në vendet arabe, Persi dhe Indinë veriore, u ndalë në Trishnapli, ku e kaloi pjesën e mbetur të jetës së vet, në devotshmëri (ibadet) dhe bërjen e veprave të mira. Numrin e madh të Hindusëve e ka kaluar në islam.

Shumë njerëz e vizitojnë dhe e pelegrinojnë varrin e tij.

Muslimanët Trishnaplin e quanin Nasarnagov, sipas emrit të këtij evliu (dobrog).47)

Sejjid Ibrahim Shehidi (konsiderohet se është lindur në gjysmën e shekullit XII), varri i të cilit është në bregun e lumit Ervadi, ka qenë luftëtar. ka udhëhequr ekspeditën luftarake në mbretërinë Pandyan. Këtë vend e ka pushtuar gjatë dymbëdhjetë vjetëve që në fund të vdesë.

Jetën e djalit të tij e kanë shpëtuar për shkak të konsideratës së qeverisjes së mirë të babait të tij. I kanë dhuruar edhe tokë, të cilën trashëgimtarët e tij e kënaqin edhe sot.

I fundit nga këta evlija ka qenë Shah el-Hamidi (1532-1600).

Është lindur në Monikpur në indinë veriore. Pjesën më të madhe të jetës e ka kaluar në vizitat vendeve të shenjta islame dhe udhëtimeve 247

misionariste, veçan në viset e Indisë jugore. Në fund u ndalë në Nagorë, ku ende pasardhësit e birit adoptiv të tij e mbikqyrin varrin e tij.48)

Gjudekulët janë grupi i dytë i muslimanëve në Indinë jugore.

Jetojnë nga pastrimi i pambukut (në çka edhe emri iu dëfton) dhe endjes së shtofit të vrazhdë. Kalimin e vet në islam ia atribuojnë Baba Fahrudinit, varin e të cilit e respektojnë në Penukond.

Legjenda thotë se Baba Fahrudini në realitet ka qenë mbret i Sistanit. Ka abdikuar në dobi të vëllaut dhe u bë lypsë - i devotshëm. Pas haxhit të kryer dhe vizitës Mekkes dhe Medines, pejgamberi, në ëndërr, i ka urdhëruar të shkojë në Indi. Këtu ai e ka takuar Nasarshahin nga Trishinopli. është bërë ithtar dhe nxënës i tij. Është dërguar në shoqëri të 200 lypsave të devotshëm me detyrë që ta përhapin mësimin fetar.

Legjenda vazhdon më tej dhe thotë se në fund janë ndalë në Penukond në afërsi të tempullit hindu.

Raxha i këtij visi nuk ka qenë i kënaqur me qëndrimin e tyre këtu. Por ai, në vend që ta përdorë fuqinë, ka kryer disa prova që të mësojë se a ka shenjtëri më të mirë veliu musliman apo kleriku i tij që ta posedojë tempullin.

Si provë e fundit ka qenë urdhëresa që të dytë të lidhen në thasë plotë gëlqere dhe të hedhen në baseu të ujit. Kleriku hindus është fundosur dhe nuk është paraqitur, por BAba Fahrudini ka dëftuar superioritetin e fesë së vet. Me çudi mbi natyrore është vendosur në bregore jashtë qytetit.

Pastaj raxha ka kaluar në islam, kurse sipas shembullit të tij kanë shkuar edhe banorët e viseve fqinje, deri sa tempulli është sndërruar në xhami.45)

Kalimet nga hinduizmi në islam kanë qenë aq të shumta sa tendenca e muslimanëve të bregut perëndimor sikur edhe lindor të Indisë jugore ka qenë fitimi i vulës nacionale hindu apo antoktone. Duke i përjashtuar rastet e disa familjeve fisnike, shuica e konvertitëve të rinj paraqesin të gjitha karakteristikat e autoktonëve me shumë pak gjak të vjetër të huaj që rrjedh te ata.52)

Në territorin e bregut perëndimor tirania e jotolerancës kastike e ka qenë jashtëzakonisht e padurueshme. Ta japi një shembull.

248

Në Travenkaru nuk i lejohet askujt nga kasta më e ulët që t'i afrohet brahmanit më tepër se 70 hapa. Ata lëshojnë zëra të vrazhdë kur ecin rrugës, në mënyrë që të tërheqin vërejtjen në afërsinë e vet. Ka shumë shembuj të këtillë që e konfirmojnë sahtësinë e këtij theksim.

Nuk është për t'u çuditur që numri i banorëve muslimanë rritej shpejtë për shkak të hyrjes në islam të njerëzve nga shtresat e ulta, që në këtë mënyrë lirohen nga dhuna që i nënçmon. Me kalimin në islam

ata e ngrisin pozitën e vet në shoqëri sikur edhe nivelin shoqëror të pasardhësve të vet.

Në fakt, Mapilanët e bregut perëndimor numerikisht janë rritur për shkak të kalimit në islam të shtresave të ulta hindu. Është bërë e mundshme që edhe të gjitha shtreset e ulta të popullit, që e banojnë bregun perëndimor, për disa vjet të bëhen muslimanë.⁵³⁾

Islami në ujdhesat Lakadi dhe Maldivi

Më se e sigurt është që islami nga Mallabara ka kaluar në ujdhesat Lakadiv dhe maldive (në gjirin e Bengalit), ku popullata është muslimane.

Banorët e këtyre ujdhesave për islamin e vet iu kanë borgj regtarëve arabë që janë vendosur në këto vite. Ato me martesë janë miqësuar me popullatën lokale dhe në këtë mënyrë e kanë përgatitur rrugën për punë në përhapjen e fesë.

Konsiderohet se koha e kalimit në islam të sunduesit të parë musliman të Maldivit Ahmed Shanrazit⁵⁴⁾ ka qenë rreth vitit 1200. Mund të supozohet se tregtarët muslimanë fenë e vet në Ujdhesë e kanë futur para asaj kohe nja tre shekuj. Procesi i konvertimit, pa dyshim, është zhvilluar suksesivisht.⁵⁵⁾ Hollësitë për këtë nuk kanë arritur deri te ne.

Në selinë e qeverisë se Maks gjendet varri i shejh Jusuf Shemsuddinit, me prejardhje nga Tibrizi në Iran. Për të thuhet se ka qenë misionar i suksesshëm i islamit në këto ujdhesa. Bota ende ia respekton dhe rregullon tyrben. Në pjesën e njëjtë të ujdhesës janë varrosur edhe disa bashkëqytetarë të tij që kanë ardhur ta kërkojnë, dhe kanë mbetur në ujdhesat maldive deri në vdekje.⁵⁶⁾

249

Hyrja në islam e ujdhesave fqinje lakadivase i atribuohet një propaganduesi arab të njohur te banorët e ujdhesës me emrin Pir Mohabir Hamdajet. Varri ende i shihet në Androt.

Duke e marrë parasysh që gjyktari (kadiu) i tanishëm mlokal pohon se ai është pasardhësi i njëzet e gjashtë i këtij misionari, është për të supozuar se ai ka arritur në këto ujdhesa në shekullin e XII.⁵⁷⁾

Islami në Dekan

Dekani po ashtu ka qenë fushë e suksesshme e punës së shumë misionarëve muslimanë. Tashmë kemi dhënë shenjë se tregtarët arabë shumë më herët i kanë vizituar qytetet në bregun perëndimor.

Kemi thënë se në shek. X Arabët janë stabilizuar në numër më të madh në qytetet e Konkonës. Ata janë martuar me femrat lokale dhe kanë jetuar sipas të drejtës dhe fesë vetjake.⁵⁸⁾

Nën sundimin e dinastive muslimane të Bahmanive (1347-1490) dhe Bixhapur-sunduesve (1489-1686) i është dhënë impuls i ri migracionit arab. Me tregtarët dhe ushtarët e pasanikëve kanë ardhur misionaret që të kryejnë pushtimet shpirtërore në llogari të islamit dhe përvetësimit të popujve që nuk besojnë në ato vise. Kanë ftuar në

islam dhe kanë kërkuar që në këtë t'i ndjekin.

Nuk kemi të dhëna të shkruara për rastet e konvertimeve të detyrueshme në islam në kohën e sundimit të dinastive të hershme të Dekanit, sundimi i të cilëve karakterizohet me tolerancë të madhe fetare.59)

Një nga thirrësit arab në fe (da'i), Pir Mahabir Hamdajeti,8) si misionar erdhi në Dekan në vitin 1304 të hershëm.

Ndër kbasët e kultivuara të Bixhapurëve gjenden pasardhësit e Gjainëve, të cilët nëpërmjet tij kanë konvertuar.60)

Në fund të atij shekulli evlijan i njohur Gulbargu8) Sejjid Muhammed Xhisudaraz61) e ka kthyer në islam një numër të Hindusëve të krahinës Puna. Njëzet vjet më vonë puna i qe kurorëzuar me suksese të ngjashme në regjionin e Belgonit.62)

Në Dahan ende qëndrojnë pasardhësit e kushërinjve të njërit prej evlijave më të mëdhenj në islam, Abdulkadir Gejlanit nga Bagdadit.

Në Indinë perëndimore ka ardhur rreth shekullit XV pasi që i ka kthyer në islam shumë banorë të Konkonës. Ka vdekur dhe është varrosur në Dahan.63)

250

Në krahinën Dohvarer ekziston numër i madh endësish të parët e të cilëve kanë kaluar në islam nëpërmjet Hashim Pir Guxharatit, i cili ka qenë mësuesi shpirtëror i mbretit bixhapuras Ibrahim Adilpasha II, në fund të shekullit XVI.

Njerëzit ende e respektojnë këtë evlija duke i bërë respekt të madh e meritues atij dhe pasardhësve të tij.64)

Pasardhësit e një evlijan tjetër, Shah Muhammed Parmost Husejnit, ende gjenden në Nasik.*) Thuhet se ai është njëri prej misionarëve më të suksesshëm mmuslimanë.

Pas kthimit në Medine në vitin 1568 ka kaluar pjesën më të madhe të Indisë dhe në fund u ndalë në Nasik. Në këtë vis një misionar tjetër i suksesshëm mmusliman, havaxhe Humir Husejn, e ka filluar punën e vet nga pesëdhjetë vjet më herët.65)

Këtu janë edhe dy misionarë tjerë arabë në të cilët duhet dëftuar.

Terreni i veprimit të tyre fetar është krahina Belgam. Njëri është quajtur Sejjid Muhammed b. Sejjid Aliu, kurse tjetri Sejjid Omer Ajdrus Bishbani.66)

Rrethina e qytetit Multani

Për lëvizjen tjetër misionariste përafërsisht mund të thuhet se qendra ka qenë rreth qytetit Multana.67) Ai, në ditët e para të pushtimit arab, ka qenë pika e zgjatur e islamit kur Muhammed b. Kasimi e futi pushtetin islam në Sind (714 v.).

Ka qenë e natyrshme që gjatë tre shekujve të sundimit arab shumica të hyjnë në fenë e pushtuesit.

Disa princa sindus iu përgjigjen ftesës së halifit Omer b.

Abdularizit që ta pranojnë islamin.68) Populli i Savandarit i është

nënshtuar Muhammed b. Kasimit. Ai ua ka dhuruar paqën me kusht t'i mbështesin muslimanët dhe t'i furnizojnë me udhëheqës që t'i mësojnë viset e tyre. Si thotë Balazuri (i cili shkruan 100 vjet më vonë), islami është përforcuar në mesin e tyre qysh gjatë kohës së tij. Shpesh raportet zyrtare, që i dërgojnë pushtuesit, referojnë për kalimin e jomuslimanëve në islam.

Që këto konversione në bazë kanë qenë vullnetare mund të gjykohet në bazë të tolerancës së Arabëve që ata e kanë dëftuar ndaj shtetasve të vet idhujtarë në pushtimet e para, që shquheshin me rreptësinë e caktuar.

251

Për shembull, popullit të Brahmanabadit, qyteti i të cilëve me forcë është pushtuar, i qe lejuar ta restaurojnë tempullin e vet, i cili ka qenë burim i furnizimit të brahmëve (klerikëve). Askujt nuk i qe e ndaluar që ta vazhdojë manifestimin dhe zbatimin e dispozitave të veta fetare.⁶⁹⁾

Marrë përgjithësisht, pushtuesit nuk kanë caktuar kuart të veçant për pjesëtarët e feve tjera ku kanë hasur në paqë dhe dëgjueshmëri. I kanë lejuar popullit që ta shpreh besimin e vet dhe dispozitat e tij.

Në Sind

Në kohën e vështirësive nëpër të cilat ka kaluar hilafeti në gjysmën e dytë të shekullit IX pushteti qendror e ka mospërfilluar Sindin, i cili ka qenë i ndarë ndërmjet disa princave të vegjël, në mesin e të cilëve më influencues kanë qenë emirët e Multanit dhe Mansurit.

Ky copëtim, normalisht, e ka dobësuar fuqinë politike të muslimanëve, dobësimi i të cilëve, në fakt, ka filluar shumë më herët në atë shekull.

Fjatë sundimit të El-Mu'tasamit (833-842) Hindusët e Sindit e kanë shpallur mëvetësinë e vet, por i kanë lënë xhamitë në të cilat muslimanët kanë vazhduar pa pengesa t'i kryejnë ritualet e veta.⁷¹⁾

Muslimanët e Multanit kanë arritur ta ruajnë pavarësinë e vet politike dhe të mbahen para pushtimeve të princave fqinjësor hindusë me kërcënim që, nëse i shulmojnë, do ta rrënojnë idolin i cili qe respektuar dhe pelegrinuar veçan nga të gjithë Hindusët, dhe edhe nga viset më të largëta.⁷²⁾

Por, në momentin kur muslimanët përjetojnë dekadencën politike, islami edhe më tej vazhdon me sukseset e veta misionariste.

El-Baladhuri⁷³⁾ sjell tregimin vijues për kalimin në islam të mbretit të Usfanit, krahinës që gjendet ndërmjet Kashmirit, ultanit dhe Kabulit.

Banorët e këtij visi e kanë adhuruar këtë idol në të cilin e kanë bërë një tempull. Djali i mbretit u sëmure, dhe janë ftuar klerikët e këtij tempulli dhe u është thënë që ta lusin idolin që t'i shërohet djali. Shkuan dhe pas pak u kthyen dhe thanë: "Ne jemi lutur dhe lutjet tona idoli i ka pranuar." Nuk kaloi gjatë kohë dhe djaloshi vdiq. Atëherë

mbreti e sulmoi tempullin e rrënoi dhe në copa e theu idolin, kurse klerikët e mbyti.

252

Pas kësaj i ftoi disa tregtarë muslimanë, të cilët e njoftuan me njësinë e Zotit, që ai e deklaroi dhe u bë musliman.

Aksione të ngjashme misionariste kanë ndërmarrë shumë bashkësi muslimane tregtare, që me vete kanë bartur edhe fenë e vet në qytetë pagane të Hindustanit.

Gjeografët arabë në shekullin e X dhe XI i përmendin emrat e shumë qyteteve të këtilla, në breg ose në brendi, ku muslimanët i kanë ngritur xhamitë. Kanë qenë të sigurtë nën mbrojtjen e princave lokalë që u kanë garantuar të drejtën e jetës në pajti me ligjet e veta.⁷⁴)

Në atë kohë tregtarët arabë kanë qenë ndërmjetësues në tregti ndërmjet Sindit dhe krahinave fqinje induse dhe botës së jashtme. Kanë sjellur prodhimet e Kinës dhe Cejlonit në limanet e Sindit, prej kah janë transportuar nëpërmjet Mulltanit për Turkestan dhe Horasan.⁷⁵)

Është e çuditshme që tregtarët tjerë, të shpërndarë nëpër shumë qytete të pabesimtarëve, nuk arrijnë ta tregojnë zjarrin e tillë fetar siç e vërejmë se e ka tregtari musliman në cilindo vend.

Është më se e sigurtë se nën ndikimin e shoqërive të këtilla tregtare ka rrjedhur konvertimi i dinastisë sammas, që ka sunduar me Sindin prej vitit 1351 deri 1521.

Qeveria e Nanda b. Babinijje nga kjo dinasti dallohet veçan si një prej "të qetave dhe të sigurtave ashtu që ky sundues nuk ka pasur nevojë të zhvillojë luftë, as që armiku i erdhi në fushëbetejë."⁷⁶)

Njëkohësisht, ai përshkruhet si personalitet i njohur me drejtësinë e vet dhe kalimit të shumë njerëzve në islam në kohën e tij.

Këto kalime në islam kanë mundur të dalin vetëm me metoda të qeta.

Një prej këtyre misionarëve më të njohur ka qenë evlijau i njohur Seyyid Jusufuddini, pasardhësi i Abdulkadir Gejlaniut. Atij i është urdhëruar në gjumë që ta lëshojë Bagdadin, të niset për Indi dhe ta kthejë popullatën e saj në islam.

Ka arritur në Sind në vitin 1422. Pas punës misionariste prej dhjetë vitesh ka arritur t'i kthejë në islam 700 familje të Lohanit, të një kaste. Ata kanë ndjekur shembullin e dy anëtarëve të vet me emrin sundragji dhe Hansragj. Këta të dytë u kthyen në islam pasi i panë disa çudi (keramete) të këtij evlijau.

Pas konvertimit i pari është quajtur Ademgji, kurse i dyti Taxh Muhammed. Kjo popullësi, nën udhëheqjen e të parit të vet të parë, u

253

shpërngul në Kuç, ku numri u është rritë konvertitëve nga familjet e Lokanit në Kuç.⁷⁷)

Sindi ka qenë fushë e veprimit të Pir Sadruddinit, njërit nga

misionarët ismailit. E ka udhëhequr hoxha-sektin rreth vitit 1430. Sipas principeve të rëndomta të adaptimit të mësimit të këtij sektit mesimeve tjera. Sadruddini ka marrë edhe emër hindu. Është pajtuar me marrjen e mësimit të caktuar fetar të Hindusëve, të cilët është përpjekur t'i kthejë në islam. Në mesin e tyre e futi librin të quajtur Dasavtar, në të cilin Aliu (b. Ebi Talibi, N.I.) është konsideruar për Avtar të dhjetë ose për Vishnë të inkarnuar. Ky libër që nga fillimi është bërë libër i shenjtë të hoxha-sektit. E lexojnë gjithnjë pranë shtratit të të vdekurit dhe në rastet e kohëpaskohshme festive. Ky libër ka marrë që nën inkarnime të Vishnes janë të sakta sipas mësimit të ithtarëve të saj, por i mungon e vërteta e plotë dhe plotësohet mungesa e sistemit Vishna me mësimin kryesor ismailit, kurse kjo është inkarnimi dhe shfaqja e Aliut.

Ky misionar ka komentuar se Brahma është Muhammedi, Vishna Aliu, kurse Ademi Shiva.

të parët që Pir Sadruddini i ka kthyer në këtë fe kanë qenë banorët e fshatrave dhe qyteteve të sindit të epërm. Ai ka ftuar edhe në Kuç. Nga këto sekte mësimi i këtij sektit është përhapur në jug, nëpërmjet Guxhuratit, deri në Bombaj. Sot bashkësitë-hoxha mund të gjenden pothuaj në të gjitha qytetet e mëdha tregtare të Indisë perëndimore dhe bregut të oqeanit Indus.78)

Pir Sadruddini nuk ka qenë misionari i parë ismailit që ka ardhur në Indi. Para tij ka qenë Abdullahu, misionari i dërguar nga Jemeni rreth vitit 1067. Fliet se ka qenë me arsimim të gjërë. Bota ka besuar se ka shumë çudira (keramete). Për këtë shkak, me besimin e vet të singertë, e ka kthyer një numër të madh të Hindusëve.79)

Misionari tjetër ismailit, Nuruddini, rëndo mi njohur me emrin e vet hindus Nur Satagar, që dërguar në Indi nga Alamuti, kështjellës së udhëheqësit kryesor ismailit. Ka arritur në Guxhurat gjatë sundimit të sunduesit indus Sidha Ragja (1094-1143).80)

Ka marrë emrin indus, por muslimanëve u ka thënë se emrin e vërtetë e ka Seyyid Sa'adat. Për të thuhet se i ka konvertuar Kaubet, Harveset dhe Koriset, fiset e kastave të ulta të Guxhuratit.81)

Sikur që Nur Satagari është vlerësuar si misionari i parë i hoxhëve, ashtu disa besojnë se Abdullahu është themelues e sektit bohra, një

254
grupi të madh dhe të rëndësishëm shiit me prejardhje induse i cili në numër të rëndësishëm zënë pozitë kryesore tregtare në pushtet në Bombaj.

i lidhin për Mulla Aliun, për metodat e thirrjes në fe të të cilit në mënyrën vijuese flet një historian shiit: "Pasi që populli i Guxhuratit ato ditë ka qenë pagan dhe për udhëheqës fetar e ka marrë një plak, mësimi të të cilit verbërisht i janë nënshtruar. Mulla Aliu nuk ka parë zgjidhje tjetër pos t'i shkojë këtij plaku dhe të kërkojë t'i bëhet nxënës. Me këtë ka synuar t'ia ekspozojë argumentet e veta dhe

provat e qarta dhe ta kthejë në islam, e pas kësaj do t'i konvertonte edhe ithtarët tjerë të tij.

Disa vjet Mulla Aliu i ka kaluar në shërbim të këtij plaku, e mësoi gjuhën e popullit të këtij vendi, i ka lexuar librat e tyre dhe i njoftoi dituritë e tyre.

Suksesivisht ka arritur t'i ofrojë mendjes së iluminuar të plakut të vërtetën e mësimin islam dhe ta bind që kalojë në islam. Pas pranimit në islam disa nxënës të tij kanë ndjekur shembullin e tij.

Në fund njëri nga ministrat kryesor të mbretit të atij vendi ka mësuar për rastin e kalimit të plakut në islam dhe erdhi deri tek ai që të bindet në këtë. Nuk u dashtë pak dhe ai iu dorëzua udhëheqjes së tij shpirtërore dhe, sikur edhe ai, u bë musliman. Gjatë kohë plakut, ministri dhe të tjerët që e kanë pranuar këtë fe, e kanë fshehur islamin e tyre, duke u frikësuar që për konversionin e tyre të mos dëgjoji mbreti.

Në fund mbreti ka qenë i njoftuar për kalimin e ministrit në islam dhe ka dëshiruar ta verifikojë këtë lajm.

Një ditë mbreti, pa paralajmërim paraprak, ka hyrë në shtëpi të këtij ministri. E gjeti në namaz, me kokë të përlurur, që e zemëroi.

Ministri e ka ditur çfarë është qëllimi i kësaj vizite. Ka qenë i bindur se mllëfi i mbretit do të sulet mbi të për shkak të dyshimit të nxitur me namazin, ruku'in dhe sexhden e tij. Mirëpo, providenca dhe ndihma e Zotit i ndihmuan, si i përgjigjej rastit konkret.

I tha mbretit se këto lëvizje i ka bërë sepse në kënd të dhomës e ka parë gjarpërin. Kur mbreti u kthye kah këndi i dhomës, me vullnetin e zotit në kënd vërtet e pa gjarpërin, e pranoi arsyetimin e ministrit dhe u lirua nga çdo dyshim.

255

Në fund edhe mbreti fshehtas u bë musliman, këtë konvertim, për shkaqe shtetërore, e ka fshehur. Kur iu afrua vdekja, ka porositur që trupi mos t'i digjet, siç ka qenë tradita e paganëve.

menjëherë pas vdekjes së tij sulltan Zaferi, një nga fisnikët e afërt të sulltan Finuz-shahut, të trebës së Delhit, e ka pushtuar Guxhuratin.

Disa autoritete sunite, që i ka pasur në shoqëri, i kanë dëshmuar që ky popull do të duhej bashkuar drejtimit sunnit të islamit. Kështu i gjejmë disa bohra si sunnitë, por shumica i përket fesë së vet të parë.⁸²⁾

Disa grupe më të vogla muslimane në Kuç dhe Guxhurat e lidhin kalimin e vet në islam për Iman-shahun nga Pirana,⁸³⁾ i cili ka qenë mjaft i angazhuar në punën e vet misionariste gjatë pjesës së dytë të shekullit XV.

Flitet se është konvertuar në islam numër i madh bujqish të Hindusëve në atë mënyrë që ka lutur për shi, që ka ra pas dy viteve të njëpasnjëshme të thata.

Me një rast tejtër ka ndodhur që ta takojë grupin e Hindusëve pelegrinë që kanë kaluar nëpër Pirane në rrugën e vet për Benares. Iu

ka propozuar që t'i dërgojë atje, dhe pranuan. Në atë moment u gjetën në qytetin e shenjtë, ku janë larë në lumin Ganges dhe e plotësuan zotimin e vet. Pastaj u vetëdijësuan dhe e gjetën veten ende në Piranë. Atëherë e pranuan fenë e këtij evlijan, që mund ta bëjë kerametin e këtillë.

Vdiç në vitin 1512. Varrin në Piranë ende e ka vend i pelegrinit të Hindusëve sikur edhe uslimanëve.84)

Shumë muslimanë të Kuçit, që janë me prejardhje hinduse, e lavdojnë si lider të vetin shpirtëror Dawala Shah-Pirin, emri i vërtetë i të cilit Malik Abdul-latif.85) Është i biri bujarit Mahmud Bigarit (1459-1511), sunduesit të njohur të dinastisë muslimane të Guxhuratit. Nga koha e tij daton tregimi i njohur për rkalimin në islam të shumë Hindusëve.86)

Në Bengal

Suksesi i misionarëve muslimanë në Indi sipas numrit të konvertitëve në islam ka qenë më i mirë në Bengal.

Shteti i parë islam këtu është themeluar kah fundi i shekullit XII.

Themelues është Muhammed Bahtijar Hilxhi, që e pushtoi Biharin dhe Bengalin, kurse Gusin e ka bërë kryeqendër të provincës së fundit.

256

Ka qenë e natyrshme që vazhdimësia e gjatë të sundimit musliman t'i ndihmojë përhapjes së islamit. Pushteti hindus sërish është vendosur dhjetë vjet nëpërmjet Kans-raxhës tolerant, sundimi i të cilit ka qenë i popullarizuar edhe te shtetasit muslimanë,87) por, megjithatë, djali i tij Xhatmali ka refuzuar hinduizmin dhe u bë musliman.

Pas vdekjes së babait në vitin 1414 i ka ftuar të gjithë nëpunësit shtetëror dhe iu ka shpallur se dëshiron ta pranojë islamin sikur edhe atë që, nëse nëpunësit e lartë shtetëror për këtë shkak nuk i lejojnë ardhjen në fron, është i gatshëm të abdikojë në emër të vëllaut.

Nëpunësit e kanë pranuar për mbret pa marrë parasysh cilën fe ta pranojë. Pastaj i ka ftuar alimët e lartë islamë që të dëshmojnë se raxha e ka lëshuar hinduizmin dhe publikisht e ka pranuar islamin.

Për vete e mori emrin Xhemaluddin Muhammed Shah. Sipas traditës, gjatë sundimit të tij kanë ndodhur shumë konvertime në islam.88) Shumë prej tyre kanë qenë të lidhur për forcën. Me fjalë tjera, vetëm sundimi i tij, prej pesë shekuj e gjymë të pushtetit muslimanë në Bengal lindor, shquhet me atë që nuk është shënuar asnjë rast i presionit në shtetasit hindusë.

Konversioni i detyrueshëm, megjithatë, në periodat tjera të sundimit muslimanë ka ndodhur.

Raxhët e Haragpurit kanë qenë Hindusë me prejardhje, pastaj e kanë pranuar islamin, sepse njëri prej komandantëve të Ekberit, kur i ka pushtuar viset e tyre, kanë lejuar se mund t'i mbajnë feudet familjare nëse e pranojnë islamin.

Stërgjyshi hindus i familjes së Esad Ali-kanit në Çitagong8) ka

qenë ekskomunikuar nga kosta e vet me atë që ka qenë i detyruar t'i merrë erë mishit të lopës. Ka qenë i detyruar ta pranojë islamin. Mund të evidentohen edhe disa raste të ngjashme.90)

Murshid Kuli-kani (i biri i brahmës së konvertuar) është caktuar për guvernator të Bengalit nga carit Aurongzebit. Në fillim të shekullit XVIII ka dhënë ligjin sipas të cilit çdo / nëpunës ose feudal që nuk e pajton haraxhin e caktuar ose nuk mund t'ia kompenzojë shtetit dëmin e shkaktuar, duhet ta pranojë islamin ai, gruaja dhe fëmijët.

Përveç kësaj, sipas ligjit popullor, nëse ndonjë Hindus bjen nga sekt i vet për shkak të thyerjes së rregullave, ka mundur të rregullohet vetëm me anë të sundimit musliman. Nëse pushteti e refuzonte intervenimin, i refuzuari nuk ka mundur ta kthejë statusin e vet në 257

sistemin shoqëror hindus. Në këtë rast nuk ka pasur dalje tjetër pos të kalojë në islam.91)

Aventurierët afganistanezë, që janë vendosur në këtë provincë, po ashtu kanë qenë aktivë në përhapjen e fesë. Përveç fëmijëve, që i kanë pasur me Hinduset, patën bërë zakon të blejnë një numër të caktuar të djelmohave, në kohët e rënda e të skamjes, dhe t'i mësojnë ata me themelet e islamit.92)

Muslimanët e Bengalit nuk i banojnë, në bashkësi më të mëdha, qendrat e vjetra të sundimit islam, por janë në fshatrat provinciale. Këto janë vise në të cilat nuk gjejmë gjurma të të shpërngulurëve nga perëndimi. i popullëzojnë shtresat e ulta të Hindusëve, sikur edhe renegatët nga shoqëria në numër më të madh.93)

Ngjashmëritë e zakoneve të këtyre kastave hinduse dhe ithtarëve të Pejgamberit dhe veçantisë kastike janë ruajtur sikur edhe ngjashmëritë fizike.

Tërë kjo dëfton dhe bind se muslimanët e Bengalit janë fise autoktone të këtij vendi.

Islami këtu nuk është takuar me sistemin e fuqishëm mfetar që do ta pengonte në rrugën e perparimit, sikur ka qenë rasti me këtë në Indinë veriperëndimore ku pushtuesit muslimanë kanë hasur në brahmanizëm flotë freski e fuqi, pas triumfit të shkëlqyeshëm ndaj budizmit.

Ndikimi i islamit ka ekzistuar edhe përveç persekutimit dhe nxitjes së forcave para rezistencës që i kanë bërë Hinduset, dhe këtë ndikim islami e ka ruajtur ndaj tyre edhe në fatkeqësitë dhe nënçmimet më të rënda.

Në Bengal misionarët muslimanë kanë qenë mirë të pritur nga popullësia lokale dhe nga shtresat e ulta, të cilët vetëm periferisht kanë qenë në hinduizëm. Kanë qenë të nënçmuar dhe të përulur nga sunduesit e vet arianë.

"Këtij populli të mjerë peshkatarësh, gjuetarësh, piratësh, fshatarësh dhe njerëzve të kastave më të ulta islami u ka ardhur si

zbulesë nga Qielli!

Islami ka qenë fe e sundusve, kurse misionarët janë karakterizuar me zjarr fetar. E kanë bartur të vërtetën për njësinë e Zotit dhe mësimin mbi barabarësinë e njerëzve në mesin e popullësisë së përçmuar e të nënçmuar.

258

Idetë që i kanë futur këta misionarë kanë vepruar ashtu që lëshimi i fesë së re të Hindusët ka qenë e pamundur. konvertitin dhe pasardhësit e tij i kanë bërë besimtar të sinqertë përgjithmonë.

Në këtë mënyrë islami është stabilizuar në viset më pjellore dhe më të pasura induse. Këto janë vise që kanë mundur t'i mbulojnë të gjitha nevojat e popullësisë, që shpejtë dhe dendur rritej.

Konversioni i detyrueshëm herë herë është regjistruar. Suksesi i përhershëm, që islami e realizoi në Bengal in e poshtëm, nuk ka qenë pasojë e detyrimit. I është drejtuar popullit dhe pjesa më e madhe e konvertitëve ka qenë nga shtresat e varfëra.

Islami iu solli koncepton më të përkryer, ide më të mirë e më fisnike të vëllezërisë njerëzore. Ai u ka ofruar kastave të shumta të ulta të Bengalit, të cilët gjatë gjeneratave kanë qenë të nënçmuar dhe larg jashtë kufinjve të shoqërisë hindu, hyrje të lirë në organizatën e re shoqërore."94)

Angazhimi dhe zelli në punën misionariste në Bengal, për të cilin flitet, i konfirmojnë edhe disa legjenda që dëshmojnë për zjarrin fetar të disa personave në fenë e vet. Turbet e disa këtyre misionarëve ende janë vende vizitash të qindra pelegrinëve.95)

Në mesin e më të vjetërve prej këtyre misionarëve është Shejh Xhelaluddin Tibrizi, që ka vdekur në vitin 1244. Ai ka qenë nxënës i evlijasë së madh Shihabuddin Suhreverdit. Në udhëtimet e veta misionariste e ka vizituar edhe Bengal in, kur për nder të tij është ndërtuar tyrbe dhe i është shtuar pasuri e pasur e lënë me testament. Vendi i vërtetë i varrit të tij në realitet është i panjohur. Atij i përshkruhen shumë keramete (vepra të mbinatyrshe). Në mesin e atyre është edhe kjo që me një shikim e ka kthyer në islam një prodhues qumshti.

Në shekullin XIX ka qenë i dalluar aktiviteti i propagandës islame në Bengal. Disa grupe, që kanë qenë nën ndikimin e lëvizjes reformatoriste vehabite, i kanë dërguar misionaret e vet. Ata kanë udhëtuar nëpër këtë provincë dhe e kanë pastruar nga të mbeturat e besimit hindu. E kanë zgjuar zjarrin fetar dhe e kanë përhapur besimin islam në mesin e pabesimtarëve.97)

Islami në viset tjera të Indisë

Kanë mbetur ende disa informata për misionarët muslimanë që kanë vepruar në pjesët tjera deri tash të papërmendura të Indisë. Nuk është e parëndësishme të shtrohen këtu.

259

Një prej më të hershmëve në mesin e tyre ka qenë Shejh Ismaili. Ka qenë sejjid i njohur i Buharës, me arsimim mjaft të gjerë fetar dhe botëror. Transmetohet se ka qenë misionari i parë musliman që ka ftuar në sial mnë qytetin Lahare, në të cilin arriti në vitin 1005. Shumënjerëz kanë ardhur që t'i dëggojnë ligjëratat e tij. numri i të konvertuarëve në islam nga dita në ditë është rritur. Thuhet se nuk ka pasur pabesimtar që me të personalisht ka kontaktuar e që nuk ka kaluar në islam.98)

Për konvertizë në isla mtë popullatës të fushëgropave perëndimore të Penxhabit thuhet se është kryer me punë misionariste të Behanlhakk el-Multanit99) dhe Baba Feriduddin Pakpatanit. Puna u ka lulëzuar kah fundi i shekullit XIII dhe në fillim të shekullit XIV.100)

Biografi i këtij evlijau të fundit sjell regjistrin e emrave të 60 fiseve të përvetësuarra për islam me thirrjen e tij, por, fatkeqësisht, autori nuk na jep asnjë hollësi nga kjo punë në konvertizëm.101)

Një nga evlijatë më të njohur muslimanë të Indisë dhe pionieri i islait në Raxhputan ka qenë Hoxha Mu'inuddin çishti, që ka vdekur në Axhmir në vitin 1234. Ka qenë banor i Sixhistanit në Persinë lindore. Transmetohet se ka marrë ftesën që ta përhapë islamin në mesin e banorëve të Indisë deri sa ka qenë në rrugë për Medine në kohën e kryerjes së haxhit.

Aty Pejgamberi iu ka dëftuar në gjum dhe iu drejtua me fjalët: "All-llahu i madhëruar ty t'i ka besuar tokat e Indisë. Shko dhe vendos në Axhmir. Me ndihmën e Zotit feja islame me devotshmërinë tënde dhe me devotshmërinë e atyre që do të ndjekin do të përhapet në atë vend."

Iu përgjegj thirrjes dhe ka kaluar rrugën deri në Axhmmir, i cili atëherë ka qenë nën sundimin hindus. Idhujtaria ka dominuar me tërë vendin.

Ndër konvertitët e parë këtu ka qenë Jogi, mësuesi shpirtëra i vetë raxhës.

Shkallërisht ky njeri rreth vetes ka tubuar numër të madh nxënësish, dhe mësimi i tij i ka ndarë nga radhët e mosbesimit. Nami i tij i liderit fetar është përhapur dhe ka tërhequr në Axhmir numër të madh Hindusësh, që ai i ka nxitur që ta pranojnë islamin.102)

Thuhet se në rrugën e vet në Axhmin në islam ka kthyer afër 700 persona nga qyteti Delhi.

260

Ardhja e Seyyid Xhelaluddinit në vend ka qenë me rëndësi të madhe për historinë i islamit në Indi. Thuhet se është i lindur në Buharë në vitin 1199. Është stabilizuar në vitin 1244 në Uçë, në territorin e Bahavalpurit*) të sotshëm dhe ka kthyer në islam numër të madh personash nga fqinjësia. Ka vdekur në vitin 1291. Te pasardhësit e tij, në mesin e të cilëve ka edhe shumë evlija, shikohet me respekt dhe nderim sikur në rojtarët e tyrbes së tij deri në ditët

tona. Këtë vend e kanë marrë për qendër të ndikimit të gjerë fetar. Nipit të tij Sejjid Ahmed Kebirit, të njohur si Mahdumi Xhihanijan, i atribuohet sukses i konvertimit të disa fiseve në islam në Penxhab.103)

Në largësinë prej 1000 milave gjendet tyrbeja e Hasan Kebiruddinit, djalit të Sejjid Fakruddinit, që ka qenë bashkëkohës i Xhelaluddinit.

Babai dhe i biri, si thonë, kanë futur në islam shumë njerëz.

Ndikimi që i përshkruhet Hasan Kebiruddinit ka qenë i atillë që çdo Hindus do të kalonte në islam sikur ky evlija vetëm ta shikonte.104)

Para fundit të shekullit të njëjtë një banor i Irakut persik, i quajtur Ebu Ali Kalandar, ka ardhur në indi dhe u vendos në Pamipat,*) ku edhe vdiq në vitin 1324 në pleqërinë e thellë prej 100 vjetësh.

Muslimanët Raxhaputë të këtij qyteti numrojnë 300 meshkuj dhe kanë prejardhjen prej njëfarë Amir Singu, i cili qe kthyer nga ky evlija.

Varri ende i çmohet e respektohet dhe është vend vizitimi i shumë pelegrinëve.

I ngjashëm me këtë evlija ka qenë Persiani Shejh Xhelaluddini, që në Indi ka ardhur në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe është vendosur në Silhat, në Assamin e poshtëm, me qëllim të kthimit në islam të popullatës së këtyre vendeve.

Si njeri i shenjtë ka arritur reputacion të gjërë, kurse puna në përhapjen e islamit i qe kurorëzuar me sukses të madh.105)

Edhe në kohën e afërt ka shumë prova se islaminë Indi është në rrugën e përhapjes, dhe këtë me sukses të madh.

Sidomos gjysma e dytë e shekullit XIX tregon ngjallje të madhe të aktivitetit misionarist. Numri i konvertimeve vjetore në islam silltet prej 10, 50, 100 dhe 600 mijë.106)

Është rëndë të merren informatat precize për përshkrimin e karakterit individual të punës misionariste individuale më të cilin ai 261

shquhet në mungesë të çfarëdo organizimi qendror ose çkado qoftë që është në lidhje me raportet misionariste. Sukseset, që i kanë përcjell punëtorët e propagandës muslimane, deri diku janë rritur.

Kështu për shembull, thuhet për njëfarë Haxhi Muhammedi se në Penxhab në islam ka kthyer afër 200 mijë Hindusë.107) Një mevlevi në Bangalar është lavduar se për pesë vjet ka kthyer në islam, në këtë qytet dhe rrethinë, njëmijë persona.

Ajo në çka nuk dyshohet është ajo se ka pasur misionaristë muslimanë që aktivisht dhe me sukses e kanë bërë punën e vet.

Shembujt vijues janë tipik për periodën me të cilën kanë të bëjnë.

Mevlevi Beka Husein-kani, misionar udhëtar, gjatë disa vjetëve ka kthyer në islam 228 persona, të banuar në Bombaj, Kavupuru, Axhmir dhe qytetet tjera. Mevlevi Hasan Aliu i ka kthyer 25 persona, 12 prej

tyre janë nga Pona, kurse të tjerët nga Hajdarabadi dhe nga anët tjera të Indisë.108)

Në krahinën Andesh, në territorin e pushtetit bombaj, me aktivitetin misionarist të Sejjid Safdar Aliut, kadiut të Nasirabadit, islamin e ka përqafuar numër i konsiderueshëm zejtarësh, që merren me përpunimin e mjeteve të hekurta ose janë farkatarë.109)

Një numër i caktuar personash të profesionit të njëjtë që e kanë përbërë bashkësinë e vogël prej 200 njerëzve, në krahinën Nasik, janë kthyer në isla mnë mënyrë të çuditshme rreth vitit 1870.

Misionarët prezbetarianë të Nasikut gjatë kohë kanë tentuar t'i kthejnë nga hinduizmi. Deri sa kanë qenë në gjendje luhatjeje të pranimit dhe refuzimit të krishterizmit, u paraqit një fakir muslimanë nga Bombaji që ka qenë njohës i shkëlqyeshëm i mënyrës së të menduarit të tyre. Ai ua ka shpjeguar principet e islamit dhe ka arritur t'i tërheq në këtë fe.110)

Në Patrial*) Mevlevi Ubejdullahu, brahmani i kthyer, me arsimim të gjërë, ka arritur të kthejë në islam pothuaj tërë një kuart të qytetit.

Ka shkruar edhe punime polemiste, që përjetojnë disa botim. Kanë qenë të drejtuar nga dy religjione - krishterizmi dhe hinduizmi.

Në njërën prej këtyre librave ai flet edhe për konvertizmin e vet vetjak: "Unë, Muhammed Ubejdullahu, i biri i Munshi Kota Malës, banorit të Pajalit në shtetin Patriala, deklaroj se ky varfanjak në fëmijërinë e vet dhe gjatë kohës së jetës së babait ka qenë rob i idhujtarisë, por dora e mëshirës së All-llahut e ka shpëtuar dhe e çoi drejt islamit. Atëherë i kam njoftuar përparësitë e islamit dhe
262

mungesat e hinduizmit. Islamin e kam pranuar me zemër dhe shpirt dhe veten e kam numruar në mesin e shërbëtorëve të Pejgamberit të All-llahut (paqa qoftë meta!).

Nga ajo kohë inteligjenca, që është dhuratë e Zotit, më ka sugjeruar se do të ishte e marrë dhe çmenduri që njeriu verbër t'i ndjek traditat e të parëve, që me ta të mashtrohet dhe të mos përsiatë dhe hulumtojë pyetjet e religjionit dhe besimit në të cilët bazohet lumturia ose mjerimi i amshueshëm.

Me idetë e këtilla e kam filluar studimin e feve ekzistuese dhe e kam hulumtuar çdonjërin pa anësi.

Hinduizmin e kam njohur në tërësi dhe e ka mhulumtuar me Panditët e ditur. kam fituar dituri edhe për krishterizmin në tërësi. Kam lexuar libra për islamin dhe kam diskutuar me dijetarët islamë - ulemanë.

Në të gjitha ata kam gjetur gabime dhe mëngësi pos në islam.

Karakteristikat e tij qartë më janë deftuar. lideri i islamit, pejgamberi Muhammedi. posedon karakteristika të tilla morale që nuk ka gjuhë që do t'i përshkruante. Ai vetë e njez besimin dhe themelet e kësaj feje, mësimin e saj etik dhe praktikimin, dhe ka mundur në tërësi ta

realizojë. Falënderimi i qoftë Zotit!

Kjo fe është aq e shkëlqyeshme që çdo gjë në të shpie drejt shpirtit të Zotit. Shkurtimisht, falënderimi i qoftë Zotit, dallimi ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës m'u bë i qartë sikur nata dhe dita, terri dhe drita.

Por, ndonëse zemra gjatë kohë më është ndritur me dritën e islamit, kurse buzët e kanë rrëfyer fenë, epshet e këqia dhe satana (shejtani) më kanë vënë në prangat e kënaqësive dhe komoditetit të kësaj bote kalimtare. Kam qenë në gjendje të keqe për shkak të manifestimit të jashtëm të idolatrisë. Atëherë providenca e All-llahut më ka paralajmëruar: "Deri kur do ta mbanë margaritarin të fshehur në guacë, i cili është me vlerë të paçmueshme, dhe këtë aromë freskuese të mbyllur në kuti? Duhesh me këtë margaritar ta stolisësh qafën dhe ta përdorosh aromën!"

Përveç kësaj, dijetarët kanë shpallur se ai që e fsheh bindjen e vet në islam dhe mbetet në petkat dhe zakonet pabesimtare, shkon drejt Xhehennemit.

Kështu - lavdia i qoftë Zotit, në bajramin e Ramazanit (id al-fitr) në vitin 1264, dielli i hyrjes sime në islam depërtoi përtej perdes së 263

reve dhe devotshmërinë time e ka mdëftuar publikisht me vëllezërit e mi muslimanë."111)

Shumë misionarë muslimanë i kanë marrë metodat e misionarëve të krishterë, siç janë thirrjet në rrugë, ndarja e trajtesave të shtypura fetare dhe aktivitetet tjera.

Në shumë qytete më të mëdha të Indisë mund të gjenden misionarët muslimanë se si për çdo ditë mësojnë të tjerët në islam në disa rrugë kryesore frekvente.

Në Bangalor kjo është praktikë e përgjithshme. një nga këta propagandues, që ka qenë imam i xhamisë rreth vitit 1890, ka qenë aq i popullarizuar sa që nganjëherë është ftuar edhe nga Hindusët që t'iu mbajë ligjërata.

Ka rrëfyer fenë edhe në tregje dhe për nja shtatë-tetë vjetësh ka përvetësuar për islam 42 persona. në Bombaj një misionar musliman fton në fe pothuaj çdo-ditë, në afërsi të tregut kryesor të qytetit, kurse në Kalkut ekzistojnë disa qendra për thirrje në islam çdo herë të gatshëm për këtë qëllim.

Ndër të konvertuarit, kohë pas kohe, gjendet edhe ndonjë Evropian, më së shpeshti personë i rrethanave të varfëra. Kalimi masovik në islam është i dukshëm te Hindusët.112)

Disa nga shoqatat e shumta Anxhuman që, viteve të fundit, janë themeluar në qendrat kryesore të jetës islame në Indi, në synimet e planifikuara kanë edhe dërgimin e misionarëve në pazare e tregje që të ftojnë në fe.

Një nga ato shoqata është "Anxhuman himajeti Islam" në Lahore

(Shoqëria për mbrojtjen e Islamit) dhe shoqëria "Anxhuman Hami Islam" në Axhmir.

Këto dy shoqata iu paguajnë agjitorëve të vet. Por pjesën më të madhe për thirrje në fe, në pazare dhe tregje, e përbëjnë personat që merren me zeje ose me punë tjera gjatë kohës së punës në shtëpi, e kohën e vet të lirë në mbrëmje ia kushtojnë kësaj punës së devotshme. Shumë elan misionarist të muslimanëve indusë është drejtuar kundër veprimit të tendencave anti-islame në të mësuar, që e japin misionarët e krishterë dhe propaganduesit e Arja Samagjit. Prandaj, përpjekjet e bëra janë më tepër të karakterit defanziv, e më pak të karakterit direkt misionarist.

Disa misionarë kujdesin e vet e kthejnë drejt forcimit të themelit më herët të shtruar dhe tentimit të çlirimit të bashkëbesimtarëve të vet

264
nga padija dhe bestytia e vjetër induse dhe drejt mbjelljes së fesë së pastër.

Kjo përpjekje nuk është tjetër pos vazhdim i aktivitetit të mëhershëm misionarist.

Puna në konvertizëm, në realitet, është shpesh i mangët. për shumicën që kanë qenë vetim sipas emrit muslimanë mund të thuhet se për gjysmë janë Hindusë. Ata i ruajnë marrëdhëniet e vjetra kastike, marrin pjesë në festat hinduse dhe kryejnë shumë ceremoni idhujtare. Në disa krahina, për shembull në Mevat dhe Gurgan, mund të gjendet numër i madh muslimanësh të cilët pos emrit nuk dijnë asgjë më tepër për fenë e vet. Ata nuk kanë xhamia as nuk kujdesen për kohën e namazit.

Gjendja e këtillë është veçan te muslimanët në fshatra ose në viset të larguara nga besimtarët.

Në qytete ekzistimi i ulemasë me të madhe e ka ndihmuar zbrapsjen e ndikimit të besimeve të vjetra dhe ka krjuar fotografi më të qartë e më të kuptueshme të jetës fetare në islam.

Viteve të fundit, duke folur përgjithësisht, ekziston lëvizja në mesin e muslimanëve indusë që mriton të përmendet sepse punon në atë që jeta fetare të bëhet sa më e qartë sipas rregullave islame. Shkollat misionariste të krishtera po ashtu kanë vepruar stimulativisht në gjeneratat e reja të muslimanëve që të hedhen në studimin e besimit vetjak dhe ngjalljen e untuziazmit përkatës fetar tek ata.

Në realitet, përhapja e arsimimit përgjithësisht ka sjellë deri te prezentimi i principeve fetare shumë më qartë sikur edhe zmadhimi i numrit të mësuesëve fetarë në krahinat e afërta, që kanë qenë, deri më sot, të mospërfillura.

Kjo lëvizje reformiste misionariste (pa marrë parasysh nga cilat shkaqe është nisur) mund të vërehet në pjesët e ndryshme të Indisë. Në krahinat lindore të Penxhabit, për shembull, pas kryengritjes

erdhi deri të rilindja e madhe fetare.

propaganduesit udhëtojnë, për së gjati e për së gjëri, nëpër vend dhe i thërrasin besimtarët që ta lëshojnë praktikën e vet idhujtare dhe u shpjegojnë principet e mirëfillta të fesë.

Si pasojë e kësaj në shumë fshatra, ku muslimanët kanë çfarëdo pjesëmarrje të rëndësishme, është ndërtuar xhamia, deri se idhujtaria e madhe dhe e kapur ka filluar të pushojë.113)

265

Në Raxhaputon fiset idnuse, të cilat kohë pas kohe kanë kaluar në islam në viset bujqësore, tash janë bërë më ortodokse dhe zelltare në kryerjen e obligimeve fetare. i lëshojnë zakonet e vjetra në të cilat deri atëherë kanë marrë pjesë me fqinjët e vet idhujtarë.

Fisi i Merateve, për shembull, tash ndjek rrugën e vërtetë islame në martesë, në vend të ritualit indus që deri atëherë e kanë ndjekur. Kanë hequr dorë edhe nga ngrënia e mishit të derrit.114)

Rilindje e ngjashme ka qenë në Bengal, për të cilin tashmë kemi folur.

Por, lëvizjet e këtilla dhe përpjekjet e misionarëve individual asesi nuk mjaftojnë që ta shpjegojnë rritjen e shpejtë të numrit të muslimanëve të Indisë. Është e natyrishtme që njeriu të pyetet cilat janë shkaqet tjera, përveç popullatës normale,115) që numri i tyre aq fuqishëm të rritet.

Përgjigjje mund të gjendet në jetën shoqërore të Hindusëve.

Nënçimi dhe përlulja, që është kryer ndaj shtresave të ulta të Hindusëve nga ana e bashkëfetarëve të tyre, dhe pengesat që kanë qenë të pakalueshme kurse kanë qenë të vendosura para çdo anëtari të këtyre kastave që ka dëshiruar ta rregullojë gjendjen e vet, dëfton në dallimin e dukshëm të prioritetit të rregullimit religjioz pakastik, që jep fushë të lirë të punës dhe plotësimit të çfarëdo ambicie.

Në Bengal, për shembull, endësit e pambukut, që janë shikuar me neveri nga bashkëfetarët e vet hindus, e kanë pranuar islamin në numër të madh që të nxirren nga pozita e përlulur, me të cilin janë turpëruar.118)

Ekziston shembull mjaft i qartë, me natyrë të ngjashme, në historinë e pjesës verilindore të krahinës së njëjtë. Këtu në vitin 1550 fisi autokton Kaç ka vëndosur dinastinë me udhëheqësin e madh Hoxhuon.

Gjatë sundimit të nipit të tij, kur shtresat e larta në shtet kanë hyrë në rreth të hinduizmit,117) shuica e botës veten e ka gjetur të nënçmuar jashtë kastës dhe janë bërë musliman.118)

Shpëtimin që islami ua ka ofruar shtresave më të ulta induse nga dhuna e kastave më të larta është manifestuar në krahinën Tineveli në fund të shekullit XIX.

Kasta mjaft e rrezikuar e Shanarëve viteve të fundit aq mirë ka prosperuar që shumë prej tyre kanë ndërtuar edhe shtëpi të bukura.

266

Me këmbëngulje kanë kërkuar të drejtën e vet që të luten në tempujt prej të cilëve nga ajo kohë me forcë janë mënjanuar.

Ka pasuar polemikë e madhe për ç'arsye Shanarët kanë pësuar shumë të këqia nga Hindusët e kastave më të larta dhe shpëtim kanë gjetur në mbrojtjen e islamit. Vetëm për një ditë në islam kanë hyrë gjashtë qind Shanarë në një fshat. Shembullin e tyre së shpejti e kanë ndjekur edhe vendet tjera.119)

Shembuj të ngjashëm mund të gjenden edhe në pjesën tjetër të indisë.

Hindusët, që në çfarëdo mënyre është mënjanuar nga kasta dhe është larguar nga familja dhe shoqëria ku ka frekuentuar, i ka ardhur normale që të përvetësohet në fenë që i ka pranuar të gjithë njerëzit pa dallim. Ajo i ka siguruar nivelin shoqëror që i përgjigjet shkallës sociale, nga e cila ka qenë i larguar.

Ndërrimi i këtyllë i fesë rëndon e ka përcjellur besimin e singertë.

Por, njerëzit të cilët kanë qenë mjaft indiferent ndaj numrit dhe emrave të hyjnive për të cilat kanë qenë të ftuar t'i adhurojnë, seriozisht ndiejnë pengimin dhe largimin nga midisi shoqëror, që ka shkaktuar humbjen e të drejtave kastike. Kanë ekzistuar muslimanët pa kurrfarë ndjenjash fetare.

Ndikimi i studimit të literaturës muslimane dhe kontakti i rëndomtë me shoqërinë muslimane shpesh pandijshëm janë ndier.

Tendenca e ndikimit islam ka qenë e hetueshme në shekullin XIX edhe në mesin e princave raxhiput - Raxhaputamt dhe Bundelkondit.120) Sikur imperatoria e Mogullëve të kishte mbetur, ka mundësi që ky afinitet do t'i çonte këta princa përfundimisht në islam. Ata nuk i kanë respektuar evlijatë muslimanë, por për mësues të bijëve të tij e kanë marrë jomuslimanët. Kafshët i kanë prerë sipas rregullave të muslimanëve. Kanë marrë pjesë në festat muslimane në rrobat e fakirëve (varfanjakëve) dhe janë lutur sikur besimtarët e vërtetë.

Nga ana tjetër, disa konsiderojnë që gjendja e tanishme e gjërave vepron në kalimin e Hindusëve në islam është shumë më tepër i mundshëm, se që ka qenë rasti nën sundimin e dinastive muslimane, kur hinduizmi është bashkuar dhe forcuar në luftë të vazhdueshme me armikun agresiv.121)

Hindusët po ashtu turma turma dhe numerikisht kanë shkuar në turbet e evlijave muslimanë në ditën e përkujtimit të tyre.

267

Njeriu që nuk ka mundur të ketë fëmijë i ka shprehur Zotit musliman adhurimin më të denjë, i nxitur me atë ndjenjë që e ka idhujtari, e kjo është që mos ta lë asnjë hyjni e që mos t'i shprehet dashuria dhe mos t'i afrohet me lutje. Nëse u lindet fëmijë - sipas të gjitha gjasave kjo ka qenë përgjigje në këtë lutje -, tërë familja në atë

rast (e ata nuk janë të rrallë) do të kalojë në islam.122)
Dashuria ndaj gruas muslimane nganjëherë është shkas i konversionit të ndonjë Hindusi, sepse sipas të drejtës islame është e palejueshme që muslimania të martohet për jomuslimanin. Nëse muslimanët i birëzonin fëmijët indusë, i edukonin në fenë e prindërve të tyre të rinj. Njëjtë ka qenë nëse Hindusja është martuar për ithtarin e Pejgamberit, më së shpeshti e pranon fenë e burrit të vet.123)

Pasi ka qenë rast mjaft i rrallë që të ndodh e kundërta, numri i muslimanëve është rritur në raport me numrin e Hindusëve. Hindusët që për ndonjë arsye janë përjashtuar nga kasta e vetë, dhe varfanjakët që kanë jetuar nga kujdesi dhe lëmosha muslimane, apo gratë dhe fëmijët që pas vdekjes së burrave dhe prindërve kanë mbetur ose kanë qenë të lënë (raste të tilla, natyrisht, ka pasur në kohët e rënda, kanë bërë hyrjen e përhershme, qoftë edhe të vogël, të Hindusëve në islam.124)

Ka pasur edhe situata lokale që i kanë konvencuar zhvillimit të islamit. Më herët është deftuar në disa shembuj.125) Kështu në fshatrat Terai, ku ka qenë numri i barabartë i muslimanëve dhe Hindusëve, rritja e pushtetit musliman më së shpeshti ka pasuar pas polemikave në lidhje me therjen e lopëve dhe traditave tjera fetare që kanë qenë të papëlqyeshme për Hindusët.

Hindusët shkallërisht kanë shkuar nga fshati duke lënë nga besimi i vet vetëm Shamarët, lavruesit, që kanë qenë në shërbim të fshatarëve muslimanë. Këta në fund i janë mbështuar fesë së zotërive të vet. Ky nuk ka qenë rezultat i fesë së tyre në vërtetësinë e tyre, por më shumë për shkak të vështirësive të izolimit nga bashkëfetarët e vet. Disa shembuj më shprehimor të konverzionit të kastave të ulta gjenden në viset bujqësore të Oudhës. Ndonëse muslimanët e kësaj province e përbëjnë të dhjetën e popullësisë së tërësishme, ende grupet e vogla të bujqëve muslimanë i përbëjnë qendrat "e shkapërderdhura" të revoltit kundër nënçmimit dhe shkeljes, të cilëve këto shtresa të ulta religjioni i tyre i ka vënë në pozitë dëshpëruese pa rrugëdalje."126)
268

Prioritetet që islami i ka ofruar shtresave të këtilla, siç janë Koru dhe Xhemari, që kanë qenë në shkallën më të ultë të shoqërisë hinduse, dhe shpëtimi që me pranimin e islamit u është ofruar, më së miri kuptohet nga përshkrimi vijues të gjendjes së tyre sociale si Hindusë.127)

"Merimin dhe nënçmimin më të ulët e kanë arritur Koriitët dhe Xhamarët, të cilët kanë qenë endës dhe regjës të lëkurave për të tjerët. Shumë juaj tyre në krahinat veriore janë, në fakt robër të vërtetë. Përgjithësisht, nuk është lehtë të përgatiten që t'i përgatiten me ndihmën juridike të gjyqeve tona. Po shkatërrohen së bashku me fëmijët nga gjenerata në gjeneratë sikur që bjen vlera e mallit të vjetër.

Ata e pranojnë plugun e zotëriut të Brahmanëve ose Shatrës,8) të cilës kasta e tij e lartë ndalon që të prekë. Jetojnë në mesin e derrave, që nuk janë më të ndyta se ata, në kuartet e ndara nga popullata tjetër e fshatit.

Figurat e tyre të zeza të dobëta, figurat e thata të uritura, fytyrat e marra, zakonet e shëmtuara që nxisin neveri, e manifestojnë mjerimin e tyre që i ka gjykuar që të jenë më të ultë se kafsha që jeton në mesin e njerëzve të klasës më të lartë.

Se nuk është e pamundur të përmirësohet gjendja e tyre dëftojnë rrethanat dhe aktivitetet e shërbëtorëve në shtalla, të cilët angazhohen nga ky midis. Në mënyrë solide i paguajnë dhe jetojnë mirë duke iu shërbyer zotërinjve evropianë.

Ndryshimi i fesë rrbhtë rruga e vetme e trasuar pëtashë tijj e tyre, së këndejmi ata kanë pak arsye të jenë të përkushtueshë m fesë që i kanë takuar.

Mosekzistimi i animit kastik paraqet fuqinë e vërtetë të islamit në Indi dhe mundet vetes t'i tërheq shumë konvertitë nga hinduizmi.

Islami në Kashmir dhe Tibet

Që ta plotësojmë këtë pasqyrë të islamit në Indi, është e nevojshme të ofrohen informatat e caktuara për përhapjen e kësaj feje në Kashmir, e prej këtu pas kufirit të Indisë në Tibet.

Nga të gjitha krahinat dhe shtetet e Indisë (përveç Sindit) Kashmiri ka numrin më të madh të muslimanëve (rreth 70%) në raport me tërë popullatën.

269

Fatkeqësisht, të dhënat historike që do ta shpjegojnë ekzistimin e numrit më të madh të muslimanëve në këtë shtet, kryesisht janë me prejardhje induse dhe tibetase, dhe janë mjaft të rralla.

Të gjitha provat na shpiejnë që këtë, në tërësi, t'ia përshkruajmë lëvizjes kontinuitive misionariste të cilën e kanë filluar dhe aplikuar fakirët dhe dervishët. Në mesin e tyre ka pasur edhe propagandues ismailitë të dërguar nga kështjella Alamut.128)

Është rëndë të thuhet kur ky ndikim islam për herë të parë e ka mbuluar këtë vend. Thuhet se sunduesi i parë musliman i Kashmirit Sadruddini129) kalimin e vet në islam ia ka borgj njëfarë dervishi Bulbul Shahu nga fillimi i shekullit XIV.

Ky evlija ka qenë mësuesi i vetëm fetar që ia ka sendërtuar dëshirën që t'ë arrijë deri te e verteta fetare. Kur e ka njoftuar me mësimin fetar që ka qenë më i pranueshëm nga ai i atij hinduist me të cilin nuk ka qenë krejtësisht i kënaqur, ka kaluar në islam.

Në fund të shekullit (1388) islami ka përjetuar depërtimin e vet më të madh me ardhjen e Sejjid Ali Hamadanit, i cili është ikur nga Hamadani i tij i lindjes në Persi ku e ka tërhequr mbi vete zemërimin e Timurleukos. Ai ka ardhur në shoqëri të 700 sejjidëve dhe i kanë themeluar vendet edevotshmërisë në të gjitha pjesët e vendit. Duket se

ndikimi i tyre ka siguruar pranimin e fesë së re.

Mirëpo, duket se shfaqja e tyre ka nxitur edhe frymën e fuqishme të fanatizmit, sepse sulltani Sikandari (1393-1417) e mori emrin Butshikan, për shkak të rrënimit të statujave dhe tempujve hindusë. Ministri i tij i parë, Hindusi i konvertuar, rreptë e ka persekutuar dhe shkelur ithtarët e fesë së vet të vjetër. Pas vdekjes së tij toleranca fetare është bërë themel i qeverisjes në mbretëri.130)

Në fund të shekullit Xv misionari me emrin Mir Shemsuddin, që i ka takuar medhhebit (drejtimit) shiit, ka ardhur nga Iraku dhe me ndihmën e nxënësve dhe ithtarëve të vet ka fituar shumë konvertitë në Kashmir.

Kur nën Akbarin Kashmiri u bë provincë e imperatorisë mogule, ndikimi musliman natyrisht është forcuar dhe në këtë vend kanë ardhur shumë njerëz të ditur, ulema.

Gjatë sundimit të Aurangzebit në islam mka kaluar Raxha Kishtyara, një nga liderët e Raxhaputave me mritën e kerameteve të njëfarë Sejjid Shah Feriduddinit.

270

Duket se konvertimi i tij në islam ka ndikuar që në këtë ta ndjekë shumica e shtetasve të tij.

Përgjatë vijës në të cilën mbretërit mogulë kanë pasur sukses në Kashmir i gjejmë raxhët, që rrjedhin nga Raxhaputët e islamizuar.131)

Veriu dhe verilindja e Kashmirit, provinca Baltistan dhe Ladahi, janë të banuara me përzjerje të racës tiberanase. Në ta islami është përqëndruar para disa shekujve, por koha dhe mënyra e hyrjes së tij janë të panjohur.

Muslimanët e Baltistanit flasin për katër vëllezër që kanë ardhur nga Horasani dhe kanë sjellur freski fetare, por nuk ka kurrfarë transmetimi që do të fliste për propaganduesit më të vjetër.132)

Duket se islami deri në mes të shekullit XIX ka treguar përparim, por përkrahja që ua ka ofruar / maharaxha Ranbir Singh ithtarëve të budizmit e ka ndalur këtë tendencë. Në Ladah ku një numër të caktuar polutanësh, që quhen Argonë,133) të lindur nga nënat Tibetanase dhe babatë muslimanë, tregtarë, që kanë ardhur në Leh. I kanë përvetësuar emrat Tibetanase për martesë që ta pranojnë islamin.

Këta Argonë të gjithë janë muslimanë sikur edhe babajt e gratë Tibetanase. Thuhet se numri po u rritet më shpejtë nga Tibetanasit e pastër.134)

Islami po ashtu është përcjellur në Tibetin e vërtetë nëpërmjet tregtarëve kashmiras.

Për shembull, këta tregtarë mund të gjenden në të gjitha qytetet kryesore të Tibetit. Ata i kanë martuar Tibetanaset të cilat, rëndom, e kanë pranuar fenë e burrave të vet. Thuhet se tash ka më tepër se 2000 familje muslimane në Lhasi.135)

Islami e ka gjetur rrugën për në Tibet edhe nëpërjet Junnanit136) dhe

Su-chinga në kufi të krahinës Li-shvan dhe Tibetit në mesin e banorëve të Tibetit.137) Konsiderohet se ndikimi isla mka ardhur nga Persia138) dhe Turkestani.139)

1) Emri i një sunduesi të tyre; dmth. stoli e fronit Aurang - fronti dhe Zeb-stoli, dokar).

2) Sot numri i muslimanëve në Indi është shumë më i madh - Vër. e SH.N. (Sipas disa të dhënave sot arrinë në rreth 100 milionë, N.I.).

3) Census of India, 1891, General Repart by I. A. Baines, fq. 167 (London, 1893)

271

4) D.m.th. zotëri, kurse u është dhënë anëtarëve të familjes së Muhammedit a.s. dhe pasardhësve të tyre.

5) Census of India, 1891. General Repart by I.A. Baines, fq. 126, 207, (London, 1893).

6) Elliot, vol. II, fq. 448.

7) Muhammed b. El-Kasi mi ka ftuar princat indusë që ta pranojnë islamin. Nuk është e pamundur se po këtë e kanë bërë edhe pushtuesit që kanë ardhur pas tij, duke i zbatuar kështu principet e fesë. (Eliot, vol. I, fq. 175, 207).

*) Fjala Hindu, e d.m.th. qytet i lartë.

8) Ose BArau, emërtimi i vjetër për Bulandshahr.

9) Elliot, vol. II, fq. 42-43.

10) Gazetteer of the N.W.P. vol. III, port. II, fq. 85.

11) Aventurierët ushtarak, që i kanë themeluar dinastitë në Indinë veriore dhe kanë krijuar shtetet në rrafshelartën e Dekanit, shumë pak i kanë dhënë rëndësi gjërave shpirtërore. Shuica nuk kanë pasur kohë për përhapjen e fesë sepse kanë qenë të preokupuar me pushtime ose me luftë qytetare.

Rëndom kanë qenë të vrazhdë Tatarët ose Mongolët. Feja e Muhammedit ende nuk patë zotëruar me shpirtërat e tyre. Kanë qenë të paprekur me entuziazmin e sinqertë semit, që i ka inspiruar Arabët e parë, e të cilët të parët e bartën flamurin e islamit. Imperatorinë që e kanë themeluar ka qenë pastër milltariste.

Kjo imperatori ka mbetur e këtillë nën ndikimin e suksesit gjysmak që i kanë pasur në pushtime, kurse i cili ka qenë përpjestimisht me mosuksesin të invazionit të tyre shpirtëror. Kanë qenë mjaft të fuqishë m që ta pengojnë diç që do t'i gjasonte unifikimit ndër Hindusët ose që ta pengojnë tubimin e fiseve në popull. Ata kanë qenë mjaft larg konvertiit të Indisë në Islam. Madje edhe në mesin e vetë muslimanëve feja e tyre nuk ka arritur kurrfarë monopoli ekskluziv në pozitat e larta drejtuese (Sir Alfred C. Lyall: Asiatic Studies, fq. 289) (London, 1882).

12) Firishtah, vol. I, fq. 184.

13) Ibn Batutah, bl. III, fq. 197.

14) Elliot, vol. III, fq. 386.

15) Panteizmi është drejtim filozogik sipas të cilit çdo gjë është Zot, identitet i plotë i zotit dhe botës. Ashtu çdo gjë mund të quhet zot.

16) Mankind and the Church, fq. 286. (London, 1907).

272

*) Greqisht - ai që zgjedh nga mësimet e ndryshme disa pjesë dhe kështu formon sistemin e vet.

17) Sir Richard Temple, India in 1880, fq. 164 (London, 1881),

Punjab States Gazetteers, vol. XXXVI - A Bahawarpur, fq. 138.

18) Maunal of titles for Oudh, fq. 78 (Allahabad, 1889).

19) Gazetteer of the Province of Oudh, vol. I, fq. 466.

20) Gazetteer of the N.W.P. vol. III, part, II, fq. 46.

21) Gazetteer of the N.W.P. vol. XIV, part II, fq. 119. Në krahinën Kanbur (Cawapare) dega muslimane e familjes Dihit (Dikhit) i ruan zakonet e veta islame të lindja, martesat dhe vdekjet. Ndonëse rëndom nuk mund ta kryejnë lutjen (namazin) sipas rregullave, ata relativisht në mënyrë ortodokse e deftojnë respektin me folje (sexhde).

Njëkohësisht ata e adhurojnë Çeçek Deven, zotin e sëmundjes së varioles dhe kolerës, që nga vetja t'i refuzojnë këto sëmundje. I ruajnë edhe lidhjet e mira mmiqësore me vëllezërit e vet kastik sakurs në ërrethanat familjare. Quhen rëndom me emrat e përbashkët hindu. (Gazetteer of the N.W.P. vol. VI, fq. 64).

22) Ibbetson, fq. 163.

23) Gazetteer of the N.W.P. vol. VI, fq. 64. Krahasoje po ashtu atë që është theksuar në burimin e njëjtë, vol. XIV, part, III, fq. 4. "Nuk ka qenë numër i madh bujqish muslimanë. Këta janë muslimanë të cilët para pak kohe e kanë pranuar islamin. Koha e kalimit në islam të shumica lidhet për sundimin e Aurangzebit. Nganjëherë kjo tregohet si rezultat i detyrimit, e nganjëherë si mjet për ruajtjen e të drejtave të veta, kur nuk mundnin ta paguajnë haraxhin.

24) Ibbetson, fq. 163.

25) Firishte pa dyshim thotë: "Zjarri i tij ndaj fesë së Muhammedit e ka nxitur që ata që kalojnë në islam me bollëk t'i shpërblejë dhe nuk dihet se e ka përdoruar dhunën ndaj atyre që janë të besimit tjetër".)The History of Hindustan, trans. from the Persian by Alexander Dow, vol. III, fq. 361, (London, 1812).

26) The Bombay Gazetteer, vol. XXII, fq. 222; vol. XXIII, fq. 282.

*) Gjendet në krahinën Mejsur në jug të Indisë, kurse e ka themeluar Haydar Aliu në shek. XVIII.

27) Innes, fq. 72-73, 190.

28) Sir W.W. Hunter, the religions of India (The Times, February, 25 th, 1888).

29) Gazetteer of the N.W.P., vol. VI, fq. 518.

273

30) Gazetteer of the N.W.P., vol. V, part. I, fq. 302-303.

- 31) Sir Alfred C. Lyall, *Asiatic Studies*, fq. 236.
 - 32) Në një varr në varrezat Pantalajini Kollam është e gdhendur data 166 Hixhrij (782 e.r.) (Innes, fq. 463).
 - 33) Zayn al-Din, fq. 34-35.
 - 34) Zayn al-Din, fq. 36 (int.).
 - 35) Ibid, fq. 21.
 - 36) Ky është qyteti bashkëkohor Madaji.
 - 37) Zayn al-Din, fq. 23-24.
 - 38) Ibid., fq. 25.
 - 39) Innes, fq. 398.
 - 41) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 82, 88 etj.
 - 42) Innes, fq. 190.
 - 43) Obvardo Barposa, fq. 10.
- Disa konsiderojnë se edhe Cejloni është bërë shtet islam pas ardhjes së Portugezëve, sepse para paraqitjes së forcave portugeze në detin Indus tregtarët arabë kanë qenë zotërues të tregtisë në këtë ujdhesë pa konkurrencë (atje i kanë pasur kolonitë e veta tregtare, një shekull para lindjes së Pejgamberit), dhe janë gjetur në çdo liman dhe qytet. Lehtësia e tregtisë i ka tërhequr hsumë grupe të të ardhurve rishtaz, që kanë ardhur nga kolonitë e veta në mallabar. Tregtarët muslimanë kanë bërë këtu atë që e kanë bërë edhe në vendet tjera. Janë miqësuar me martesë me banorët e vendit dhe e kanë përhapur fenë e vet përgjatë bregut. Duket se aty nuk ka pasur lëvizje të vërtetë misionariste dhe punë ose Singalezët nuk janë treguar të painedesuar për islamin, sikur që kjo sot mund të vërehet. Shumica e muslimanëve në Cejlon janë me prejardhje arabe. Sir James Emerson Tenneut, *Ceylon*, vol. I, fq. 631-633. (5-6 h II. London, 1860).
- 44) Kur'an, 126.
 - 45) Abd al'Razaq, *Mat al'sa'dayn*, fletushkë, 173.
 - 46) Ata gjenden veçan në krahinat në të cilat flitet gjuha tamali, e këto janë regjionet: Mandura, Tinnevelli, Kovinbator, Arkoti verior dhe Nilgiri (India jugore).
 - 47) *Madras District Gazetteers, Trichinopoly*, vol I, fq. 338. (Madras, 1907), Qadir Husayu Khan, *South Indian Musalmaus*, fq. 36 (Madras, 1910)
 - 48) Qadir Husayn Khan, fq. 36-38.
- 274
- 49) Qadir Husayn Khan, / op. cit., fq. 39-42, *Madras District Gazzetters, Anantapur*, vol. I, fq. 193-194. (Madras, 1905).
 - 50)
 - 51)
 - 52) *Report of the Census of the Madras Presidency, 1871*, by W.R. Cornish, fq. 71, 72, 109 (Madras, 1874).
 - 53) *Report of the Second Decennial Missionary Conference held*

- at Calcutte, 1832-1833 (fq. 228, 233, 248), Calcutta, 1883).
- 54) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 128. Ibn Batuta ka qeëndruar në ujdhesat Maldive ndërmjet vitit 1343 dhe 1344, dhe është martuar me vajzën e vezirit i cili ka qenë nip i sulltan Davudit, e ky sërish nip i sulltan Ahmed Sanurazit (bl. IV. fq. 154). nga kjo e dhënë, duke supozuar, viti 1200 është marrë si datë e mundshme.
- 55) H.C.P. Bell, The Maldive Islands, fq. 23-25, 71. (Colombo, 1883).
- 56) Memoir / on the Inhabitants of the Maldive Island's By J. A. Young, and W. Christopher. (Translations of the Bombay Geographical Society from 1836, to 1938, fq. 74, Bombay, 1884.
- 57) Innes, fq. 485, 492.
- 58) Mas'udi, bl. II, fq. 85-86.
- 59) The Bombay, gazetteer, vol. X, fq. 132, vol. XVI, fq. 75.
- *) Pir-mësues, mah - më i mdhi, abir - i devotshëm (vër. e SH.N.).
- 60) Ibid., vol. XXIII, fq. 282.
- *) Emri i qytetit në rrafshlartën dakkase i përket shtetit Nidhama nga Hajdarabadi.
- 61) Xhisudarazi në persishte d.m.th. flokëgjatë. nganjëherë e quajnë Sejjid Mahdum Xhisudaraz.
- 62) The Bombay Gazetteer, vol. XVII, fq. 501, vol. XXI, fq. 218, 223.
- 63) Ibid., vol. XIII, pjesa I, fq. 231.
- 64) Ibid., vol. XXII, fq. 242.
- 65) The Bombay Gazetteer, vol. XVI, fq. 756-76.
- 66) Ibid., vol. XXI, fq. 203.
- 67) Në kohën e pushtimeve arabe pronësia e sunduesit hindus Sindit është shtrirë në veri deri te ky qytet që tash nukhynë në përbërje të kësajprovinçe.
- 68) Baladhuri, fq. 441.
- 69) Elliot, vol. I, fq. 185-186.
- 275
- 70) Ndoshta Sindani është Abresi, krahina jugore e Kaçit.
- 71) Baladhuri, fq. 446.
- 72) Istakhri, fq. 173-174.
- 73) Baladhuri, fq. 446.
- 74) Ibn Hawqal, fq. 230; Idrisi (Geographie d'Edrisi traduite par P.A. Jaubert, I, fq. 175 sqq.).
- 75) Mas'udi, vol. I, fq. 207.
- 76) Elliot, vol. I, fq. 273.
- 77) Khoja Wrstant, p. 208. Sir Bartle Frere, The Khojas The Disciples of the Old Man of the Mountain, Macmillans Magazine, vol. XXXIV, fq. 431, 433-434, (London, 1876).
- 78) Bombay Gazetteer, vol. IX, pjesa II, fq. 26.
- 79) K.B. Fazallah Lutfullahu konsideron se Nur Satagar erdhi në

Indi diç më vonë gjatë sundimit të Bhimas II (1179-1242). (Bombay Gazetteer, vol. IX, pjesa II, fq. 38).

81) Khoja Vrttant, fq. 151-158.

82) Nur Allah al'Shushtari, Majal's al'Mu'mimin, fol. 65. (India Office, M.S. No 1400).

83) Qyteti i largëta dhjetë mila në jugperëndim prej qytetit Ahmedabad.

84) Bombay Gazetteer, vol. IX, pjesa II, fq. 66, 76.

85) Ibid., vol. V, fq. 89.

86) Ibid., vol. II, fq. 378; vol. III, fq. 36-37.

87) Po ashtu Firishtah, por shih edhe H. Bloch mam, Contributions to the Geograpy and History of Bengal (J.A.S.B. vol. XIII, no. I, fq. 264-266, 1873).

88) J.A. Ravenshaw, Gaur: its ruins and inscriptions, fq. 9 (London, 1878) Firishtoh, vol. IV, fq. 337.

89) Wise, fq. 29.

*) Qytet bregdetar në afërsi të Kalkutës.

90) Census of India, 1901, vol. VI, pjesa I, fq. 170.

91) Census of India, 1901, vol. VI, pjesa I, fq. 30.

92) Charles Stewart, The History of Bengol, fq. 176 (London, 1813); H. Blochmann, Contributions to the geography and History of Bengal (J.A.S.B., vol. XIII, No. I, fq. 220, 1873).

93) The Indian evangelical review, fq. 278. (Jonuary 1883).

94) Sir W.W. Hanter, The Religions of India (The times, February, 25, 1888). Shih po ashtu Wise, 32.

276

95) Wise, fq. 37.

96) Blochmann, op. cit., fq. 260.

97) Wise, fq. 48-55.

98) Gulam Sarwar, Khazinat al'Asifiya, vol. II, fq. 330.

99) Në transmetimin tjetër është i njohur si Shejli Behauddin zekeriyya.

100) Ibbetson, fq. 163.

101) Asghar Ali, Jawahir-i - Faridi, (A.H. 1033), fq. 395 (Lahare, 1884).

102) Elliot, vol. II, fq. 548.

*) Kjo është krahinë islame në Penxhab, sunduesit e së cilës kanë prejardhje prej Abasitëve.

103) Punjab States Gazetteers, pej XXXVI A. Bahawalpur State (Lahore, 1908) fq. 160 sqq. Emrat e disa fiseve që e lidhin konvertizmin e vet për Mahdumin dhe Xhihanjanin janë dhënë në fq. 162.

104) Punjab States Gazetteers, vol. XXXVI, fq. 171.

*) Vendi në Indi ku kanë ndodhur tri ndodhi të rëndësishme: në të parën BAburi e ka mundur Ibrahim Ludhin në prill të vitit 1521; në të

dytën Xhelaluddin Muhammed Ekber e ka mundur Hajim mBakalin në vitin 1556 dhe në të tretën dhe më të njohurën Ahmed shah al'Darani e ka mundur Sebmerch Hindusin në vitin 1761.

105) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 217, Yule, fq. 515.

106) The Indian Evangelical Review, vol. XVI, fq. 52-53 (Colcuta, 1889-1890). The Contemporary Review, February, 1889, fq. 170. The Spectator, October, 15, 1887, fq. 1382.

107) Gorcin de Tassy, La Langue et Litterature Hindonstanies de 1850, a 1869, fq. 343 (Paris, 1874):

108) Këto të dhëna m'i ka ofruar mevlevi Hasan Aliu disa vite para vdekjes më 1896. Në nekrologun që është shpallur në revistën "Kroniko muslimane" (The Muslim Croniclo, prill 4, 1986) është dhënë karakteristika vijuese interesante nga jeta e tij: "Në jetën private dhe arsimore ka qenë i njohur si djalosh mjaft inteligjent. për një kohë majft të shkurtër ka bërë përparim të madh në karrierën e vet shkencore.

Në vitet e hershme të jetës ka dhënë provimin "e hyrjes" dhe ka fituar bursën, që i ka ndihmuar që ta fitojë diplomën Bakalerijus të 277

klasit të parë. Por pak pak kohësh jorehatia e tij e lindur e shtynë në kërkimin e të vërtetës, për ç'arsye udhëton jashtë vendit.

I lë studimet dhe përzihet me njerëzit e bindjeve të ndryshme:

fakirët, Panditët dhe të krishterët, hynë nëpër kisha, endet shkretëtirave, maleve dhe qyteteve. Asgjë s'i ka interesuar pos shpresa, lojaliteti dhe mbështetja absolute në mëshirën e Zotit të lartësuar.

Vetëm për një vit ka kaluar disa hapësira të ndryshme religjose, deri sa në vitin 1874 nuk e pranoi shërbimin e mbkqyrësit në një shkollë të Patorëve...

Pasi ka qenë i lindur të jetë misionar i islamit, ka ndier mallëgjimin e fshehtë që ta lëshojë pozitën për të cilën çdo muaj fitonte 100 rupi. Dha dorëheqje nga pozita, kundër vullnetit të miqëve të vet. I mbeti besnik vendimit të vet. Një kohë ka botuar revistën mujore "Nuru-l'islam" (Drita e islamit). Disa ligjërata i ka mbajtur në Patni, pastaj ka udhëtuar në Kalkutë, ku ka mbajtur ligjërata në gjuhën angleze. Këto ligjërata kanë pasur efekt të tillë që disa klerikë evropianë e kanë konfirmuar të vërtetën e islamit. Një personalitet autoritativ, Babu Bepin Çandra Pal, para pak kohe u bë musliman. Qe ftuar nga populli i Dakës në vizitë. Këtu varet dhe ligjëratat ia kanë përjetësuar emrin në zemrat e banorëve.

Librat e tij të shumta, pamfletet dhe ligjëratat e sukseshme në urdu dhe anglishte, në qytezat dhe qytetet e ndryshme të Indisë ia kanë bërë emrin historik në botë.

Më së paku 100 njerëz e kanë pranuar islamin duke i dëgjuar ligjëratat e tij dhe duke i lexuar librat e tij.

Zjarri i tij misionarist është dëftuar edhe në çastin e fundit të jetës kur disa kanë dëgjaur që thotë: "Lëshoje fenë tënde dhe bëru musliman. Kur e kanë pyetur për këtë, ka thënë se i është drejtuar një të krishteri".

109) Bombay Gazetteer, vol. XII, fq. 126.

110) Ibid., vol. XVI, fq. 81.

*) Emri i krahinës hinduse, të cilën e banojnë Sikët 111/ Tuhfat al'Hind, fq. 3 (Delhi, Hixh, 1309).

112) The Indian Evangelical Review, 1884, fq. 128. Garcin de Tassy'la Langue et La Litterature Hindostanies de 1850 a 1869, fq. 485 (Paris, 1874), Garcin de Tassy: La Langue et la Litterature Hindoustanies en 1871, fq. 12 (Paris, 1872).

278

113) Ibbetson, fq. 184.

114) The Rajputana Gazetteer, vol. I, fq. 90; vol. II, fq. 47 (Calcuta, 1879).

115) Për shkaqet e rritjes së numrit të muslimanëve shih: The Cencus of India, 1901, vol. VI, fq. 172.

116) E. T. Dalton, fq. 324.

117) Për futjen e fiseve autoktone në hinduizëm shih: Sir Alfred Lyall, Asiatic Studios, fq. 102-104.

118) E. T. Dalton, fq. 89.

119) The Missionary Review of the World, N.S. vol. XIII, fq. 72-73. (New York, 1900).

120) Sir Alfred Lyall (Asiatic Studies, fq. 29), flet për afinitetin e dukshëm mqë, kohë pas kohe, e kanë treguar disa nga liderët indus.

121) Gazetteer of the Province of Oudh, vol. I, fq. XIX.

122) Do ta cekim mvetëm një shembull. Në Gatanpur, në krahinën Kanfor, një degë e fisit të madh janë muslimanë për shkak të zotimit të të parit të tyre Gatem Deo Bais. Ai ka premtuar, kur është lutur ta ketë një djal në varrin e evlijas muslimanë Madar-shahut, nëse lutja i plotësohet, gjysma e pasardhësve të tij në mënyrë islame do të edukohen.

(Gazetteer of the N.W.P. vol. VI, fq. 64, 328).

Përlujta evlijave muslimanë ka qenë aq e përhapur në mesin e disa kastave të ulta hinduse që regjistrimi nga 1891, në provincën veriperëndimore dhe Udah është ndërmjet 2.333.643 Hindusëve (ose 5.78% të popullësisë së përgjithshme induse të krahinës) me lutje i është drejtuar evlijave muslimanë.

(Cencus of India, 1891, vol. XVI, pjesa I, fq. 217, 244, Allahabad, 189).

123) Disa shembuj të rasteve të këtilla janë dhënë në: Cencus of India, 1901, vol. VI, Bengal, pjesa I, Apendix II.

124) Report on the Census of the N.W.P. and Oudh, 1881, by Edward White, fq. 62 (Allahabad, 1882).

125) Ibid., fq. 63.

126) Gazetteer of the Province of Oudh, vol. i, fq. XIX.

127) Ibid., fq. XXIII - XXIV.

*) Banorët e Indisë ndahen në pesë kasta:

- bramët - kasta e personaliteteve të ditura e të shenjta.

- shatrët - ushtarët.

279

- vishët ose bishët - njerëzit tregtarë dhe afaristë.

- shodrët - kasta e ulët dhe

- xhandalët - kasta që nuk dallon nga kafshët.

Anëtarët e disa kastave në asnjë rast nuk përzihen.

128) Khoja, Vrttant, fq. 141. Këtë kështjellë e ka themeluar Hasan as'Sabahu në afërsi të detit Kaspik në sheh. V H. (IX sheh.).

129) Sipas transmetimit tjetër emrin e ka Shemsuddin. Shih: Muhammed Hajdar, fq. 433 (not. 2).

130) Firishtah, vol. IV, fq. 464, 469.

131) F. Drew the Jummo and Kashmir Territories, fq. 58. 155 (London, 1875).

132) Drew, op. cit., fq. 359.

133) Për këtë fjalë shih te Yule: Marco-Polo, vol. I, fq. 290.

134) Ahmad Shah, Four Years in Tibet, fq. 45, 75 (Benarus, 1906).

135) Broomhall, fq. 206. Tu Wen-su është lideri kryengritjes Ponthay prej vitit 1856 deri 1873. Gjashtëmbëdhjetë vjet ka qenë sulltan i vërtetë i gjysmës së provincës së Junnanit. Ka shpallur m'u në Lhas Kamunikatën për fillimin e kryengritjes që t'i përfitojë ushtarët muslimanë.

136) Mission d'Ollone, fq. 207, 226, 233.

137) Broomhall, fq. 206.

138) A. Bastian, Die Geschichte der Indochinesen, fq. 159. (Leipzig, 1866).

139) R. du M.M., bl. I, fq. 275 (1907).

KAPTINA X

PËRHAPJA E ISLAMIT NË KINË

Avangarda e islamit në Kinë

Tradita transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë: "Kërkonie diturinë qoftë edhe në Kinë.1) Ndonëse nuk ka provë të sigurtë se këto fjalë i ka shqiptuar pikërisht Pejgamberi, nuk përjashtohet që emri i këtij vendi ka qenë për të i njohur, sepse lidhjet tregtare ndërmjet Arabisë dhe Kinës qenë lidhur shumë para lindjes së tij.

Prodhimet e Lindjes, që arrinin në limanet e Sirisë dhe detit Mesdhe, në sasi të mëdha kanë kaluar nëpër Arabi.

280

Në shekullin VI zhvillohej tregti e rëndësishme ndërmjet Kinës dhe Arabisë nëpërmjet Cejlonit. Në fillim të shekullit VII tregtia ndërmjet Kinës, Persisë dhe Arabisë ka qenë e përhapur, kurse qyteti

Siaf në gjirin Persik ka qenë tregu kryesor i tregtarëve kinezë. Në këtë periodë, në fillim të sundimit të dinastisë Tang (618-907) për herë të parë në burimet historike kineze²) përmenden Arabët. Ata flasin për forcën muslimane në Medine dhe shkurtimisht flasin për mësimin religjioz të fesë së re.

Kronikat Kwantgtung kanë shënuar ardhjen e muslimanëve të parë në Kinë: "Në fillim të sundimit të dinastisë Tang në Kantau erdhi grupi i madh i të huajëve nga mbretëria Annam, Kamboxhia, Medineja dhe disa vende tjera.

Këta të huaj i janë lutur Zotit e që në tempujt e vet nuk kanë pasur statuja, idole ose fotografi. Mbretëria e Medines ka qenë afër Indisë. Në të ka lindur feja e këtyre të huajve, që dallohet prej fesë së Budës. Ata nuk e hanë mishin e dërrit as nuk e pijnë verën. E konsiderojnë të ndytë mishin e kafshës që vetë nuk e therin.

Ata tash quhen Hui-Hui...³). Pasi që kërkuan, e morën lejen e mbretit që të vendosen në Kanton, kanë ndërtuar shtëpi të bukura në stilin që dallon nga i yni. Kanë pasur pasuri të madhe. kanë qenë të bindur ndaj prijësit që e kanë zgjedhur vet."⁴)

Ndonëse mungojnë provat direkte historike,⁵) parashtrohet se islami ka hyrë në Kinë me tregtarët që kanë ndjekur rrugën e vjetër detare. Por, burimet e shkruara më të vjetra, në të cilat mund të mbështetemi, tregojnë në lidhjet diplomatike që kanë shkuar rrugës tokësore nëpërmjet Persisë.

Kur vdiq mbreti i fundit sasanidas, djali i tij Firuzi kërkoi nga Kina që ta ndihmojnë kundër pushtuesve arabë,⁶) por mbreti u përgjegj se Persia është mjaft larg prej tij që ta dërgojë ushtrinë e kërkuar. Por transmetohet se ai megjithatë e ka dërguar ambasadorin në pallatin arab që të merret për rastin e princat të ikur; supozohet se mbreti ambasadorit të vetë i ka këshilluar që të bindet në shtrirjen dhe fuqinë e shtetit të ri, që u krijua në perëndim.

Transmetohet se halifi Osman e ka dërguar një komandant arab ta përcjellë ambasadorin kinez në kthim në vitin 651. ky i deleguari i parë musliman ka qenë, me të gjitha nderimet, i pranuar tek imperatori.

281

Gjatë sundimit të Velidit (705-715) / 86-96 H.) komandanti i njohur arab Kutejbe b. Muslim ka qenë guvernator i Harasanit. E ka kaluar lumin OXUS dhe ka filluar serinë e sulmeve të suksesshme në të cilat e ka nënshtruar Buharën, Semerkandin dhe qytetet tjera dhe i translokoi pushtimet e veta në anën lindore, drejt imperatorisë kineze.

Në vitin 713 ai i ka dërguar emisarët te mbreti i cili (sipas gojëdhënave arabe) i ka kthyer me dhurata të pasura.

Disa vjet më vonë kronikat kineze e përendin ambasadorin me emrin Sulejman, të cilin e dërgoi halifi Hishami në vitin 726 imperatorit Hsuan Tsungut.

Këto marrëdhënie diplomatike ndërmjet Arabëve dhe mbretërve kinezë fituan rëndësi të re kah fundi i sundimit të këtij mbreti, kur qe përmbysur nga froni nga uzurpuesit. Abdikoi në favor të djalit të vet Su Tsungut (856).

Ky i fundit ka kërkuar ndihmën e halifit abasit El-Mensurit. Halifi iu përgjegj kërkesës së tij dhe i dërgoi një numër të caktuar të trupave arabe. Me ndihmën e tyre mbreti arriti t'i kthei dy qytetet e veta kryesore Si-ngan-fu dhe Ho-non-fu nga kryengritësit.

Pas mbarimit të luftës këto forca arabe nuk u kthyen në vendin e vet por janë martuar me Kineze dhe janë vendosur në Kinë.

Kësaj sjelljeje të tyre i janë dhënë arsye të ndryshme. Një transmetim thotë se janë kthyer në vendlindje, por nuk iu qe lejuar të mbesin në të, sepse gjatë kohë kanë qëndruar në vendin ku hahet mishi i derrit, dhe se sërish janë kthyer në Kinë. Spas versionit tjetër, kur janë përgatitur të lundrojnë për Arabi në Kanton, filluan t'i përqeshin se gjatë luftimeve kanë ngrënë derrin.

Pasojë e kësaj ka qenë që kanë refuzuar të kthehen në vendlindje dhe t'u shmangen akuzave të ngjashme në popullin e et.

Kur guvernatori i Kantonit ka tentuar t'i detyrojë në këtë janë bashkuar me tregtarët arabë e persianë, vellezërit e vet të fesë, dhe i kanë plaçkitur shtëpitë kryesore tregtare në qytet. Vetë guvernatori shpëtoi duke ikur në fortifikatën e qytetit. Nuk ka undur të kthehet deri sa nga mbreti nuk mori lejen që kjo ushtri arabe të mbetet në vend.

Në qytetet e ndryshme iu kanë caktuar shtëpitë dhe vendin, ku janë vendosur dhe janë martuar me vendaset.7)

282

Islami gjatë sundimit të dinastisë T'ang

Në mesin e muslimanëve kinezë ekziston legjenda që në fenë e tyre i pari i ka ftuar një nga dajët e Pejgamberit varrin e të cilit mjaft e kanë respektuar në Kauton. Por, kjo legjendë nuk ka kurrfarë ????????? historike. Duket se është krijuar më vonë.8)

Nuk ka dyshi mase shfaqja e saj është rezultat i dëshirës së tyre që historinë e islamit në vendin e tyre, sipas mundësisë, ta lidhin me kohën e pejgamberisë së Muhammedit a.s. - kurse kjo është koha që ka qenë buri mi frytshëm i legjendave në vendet larg nga qendra e historisë islame.9)

Por, sa i përket ekzistimit të muslimanëve në Kinë, veçan të tregtarëve në qytete dhe limane gjatë kohës së dinastisë T'ang, kjo është plotësisht e evidente.

Kronisti kinez i kësaj periode (713-742) thotë: "Barbarët nga

Perëndimi erdhën në mbretërinë e mesme më shumësi, si vërshim.

Erdhën nga largësia më së paku 1000 liga (i lig - 23 mila ose 2250 m)

dhe më shumë se 100 shtete. Si tatim bartin librat e veta të shenjta, që

i kanë sjellur dhe lënë në pallatin mbretëror, në sallën për përkthimin e

librave të shenjta dhe kanonike.

Nga kjo kohë doktrinat fetare nga vendet e ndryshme janë

zhvilluar dhe haptazi janë praktikuar në imperatorinë T'ang."10)

Një gjeograf arab në vitin 851 ka shkruar për këto vendbanime dhe

xhami, ndërtimi i të cilave u qe lejuar tregtarëve, që të mund t'i

kryejnë detyrat e veta fetare.11) Ai thotë se nuk ka dëgjuar se ndonjë

princ ka pranuar islamin. Por, pasi që vrojtimin e njëjtë e ka bërë

edhe për popullësinë e Indisë, ka mundësi se ka qenë i informuar

dobët si për rastin e parë ashtu edhe për rastin e dytë.12)

Është e sigurtë se nuk ka provë të vërtetë se muslimanët në Kinë

kanë hyrë në çfarëdo aktiviteti misionarist. Në realitet, për ta ka mjaft

pak të dhëna deri në kohën e pushtimeve mongole në shekullin XIII.

Pasojat e pushtimit mongol

Këto pushtime kanë pasur për pasojë shpërnguljet e mëdha të

muslimanëve të nacionaliteteve të ndryshme: Arabëve, Persianëve dhe

të tjetërve, në imperatorinë kineze.17)

283

Disa kanë ardhur si tregtarë, zejtarë, ushtarë ose kolonë, kurse të

tjerët janë sjellë si robër luftime.

Numri i madh është vendosur në vend për gjithnjë dhe janë

zhvilluar në bashkësi të shumtë dhe përparimtare. Shkallërisht i kanë

humbur veçantitë e veta origjinale me martesë me Kinezet.

Disa muslimanë në kohën e sundimit mongol kanë zënë pozita të

larta. Shembull është Abdurrahmani i cili në vitin 1244 është zgjedhur

për shëf të financave të Imperatorisë, dhe i është obliguar t'i caktojë

tatimet të imponuara Kinës.14)

Ngjashëm është edhe me Omer Shemsuddinin, të njohur si Sejjid

Axhal, me prejardhje nga Buhara, të cilit Kublaj-kani, me rastin e

hyrjes në pushtet në vitin 1259 i besoi drejtimin e financave të

mbretërisë. më vonë u bë drejtues i Junnanit, kur kjo krahinë është

pushtuar dhe i është bashkuar imperatorisë kineze.15)

Sejjid Axhali ka vdekur në vitin 1270 duke lënë pas vetes zërin e

drejtesit të urtë e të drejtë. Ai në qytetin Junnan ka ndërtuar

tempullin konfuçian, siç e ka ndërtuar edhe xhaminë.16)

Pasardhësit e Sejjid Axhalit kanë luajtur rolin e rëndësishëm në

forcimin e islamit në Kinë. Nipi i tij ka arritur të fitojë nga imperatori

në vitin 1335 miratimin se islami është "fe e vërtetë dhe e pastër", që

është emër që islami e bartë deri sot. Një pasardhësi tejtër Sejjid

Axhalit mbreti i lejoi në vitin 1420 t'i ndërtojë xhamitë në qytetet

kryesore Si-ngan-fu dhe Non-kinu.17)

Historianët kinezë, gjatë sundimit të Kublaj kanit, janë ankuar

shumë në këtë monark për shkak se nuk i ka angazhuar nëpunësit

kinezë në vend të Turqëve dhe Persianëve të shpërngulur.

Kujdesi i shkëlqyeshëm që e ka gëzuar Sejjid Axhali dhe

komunikimi i lehtë ndërmjet Kinës dhe perëndimit, i krijuar me

pushtimin mongol, ka tërhequr numrin e madh të këtyre figurave në veri të Kinës.

Ka mundësi që rezultati i këtyre migracioneve është që kanë filluar të formohen bashkësitë e shkapërderdhura muslimane, që në përqindje të madhe kanë filluar të zhvillohen në të gjitha viset e Kinës.

Marko Polo, që ka gëzuar simpatinë e Kublaj-kanit dhe ka jetuar në Kinë prej vitit 1275 deri 1292, ka vërejtur praninë e muslimanëve në shumë vise të Junnanit.19)

284

Historiani, bashkëkohës i Marko Polos, thotë se në fillim të shekullit XIV tërë popullësia e Talifos, kryeqendrës së Junnanit, ka qenë muslimane.20)

Ibn Batuta, që i ka vizituar disa qytete bregdetare në Kinë, kah mesi i shekullit XIV flet për pritjen e ngrohtë në të cilën ka hasur të bashkëbesimtarët e vet21) dhe përsërit që në çdo qytet ekzistojnë kuartet e veçanta për muslimanët në të cilat banojnë vetë dhe i kanë xhamitë e veta. Janë të çmuar dhe të respektuar nga Kinezët.22)

Islami në kohën e dinastisë Ming

Deri në atë periudë të muslimanët në Kinë është shikuar si në shoqëri të huaj. Por pas përzënies së dinastisë mongole në gjysmën e dytë të shekullit XIV nuk kanë marrë përforsim të ri për gjendjen e vet numerike nga jashtë për shkak të politikës së izolimit që atëherë qeveria kineze e ka zbritur.

Pasi e kanë ndërprerë lidhjen me bashkëbesimtarët e vet në vendet tjera, në shumë vise të imperisë kanë filluar të shkrihen në masën e popullësisë së vendit me martesë me Kinezet. I janë adaptuar manireve dhe zakoneve kineze.

Shumë privilegje iu ka ofruar themeluesi i shtetit të ri Ming; mbreti Hung Wu. Për lulëzimin e fuqisë së tyre, në periudën e sundimit të kësaj dinastie (1368-1644), dëshmon edhe numri i madh i xhamive të ndërtuara.

Mbretërit e kësaj dinastie kanë ushqyer marrëdhënie miqësore me sunduesit muslimanë në kufirin e tyre perëndimor. Kanë bërë këmbimin e të deleguarve edhe me sunduesit timuridë.

Një prej tyre është veçan me rëndësi për historinë misionariste të islamit.

Ka qenë ky Shah Ruh Bahadur, i cili e shfrytëzoi rastin e qëndrimit të ambasadorit kinez në pallatin e tij në Semerkand në vitin 1412 që pos përgjegjes së vet imperatorit kinez t'i ofrojë edhe thirrjen në islam.

Me të deleguarin e vet, që e ka përcjellur deputacionin kinez në kthim, i ka dërguar dy letra. E para, që është shkruar në gjuhën arabe, ka përmbajtjen vijuese:

"Në emër të All-Ilahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit! Nuk ka zot tjetër pos All-Ilahut, Muhammedi është peygamberi i Tij.

285

Muhammedi a.s. ka thënë: "Nuk do të ketë në mesin e ithtarëve të mi popull që do t'i kryej urdhërat e All-Ilahut e që i ndihmon ata që i shkatërrojnë dhe i dëgjojnë ata që iu kundërvihen. Në këtë janë deri sa nuk pason urdhëri i All-Ilahut (Dita e gjykimit)."

Kur All-Ilahu i madhëruar dëshiroi ta krijojë Ademin dhe llojin e tij, ka thënë: "Kam qenë thesar i fshehtë dhe kam dëshiruar të bëhem i njohur. I kam krijuar njerëzit që të Më njohin."

Kjo atëherë qartë ka treguar që plani hyjnor (lojaliteti I është forcë, kurse lartëmadhësia fjala e Tij) që me krijimin e njeriut Vetë ta nisë impresionin e njohjes dhe ta ngrisë flamurin e përudhjes dhe fesë së vërtetë.

E ka dërguar Pejgamberin e vet më udhëzim dhe fe të vërtetë, duke e ngritur mbi fetë tjera, qoftë edhe nuk u pëlqen idhujtarëve. E ka dërguar t'i mësojë njerëzit me rregulla dhe ligje dhe rrugët e të lejuarës (hallall) dhe të ndaluarës (haram).

Ia ka dhënë Kur'anin e Shenjtë, si vepër mbinatyrore (mu'xhize), që ashtu t'i heshtë mohuesit dhe mbylljen gojën në diskutim dhe polemikë me të.

Me kujdesin e Tij të plotë dhe me udhëzimin e Tij të gjithëanshëm bënë që kjo fe të mbetet deri në Ditën e gjykimit.

Me fuqinë e Vet ka vënë, në të gjitha epokat dhe kohët, dhe në të gjitha pjesët e botës, në lindje dhe në Perëndim, në Kinë, sundues të fuqishëm, komandant të ushtrisë së madhe dhe pushtetit që ta mbikqyr drejtësinë dhe bëmirësinë dhe t'i shtrijë krahët e paqës dhe sigurisë mbi kokat njerëzore, që t'i urdhërojë mirëbërjen, kurse ndalon shkaktimin e të keqes dhe dhunës. Që mbi ta shtrije bajrakun e sheri'atit të çmueshëm, ta dëbojë idhujtarinë dhe mosbesimin nëpërmjet besimit korrekt në njësinë e Zotit.

All-Ilahu na ka dinjitur me përkrahjen e mirësisë së VEt që të punojmë në vendosjen e ligjit të shariatit të pastër dhe vazhdimin të urdhërave të rrugës së ndritshme.

Na ka urdhëruar, lavdia i qoftë Zotit, që gjërat tjera dhe të gjitha lëndët në konteste dhe raste t'i zgjidhin sipas shariatit të Pejgamberit dhe dispozitave të të Zgjedhurit. Që në të gjitha anët të ndërtojmë xhamia dhe shkolla, tempuj dhe manastire dhe vende të devotshmërisë, që përgjithnjë mos të zhduken shenjat e dijes dhe vendet e mësimin, mos të fshihen gjurmat e shariatit dhe dispozitat e tij.

286

Ekzistimi i përparimit dhe pushtetit të kësaj bote, vazhdimi i pushtetit dhe qeverisë varet nga ndihma të vërtetës, drejtësisë dhe çrrënjësjes së të keqes, idhujtarisë dhe mosbesimit nga faqja e dheut që të pritet e mira dhe shpërblimi. Luemi dhe shpresojmë nga Lartëmadhëria juaj dhe aristokracia e mbretërisë suaj që së bashku me

ne do të pajtoheni në gjërat e përmendura dhe do të na mbështetni në forcimin e bazës së shariatit të sigurtë.”

Letra e dytë, e shkruar persisht, është me më shumë thirrje direkte dhe pa zbulim retorik që e gjejmë në gjuhën arabe: “Zoti i madhëruar me urtinë e vet të lartë dhe me fuqinë gjithpërfshirëse e ka krijuar Ademin (paqa qoftë bi të) dhe i ka caktuar disa nga bijtë e tij për peygamberë dhe të dërguar.

I ka dërguar në mesin e njerëzve që t’i ftojnë kah e Vërteta. Disave nga këta peygamberë, sikur Ibrahimit, Musaut, Davudit dhe Muhammedit (paqa qoftë mbi ta) ua ka dhënë librin dhe i ka mësuar me ligjet. Njerëzve të kohës së tyre iu ka urdhëruar ta ndjekin ligjin (sheri’atin) dhe fenë e secilit prej tyre.

Të gjithë këta peygamberë kanë ftuar popullin në fenë në Një Zot dhe adhurimit vetëm të Atij dhe ndalimit të Itjes Diellit, Hënës, yjëve, sunduesëve dhe idoleve.

Edhe pse secili nga këta peygamberë ka pasur ligjin e vet (sheri’atin), të gjithë ata janë pajtuar në idenë e njëjesisë së All-Ilahut të madhëruar.

Më në fund, kur misioni i peygamberisë (nubivetet /, N.I.) dhe dërgatës (rusulijetit /, N. I.) kaloi në Muhammed - Mustafanë (paqa dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), të gjitha ligjet tjera janë abroguar. Ai është felajmërues dhe i dërguar i epokës së fundit dhe duhet tërë bota: princat, mbretërit dhe ministrat, pasanikët dhe varfanjakt, të vegjlit e të mëdhenjt, që ta ndjekin ligjin (sheri’atin) e tij dhe t’i lënë të gjitha besimet dhe zakonet e mëparshme. Kjo fe e vërtetë dhe e përkryer qytet islam.

Para një kohe të caktuar Xhingis-kani ka tubuar ushtrinë dhe i ka dërguar bijtë në shumë vende të Mbretërisë: Xhuxhi-kanin e ka dërguar drejt Sarajit, krimin dhe Dasht Kajçakut, ku disa sundues si Uzbek-kani, Xhani-kani dhe Urus-kani e kanë pranuar ligjin e Muhammedit a.s. - sheri’atin dhe janë bërë muslimanë.

Hulagu-kani është dërguar në Horasan, Irak dhe në vendet fqinje. Disave nga bijtë e tij, që e kanë trashëguar, në zemra u ka hyrë drita e 287

sheri’atit - ligjit të Muhammedit a.s. Janë bërë muslimanë. Të nderuar me bekimin e islamit, janë shpërngulur në botën tjetër.

Në këta bëjnë pjesë sunduesi i sigurtë GAzani, Ulxhatu-sulltani dhe mbreti i lumtur Ebu Said Bahadur, deri sa babai i mi ndershëm Emir. Timur Xhurxhani nuk u ulë në fron. Ai po ashtu ka vepruar sipas ligjit të Muhammedit a.s. në të gjitha vendet nën sundimin e tij. Gjatë sundimit të tij pjesëtarët e islamit kanë gëzuar mirëqenie të plotë.

Tash me mirësinë dhe providencën e Zotit mbretëria e Horasanit, irakut, Ma verau n-nehri (Transoksanisë) etj. kaluan në duart e mia. Qeverisja në të gjitha vendet e Mbretërinë zhvillohet sipas ligjit të

pastër (shariatit) të Pejgamberit. Drejtësia imponohet, kurse padrejtësia ndalohet. Jargu dhe principet e ligjit të Xhingiskanit janë të përgjithësuar.

Nga kjo kohë sigurisht është konfirmuar se shpëtimi dhe çlirimi në Ditën e gjykimit dhe qetësia dhe lumturia në këtë botë janë shkaktuar me fenë e vërtetë islame dhe me ndihmën e All-Ilahut të Madhëruar. Është e domosdoshme që të sillemi mirë me shtetasit tonë ligjërisht dhe drejtësisht.

Unë shpresoj se edhe ju, me fisnikëri dhe me mirësitë e All-Ilahut të Madhëruar, do ta ndiqni po ashtu ligjin, sheri'atin e Muhammedit, të Dërguarit të All-Ilahut a.s. dhe se do ta forconi islamin dhe ashtu, në vend të pushtetit kalues të kësaj bote, do ta arrini lavdinë dhe fuqinë e asaj bote."23) Kamundësi që këta dy letra kanë qenë bazë që të krijohet më vonë legjenda për atë se një mbret kinez është konvertues në islam.24)

Këtë legjendë, bashkë me të tjerat, e transmeton tregtari musliman Sejjid Ali Ekberi, i cili i kaloi disa vjet në Peking, kah fundi i shekullit XIV. Ai flet për numrin e madh të muslimanëve të banuar në Kinë. Në qytetin Keuxhanf ka pothuaj 30 mijë familje muslimane. Ata nuk paguajnë tatime dhe e gëzojnë simpatinë e Imperatorit. Ai u jep prona tokësore për dhuratë. Gëzojnë lirinë e plotë në kryerjen e rregullave të veta fetare, në të cilat Kinezët shikojnë me respekt.

Kalimi në islam është krejtësisht çështje e lirë. Në vetë kryeqendër kanë qenë katër xhamia të mëdha dhe rreth 90 të tjera në provincat tjera të lperatorisë. Të gjitha janë ndërtuar në shpenzim të mbretit.25) Kryengritja e muslimanëve në kohën e dinastisë Mançu

288
Deri me ardhjen në pushtet të dinastisë Mançu në vitin 1644 nuk është regjistruar asnjë kryengritje e muslimanëve. Duket se kanë qenë plotësisht të kënaqur me liritë fetare që i kanë gëzuar.

Problemet filluan me ardhjen e pushtetit të ri kur janë ngritur muslimanët në krahinën Kansu në vitin 1648. Kjo ka qenë hera e parë që muslimanët janë armatosur dhe u nisën kundër pushtetit kinez. Deri në shekullin XIX nuk ka pasur asnjë revolt të tillë që do të kishte pasoja të tmerrshme apo që do t'i ndërprente marrëdhëniet miqësore, prej fillimit të mira ndërmjet muslimanëve kinezë dhe sunduesve të tyre.

Qëndrimi zyrtar i pushtetit kinez për këto marrëdhënie qartë duket nga edikti të dhënë nga mbreti Yung Çeni në vitin 1731:

"Në krahinat e mia të mbretërisë nga shekujt e kaluar ka numër të madh muslimanësh, që përbijnë një pjesë të popullit, kurse të cilët unë i konsideroj fëmijë të vet vetjak sikurse edhe shtetasit tjerë të mijë. Nuk bëj dallime ndërmjet tyre dhe atyre që nuk i përkasin fesë së tyre. Nga disa nëpunës të mi kam pranuar raporte të fshehta kundër muslimanëve, kurse shkaku është në atë që besimi dallon nga feja e

Kinezëve të tjerë. Ata nuk flasin me gjuhën kineze dhe bartin petkat që dallojnë nga petkat e popullësisë tjetër.

Akuzohen për padëgjueshmëri, mendjemadhësi, synime rebeluese.

Nga unë është kërkuar të ndërmarrë hapa vendimtare.

Kur i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe akuza, kam gjetur se nuk bazohen në të vërtetën.

Në realitet, besimi që muslimanët e ndjekin është besimi mi të parëve të tyre. Është e saktë që gjuha e tyre nuk është gjuha e Kinezëve të tjerë, por sa shumë dialekte ka në Kinë?

Sa i përket faltoreve të tyre, petkave dhe mënyrës së shkrimit që dallohen nga Kinezët tjerë - këto janë gjëra që fare nuk kanë rëndësi.

Këto janë, në fakt, vetëm zakonet.

Ata janë me sjellje të mirë dhe etikë sikur edhe shumë shtetas tjerë dhe nuk ka asgjë që dëfton në tendencat e tyre rebeluese. Dëshira ie është që t'u jepet liria në kryerjen e rregullave të tyre fetare, që kanë për qëllim mësimin e njerëzve përmbajtjes së moralit dhe përmbushjes së të këqiave shoqërore dhe qytetare.

Ky besim i respekton themelet e pushtetit. Çka mund të kërkojmë më shumë prej tij?

289

Nëse muslimanët vazhdojnë të sillen si shtetasit tjerë lojalë, kujdesi im ndaj tyre do të jetë sikur edhe ndaj fëmijëve tjerë të mi. Në mesin e tyre ka pasur mjaft nëpunës civil dhe ushtarak, që kanë arritur pozita të larta.

kjo është prova më e mirë që t'u adaptohen shprehive dhe zakoneve tona dhe të mësojnë se si veten ta adaptojnë rregullave të librave tona të shenjta. Në letërsi i japin provimet sikur edhe të gjithë të tjerët. I kryejnë të gjitha obligimet që ua obligon ligji.

Shkurtimisht, ata janë anëtarë lojalë të familjes së madhe kineze dhe gjithnjë orvaten t'i përmbushim të gjitha detyrat e veta fetare, civile e politike.

Kur gjyqtarët e shqyrtojnë kontestin qytetar, nuk shikojnë në fenë e palës kontestuese. Ekziston vetëm një ligj për të gjithë shtetasit e mi. Kush punon mirë do të shpërblehet, e kush punon keq do të ndëshkohet."26)

Tridhjetë vjet më vonë trashëgimtari i tij, imperatori Kimbung, ka treguar prova të qarta të simpatisë së vet ndaj muslimanëve kur ua ka dhënë bujarinë dy bejve turqë, të cilët vërtet e kanë ndihmuar në zbrapsjen e kryengritjes në pjesën veriperëndimore të Imperisë dhe Kashgarit. Iu ka ndërtuar pallate në Peking. E ka ndërtuar edhe xhaminë, të cilën do ta përdorojnë bejët turqë kur të vijnë në vizitë në pallatin mbretëror dhe për robërit e luftës, të cilët nga Kashgari janë sjellë në kryeqendër.

Në mesin e këtyre robërve ka qenë edhe vasha e bukur, e cila ka qenë konkubinate e favorizuar e mbretit. Flitet se mbreti nga dashuria

ndaj saj e ka ndërtuar këtë xhami kundruall pallatit të tij, sikur edhe pavijonin në rreth të pallatit, në mënyrë që kjo vashë të mund t'i shikojë vendasit e vet deri sa e kryejnë namazin dhe të marrin pjesë në devotshmërisë e tyre.

Kjo xhami është ndërtuar ndërmjet vitit 1763 dhe 1764 dhe ka mbishkrimet në katër gjuhë, Tekstin në gjuhën kinezishte e ka shkruar personalisht mbreti.27)

Pas thyerjes së kryengritjes në Zungari, imperatori Kien Lung, në vitin 1770 i ka translokuar këtu, nga pjesët tjera të Kinës, dhjetë mijë kolonë ushtarake (të shpërngulur), që i kanë përcjellur familjet e tyre dhe njerëzit tjerë, që ta popullëzojnë vendin.

Transmetohet se të gjithë këto kanë kaluar në fenë e popullatës uslimane në periferi.28)

290

Nuk kemi të dhëna për atë se kalimi i këtillë masiv a ka ndodhur edhe në vendet tjera të Imperisë.

Ekzistimi i numrit të madh të muslimanëve në çdo krahinë kineze29) vështirë që mund të komentohet vetë mme popullëzi nga jashtë dhe me rritjen natyrale të popullësisë me atë që numri i tyre është më i madh në ato provinca që i banojnë muslimanët të huaj.30) Është e pamundur që muslimanët e Kinës gjatë kohës së ekzistimit të tyre shumëshekullor në këtë vend dhe lirive fetare që i kanë pasur dhe mbrojtjes që e kanë gëzuar nga disa mbretër, kanë qenë pa zjarr fetar për përhapjen e islamit, që hulumtuesit bashkëkohorë i vërejnë sot te pasardhësit e tyre.31)

Për këtë aktivitet direkt misionarist lidhet edhe kalimi në islam të Hebraikëve kinezë. Vendosija e tyre në këtë vend daton nga perioda e hershme. Kanë qenë në shërbimet shtetërore dhe kanë pasur prova të gjëra, por në fund të shekullit XVII shumica e tyre kanë konvertuar në islam.32)

Duhet të jetë që kjo propagandë të jetë fare epaimponuar. Në realitet, ka pasur mjaft metoda tjera publike në thirrje, që kanë nxitur dyshimin dhe mosbesimin e qeverisë, siç e dëfton këtë raport i interesant që e ka dërguar guvernatori i krahinës Kwang-se mbretit K'ien Lungut në vitin 1783. përmbajtja e tij është si vijon:

"Kam nderin ta njoftoj mëdhërinë Tuaj se një aventurier, me emrin Han-Fo-Yun nga provinca Kwang-Se është arrestuar me akuzë të endacakut. Në hetime ka pranuar se ka kaluar dhjetë vjet duke i vizituar shumë krahina të mbretërisë me qëllim që të njoftohet me gjendjen e fesë.

Në një çantë të tij kemi gjetur tridhjetë libra. Disa prej tyre ai vetë i ka shkruar, kurse të tjerat janë të shkruara me gjuhën që askush prej nesh nuk e kupton.

Këto libra e lavdojnë mbretin perëndimor që e quajnë Muhammed, në mënyrë qesharake dhe fantastike.

Kur endacakun e përmendur e munduam, në fund pranoi se qëllimi real i udhëtimit të tij ke qenë që të thërret në këtë fe të shtrembër nga këto libra. Ka pranuar se në krahinën Sheu-sin ka kaluar shumë kohë se në çdo krahinë tjetër.

Personalisht i kam hulumtuar këto libra. Disa prej tyre vërtet janë shkruar me gjuhë të huaj, për ç'arsye s'i kam kuptuar. Të tjerat, që janë shkruar kinezisht, janë mjaft të këqia.

291

Kësaj mund t'i shtojë edhe këtë se nxisin nënçmim për shkak të tepriit në lavdim njerëzve, që këtë / lavdi nuk e meritojnë, sepse unë asnjëherë as nuk kam dëgjuar për ta.

Ndoshta Han-Fo - Yun-i i përmendur është një nga kryengritësit nga Kan-Su-i.

Pa dyshim, sjellja e tij është e dyshimtë, sepse ç'ka punuar ai në provincat nëpër të cilat ka kaluar gjatë dhjetë viteve të kaluara? Kam vendosur që me këtë pyetje seriozisht të preokupohej. Në ndërkohë, e lusë madhërinë tuaj që të urdhërojë ndezjen e pllakave të rradhitjes së shkronjave të cilat janë në pronësi të familjes së tij, kurse rradhitësit e shkronjave që të mbyllën, njëjtë sikur edhe autorët e librave, që po ia dërgoi madhërisë suaj, e dëshirë të dijë çfarë është botëkuptimi i Juaj i gjërave."33)

Muslimanët dhe bashkëqytetarët e tyre

Ky raport dëshmon, së paku, për një aktivitet të njërit prej misionarëve të fundit muslimanë, në shekullin e XVIII. Tregon po ashtu që rritja e islamit, që misionarët jezuitë³⁴⁾ e kanë shënuar në shekullin e XVIII, nuk është pa lidhje me thirrjen e hapur në islam, si e konsiderojnë këtë disa.

Du Halde, në disa faqe të kushtuara muslimanëve në punimin e vet të vëllimshëm,³⁵⁾ e sjell rritjen e numrit të tyre në lidhje me blerjen e tyre të rëndomtë të fëmijëve në kohën e urisë dhe skamjes.

"Muslimanët janë vendosur në shumë provinca qysh para 600 vitesh, ku jetojnë në qetësi të plotë, sepse nuk japin kurrfarë angazhimi më të madh në përhapjen e besimit të vet dhe në përvetësimin e muslimanëve të ri. Në kohët e kaluara numri u që rritur me lidhje martesore me Kinezët.

Por, qysh para disa viteve ata dukshë mshkojnë përpara duke iu falënderuar pasurisë së vet.

Ata blejnë fëmijët e paganëve kudo, sepse prindërit e këtyre fëmijëve nuk janë në gjendje që gjithnjë t'ua sigurojnë ushqimin.

Gjatë kohës së urisë, që e ka goditur krahinën Çantong, muslimanët kanë blerë më shumë se 10.000 fëmijë. Muslimanët martohen me Kinezet dhe ua blejnë shtëpitë ose në qytet bëjnë kuarte të ndara, e madje edhe fshatra të tëra.

292

Në shumë vende shkallërisht kanë arritur shkallë të atillë që nuk

lejojnë të jetojnë në mesin e tyre ata që nuk shkojnë në xhami. Në këtë mënyrë në shekullin e kaluar mjaft u është rritur numri." Ngjashëm ka ndodhur me urinë që e ka goditur provincën Kwangtun në vitin 1790 kur muslimanët, si thonë, kanë blerë më shumë se 10.000 fëmijë nga familjet që kanë qenë aq të varfëra që nuk kanë mundur t'i mbajnë dhe i kanë dhënë që të shpëtojnë nga uria. Të gjithë këta janë edukuar në islam".36)

Muslimani kinez nga krahina Juman, i quajtur Sejjid Sulejman, e vizitoi Kairon në vitin 1894 dhe deklaroi në intervjuin një përfaqësuesi të revistës arabe37) se numri i atyre që në këtë mënyrë hyjnë në islam çdo vit është i panumërt.

M. D'Ollone jep dëshim të ngjashëm dhe konfirmon se tradita e blerjes së fëmijëve në kohën e urisë është e shtrië edhe tash në mesin e muslimanëve në të gjitha viset e Kinës. Në këtë mënyrë janë blerë fëmijët e familjeve të krishtera që boksierët i kanë mbytur në vitin 1900 dhe janë edukuar në islam.38)

Muslimanët e Kinës kanë prirje për jetesë të përbashkët në fshatrat dhe qytetet e ndara ose themelimit të kuartit të ndarë muslimanë në qytetet ku nuk i lejojnë asnjë personi që nuk shkonë në xhami të banojë në mesin e tyre.39)

Ndonëse, deri diku, e mbajnë veten në izolim, përpiqen t'i shmangen çfarëdo manifestimi të hapur e të veçantë fetar që do t'i shqetësonte fqinjët e tyre.

Janë orvatur që të mos nxisin jotolerancën e bashkëqytetarëve të vet kinezë.

Në jetën e vet të përditshme ata i përmbahen traditave dhe rregullave që dominojnë rreth tyre. Ata mbajnë gërshetin në kokë dhe petkat e njohura kineze, e sipas traditës në xhami i vënë tarbanat. Muslimanët i janë shmangur ndërtimit të minareve të larta në cilindo vend, që mos të nxisin padurimin e Kinezëve.40)

Në rast më të shumta, xhamitë e tyre i janë përshtatur arkitekturës kineze dhe më së shpeshti nuk dallohen nga tempulli i rëndomtë kinez ose nga shtëpia për banim.41)

Çdo xhami sipas ligjit është dashur ta ketë tabelën në të cilën është gdhendur: "Rroftë mbreti i pavdekshëm gjithnjë. "Sipas traditës aktuale kineze, edhe muslimanët janë dashur t'i përkulen kësaj table, 293

por këta kanë pasur më shumë shtigje që t'i shmangen kësaj, ta kënaqin ndërgjegjen e vet dhe t'i shmangen akuzës për idhujtari.42)

MADje edhe në viset e Kinës tatarë, ku si privilegj i veçantë u është lejuar ushtarëve muslimanë që të mos përzihen me të tjerët dhe se mund të jenë bashkësi e ndarë, nëpunësit e lartë muslimanë kanë bartur rrobat që i përgjigjej pozitës së tyre, kanë lëshuar mustaqe të gjata dhe gërshetin.

Gjatë festave kanë aplikuar ceremonialin zyrtar të shprehjes së

besnikërisë dhe dëgjueshmërisë kundrejt potretit të mbretit, me atë që me ball e kanë prekur tokën tri herë.43)

Ngjashëm të gjithë mandarinët muslimanë (dinjitarët) sikur edhe nëpunësit tjerë në provincat tjera kanë aplikuar gjatë festave ceremoni të veçanta sipas pozitave të veta zyrtare në tempujt e Konfuçios. Në realitet, muslimanët kanë qenë të kujdesshëm dhe kanë ndërmarrë masa preventive që feja e tyre mos të dëftohet opozicionale kundruall religjionit shtetëror.

Në këtë mënyrë i janë shmangur urrejtjes me të cilën Kinezët kanë shikuar në besimtarët e religjioneve të huaja, siç janë hebraizmi dhe krishterizmi.

Muslimanët ua prezentonin Kinezëve fenë e vet sikur ajo pajtohet me mësimin e Konfuçies, me një dallim që muslimanët ndjehin traditën e të parëve në martesën, në varrim dhe larjes së duartve para ushqimit, dhe ndalimit të ngrënies së mishit të dërrit, pirjes së verës, pirjes së duhanit dhe bixhozit.44)

Ngjashëm me këtë, veprat e shkruara muslimane kineze me konsideratë të lartë janë sjellur ndaj Konfuçies dhe klasikëve tjerë kinezë dhe sado që ka qenë e mundur kanë dëftuar në pajtueshmërinë në përmbajtjen e librave kineze dhe mësimin islam.45)

Qeveria kineze u ka dhënë shtetasve muslimanë (me përjashti në kohën e kryengritjeve) privilegjet dhe të drejtat e njëjta që i ka gëzuar popullsia tjetër.

Nuk ka pasur shërbim shtetëror që për ta ka qenë e papërshtatshme. Kanë gëzuar besimin dhe respektin si guvernatorë të krahinave, komandantë, gjyqtarë dhe ministre shtetëror te sunduesi dhe te populli. Në historinë kineze janë paraqitur emrat muslimanë si nëpunës të njohur shtetëror, ushtarë ose civilë, por ata janë dalluar edhe në disiplinat teknike dhe shkencore, matematikë dhe astronomi.46)

294
Për muslimanët kinezë thuhet se janë njerëz të suksesshëm afaristë dhe tregtar. Monopoli i tyre është tregtia me mishëlope.47)

Kështu i gjejmë se janë në lidhje me të gjitha palët e jetës nacionale dhe i kanë të gjitha rrethanat për propagandë. Por, disa misionarëve të krishterë, që u ka interesuar kjo gjë, kanë vërejtur se këta muslimanë nuk i nxitë zjarri fetar në përhapjen e mësimin islam.48)

Ajo që është e sigurtë është që numri i madh i muslimanëve kinezë të kovnertuar mund ta cekë emrin e të parit të parë që ka kaluar në islam, që dëfton në procesin e kontinuar të konversionit në këtë fe. Sipas të gjitha gjasave, muslimanëve nuk u është lejuar që në fenë së vet të thërrasin nëpër rrugë, siç bëjnë protestantët,50) por (siç kemi parë më herët),51) ata nuk druajnë që bashkësisë së vet t'ia rrisin numrin.

Një nga librat i tyre fetar "Udhëzim në themelet e fesë së vërtetë" (e botuar në Kanton në vitin 1668) nxitë në aksionin e thirrjes në fe

duke i theksuar ata që kanë kaluar në islam në mesin e idhujtarëve.52) Me themelet e mësimit islam muslimanët e ri mësohen nëpërmjet librave fillestarë në vargje.53) Ndikimit të librave fetarë të muslimanëve kinezë Sejjid Sulejmani ia përshkruan kalimin e të shumtëve në islam viteve të fundit.54)

Transmetohet se instituti (seminari) musliman në Hoçovë, në krahinën Kan-su, i mëson studentët e teologjisë që kthehen në provincat e veta pas plotësimit të studimeve, që atje ta përhapin fenë e vet.

Theksohet se këtë punë të vet e kanë filluar në më shumë se dhjetë qendra provinciale ku i kanë përgatitur mullët (mësuesit fetar) për propagandën islame.56)

Shumë oficerë kanë kthyer në islam shumë ushtarë të vet, që i kanë pasur nën komandë. Njëjtë kanë vepruar edhe dinjitarët e mëdhenj, mandarinët muslimanë, duke shfrytëzuar autoritetin që e kanë gëzuar në përvetësimin e konertitëve. Por, pasi kanë qenë vazhdimisht të transferuar nga vendi në vend, ata nuk kanë mund të kenë aq shumë sukses dhe ndikim tek eprorët ushtarakë muslimanë.57)

Kanë ndodhur kaliemt në islam që nuk kanë qenë rezultat i ndonjë lidhjeje direkte propaganduese.

Për shembull, udhëpërshkruesi turk që në vitin 1895 ka qëndruar në Peking, përmend se ai atje ka parë tridhjetë xhamia. Në mesin e atyre ka qenë një që më herët ka qenë tempull i vërtetë, dhe ky

tempull familjar i një Kinezi të pasur. Atij ia ka shpëtuar jetën muftiu Wa-Ahond (Abdurrahman) në kohën e kryengritjes së bokserëve. Si shprehje e falënderiit të tij, ai kaloi në fenë e shpëtuesit të vet.58)

Misionarët turqë dhe të tjerë muslimanë viteve të fundit e kanë vizituar Kinën dhe janë orvatur ta forcojnë në mesin e muslimanëve kinezë më thellë dhe më gjërë njohjen e fesë së vet dhe të zgjojnë në ta zjarrin fetar. Por, duket se angazhimi i tyre ka rezultuar me fryte të dobëta.59)

Autori rus60) në vitin 1868 ka shkruar në veprën e vet interesante për islamit në Kinë duke shprehur mendimin se islamit është destinuar të jetë feja nacionale e imperatorisë kineze, për ç'arsye do të ndërroheshin forcat e brendshme politike të botës lindore.

Kaloi gjysmë shekulli prej kësaj profecie alarmante, por asgjë nuk ndodhi që do ta konfirmonte. Përkundrazi, duket se islami në shekullin e kaluar ka qenë në ngecje më shumë se në përparim.

Nga masakrat e mëdha, që i kanë përcjellur shkeljen e trazirave të idhujtarëve në Junnan prej vitit 1855 deri më 1873 dhe kryengritjes Tungan në krahinën Shen-si dhe Kan-su në vitin 1864-1877 dhe 1895 - 1896 popullësia muslimane është rralluar për disa milionë frymë.61)

Rivënia e republikës së re u ka dhënë muslimanëve kinezë lirinë e punës, më mirë se cilido pushtet paraprak. Ende është rëndë të

zbulohet deri në çfarë kufiri do të mund t'i shfrytëzojnë rrethanat që u kanë mundësuar kushtet e jetës së re.

Përhpaja e mësimi islam në Kinë ende përpuron në vëllimin që ia lejojnë rrethanat, që tregon se shpresa për përhapje ende ekziston. Ndonëse kaluan katër shekuj nga koha kur udhëpërshkruesi muslimanë⁶²) në Kinë ka mundur të diskutojë për mundësinë e kalimit në islam të imperatorit, e pastaj edhe shtetasve të tij, ende ka mundësi që muslimani kinez i kësaj gjenerate të deklarojë që bashkëfetarët e tyre në këtë vend shikojnë përpara me siguri në ditën kur islami do të triumfojë përsëjati e përsëjleri imperatorisë kineze.⁶³)

1) Kauz al'Ummal, vol. V, fq. 202.

2) Bretschneider, (2), fq. 6.

3) Për prejardhjen e këtij emri shih: Deveria, fq. 311, Mission d'Ollone, fq. 420, sqq.

4) De Thiersant, vol. I, fq. 19-20.

296

5) D'Ollon jep vërejtjen vijuese mbi dyshimin e dijes sonë për islamin në Kinë: "Nuk dijmë asgjë për islamin në Kinë. Nuk dijmë saktë si është përhapur në imperatori as numrin e atyre që e kanë pranuar islamin, as a i ka pasur të saktë të gjitha principet. Nuk dijmë asgjë për organizimin e tij as për lidhjet e tij me botën tjetër islame" (Mission d'Ollone Shefer ka tubuar atë që Arabët dhe Persianët e kanë shkruar për kinën. "Notice sur les relations des peuples musulmans avec Les Chinois".)

6) Chavennes, fq. 172.

7) De Thiersant, vol. I, fq. 70-71.

8) Broomhall këtë legjendë mjaft e ka shqyrtuar; Islam in China, IV, VII.

9) Në këtë mënyrë banorët e Hotanit pohojnë se islamin i pari e ka sjell në vendin tyre Xhaferi, djali i axhës së Pejgamberit (Grenard Mission Dutreuil de Rhins, bl. III, fq. 2). Fiset Cam në Kamboxh e lidhin hyrjen e vet në islam për një prej axhëve të Pejgamberit. (R. du M.M. vol. II, fq. 138).

10) De Thiersant, vol. I, fq. 153.

11) Reinond, Relation des Vayages foits par les Arobes et les Persans, dans l'Inde et a la Chine, I, fq. 13, 64 (Paris, 1845).

12) Ibid., fq. 58.

13) Se ka pasur migrime edhe të Kinezëve drejt Perëndimit, në viset e pushtuara të islamit, ku kanë ardhur në sferën e ndikimit të tij fetar, mund të lexojmë në ditarin e një monaku kinez, i cili më 1222-1224 ka kaluar nëpër Azinë qendrore për Persi, dhe duke folur për Samerkandin, thotë: "Mjeshtrit kinezë jetojnë në çdo vend" (Bretschneider (I), vol. I, fq. 78).

14) Howarth, vol. I, fq. 161.

- 15) Për biografitë kineze të Sejjid Axhalit shih: R. du M.M. VIII, fq. 344, sqq, dhe XI, fq. 3 sqq; Mission d'Ollone, fq. 25, sqq.
- 16) Broomhall, fq. 127.
- 17) Mission d'Ollone, fq. 435-436.
- 18) Howarth, vol. I, fq. 257.
- 19) Marco Polo, vol. I, fq. 219, 274; vol. II, fq. 66.
- 20) Rashid al'Din (Yule's Cathay, fq. 9).
- 21) Ibn Batutah, vol. IV, fq. 270, 283.
- 22) Ibid., fq. 258.
297
- 23) Abd al'Razzaq al'Samarqandi, Matla'al-sa'-dayn, foll. 6-61, (Blochet, fq. 219-252).
- 24) Zeuher, fq. 798-799 Melanges Orient-aux, fq. 65 (Publications de l'Ecole des Langues Orientales Vivantes, Ser. II, bl. 9) (Paris, 1883).
- 25) Schefer, fq. 29-30, Zenker, fq. 796.
- 26) De Thiersant, bl. I, fq. 163-164.
- 27) Broomhall, fq. 92 sqq, Deveria, Musulmans et Manicheens chinois (J. A. gme. Ser. bl. X, fq. 447 sqq.).
- 28) De Thiersant, bl. I, fq. 163-164.
- 29) Broomhalli përmend në kaptinën XII të librit të vet "Islami në Kinë" se numri i përgjithshëm është pesë dhe dhjetë milionë persona, kurse d'Ollonc e zvogëlon këtë numër në katër milionë (fq. 430).
- 30) Thuhet se nataliteti i muslimanëve është më i madh se nataliteti i Kinezëve tjerë. Sipas regjistriit kinez, i cili është kryer sipas familjeve, është llogaritur se familja muslimane ka gjashtë anëtarë, kurse ajo e rëndomtë kineze pesë. (Bromhall, fq. 197, 203).
- 31) Vide infra, fq. 309-310.
- 32) Clark Abel, Narrative of a journey in the interior of Chine, fq. 361. (London, 1818).
- 33) De Thiersant, bl. II, fq. 361-363.
- 34) Një misionar shkruan nga Pekingun më 1721: "Bashkësia e muslimanëve gjithnjë shumë e më shumë zgjerohet" (Lettres edificantes et curieuses bl. XIX, fq. 140).
- 35) J. B. du Halde, Description Geographique, historique, chronologique, politique et physique de l'Empire de la Xhine, bl. III, fq. 64 (Paris, 1735).
- 36) Anderson, fq. 151; Grosier, bl. IV, fq. 507.
- 37) Thamarat al'Funun, 17 th. Shawwal, fq. 3 (Bayral, A.H. 1311).
- 38) Mission d'Ollone, fq. 279, R. Du M.M. bl. IX, fq. 577-578.
- 39) Broomhall, fq. 226, Grosier, bl. IV, fq. 508.
- 40) Vasilev, fq. 15.
- 41) Broomhall, fq. 237.
- 42) Ibid., fq. 186, 228.
- 43) Arminias Vambery, Travelsin Central Asia, fq. 404 (London,

- 1864).
44) Vasil'ev, fq. 16.
45) De Thiersant, bl. II, fq. 367, 372.
298
46) De Thiersant, bl. I, fq. 247; Thamarat al'Funun, 28 th Sha'ban, fq. 3.
47) Broomhall, fq. 224.
48) Du Halde, Loc. Cit, Broomhall, fq. 282.
49) Mission d'Ollone, fq. 210, 431.
50) Broomhall, fq. 273, 282.
51) Ibid., fq. 307.
52) Ibid., fq. 231-232.
53) W. J. Smith, fq. 175, Mission d'Ollone, fq. 407 sqq.
54) Thamarat al'Funun, Loc. cit.
55) Broomhall, fq. 240.
56) The Missionary Review of the World, vol. XXV, fq. 786 (1912).
57) Mission d'Ollone, fq. 431.
58) R. du M. h. III, fq. 124 (1907).
59) Broomhall, fq. 242, 292 sqq.
60) Vasil'ev, fq. 3, 5, 14, 17.
61) Për të dhëna më të gjëra për shkaqet e kryengritjeve muslimane, shih: Mission d'Ollone, fq. 436.
62) Sayyid 'Ali Akbar, Khitay Nameh, fq. 83. "Nëse Imperatori i Kinës e pranon islamin, është e pashmangshme që edhe shtetasit e tij ta pranojnë, sepse ata të gjithë e adhurojnë deri në atë masë sa i besojnë çka thotë. Nëse kjo dritë, që vjen nga perëndimi, është e fuqishëm, mosbesimtarët e Lindjes grupe grupe do të hyjnë në islam, pa kurrfarë kundërshtimi, sepse janë liruar nga cilido fanatizëm në pyetjet fetare."
63) Thamarat al'Funun, 26 th (Shawwal, fq. 3 (A.H. 1311).

KAPTINA XI

PËRHAPJA E ISLAMIT NË AFRIKË

Arabët në Afrikën veriore

Historia e islamit në Afrikë, që përfshinë periodën prej gati trembëdhjetë shekuj dhe përfshinë dy të tretat e këtij kontinenti, me shumë fise dhe raca, paraqet vështirësi të veçantë për hulumtimet sistematike. Pothuaj është e pamundur të jepet shpjegim i

299
njëkohësishë i rrjedhës kronologjike të përhapjes së kësaj feje në viset e ndryshme të kontinentit afrikan.

Në pjesën e parë të këtij libri jemi preokupuar me lidhjet ndërmjet përhapjes së islamit dhe kishave të krishtera të Egjiptit dhe Pjesëve tjera të Afrikës veriore, Nubisë dhe Abesinisë.

Në këtë kaptinë do të ndiqet përparimi i tij së pari në mesin e

popullatës idhujtare të Afrikës veriore, pastaj në Sudan dhe më tej në bregun Perëndimor dhe, në fund, përgjatë bregut Lindor dhe kolonisë Kpa.1)

Islami i Berberëve

Informatat që i kemi për përhapjen e islamit në mesin e popullatës pagane të Afrikës veriore janë vetëm disa të dhëna më të vogla, që mund t'u shtohen atyre më herët të përmendura, për zhdukjen e kishës së krishterë.

Berberët rreptë i janë kundërvënë ushtrisë arabe. Duket se fuqia ka pasur shumë më tepër ndikim në konvertimin e tyre në islam se sa bindja fetare.

Kurëdo që u paraqitej rasti, ata kundërshtonin kundër fesë, njëjtë ashtu sikur edhe kundër udhëheqjes së pushtuesve të tyre. Historianët arabë shtojnë se njëzet herë kanë renegatur nga feja.2)

Në historinë e luftës së gjatë mund të gjenden vetëm disa aluzione të varfëra mbi konversionet.

Duket se kah islami nganjëherë i ka shpejtrë njohja se është e padobishme t'i kundërvihesh ushtrisë arabe.

Kur për herë të fundit Berberët i janë kundërvënë në pushtuesve në vitin 703, udhëheqësi i tyre i tmerrshëm dhe fallxhorja El-Lahina³) ka profetizuar se fati luftarak do të kthehet kundër tyre.

Ajo i ka dërguar bijtë e vet në llogarin ushtarak të komandantit musliman duke iu këshilluar që ta pranojnë islamin dhe të hyjnë në radhët e arikut. Vetë e zgjedhi vdekjen dhe luftën me bashkëqytetarët e vet në betejën e madhe, që e ka thyer forcën politike të Berberëve dhe ia nënshtroi Afrikën veriore Arabëve.

Është lidhur paqë me atë që Berberët të japin 12.000 luftëtarë në përbërjen e ushtrisë arabe. Nga ata janë formuar dy ushtri. Secila prej tyre është vënë nën komandën e njerëzit prej bijëve të El-Kahinës.4)

300

Me këtë dredhi të kyqjes së Berberëve në ushtrinë e tyre komandantët arabë kanë shpresuar që me dëshirën e tyre për pre lufte do t'i përvetësojnë për fenë e vet vetjake.

ushtria që ka dalur nga Afrika në vitin 711 që ta pushtojë Spanjën është përbërë prej 7000 Berberëve, nën udhëheqjen e Tarikut (edhe vet ka qenë Berber), kurse kanë qenë konvertitë të rinj në islam.

Thuhet se në islam kanë kaluar nga bindja e fuqishme.

Kanë qenë zgjedhur juristët (fakihët) dhe dijetarët Arabë, të cilët do t'i mësojnë dhe do t'i komentojnë fjalët e shenjta (ajetet) të Kur'anit dhe t'i mësojnë për çdo gjë që kërkon feja e re.5)

Musa, pushtuesi i madh i Afrikës, ka treguar zjarrin e vet fetar ndaj përparimit të islamit. Ka caktuar shumë të madhe të parave, që ia ka dhënë halifi Abdulmeliku, që t'i blejë robërit e këtillë nëse obligohen dhe dëftohen se do të bëhen bijë lojole të islamit.

"Pas çdo fitoreje gjithnjë një ënumër i caktuar robëresh do të ishte

në shitje. Ai ka bërë traditë të blejë të gjithë ata për të cilët ka menduar se kanë dëshirë ta pranojnë islamin, sikur edhe ata që kanë qenë me prejardhje fisnike, e përveç tyre edhe ata që janë dukur të fuqishëm dhe aktivë. Atyre ai së pari u ka propozuar ta pranojnë islamin. Nëse, pas kristalizimit të pikëpajës së tyre dhe përgatitjes që ta pranojnë të vërtetën e lartësuar, ata do të konvertoheshin në fenë më të mirë dhe nëse konvertimi i tyre do të ishte i sinqertë, i ka vënë në sprovë sipas aftësive të tyre.

Në rast se kanë treguar gatishmëri dhe talent të mirë, menjëherë i ka liruar dhe u ka dhënë komanda të larta në ushtrinë e tij. I ka përparuar sipas meritave.

Nëse do të ndodhte e kundërta, d.m.th. nëse nuk do tregonin prirje për punët e veta, do të ktheheshin në llogarin e përbashkët të robërve, që i ka takuar ushtrisë. Këtu, sipas zakonisht të përgjithshëm tek ata, do të çliroheshin dhe me rrahje do ta nxjerrnin atë që është e keqe tek ata.6)

Sa ka qenë kovnersioni i Berberëve sipërfaqësor mund të gjykohet nga ky rast. kur Omer b. Abdulazizi i devotshëm në vitin 100/718 e ka emëruar Ismail b. Abdullahun guvernator të Afrikës veriore, me të i ka shkruar dhjetë dijetarë islamë t'i mësojnë muslimanët Berberë me rregullat e fesë së tyre. Deri atëherë ata nuk kanë ditur që feja e tyre e re e ndalon përdorimin e verës.

301

Thuhet se guvernatori i ri ka treguar entuziazëm të madh që t'i përvetësojë Berberët për islam. Por nuk është i saktë mendimi që angazhimi i tij është i kurorëzuar me sukses të atillë që nuk ka mbetur asnjë Berber që nuk ka pranuar islamin.

Pa dyshim konvertimi i Berberëve ka qenë punë e disa shekujve.

Madje edhe deri në ditët e sotshme ata kanë ruajtur shumë prej bindjeve të veta primitive që janë në kundërshti me sheriatin e mirëfilltë.8)

Islami në mesin e tyre nuk është përforcuar deri sa nuk u bë lëvizje nacionale dhe ka qenë i lidhur me konstituimin e pushtetit të dinastive vendëse, nën sundimin e të cilit shumë Berberë kanë hyrë në rrethin e islamit. Para kësaj pranimin e kësaj feje e kanë konsideruar humbje të pavarësisë politike.

Nuk është këtu vendi që të flitet për ndryshimet e ndryshme politike. Ajo që meriton përmendjen në historinë e misionaritetit islam është paraqitja e Muralitëve (Almoravitëve), që mmeriton kujdesin e veçantë si lëvizje e madhe nacionale që i ka tërhequr fiset berbere në përbërje të shoqërisë islame (ebumma).

Kah fillimi i shekullit XI Jahja b. Ibrahim, udhëheqësi i Sanhoxhëve, një fisi berber sakaras, në kthimin e vet nga haxhi nga Mekkejam ka gjurmuar në qendrat fetare të Afrikës veriore për mësuesin e ditur e të devotshëm, që do të niset me të si misionar i

islamit në mesin e bashkëfistarëve të tij të padishë dhe me terrin e padijes të mbështjellur.

Në fillim ka konsideruar se është vështirë të gjendet njeriu që dëshiron ta lëshojë vetminë e et prej shkencëtari dhe t'i kundërvehet rreziqeve të Sahares. Në fund e takoi Abdullah b. Jasinin, personalitetin e aftë, mjaft të guximshëm që ta pranojë këtë detyrë të rëndë.

Ka qenë i devotshëm dhe asketik, i ditur në fe, në të drejtën e sheri'atit dhe dituritë tjera.

Nëse kthehemi në shekullin IX, do të shohim se thirrësit në isla kanë gjetur rrugën e vet ndër Berberët e Saharës, dhe në mesin e tyre kanë konstituar fenë e Pejgamberit, por atje ka hasur në pranim të dobët.

Abdullah b. Jasini ka parë se edhe ata që e kanë pranuar islamin mjaft e kanë mos përfillur kryerjen e ritualeve të veta fetare dhe u janë dorëzuar të këqijave të llojllojshme të rrezikshme.

302

Ai me zell i është dorëzuar punës së mundimshme që t'i mësojë gjërat e fesë së tyre. Por, fuqia me të cilën i ka çmmësuar nga të këqijat e tyre dhe përpjekje që me ndihmën e saj t'ua përmirësojë mirësjelljen, i ka tëhuajësuar simpatizerët prej tij. Kjo, kryesisht, e ka nxitur në abstenimin nga detyra e vet, lëshimi i këtij populli kryefortë dhe në vendiin që forcat e veta t'ia përkushtojë konvertimit në Sudan. Pasi që është motivuar që mos ta lëshojë punën, që më herët e ka ndërmarre, qe strehuar me simpatizerët që thirrja e tij i ka tubuar rreth tij në një ujdhesë të lumit Senegal. Këtu kanë ndërtuar ribotim (tegeu) dhe i janë përkushtuar ibadetit të përhershëm.

Ata Berberë që kanë qenë diç më të dhënur kah devotshmëria, përsiatje për turpin, që ua kanë larguar mësuesin e devotshëm nga midisi ityre, i ka shtyrë në pendim. Kanë ardhur të përunjtur në ujdhesën e tij duke kërkuar prej tij falje dhe marrjen e instruksioneve në të vërtetat e sigurta fetare.

Në këtë mënyrë, nga dita në ditë, rreth tij janë tubuar dhe është rritur grumbulli i ithtarëve, veçan nga Lamutoni, degës së fisit të Sanhaxhës. Numri iu është rritur dhe ka arritur rreth njëmijë persona. Pas kësaj Abdullah b. Jasini ka parë se ka ardhur koha për dalje në hapësirë për veprim. Ka kërkuar nga ithtarët e vet që ta shprehin falënderimin e vet All-Ilahut në këtë shpallje me të cilën i ka shpërngulur, e kjo është që njohjen për të t'ua përcjellin të tjerëve: "Shkoni te bashkëfistarët tuaj dhe mësoni ata me Ligjin e Zotit dhe frikësojini me denimin e Tij.

Nëse pendohen dhe i kthehen të Vërtetës, lëni në qetësi. Nëse refuzojnë dhe nëse vazhdojnë në mashtrimin e vet, do ta thërrasim ndihmën e Zotit kundër tyre dhe do të luftojmë me ta deri sa Zoti nuk gjykon ndër ne."

Pas kësaj çdo njeri ka shkuar në fisin dhe gjininë e vet dhe i ka këshilluar që të pendohen dhe sinqerisht të besojnë, por nuk patën sukses në këtë. Po ashtu pa sukses kanë qenë edhe orvatjet e vet Abdullah b. Jasinit. E lëshoi ribatin me shpresë se tash do t'i gjejë udhëheqësit berberë shumë më të disponuar që ta dëgjojnë thirrjen e tij.

Kah fundi i vitit 1042 u vendos në krye të ithtarëve të vet, të cilët i ka quajtur El-Murabitun (Almoravidët) - eri është marrë nga rrënja e njëjtë sikur ribati,9) d.m.th. vetëmia (manastiri) në ujdhesën e tij në 303

Senegal - dhe i ka sulmuar fiset fqinje dhe i ka detyruar ta pranojnë islamin.

Duket se sukseset që i ka pasur në ekspedicionet e vet ushtarake kundër fiseve në Saharë kanë qenë argumentet më të fuqishme nga i gjithë mësimi i tij sepse së shpejti vullnetarisht kanë ardhur që ta pranojnë fenë që siguron sukseset aq të shkëlqyeshme të ushtrisë së ithtarëve të vet.

Abdullah b. Jasini ka vdekur në vitin 1059, por lëvizja që e ka filluar ka jetuar pas tij.

Shumë fise pagane berbere kanë ardhur ta forcojnë numrin e vendasve të vet muslimanë.

Islamin e kanë pranuar si gjë për të cilën kanë luftuar. Si vërshim kanë dalur nga Sahara në Afrikën veriore, që më vonë të bëhen zotëri të Spanjes.10)

Ka mundësi që lëvizja tjetër e madhe nacionale që është krijuar ndër fiset berbere, me fjalë tjera shfaqja e Mevehidit (Almohadit) në fillim të shekullit XII ia ka afruar shoqërisë muslimane disa fise që deri atëherë kanë qenë larg nga islami.

Themeluesi i saj Ibn Tumarti e ka bërë popullarizuese mësimin fetar të tevhidit (Njësisë së Zotit) të kësaj bashkësie me punimet në gjuhën berbere. Në to në mënyrën e vet i ka komentuar themelet e mesimit islam. Në këtë ka shkuar edhe më tej duke i dhënë shpirtit nacional berber privilegj të veçantë duke urdhëruar që edhe ezani të jetë në gjuhën e tyre vetjake.11)

Përveç kësaj, disa fise berbere kanë mbetur pagane deri në fund të shekullit XV,12) por tendencë e përgjithshme ka qenë kyqja natyrore i këtyre të voglave në bashkësitë e mëdha.

Shekulli i XVI ka qenë dëshmitar i krijimit të një lëvizjeje aktive dhe përhapjes së fesë në magreb. Ka qenë i trasuar me reaksionin të nxitur me sukseset e forcave të krishtera në Spanjë dhe Afrikën veriore.

Kjo lëvizje ka dhënë impuls të fuqishëm minstitutionit të "murabitëve".13) Një numër i madh i tyre ka dalur nga ribaetet (manastiret) e veta ë jug të Marokos që të zhvillojnë fushatë të udhëzimit të qetë në fe nëpër tërë Magrebin duke e ringjallur fenë e

muslimanëve të pakujdesshëm dhe duke i kthyer në islam fiqinjët e vet paganë.14)

304

Në këtë lëvizje në përhapjen e mesimit të islamit kanë marrë pjesë edhe muslimanët e persekutuar nga Spanja, në çka është dhënë shenjë më herët (fq. 127). Kanë ardhur ta ndihmojnë Eshrafimin ose pasardhësit e Idris b. Abdullahut, që kanë ikur në Maroko para mllefit të Harun err-Rreshidit.15)

Nga Sahara shkenca islame së pari është përhapur në mesin e zezakëve të Sudanit.

Historia më e hershme e kësaj lëvizjeje është e mbështjellur me paqartësi. Duket pak e dyshimtë se Berberët kanë qenë ata që të parët e kanë futur islamit në vendet që i ujin lumenjt Senegal dhe Niger, ku kanë ardhur në lidhje me mbretërit paganë, prej të cilave psh. Gana dhe Songhaj janë mjaft të vjetra.16)

Dy fise berbere Lamtuna dhe Xhadala, që i përkasin familjes së Sanhaxhëve, veçan janë dalluar me zjarrin e tyre fetar në punën në kthimin e njerëzve në islam.17)

Me ndërjetësimin e tyre Murabitët (Almoravidët) kanë ndikuar në fiset pagane të Sudanit.

Sundimi i Jusuf b. Tashafinit, themeluesit të Marokos (1062) dhe sunduesit (emirit) të dytë të dinastisë murabite, ka qenë përplotë hyrje në islam. Shumë zezakë që kanë qenë nën sundimin e tyre kanë ardhur që ta njoftojnë mesimin e Muhammedit.18)

Në vitin 1076, Berberët, që një kohë e kanë përhapur islamit në mbretësinë e Ganës, e kanë larguar dinastinë sunduese. Supozohet se kjo është dinastia tulbe dhe kjo mbretëri është bërë plotësisht muslimane.

Në fillim të shekullit XII e ka humbur pavarësinë, sepse e kanë okupuar Mandingët.19)

Sa i përket hyrjes së islamit në mbretërinë Sanghaj, për të cilën thuhet se ka ekzistuar herët, rreth vitit 700, e kemi të shënuar se sunduesi i parë islam është quajtur Za-kassi, mbreti i pesëmbëdhjetë i dinastisë Za.

Kalimi i tij në islam vëhet në vitin 400/1009 - 1010. Në gjuhën sanghaje ai është quajtur Muslim-dam, që dëfton se islamit e ka pranuar nga vullneti i vet i lirë, e jo me presion, por nuk ka kurrfarë gjurme për ndikimet në të cilët e ka pranuar islamit.20)

Islami në Sudanin perëndimor

305

Në po atë shekull në Nigerin e epërm qenë themeluar dy qytete të cilët kanë pasur fatin, në shekujt vijues, të kenë ndikim të fuqishëm në zhvillimin e islamit në Sudanin perëndimor. Xhine21) është themeluar në vitin 435/1043-104422) dhe i është destinuar të bëhet qendër e rëndësishme tregtare. Kurse tjetri është Tinbuku, qendra e

rëndësishme e tregtisë me karavane nga veriu. Është themeluar diku rreth vitit 110 e.r.

Kunburu, mbreti i Xhines, u bë musliman kah fundi i shekullit VI Hixhrij (rreth vitit 1200 e.r.), kurse shembullin e tyre e kanë ndjekur edhe banorët tjerë të qytetit.

Kur ka vendosur ta pranojë islamin, Kunburu ka thënë që të tubohet tërë ulemaja e mbretërisë së tij. Numri i tyre ishte 4200 ulema (sado që ky numër ka qenë i tepruar, tregimi na tregon në atë se islami tashmë ka bërë përpari më të rëndësishëm në vendin me të cilën ka sunduar. Në praninë e tyre botërisht ka deklaruar se është musliman dhe ka kërkuar nga ulemaja ta lutin Zotin për prosperitetin e qytetit të tij.

Pas kësaj e ka rrënuar pallatin e vet dhe ka ndërtuar xhaminë e madhe²³) dhe vendin e tij.²⁴)

Përveç kësaj, Tinbuku ka qenë qytet musliman prej fillimit, kurrë nuk e ka përdhosur adhurimi i statujave, as që cilido njeri ka bërë sexhde (përrulje) kujt do qoftë tjetër pos All-llahut të Madhëruar.”²⁵) Disa vjet pas kësaj është bërë vend influencës i mësimit islam dhe devotshmërisë. Në nuër të madh në të kanë arritur studentët dhe ulemaja, të motivuar me trimërimin dhe mbrojtjen që aty e kanë gjetur.

Ibn Batuta, që i ka ecur këto vise kah mmesi i shekullit XIV, i ka lavduar zezakët për entuziazmin e tyre në kryerjen e obligimeve fetare dhe në studimin e Kur’anit. Ai na flet që nëse dikush nuk vjen më herët në xhuma në xhami, e ka të pamundur ta gjejë vendin për shkak të tollovisë së madhe.²⁶)

Në kohën e tij shteti më i fuqishëm i Sudanit perëndimor ka qenë Melle ose Malli, që e ka ngritur autoritetin e vet një shekull para kësaj, pas pushtimit të Ganes nga Mandingët, njërin nga popujt më të përparuar të Afrikës.

Leo Afrikani²⁷) (Africanus) i quan zezakët me të civilizuar, më mendjemprehtë dhe më të çuar. Udhëtarët modernë lavdojnë prodhimin, shkathtësinë dhe respektin e tyre.²⁸)

306

Mandingët kanë qenë misionarët më aktivë të islamit që e kanë përhapur në mesin e popujve fqinjë.²⁹)

Sipas Kano-kronikës, Mandingët e kanë njohur popullin e Hansit me islamin. Koha e këtij njoftimi nuk është e njohur,³⁰) siç është këtu rasti edhe me shumicën e datave të lidhur për historinë e shtetit të Hansëve, sepse Tulbët, që i kanë nënshtruar në filli të shekullit XIX, i kanë shkatërruar shumicën e shkresave të tyre historike.

Rëndësia e pranimit të islamit të Hansëve nuk mund të stërmadhohet. Ato janë popull punëtor e inteligjent. Shkathtësia e tyre e madhe në tregti iu ka sjell ndikim të madh në mesin e popujve të ndryshë mme të cilin kanë ardhur në lidhje. Gjuha e tyre është bërë

gjuhë e tregtisë të Sudanit perëndimor.

Dhe kudo që kanë shkuar tregtarët e Hansit - e kanë qenë të pranishëm prej bregut të Ginisë (Guinesë) deri në Kairo - ata kanë bartur edhe fenë islame.

Të dhënat për aktivitetin e tyre misionarist do të gjenden në faqet vijuese.

Por, për pranimin e tyre të islamit, sikur edhe shtatë shtetet dhe krahinat tjera të Hansëve që i përkasin,³¹⁾ të dhënat historike pothuaj se nuk ekzistojnë.³²⁾

Duhet se një prej misionarëve të dërguar në Kano dhe Katsen ka qenë mësues i ditur e i devotshëm nga Tilmisani. Ka qenë ky Muhammed b. Abdulkerim b. Muhammed el-Maxhili. Ka përparuar rreth vitit 1500.³³⁾

Ka pasur mundësi që Hansët kanë qenë nën ndikimin e hovit të madh të ndikimit islam që ka ardhur nga ana jugore e Egjiptit në shekullin XII,³⁴⁾

Tregtarët e Kardafanit dhe përgjithësisht të Sudanit lindor krenohen që ata rrjedhin nga Arabët që kanë shkuar atje pas rënies së hilafetit fatimit në vitin 1171.

Ka mundësi që ka pasur ndiki më të hershëm muslimanë që në Afrikën qendrore ka ardhur nga verilindja.

Nga Egjipti islami është zgjeruar në Kanem, mbretërinë në veri dhe verilindje të liqenit të çadit. Një kohë të shkurtër pasi që popullsia ka pranuar islamin, është bërë shtet me rëndësi të madhe dhe sundimin e vet e ka shtrirë në fiset e Sudanit lindor deri në kufinj të Egjiptit dhe Nubisë.

307

Thuhet se mbreti i parë muslimanë i Kanemit ka sunduar diku kah fundi i shekullit XI ose në gjysmën e parë të shekullit XII.³⁵⁾

Detajet që i posedojmë për përhapjen e islamit prej verilindjes janë shumë më të rrallë nga ata që i kemi përmendur më herët për historinë e shteteve të Sudanit perëndimor.

Vetë datat e konvertimit të sunduesve dhe vendosies së dinastive muslimane mjaft pak na flasin, por një fakt qartë na tregon nga këto të dhëna të varfëra historike: ngadalësia e madhe në procesin e përhapjes së islamit në këtë territor.

Ekzistimi i grupacioneve të mëdha pagane në qendër të territoreve, që me shekuj kanë qenë nën sundimin musliman, tregon se ndikimi i islamit gajtë ka mbetur i kufizuar në qytete dhe vetë shkallërisht ka gjetur rrugën në mesin e popullata pagane.

Në realitet, ndikimi islam nuk ka hasur në rezistencën aq të rreptë siç e kanë bërë paganët e Bambares (e kanë banuar Senegalin e epërm dhe Nigerin e epërm) ndonëse disa shekuj kanë qenë të rrethuar me popullatën muslimane.

I pasuksesshëm ka qenë tentimi i konvertimit të Bambarëve në

islam prej Murabitit Umar Kabit, në filli mtë shekullit XII.

Ky njeri ka themeluar vëllazëri të re fetare, që ka pasur lidhje me kadiritet. Kur nuk arriti t'i tërheq bashkëbesimtarët e vet në të, kujdesin e vet e kthei kah paganët e Bambarës. Ka tentuar t'i kthejë në islam dhe t'i kyq në radhën e vet.

Duket se ka qenë në rrugë të suksesit sepse para kësaj ka kthyer në islam fshatin pagan në krahinën Sansanding. Kur drejtuesi i kësaj krahine e përzuri këtë misionar jashtë kufijëve të krahinës së vet, iu ka urdhëruar konvertitëve të ri që të kthehen në besimin e vet të vjetër religjioz.³⁶)

Kurëdo që martesë reciproke ndërmejt këtyre popujve dhe të tjerëve, siç janë Arabët dhe Berberët, ka qenë e vëllimshme, procesi i përzjerjes është zhvilluar normalisht. Me këtë është lidhur aktiviteti misionarist i popullit Fulani (Fulbe), Hans dhe Mandingo, që janë shquar me entuziazë mtë flaktë në rrugën e fesë së vet. Rritja e popullatës muslimane do të ishte shumë më e madhe sikur mos të kishte luftëra vëllavrasëse, që kanë shkaktuar që një shtet musliman ta shkatërrojë tjetrin.

Populli i Mallit (Malit) është ngritur në gërmadhat e Ganes në shekullin XIII që të shkelen, në fillim të shekullit XVI, nga Songhajët, 308

kurse këta janë shkretëruar nga Morët (Arabët) vetëm një shekull më vonë.

Pasi këto shtete muslimane kanë rënë në masakrat e tmerrshëm, karakteristike për luftën në Sudan, fetishizmi e ka kthyer autoritetin e vet, që e patë humbur. Sikur ka qenë gjendja në botën e krishterë, po ashtu ka ndodhur edhe me botën islame. Ka pasur perioda kur forca e zjarrit misionarist ka rënë. Muslimanët në disa pjesë të Sudanit janë kënaqur me atë që ta lënë paganizmin që t'i rrethojë, dhe se nuk i intereson çfarëdo pune në përhapjen e islamit.

Në shekullin e XIV Tunxhar - Arabët janë shpërngulur nga Tunisi drejt jugut. Kanë kaluar nëpër Born dhe Nagjai drejt Darfurit, kurse të tjerët më vonë kanë arritur nga lindja.³⁷) Njëri prej tyre, me emrin Ahmed, qe pranuar dashamirësisht nga mbreti idhujtar i Darfurit. Ka pasur konsideratë ndaj tij dhe e ka emëruar mbikqyrës të punëve të shtëpisë së tij dhe me të është konsulltuar në të gjitha rastet.

Përvoja e tij me metodat më të larta civilizuese të udhëheqjes i ka mundësuar që të fusë reforma të numërta në punët ekonomike të shtëpisë së mbretit dhe aparatit shtetëror.

Thuhet se ai me udhëheqje të urtë i ka sjellur në dëgjueshmëri udhëheqësit e panështruar. Me ndarjen e tokës banorëve të varfër ia doli në krye grabitjeve dhe problemeve të përhershme të brendshme. Me këtë në vend ka futur ndjenjën e sigurisë dhe kënaqësisë, që më herët ka qenë e panjohur. Mbreti nuk ka pasur pasardhës mashkull. E ka martuar vajzën e vet për Ahmedin dhe e ka caktuar për

trashëgimtar të vetin. Zgjedhja që përshëndetur prej popullit. Dinastia muslimane, që në këtë mënyrë është vënë ka vazhduar të sundojë deri në këtë shekull.

ndikimi civilizues, që e ka kryer ky udhëheqës dhe pasardhësit e tij, pa dyshim është përcjellur edhe me punën e caktuar në përhapjen e besimit. Duket se këta Arabë të shpërngulur shumë pak kanë punuar në përhapjen e fesë së vet në mesin e fqinjve paganë.

Darfuri përfundimisht u bë me angazhimin musliman njeri prej sunduesve të tij që quhej Sulejman, kurse i cili ka filluar të sundojë në vitin 1596.³⁸) Deri në shekullin XVI islami nuk është përfarcur në mbretëritë tjera që qëndrojnë ndërmejt Kardofanit dhe liqenit të Çadit, siç janë Wadai dhe Baghirmi.

Mbreti i parë musliman Baghirmi ka qenë sulltan Abdullahu, që ka sunduar prej vitit 1568 deri 1608, por qendra kryesore e ndikimit 309

musliman në këtë kohë ka qenë mbretëria Vaxhi. E ka themeluar Abdukerimi rreth vitit 1612. Nuk ka mbaruar as pjesa e fundit e shekullit XVIII, kurse shumica e popullit Baghirit ka kaluar në islam.³⁹)

Historia e misionit musliman në Afrikë gjatë kohës së shekullit XVIII dhe XVIII. është shumë sipërfaqësore dhe krejtësisht e parëndësishme kur krahasohet me rilindjen e madhe të aktivitetit misionarist në shekullin e tanishëm.

Ka pasur nevojë për motivacion të fuqishëm që ta zgjojë energjinë e përgjumur të muslimanëve afrikanë, gjendja e të cilit, gjatë shekullit XVIII, është dukur pothuaj si gjendje e indiferentitetit fetar.

Zgjimi i tyre shpirtëror duhet t'i fënderohet ndikimit të reformacionit vehabit, në fund të shekullit XVIII.

Së këndejmi që në kohën bashkëkohore takohemi me rafortet mbi përhapjen e mësimin fetar në mesin e zezakeve, që nuk janë krejtësisht refuzues dhe të dobët sikur ata që pikërisht e kemi cekur. Ata na prezantojnë mjaft detaje për paraqitjen dhe përparimin e disa ndërmarrjeve të rëndësishme misionariste.

Rreth fundit të shekullit XVIII një njeri interesant, shejh Osman Danfadio,⁴⁰) u paraqit në mesin e Fulanëve (Fulbe)⁴¹) si reformator fetar dhe misionar luftarak.

Nga Sudani shkoi në Mekke që ta kryej haxhin. Nga aty u kthye plot zjarr e entuziazëm për reformë dhe thirrje në islam.

Ka rënë nën ndikimin e mësimin vehabit që, në kohën e vizitës së tij Mekkes, është rritur dhe forcuar.

Ka gjykuar faljen (lutjen) për shpirtin e të vdekurit dhe nderimin e evlijave të vdekur.

Ka gjykuar edhe teprimin në lavdimin e vetë Muhammedit.

Njëkohësisht i ka atakuar edhe dy turpe të Sudanit, dehja dhe jomorali.

Deri në atë kohë Fulbët (Fulanët) janë përbërë nga disa gjini të vogla të shpërndara, që kanë jetuar me jetë blegtori. Ata herët e kanë pranuar islamin. Deri në atë kohë kanë qenë të kënaqur me themelimin e kolonive blegtare dhe bujqësore në pjesët e ndryshme të Sudanit. Sipas lajmeve që i kemi për ta, në filli të shekullit XVIII janë prezentuar si popull i qetë e punëtorë. Nje udhëtar⁴²) që e ka vizituar vendbanimin e tyre në lumin gambia në vitin 1731 flet për ta: "Në çdo shtet dhe vend, në çdo prej brigjeve të lumit, ka popull më ngjyrë të 310

mbyllur. Quhen Fulzi (Pholeys, d.m.th. Fulbët-Fulanët). U gjasojnë Arabëve, gjuhën e të cilëve e flasin shumica, sepse e mësojnë në shkollat e veta, kurse mësojnë edhe Kur'an, që është ligji i tyre, në gjuhën arabe. Ata, përgjithësisht, janë më të ditur në arabishte se Evropianët në latinishte, për ç'arsye shumica mund ta flasin. Ata kanë edhe gjuhën e thjeshtë që e quajnë fuli (fulani).

Jetojnë në fise dhe gjiri. Ndërtojnë qytete, e nuk i nënshtrohen asnjë mbreti në vend, ndonëse jetojnë në territorët e tyre. Nëse ndonjë popull iu bënë keq, ata i rrënojnë qytetet e veta dhe shkojnë te populli tjetër.

Kanë eprorët e vet që drejtojnë aq maturisht që çdo punë e qeverisë duket si akt i popullit me tepër se sa akt i një njeriu.

Ky lloj i qeverisjes paraqet drejtim të lehtë, sepse populli është i mirë dhe me karakter të qetë, kurse mirë janë të udhëzuar ç'është e vërteta dhe e drejta. Ashtu ai që bënë keq gjykohet nga të gjithë.

Ata janë mjaft punëtorë dhe kursimtarë. Mbjellin drithë dhe pambukë më shumë se që shpenzojnë. I shesin me çmime të matura. Ata janë ashtu të respektuar për shkak të mikëpritjes së tyre sa që vendasit e vlerësojnë si bekim ta keshë në fqinjësi të vet qytetin fulani. Gjatë kësaj, sjellja e tyre u ka sjellur reputacion të tillë se u bë e turpshme që dikush të silelt keq me ta. ndonëse njerëzia e tyre shtrihet në të gjithë njerëzit, ata janë dyfish më të sjellshëm ndaj popullit të vet.

Nëse mësojnë që dikush nga bashkësia e tyre u bë rob, të gjithë fuulanet bashkohen që ta çlirojnë.

Pasi kanë mjaft ushqim, kurrë nuk lejojnë që dikush prej tyre të jetë në skamje, por i mbajnë pleqtë, të verbët dhe të gjymtit barabartë sikur edhe të tjerët.

Rrallë janë të zemëruar. Kurrë nuk kam dëgjaur që njëri tjetrin e shanë. Kjo maturi nuk buron nga dëshira për guxim, sepse janë të guximshëm sikur edhe çdo popull në Afrikë.

Janë mjaft të shkathtë në përdorimin e armëve të veta, që përbëhet prej shtizës, jataganëve (thikave) të shkurtër, harkut, shigjetës, e madje nganjëherë i përdorin edhe pushkët. Ata janë muslimanë striktë.

Rrallë që dikush prej tyre pinë raki ose çkado qoftë më të fortë se uji."

Danfadio i ka bashkuar në një organizatë të fuqishme këto

bashkësi të ndara nëpër krahinat e vogla të Hansit.

311

Kryengritja e parë ka ndodhur rreth vitit 1802, ende në mbretërinë pagane Gober, që pushtetin e vet e ka shtyrë deri në veriun skajor të vendeve të Hansit.

Mbreti i Goberit ka tentuar ta zbrapsë fuqinë në rritje të Fulbëve (Fulanëve) në vendin e vet, që ku shkaktuar që Danfadio të ngre kryengritje. Së shpejti u gjend në krye të ushtrisë së fuqishme që nuk i ka atakuar vetëm fiset pagane dhe ua ka imponuar fenë e Pejgamberit, por edhe krahinat islame të hansëve.

Kanë rënë një nga një edhe ato krahina, deri sa të gjitha vendet Hanse nuk u gjendën nën drejtimin e Danfadiut para vdekjes së tij në vitin 1816.

Varri i tij në Sokat ende është objekt i nderimit të vizitorëve të shumtë. Mbretërinë e ka ndarë ndërmjet dy djemve të vet. Ata po ashtu i kanë zgjeruar kufijt e pushtetit-fulba. Qyteti i Adamamëve, që është themeluar në vitin 1837 në gërmadhat e disa mbretërive pagane, paraqet kufirin e pushtimeve të tyre drejt juglindjes.

Qyteti Ilorin në krahinën Joruba, i themeluar gjatë jetës së Danfadios, është kufiri jugperëndimor i Pull-imperatorisë.

Me fat relativ fuqia e pushtetit ka mbetur në duart e Fulbëve (Fulanëve) gjatë shekullit XIX. Janë treguar propagandues të rreptë e fanatike të ismailit deri në rivendosjen e pushtetit britanik në Nigjeri në vitin 1900.

Aplikimi i ligjit dhe rendit në Nigjerinë jugore ka ndihmuar thirrjen në islam siç ka qenë rasti në pjesët tjera të Afrikës, që kanë ardhur nën sundimin e Evropianëve.

Muslimanët e Hansit, prej të cilëve disa i kanë takuar tarikatin (rendit) tixhanik, kanë mundur që të lëvizin lirisht nëpër tokë dhe të depërtojnë në mesin e fiseve pagane, të cilat, deri në atë kohë, në mënyrë fanatike dhe fuqishëm kanë penguar çfarëdo ndikimi musliman në mesin e tyre.

Thuhet se islami mjaft shpejtë është përhapur në vendet e Jorubit.

Ekziston legjenda për tentimin e pasuksesshëm të një misionari musliman në shekullin XI ose XII. Ky njeri ka qenë prej

Hansëve. Ka arritur në Ifa, kryeqendrën fetare të vendit pagan Joruba.

Ka filluar ta tubojë popullin dhe t'ua mësojë pjesët nga Kur'ani. Nuk e ka folur rrjedhshë gjuhën joruba. Me akcentin e huaj u ka përsëritur dëgjuesve të vet: "Ejani ta adhurojmë Allahun. Ai i ka krijuar malet dhe fushat. Ai ka krijuar çdo gjë, e edhe neve".

312

Këtë e ka bërë kohë pas kohe por nuk arriti ta kthejë në islam së paku një njeri. Vdiq pas disa muajve pas ardhjes në Ifa.

Pas vdekjes së tij ia kanë gjetur në dhomë Kur'anin të varur përgoçdhë në mur. Kanë filluar ta adhurojnë si fetish.⁴³⁾

Deri sa lajmëtarët e parë të kësaj feje janë zbrapsur bashkëfetarët e tyre bashkëkohor arrijnë suksese të shkëlqyeshme.

Në periodën e anarkisë, para okupimit britanik, shumica e

muslimanëve i ka banuar qytetet e mëdha me mur të rrethuar.

Por, në gjendjen e re të sigurisë, ata mund të banojnë edhe në fshatrat në afërsi të punëve të veta bujqësore. Kështu ndikimi islam filloi të përhapet shpejtë në këto vise.

Sikur , është dëftuar se ekzistoi i

muslimanëve në ushtrinë vendëse ndihma përhapjen e fesë së tyre.

Ushtarët paganë më së shpeshti e kanë pranuar islamin në mënyrë që t'i shmangen nënçmimit të botës dhe t'i sigurojnë vetes respekt.44)

Lëvizja kretësisht e re misionariste mund të vërehet edhe në

krahinën Igjeb, në jug të Nigjerisë. Në këtë pjesë të vendit islami ka hyrë tek në vitin 1893 dhe tashmë në vitin 1908 në një qytet ka pasur njëzet, kurse në tjetrin dymbëdhjetë xhamia.43)

Përhapja e shpejtë e islamit mund të vërehet veçanërisht bregut të lumit Niger në Nigjerinë jugore.

Një misionar i krishterë njofton: "Kur i kam lëshuar këto vise, ka pasur vetëm disa muslimanë nën qytetin Ide,46) por tash janë kudo pos Abo-s së poshtëm. Sipas shpejtësisë bashkëkohore të përhapjes së islamit, mezi se do të ketë fshat pagan në brigjet e lumit deri në vitin 1910."47)

Muhammed Osman el-Mirgini

Kështu, në këtë pjesë të Afrikës, ka qenë aktiviteti i madh

misionarist në thirrjen në islam prej njerëzve që nuk janë qetësuar deri sa nuk e arrijnë qëllimin e vet: konvertimin e paganëve.

Të këtillë kanë qenë shumë prej atyre që i kanë ndjekur principet fetare islame, që e kanë formuar ardhmërinë e shkëlqyeshme të jetës fetare të Afrikës veriore.

Përpjekjet e tyre kanë rezultuar me rezultate të mëdha gjatë shekullit XIX. Pa dyshim, shumë punë të tyre nuk janë evidentuar, por ende kemi lajme për disa lëvizje që këta misionarë i kanë filluar.

313

Një prej më të hershmeve është ai që lidhet për Si Ahmed b.

Idrisin48) që ka gëzuar autoritet të madh si mësues fetar në Mekke prej vitit 1797 deri 1833. Ka qenë udhëheqës shpirtëror i Hadaritëve. Para vdekjes në vitin 1835 e dërgoi një ithtar të vetin, që është quajtur Muhammed Osman el-Emir Gani, për rrugë në Afrikë për shkak të përhapjes së islamit.

E kaloi detin e Kuq deri në Kosajr, prej kah nëpër brendësi arriti deri në Nil. Këtu në mesin e popullatës muslimane e redukoi angazhimin e et kryesisht në përvetësimin e anëtarësisë për rendin që i ka takuar. Në këtë udhëtim, në rrjedhën e epërme të lumit, nuk ka pasur sukses më të madh deri në Asuanë. Prej Asuanit deri në Dongolë udhëtimin e ka pasur me plotë sukses.

Nubijët kanë nxitur të hyjnë në rendin e tij. Pompa mbretërore me të cilën është rrethuar i bënte në këtë botë përshtypje të thellë. Njëkohësisht, zëri për kerametet (çuditë) e tij i ka tërhequr këtë mjaft ithtarë.

Në Dongolë Muhammed Osmani e lëshoi luginën e Nilit dhe shkoi për Kardafan, ku mbeti gjatë kohë. Këtu filloi me punën misionariste në mesin e pabesimtarëve.

Shumë fise të këtij vendi rreth Sennarit kanë qenë pagane. Thirrja në fenë e Muhammed Osmanit në mesin e tyre ka pasur sukses të plotë. Që ndikimin e vet në mesin e tyre ta bëjë të përhershëm, ai u martua me disa gra të tyre. Pasardhësit e tij prej tyre, pas vdekjes së tij në vitin 1893, kanë vazhduar me aktivitetin e rendit që ai e ka themeluar, kurse i cili më vonë është quajtur sipas emrit të tij: elmirganije. 49)

Disa vjet para udhëtimit misionarist të uammed Osmanit, ushtria e Muhammed Aliut, themeluesit të dinastisë aktuale sunduese të Egjiptit, pa të filluar me shtrirjen e pushtimeve të veta në Sudanin lindor. Misionarët e disa rendeve fetare në Egjipt kanë qenë përmbajtur nga qeveria egjiptiane, me shpresë që përpjekjet e tyre do ti ndihmojnë qetësimin të vendit. Kanë vazhduar me përhapjen e misionit në territorët e pushtuara rishtas, ku kanë punuar me shumë sukses. Madje edhe kryengritja e paradokohshme nën udhëheqjen e Mehdiut ka qenë ndihmuar me zjarrin fetar që e ka nxitur thirrja e tyre. 50)

Kadiritët dhe tixhanitët

314

Në Afrikën perëndimore dy rende (tarikate) sidomos e kanë ndihmuar përhapjen e islamit. Këta kanë qenë kadiritët dhe tixhanitët. I pari është njëri prej rendeve fetare më të përhapur në islam. Është themeluar në shekullin XII nga Abdulkadir Gjilaniu. Konsiderohet se ai ka qenë evlijau më i popullarizuar dhe më i njohur islam. 51) - Tarikati kadirit ka hyrë në Afrikën perëndimore në shekullin XV. E kanë sjellur dy refugjatë nga Tuota, një oazë në gjysëmshpeshën perëndimore të Saharës.

Valatin e kanë bërë qendrën e parë të organizatës së vet, por më vonë pasardhësit e tyre janë larguar nga ky qytet. Kanë gjetur strehim në Timbuktu, në lindjen skajore.

Në fillim të shekullit XIX rilindja e madhe shpirtërore, që e ka përfshirë botën islame, i ka nxitur kadiritët e Saharës dhe Sudanit perëndimor në jetën dhe aktivitetin e ri. Nuk ka kaluar gjatë, e teologët e ditur ose grupacionet e vogla të njerëzve u kyqen në rende. Kanë mundur të gjenden nëpër Sudanin perëndimor, prej Senegalit deri te gryka e Nigerit.

Qendrat kryesore të organizatës së tyre misionariste kanë qenë në Kaukai, Timbn (në kodrat Futah-Xhallon) dhe Musardu (në vendin e

Mandingëve).52)

Këta persona të udhëzuar kanë bërë qendrat e ndikimit islam në qendër të popullatës pagane, të të cilët janë pranuar duarhapur. Si shkrues popullor, juristë, shkrues të hajmalive (nuskave), mësues pak nga pak kanë arritur supremacion dhe ndikim mbi fqinjët e tyre të ri. Rastet individuale të konversionit së shpejti u rritën në grupe të vogla konvertitësh.

Ata që më shumë kanë premtuar shpesh i kanë dërguar t'i plotësojnë studimet e veta në qendrat kryesore të rendit ose në shkollat e Kajrevanit ose Tripolit ose në unviersitetet e Fesit dhe El-Ez'herit në Kairo.53)

Atje i kalonin disa vjet deri sa i plotësonin studimet e veta teologjike. Atëherë ktheheshin në vendlindje, plotësisht të gatshëm për punë në përhapjen e fesë në mesin e bashkëqytetarëve të vet. Në këtë mënyrë mikrobi hynte ndër paganët dhe idhujtarët. Ndonëse ngapak, islami përhapej sigurt dhe pandërprerë. Më së shpeshti kjo ka ndodh pa u vërejtur.

315

Mësuesit, deri në gjysmën e shekullit XIX, kanë themeluar dhe drejtuar me shumicën e shkollave në Sudan. Këta mësues janë edukuar nën patronatin e kadiriteve dhe organizatës së tyre, që ka qenë e furnizuar me sistemin e plotë e të përhershëm të propagandës në mesin e fiseve pagane.

Puna misionariste e këtij rendi ka qenë e karakterit krejtësisht të qetë. Plotësisht është mbështetur në shembullin personal dhe udhëzim, në ndikimin e mësuesit në nxënësit e tij dhe në përhapjen e arsimimit.54)

Në këtë mënyrë misionarët kadirit të Sudanit janë treguar strikt ndaj principeve të themeluesit të vet dhe traditës së përgjithshme të këtij rendi.

Principet kryesore, që kanë dominuar me jetën e Abdulkadirit, kanë qenë dashuria ndaj fqijut dhe toleranca.

Mbretërit dhe pasanikët ua kanë dërguar të deleguarit e vet.

Fisnikëria e tij e paskajshme e ka mbajtur në varfëri. Në librat dhe vazet e tij nuk mund të gjendet çfarëdo qoftë shprehje me qëllim të keq ose me armiqësi ndaj të krishterëve.

Kurdo që flitte për "njerëzit e librit", gjithnjë ka shprehur keqardhjen e tyre për gabimet e tyre fetare dhe e ka lutur Zotin që t'ua ndriçojë rrugën.

Nxënësve të vet ua ka lënë porosi këtë sjellje tolerante, që ka qenë karakteristike evidente e ithtarëve të tij nëpër të gjitha epokat.55)

Tixhanitë i përkasin rendit që është themeluar në Algjeri në fund të shekullit XVII. Prej stabilizimit të tyre në Sudan, rreth gjysmës së shekullit XIX, i kanë ndjekur metodat e njëjta misionariste sikur edhe kadiritët. Shkollat e tyre të numërta e të shtrira iu kanë ndihmuar në

propagandimin e fesë. Por tixhanitë, për dalli mnga kadiritët, nuk janë ngurruar ta përdorin edhe shpatën dhe të ndihmohen me të në përparimin e mënyrës së vet të konvertiit në fe.

Nëse korrektësisht vlerësohet puna e këtyre misionarëve në thirrjen në islam në Afrikën perëndimore, do të gjendet, fatkeqësisht, se lavdia e xihadit të tij ose luftëra fetare i ka hedhur në hije sukseset e propaganduesve të qetë. Puna e këtyre të fundit ka qenë më e efektshme për përhapjen e islamit nga themelimi i dinastive të vogla jetëshkurtër.

Lajmet për ekspeditat luftarake, veçan kur janë gërshetuar me planet tregtare dhe pushtuese të njeriut të bardhë, natyrisht më shumë

316
e kanë tërhequr vëndjen e Evropianëve se sa puna e paimponuar e misionarëve muslimanë dhe mësuesve të tyre.

Por, historia e lëvizjeve të tilla dhe mësuesve të tyre e ka këtë rëndësi, që - si ka ndodhur shpesh edhe në rastin e misioneve të krishtera-pushtimet i hapin fushat e reja të aktivitetit misionarist, duke krijuar në shpirt bindjen e fuqishme për ekzistimin në shpirt bindjen e fuqishme për ekzistimin e vendeve të gjëra të Tokës popullësia e së cilës ende nuk është konvertuar.

I pari prej lëvizjeve propaganduese ushtarake pjesës së rendit tixhanit e lidh fillimin e vet për El-Haxh Omerin. Ai ka hyrë në këtë tarikat nëpërmjet njërit prej liderëve të tij, të cilin e ka njohur në Mekke.

Është i lindur në vitin 1797 afër Podorës në Senegalin e poshtëm. Duket se ka qenë njeri me manire fisnike, me ndikim personal dhe pamjes që ka dhënë autoritet.

Është bir i një Murabiti dhe ka marrë arsiim serioz fetar. Ka qenë tashmë i njohur sipas dijes dhe devotshmërisë së vet kur u nisë për në haxh në Mekke në vitin 1827. Nuk u kthye në vendin e vet deri më 1833, kur aktivisht ka filluar ta propagandojë mësimin e rendit tixhanit.

Rrept i ka sulmuar bashkëfetarët e vet për shkak të padijes dhe neglijencës, veçan shejkët kadiritë toleranca tradicionale e të cilëve ka nxitur mllefin e tij.

El-Haxh Omeri kaloi në Sudanin qendror. Fitoi shumë ithtarë dhe arriti autoritetin e shpëtimtarit të ri (el-mehdiut). Rreth vitit 1841 arriti deri te mali Futih-Xhallon, ku i ka armatosur ithtarët e vet dhe e filloi serinë e ekspeditave për përhapjen e fesë në mesin e fiseve që ende kanë qenë pagane dhe të banuara rreth Nigerit të epërm dhe Senegalit. Në një prej këtyre fushatave e gjeti vdekja më 1965.

I biri i tij Ahmedu Shejhu arriti t'i bashkojë disa provinca në shtetin e babait të tij, por vetëm për disa vjet.

Konfliktet e brendshme dhe depërtimi i Françezëve e kanë thyer imperatorinë tixhanite, kurse territoret e tyre kanë ardhur nën

sundimin e Francës.56)

Disa vërejtje tashmë janë dhënë për hyrjen e islamit në këtë pjesë të Afrikës.

317

Farën që këtu e mbolli Abdullah b. Jasini dha shokët e tij, është ushqyer me kontaktet e përhërshme të tregtarëve muslimanë, mësuesve dhe Arabëve nga oazat el-Havda e të tejtra.

Udhëpërshkruesi i shekullit të XV flet për atë se si Arabët janë përpjekur t'i mësojnë krerët zezakë me sheriatin (ligjin) e Muhammedit, duke iu shpjeguar se është turp të jenë udhëheqës, të jetojnë pas kurrfarë ligji të Zotit dhe të punojnë si njerëzit e thjeshtë, që ka jetuar pa kurrfarë ligji.

Nga kjo mund të shihet se këta muslimanët e parë kanë përdorur karakteristikat imponante të fesë islame dhe rregullimin e saj që të ndikojnë në mendjet e këtyre njerëzve të egër të pakulturë.57)

Kemi detajet për lëvizjen e këtij lloji që është më i ri se i sipërmi.

Është nisur në jug të Senegambisë nga një Manding. Është quajtur Samudu, i njohur me emrin Samari, pagan dhe ushtar i lumturisë.

Është lindur rreth vitit 1846. Musliman është bërë herët, në kulmin e fuqisë. E ka themeluar imperatorinë në jug të Senegambisë në territoret që i ujiti Nigeri i Epërm dhe degët e tij.

Një raport arab për karrierën jetësore të Samarit, i shkruar nga kronistët e vendit, na ofron hollësi interesante për të arriturat e tij.

Ai fillon kështu:

“Ky është rrëfim për xhihadin e imam Ahmedu Sammu-du-os, një mandingu... Zoti ia ka dhënë ndihmën e Vet, prej kur ka filluar me vizitat paganëve, idhujtarëve, që jetojnë ndërmjet deteve dhe vendeve të Vasulit. I ka vizituar për shkak të thirrjes që ta ndjekin fenë e Zotit islamin. Le ta dijë ai që këtë e lexon se aksioni i parë që e ka ndërmarrë imam Sammu-du ka qenë qyteti që quhet Fulindi. Sipas librit, sheriatis deh Sunnetit (traditës), ai ia ka dërguar të deleguarit mbretit në qytet, me emrin Sindidu. E ka ftuar që t'i nënshtrohet pushtetit të tij, ta lëshojë idhujtarisë dhe ta adhurojë Një Zot, të Lartësuar, të Vërtetë, adhurimi i të cilit i ka shërbyer krijesave të tij në këtë dhe në botën tjetër, por ata kanë refuzuar nënshtueshmërinë.

Ai atëherë u ka caktuar xhizjen, si iu ka urdhëruar Kur'ani shtetasve të tij, por ata kanë mbetur në rendin dhe shurdhërinë e vet. Imami atëherë tuboi fuqinë e vogël, rreth pesëqind njerëz, të guximshëm e krenarë për xhihad. E sulmoi këtë qytet, Zoti i ka ndihmuar kundër tyre dhe ia ka dhënë fitoren ndaj tyre. I ka ndjekur me kalorinë e vet deri sa nuk janë dorëzuar. Më nuk janë kthyer

318

idhujtarisë së vet. Prej atëherë të gjithë fëmijët e tyre në shkollë mësojnë përmendsh Kur'anin, diturisë fetare dhe edukatën e bukur.

Lavdia i qoftë Zotit në këtë."58)

Është e pamundur këtu të ndiqen pushtimet e tij, që kanë qenë plotë mbytyje dhe shkretërim të plotë.59) E ka arritur kulminacionin e fuqisë së vet në vitin 1881 pak më parë se të vijë në konflikt me Françezët, që e kanë robëruar në vitin 1898 pas shumë përlëshjeve të mundimshme të njëpasnjëshme. Vdiq në 1900.

Kështu efekti i pushtimeve të tij ka qenë shkatërrimi i numrit të madh të paganëve, që kanë qenë të mbytur nga ushtarët e tij të rreptë, deri sa të tjerët kanë qenë të tmerruar dhe vetëm sipas emrit e kanë pranuar islamin.

Duket se ai nuk ka shkuar drejt qëllimit të njëjtë të qartë fetar drejt së cilës ka shkuar El-Haxh Omeri.60)

Ai Murabitëve kadirit u ka dhënë punë të mundimshme të propagandës. Ata me tolerancën e njohur tradicionale kanë tentuar t'i zbusin veprimet e tyre të ashpra.61) Hapin shkolla në qytetet e pushtuara dhe e forcojnë organizimin e punës së vet. I mësojnë të ardhurit rishtas në islam dhe përpiqen të përvetësojnë muslimanë të rinj.

Duke i soditur këto lëvizje ushtarake të propagandës muslimane, është me rëndësi të vërehet se sukseset ushtarake dhe pushtimet territoriale nuk i kanë kontribuar shumë përparimit të islamit në këto treva.

Qatë u tregua se konvertimi i detyrueshëm i njerëzve, që e ka zbatuar El-Haxh Omeri, shpejtë është harruar, pos në pjesët më të vogla të shtetit të tij që, përfundimisht, kanë mbetur në duart e trashëgimtarëve të tij.

Përkundër madhësisë së suskeseve të tij të përkohshme dhe entuziazmit të ushtrisë së tij, shumë pakë ka mbetur përkujtim në këtë propagandë ushtarake.62)

Rëndësia e vërtetë e këtyre lëvizjeve në historinë misionariste të islamit në Afrikën perëndimore është entuziazmi fetar që e kanë nxitur kurse i cili është dëftuar në aktivitetin misionarist larg të zgjeruar të karakterit krejtësisht të qetë në mesin e popullësisë pagane.

Këta xhihadë (luftëra fetare), nëse kundrohen korrektësisht, s'janë gjë tjetër pos incidente përcjellëse të zgjimit modern islam dhe ata nuk

319

kanë karakter të virtytit të forcave dhe aktiviteteve që njëmend kanë vepruar në paraqitjen e islamit në Afrikë.

Përndryshe, këto luftëra nuk i ka përcjellur ndonjë punë e veçantë misionariste. Ata gjithnjë kanë dëftuar paaftësi të plotë në krijimin e shoqërisë së vërtetë islame.

Është fakt se luftërat rrënuese dhe egërsia e tmerrshme e pushtuesve çfarë kanë qenë El-Haxh Omeri dhe Samari, e veçan emisarët e tixhanitëve, kanë shkaktuar që besimi islam të urrehet të fiset pagane të Sudanit, në vendet që njiten me Senegal dhe Niger.

Armiqësia ndaj islait gjithnjë ka marrë formën e lëvizjes nacionale, por edhe përveç kësaj propaganda islame e ka përhapur fenë e Pejgamberit në shumë pjesë të Guinesë dhe Senegambisë. Këto janë vise në të cilat Fulbe⁶³) dhe tregtarët nga vendet e Hansit me udhëtimet e veta të shpeshta tregtare e kanë sjellur edhe diturinë e fesë së tyre. Kanë arritur gjatë shekullit të kaluar dhe këtij të tërheqin nummër të madh konvertitësh.

Sidomos dallohet aktiviteti i propaganduesve kadirritë dhe tregtarëve muslimanë, që i kanë përvetësuar konvertitët e ri në fenë e vet prej kur okupacioni francez i solli paqë vendit. Ky depërtim i qetë i fesë ka qenë lehtësuar në Sudanin francez, sikur edhe në viset e Afrikës, të cilët prej para do kohësh erdhën nën sundimin e forcave evropiane.

Lehtësimi ka ardhur sandejmi që sunduesit francezë diç më privilegjueshëm kanë shikuar në shtresat e arsimuara, në mesin e të cilëve më së shumti ka pasur muslimanë. Për dalli mprej tyre, nëpunësit qeveritarë me nënçmim kanë shikuar në zakonet e këqia dhe bestytnitë të përhapura të idhujtarët paganë.⁶⁴)

Senusitë

Puna në përhapjen e islamit që e kanë zhvilluar senusitë nuk mundet në asnjë rast të sillet në lidhje me dhunën ose luftën. Në shërbim të fesë janë përdoruar vetëm mjetet e qeta dhe bindjet. Juristi (fekihu) algjerian i quajtur Sidi Muhammed b. Ali Es-Senusi në vitin 1837 e themeloi shoqatën fetare me qëllim të reformave në islam dhe përhapjes së fesë.

Para vdekjes në vitin 1859 arriti ta themelojë shtetin teokratik me fuqinë e gjenialitetit të vet, pa gjakderdhje. Ithtarët e tij dëftojnë 320

besnikërinë e shtetasit shtetit kufijt e të cilit, për çdo ditë, i zgjerojnë trashëgimtarët e tij.⁶⁵)

Anëtarët e kësaj vëllazërie (rendi) i përmbahen, deri në hollësi, sjelljes së mirë sipas normave të Kur'anit, në pajtim me monoteizmin e pastër. Këta janë principet e dëgjueshmërisë All-llahut të Vetëm. Plotësisht ndalohet kërkimi i ndihmës prej evlijave dhe vizitës së varreve të tyre.

Janë detyruar të heqin dorë nga kafeja dhe duhani, t'u shmangen të gjitha lidhjeve reciproke me Hebraikët dhe të krishterët. E kanë ndihmuar shoqërinë me ndarjen e pjesës së caktuar të mjeteve nga të ardhurat e veta, nëse vetë nuk kanë ditur të angazhohen në shërbim bashkësisë.

Ia kanë përkushtuar të gjitha forcat e veta përparimit të islamit duke iu kundërvënë, njëkohësisht, cilit do lloj të ndikimit evropian. Kjo bashkësi është zgjeruar nëpër tërë Afrikën veriore. Zavitë (teqet) e saj janë të shpërndara prej Egjiptit deri në Maroko, kurse në brendësi shtrihen nëpër oazat e Saharës dhe Sudanit.

Qendra e kësaj organizate gjendej në oazën e Xhagbubës(66) në shkretëtirën e Libisë, ndërmjet Egjiptit dhe Tripolit. Në të çdo vit janë aftësuar me qindra misionarë, pastaj janë dërguar në të gjitha pjesët e Afrikës veriore.

Prej zavisë në këtë fshat të gjitha zavitë tjera - degët (e konsiderohet se kanë qenë 121) i kanë marrë udhëzimet dhe urdhëresat në të gjitha pyetjet të lidhura për rregullimin dhe zgjerimin e këtij shteti të madh teokratik, që ka kyqur me rregullimin e vet të shkëlqyeshëm mijëra persona racash dhe nacionalitetesh të ndryshme. Sikur situata mos të ishte e këtillë, dallimet gjeografike dhe intereset e kësaj bote do t'i ndanin këta nga ata.

Pasi ka qenë sukses i fuqishëm, që e kanë sendërtuar këta emisarë vetëmohues dhe energjik, ekzistimi i ithtarëve të tyre nuk është kufizuar në Afrikën veriore, prej Egjiptit deri në Maroko, nëpërmjet Sudanit, Senegambisë dhe Somalisë, por ithtarët e kësaj vëllezërie mund të gjenden edhe në Arabi, Mezopotami dhe në ujdhesat e arkipelagut të Malajeve.67)

Ndonëse senusitë në filli mkanë qenë lëvizje reformiste brenda islamit, ata njëkohësisht janë aktiv edhe në përhapjen e mësimit islam. Disa fise afrikane, që para kësaj kanë qenë pagane, ose muslimanë 321

vetëm në emër, kur emisarët e rendit senusijë kanë hyrë në midisin e tyre, janë bërë ithtarë të zjarrtë të fesë së Pejgamberit.

Shembull i kësaj është puna e misionarëve senusijë në konvertimit e pjesës së Beolëve (fisi që e ka banuar trevën kodrinare të Ennedisë, në lindje prej Barku-as) që ende kanë qenë paganë. Një pjesë e këtij fisi entuziazmin e vet fetar e ka sjell në pjesën tjetër të fisit që ka pasur vetëm dije sipërfaqësore për islamin dhe kanë qenë muslimanë vetëm sipas emrit.68)

Kur senusitë erdhën në mesin e popullit Tedas në viset Tu ose Tibisti, në Saharë, në jug nga oaza Fezzan, që po ashtu kanë qenë vetëm sipas emrit, kanë qenë dëshmitarë të suksesit të përpjekjes dhe angazhimit të tyre.69)

Misionarët e këtij rendi po ashtu janë bartës të propagandës aktive në vendin e Gallëve, në të cilën çdo vitë kanë dërguar misionarë nga Herari, ku senusitë kanë qenë mjaft influencues. Pa përjashtim, shumë krerë të pallatit të emirit kanë qenë anëtarë të tyre.70)

Për shkak të ndihmës në përpjekjet në përhapjen e fesë këta misionarë kanë hapur shkolla dhe kanë formuar qendra në oazat shkretinore. Është rast evident në Wadai. Numër të madh të ithtarëve kanë arritur edhe me blerjen e robërve që i kanë arsimuar në Xhagbubu, dhe kur u është dukur se janë aftësuar jaft në mësimin e rendit, i kanë liruar dhe i kanë kthyer prapa në vendlindje t'i kthejnë në islam vëllazërit e vet.71) Duket se ndikimi i këtij rendi tash është në rënie.72)

Oftë edhe të parëndësishme, këto lajme për punën misionariste të muslimanëve në mesin e fiseve pagane të Sudanit janë me rëndësi duke e marrë parasysh mëngësinë e përgjithshme të informatave për përhapjen e islamit në këtë pjesë të Afrikës.

Por, deri sa evidenca dokumentarike është në mëngësi, deri atëherë qëndrimi i bashkësive muslimane në midisin e fetishistëve dhe idhujtarëve, si përfaqësues të besimit dhe civilizimit më të lartë, janë provë e gjallë e misionarëve muslimanë në përhapjen e fesë (sidomos në kufirin jugperëndimor të ndikimit islam) dhe paraqesin dallimin shprehës fiseve pagane moralin e të cilave e ka rrënuar tregtia evropiane me alkohol.

Këtë kontrast mirë e ekspozon udhëpërshkruesi bashkëkohor⁷³) kur flet për gjendjen nënçmuese të fiseve të Nigerit të Poshtëm: "Deri sa kam lundruar lumit përpjetë (Nigerit), në 200 millet e para ka parë pak 322

sosh që e ndërron pikëpamjen time. Këtu kanë marrë hov në unitetin e afërt fetishizmi, kanibalizmi dhe tregtia me alkohol.

Por kur pas vetes kam lënë vendin e ulët bregdetar dhe jam gjetur afër kufirit jugor të asaj që quhet sudani jugor, kam vërejtur përmirësi të konsiderueshme në virtytet e jashtme dhe morale të vendasve.

Kanibalizmi u zhduk, kurse në këtë e ka ndjekur zhdukja e idhujtarisë.

Me të madhe u zhduk edhe tregtia me alkohol. Rrobet janë bërë më të mëdha e më komode. Pastërtia u është tradicionale, kurse pamja e tyre e jashtme është më dinjitare, që, më tej, ka paralajmëruar përtëritjen normale.

Çdo gjë çonte në embrionin e një parimi më të lartë, principin që aq thellë ka ndikuar në natyrën e zezakëve që prej tij ka krijuar njeriun e ri.

Ndoshta do të befasoheni kur të mësoni / se ky parim është - islami.

Kur ka kaluar pranë Lokogjes, në përbërjen e Benes me Nigerin, pas vetes kam lënë qendrat misionariste të islamit. Duke hyrë në Sudanin qendrar, jam gjetur në shtetin relativisht mirë të drejtuar përplotë me grupe aktive të tregtarëve të mençur dhe njerëzve të shkathët në prodhimin e tekstit, bakrit dhe lëkurës. Ky është popull që ka bërë përparim të madh drejt civilizimit."

Që të fitohet vlerësimi i plotë i aktivitetit misionarist të islamit në Afrikën e zezë (Nigritia), nuk guxon të heqet nga mendja vijuesja: deri sa në breg dhe përgajtë kufirit jugor të sferës influencuese të islamit misionari musliman ka qenë pionier i fesë së vet, nga ana tjetër ende pas tij ka mbetur fushë e gjerë për propagandën islame në brendi të vendit, të cilat janë shtu drejt veriut dhe lindjes, edhe përkundër asaj që islami në këto treva i ka forcuar rrënjët ende më herët.

Një pjesë e Fungjit, racës zezake që ka dominuar me Semanarin, kanë qenë muslimanë, kurse të tjerët kanë qenë paganë. Tregtarët

muslimanë nga Nubia këta të fundit kanë tentuar t'i kthejnë në islam.74)

Fisi pagan Gjukur,74) shteti i fuqishëm i të cilit është zhdukur para zhvillimit triumfal të Fulbëve, ka arritur t'i kundërvihet ndikimit në rritje të islamit ndonëse ministri i punëve të jashtme të mbretit të tyre ka qenë gjithnjë musliman, kurse të shpërngulurit e Hansëve dhe muslimanëve të tjerë janë vendosur në mesin e tyre. Këta të shpërngulur nuk kanë arritur ta kthejnë në islam askënd nga Gjukurët.

323

Tradita e tyre e lavdisë së vjetër ka bërë që fuqishëm m't'i përmbahen besimit të vet nacional. Udhëheqja shpirtërore iu është prezentuar në figurën e mbretit të tyre.76)

Është lehtë të numrohen shumë pjesë të popullsisë së Sudanit dhe Senegambisë, që ende i ruajnë traditat e veta dhe besimet pagane ose këtë e mbulojnë me ritualet islame, qoftë, në rastet më të shumta, me shekull janë të rrethuar me ithtarët e Pejgamberit.

Konnhosi, një degë e fisit të madh Mandingo, ende në pjesën më të madhe janë paganë. Vetë viteve të fundit ka përparuar në mesin e tyre.77)

Si pasojë e kësaj është entuziazmi i pazakonshëm ndaj punës misionariste, që është zhvilluar në mesin e muslimanëve të kësaj treve gjatë këtij shekulli, ndonëse nuk ka gjetur fushë të gjerë në të cilën do ta zhvillonte veprimtarinë e vet.

Rëndësia në historinë misionariste të islamit anifestohet në këtë kontinent të lëvizjeve reformatore brenda vetë islamit dhe në përtëritjen e jetesës fetare vetjake të muslimanit. Këto janë pyetjet në të cilat më herët kemi tërhequr vëmendjen.

Islami në bregun perëndimor të Afrikës

Bregu perëndimor i Afrikës është fusha e dytë e ndërmarrjes misionariste islame. Kështu islami është ballafaquar me popullsinë e shumtë që ende nuk është konvertuar përkundër përparimit që ka pasur në bregun e Guinesë, Sierra Leones dhe Liberisë, ku, në fund, ka më shumë muslimanë se sa paganë.

Një prej aktiviteteve më të hershme të hetuara në fqinjësi të Sierra Leones mund të gjendet në lutjen për shpërndarjen e Kompanisë Sierra Leone. Shkrimin e saj e urdhëroi Shtëpia e Poshtme (House of Commons) më maj 1802. "Jo më shumë se para 70 viteve, një numër i vogël muslimanësh u vendos në vendin larg rreth 40 mila në veri prej Sierra Leones, kurse e kanë quajtur Vendi i Mandingëve. Si është në praktikën e kësaj feje, ata i kanë themeluar shkollat në të cilat mësohej gjuha arabe dhe doktrinat e Muhammedit, pastaj zakonet islame. Është e nevojshme të përmendet se ata nuk e shesin si rob askënd nga bashkëbesimtarët e vet.

Ligjet e futura janë vënë me Kur'an. Praktika që kryesisht i ka kontribuar shpopullëzimit së Bregut është çrrënjësor dhe, përkundër

324

shumë përçarjeve të brendshme, është futurpërpjestimisht shkallë e madhe e civilizimit, unitetit dhe sigurisë.

Për këtë arsye popullësia është rritur shpejtë dhe tërë pushteti në territor që e banojnë ka kaluar shkallërisht në duart e tyre.

Ata që mësojnë në shkollat e tyre kanë marrë pasuri dhe pushtet edhe në vendet fqinje dhe kanë sjellur me vehte një pjesë të konsiderueshme të trashëgimisë së fesë dhe zakonit të vet.

Krerët tjerë i kanë pranuar emrat, që për veti i kanë pranuar këta muslimanë për shkak të autoritetit që i ka përcjellur. Duket i mundshëm që islami është përhapur qetësisht në tërë trevën ku gjendet kolonia (e Mandingëve), duke bartur me vete ato përparësi të cilat, si duket gjithnjë i shërbejnë fitores së tij ndaj bestytnisë zezake."78)

Në vendin Mendi, rreth njëqind mila në jug prej Sierra Leone, islami, si duket, ka gjetur hyrje vetëm në shekullin e tanishëm dhe tash kryen përparim të vazhdueshëm. "Propagandën nuk e zhvillon ndonjë trup i veçante ose klerikët të caktuar për këtë qëllim, por çdo musliman është misionar aktiv.

Nëse takohen gjashtë sosh, më pak apo më shumë, në ndonjë qytet, ku kanë për qëllim që të vendosen një kohë, së shpejti e ngrisin xhaminë dhe fillojnë me punë.

Më së pari i drejtoheshin kryeparit të qytetit që ta fitojnë lejen e tij për aktin e synuar, e ndoshta edhe premtimin e tij se do të bëhet ithtar.

Ata e mësojnë me lutjet e veta në gjuhën arabe ose kujdesen që përmendsh t'i mësojë.

Ata e udhëzojnë në format dhe ritualet gjatë lutjes. Ia ndalonin pijet - ndalesë së cilës i është dhe nuk i është përmbajtur - dhe njeriu bëhej konvertit".79)

Në bregun e Guinesë ndikimi musliman kryesisht është zgjeruar nëpërmjet tregtarëve Hausë, që kanë mund të gjenden në të gjitha qytetet tregtare në breg. Aty i kanë formuar vendbanimet, e ndërtonin menjëherë xhamive dhe me sjelljen e vet serioze dhe me kulturë më superiore kanë lënë përshtypje në fqinjët paganë.

Tërë fiset idhujtare kanë kaluar në islam për atë shkak që kanë filluar ta immitojnë atë që e kanë njohur si më të lartë prej kulturës së tyre vetjake. Kjo ka ndodhur pa kontribut të veçantë të dhënë për bindjen e tyre.80)

Në Ashonti ka qenë embrioni i shoqërisë muslimane, ekzistimi i së cilës daton majft herët, rreth vitit 1750. Prej atëherë, misionarët

325

muslimanë kanë punuar ngadalë, por me sukses të sigurtë,81) sepse kanë hasur në mirëseardhje në vend dhe vetes i kanë arritur ndikim të konsiderueshëm mnë pallat.

Me ndihmën e shkollave të veta kanë arritur të sundojnë me shpirtërat e brezit të ri. Këtu thuhet se ekzistojnë shenjat e qarta se

islami do të bëhet fe sunduese në Ashanti, që e kanë pranuar shumë krerë.82)

Në Dahomej në Bregun e Artë islami për çdo ditë shënon përparim të ri. Në rastin kur krerët paganë nuk e pranojnë, në fund më së shpeshti përjetojnë të bien nën ndikimin e misionarëve të tij, që kanë se si ta shfrytëzojnë për punën e vet në mesin e botës së rëndomtë.83) Dahomej dhe Ashanti janë mbretëritë më të rëndësishme në këtë pjesë kontinenti. Me to ende sundojnë paganët - udhëheqës. Thuhet se konversioni i tyre në islam është vetëm pyetje e kohës së shkurtër.84) Në Llagosë ka afër 10.000 muslimanë. Të gjitha qendrattregtare të bregut perëndimor, duke e llogaritur edhe popullësinë e tyre dhe muslimanët e shumtë, i takojnë fiseve zezake në aspektin kulturor më të përparuar, siç janë Fulbët (Fulanët), Mandingët dhe Hansët. Kur këta njerëz të zbresin në qytetet bregdetare, që e bëjnë në numër të konsiderueshëm, qoftë si tregtar ose të shërbejnë në forcat ushtarake evropiane, ata nuk mund t'i shmangen të lënë përshtypjen me guximin e vet dhe mirësjelljen e lirë në zezakun e anës bregdetare. Ai mund të vërejë që ata që besojnë në Kur'an, kudo qofshin, gëzojnë respektin e sunduesve nëpunësve dhe tregtarëve evropianë. Kurse ata sipas racës dhe pamjes, rrobave dhe manireve nuk dallojnë shumë prej tij, që afrimin vëllezërisë së tyre do ta bënte të pamundur. Atij po ashtu i ofrohet pjesa në privilegjet e tyre, me kusht të hyjë në fenë e tyre.85)

Nëse zezaki-pagan, sado qoftë i papashëm dhe i përçmuar, tregon vullnet ta pranojë mësimin e Pejgamberit, ai menjëherë pranohet i barabartë në shoqërinë e tij.

Pranimi në vëllazëri në islam nuk është prani mqë jepet me gjysmë zemër, por kjo është diç që lirisht i ofrojnë propaganduesit e zjarrtë e të zellshëm të fesë.

Për këtë shkak, prej grykës së Senegalit në Llagos, në hapësirën prej 2000 milash, thuhet se është vështirë të gjendet qyteti me rëndësi në Bregdet e që në të mos të ketë së paku një xhami me

326

propaganduesit aktiv të islamit, të cilët shpesh punojnë krah për krah me mësuesit e krishterizmit.86)

Islami në bregun lindor afrikan

Tash do të hedhemi në historinë e përhapjes së islamit në anën tjetër të kontinentit afrikan, popullësia e të cilit ka qenë në lidhje me vendet ku kjo fe është lindur.

Të dhënat e shkruara, që kanë të bëjnë me vendbanimet e para arabe në bregun lindor të Afrikës, janë të parëndësishme.

Sipas një kronike arabe, që Portugalezët e gjetën në Kibu87) kur këtë qytet e ka plaçkitur Don Froncisko d'Almuidi në vitin 1505, të shpërngulurit e parë kanë qenë grupi i Arabëve, të cilët janë përzënë për shkak të ndjekjes së mësimëve heretike të njëfarë Zejdi,88)

pasardhësit të Pejgamberit, pas çkahit janë quajtur Emozadije (ndoshta Ummetu Zeyd, Populli i Zejdit).

Ka mundësi që kjo ka të bëjë me Zejb b. Aliun, nipin e Husejnit.

Ai është një prej pasardhësve të Aliut, nipit të Muhammedit.

Gjatë pushtetit të halifit Hishamit është shpallur për imam -

Mehdi. Nxiti trazirën e partisë shi'ite, por që ngadhnjyer dhe mbytur në vitin 122 H. (740.89)

Duket se kjo bashkësi e muslimanëve ka jetuar në frikë të madhe prej popullësisë pagane vendëse. Edhe përkundër kësaj kanë arritur shkallësirht t'i zgjerojnë vendbanimet e veta përgajtë bregut. Pastaj arriti edhe grupi i dytë i ikanahëve, që erdhi prej anës arabe të gjirit Persik, jolarg nga ujdhesa Bahrejn.

Ata kanë arritur në tri anije nën udhëheqjen e shtatë vëllezërve.

Kanë ikur nga dhuna e mbretit të Lasahës (90) (El-Ahsa), qytetit në afërsi të kolonive të fisit të tij.

Qyteti i parë që e kanë themeluar ka qenë Magdisho (Magdaxo) (91)

që është zhvilluar, më vonë, në aso fuqie që ka dominuar më të gjithë Arabët në breg.

Duke e marrë parasysh se autoktonët, d.m.th. Amuzejditët i kanë takuar drejtimit tjetërfaqe, sepse të parët kanë qenë shi'itë, kurse të dytët sunnitë, kanë refuzuar t'i nënshtrohen pushtetmbajtësve të Mogadishi. Janë tërhequr në brendi, ku janë përzier me popullatën vendëse. Janë martuar me ta dhe i kanë pranuar shprehitë dhe traditat e tyre. (92)

327

Magdisho është themeluar kah mesi i shekullit X dhe ka mbetur qyteti më i fuqishëm në këtë breg diç më shumë se 70 vjet, kur kanë arritur të shpërngulur të ri nga gjiri Persik dhe kanë themeluar vendbanim rival diç më në jug.

Udhëheqësi i këtij ekspedicioni është quajtur Ali, një prej shtatë bijëve të njëfarë sulltani Hasani nga Shirazi. Pasi nëna i qe Abesinase, vëllezërit e kanë shikuar me sy nënçmues. mënyra e tyre e egër ndaj tij, pas vdekjes së babait, e ka detyruar që ta lëshojë endlindjen dhe të vendoset dikund tjetër.

Për këtë shkak ka lundruar nga ujdhesa Ormuz me gruan dhe fëmijët dhe me një grup të vogël ithtarësh, duke iu shmangur Mogadishit, popullësia e të cilit i ka takuar drejtimit tjetërfaqe fetar. Ka shkuar më tej drejt jugut, sepse ka dëgjuar se është gjetur ari në bregun e Zanzibarit. Atje e ka themeluar qytetin Kilva.

Këtu ka mundur ta ruaj pozicionin e pavarur dhe të bëhet i lirë nga përzierja e pararendësve të tij nga veriu. (93)

Në këtë mënyrë është formuar një numër i caktuar i qyteteve arabe përgajtë bregut, prej gjirit të Ademit e deri te tropiku i Jugut (Sqapit), në skajin që nga gjeografët mesjetarë arabë është quajtur "Vendi zunxh", Vendi i zezakëve.

Çfarë angazhimi është dhënë nga popullsia muslimane në konvertimin e zunxhëve (zezakëe) fare nuk është shënuar. Ekziston tregimi i parëndomtë që është ruajtur në një përmbledhje të vjetër udhëpërshkruese, të shkruar sigurisht kah fillimi i shekullit X. Ajo dëfton se islami ka hyrë në mesin e njërit prej atyre fiseve nëpërmjet mbretit të tij.

Njëfarë anije tregtare arabe me anë të shtërngatës që qitur ngakursi i vet në vitin 922 dhe është sjellë deri te vendi i kanibalistëve - zunxh, ku ekuipazhi ka pritur vdekjen e sigurt.

E kundërta nga e pritura, mbreti i atij vendi me dashamirësi i ka pritur dhe u ofroi mikëpritje disa muaj. Për atë kohë e kanë shitur mallin e vet me çmime shumë të volitshme. Mirëpo, tregtarët në mirësinë e tij iu përgjigjën me besëthyerje. Kur ai dhe suita e tij erdhën në anije që t'i përcjellën, ata i lidhën dhe si robër i dërguan në Oman.

Disa vjet më vonë po ata tregtarë shtërngate i hodh në limanin e njëjtë.

Popullsia vendëse i njohur dhe i rrethoi me barkat e veta.

328

U dorëzuan këtë herë sikur të humbur. Njëri tjetrit ia kanë falur namazin e vdekjes. U sollën para mbretit. Këtu me habi dhe befasi zbuluan se ky është mbreti i njëjtë ndaj të cilës ata, para disa viteve, aq turpshëm janë sjellur.

Në vend që të hakmerret për sjelljen e tyre të pabesë, i la në jetë dhe u lejoi ta shesin mallin e tyre. Me përbuzje e refuzoi dhuratën e tyre, që ia ofruan.

Para se të largohen, një prej tyre mori guxi dhe e luti mbretin të rrëfejë për ikjen e tij.

Iu përshkroi se si si rob ka arritur në Basra, e pastaj në Bagdad.

Aty e pranoi islamin dhe u aftësua në fe. Duke ikur nga zotëriu i vet, iu bashkua karavanit të haxhëve, që ka shkuar në Mekke.

Pasi që e kreu haxhin, arriti në Kairo. Prej këtu Nilit u drejtua në drejtim të vendit të vet. Atje arriti pasi që përjetoi shumë rreziqe dhe shumë herë ra në robëri.

Duke u kthyer sërish në mbretërinë e vet, popullin e vet e mësonte në islam "dhe tash jam i kënaqur që Zoti mua dhe popullit ti mi ka dhënë dije për islam dhe fenë e vërtetë dhe që askush tjetër në Vendin e zunxhëve nuk është dinjitur me këtë mëshirë. Për atë shkak se ju keni qenë shkak për kalimin tim në islam, unë ua fali.

Thuaju muslimanëve se mund të vijnë në vendin tonë dhe se do t'i konsiderojmë vëllezër tonit."94)

Nga burimi i njëjtë mësojmë se, qysh në këtë periudë të hershme, ky vend bregdetar shpesh është vizituar nga një numër më i madh i tregtarëve arabë. Por, për kundër ekzistimit të lidhjes që me shekuj ka vazhduar ndërjet muslimanëve dhe popullsisë së vërtetë të Bregut

(me përjashtim të Somalianëve), pak prej tyre kanë qenë nën ndikimin e islamit.

Madje edhe para pushtimit portugalez në shekullin VI ka pasur disa kovnertime të kufizuara kryesisht në zonën bregdetare.

Pas thyerjes së ndikimit portugalez në këtë pjesë të botës dhe përtëritjes së pushtetit arab nën sundimin e Sejjid Osmanit, ka qenë vështirë të bëhet çfarëdo përpjekjeje deri në shekullin XV në përhapjen e dijes për islamin në mesin e fisve në brendi, me përjashtim të fisve Galla dhe Somale.

Një udhëpërshkrues i asaj kohe ka thënë: "Gjatë kohës së tri udhëtimeve të mia, që i ka mndërmarrë drejt lindjes së Afrikës së 329

mesme, nuk kam vërejtur asgjë që islamin do ta parashtronte si fuqi civilizuese.

Sado të jetë forca jetësore e kësaj feje, ajo ka mbetur latente.

Arabët dhe trashëgimtarët e tyre në këtë territor nuk kanë qenë propagandues. Aty nuk kishte misionarë që thërrasin në islam.

Banorët e Maskatit janë kënaqur që robërit e tyre të jenë deri diku në harmoni me disa forma të fesë.

Ata i kanë lënë fiset e Afrikës lindore në mosdijen e tyre të madhe, duke u kënaqur, si duket, me atë që të mbeten në atë jedi dhe në mosdijen e vet.

Paaftësia e tyre për civilizim qartë është manifestuar në faktin çuditës se 500 vjet kanë kontaktuar me botën gjysmëcivilizuese, e që nuk ka mbetur as nuanca më e vogël e virtyteve prosperuese me të cilat shquhen fqinjët e tyre. Nuk ka mundur as nuk është zhvilluar një embrion i mirë gjatë gjithë këtyre viteve.⁹⁵⁾

Arabët në Afrikën lindore tërësisht i janë dorëzuar profesionit tregtar ose gjuetisë në robër, duke dëftuar pakujdesi për përparimin e interesave të fesë së vet.

Kjo është kundërshti e evidente të vetëmohimit misionarist që e kanë dëftuar bashkëfetarët e tyre në pjesët tjera të Afrikës.

Islami në Ugandë

Përjashtimi mi dukshëm është aktiviteti propagandues i tregtarëve arabë të cilët i janë qasur në ugandë në gjysmën e parë të shekullit XIX.

Ka mundësi të kenë vërejtur se fuqia e lirisë së Bagandës është e atillë që tregtia me robër në mesin e tyre është e atillë që tregtia me robër në mesin e tyre është e pamundur. Për këtë kanë parë se besimin e tyre do ta fitojnë ashtu që do t'i tërheq në fenë e vet.

Shumë prej Bagandëve janë bërë muslimanë gjatë kohës së sundimit të mbretit Mutes, por vizita e Stanliut këtij mbreti në vitin 1875 solli deri te hyrja e misioneve të krishtera vitin vijues.

Fuqia muslimane në shtet shpejtë ka rënë me rritjen e numrit të të kryqarve dhe me konstituimin e protektoratit britanik.⁹⁶⁾ Por, ende një

numër i caktuar muslimanësh mbajnë pozicione me rëndësi në Ugandë dhe është mundësi e qëndrueshme që Provinca Lindore të bëhet muslimane.

330

Transmetohet se numri i madh i personave influencues, në krahinën e pasur Busoga, në eri të ugandës, ka kaluar në islam në vitin 1906.97)

Me këtë përjashtim, islami në Afrikën lindore ekuatoriale ka qenë deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX i kufizuar në vendet bregdetare dhe fqinje.

Shpjegimi mund të gjendet në atë që tregtarët me robër nuk kanë pasur interes për përhapjen e islamit në mesin e fiseve pagane, dnër të cilët kanë zënë sakrificat e veta të pafatshme, sepse nëse ndonjë fis ka kaluar në islam, ata bëheshin vëllezërit e tyre sipas fesë dhe në këtë rast nuk do të robëroheshin dhe të dërgoheshin si robër.98)

Islami në Afrikën lindore

Kur u ndalua tregtia me robër me përhapjen e sundimit evropian mbi Afrikën lindore - ekuatoriale, pasoi ekspansioni evident i aktivitetit misionarist islam.

Në brendi u vendos rendi dhe paqa. Janë ndërtuar hekurudha dhe rrugët e gjëra dhe tash tregtari i qetë musliman ka mundur ta gjejë rrugën në trevën që deri atëherë për të ka qenë e mbyllur.

Qeveria e vendit i ka zgjedhur nëpunësit e vet nga pjesa e arsimuar më e lartë e popullësisë të cilën pak a shumë e kanë përbërë muslimanët.

Me mijëra shërbime ka formuar administrata gjermane e Afrikës lindore dhe ua ka dorëzuar nëpunësve muslimanë. Ata e kanë përdorë ndikimin e vet dhe tërë fshatrat i kanë kyqur në islam.99)

Mësuesit e shkollave shtetërore kanë qenë po ashtu muslimanë.

Me fillimin e decenieve të fundit të shekullit XIX është hetuar se mësuesit svahili zhvillojnë punë të gjallë e të suksesshme misionariste në mesin e popujve Bondei dhe Vadigo (të cilët banojnë pak në brendi prej bregdetit) në Afrikën lindore gjermane.100) Aktiviteti i kësaj lëvizje të re misionariste ka qenë mjaft i shprehur në brendi101) në fillim të shekullit XX, veçan pas shuarjes së trazirës në vitin 1905 në Afrikën lindore gjermane.

Kjo lëvizje e ekspansionit veçan ka rrjedhur me hekurudhë dhe me rrugët e mëdha tregtare. Është zgjeruar drejt nëpërmjet Afrikës lindore gjermane drejt bregut të saj perëndimor në liqenin Tanganian, kurse 331

në veri prej Usambares drejt krahinës Kilimanxharo dhe në jug deri të liqeni Njasa.102)

Në këtë propgadandë kanë punuar tregtarët, veçan svahilit, nga bregu, pastaj ushtarët dhe nëpunësit shtetëror...

Në pranimin e islamit shikohej sikur në shenjën e ngritjes në

pozitë më të lartë kulturore dhe shoqërore, kurse edhe nënçmimi me të cilin muslimanët kanë shikuar në paganët, se si flitet, shpesh ka qenë faktori vendimtar në kthimin e tyre në islam.103)

Një shembull i ndjenjave të këtilla mund të merret nga Usambare perëndimore, për të cilën thuhet se deri në vitin 1891 ka qenë e mbyllur për islamin.

Ndjenje armiqësore kanë pasur edhe populli edhe krerët ndaj muslimanëve, nga të cilët janë frikësuar dhe kanë drojtur sikur nga tregtarët me robër. Por kur ditët e tregtisë me robër kanë kaluar dhe kur është futur qeverisja dhe rendi i përhershëm, nëpunësit e parë vendës që janë emëruar kanë qënë pothuaj të gjithë muslimanë.

Këta kanë vepruar në krerët dhe personalitetet tjera të rëndësishme me të cilët kanë ardhur në kontakt duke e konsideruar korrekte hyrjen në islam të atyre që punojnë në institucionet zyrtare. Kështu e kanë arritur konvertizmin e disa krerëve më të lartë, që emë vonë me ndiki mtë ngjashëm kanë vepruar në ata me rang më të ulët se vetja.104)

Duhet se ka pak prova mbi punën e misionarëve profesionalë ose cilit do grup fetar. Nuk ka as evidencë të mangët për përpjekjet sistematike, sikur për atë që e ka dhënë një mësues musliman. Ai njofton se rregullisht e ka vizituar një zonë në krahinën Kilimanxharo pesë muaj çdo javë dhe ka ftuar në islam.

Shërbimi i tij ka qenë përshëndetur në popull, ka ditur t'i gostisë me orizë e të tjera.105)

Është evidente se në këtë propagandë të zjarrtë thirrësit muslimanë në fe kujdesin e vet nuk ua kanë kushtuar vetë mpaganëve, por janë përpjekur të fitojnë konvertitë edhe në mesin e të krishterëve vendas.106)

Islami ka gjetur rrugën edhe në Njasalandë po ashtu në bregun lindor. Ka hyrë me tregtarët arabë me robër dhe me aleatët e tyre Jaosi, të parët e të cilëve kanë ardhur nga afërsia e bregut lindor, ku shumë më herët e kanë pranuar islamin.

332

Thuhet se është gjë e rrallë të shihet Arabi në Njasalandë, por Jaosët përbëjnë një prej fiseve vendëse më të fuqishme në Njasabandë. Në isla mshikojnë si në fenë e vet nacionale.

Ndonëse duket se nuk ka pasur propagandë të organizuar, islami shpejtë është zgjeruar gjatë decenies së parë të shekullit XX dhe këtë në mesin e disa fiseve në intelegjente në vend.107)

Fiset Galla dhe Somal

Sukses të ngjashëm islami ka arritur në mesin e fiseve Galla dhe Somal. Tashmë ka pasur fjalë për vendbanimet e Gallëve në Abesini. Parashtrohet se këta të shpërngulur, që ndahen në shtatë gjiri tjera, me një emërtim Vollo-Galla, kanë qenë të gjithë paganë në kohën e sulmit të tyre në këtë vend.107/a) Një pjesë e mirë ka mbetur në paganizë mderi më sot.

Pas stabilizimit në Abesini ata janë përshtatur aty. Në të shumtën e rasteve e kanë përvetësuar gjuhën, shprehitë dhe traditat e popullësisë vendëse.108)

Tregimi për kalimin e tyre në islamm është i pasqaruar. Për disa prej tyre thuhet se janë kryqar detyrimisht. osekzistimi i fuqisë politike në duart e muslimanëve nuk ka lejuar mundësinë e çfarëdo qoftë konvertii në isla në mënyrë të ngjashme.

Thuhet se ata në jug në shekullin XVIII në të shumtën kanë qenë muslimanë, deri sa ata në lindje dhe perëndim kryesisht kanë qenë paganë.109)

Informatat diç më të reja dëftojnë në rritjen e mëtejme të numrit të ithtarëve të Pejgamberit.

Munzingeri në vitin 1867 ka paradëftuar se në kohë të shkurtër të gjitha fiset Galla do të jenë muslimanë.110) Pasi për ta thuhet se janë mjaft fanatikë", këtë mund ta konkludojmë se në asnjë kupti nuk kanë qenë indiferentë dhe jolojalë në besnikërinë e vet kësaj feja.111)

Galla i çliruar, të cilin Donghty e ka takuar në Hajber, ka treguar shkallë të lartë të entuziazmit ndaj fesë së vet.

Ky njeri si fëmijë është marrë nga shtëpia e tij dhe është shitur në Xhide. Donghty e ka pyetur vallë ende në zemër nuk mbanë urrejtje ndaj atyre që e kanë vjedhur dhe jetën ia kanë shitur të shërbejë në fund të jeës. "Një gjë çdo gjë ma ka kompenzuar", u përgjeggj, e kjo është që nuk jam fundosur në mosdije në mesin e paganëve.

333

Ah, çfarë providence e All-llahut është kjo që kam ardhur në vendin e Pejgamberit dhe e kam njohur këtë fe.112)

Ah, sa ëmbël është këtu në besim! Më beso, mik i dashur, kjo është çështje për të cilën zemra është e pafuqishme të flet. Sa dëshiroj që Zoti të të udhëzojë në atë dije (qiellore), por unë jam i sigurtë se Zoti do të të mbrojë dhe se nuk do të shkatërrojë deri sa nuk hynë në këtë fe. Ah, sa bukur do të ishte të të shihja si musliman. Të bëhesh një prej nesh, por unë di se koha (e vdekjes) është në dorën e Zotit, dhe Ai punon ç'të dojë."113)

Një pjesë e popullësisë në mesin e fiseve Galla të banuar në vendin njëmend të Gallëve është muslimane (disa fise janë konvertuar rreth vitit 1500,114) kurse pjesa tjetër janë paganë. Përgjashtim mbëjnë ato fise që direkt jetojnë pranë kufirit abesinas. Ata kah fundi i shekullit XIX kanë qenë të detyruar nga mbreti i atij vendi ta pranojnë krishterizmin.117)

Në viset malore muslimanët janë në pakicë, por në fushë gropa misionarët islaë kanë pasur sukses të qartë dhe mësimi i tyre ka hasur në pritje të shkëlqyeshme gjatë kohës së shekullit të kaluar.

Antonio Cecchi (Seçi), që e vizitoi mbretërinë e vogël Limmën në vitin 1878, e sjell një tregim për konversionin e abba Baghibas,115) babain e kryeparit të atëhershëm regjional, nëpërmjet muslimanëve që

kanë shkuar pas punës së vet misionariste në këtë vend në petkat e tregtarëve. Shembullin e tyre e kanë ndjekur edhe krerët tjerë të mbretërive fqinje Galla, sikur edhe nëpunësit e pallateve të tyre. Një pjesë e popullësisë po ashtu është përvetësuar për fenë e re që ka vazhduar të përparojë në mesin e tyre. Por pjesa më e madhe e tyre ka mbetur në kultin e vet të vjetër të besimit.117)

Këta tregtarë kanë hasur në mirëseardhje në pallatet e krerëve - Gallasë, pasi që atje kanë gjetur treg për këmbimin e prodhimeve tregtare lokale për mallin e importuar të prodhimit të huaj. Pasi që këta tregtarë vetëm një herë në vit, apo në dy vjet kanë udhëtuar deri në breg, kohën tjetër e kanë kaluar në vendin e Gallëve. Kanë pasur shumësi rastesh që mirë kanë ditur ta shfrytëzojnë në punën në propagandimin e islamit. Kudo që shkelën në këmbë, sigurisht për një kohë të shkurtër kanë përvetësuar një numër më të madh të atyre që kanë hyrë në islam.118)

Islami ka ardhur këtu në konflikt me misionarët e krishterë nga Evropa, përpjekjet e të cilëve, qoftë edhe kanë arritur disa konvertitë 334

të krishterë, janë kurorëzuar me sukses të vogël.119) Madje edhe nga ata që i ka kryqar kardinali Massagja, që më vonë ishte larguar nga këto vise, disa e kanë pranuar islamin ose kanë mbetur në pafe - as kanë besuar në Krishtin as në All-llahun.120)

Në ndërkohë misionarët muslimanë kanë realizuar suksese të kontinuar dhe ia kanë hapur vetes rrugën larg drejt jugut dhe e kanë kaluar lumin Vabi.121)

Shumica e Galla-fiseve qëndron në perëndim të Galla-vendit, ku deri në fund të shekullit XIX kanë mbetur pagane. Në mesin e fiseve me perëndimore prej tyre fisit Lega122) adhurimi i vjetër i natyrës ka filluar t'i bjerë dhe ndikimi në rritje i misionarëve muslimanë e ka bërë të mundur që për disa vjet të gjithë Legët të hyjnë në rrethin e islamit.123)

Afrika verilindore në kohën bashkëkohore paraqet skenë të aktivitetit të gjallë e të zjarrtë misionaristë nga ana e muslimanëve. Nga disa qindra misionarë vijnë çdo vit nga Arabia. Në punën e vet kanë shumë më tepër sukses në mesin e Somaliasëve se sa në mesin e Galëve.124)

Afërsia direkte e Somalisë dhe Arabisë ka shkaktuar që ky vend mjaft herët të bëhet arenë e punës misionariste muslimanve, por, fatkeqësisht, ajo që për këtë është e shkruar është shumë pak. Ibn Havkali125) përmend se populli i Zoilit në gjysmën e dytë të shekullit IX ka qenë i krishterë, por në gjysmën e parë të shekullit XIV Ebu Fida për ta thotë se janë muslimanë.126)

Feja e re, sipas gjasave, është përcjellur përtej detit me tregtarët arabë të arratisur.

Somalianët në veri kanë legjendën për njëfarë Arabi e prejardhje

fisnike që është detyruar ta lëshojë vendin e vet, ta kalojë detin deri në Adel, ku i ka ftuar në islam të parët e tyre.127)

Në shekullin e XV grupi prej 44 Arabë ka ardhur si misionarë nga Hodromevti. Kanë zbritur në Berber në detin e Kuq dhe prej aty janë shpërndarë nëpër Somali për të ftuar në islam.

Një prej tyre, shejh Ibrahim mEbu Zarbaj, u drejtua deri në Herar në vitin 1430 dhe atje ka përvetësuar shumë konvertitë. Varri ende i është objekti respektit në qytet.

Kodra afër Berberës ende quhet Kodra e evlijave, si përkujti mpre këto misionarë. Për ta thuhet se aty kanë qëndruar në vetminë 335

devocionuese serioze para se, përsëgjati e përsëgjëri, janë shpërndarë nëpër tokë, duke punuar për kthim në islam.128)

Islami, pak nga pak, ka dominuar me të gjitha pjesët e Indisë verilindore, por rritja e fuqisë së mbretit Menalik dhe okupacioni i tij i Harasit në vitin 1866 ka rezultuar me kalimin e një numri të caktuar të popullësisë në krishterizëm.129)

Islami në Koloninë Kap

Që ta plotësojmë këtë pasqyrë të islamit në Afrikë, ka mbetur që të tregohet në faktin se kjo fe ka depërtuar deri në jugun skajor në këtë kontinent, deri te kolonia Kap.

Muslimanët e Kapit janë pasardhës të malajëve të cilët këtu i kanë sjell Holandezët130) diku në shekullin e XVII ose XVIII.131) Ata flasin me dialektin e shtrembëruar Boer me përzierje të madhe të fjalëve arabisht dhe disa anglisht dhe malajisht.

Një broshurë e pazakonshe është botuar në këtë dialekt. Është shkruar me alfabet arab dhe është shtypur në Istambull në vitin 1877 nga ana e ministrit turk të arsimit që të shërbejë si doracak për mësimin e themeleve islame.132)

Emrat holandezë, që disa prej tyre i mbajnë, sikur edhe forma e fytyrës që te shumica e tyre është e hetueshme, dëftojnë në supozimin se në bashkësinë e vet nganjëherë i kanë pranuar disa persona të prejardhjes holandeze. Në rastin skajor, në damarët e tyre ekziston përzierja e konsiderueshme e gjakut holandez.

Ata i kanë përvetësuar edhe disa konvertitë në mesin e Hatentotëve.

Udhëpërshkruesit evropianë133) nuk kanë shkruar për ata sikur as bashkëbesimtarët e tyre deri në ditët e fundit.

Kolbruku (Colebrooke) ka tërhequr vëmendjen në vitin 1819 në rritjen e islamit në shënimet e veta interesante që i ka shkruar për Kapkoloninë:

“Thonë se islami përparon në mesin e robërve dhe në mesin e të lirëve në Kap. E kjo d.m.th. se numri shumë më i madh i atyre në mesin e zezakëve dhe të ngjyrosurve, të llojeve të ndryshme, të cilët nga paganizmi kanë kaluar në islam, se sa në fenë e krishterë, edhe përkundër përpjekjes së madhe që e kanë dhënë misionarët e

devotshëm. Një nga shkaqet për këtë shtrembërueshmëri është mmbrojtja dhe mosdisponimi që skllavopronarët e kanë treguar ndaj 336

kryqiit të robërve të tyre. Kjo është lajmëruar për shkak të kuptuarit të gabueshëm dhe frikës së tepruar, nga të drejtat që robërit e kryqvar do t'i fitojnë.

Nuk ka dyshi mse robërit kanë qenë nën ndikimin e mbetjes së këtij mosdisponimi dhe s'ka qenë e rrallë që robi të përgjigjet, kur pyetjet për motivin e kalimit në islam, se duket të ketë ndonjë fe, kurse nuk i është lejuar të kalojë në krishterizëm.

Paragjykimi për këtë gjë hiqet dhe tash është zvogëluar kundërshtimi i këtyre pronarëve për shkak të konversionit të robërve të tyre siç ka qenë më herët.

Zotërinjtë kanë filluar të kuptojnë se robërit e tyre nuk e keqpërdorin mësimin që e pranojnë me detyrat fetare.

Misionarët që i janë përkushtuar veçanësisht misionarët fetar të robërve (dhe në çdo qytet kryesor ka nga një), kanë arritur sukses që të rritet numri i besimtarëve dhe shpresojnë se angazhimi i tyre nuk do të jetë i pafrytshëm. Por, kleriku musliman me pak angazhimi ka kope më të madhe.134)

Për pesëdhjetë vitet e fundit muslimanët në koloninë Kapu i kanë vizituar bashkëbesimtarët e tyre të zjarrtë nga vendet tjera. Shumë më tepër kujdes tash u është kushtuar arsimimit të tyre. Tek ata është ngjallur jeta më e thellë fetare nga ajo me të cilën kanë jetuar. Thuhet se kanë zhvilluar propagandë të zjarrtë veçanësisht në mesin e popullësisë së ngjyrosur të Kapus dhe kanë arritur sukses të caktuar.135)

Kjo lëvizje e misionarisë veçanësisht është e fuqishme në pjesën perëndimore të Kolonisë.

Thuhet se ekziston lëvizja që është në rrugë ta themelojë fakultetin në Klirmaut në afërsi të Keptaunit. Ai do të bëhet qendra e propagandës së islamit.

Një nga metodat që tash përdoret është edhe marrja e fëmijëve të lënë e të pakujdesur dhe edukimi i tyre në islam.136)

Çdo vit dikush nga ata shkon në haxh në Mekke ku caktohet shejh i veçant që t'i mbikqyrë.137)

Thuhet për punëtorët indusë që vijnë të punojnë në fushat e margaritarëve të Afrikës jugore, se po ashtu janë propagandues të islamit.138)

Për shkak të pozicionit të vet të veçuar prej rreth 220 deri 540 mila prej tokës kryesore ujdhesës Madagaskas kërkon vëndjen e veçant. 337

Një fis që e ka pranuar islamin është Antaimorana, që e zënë pjesën juglindore të bregut. Nuk ka dyshim se në islam kanë kaluar nëpërmjet misionarëve arabë, por është e panjohur koha kur ky ndryshi mi fesë ka ndodhur.

Tradita këtë e kthenë në kohën e vetë Pejgamberit por ne vetëm në shekullin e XVI i gjejmë të dhënat e njëmendta për muslimanët në ujdhesën në veprat e gjeografëve italianë dhe portugalezë.139)

Metodat misionariste në përhapjen e fesë

Nga kjo pasqyrë e dhënë sumarre historike mund të vërehen metodat e qeta që në shumicë e kanë karakterizuar lëvizjen misionariste islame në Afrikë. Ndonëse islami shpesh e ka shtrirë shpatën si instrument të pushtimeve të veta shpërtërore, megjithatë përdorimit të forcës dhe gjakderdhjes, në të shumtën e rasteve, i kanë paraprirë përpjekjet e qarta misionariste. Propaganduesi e ka ndjekur pushtuesin që ta përmbushi mëngësinë e punës së konversionit. Është e vërtetë, islami me lehtësi të madhe ka arritur në shumë pjesë të Afrikës me sukseset botërore të pionierëve muslimanë sikur edhe me formimin e shteteve muslimane me elemente pagane. Shpesh zjarri dhe gjakderdhja e kanë karakterizuar drejtimin e xhihadit, janë zbatuar për çrrënjosjen e paganëve.

Fjalët e të riut Arab nga Boruni të cilin kaptenai Burtani140) e takoi në pallatin e mbretit Abeokuti, pa dyshim shprehin synimet e shumë muslimanëve afrikanë: "Na i jep ato pushkë dhe barutë dhe ne këta qenë do t'i islamizojnë."

Ehoja e këtyre fjalëve mund të gjendet edhe në porosinë që na kanë dhënë Mungo Parku,141) që është dërguar nga mbreti musliman Futih Toroi fqinjët të tij pagan: "Me këtë thikë Abdulkadiri do të dinjitetohet t'ia rruaj kokën Damelit nëse Dameli kalon në islam, kurse e këtë thikën tjetër Abdulkadiri do t'ia prejë qafën Damelit nëse Dameli do të refuzojë të kalojë në islam. Zgjidhja vetes."

Sado që islami i ka pasur borgj trimërisë luftarake të fanatikëve siç janë këta, ne kemi prova të pakontestueshme të udhëpërshkruesve dhe të tjerëve për thirrjen e qetë në fe, për punën e paatakueshme dhe vazhduese të propaganduesve muslimanë që i kanë kontribuar përhapjes së shpejtë të islamit në Afrikën bashkëkohore pa asnjë lloj aspekti të detyrimit.

338

Ka mundësi se me këtë metodën e fundit kundërshtarët kanë qenë të zhdukur dhe puna në konvertizëm ende është e hetueshëm në përparim mnë shumë vise në breg dhe në brendësi.142)

Kudo që islami vetes ia ka hapur rrugën, aty do të gjendet misionari musliman si bartës i doktrinëve të kësaj feje. Tregtari, qoftë ai Arab, Pul apo Mandingo, e ka bashkuar përhapjen e fesë dhe shitjen e mallit të vet. Vetëm profesioni i tij e ka shpjerë në kontakt të ngushtë dhe direkt me ata që ka dëshiruar t'i kthejë në islam dhe i ka çarmatosur të gjitha mundësitë të akuzës të motiveve keqsynuese. Kur njeriu i këtille të hyjë në fshatin pagan, do ta tërhiqte vëmëndjen në marrjen e vet të shpeshtë të abdestit dhe përcjelljes së rregullt të kohës së namazit dhe devotshmërisë në të cilin duket sikur

bisedon me ndonjë genie të fshehtë.

Me superioritetin e vet të lartë intelektual dhe moral ka nxitur respektin dhe besimin e popullësisë pagane. Njëkohësisht është treguar i gatshëm dhe i vullnetshëm t'i përcjell virtytet e veta të larta dhe dijen. Haxhiu ose pelegrini që kthehej nga mekkeja, plotë entuziazë për përhapjen e fesë, të cilës ia ka kushtuar gjithë energjinë e vet, duke shkuar nga vendi në vend, duke jetuar nga sadaka e besimtarëve, do ta fuste provën e të vërtetës në mesin e fqinjve të vet paganë.

Studenti, si njeri i shkencës, ka hasur në respekt nga arsyeja e dijes së tij nga feja dhe e drejta islame. Nganjëherë është preokupuar edhe me medicinë. Në fund ka qenë me të madhe i kërkuar si shkruer i talismanëve, ajeteve kur'anore, të cilat janë qepa në copëza të lëkurës dhe pëlhurës dhe janë lidhur për krahë ose rreth qafës. Kjo është detyrë që ka mundur ta shfrytëzojë si mjet i rritjes së numrit të konvertitëve në islam.

Për shembull, kur prej tij kërkojnë këto hajmali gratë sterile ose ato që i kanë humbur fëmijët e mitur, ua bënë si kusht të suksesit të këtyre talismanëve që fëmijët e vet të ardhshëm t'i edukojnë në islam.143)

Këta mësues fetar, murabitë ose alutë, si janë quajtur, lartë janë çuar. Në disa fise të Afrikës perëndimore çdo fis ka pasur një shtëpizë për pritjen e tyre. Me ta është sjellur me konsideratën dhe respektin më të lartë. Në Darfur ata zënë shkallën më të lartë shoqërore pas nëpunësve shtetëror.

339

Në mesin e andingëve kanë rang edhe më të lartë dhe gëzojnë respektin menjëherë pas mbretit. Krerët e nënshtruar konsiderohen sipas pozitës të nënshtruar të tyre.

Në shtetet që Kur'anin e kanë marrë për bazë të sundimit të vet në punët qytetare shërbimet e tyre kanë qenë mjaft të nevojshme në mënyrë që t'i shpjegojnë domethënien e tyre.

Personaliteti i këtyre mësuesve ka qenë aq i çmueshëm që pa shqetësim kanë kaluar nëpër vendet e disa princave, që nuk kanë qenë vetë në armiqësi njëri me tjetrin, por kanë qenë të preokupuar edhe me luftë reale.

Ky respekt nuk iu është dëftuar vetëm në fshatrat muslimane, por edhe në ato pagane ku i kanë themeluar shkollat e veta. Njerëzit i kanë nderuar si mësuesit e fëmijëve të tyre. Në ta kanë shikuar si në ndërmjetësuesit ndërmjet vetes dhe Zotit, barabartë në plotësinë e nevojave të veta ose në refuzimin dhe evitimin e fatkeqësive.144)

Shumë prej këtyre mësuesve kanë studiuar në xhamitë e Kajrevanit, Fesit, Tripolit145) dhe në qendrat tjera të mësimit islam, por sidomos në xhamitë e El-Ez'herit në Kairo.

Studentët i shkojnë nga të gjitha pjesët e botës islame dhe në mesin

e tyre shpesh gjendet edhe grupi izezakëve të Afrikës. Këta janë studentët nga Darfuri, Wadai dhe Bornua. Disa e kalojnë rrugën e vet këmbë nga bregu Perëndimor i largët.

Kur i kryejnë shkollimet e veta nga teologjia dhe e drejta islame, shuë prej tyre bëhen misionarë në mesin e popullësisë pagane të vendit të vet.

Këta misionarë themmelojnë shkolla në qytetet që i vizitojnë, kurse i ndjekin fëmijët paganë sikur edhe muslimanë. I kanë mësuar të lexojnë (mësojnë) Kur'an dhe i kanë përudhur në rregullat dhe manifestimet islame.

Duke pasur themel të tillë, misionari musliman me dijen dhe dashuri e vet më të mirë padyshim ka arritur ndikim më të madh në popull në të cilin ka ardhur të jetojë.

Në këtë i ka ndihmuar fakti që mënyra e jetesës dhe irësjellja kanë qenë në të shumtën të ngjashëm mënyrës së tyre të jetesës.

Pasi që tregtari ia ka përgaditur rrugën, në të nuk është shikuar me dyshim. Me martesën me popullësinë vendëse fillon pranimi i tij në jetën e tyre shoqërore, ndikimi i tij bëhet fortë i rrënjosur dhe i 340

qëndrueshëm. Kështu ai më së natyrshmi, pak nga pak, ka shkaktuar përhapjen e islamit në mesin e tyre.

Përpjekjet e tij misionariste më tej janë lehtësuar me faktin se deizmi (botëkuptimi se Zoti e ka krijuar botën, e pastaj nga ajo është tërhequr, dhe se bota i është lënë vetëvetes - vër. e përkthyesit) është themel i ndjenjave fetare të shumë idhujtarëve - ku mundur lehtë të kalojë në teizmin e ismailit (besimi në Zotin që krijoi çdo gjë dhe e çdo gjë udhëheq, kurse vet gjendet jashtë botës - vër e përkthyesit) së bashku me disa aspekte tjera të mësimin të tyre teologjik.

Shikimi i tyre i përgjithshëm në jetë dhe disa institucione religjioze të tyre janë të aftë të ngjyrosen me ngjyrat islame dhe të përcillen në sistemin e ri fetar pa nënshtrim ndryshimeve më të mëdha.146)

Ardhja e muslimanëve në vendet pagane po ashtu është fillimi i hapjes së tregtisë më të fuqishme e frekvente dhe lidhja me qendrat e mëdha tregtare muslimane çfarë janë Xhene, Segu apo Kano.

Së bashku me fenë e Pejgamberit ata kanë meritë edhe në kulturën e saj materiale.

Për këtë në mesin e fiseve zezake të pavivilizuara misionari ka mund të jetë i sigurtë në pritje më shpejtë. Ai nuk iu ka ofruar vetëm të vërtetat për Zotin dhe njeriun, që ua ka hapur rrugën e zemrës dhe ua ka ngritur intelektin, por njëkohësisht ua ka dhënë moton për qasje në unitetin shoqëror dhe politik, që sërish është dokument udhëtimi për mbrojtje dhe ndihmë prej Atlantikut deri te Muri Kinez.

Kudo të gjendet shtëpia muslimane, atje është zezaku - konvertit, i cili mund të përsërisë një shumësi rregullash të fesë së vet i sigurtë në

mbrojtje, ushqim dhe këshillë. Në vendin e vet përnjërend, ai bëhet anëtar i shtresës me ndiki, nsëe je edhe klasës sunduese.

Duket se kjo është fakti real i suksesit të misionarëve islaë në Afrikën perëndimore.

Sa i përket numrit të të konvertuarve, ai është i madh dhe shpejt rritet nga shkaku i thjeshtë që misionari musliman nga çasti i parë të besiit konvertues praktikisht ka punuar në zbatimin e principeve të barabarësisë dhe vëllazërisë të të gjithë besimtarëve para Zotit, në çka islami merrë pjesë me krishterizmin.

Misionari musliman përgjithësisht është më i shpejtë dhe me i vendosur në këtë punë nga misionari i krishterë, që në të shumtën e rasteve ndien se është i detyruar të kërkojë provë të fortë të lojalitetit 341

të të kryqarit para se t'ia zgjasë dorën e vëllazërimit në krishterizëm. Kjo ka nxitur padurimësinë racore, që nuk ka mund të zhduket në një gjeneratë, kur gjatë gjeneratave i krishteri - i bardhë është konsideruar zotëri, kurse zezaku pagan dhe rob.147)

Me rëndësi është, po ashtu, të vërehet se ngjyra dhe raca në asnjë rast nuk e ka bërë zezakun më anues në sytë e bashkëfëetarëve të tij të ri.

Nuk ka dyshi se progresi i islamit në Afrikën e zezë ka qenë, në bazë, i ndihmuar me këtë mosekzistimin e ndjenjës së neverisë ndaj zezakut. Është fakt se islami kurrë nuk e ka trajtuar zezakun si të nënshtruar, sikur që, fatkeqësisht, ka qenë rast i shpeshtë në botën e krishterë.148)

Ky vrojtim shpjegon, deri diku, suksesin e muslimanëve nëse krahasohet me misionet e krishtere në mesin e popujve zezakë. Më së shpeshti kjo dëfthohet në atë që zezaku i kryqar nën ndjenjën që bashkëbesimtarët e tij evropianë i përkasin llojit të atillë të civilizimit që nuk i përgjigjet natyrës dhe jetës së tij. Njëkohësisht, veten e ka konsideruar shumë më të lartë në shtëpi, në shoqërinë muslimane.

Kjo veçan është cekur te një vështrues bashkëkohor në citatin vijues: "Islai përveç mëngësive të veta nga pikëpamja e Nigeriasëve nuk kërkon humbjen e nacionalitetit të Nigerianëve si rrethanë përcjellëse të konversionit. Ai nuk kushtëzon ndryshime revolucionae të jetës sociale, të cilat janë të pamundura në situatën bashkëkohore të zhvillimit nigerian. Ai nuk e shkatërron autoritetin e failjes dhe shoqërisë. Kërtu nuk ka pafund ndërmjet atij që thërret në islam dhe atij që e pranon. Të dytë janë të Afrikanë. Janë bijë të një vendi. Principi i vëllazërisë njerëzore zbatohet praktikisht.

Transformimi në isla nuk d.m.th. se konvertiti ndërpre në punët e veta, familjen dhe me jetën e vet shoqërore, as me respektimin e pushtetit të sunduesve të tij vendës. Nuk mund të gjendet askush që nuk kënaqet me qëndrimin dhe sjelljen e Nigerianëve, por edhe të

muslimanëve të Afrikës perendimore. Tërë zhvillimi i njeriut e imponon vetëdijen për të drejtën qytetare. Krenaria nacionale duket se flet: "Ne dallojmë, ti dhe unë, por ne jemi njerëz."

Përhapja e islamit në Nigerinë jugore, nëse sot shohim, kryesisht është veprim shoqëror. Islai u sjell atyre me të cilët kontakton status më

342
të lartë dhe konceptin më të lavduar të vendit njerëzor në botë që e rrethon. E liron nga robërimi dhe njëmijë frika tjera.149)

Sipas traditës muslimane, Musau ka qenë njeri i zi, që mund të shihet nga ajetet vijuese kur'anore: "Dhe fute dorën..." (Ta Ha, 22).

"... dhe nxirre dorën tënde..." (el-A'raf, 108-109).

Rrëfimi vijues nga perioda e artë e dinastisë abasite, që ka arritur deri te ne, është dëshmi e ndierjes së simpatisë së muslimanëve ndaj zezakëve.

Ibrahimi, vëllau i Harun err-Rreshidit dhe i biri i zezakes, u prklamua për halif në Bagdad, por Me'muni, që ka sunduar në vitin 819 e ka ngadhjyer dhe ia ka falur.

ibrahimi rrëfen për takimin e vet me Halifin: "Me'muni më tha, kur hyra tek ai, pas faljes: "Ti je halifi i zi?" Në këtë unë u përgjigja: " - D sunduesi i besimdrejtëve! Unë jam ai që është shpërblyer me falje."

Robi i Benu-l-Hashasit tha:

"Kur njriu e lavdon vlerën e vet, robi i Benu-l-Hashasit mund ta zëvendësojë me vargjet e veta mëngësinë e prejardhjes dhe fatit.

Nëse jam rob, shpirtin e kam të lirë e bujar:

Nëse trupin e kam të zi, shpirti im është i bardhë.

Në këtë El-Me'muni m'u përgjigj: "Xhaxha! Shakaja ime të solli në disponim serioz."

Ai atëherë ka cituar vargjet vijuese:

"Ngjyra e zezë e lëkurës nuk e zvogëlon mendjehollësinë e shpirtit As nuk e zvogëlon vlerën dhe mençurinë e të arsimuarit.

Nëse e zeza ka pjesë në ngjyrën e trupit tënd, bardhësia e sjelljes së mirë nga ana jote është pjesa ime."150)

Kështu zezaku i konvertuar përnjëherë zënë vend të barabartë në vëllazërinë e besimtarëve. Në rrugë nuk i qëndrojnë as ngjyra, as raca, as çfarëdo shoqërie më e hershme.

Nuk ka dyshi se pritja e bukur, në të cilën kanë hasur, ka ndikuar në atë që zezakët paganë mme dëshirë hyjnë në shoqëri religjioze, kultura e lartë e të cilës ka kërkuar që t'i lëshojnë shumë tradita dhe shprehi barbare.

Ajo që, njëkohësisht, në të shumtën i ndihmon shpjegimit të suksesit të kësaj feje është fakti që pranimi i islamit d.m.th. përpari mcivilizues dhe hap me rëndësi në progresin intelektual, moral dhe material të fiseve zezake.

343

Forcat që kanë qenë në anën e islamit kanë qenë aq të forta e superiore sa që barbarizmi, padituria dhe bestytia kanë pasur pak gjasa që ta vazhdojnë rezistencën.

Ç'i ka dhënë civilizimi i Afrikës muslimane zezakut, konvertitit, shkëlqyeshëm mëshhtë shprehur në fjalët vijuese: "Turpet më të mëdha, ngrënia e mishit të dërrit, flijimi i njeriut dhe gropimi i fëmijëve të gjallë, janë mbrapshtina që arsyeja nuk i beson. Një kohë kanë dominuar nëpër tërë Afrikën dhe ende mund të gjenden në shumë pjesë të saja. Tërë kjo nuk është larg nga Bregu i Artë dhe nga vetë vendbanimet tona, përnjëherë u zhduken përgjithmonë. Vendasit, që deri atëherë kanë jetuar lakuriqë ose gjysmëlakuriqë, filluan të veshen dhe këtë mjaft me rregull. Vendasit, që para kësaj nuk janë larë, filluan ta bëjnë këtë, dhe këtë jaft shpesh. Sheri'ati i shenjtë iu urdhëron pastrimin, dhe kjo është dispozitë që nuk ka pasur për pasojë ndikimin e fortë në instinktet e tyre natyrore.

Organizimi fisnor i jetës ka synuar drejt krijimit të hapësirës të diçkahit në fundamente më të gjëra. Thënë ndryshe, shkrija e fiseve në popuj, e me zmadhiin e forcës dhe dijes, nacionet bëhen imperatori. Shumë situata të këtilla mund të cekën në historinë e Sudanit dhe vendeve përreth gjatë kohës së njëqind viteve të fundit.

Nëse fryma luftarake këto i ka nxitur, qendrat nga të cilat ka buruar lufta numerikisht është i vogël, e përveç kësaj janë anash.

Lufta është organizuar më mirë edhe në njëfarë aspekti të përmbajtjes, dhe konflikti nuk imponohet pa arsye. Më pak ka konfiski të paarsyeshëm dhe siguria më e madhe është e pasurisë dhe jetës.

Themelohen shkollat fillestare (151) sikur ato që i ka përshkruar më herët Mungo Park. Madje sikur edhe këto shkolla të kufizoheshin në aftësimin e nxënësve të vet në leximin e Kur'anit, janë të vlefshme vetëvetiu dhe paraqesin një shkallë drejt asaj shumë më të lartës. Xhamia bukur e ndërtuar dhe pastër e mirë mbajtur me pesë herë thirrjen në namaz gjatë ditës, kthimin kah Mekkeja, me imamin e saj dhe me namazin javor të xhumasë, është bërë qendër e fshatit, në vend të fetishëve të tmerrshëm ose Gjugju-shtëpive.

Adhurimi i një Zoti, të Gjithmundshmit, Ekzistuesit, Gjithdijshmit dhe Gjithmëshirshmit, është përparim i pamatur mbi të gjitha ato që popullësia ka mësuar të adhurojë më herët.

344

Gjuha arabe, në të cilën gjithnjë janë shkruar librat muslimane, është gjuhë e bukurisë dhe pasurisë së shkëlqyeshme. Nëse njëherë e mësojnë këtë gjuhë, ai do të bëhet gjuhë e komunikimit të fiseve të gjysmës së kontinentit. Ai shërben si hyrje në letërsi, ose më mirë: ai është letërsi vetëvetiu.

Përveç kësaj, ajo është gjuhë e kodeksit të shkruar të ligjit dhe ndërrim i ekstravagancës tekanoze të kryeparit të fisit - ndryshimi që

është, vetëvetiu, përpari i madh civilizues.

Zejtaria dhe tregtia janë ngritur jo si grumbull tregtar i mallit ose si këmbim elementar i prodhimeve të papërfunduara, për të cilën dijmë prej Herodotit se ka ekzistuar në kohë të parë në Afrikë. As nuk janë si guacat, baruti, duhani ose rrumi, që ende shërbejnë si mjet kryesor të këmbimit përgjatë tërë Bregut, por këto janë prodhime zejtare të shkathtësisë së madhe dhe tregtia e organizimit të fuqishëm. Nën ndikimin e kësaj zejtarie dhe tregtia dhe qeverive majft stabile, me të cilat erdhi islami, u krijuan ato qytete të mëdha në tokën zezake. Ata janë mjaft të gjallë, si i përshkruajnë në fillim udhëpërshkruesit evropianë. Nuk kanë mundur thjeshtë t'i mospërfillin.

Jam larg nga ajo të them se religjioni është shkaku i vetëm i këtij përparimi proporcional. Unë vetëm them se ai është pajtuar me të dhe e ka nxitur.

Kushtet klimatike dhe shumë ndikime tjera kanë ndihmuar arritjes së këtij përparimi. Por, çka e nxitë Afrikën pagane kur rrethanat janë aq të ngjashme të bëjë krahasim me atë gjendje dhe sukses?

Sa i përket personalitetit, mund të besohet, në çdo aspekt, se islami u ka ofruar konvertitëve të ri të zi fuqi, krenari dhe mbështetje në veten dhe vetërrespekt, kurse tërë këto cilësi rrallë mund të gjenden të bashkëqytetarët e tyre paganë e të krishterë.152)

Paraprakisht kemi shkruar që - para ndarjes së pjesës së madhe të Afrikës në mesin e qeverive të krishtera evropiane. Anglisë, Francës dhe Gjermanisë - karakteri imponant i civilizimit islam nuk ka pushuar që të mbillet në shpirtin e zezakut dhe të ndikojë si një nga faktorët që ndihmon në konvertimin e idhujtarëve afrikanë.

Befasisht të përcjellur në kontakt me kulturën evropiane, kanë fituar motiv të nisen shtegut të civilizimit, por kanë qenë të paaftë ta kapërcejnë pafundin që i ka ndarë nga sunduesit e tyre të huaj.

Në islam mkanë gjetur kulturën që u përgjigjet nevojave të tyre dhe e cila është e aftë t'i miratojë kërkesat dhe synimet e tyre.153)

345

Për këtë shkak ka qenë iluzore që përhapja e dominimit evropian synon pengimin e aktivitetit të propaganduesve islame".

Përhapja e këtij dominimi në të vërtetë me të madhe ka ndihmuar përparimin e islamit.

Hyrja e islamit ka ndihmuar futjen së qetësisë në vendet - që më herët kanë qenë të rraskapitura me luftërat ose sulmet zhdukëse të gjuetarëve në robër dhe vënies së instrumentit të pushtetit dhe administratës dhe lehtësimit dhe zmadhimit të mjeteve të komunikimit me ndërtimin e rrugëve dhe hekrudhave.

Tërë kjo me të madhe ka stimuluar tregtinë dhe ka mundësuar aktivitetin e propaganduese, tregtarëve muslimanë, që ta shtijnë ndikimin e vet në viset në të cilat para kësaj nuk ka shkelur këmba e njeriut dhe ta kalojnë vendin e njohur me siguri të plotë.

Më tej, ndalimi i tregtisë me robër ka abroguar një pengesë të madhe në rrugën e përhapjes së islamit në Afrikën pagane. Kjo ka qenë në interes të Arabëve dhe tregtarëve të tjerë muslimanë me robër që mos ta ngushtojnë fushës e punës së vet, me lejin e vet sakrificave të mundshme që të vëllezërohen në islam.154)

Tash në islam hyjnë fiset pagane deri te të cilat nuk ka depërtuar aktiviteti misionarist nga koha e tregtisë me robër.

Qeveritë evropiane kanë ndihmuar që të arrihet ky rezultat duke i marrë muslimanët në shërbimet e dorës së dytë të administratës civile (sepse vetëm në mesin e muslimanëve kanë mund të gjenden persona të arsimuar) dhe duke i sistematizuar në viset pagane dhe duke i pranuar mësuesit muslimanë në shkollat shtetërore ose duke i rekrutuar ushtritë e veta në mesin e fiseve muslimane. me këtë ato kanë kontribuar autoritetit të islamit në sytë e Afrikanëve paganë, kurse ky është rast që muslimanët nuk e kanë lëshuar ta shfrytëzojnë për fenë e vet.155)

Krejt pak të vërtetë ka në pohimin se islami përparon me forcë të armës,156) por çështja është krejtësisht e kundërt me këtë. Ndarja e Afrikës në mesin e forcave evropiane e ka nxjerrur shpatën e dora e kryeparëve muslimanë. Nën kontrollin e tyre tash ka filluar propaganda e islamit, që ka gjasa të ketë sukses, dhe këtë në kohën kur vendet me pushtetin muslimanë shkatërrohen.

346

1) Harta e shkëlqyeshme që e shpjegon shtrirjen e islamit në Afrikë mund të gjendet në "The International Review of Missions", vol. I, fq. 652.

2) Fournel, vol. I, 271.

3) Emri i vërtetë i saj është i panjohur.

4) Fournel, vol. I, fq. 224.

5) Markkari, vol. I, fq. 253.

6) Makkari, vol. I, fq. LXV.

7) Fournel, vol. I, fq. 270.

8) Për këtë dhe për lëvizjet heretike, që i kanë zbuluar mbeturinat e besimit të vjetër berberë, shih: Goldziher, Materialien zur Kenntnies der Almohaden bewegung in Nordafrika (Z.D.M.G. vol. XLI, fq. 37, sqq.)

9) Për këtë fjalë shih: Doutte, Noes sur l'islam maghribin (Revue de l'histoire des religions, bl. XLI, fq. 24-26).

10) Ibn Abi Dharr, fq. 168-173; A. Müller, vol. II, fq. 611-613.

11) Ibn Abi Dharr, fq. 250; Goldziher, op. London, fq. 31.

12) Leo Africanus (Ramusia, bl. V, fq. 11).

13)

14) DouttÉ, XL, fq. 354; XLI, fq. 26-27.

15) Depont et Coppoloni, fq. 127, sq.

16) Nuk është këtu vendi që të ekspozohet fillimi dhe historia politike e mbretërive të ndryshme të Afrikës perëndimore. Kjo më së ploti i është e mundshme lexuesit anglez në punimin e Lady Tugardit me titull:

“E Tropical Dependency. An Outline of the Aucient History of the Western Sudioniwith Account of the Modern Settlement of the Western Sudoniwith Account of the Modern Settlement of Northern Nigeria” (London, 1905), Shih po ashtu: H. F. helmult: The World’s History, vol. III, kaptina IX (London, 1903).

17) Blau, fq. 322.

18) Leo Africanus (Ramusio, bl. I, fq. 7,77).

19) Mayer, fq. 91.

20) As’Sa’di, Tarikh al’Sudan, fq. 3 (Paris, 1898).

21) Xhine apo Diniyye.

22) Meyer ndjek Barhta: The Tarikh al-Sudan (fq. 12). dhe vë datën e themelimit të qytetit - tre shekuj më herët.

347

23) Felix Dubois, në punën e et “Tombaucton la Musteriense”, kaptina IX, jep planin e rekonstrukcionit të kësaj xhamie e cila është rrënuar me urdhërin e Shejh Ahmedit rreth 1830.

24) As’Sa’di, Tarikh al-Sudan, fq. 12-13.

25) Ibid., fq. 21.

26) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 421-422.

27) Ramusio, bl. I, fq. 78.

28) Winwood Rede i përshkruan si të lartë, me pamje të bukur, ngjyrë të ndritshme, muslimanë të devotshëm. Posedojnë kuaj dhe kope të shumta, kultivojnë pamukë, arra dhe lloje të ndryshme të drithërave. Jam kënaqur në mirësinë dhe pritjen e tyre, me pamjen serioze dhe të denjë të grave të tyre, me pastërtinë dhe paqën e fshatrave të tyre.” (W. Winwood Reade, African Shetchbook, vol. I, fq. 303).

29) Waitz, II, Theil, fq. 18-19.

30) Palmer (fq. 59) e vë hyrjen e islamit në Kano ndërmjet vitit 1349 dhe 1385. Një histori tjetër e Hansit e vë fillimin e sundimit të mbretit muslimanë Zozoa rreth 1456 (Journal of the African Society, vol. IX, fq. 161).

31) Mbi llojet e këtyre krahinave shih Meyer, fq. 27.

32) Siç është rasti edhe në pjesët tjera të botës islame, tradita e vë hyrjen e islamit në kohën e themeluesit të saj dhe ia jep emrin al’Farisija, një nga shokët e njohur të Pejgamberit, si të deleguar të popullit Hans. (J. Lippert, Sudanica, M. SOS, III, pjea III, fq. 204 (Berlin, 1900).

33) Mischlich and Lippert, fq. 138-139.

34) Mayer, Loc. cit. Artin Pasha (fq. 62) e vë fillimin e kësaj hyrje të Arabëve muslimanë në shekullin e hershëm VIII.

- 35) Becker, GEschichte des osthichen Sudan, fq. 162-163, Blan, fq. 322, Opper, fq. 289.
Në fund të shekullit XIV Omer b. Idrisi e ka bartur kryeqendrën e vet në perëndim të liqenit të Çadit në teritorin e Bornusë me të cilin emër mbretëria Kanem në të ardhmen është e njohur.
- 36) Becker, Geschichte des ostlichen Sudan, fq. 161-162.
- 38) R. C. Slatin Pasha, Fire and Sword in the Sudan, fq. 38, 40-42 (London, 1896).
- 39) Westermann, fq. 628.
- 40) Opper, fq. 292; Mayer, fq. 36-37; Westermann, fq. 629-630. 348
- 41) Fulbi (njëjësi Ful) është emër me të cilin vetë populli veten e ka quajtur. Rreth njëqind variantat tjera ua kanë dhënë fqinjët e tyre, kurse më të përhapurit janë Fuli dhe Fulani (Meyer, fq. 28).
- 42) Francis Moore, fq. 75-77.
- 43) R. E Dennett, Nigerian Studies, fq. 12, 75 (London, 1910).
- 44) Islam and Missions, fq. 71-73, The Moslem World, fq. 296-297, 351.
- 45) Church Missionary review, 1908, fq. 640.
- 46) Qyteti në Niger, në jug të kufirit verior të Nigerisë jugore.
- 47) Church Missionary Society Intelliguencar, 1902, fq. 353.
- 48) Rinn, fq. 403-404.
- 49) Le Chatelier (1), fq. 231-293.
- 50) Le Chatelier (2), 89-91.
- 51) Rinn, fq. 175.
- 52) Bonet - Maury, fq. 239.
- 53) Bonet - Maury, fq. 230.
- 54) Le Chatelier (w), fq. 100-109.
- 55) Rinn, fq. 174.
- 56) Opper, fq. 292-293; Blyden, fq. 10; Le Chatelier, (3), fq. 167.
- 57) Delle Navigazioni di Messer Alvise da ca da Mosto (A.D. 1454), Ramusio, bl. I, fq. 101.
- 58) Blyden, Christianity, Isla and the negro Race, fq. 357-360.
- 59) Këtë pyetje gjerësisht e ka shtruar Le Chatelier (3), fq. 225 sqq.
- 60) LA Chatelier (3), fq. 237, "Samari direkt nuk është përzier në pyetjet fetare." L. G. Binger ka ardhur deri te përfundimi i njëjtë, në bazë të kontakteve personale me Samarin (Le Peril de l' Islam, fq. 20), Paris, 1906).
- 61) Le Chatelier (3), fq. 238-240.
- 62) Le Chatelier (2), fq. 112; R. du M. M., vol. XII, fq. 22.
- 63) "Fulanët të gjithë janë muslimanë zelltarë: kudo që janë Fulanët, atje und të gjenden edhe xhamitë" (Haywood, fq. 200).
- 64) Le Chatelier (3), 231, 273, 303; Westermann, fq. 632-633.
- 65) Muhammed b. Uthman al'Hasha'ishi, fq. 84 e më tej.

- 66) Sidi al'Mahdi, i biri dhe trashëgimtari i Sidi Muhammed es-Senusise më 1895 u shpërngul në Kufur, sepse më shumë ishte në qendër të Xhagbubës (MUhammed b. Uthman al'Hasha'ishi, fq. 11-115). Më vonë ka shkuar më tej drejt jugut në drejtim të krahinës 349
Borku dhe Tibesti, ku edhe vdiq në vitin 1902. Eprori i kësaj bashkësie në vitin 1908 ka qenë Sidi Ahmedi, kushëriri i themeluesit (J. C. E. Falls, *Drei Jahre in der Libyschen Wüste*, fq. 274) (Freiburg, 1911).
- 67) Reidel (I), fq. 7, 59, 162.
- 68) G. Nachtigal, *Sahara und Sudan*, vol. II, fq. 175. (Berlin, 1879-1881).
- 69) Duveyrier, fq. 45.
- 70) Poulitschke, fq. 214.
- 71) H. Duveyrier, *La Conferie musulmane de Sidi Mohammed ben Ali, Es-Senousi*, passim, Paris, 1886, Lonis Rinn, Marabauts et Khouans, fq. 481-513. N. Slonsch, *Les Senonsiya en Tripolitaine* (R.du . M. vol. I, fq. 169, sqq.). Mbi bibliografinë e lëvizjes senusite shih: *Der islam*, III, fq. 141-142, 312.
- 72) R.du M.M. vol. I, fq. 181; vol. III, fq. 64-65.
- 73) Joseph Thomson, (2), fq. 185.
- 74) Opper, fq. 303.
- 75) Gjendet në krahinën Muri në Nigerinë veriore.
- 76) *Journal of the African society*, vol. VII, fq. 379-381.
- 77) Haywood, fq. 33.
- 78) Claude George, *The Rise of British West Africa*, fq. 120-121. (London, 1902).
- 79) *Islam and Missions*, fq. 73-74.
- 80) Lippertt, *Über die Bedeutung der Haussonation für unsere Togo - und Kamerunkolonie*, fq. 200, MSOS, Band, X (1907), Abteilung, III.
- 81) Waitz, II, Theil, fq. 250.
- 82) C. S. Salomon, fq. 891.
- 83) Pierre Bouche, fq. 256.
- 84) Blyden, fq. 357.
- 85) C. S. Salman, fq. 887.
- 86) Blyden, fq. 202. Westermann, fq. 633-634.
- 87) Gjendet në ujdhesë në largësi 20 në jug të Zanzibarit.
- 88) J. de Barros, Dec. Liv. VIII, cop. IV, fq. 211.
- 89) Ibn Khaldun, vol. III, fq. 98-100.
- 90) Ka mundësi që kjo është fjala e shtrembëruar prej al'Hasa. Shih Ibu Batutah, bl. II, fq. 247-248.
- 91) Ose (emri arab) Maqdishu.
350
- 92) J. de Barros, Dec. i. Liv. VIII, cop. IV, fq. 211-212.

- 93) De Barros, id. fq. 224-225. Shih po ashtu Justus Strandes, Dic. Portugiesen - zeit von Deutsch und Englisch - Ostafrika, fq. 81, sqq., Berlin, 1899.
- 94) Kitab agaib al-Hind, on Liore des Merveillas de l'Hinde, bublie par P.A. von der Lith., fq. 81-68 (London, 1883).
- 95) Mohammedanism in Central Africa, by Joseph Thomson, fq. 877.
- 96) Roscoe, fq. 229.
- 97) Zwemer, fq. 236 gairdner (fq. 26) jep numrin prej 200.000 muslimanëve prej gjithsej 4 milionë banorë, por ai nuk sjell burimin prej nga e merrë këtë të dhënë. Roscoc (fq. 6) përmend që tërë popullësia e Ugandës është rreth një milioni.
- 98) Richter, fq. 146-147, 164. Merenskog, fq. 156; Klamroth, fq. 4.
- 99) R. Du M. M. vol. IX (1909, fq. 322.
- 100) Oscar Baumann, Usambara und seine Nachbargebiete, fq. 141, 153 (Berlin, 1891).
- 101) Becker, Islam in Deutch - Ostafrika, fq. 10.
- 102) Becker, Islam in Deutsch - Ostafrika, fq. 13 sqq. Klamroth, fq. 14-28.
- 103) Ibid., fq. 5.
- 104) Klaru Roth, fq. 23-24.
- 105) Ibid., fq. 26.
- 106) Ibid., fq. 67.
- 107) Becker, Islamin Deutsch - Ostafrika, fq. 14. The Moslem World, vol. II, fq. 3 sqq.
- 107/a) Një raport bashkëkohor etipian për këto fise - Geschichte der Galla. bericht eines abessinischen Monches uber die Invasion der Galla in sechzehnten Jahslundert. Tekt und Ubersetzung hrag. Von A. W. Schleichler (Berlin, 1809) i paraqet këto fise si pagane, ndonëse nuk jep informata të hollësishme për fenë e tyre. Reclus (bl. X, fq. 330) konsideron se kanë qenë muslimanë në kohën e atakut të tyre.
- 108) Henri Salt, A. Voyage to Abyssinia, fq. 299, (London, 1814).
- 109) James Bruce, Travels to discover the source of the Nile, botimi II, vol. III, fq. 243 (Ediuburgh, 1805).
- 110) Munzinger, fq. 408.
351
- 111) J. L. Krapf, Reisen in Ost - Africa, ansgefuhrt in den Jahren 1837-1855, ol. I, fq. 106 (Kornthal, 1858).
- 112) Arabia Deserta, vol. II, fq. 169.
- 113) Ibid., vol. II, fq. 109.
- 114) Morie, vol. II, fq. 248.
- 115) Reclus, bl. X, fq. 309; Basset, fq. 270-271.
- 116) Kur romakokatolikët e hapën msionin e vet ndër Gallët në vitin 1846, Abba Baghibo in ka thënë: "Sikur të kishit ardhur këtu

dhjetë vjet më harët, jo vetëm unë, por edhe bashkëqytetarët tjerë të mi do ta pranoin fenë tuaj, por kjo tash është e pamundur" (Massaja, vol. IV, fq. 103).

117) Da Zeila alle frontiere del Caffa, vol. II, fq. 160; (Rome, 1886-1887); Massaja, vol. IV, fq. 103, vol. VI, fq. 10.

118) Massaja, vol. IV, fq. 102.

119) Duke folur për mossuksesin e misioneve të krishtera, Cechi (Seçi) thotë: "Duket kërkuar shkakun për këtë në përhapjen e islamit këtu gjatë viteve të fundit, bartësit e të cilit janë qindra ulema dhe tregtarë muslimanë, të cilëve nuk u kanë munguar mjete materiale, gjeturi dhe mundësi gjuhësore." (Massaja, vol. II, fq. 342.).

120) Massaje, vol. II, fq. 343.

121) Reclus, bl. XIII, fq. 834.

122) Lage gjendet në gjatësinë 90 dero 90300 dhe gjërësinë 340 deri 350 në lindje.

123) Reclus, bl. X, fq. 350.

124) Paulitschke, fq. 330-351.

125) ibn Hawqal, fq. 41.

126) Abul-Fida, bl. II, pjesa I, fq. 231-232.

127) Documents sur l'histoire, la geographie et le commerce d l'Afrique orientale, recueillis par M. Guillain Deuxieme partie, bl. I, fq. 299, (Paris, 1856).

128) R. F. Burton, First Footprints in East Africa, fq. 76, 404 (London, 1856).

129) R. du M.M., VI, fq. 288 (1908).

130) Kepi i Shpresës së Mirë ka qenë në pronësi të Holandezëve prej 1652 deri 1759. E kanë kthyer në vitin 1803 pas paqës në Amijami, pas çkahit sërish e kanë okupuar Britanikët pas shpërthimit të luftës së re.

352

131) Në mesin e tyre ka qenë shejh Jusufi, mësues i fesë, me ndikim të madh në Java dhe trimi i fundit për pavarësinë e Bautamit. Si të burgosur shtetëror Holandezët e kanë sjellur në koloninë Kap atë dhe familjen e tij si dhe një numër të caktuar të ithtarëve të tij. Varri i tij ende respektohet si vend i shenjtë. (G. M. Theal, History and Ethnography of Africa south of the Zam-besi, vol. I, fq. 263), (London, 1909).

132) M. J. de Goeje, Mohammedaansche Propaganda, fq. 2,6 (Overgedrukt uit de Nederlandsche Spectator, No. 51 1881).

133) Për ta ka tërhequr vëmendjen Mr. Kambell (Campbell) 1814. Shih: William Adams, the Modern Voyager and Traveller, vol. I, fq. 93, (London, 1834).

134) Sir T. E. Colebrooke, The Life of H. T. Colebrooke, fq. 335 (London, 1873).

135) F. Coillord, Au Cap de Bonne Esperance (Journal des

- missions evangeliques, a vril 1899, fq. 265).
136) Kumm, fq. 233.
137) C. Snouck Hurgronje (3), vol. II, fq. 296-297.
13) Jacques Bonzon, Les Missionnaires de l'islam en Afrique (Revue Chretienne, bl. XIII, fq. 295). Paris, 1893).
139) G. Ferrand, Les Musulmans a Madagascar, fq. 19, 50, sqq.
138 (Paris, 1891), Id. Les Migrations musulmanes et juives a Madagascar (Revue de l'Histoire des Religions, vol. LII, fq. 381, sqq).
140) Richard F. Burton (I), vol. I, fq. 256.
141) Travels in the Interior of Africa, chop. XXV, adfin.
142) D. J. East, fq. 118-120. W. Winwood Reade, vol. i, fq. 312, Blyden, fq. 13, 202.
143) Bishop Crawther, On Islam in Western Africa (Church Missionary Intelligencer, fq. 254, Aprill 1888).
144) D. J. East, fq. 112-113, Blyden, fq. 202.
145) Thuhet se mbi njëmijë misionarë islamë çdo vit e lëshojnë Tripolin për të vepruar në Sudan (Panlitschke, fq. 331).
146) Për hollësitë e hulumtimit të këtyre piakve të kontaktit shih: Forget, fq. 28 sqq. Merensky, fq. 155.
147) Sir Bortle Frere (I), fq. 18-19.
148) E. W. Blyden, fq. 18-24. E. Allegret, fq. 200. Westerman, fq. 644-645.

353

Në një debat mjaft interesante, por sot të harruar para Shoqërisë autropologjike e misionarëve në mesin e të egërve, është përmendur rasti i misionarit të krishterë në Afrikë që është martuar me zezaken. Ndjenjat kundruall atij dhe pasojat kanë qenë të atilla që është detyruar të lëshojë koloninë. Misionari musliman punon, por jo në pozitë të tillë jo të favorshme.

(Journal of the Anthropological Society of London, vol. III, fq. 1865).

Dallimin në mënyrën se si krishterizmi dhe islami e prezentojnë veten në Afrikë mirë e ka paraqitur njeriu që vetë është zezak në pasusin vijues: "Deri sa delegacionet misionariste caktojnë emërimin e klerikëve vendas kohës së pacaktuar, në anën tjetër misionarët muslimanë veprojnë në zemrën e Afrikës dhe me lehtësi arrijnë deri te paganët dhe i kthejnë në islam. Për këtë arsye zezakët shikojnë në islam si në fenë e zezakëve, e në krishterizmin sikur në fenë e të bardhëve. Shohin se krishterizmi e fton zezakun drejt shpëtimit, por e vë në pozitë nenshtruese deri në atë masë që ai në vete thotë, deri sa e kaplon dëshpërimi: "Unë nuk kam pjesë dhe lumturi në këtë fe. Sa i përket islamit, ai botën e thërret në shpëtim mdhe i thotë: "Arritja e shkallës më të lartë të mundur varet nga vetë ti."

Për këtë shkak zezaku hynë me entuziazëm, me shpirt dhe me trup në këtë fe.

L'islam met le christianisme an Afrique d'apres un Africain.
(Journal des Missions Evangeliques, 633 annce, fq. 207 (Paris, 1888).

149) E. D. Morel, Nigerio, its people and its pro blems, fq. 216-217 (London, 1911).

150) Ibn Khallikon, vol. I, fq. 19.

151) Zgjidhjet nga Kur'ani janë forma të mësimëve fillestare për leximi për fëmijët. Sa i përket tefsirit (komentit) dhe punimeve tjera të shkruara në lidhje me këtë, ato i furnizojnë lëndët kryesore në studimin e mëtejshëm.

Shkollat themelore janë të nivelit të ndryshëm, para disa shekujsh, në vendet e ndryshme të brendshme zezake, nën drejtimin e ligjit.

Në to arsimohen madje edhe të varfërit me shpenzime të popullit.

Meritorët ndër ta vazhdojnë shumë vjet studimet e gjata gjatë shkollimit të rregullt, Sistemi i studimeve nuk kufizohet në gjuhën arabe ose në punimet e autorëve arabë.

354

Numri i caktuar i gjuhëve të vendit i është përshtatur shkrimit.

Librat janë përkthyer nga gjuha arabe, kurse edhe punimet origjinale shkruhen në ta. Janë hapur shkolla në të cilat mësohen edhe gjuhët e vendit. "Condition and Character of Negroes iu Africa. By Theodore Dwight. (Methodist Quarterly Review, Jonuary, 1869). Dr Blyden (fq. 206-207) cek librat vijuese që i lexojnë muslimanët e Afrikës përëndimore: Mekamet e Haririt, përkthimet e Aristotelit dhe Platonit në gjuhën arabe, versioni arab i Hipokratit dhe përkthimi arab i Dhjatës së Re, dhe Psalmet që i ka botuar Shoqata biblike amerikane. Në lidhje me literaturën islame të muslimanëve të Afrikës lindore shih: Becker, Islam in Deutsch Ostafrika, fq. 18, sq..

152) Mohammedanism in Africa, by R. Bosworth Smith (The Nineteuth Ceutury, Decembar, 1887, fq. 798-800).

153) La Chatelier, (3), fq. 348.

154) Farget, fq. 95; Mereusky, fq. 156.

"Dobinë që muslimanët e kanë pasur nga eksploatocioni i popullësisë vendëse ka qenë më e madhe nga ajo që e kanë pasur nga përhapja e islamit në mesin e tyre. Sikur ata popujt e Afrikës t'i kthenin në islam me anë të metodave shpirtërore, do t'iu bëheshi vëllazër sipas feje dhe do të ishi me ta të barazuar në të drejta. Atëherë do t'iu bëhej e ndaluar që t'i vjedhin dhe robërojnë dhe ta shfrytëzojnë punën robërave."

155) Westermann, fq. 643, L. de Contenson, fq. 244; Kumm, fq. 122.

156) Në lidhje me këtë Merensky, kur flet për humbjen e rastit të islamit që të dominojë me tërë Afrikën pasi që kaloi okupacioni shekullor, thotë:

"Gjejmë se shkaku kryesor i këtij fenomeni të çuditshëm në raporte është ai që fuqia e jashtme e islamit te muslimanët dhe te

përhapja e islamit shkojnë së bashku, përzihen dhe hapërojnë tok përpara dhe mbrapa." (fq. 156).

KAPTINA XII

PËRHAPJA E ISLAMIT NË ARKIPELAGUN MALEZIAS

355

Historia e arkipelogut Malajas në periodën e 600 viteve të fundit na ofron një prej kaptinave më interesante të tregimit për përhapjen e islamit me angazhim misionarist.

Gjatë tërë kësaj periode gjejmë prova të aktivitetit kontinuitiv të pjesës së misionarëve muslimanë në një apo në ujdhesën tjetër të Indisë lindore.

Sido qoftë, në filli puna e tyre është udhëhequr pa kurrfarë mbikqyrje dhe ndihme të drejtuesit të vendit, vetëm me fuqinë e besimit, por në të shumtën e rasteve edhe me ballafaqimin me opozicionin e fuqishëm, veçan nga ana e Spanjollëve.

Por, përkundër të gjitha vështirësive, me sukses mashtrues ata kanë vazhduar punën e et. Me aktivitetin e palodhshëm e kanë përkryer punën e vet (veçan në kohën bashkëkohore), sado të jetë i pjesërishëm ose i mëngët.

Është e pamundur të caktohet koha e hyrjes së pari të islamit në arkipelogun Malajas. Mbase atje e kanë sjell tregtarët arabë në shekujt e parë të Hixhretit shumë më parë se sa që kemi çfarëdo prove historike për ndikimet e këtilla në vepër.

Ajo që këtë supozim me bënë të mundshëm është njohja që e kemi për tregtinë e zhvilluar të Arabive me Lindjen qysh nga kohët e hareshme.

Në shekullin II para Krishtit tërë tregtia me Cejlonin ka qenë në duart e tyre.

Në filli më shekullit VII të erës së krishterë tregtia me Kinën nëpërmjet Cejlonit ka arritur depërtim të konsiderueshëm ashtu që kah mesi i shekullit VIII tregtarët arabë mund të gjenden me numër të madh në Kanton.

Në kohën ndërmjet shekullit X dhe XV, deri në ardhjen e Portugalezëve, Arabët kanë qenë zotërinj në aleancë të tregtisë me lindjen.1)

Për këtë shkak mundemi të parandiejmë me pohi më sigurtë se ata kanë themeluar kolonitë e veta tregtare në disa ujdhesa të arkipelogut Malajas, siç e kanë bërë këtë në vendet tjera në periodën mjaft të hershme.

ndonëse nuk përmenden këto ujdhesa në punimet e gjeografëve arabë para shekullit IX,2) megjithatë në analet kineze nga viti 674 ekziston lajmi për udhëheqësin arab për të cilin sipas lajmeve të

356

mëvonshme konsiderohet se ka qenë udhëheqës i një kolonie arabe në bregun perëndimor të Sumatres.3)

Sido qoftë, misionarët është dashur të vijnë në arkipelogun Malajas nga India jugore, që dëshmohet me cilësitë e caktuara të teologjisë islame që banorët e ujdhesës e kanë miratuar.

Shumcia e muslimanëve të Arkipelogut i takon shkollës juridike sha'fiite. Ajo deri sot dominon në brigjet e Karomandevë dhe Mallabareve, siç ka qenë rasti edhe kah mesi i shekullit XIV kur këto treva i ka vizituar Ibn BAute.4)

Nëse marrim që muslimanët e vendeve përreth i përkasin drejtimit hanefit, dominimin e mësimit shafiit dhe përvetësimin e tij mund ta shpjegojmë vetëm me atë se ai është sjell atje nga bregu Mallabaras, kurse kjo është pjesë që shumë e kanë vizituar tregtarët nga Java, prej Kinës, Jemenit dhe Persisë.5)

Me siguri se shi'izmi, gjurma e të cilit ende mund të gjendet në javë dhe Sumatra, ka ardhur nga India ose Persia.

Nga ibn Batuta mësojmë se sulltani musliman, i Samudres*) ka hyrë në lidhje miqësore me pallatin në Delhi.

Në mesin e dijetarëve juridikë (fukaha), që ky sundues veçan i ka favorizuar, kanë qenë dy kadi me prejardhje persike. Njëri erdhi nga Shirazi, kurse tjetri nga Isfahani.6)

Por shumë para kësaj kohe tregtarët nga Dekani, nëpërduart e të cilëve ka kaluar tregtia e shteteve muslimane të Indisë dhe arkipelogut Malajas, në numër të madh janë përqëndruar në limanet tregtare të këtyre ujdhesave, ku e kanë mbjellur farën e fesë së re.7)

Për ekzistimin e popullësisë vendase muslimane, për islamin e të cilëve gjejmë gjurma në shkresat e hershme historike, duhet t'i falënderohemi përpjekjeve misionariste të tregtarëve arabë dhe indusë. Duke i banuar qendrat tregtare, ata janë martuar me gratë e popullësisë vendëse. Nga këto gra dhe robër paganë në familje është themeluar bërthama e shoqërisë muslimane, anëtarët e së cilës kanë dhënë çdo angazhi që ta forcojnë.

Përshkrimi vijues i metodës që e kanë përvetësuar këta tregtarë, misionarët në ujdhesat Filipinase, na ofrojnë, pa dyshim, pasqyrën e praktikës që e kanë pasur edhe gjeneratat e mëhershme të tregtarëve muslimanë. Mënyra më e mirë për kyqjen e fesë së vet në vend për muslimanët ka qenë marrja e gjuhës dhe shumë traditave të vendasve të vjetër, martesat me gratë e tyre, blerja e robërve që ta ngrisin namin

357
personal dhe në fund kanë arritur të përzihen në mesin e atyre shtresave që i kanë zënë pozitën më të rëndësishme në shtet.

Së bashku kanë punaur me mjeshtri të madhe dhe harmoni më mirë se njerëzit vendas. Shkallërisht gjithnjë e më shumë janë forcuar.

Pasi kanë poseduar numër të madh robërish, kanë bërë njëfarë aleance reciproke, kanë konstituar një lloj të monarkisë dhe e kanë bërë trashëguese në një familje.

Ndonëse aleanca e këtillë i ka forcuar, megjithatë kanë ndier

nevojën për mbajtjen e lidhjeve miqësore me aristokracinë e vjetër. Nevojën e njëjtë e kanë ndier edhe të siguri i lirisë së vet te kjo klasë. Përkrahejs dhe ndihmës së tyre nuk kanë mund t'i shmangen."8) Duket se pa tjetër, në mënyrën çfarë është kjo, që vendbanimet e ndryshme muslimane në arkipelogun Malajas kanë vënë bazën politika dhe shoqërore për veprimin e vet prozelit. Ata nuk kanë ardhur si pushtues, sikur Spanjollët në shekullin XVI, as nuk e kanë përdoruar shpatën si mjet për konvertimin e detyrueshëm.

Për vetë nuk kanë përvetësuar me arrogancë privilegjet e racës superiore dhe sunduese që ta zhvlerësojnë dhe ndjekin popullësinë e vendit, por në mënyrë modeste kanë ardhur në veshjen e tregtarit. Tërë inteligjencinë dhe kulturën e vet të lartë e kanë vënë në shërbim të fesë së vet se që i kanë përdoruar për prestigjin personal ose për rritjen e pasurisë.9)

Krahas kësaj pasqyre të përgjithshme të mjeteve ndihmuese, që i kanë pranuar, do të vazhdojmë me ekspozimin e përpjekjeve të tyre në rrugën e përhapjes së islamit në ujdhesat e ndryshme përreth.

Islami në Sumatra

Tradita flet se islami në Sumatra ka ardhur nga Arabia, por për besimin e tillë nuk ka bazë të saktë historike.

Të gjitha të dhënat dëftojnë në atë se India është burim nga i cili popullësia e Sumatras ka fituar dijen e vet për fenë e re.

Lidhjet aktive tregtare me shekuj kanë ekzistuar ndërmjet Indisë dhe arkipelogut Malajas. Ka mundësi që misionarët e parë në Sumatra kanë qenë tregtarët indusë.10)

Nuk ka të dhëna historike për punimet e tyre, kurse kronikat malajase ia atribuojnë nderiu e thirrjes së parë në islam në qytetin 358

Atxheh, në veriperëndim të Sumatras, një Arabi me emrin Abdullah Arif.

Për të thuhet se Ujdhesën e ka vizituar rreth mesit të shekullit XII.

Një ithtar i tij Burhanuddini, thotë, e ka përcjellur diturinë mbi islamin në bregun perëndimor deri në Priaman.11)

Ndonëse kjo e dhënë është e pasigurtë, megjithatë ai shpjegon ekzistimin e aktivitetit të caktuar misionarist në këtë periudë.

Kronika Malajase nga Atxhehu jep në vitin 1205 si datë të kyqjes në fron të Xhuhanshahut, sipas transmetimit të themeluesit të dinastisë muslimane.

Për të thuhet se ka qenë i huaj nga perëndimi dhe se ka ardhur në këto brigje të thërret në fenë e Pejgamberit.

Shumë njerëz i ka kthyer në islam. Është martuar me gruan nga ai popull, që e ka përhëndetur si mbretin e vet me titullin Sri Padukasulltan, gjysma me shprehje sauskriste, gjysma arabe.

Një kohë të caktuar feja e re është kufizuar kryesisht në limanet në

të cilat kanë arritur tregtarët muslimanë. Përparimi i kësaj feje në brendi të vendit ka qenë diç m i ngadalshëm, sepse ajo këtu është ndeshur me ndikimin e fuqishëm mhindus që ka pasur qendrën e vet në mbretërinë Menangkabau.

Marko Polo, që ka kaluar pesë muaj në bregun verior të Sumatrës në vitin 1292, thotë se tërë popullësia ka qenë pagane përveç mbretërisë së vogël Porlak në këndin verilindor të Ujdhesës. Këtu vetëm popullësia qytetare ka qenë muslimane, sepse në këtë mbretëri, duhet ta dishë, shumë shpesh janë kthyer tregtarët saracenas (muslimanë), të cilët popullësinë e vendit e kanë kthyer në ligjin e Muhammedit, por popullata malore është në tërësi pagane dhe konibaliste."12)

Më tej, një kronikë malajase thotë se sulltan Ali Mugajat-shahu, që ka sunduar me Atxhehun prej vitit 1507 deri 1522, ka qenë shembulli i parë i kalimit në islam, në çka do ta ndjekin shtetasit e tij.13)

Duket se nderi i sunduesit të parë musliman të shtetit i është dhënë oreolit të monarkut që e ka vënë themel madhështisë së Atxhehut dhe ka filluar ta zgjeroj ndikimin e vet në vendet përreth.

Ai barabartë ka shkaktuar ngjalljen ose i ka dhënë nxitje të freskët jetës fetare të shtetasve të vet duke iu dhënë së pari dijen për fenë e Pejgamberit. Natyrisht, islami është përforcuar në Sumatra shumë më herët se kjo kohë.

359

Siaps traditës që flet për qytetin Samudra, sherifi i mekkes e dërgoi një mision që popullin e Sumatrës ta kthejë në islam.

Shef i këtij misioni ka qenë njëfarë shejh Ismaili. Vendi i parë me të cilin erdhën në kontakt pas lëshimit të Mallabarit ka qenë Pasuri (ka mundësi të ketë qenë i situuar diç më tej në bregun perëndimor) popullësia e të cilit, duke iu falënderuar thirrjes së tyre, ka kaluar në islam.

U nisën pastaj drejt anës veriore drejt Lambres dhe lundruan Ujdhesën deri sa nuk erdhën në anën tejtër të saj. Prej aty lundruan deri në Ara, në bregun lindor, e ai gati është në anën e kundërt të Malakës. Në të dy këto vendet përpjekjet e tyre janë kurorëzuar me suskese të ngjashme.

Në Ara kanë pyetur për Samudrën, qytet në bregun verior të Ujdhesës, i cili ka qenë objekt i veçant i misionit të tyre, por kanë konfirmuar se e kanë kapërcyer.

Për këtë shkak rrugës së njëjtë janë kthyer në Parlak, ku Marko Polo, para disa vitesh, ka gjetur bashkësinë muslimane. Pasi që atje po ashtu fituan konvertitë të ri, vazhduan për në Samudra.

Këtë qytet dhe mbretërinë me këtë emër më vonë e ka themeluar njëfarë Mara-silu, të cilin e përvetësoi ta pranojë islamin shejh Ismaili dhe e mori emrin El-Melik es-Salih.

Ai është martuar me të bijën e mbretit të Parlakut, me të cilën do

t'i ketë dy djem. Qëtë dyve prej tyre t'ua lë principatën, e themeloi qytetin musliman dhe mbretërinë Posoi, po ashtu në bregun verior.14) Nuk përjashtohet se El-Melih ez-Zahiri është ai të cilin ibn Betuta e ka gjetur se sundon në Samudra kur e vizitoi ujdhesën në vitin 1345. Ky sundues ka dëftuar tërë shkëlqimin e mbretërisë islame dhe pushteti i tij është shtrirë shumë ditë ecje përgjatë Ujdhesës. Ka qenë musliman i zjarrtë dhe ortodoks. Ka dëshiruar të zhvillojë diskutime shkencore me juristët dhe teologët islamë. Pallatin e ka pasur përplotë poetë dhe shkencëtarë.

ibn Betuta na jep emrat e dy kadive që kanë ardhur atje nga Persia. Për mend edhe emrin e bujarit që ka shkuar si i deleguar i sulltanit të Delhit, që dëfton se Sumatra edhe më herët ka qenë në kontakt me shumë vise të botës islame.

El-Melik Ez-Zahiri ka qenë komandant i madh. Iu ka shpallur luftë paganëve të vendeve fqinje deri sa nuk iu nënshtruan administrimit të tij dhe nuk e paguan xhizjen.15)

360

Islami, pa dyshim, në atë kohë ka arritur përpari më të madh në Sumatra. Pasi u forcua përgjatë bregut, filloi ta rregullojë rrugën në brendi.

Misioni i shejh-Ismailit dhe shoqërisë së tij ka rezultuar me fryt të pasur.

Një udhëpërshkrues kinez, që e vizitoi Ujdhesën në vitin 1413, ka folur për Lambron se popullsia ka 1000 familje dhe të gjithë janë muslimanë dhe "njerëz mjaft të mirë". Mbreti dhe populli i mbretësisë së Aurës janë të njëjtës fe.16)

Ka ndodhur kah fundi i shekullit të njëjtë ose në shekullin e XV që feja e Pejgamberit ka gjetur ithtarët edhe në mbretërinë e madhe të menangkabauos, teritorët e të cilit janë shtrirë nga skaji në skaj të bregut dhe në pjesën e madhe të ujdhesës, në veri dhe në jug prej ekuatorit.17)

Ndonëse fuqia, në atë kohë, me të madhe i patë rënë, si strehimore e lashtë e hinduizmit, ajo ka qenë pengesë e madhe për përparimin e fesë së re.

Përkundër këtij fakti, islami në fund thellë zuri rrënjë në shpirtërat e shtetasve të kësaj mbretërie më shumë se sa në mesin e shumicës së popullësisë në brendi të Ujdhesës.18)

Është krejt e qartë se kjo pjesa qendrore e popullësisë së Ujdhesës më së ploti është dashur të jetë konvertuar nga banorët e shumë viseve tjera, që kanë qenë më të përshtatshme ndikimit të huaj.

Deri sot banorët e Batak-vendit ende në pjesën më të madhe janë paganë, por islami ka arritur në mesin e tyre të lë gjurmë. Shembull janë disa që jetojnë në kufijt e Atxhehut, në të cilin islamin e kanë pranuar nga fqinjët e vet muslimanë.19) Të tjerët që i banojnë malet e krahinës Rau në ekuator po ashtu janë bërë muslimanë.20)

Në bregun lindor janë konvertuar Batakët, që shumë kanë qenë në kontakt me Malajët.21)

Padri-tët fanatikë (fq. 372) kanë dhënë angazhim zelltar të kotë që me shpatë t'ua imponojnë Batakëve islamin. Ua rrënuan vendin dhe shumë prej tyre i mbytën, por metodat e këtilla të ashpra askend nuk e tërhoqën në islam.

Kur pushteti holandez e theu kryengritjen e Padrëve, ku anektuar pjesën jugore të veudeve të Batakëve. Islami ka filluar të zgjerohet e rrugë të qetë. Kjo kryesisht rrjedh e angazhimit e zjarrtë të nëpunësve ndihës të regjimit të ri, kurse të gjithë kanë qenë muslimanë Malajas.22)

361

Por, ky ndikim shkon edhe nëpërmjet tregtarëve që kanë ecur nëpër vend.

Aktivitetin e tyre prozelit e vazhdojnë haxhinjt dhe mësuesit tjerë të njohur të fesë.

Është fakt krejt i qartë se Batakët, që me shekuj kanë bërë rrezistencë të rreptë hyrjes së islamit ndër ta, ndonëse kanë qenë ndërmjet dy popullësive fanatike muslimane: Açinezëve në veri dhe malajëve në jug, viteve të fundit iu përgjigjen përpjekjeve të qeta që me entuziazëm të kthehen në islam.

Shpjegimi për këtë mund të gjendet në rënien e veçorive të tyre nacionale gjatë okupimit holandez. Pushtimet e hapën vendin e tyre ndaj ndikimeve të huaja, që kyq fillimin e erës së re në zhvillimin e tyre kulturor. Përfaqësuesit e fesë së re po ashtu kanë vepruar me shumë kujdes dhe kanë ditur ta përshtasin mësimin e tyre besimeve ekzistuese të Batakëve dhe traditave thellë të rrënjosura në ta.23) Duket se nxitje e rëndësishme i është dhënë propagandës muslimane me themelimin e misioneve të krishtera në mesin e Batakëve në vitin 1897. Këto misione madje kanë përgatitur rrugën sukseseve të tij.

Dy fshatra të Batakëve, banorët e të cilëve qenë kryqar, kanë kaluar komplet në islam jolarg paskryqit.24)

Në Sumatrën qendrore ende ka mjaft popullësi pagane, ndonsëe shumica janë muslimanë. Këta të fundit janë dobët të udhëzuar në fe, me përjashtim të disa haxhive dhe mësuesve fetarë.

Në mesin e popullit Korintxhi, të cilët shumica kanë qenë ithtarë të zjarrtë të islamit, ka pjesë të caktuara të popullësisë të cilët ende i adhurojnë hyjnitë e të parëve të vet paganë.25)

Jepen angazhime në ngjalljen fetare, kurse edhe mmisionarët muslimanë kryejnë pushtime të reja në mesin e paganëve, veçan gjatë bregut perëndimor.26)

Në krahinën Sipirok një mësues fetar, që ka shërbyer në xhami të qytetit me emrin e njëjtë, për një çerek shekulli ka kthyer në islam tërë popullësinë e kësaj krahine, pos krishterëve që kanë jetuar aty kurse kanë qenë pasardhës të robërve të hershëm.27) Lëvizja e mëvonshme

misionariste në decenien e parë të shekullit XX ka arritur të tërheq në islam shumë të krishterë të kësaj krahine, e janë përvetësuar madje edhe ata që jetojn ënë qendër të ndikimit të mësionit të krishterë.28)
362

Sipas paraqitjes tradicionale, islami ka hyrë në Palembang rreth vitit 1440 nëpërmjet Raden Rahmatës, aktiviteti propagandues i të cilit do të ceket më vonë.

Por, ndikimi hindu prej më parë këtu ka qenë rrënjësor, ashtu që është ngadalësuar përparii i fesë së re.

Thuhet se muslimanët e Palembangut deri në shekullin XIX pak kanë ditur për fenë e vet, pos disa ritualeve të jashtme. Nga kjo përjashtohen edhe banorët e kryeqendrës, të cilët ditë për ditë kanë ardhur në kontakt me Arabët.29)

Duket se në dekadën e parë të shekullit XX ka ardhur deri te ngjallja fetare dhe se propaganda është rritur, sepse raportet kolonialiste të qeverisë holandeze tërheqin vëmendjen në përhapjen e vazhdueshme të islamit në mesin e popullësisë pagane të disa krahinave të Palembangut.30)

Nga Java islami është përcjellur në krahinën Lampung, që paraqet kufirin skajar jugor të Sumatrës, nëpërmjet kryepareve të kësaj krahine që quhen Minak Kamalo Bumi.

Ai rreth shekullit XV ka kaluar ngushticën e Sundit drejt mbretërisë BAntam, në bregun perëndimor të Javës, që e ka pranuar mësiin e misionarëve muslimanë disa vjet para vizitës së tij. Këtu edhe ai e ka pranuar islamit dhe pas haxhit të kryer në Mekke ka përhapur mësimin e fesë rishtas të pranuar ndër bashkëqytetarët.31)
Kjo fe ka bërë përparim më të rëndësishëm ndër Lampongzët. Ata në të shumtën e fshatrave kanë xhami, por kestytnitë e vjetra ende mbajtur në disa vise në brendësi.32)

Në fillim të shekullit XIX erdhi deri te ngjallja fetare, që nuk ka mbetur pa ndikim në aritjen e efikasitetit të propagandës së mëtejme të islamit.

Tre Sumatras, anëtarë të shoqërisë "Haxhi" u kthyen në vitin 1803 nga mekkeja në vendlindjen e tyre.

Gjatë kohës së qëndrimit në qytetin e shenjtë ranë nën ndikimin e lëvizjes vehabite për reformimin e islamit. Kanë lakmuar në atë që reformat e njëjta t'i kyqin në mesin e qytetarëve të vet dhe që ndër ta ta fusin jetën fetare më të pastër e më të zellshme.

Filluan thirrjen të monteizmit strikt të drejtimit vehabit. Kanë ndaluar kërkimin ndihmë nga evlijatë, pirjen e verës, bixhozit dhe punët tjera që janë në kundërshtim me Kur'anin.

363

Numrin e caktuar të bashkëfetarëve dhe paganëve e kanë futur në drejtimin e vet. Më vonë e kanë shpallur luftën e shenjtë xhihadin kundër Batakëve. Duke ardhur në duart e njerëzve të pandërgjegjshëm

dhe ambicioz, lëvizja e humbi karakterin e vet zanafillor dhe a bastardhua në vrazhdësi dhe luftë të përgjakshme të pushtimeve. Këta që i quajnë Padra në vitin 1821 erdhën në konflikt me pushtetin holandez dhe deri në vitin 1838 vendstrehimi i tyre i fundit ka rënë, kurse fuqie është thyer.³³⁾

Islami në siujdhesën Malajase

Të gjithë Malajasit e banuar në siujdhesën Malajase mbajnë prejardhjen nga shpërnguljet nga Sumatra, veçan nga Menangkabani, mbretëria e njohur, më herët të përendur. Për të thuhet se ka qenë mbretëria më e fuqishme në Ujdhesë.

Disa nga drejtuesit e shteteve të brendshme në një pjesë të siujdhesës malajase ende i pranojnë titujt e nderit zyrtar të vet nga ai vend.

Kur këta kolonë nga zemra e Sumatrës e kanë banuar brendinë e Siujdhesës, është lëndë spekulimesh. Sa i përket Singapurit dhe pjesëve jugore të shtyra të Siujdhesës, duket se kolonët atje kanë arritur kah gjysma e shekullit XII, me pasardhësit e të cilit është themeluar Malakka, një shekull më vonë.³⁴⁾

Duke iu falënderuar pozitës së favorshme në rrugën kryesore të tregtisë lindore, së shpejti u bë qytet i madh e i lulëzuar. Ka pak dyshim se islat ka hyrë me tregtarët muslimanë, që këtu banojnë.³⁵⁾

Kronika malajase e Malakkes ia atribuon konvertimin e kësaj mbretërie në islam kohës së sundimit të njëfarë sultani Muhammed-Shahu, që hyri në fron në vitin 1276.

Tregohet se ai ka sunduar vetëm disa vite dhe këtë para ardhjes së anijes nën komandimin e Sidi Abdulazizit, që në Malakk ka ardhur nga Xhiddeja.

Konvertitët e rinj e bindën mbretin që ta ndërrojë fenë e vet dhe ta lë emrin e vet malajas dhe ta ndërrojë me një që do ta përmbajë emrin e Pejgamberit.³⁰⁾

Por, karakteristika e përgjithshme e këtij dokumenti e përbënë vërtetësinë e tij me të madhe të dyshimtë edhe përkundër asaj që është e mundur që data e ndodhësë aq të rëndësishme mundet njëmend të 364

vërehet te populli (siç ka ndodhur në shumë anë të Arkipelogut) i cili krenohet me ndodhinë dhe në të shikon si në hapjen e epokës së re në historinë e vet.

Një historian portugalez e jep një datë ë të vonshme, d.m.th. vitin 1384 kur, si thotë, arriti kadiu nga Arabia, e kthei mbretin në islam dhe ia dha emrin Muhammed, sipas shembullit të Pejgamberit, duke ia shtuar edhe "shah".³⁷⁾

Në analet e Kuedes, njëres prej shteteve në veriun skajor të siujdhesës Malajase, kemi tregimin e çuditshëm për hyrjen e islamit në këtë mbretëri rreth vitit 1501.³⁸⁾ Ja ky tregim (pasi që nga ai i lëshua disa ndodhi të çuditshme): "Një Arab i ditur, me emrin shejh

Abdullah, ka ardhur në Kuedë, e vizitoi raxhën dhe pyeti për religjionin vendas. "Feja ime", u përgjegj raxha, "dhe feja e të gjithë shtetasve të mi është ajo që ka arritur deri te ne nga popujt e kaluar. Të gjithë ne i adhurojmë idhujt."

"Domethënë se eksilenca juaj kurrë nuk ka dëgjuar për islamin dhe Kur'anin që Zoti ia zbriti Muhammedit dhe i cili i zbrapsi të gjitha fetë tjera dhe i ka në pronësi djallit?" "Unë të lusënëse kjo është e vërtetë," tha raxha, "të na mësosh e të na ndriçosh me atë fenë e re". Në ngazëllim të zjarrit të shenjtë, në këtë lutje shejh Abdullahu e konvertoi raxhën, e pastaj e drejtoi në mësimin e fesë.

Pasi që raxha u bind në mësimin e shejhit, i dërgoi për të gjithë "qypat e shpirtërave" të vet "të cilave vetë u ka qenë mjaft besnikë) dhe me duart e veta i ka zbratur në dhe.

Pas kësaj ai i qiti të gjithë idhujt nga pallati. Idhujt nga ari, argjendi, argjilla dhe druri janë grumbulluar para tij. Shejh Abdullahu i theu në copa me shpatën dhe sopatën e vet. Mbeturinat janë ndezur në zjarr.

Shejhu kërkoi nga raxha t'i tubojë të gjitha gratë e veta në kështjellë dhe pallat.

Kur të gjitha erdhën në prani të raxhës dhe shejhut, janë këshilluar në mësimin islam.

Shejhu ka qenë bukur i edukuar dhe i këndshëm në komunikim, tërheqës dhe gojëmbël ashtu që dominoi me zemrat e të gjithë banorëve të pallatit.

Raxha në fund i ftoi edhe katër ministrat e vet të vjetër që gjatë hyrjes në koridor qenë të befasuar duke e parë shejhin që është ulur pranë raxhës.

365

Raxha ua shpjegoi lëndën e ardhjes së shejhut. Atëherë këta katër liderë shprehën gatishmëri ta ndjekin shembullin e eksilencës së tij duke thënë: "Ne shpresojmë se shejh Abdullahu edhe neve do të na mësojë."

Kur shejhu i dëgjoi këto fjalë, i kthei në isla mkatër ministra dhe u tha se ai shpreson se ata do ta dëshmojnë lojalitetin e tyre nëse e ftojnë popullin në koridorrin pranue edhe i sjellin me vete të gjitha idolet, që e kanë pasur traditë t'i adhurojnë, sikur edhe ata që u kanë mbetur nga njerëzit e kohëve të kaluara.

Kërkesa iu plotësua. Të gjitha idolet që i kanë ruajtur njerëzit kanë qenë, në kohën e caktuar, të grumbulluara dhe aty janë thyer e ndezur në hi.

Askush nuk u pikëllua me këtë shkatërrim të hyjnive të veta të pavlerë. Të gjithë ishin të kënaqur të hyjnë në rrethin e islamit.

Pastaj shejh Abdullahu i pyeti të katër ministrat: "Çfarë emri ka sunduesi juaj?" U përgjigjën: "Emrin e ka Pro Ong Mahawangsa."

"Më lejoni që t'ia ndërrojmë me një në gjuhën e islait", tha shejhu.

Pas konsultimeve të caktuara emri i raxhës është ndërruar me kërkesën e tij në sulltan Muzhif-shahu, sepse shejhu ka pohuar se ky emër është i njohur dhe se gjendet edhe në Kur'an.39)

Raxha ka ndërtuar xhamia në viset e banuara. Ka urdhëruar që secilës t'i bashkangjiten së paku 44 persona prej banorëve që do ta përbëjnë tubimin, xhematin, sepse cilido numër më i vogël se ky është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave fetare.

Krahas xhamive të ndërtuara janë shtuar lodrat të cilëve u është rënë gjatë thirrjes së njerëzve në namazin e xhumasë të premtën. Shejh Abdullahu një kohë të caktuar ka vazhduar t'i mësojë njerëzit me islamin. Kanë nxitur nga të gjitha brigjet e krahinës Kueda dhe rrethina e saj. Njëpërmjet tij kanë mësuar format e manifestimit dhe shprehjes islame.

Lajmi për kthiën në islam të popullësisë së Kuedës me anë të shejh Nuruddinit një misionar arab që ka ardhur nga Mekkeja, ia dërguan disa libra dhe letrën me përmbajtjen vijuese: "Kjo letër është e sulltanit të Atxhehut dhe Nuruddinit, vëllaut tonë sulltanit të Kuedit dhe shejh Abdullahut nga Jemeni, tash në Kuedë. I dërgua dy libra fetare me qëllim që islami fuqishëm të ngulitet dhe njerëzia plotësisht të përudhet në detyrat dhe të drjtat e tyre në fe."

366

Më vonë është dërguar përgjegjja e raxhës dhe shejh Abdullahut në të cilën alenderojnë dhuruesit.

Shejh Abdullahu i dyfishoi pastaj përpjekjet e veta. Ka ndërtuar në çdo fshat xhamia të vogla dhe zavi që të shërbejnë për dobi të përgjithshme dhe ta mësojë botën me dispozitat e saj dhe me ritualet e fesë.

Raxha dhe gruaja e tij kanë qenë gjithnjë pranë shejhut dhe kanë mësuar leximin e Kur'anit. Ky qift mbretëror kanë hulumtuar për grua nga fammija e raxhëve që të martohet shejhu. Mirëpo, askend se kanë gjetur që do të donte t'ia jepte vajzën për grua, sepse ky njeri i shenjtë, së shpejti kthehej në Bagdad. Ka pritur që dikend ta mësojë mjaft që do të vijë në vendin e tij.

Në atë kohë sulltani ka pasur tre djemë emrat e të cilëve janë raxha Mu'azzam-shah, raxha Muhammed-shah dhe raxha Sulejman-shah. Këta emra shejh Abdullahu i mori nga Kur'ani dhe ua dha këtyre primave. Atyre shejhu ua ka tërhequr vërejtjen që të jenë të durueshëm dhe mos të zemërohen shpejtë në komunikim me robërit e vet dhe shtresat e ulta dhe që me dhembisuri të sillen me shërbëtorët e Zotit, me varfanjakët dhe me të mjerët.40)

Nuk und të merret se të gjitha përpjekjet e shejh Abdullahut janë kurorëzuar me sukses të plotë, sepse mësojmë nga analet e Atxhehut se sulltani i këtij vendi, që e ka pushuar Kuedon në vitin 1649 ka vendosur "që fortë ta forcojë fenë dhe ta rrënojë shtëpinë Liar, tempujt e idoleve."41)

Kështu kaloi një shekull e gjysmë deri sa idhujtaria nuk u çrrënjos plotësisht nga këto vise.

Ne nuk posedojmë kurrfarë hollësisht tjera për historinë e kaliit të Malajasëve nga Siujdhesa në islam, por në shumë vende gjenden tyrbet e misionarëve arabë që të parët kanë thirrë në fe. Ato te kjo botë mjaft respektohen.42)

Marrëdhëniet e tyre të gjata reciproke me Arabët dhe muslimanët e bregut lindor-undus i kanë bërë mjaft të zellshëm në kryerjen e detyrave të tyre fetare ashtu që gëzojnë reputacionin e muslimanëve ë shembullor të Arkipologut.

Njëkohësisht, kontakti i tyre i përhershëm me Hindusët, budistët, të krishterët dhe paganët në vendin vetjak i ka bërë liberalë dhe tolerantë.

367

Strikt i përmbahen agjërimit të ramazanit dhe kryerjes së haxhit në Mekke. Dobitë fetare për popullin gjithnjë merren parasysh njëkohësisht si dobi të jetesës së përditshme të tyre.

Kur vërtetohet se fsahti ka më shumë se dyzet shtëpi dhe vërehet se vëllimi i tij kërkon organizimin dhe emërimin e nëpunësve të përhershëm të fsahtit, ndërmjet tyre caktohen edhe vaizët popullarpredikuesit, dhe xhamia ndërtohet dhe themelohet.43)

Islami në ĒSijam

Në veri, ku shtetet malajase kufizohen me Sijamin, islami ka kryer ndikim të konsiderueshëm në Sijamezët - budistë.

Ata që kanë kaluar në islam janë quajtur Samsam dhe flasin me gjuhën që është dialekt i përzier i gjuhës së dy popujve.44)

Kthimi në isla është bërë edhe në mesin e fiseve të egra të Siujdhesës.45)

Historia e përhapjes së islamit në Indokinë është e pasqaruar. Ka mundësi që tregtarët arabë dhe persianë e kanë futur janë e vetë në qytetet limane prej shekullit X. Merita për përhapjen shumë më të madhe i përket shpërnguljeve të Malajasëve, që kanë filluar në fund të shekullit XIV.46)

Islami në Javë

Tash duhet të kthehemi prapa disa shekuj që ta ndjekim historinë e kthiit të javës në islam.

Nuk ka dyshim se thirrja dhe botshmëria e mesimit islam në këtë ujdhesë qysh kaherë është rezultat i punës individuale të tregtarëve ose krerëve të kolonive të vogla. Në Javë nuk ka pasur ndonjë forcë qendrore muslimane që ndikimin e vet do ta vente në anën e fesë së re ose do ta impononte pranimin e saj me mjetet luftarake.

Misionarët muslimanë kanë ardhur në kontakt me civilizimin hindu, që ka lëshuar rrënjët e thella në jetën e vendit. Javanët i ka ngritur në nivel të lartë kulturor dhe progres të përgjithshëm, që përfundimisht, qartë manifestohet në institucionet dhe ligjet që

radikalisht dallohen nga ata në Arabi.

Deri në ditën e sotshme e drejta islame nuk ka pasur sukses që absolutisht të forcohet madje as atje ku pushteti i islamit shkallërisht 368

bëhej dominant. Aty është konflikti i përhershëm ndërmjet ithtarëve të traditave të vjetra malajase dhe haxhive që e kanë kryer haxhin në mekke dhe janë kthyer me entuziazmin e forcuar për aplikimin strikt të sheriatit (ligjit) islam.

Pasojë është ajo që puna në konvertim ka dashur të rrjedh mjaft ngadalshëm. Mund të themi, me siguri të madhe, që një pjesë e historisë të kësaj lëvizje prozelite mund të zgjidhet nga legendat dhe traditat. Shumë prej tyre do të na mbetet plotësisht e panjohur.

Në kronikën malajase, qëllimet e së cilës janë të na ofrojë përshkrimi të caktuar të thirrësve të parë në këtë fe, kjo pa dyshim, ka qenë punë e shumë gjeneratave dhe është dashur të vazhdohet gjatë mjaft shekujve, është ngjeshur në kufinjtë e disa viteve.

Siç ndodh më së shpeshti në historitë popullore, disa emra mjaft mirë të njohur gjithnjë arrijnë lavdinë dhe besimin, e në fakt, kjo i përket punës së zellshme të pararendësve të tyre të panjohur.47)

Më tej, puna e qetë dhe e paimponueshme e shumë prej atyre misionarëve nuk ka mundur ta tërheq vëmendjen e kronistëve, kujdesi i të cilëve, natyrisht, ka qenë i lidhur para së gjithash për veprën e mbretërve dhe princave dhe të atyre më të cilët kanë ardhur në lidhje të ngushtë.

Por, nëse e kemi humbur njoftimin aq të gjërë, duhet të kënaqemi me faktet që kanë arritur deri te ne.

Për këtë shkak në faqet vijuese do të ekspozohet paraqitje e shkurtër e përforcimit të islamit në këtë ujdhesë, siç është treguar në kronikat popullore përplotë kundërshti dhe përralla, por të cilat megjithatë kanë bazamentin e caktuar historik.

Në këtë udhëzojnë mbishkrimet në varret e personaliteteve autoritative të përmendur, në mbeturinat e gërmadhave të qytetit etj.

Sido qoftë, lajmet tjera munden, pasi nuk ka të dhëna tjera, të pranohen si në esencë të sakta, krahas kujdesit të cekur ndaj atribuimit të efikasitetit aq të madh në përpjekjet prozelite të individëve.

I pari që ka tentuar ta fusë islamin në Javë, në fund të shekullit XII, ka qenë autokton i Ujdhesës.

Mbreti i parë i Paçaçaranëve, shtetit në pjesën perëndimore të Ujdhesës, ka lënë dy djem. I vjetri prej tyre zgjodhi tregtinë. Iu bashkangjitë ekspeditës tregtare që ka shkuar në Indi, duke ia lënë mbretërinë vëllaut të ri. E trashëgoi fronin në vitin 1190 me emrin Prabu Munding Sari.

369

Gjatë kohës së kryqtërthores së vet vëllau i vjetër është takuar me disa tregtarë arabë të cilët e kanë kthyer në islam. Ka marrë emrin

Haxhi Purva.

Pas kthimit në vendin e vet ai ka tentuar, me ndihmën e misionarit arab, ta kthejë vëllaun dhe familjen mbretërore në fenë e vet të re, por përpjekjet i kanë mbetur pa rezultate.

Ka ikur në xhungël nga frika prej mbretit dhe shtetesve të tij të pafe. Pas kësaj për të asgjë më tepër nuk kemi dëgjuar.48)

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV lëvizja misionariste, që është përcjellur me sukses të madh, është filluar nga njëfarë meolana Malik Ibrahim. Ai është ndalur në bregun hudar të Javës me disa bashkëbesimtarë. Kanë banuar afër qytetit Gresika, përkundër qytetit Madura.

Ka folur se mbanë prejardhjen prej Zejnulabidinit, njërit prej nipërve të Pejgamberit, dhe se është nip (djali i motrës) i ra xha nga Çermani.49)

Këtu është marrë me punën e suksesshme në kalimin në islam dhe së shpejti rreth vetes ka tubuar shoqëri të vogël besimtarësh.

Më vonë u takua me nipin e vet, raxhën nga Çermani, që ka ardhur me shpresë që në islam ta kthejë raxhën e Magjapahitës, mbretërisë hinduse, dhe të krijojë aleancë me të me ofertë që të martohet me vajzën e tij.

Pas ardhjes e dërgoi djalin e vet Sadik Muhammedin në Magjapahit që ta caktojë kohën e takimit deri sa vet ishte i zënë me ndërtimin e xhamisë dhe me kthimin e popullësisë në islam.

Takimi i dy sundesve u realizua. Por, para se veprimi i favorshëm të arriturës ka mundur të vazhdohet, është përhapur sëmundja në popullin e raxhës nga Çermani. Sëmundja ia mori të bijën dhe tre kushërij që e kanë përcjellur sikur edhe pjesa e mirë e suitës së tij. Pas gjithë kësaj ai u kthye në mbretërinë e vet.

Kjo fatkeqësi e ka mbushur me paragjykime kokën e raxhës nga Magjapahiti ndaj fesë së re, e cila duhej, siç thotë raxha, të jetë mbrojtësi më i mirë i ithtarëve të vet. Misioni, në pajti me këtë, ka dështuar.

Mevlan Ibrahim pas kësaj ka marrë detyrën e ruajtjes së varreve50) të kushërinjve dhe bashkëbesimtarëve të vet.

370

Ka vdekur i vetmuar njëzet vjet më vonë në vitin 1419. Është varrosur në Grosik, ku varri ende i nderohet si varri i të deleguarit të parë të islamit në Javë.

Një musliman kinez që ka përcjellur deputacionin e imperatorit kinez në Javë në cilësi të përkthyesit, gjashtë vjet para vdekjes së mevlana Ibrahimit, në vitin 1413 përmend praninë e bashkëfetarëve të vet në këtë ujdhesë. Në "Përshkrimin e përgjithshëm të brigjeve të Oqeanit" të vet thotë: "Në këtë vend ekzistojnë tre lloje popujsh. Të parët janë muslimanët, që kanë ardhur nga perëndimi dhe janë vendosur aty. Petkat dhe ushqimi i tyre është i pastër dhe i

përshtatshëm. Të dytët janë Kinezët që kanë ikur dhe janë vendosur këtu. Atë që e hanë dhe e përdorjnë po ashtu është e bukur. Shumë prej tyre e kanë pranuar islamin dhe i përmbahen mësimin të tij.

Lloji i tretë janë vendasit të cilët janë majft dëbues e të panjerëzishëm. Vijnë e shkojnë me koka të zbuluara e të zbathur. Devotshmërisht besojnë në djajë. Pasi që janë të njohur me këtë në librat budiste, vendi u është i njohur si vend djajshë".51)

Tash do t'i ofrohemi periodës në të cilën udhëheqja e muslimanëve u bë dominante në Ujdhesë pasi që feja e tyre hyri në ujdhesë para afër një shekulli.

Këtu është e domosdoshme të hyhet më tepër për së afërmi në hollësitë historike me qëllim që të tregohet se kjo nuk ka qenë rezultat i çfarëdo lëvizje fanatike të nxitur nga Arabët, por në të vërtetë revolucion i nxjerrë nga vetë popullësia vendëse.52)

Ata, pasi e arritën forcën nëpërmjet formës së besimit të përbashkët, kanë qenë të nxitur në bashkim me qëllim që t'ia nxjerrin pushtetin suprem nga duart e bashkëqytetarëve të vet paganë duke mos ftuar në luftë fetare. Këtë e kanë realizuar me ndihmën e hekurit me hakmarjen e një pretendenti ambicioz për fron të cilit i qe shkaktuar padrejtësi.53)

Situata politike në Ujdhesë dukej kësisoji.

Treva qendrore e lindore, të cilat kanë qenë më të pasura e më të popullëzuara dhe në aspektin civilizues më të përparuara, ka qenë nën sundimin e mbretërisë induse Magjapahit.

Perëndimi skajor janë Çeriboni dhe disa principata më të vogla të pavarura, deri sa pjesa tjetër e Ujdhesës, duke i kyqur të gjitha viset e perëndimit të tij më të largët, ka qenë nën ndikimin e mbretit të Paçaçaranëve.

371

Mbreti i Magjapahitëve ka qenë martuar me vajzën e princit nga Çampa, shtetit të vogël në Kamboxhë, në lindje prej gjirit Sijamez.54)

Ajo ka qenë xheloze ndaj një konkubine të privilegjuar të mbretit.

Ai këtë konkubinë ia dërgoi birit të vet Arya Damarit, guvernatorit të Palambangut në Sumatra. Ia lindi të birin Raden Patahun, i cili është i edukuar si një prej bijëve të sunduesit.

Këtij fëmije (siç do t shohim) do t'i gjykohej, në vitet e mëvonshme, të punojë në hakmarrjen e tmerrshme për shkak të sjelljes së vrazhdë të nënës së tij ndaj tij.

Vajza tjetër e princit nga Çampa ka qenë e martuar për një Arab që në Çampë ka ardhur të ftojë në islam.55)

Nga kjo martesë është lindur Raden Rahmat, të cilin babai e edukoi në islam. Ende javasit e nderojnë si të deleguarin kryesor të islamit në vendin e tyre.56)

Kur ka pasur njëzet vjet, familja e ka dërguar me shkresa dhe dhurata xhaxhait mbretit të Magjapahitëve.

Në rrugë ka mbetur dy muaj në Palambangë. Ka qenë musafir i Arya Damarit, të cilin gjithnjë e ka bindur të bëhet musliman. Por ky nuk marri guxim publikisht të predikojë islamin, nga frika prej popullit që ka qenë mjaft lojal bestytnive të veta të vjetra.

Duke vazhduar udhëtimin e vet, Raden Rahmat ka ardhur në Gresik ku një misioanr arab, shejh Mevlana Xhumadel-Kubre, e ka pritur me hare si Rajmëtar të pritur të islamit në javën lindore. Është profetizuar që me dorën e tij do të jetë shkatërim i paganizmit dhe që puna e tij do të kurorëzohet me kurorëzimin e të shumtëve në këtë fe.

Në Magjapakit është pritur shumë bukur nga mbreti dhe princërat e Çampa. Ndonëse vetë mbretë nuk ka dëshiruar të kalojë në islam, ka dëftuar dashuri dhe respekt ndaj Raden Rahmatit. E ka vënë për sundues të tre mijë familjeve në Ampelë, në bregun lindor, diç më në jug prej Gresikës.

I ka lejuar që lirisht ta praktikojë fenë e vet dhe ta kthejë në islam. Pas një kohe të caktuar në islam ka tërhequr të gjithë ata që kanë qenë nën sundimin e tij.

Ampeli është bërë, nga kjo kohë, qendra kryesore e islamit, kurse lavdia e sunduesit që aq me zjarr ka punuar në propagandimin e fesë së vet është përhapur larg e gjërë.

372

Pas kësaj në Ampel ka ardhur njëfarë Mevlana Is'haku që t'i ndihmojë në punë për kthim në këtë fe.

Atij ia ka besuar përhapjen e fesë më mbretërinë BAlambangan, në lindjen skajore të Ujdhesës.

Këtu e shëroi të bijën e mbretit, e cila ka qenë rëndë e sëmure, kurse babai mirënjohës ia dha për grua.

Ajo me zell e përqafoi islamin, kurse edhe babai i saj pajtoi që të mësohet në islam. Por, kur Mevlana e ka nxitur që haptazi ta manifestojë islamin e vet, si patë premtuar të bëjë nëse vajza do t'i shërohet, ka urdhëruar që shejhu të largohet nga mbretëria e tij dhe ka urdhëruar që fëmija së shpejti që do të lindet e bijës së tij do të mbytet.

Nëna, fshehtazi e dërgoi foshnjën e re në Gresik një të veje të pasur muslimane,57) e cila e ka edukuar me tërë kujdesin e nënës. E ka arsimuar deri në vitin e dymbëdhjetë, e pastaj ia besoi Raden Rahmatit.

Kur Raden Rahmati mësoi për të kaluarën e kësaj fëmije, ia dha emrin Raden Paku. Pas një koha e martoi me vajzën e vet. Më vonë Raden Paku ka ndërtuar xhaminë në Giri, në jugperëndim prej Gresikut, ku njëmijë njerëz i kthei në islam.

Ndikimi i tij u rritë aq sa që mbreti i Magjapahitës, pas vdekjes së RAden Rahmatit, e emroi për guvernier të Ampelës dhe Gresikut.58)

Në ndërkohë shumë misione janë themeluar në Gresik.

Dy djemt e Raden Rahmatit janë forcuar në pjesët e ndryshme të bregut verilindor dhe janë bërë të njohur me zjarrin e tyre fetar.

Shumë banorë të këtyre viseve i kanë kthyer në islam.

Raden Rahmati, po ashtu, ka dërguar misionarin me emrin shejh Halifa Husejin në ujdhesën fqinje Madusa. Aty e ndërtoi xhaminë dhe tërhoqi shumë njerëz në islam.

TAsh duhet t'i kthehemi Arya Damarit, guvernatorit të Palembangut. Duhet se ai i ka edukuar fëmijët e vet në islam, të cilin ai vetë është frikësuar haptazi ta manifestojë.

E ka dërguar RAden Patahun, kur i mbushi 20 vjet, së bashku me vëllaun e tij sipas qumshtit Raden Huseinit, që ishte dy vjet më i ri se ai, në Javë. Ata janë vendosur në Gresik.

Raden Pataku ka qenë i vetëdijshëm për persekutimin e et. Ka qenë i stërkequr në veprimin e vrazhdë në të cilin ka hasur nëna e tij. Nuk ka dëshiruar ta përcjell vëllaun e vet sipas qumshtit në

373

Magjapahit por mbeti me Raden Rahmatin në Ampel, deri sa Raden Huseini shkoi në kryeqendër, ku është pritur mirë dhe është vënë në shërbim në krahinë. Më vonë u bë gjeneral në ushtri.

Në ndërkohë RAden Patahu është martuar me mbesën e Raden Rahmatit dhe formoi vendbanimin në vendin natyrisht të pasur të quajtur Bintara, në qendër të tokës moqalike, në perëndim prej Gresikut.

Kur, në fund, mbreti i Magjapahitëve dëgjoi për këtë vendbanim të ri, e dërgoi Raden Huseinin ta bind vëllaun e vet të vijë në kryeqendër e t'i shpreh dëgjueshmëri mbretit.

Raden Huseini e bindi në këtë dhe shkoi në pallat, ku ngjashmëria e tij me mbretin menjëherë u dukë. Këtu është pritur mirë dhe është emëruar guvernator i Bintares.

Pasi që ende lakmonte për hakmarrje dhe punoi në shkatërrimin e shtetit të babait, u kthye në Ampel, ku planin e vet ia shtroi Raden Rahmatit.

Ky i fundit është orvatur ta heshti hidhërimin e tij, duke e përkujtuar që prej babait të tij, mbretit të Magjapahitëve ka gjithnjë mbrojtjen dhe kujdesin. Deri sa princi është ashtu besimtar i drejtë dhe i mirë, besimi i tij i ndalon të luftojë ose që në çfarëdo mënyrë ta dëmtojë. Raden Patahu nuk u kënaq me këto këshilla (siç do të shpjegohet më mirë). u kthye në Bintar, që tash për çdo ditë bëhej më i rëndësishëm dhe më i popullëzuar. Numër i madh njerëzish nga vendet përreth ka kaluar në islam.

Patë hartuar planin për ndërtimin e xhamisë së madhe, por pak kohë, pas fillimit të punëve i arritën lajme se Raden Rahmati është sëmurë rëndë. Nxitoi në Ampel. Atje i takoi misionarët e islamit të tubuar rreth shtratit të tij, kurse në të shikonin sikur në udhëheqësin e vet.

Në mesin e tyre kanë qenë edhe dy djemtë e Raden Rahmatit, më herët të theksuar, Raden Paku nga Giria dhe pesë të tjerë. Raden Rahmati pas disa ditësh e lëshoi frymën e vet të fundit dhe kështu u hoq pengesa e fundit që ishte në rrugën e realizimit të planit hakmarrës të Raden Patakut.

E kanë përcjellur tetë udhëheqës tjerë në kthim kah Bintori, ku i ndihmuan ta kryej xhaminë.59) Mbi vete morën obligimin që t'i ndihmojnë në orvatjen kundër Magjapahitëve.

374

Të gjithë princat muslimanë u tubuan në këtë aleancë, pos raden Huseinit, që së bashku me ithtarët e vet i mbeti besnik zotëriut të vet dhe refuzoi të ketë pjesë me bashkëbesimtarët e vet rebelues. Pas kësaj pasoi fushata e gjatë ushtarake, në hollësitë e së cilës nuk ka nevojë të hyjmë. Pas betejës së rreptë, që zgjati shtatë ditë, në vitin 147860) Magjapahitje pësoi humbje dhe pushteti indus në Javën lindore është ndërruar me fuqinë muslimane.

Një kohë të shkurtër pas kësaj Raden Huseini që rrethuar me ithtarët e vet në një kështjellë, i detyruar në dorëzi dhe është dërguar në Ampel, ku vëllau e priti bukur.

Numri i madh i atyre që kanë mbetur lojal besimit hindu ikën në ujdhesën Bali në vitin 1481 ku adhurimi i Shives ende ka qenë religjioni kryesor.61)

Të tjerët kanë formuar shtete të vogla nën udhëheqjen e princave nga shtëpia e Maçapahitëve. Ato kanë mbetur në idhujtari njëfarë kohe pas rënies së kryeqendrës së madhe hinduse.

Madje edhe nën udhëheqjen e Idierëve muslimanë popullësia e Javës së mesme ka mbetur pagane. Përparimi i islamit drejt jugut, nga qendrat e para të punës muslimane në veri, ka qenë punë shekulli.

Deri në kohën e sotshme ndikimi i fesë së tyre hinduse qartë manifestohet në pikëpamjet fetare të popullësisë muslimane të Javës qendrore.

Një provë e qartë se hinduizmi ka lëshuar rrënjë të thella në këtë pjesë të Ujdhesës është në faktin se deri në vitin 1768 autoriteti i librave juridike induse, veçan kodeksi i ligjit Manu, nuk u tërhoq para kodeksit të ligjit që janë në pajtim me frymën e jurisprudencës muslimane.62)

Islami ka hyrë në pjesën lindore të Ujdhesës disa vite më vonë, ka mundësi tashmë në fillim më shekullit vijues, nëpërmjet punës misionariste të shejh Nuruddin Ibrahimit nga Çeribani.

Autoritet të madh ka arritur duke e shëruar një grua të infektuar me gërbulë. Rezultat i kësaj ka qenë që me mijëra prej tyre kanë ardhur që t'i mësojë me themelet e fesë së re.

Në filli më disa kryeparë në fqinjësi kanë tentuar t'i kundërvihen lëvizjes. Së shpejti kanë vërejtur se kundërvënia nuk ndihmon.

Janë lëshuar që t'i bartë rryma dhe shumë prej tyre kanë kaluar në

islam.63)

375

Shejh Nuruddin Ibrahim nga Çeribani e dërgoi të birin e vet Mevlana Hasamuddinin që të thërret në islam në Bontan, provincën më perëndimore të Ujdhesës, të varur nga mbretëria pagane e Paçaçaranëve.

Angazhimi i tij ka rezultuar me sukses të mëdha. Ndër të konvertuarit ka qenë edhe grupi prej 800 asketëve.

Historia e kësaj treve të vendit veçan e përmend princin e ri i cili i ka përvetësuar të kalojnë në islam, ekskluzivisht në mënyrë të qetë, e jo me shpatë.64)

Pas kësaj shkoi me babain në haxh në Mekke. Pas kthimit fuqinë e vet e shtriur në bregun fqinj të Sumatrës, po ashtu pa përdorimin e shpatës. Vetëm në mënyrë të qetë i ka tërhequr konvertitët në islam.65) Duket se përparimi i islamit ka qenë më i ngadalshëm në bregun perëndimor se lindor të Javës. Ka lind konflikt i gjatë ndërmjet idhujtarëve të Shivës dhe ithtarëve të Pejgamberit.

Mbretëria induse Paçaçarau, që në një periodë të historisë së Javës e ka shtrirë sizerenitetin e vet edhe në principatat e pjesës perëndimore të Ujdhesës, përjetoi fundin e vet66) vetëm kah mesi i shekullit XVI.

Bashkësitë tjera më të vogla idhujtare kanë mbijetuar deri në periodat shumë të vonshme,67) e disa edhe deri në ditët e sotshme. Historia e njërës prej tyre - që duhet Baduvis është me rëndësi të veçant. Ata janë pasardhës të ithtarëve të religjionit të vjetër. Pas rënies së Paçaçaranëve kanë ikur në male dhe bjeshkë të shkreta, në mënyrë që të mund ta vazhdojnë kryerjen e ritualeve të fesë së të parëve të vet.

Në kohën e mëvonshme, kur i janë nënshtruar udhëheqjes së sulltanit musliman Bantamit, iu qe lejuar ta vazhdojnë praktikimin e fesë së vet me kusht që mos ta rrisin bashkësinë e atyre që e predikojnë këtë fe idhujtare.68)

Është e çuditshme të thuhet se ende i përmbahen traditës ndonëse sundimi holandez aq gjatë është forcuar në javë. Ajo i ka liruar nga nevoja e dëgjueshmërisë ndaj asaj marrëveshje të vjetër.

Ata strikt e kufizojnë numrin e vet në dyret familje. Kur bashkësia e kalon kufirin e këtij kufizimi, një apo më shumë e lëshojnë këtë rreth të brendshëm mdhe vendoset në mesin e popullësisë muslimane në një prej fshatrave të afërta.69)

376

Pos asaj se puna në konvertizëm në Javën perëndimore është zhvilluar shumë më ngadalë se në pjesët tjera të Ujdhesës, me të madhe duhet falenderuar faktit se hinduizmi këtu nuk ka pasur rrënjë aq të thella në popull sikur në brendi.

Ngadhënjimi i islamit ndaj idhujtarisë, që e ka ndërruar, ka qenë

shumë më e plotë se në viset që shumë më shpejtë kanë ardhur nën sundimin e raxhëve të Magjapahitëve.

E drejta islame këtu është fuqi e gjallë, kurse edhe civilizimi është futur në vend nga Arabia dhe është gërshetuar me pushtetin dhe jetën e popullit.

Mund të vërehet se edhe sot muslimanët e Javës perëndimore, të cilët e mësojnë fenë e tyre në tërësi dhe e kryejnë haxhin në Mekke, e përbëjnë rëndo pjesën më inteligjente dhe më përparimtare të popullësisë.70)

Tashmë kemi parë se pjesa e madhe e Javasëve ka mbetur në idhujtari shumë shekuj pas konstituimit të mbretërive muslimane në Ujdhesë.

Sot tërë popullësia e Javës është muslimane, me përjashtime të vogla. Krahas shumë bestytnive dhe traditave, që u kanë mbetur nga koha e të parëve paganë, ende ekziston synimi në vazhdimin e drejtimit të lëvizjes, mendiit dhe orientimit sipas mësimi të islamit. Kjo puna tjetër në konvertizëm mka kaluar në qetësi dhe shkallërisht. Shtetet muslimane të kësaj ujdhese ia kanë borxh zhvillimit të vet më tepër historisë politike se sa religjioze, sepse përparii fetar ka qenë më shumë rezultat i punës së misionarëve se sa punës së sunduesit.

Derisa muslimanët e Javës kanë intriguar kundër qeverisë hindu dhe me forcë kanë marrë sundimin në duart e veta, në anën tjetër kthesa në pjesët tjera të Arkipelagut ka qenë krejtësisht i karakterit të qetë. Kjo kthesë ka rrjedhur me anë të thirrjes së misionarëve islame të cilët ngadal por me siguri kanë arritur suksese me përpjekjet e veta misionariste.

Ta drejtojmë vëmendjen tonë historisë së kësaj lëvizje propaganduese në ujdhesat e Molukasëve.

Islami në ujdhesat Molukase

377

Duket se tregtia me karanfila i ka sjellë Molukasit shumë herët në kontakt me banorët e ujdhesave të pjesës perëndimore të Arkipelogut, Javasit dhe MMolajët tjerë që kanë kaluar në islam, kanë ardhur në këto ujdhesa dhe e kanë përhapur fenë e vet në mesin e banorëve të Bregut.71)

Bashkëudhëtarët e Maqelanit kanë sjellur rrëfimin e çuditshëm për mënyrën se si këta njerëz e kanë futur mësiin e vet fetar në mesin e Molukasëve. "Mbretërit72) e këtyre ujdhesave, para ardhjes së Spanjollëve nja disa vite, kanë filluar të besojnë në pavdekshmërinë e shpirtit. Këtë e kanë konkluduar në bazë të vetëm një prove: kanë parë shpendin e shkëlqyeshëm mqë nuk i ka gjasuar tjetër në Tokë, as që ka pasur diç në Tokë ë të bukur se ai.

Muslimanët që janë marrë me tregti në këto ujdhesa iu kanë thënë se ky shpend i vogël është lindur në parajsë, kurse parajsa është vend

ku pushojnë shpirtërat e atyre që kanë vdekur.

Nga ky shkak këta zotërinj i ofruan bashkësisë muslimane, e cila iu ka premtuar shumë gjëra të çuditshme në atë vend të shpirtërave."73)

Duket se islami ka filluar të përparojë këtu në shekullin XV.

Mbreti idhujtar Tidori i është dorëzuar në besë një Arabi me emrin shejh Mensur dhe e pranoi islamin së bashku me shumë shtetas të vet.

Emri pagan i mbretit Teireli Liçatu është ndërruar në

Xhemaluddin, deri sa djali i tij më i vjetër është quajtur. Mensur sipas mësuesit të tij arab.74)

Ky ka qenë sunduesi i fundit që e ka gostitur deputacionin

spanjoll, që ka arritur në Tidori në vitin 1521 pak pas vdekjes së Magelanit.

Pigafeta, historian i kësaj ekspedite, e quan raxha sulltan Manzor

dhe thotë se ka mbi 55 vjet dhe se nuk ka mbi 50 prej kur muslimanët kanë ardhur të jetojnë në këto ujdhesa.75)

Duhet se islami është përforcuar në ujdhesën fqinje Ternadi diç më

herët. Portugalezët, që kanë arritur në këtë ujdhesë po atë vit kur

Spanjollët erdhën në Tidori, popullësia ka njoftuar se islami ka ardhur në vendin e tyre para tetëdhjetë vjet.76)

Po ashtu sipas njoftimeve të Portugalezëve,77) sulltani i Ternates

është sunduesi i parë molukas që është bërë musliman.

Legjenda për hyrjen e islamit në këtë ujdhesë flet për atë se si

tregtari me emrin Datu Mulla Husein ka nxitur kërshërinë e njerëzve me leximit e Kur'anit me zë, në praninë e tyre.

378

Kanë tentuar t'i imitojnë shkronjat e shkruara në Libër, por nuk

kanë mundur t'i lexojnë. E kanë pyetur pastaj tregtarin si mundet ai këtë ta lexojë kur ata nuk mundën.

Iu përgjegj se së pari patjetër duhet të besojnë në Zotin dhe në

Pejgamberin e Tij. Pas kësaj kanë shprehur dëshirën ta pranojnë mësimin e tij dhe të kthehen në fenë e tij.78)

Thuhet se sulltani i Ternates, që ka zënë vendin e të rëndësishëm

në mesin e sunduesve të pavarur të Ujdhesës, ka udhëtuar deri në

Gresik në Javë me qëllim që atje të kalojë në islam në vitin 1495.79)

Në këtë është ndihuar me punën propaganduese të njëfarë Pati

Putahu, që ka udhëtuar deri në Htua në Amboinë drejt Javës me qëllim

që t'i mësojë principet e fesë së re. Pas kthimit të vet ka përhapur

doktrinën e islamit në mesin e popullit të Amboinës.80)

Duket se islami në filli ka përparuar ngadal. Është takuar me

rezistencën e madhe të banorëve të ujdheseve të cilët kanë qenë në

mënyrë të zjarrtë përkushtueshëm ndaj bestytive dhe mitologjisë së

vet të vjetër. Kështu idhujtaria e vjetër ka vazhduar një kohë ngathtë

të përzihet me mësimin e Kur'anit, duke e mbajtur shpirtin e popullit

në frikë të vazhdueshme.81)

Pushtimi portugalez po ashtu ka ngadalësuar përparimin e islamit,

që përndryshe do të ishte sikur kjo edhe mos të kishte ndodhur. Ata e kanë larguar kadiun që e ka mësuar popullin në mësimin e Muhamedit dhe kanë përhapur krishterizmin në mesin e popullatës pagane, në çka kanë pasur njëfarë suksesi, së paku për një kohë të shkurtër.82)

Kur Molukasit kanë shfrytëzuar preokupimin e Portugalezëve me vështrësitë e veta vetjake në gjysmën e dytë të shekullit XVI që të lirohen nga pushteti i tyre, ata kanë vënë ndjekje të tmerrshme të të krishterëve. Shumë prej tyre kanë gjetur vdekjen, kurse të tjerët kanë lëshuar fenë e vet, kështu krishterizmi ka humbur pronësinë e vet që e patë arritur.83)

Nga ajo kohë e më tutje kundërvënia supremacionit politik të të krishterëve ka siguruar mirëseardhjen mësuesve muslimanë të cilët në numër më të madh kanë ardhur nga perëndimi.84)

Holandezët e kanë plotësuar rrënimin e krishterizmit në Molluke me largimin e Spanjollëve dhe Portugalezëve nga këto ujdhesa në shekullin XVIII. Pas kësaj jezuitët kanë dërguar pjesën tjetër të të krishterëve të Ternates me to në Filipine.85)

379

Nga këto ujdhesa islammi është përhapur në ujdhesat tjera të Mollukës, edhe pse një kohë konvertitit ka qenë i kufizuar në popullësinë e bregut.86)

Pjesa më e madhe e atyre që kanë kaluar në islam janë Malajët, që e përbëjnë popullësinë e ujdhesave të vogla, deri sa Alfurët e popullëzojnë brendinë. Por konvertitët e periodës së mëvonshme po ashtu do të jenë prej tyre.87)

Madje mjaft herët, në vitin 1521, ka qenë musliman mbreti i Gilolit, mbretërisë në anën perëndimore të pjesës veriore të ujdhesës Halennaher.88)

Në kohën më të re ekzistimi i rregullave të veçanta në dobi të religjionit shtetëror deri diku solli deri te lehtësimi i përparit të islamit në mesin e Alfarëve në pjesën e brendshme të vendit.

Për shembull, sipas atyre rregullave nëse dikush nga Alfuret ka pasur marrëdhënie joligjore me vashën muslimane, duhet të martohet me te dhe të bëhet musliman. Nëse ndonjë femër Alfure martohet për muslimanin, duhet të kthehet në fenë e burrit të vet.

Thyesi i ligjit ka mundur të pendohet me pranimin e islamit.

Nëse do të dëshirohej të plotësohet ndonjë vend udhëheqës i lirë, nuk shikohej në përshtatshmërinë ligjore të kandidatit sa në gatishmërinë e tij ta pranojë islamin.89)

Islami në Borneo

Duket se islami në Borne kryesisht është vendosur në breg, ndonëse në ujdhesë mjaft herët, në filli të shekullit XVI, është forcuar.

Rreth kësaj kohe është pranuar edhe nga popullii Bangjarmasinit,

mbretëria në anën jugore, që ka qenë në raport vazal ndaj mbretërisë induse Magjapoliste deri në rinien e saj në 1478.90)

Rrëfëhet se populli i Bangjarmasinit ka kërkuar ndihmë për ta shkelur një trazinë. Kjo ndihmë iu dha me kusht që ta pranojnë fenë e re.

Pas kësaj ka arritur numër i caktuar muslimanësh nga Java, e shuan kryengritjen, e pastaj me sukses kanë filluar aksionin e konvertimit në islam.92)

Në bregun veriperëndimor Spanjollët kanë gjetur mbretin musliman në Borne kur kanë arritur atje në vitin 1521.93)

380

Diç më vonë islami hynë, në vitin 1550, edhe në mbretërinë e Sukadanëve,94) në pjesën perëndimore të Ujdhesës, me ardhjen e Arabëve nga Palembangu në Sumatro.95)

Monarku sundues refuzoi ta lëshojë fenë e të parëve të vet, por për dyzet vjet të kaluara para vdekjes së tij (1590) feja e re ka arritur përparim të rëndësishëm.

Trashgimtari i tij u bë musliman dhe është martuar me vajzën e princit të ujdhesës fqinje, në të cilin islami, sipas të gjitha gjasave, tashmë një kohë të gjatë është forcuar.96)

Gjatë sundimit të tij një udhëtar,97) që e ka vizituar Ujdhesën në vitin 1600 flet për islamin si fe e shtrirë përgjatë bregut.

Banorët e brendisë, si thotë, të gjithë kanë qenë idhujtarë, kurse shumica këtë janë edhe deri më sot.

Duket se përparimi i islamit në mbretërinë e Sukadanit ka tërhequr vërejtjen e qendrës së botës islame në këtë anë të largët. Gjatë sundimit të princit vijues erdhi shejh Shemsuddini nga mekkeja, duke bartur me vete për dhuratë ekzemplarin e Kur'anit dhe unazën e madhe prej zymbyli me shkresën në të cilën ky mbrojtës i fesë fiton emërtiin e nderit sulltan uhammed Safiuddin.98)

Në fund të shekullit XVIII thuhet për një fis nga brendia me emrin Idani, të banuar në brendi të Barneut verior, që në muslimanët nga bregu ka shikuar me respekt të madh sepse kanë fenë të cilën ata vetë nuk e kanë.99)

Dalrimple, i cili informatën e vet për Idanët nga Borneu e ka fituar gjatë kohës së vizitës së tij Suluut prej vitit 1761 deri 1764, thotë se ata "në shpirt ushqejnë keqardhje për shkak të mosdijes së vet dhe për veten për këtë shkak kanë pasqyrë të keqe.

Prandaj, kur hyjnë në shtëpi dhe anije të muslimanëve, iu shprehin respektin me të madh, si shumë më të mençur, që e njohin Krijuesin e vet.

Ata nuk ulen ku muslimanët flejnë, as i vënë gishtat e vet në chunamin e njëjtë dhe në kutinë e specave, por nga ajo marrin pak me për unjtësinë më të madhe. Ato sidoqoftë shprehin synimin më të madh dhe respektin skajor ndaj Zotit të panjohur. Prandaj ata edhe

nderojnë ata që kanë njohje për Të."100)

Dukej se ky popull, nga ajo kohë, ka miratuar fenë e

Muhammedit.101) Ky është një prej provave të shumta që dëfton në
381

ndikimin e fuqishëm të islamit në fiset që kanë qenë në shkallën më të
ulët civilizuese.

Konversioni ka ndodhur herë pas here edhe në mesin e

kolonistëve: Arabët, Bugisimët dhe Malajasit, njëjtë sikur edhe te

Kinezët (të cilët këtu janë vendosur prej shekullit VII),102) sikur edhe
në mesin e robërve që kanë ardhur në Ujdhesë nga vendet endryshme.

Kështu muslimanët e Borneut sot janë racë e përzier.103)

Shumë prej këtyre të huajve kanë qenë ende paganë kur kanë

arritur në Bornev. Kanë qenë më të civilizuar se Djaksët, që ato i kanë

pushtuar ose larguar në brendi ku ende shumica janë paganë.

Përrjashtim janë ato në pjesën perëndimore të jdhësës ku, kohë pas

kohe, ndonjë fis më i vogël i Djaksëve konvertohet në islam.104)

Kur Djaksët paganë e ndërrojnë fenë e vetë, në rastet e shumta me

tepër i dorëzoheshin bindjes islame se sa bindjes së misionarit të

krishterë ose së pari ktheheshin në krishterizëm, e pastaj kalonin në
islam.

Muslimanët kanë dhënë angazhim të zjarrtë që t'i përvetësojnë

konvertitët barabartë në mesin e Djaksëve paganë dhe të krishterë.105)

Islami në Celebes

Në ujdhesën Celebes hasim rritje të ngjashme të lehtë të fesë

islame. Suksesin e vet e fillon ndër popullatën e bregut dhe

dalëngadalë hapë rrugën drejt brendisë me atë që pjea më e civilizuar

e popullësisë e ka pranuar islamin. Ata në të shumtën janë ndarë në dy

fise: Makasare dhe Bugie, që e popullëzojnë pjesën jugperëndimore të

Siujdhesës. Këta të fundit, Bugët, përbëjnë shumicën proporcionale të

popullësisë së bregut edhe në siujdhesat tjera.

Popullësia që e banon brendinë e Ujdhesës, pos juglindjes së

Siujdhesës ku për afërsisht të gjithë banorët janë muslimanë, ende janë

paganë. Shumica janë të vendosur me Alfurët, me racën me shkallën

më të ulët civilizuese, të cilët po ashtu përbëjnë shumicën e

popullësisë së veriut, lindjes dhe juglindjes së Siujdhesës.

në lindjen skajore të kësaj siujdhesës së parë, d.m.th. në Minahass,

shumica e popullësisë janë të kthyer në krishterizëm.

Muslimanët nuk kanë gjetur rrugë atje deri sa Portugalezët nuk u

forcuan në këtë pjesë të Ujdhesës. Alfurët, të cilët Portugalezët i kanë

kthyer në romako-katolicizëm, kanë qenë të konvertuar në

382

protestandizëm prej Holandezëve, Misionarët e tyre kanë punuar në

Minahassa me sukses të madh.

Islami dalëngadalë ia ka hapur vetes rrugën në mesin e fiseve

pagane të Alfurëve në pjesët e ndryshme të Ujdhesës, pa marrë

parasysh a ka qenë krahina direkt nën administrimin holandez apo nën administrimin e udhëheqësve të vendit.106)

Kur Portugalezët për herë të parë e kanë vizituar Ujdhesën rreth vitit 1540, i kanë gjetur atje vetëm disa muslimanë të huaj në Govë, kryeqendrën e mbretërisë Makassar. Popullësia vendëse ende nuk kishte konvertuar dhe kjo nuk ka ndodhur deri në fillim të shekullit XVII kur islami përgjithësisht është pranuar tek ata.

Historia e lëvizjes është veçanësisht interesante sepse këtu kemi një prej disa rasteve ku krishterizmi dhe islami kanë garuar për besnikërinë e popullit paganë.

Një autor i vjetër bukur flet për një incident në këtë kuptim:

Portugalezët e kanë shikuar zbulimin e vendit aq të rëndësishëm msi në qështjen e pushtimit të madh.

Janë ndërmarrë masat për përvetësimin e simpatisë së atyre që nuk ka qenë lehtë të pushtohet. Nga ana tjetër, ata kanë qenë të gatshëm të shprehin falënderim ose ta kthejnë me të mirë, si aleatë të tyre, për sjelljet e mira.

Ka qenë ky popull i guximshëm, madje më i arsyeshëm dhe më vital nga shumica e Hindusëve.

Pas kësaj, pas diskutimit të vogël me Evropianët, kanë filluar, përgjithësisht, të kuptojnë se feja u është pa kuptim dhe këshilla (mësim).

Disa prej tyre që janë bërë të krishterë me kujdesin e Don Antonio Galvanit (gubernatorit të Malukës) nuk janë aftësuar në atë që është e nevojshme që t'i mësojnë në fenë e re.

Tërë populli përgjithësisht ka refuzuar bestytininë e vet të vjetër dhe kanë filluar, përnjëherë, të besojnë në Zotin. Por nuk u kënaqen me këtë por njëkohësisht kanë vendosur të kërkojnë nga Malokka priftër, kurse nga Achina¹⁰⁷) dijetarë të t'edrejtës islame. Kanë vendosur ta pranojnë fenë e atyre mësuesve që të parët të arrijnë në mesin e tyre.

Portugalezët deri atëherë kanë qenë të çmuar mme entuziazmin e caktuar për fenë e vet, por duket se Don Luis Perera, që ka qenë guvernator i Malakkës, ka qenë nga pak jo i përpiktë për kujdesin për 383

te. Kështu ai bëri vonesë të madhe e të panevojshme në dërgimin e priftërve të kërkuar.

Nga ana tjetër, mbretëresha e Achinës, muslimane e zjarhtë, posa e morri raportin për këtë prirje të popullit nga ujdhesa Celebes, menjëherë përgatiti përplotë anijen juristë islam mqë, për një kohë të shkurtër, me sukses e forcuan fenë e vet në mesin e popullësisë.

Një kohë të caktuar pas kësaj arritën priftëretë e krishterë. Rreptë dhe me idhtësi kanë atakuar të drejtën islame, por pa sukses. Populli i Celebesit vetes ia zgjodhi fenë dhe qe e pamundur të nxiten ta ndërrojnë atë.

Një nga mbretërit e ujdhesës që më parë e ka pranuar krishterizmin ka këmbëngulur në fe dhe shumë shtetas të vet i ka kthyer në të. Por shumica e madhe e popullësisë ka mbetur muslimane. Ata këtë janë deri sot dhe janë më zelltarë ndaj fesë së vet nga cilado popullësi të ujdhesës të Indisë lindore.108)

Thuhet se kjo ndodhi ka ngjarë në vitin 1603.109) Shumë dëftime në te në literaturën bashkëkohore lindin dyshimin në vërtetësinë e këtij tregimi.109/a)

Në principatën e vogël Tallo, në veri të Govës, me të cilën gjithnjë ka qenë në aleancë, ende mund të shihet varri (turbeja) i njërit prej misionarëve më të njohur të Makassarës, me emrin Hatib Tunggal. Sunduesi i këtij shteti pas konvertimit është dëshmuar si trii më i zellshëm i fesë së re. Nën ndikimin e tij islami përgjithësisht është pranuar nga të gjitha fiset që e flasin gjuhën e Makassarës. Rezultati i lëvizjes nuk ka qenë e karakterit aq paqëndashës. Makassarët, të bartur me zjarrin në fenë e posapranuar, kanë atakuar që në te t'i konvertojnë edhe fqinjët e tyre Bugët.

Mbreti i Govëve i ka propozuar mbretit të Bonias që t'ia konsiderojë vetes të barabartë në çdo gjë nëse do ta adhurojë një Zot të vërtetë.

Kur mbreti i konsulltoi popullin e vet për këtë, i thanë: "Ende nuk kemi luftuar, as që kemi pësuar humbje".

Provuani në betejë dhe humben. Mbreti pastaj u bë musliman.

Morri mbi vete obligimin që me forcë ta imponojë besimin e vet shtetasve dhe shteteve të vogla të fqinjve të vet.

Çudi, populli iu drejtua për ndihmë mbretit të Makassarës, që i dërgoi të deleguar mbretit të Bonias, duke kërkuar që t'i përgjigjet nëpyetjeve vijuese: - A ka qenë mbreti në persekutimin e vet veçan i

384

nxitur me shpalljen prej Pejgamberit ose i është nënshtruar ndonjë tradite të vjetër, ose në persekutim ka shkuar nga kënaqësia vetjake?

Nëse kjo është nga shkak i parë, mbreti i Govëve dëshiron njoftim, nëse është nga shkak i dytë, sinqerisht do t'i ofrojë ndihmë, nëse është nga shkak i tretë, mbreti i Bonias duhet të heq dorë, sepse ata te të cilët ka marrë guxi më t'i shtypë janë miqë të Govës.

Mbreti i Bonias fare nuk u përgjigj. Makassarët kanë përgatitur ushtri të madhe në tokë dhe në tri beteja e ngadhjnyen. E kanë detyruar ta lëshojnë vendin, kurse Bonin e kanë shëndrruar në provincë.

Pas zgjedhës tridhjetvjeçare, populli i Bonies me ndihmën e Holandezëve është rebeluar kundër Makassarëve. Kanë pranuar udhëheqjen e fisit Celebes në vend të zotërinjve të vet paraprak.110) Nuk ka dyshim se propaganda e islamit në mesin e Bugëve111) ka kaluar shkallërisht dhe ngadalë, por kur e pranuan fenë e re, duket se i ka nxitur në punë, sikur që i ka nxitur më herët Arabët (ndonëse ky

zgj i ri i energjisë në të dy këto rastet është nisur në drejtime të ndryshme). Prej tyre islami ka bërë atë që sot janë njëkohësisht njerëzit e të guximshëm dhe tregtarët më të shkathtë dhe detarë të Arkipelogut.112)

Me anijet e veta tregtare kanë udhëtuar deri te të gjitha pjesët e Arkipelogut, nga brigjet e Guinesë së Re deri në Singapur. Me kolonitë e tyre të shumta në vendbanimet në të cilat Bagët veçan janë dalluar është futur islami në shumë ujdhesa pagane.

Për shembull, një koloni e tyre është themeluar në shtetin që është shtrirë në pjesën e konsiderueshme të bregut jugor të Floresit. Aty janë përzier mme vendasit e vjetër, prej të cilëve një pjesë ka qenë romakokatolikë. Tërë popullësinë e këtij shteti kanë arritur ta kalojnë në islam.113)

Bugët edhe në ujdhesën e vet vetjake Celebes kanë kombinuar punën në përhapjen e fesë mme punët e tyre tregtare.

Arritën në mbretërinë e vogël Balang - Mongondou në veri të Siujdhesës114) gjatë këtij shekulli të përvetësojnë në islamm popullësinë e krishterë, konvertimi i të cilëve daton nga fundi i shekullit XVII.

Mbreti i parë i krishterë i Balaang-Mongondvas ka qenë Jakop Monopo (1689-1709), gjatë sundiit të të cilit krishterizmi shpejtë është 385

përhapur me anë të ndikimit të kompanisë lindoro-induse të Holandës dhe me punën misionariste të priftërve holandezë.115)

Të gjithë trashëgimtarët e tij kanë qenë të krishterë deri në vitin 1844 kur raxha sundues Jakob Manuel Manopo ka kaluar në islam. Kalimi i tij në islam ka qenë kurora e përpjekjeve në përhapjen e fesë së re, e cila ishte në përparim në fillim të këtij shekulli.

Kjo ndodh në kohën kur tregtarët muslimanë, Bugët dhe të tjerët, me punën e tyre të zjarrtë kanë përvetësuar një numër të caktuar të konvertitëve në islam mnë një qytet bregdetar në veri të mbretërisë Mongodou.

Nga ky qytet janë nisur dy tregtarë misionarë me emrin Haki mBagus dhe imam Tuveko ta përhapin fenë e vetë në viset tjera të mbretërisë.

Filluan me konvertimin e disa robërve dhe grave vendase me të cilat janë martuar. Pak nga pak i kanë përvetësuar shokët dhe kushërinjt e vet ta pranojnë fenë e re.

Nga Mongondoui islami është përhapur në mbretërinë veriore Balaang, ku tërë popullësia në vitin 1830 ka qenë ose e krishterë ose pagane, me përjashtim të dy apo tre banorëve muslimanë.

Por thirrësit e zjarrtë në islamm Bugë dhe Arabët, që u kanë ndihmuar në punët e tyre misionariste, kanë arritur sukses të përmasave të gjëra.

Të krishterët, njohja e të cilëve e mësiit të religjionit të vet ka qenë

e parëndësishme, kurse edhe vetë besimi ka qenë i dobët, kanë qenë dobët të armatosur për polemikë që të marrin goditjen e mësimit rival.

Pasi vetë pushteti holandez në këta të krishterë ka shikuar me nënçmimin, kurse edhe autoritetet kishtare i kanë mospërfillur, ata këto të huaj, nga të cilët disa janë martuar dhe në mesin e tyre janë vendosur, i kanë mbajtur për miqë të vetë.

Pasi që puna në konversion ka përparuar, vizita e këtyre Bugëve dhe Arabëve, në fillim e rralluar, është bërë më e shpeshtë, kurse ndikimi i tyre në tokë ka qenë në rritje të madhe. Kjo ka shkuar deri aty që rreth vitit 1832 një Arab është martuar me vajzën e mbretit Korneligë Manopa, që ishte i krishterë. Diku në të njëjtën kohë shumë krerë, dhe ata më me influencë në mesin e tyre, e kanë lëshuar krishterizmin dhe kanë pranuar islamin.

Në këtë mënyrë islami është forcuar në mbretërinë e tij para se raxha Jakob Manuel Manopo është bërë musliman në vitin 1844.

386

Ky princ shumë herë ka kërkuar nga pushteti holandez në Manadou që ta caktojë trashëgimtarin mësuesit të krishterë Jakob Bastiaanos, vdekja e të cilit ka qenë humbje e madhe për bashkësinë e krishterë, por që pa sukses.

Kur mësoi nga rezidenca në Manadou se administrata holandeze është plotësisht indiferente, se populli i shtetit të tyre është i krishterë apo muslimanë dhe se janë lojalë, haptazi deklaroi se është musliman dhe me të gjitha mjetet ka tentuar t'i fusë të deleguarit e vet në fenë e njëjtë - në islam.

Një Arab, misionar, shfrytëzoi vitin vijues vështirësitë gjatë shpërthimit të termetit, duke profetizuar se Bolang - Mongondou do të rrënohet nëse populli së shpejti nuk kthehet në islam.

Shumë prej tyre në frikë e dëgjua këtë këshillë. Raxha dhe fisnia e tij u kanë ofruar ndihmën e vet misionarëve dhe tregtarëve arabë, metodat e të cilit në mirësjellje me ata që janë në kontest nuk kanë qenë gjithnjë më të përzemërta.

Afër gjysma e popullësisë ende është pagane, por progresi i islamit në mesin e tyre, ndonëse i ngadalshëm, sigurisht vazhdon.116) Duket se Sambava fqinje dijen e vet për këtë fe e ka pranuar nga Celebesi, me anë të thirrjes së misionarëve nga Makassar ndërmjet vitit 1540 dhe 1550.

Thuhet se të gjithë banorët më të civilizuar janë besimtarë të sinqertë dhe më të përpiktë në kryerjen e detyrave fetare nga cilido popull fqinj musliman.

Kjo mme të madhe është meritë e lëvizjes përtërëse që e ka filluar njëfarë haxhi Aliu, pastaj erupcionit të tmerrshëm në malin Tambora në vitin 1815. Kjo fatkeqësi e tmerrshme në atë vend ka pasur për pasojë që populli të nxitet në aplikimin më të përpiktë mësimit të fesë së vet dhe të zhvillojë jetë më të devotshme.117)

Deri më sot islami vazhdon me përvetësimin e konvertitëve të rinj në këtë ujdhesë.118)

Sasaksët, që e popullëzojnë ujdhesën fqinje Lambok, po ashtu i kanë borgj kthimin e vet në islam thirrjes së Bugit, që atje kanë themeluar koloninë e madhe. Kanë ardhur me kalimin e ngushticës nga Sambave ose direkt nga Celebesi. Sido qoftë, konvertimi ka kaluar në mënyrë të qetë.119)

Popullësia e Lambokës ndahet në dy pjesë: në Sasaksë dhe Balinë. 387

Pjesën e parë e përbëjnë Sasaksët muslimanë, popullësia autoktone e Ujdhesës, shumë më e numërt nga pjesa e dytë.

Por, kah mesi i shekullit XVIII kanë ardhur nën administratën e BALinëve dhe së shpejti ujdhesa që vërshuar me grupet e fqinjëve hindusë.120)

Administrata e BALinëve ka qenë mjaft e vrazhdë dhe kanë dhënë angazhim - ndonëse me pak sukses - që shtetasit e vet muslimanë t'i kthejnë në hinduizëm.

Sasaksët janë orvatur, pa sukses, që të çlirohen nga tirania dhe shkelësit e tyre dhe shumë herë kanë kërkuar ndihmën e pushtetit holandez para se fushata luftarake nga viti 1894 solli paqë në Ujdhesë dhe konstitui administratën e rregullt nën sundimin holandez.

Pushteti i ri me vete solli numër të madh të nëpunësve muslimanë vendas, të cilët ndikimin e vet e vunë në anën e fesë së vet.

Për këtë shkak duhej prituri që një prej rezultateve të pushtetit holandez të Lombokit të jetë hovi i madh i islamit në këtë ujdhesë.121)

Islami në Filipine

Në Filipine hasi mkonfliktin ndërmjet krishterizmit dhe islamit për lojalitetin e banorëve. Deri diku, ky konflikt sipas karakterit të vet është i ngjashëm me atë në Celebes, me atë që atje ka qenë shumë më i rreptë dhe më i gjatë.

Në të janë përleshur Spanjollët dhe muslimanët në konflikt të rreptë e të përgjakur, që ka zgjatur deri në shekullin XIX.

Është e pasigurtë kur ka arritur islami në këto ujdhesa.122)

Kronika tradicionale e Mindanoas shtron se islami ka hyrë nga Gjahora, në siujdhesën Malajase, nëpërmjet njëfarë Kabungsnvani, që është vendosur në Ujdhesë me një numër të caktuar të ithtarëve të vet dhe atje është martuar.

Rrëfëhet se ai ka refuzuar që të zbret deri sa njerëzit, që e kanë prituri, nuk premtojnë se do të kalojnë në islam.

Këto lajme të para japin përshtypjen se zbritja e Kabungsuvanit dhe konversioni i popullit të Mindanaot në filli mka kaluar krejtësisht qetë.

por, pasi e forcoi fuqinë e vet, filloi t'i pushtoi kryeparët dhe fiset fqinje. E kanë pranuar edhe fenë e tij duke iu nënshtruar pushtetit të tij.123)

388

Spanjollët që i zbuluan në vitin 1521 kanë konfirmuar se banorët e ujdhesave veriore janë paganë të vrazhdë e të thjeshtë, deri sa ujdhesat Mindanao dhe Sulu janë të banuara me fiset shumë më të kulturuara muslimane.124)

Deri në fund të shekullit XIX në shumë pjesë të Ujdhesës me sukses i janë kundërvënë të gjitha orvatjeve të të krishterëve në pushti mdhe kryqim. Kështu misionarët spanjollë kanë rënë në dëshpërim në kryerjen e konversionit të tyre.125)

Suksesi i islamit në krahasi mme krishterizmin në masën më të madhe duket t'i falënderohen llojllojshmërisë së formës në të cilën këto dy lloje të feve i janë prezentuar popullësisë.

Pranii i krishterizmit d.m.th. humbje e çdo lirie politike dhe pavarësie nacionale. Për këtë shkak në të shikohej sikur në simbol të robërisë.

Metodat me të cilat janë shërbyer Spanjollët në propagandimin e fesë së vet e kanë bërë prej fillimit jopopullarizuese. Rreptësia dhe jotoleranca e tyre ka qenë në kundërshti të fuqishme me sjelljen e qetë të misionarëve muslimanëve. Ata e kanë mësuar gjuhën e popullit, kanë pranuar traditat e tij, janë martuar me ta dhe janë shkrirë në masën e popullit. Për vete nuk kanë përvetësuar të drejta të veçanta të racës së privilegjuar as që në popullësinë vendëse kanë shikuar si në kastën e nënçmuar.

Nga ana tjetër, Spanjollët kanë injoruar gjuhën, rrobat dhe shprehitë e popullësisë vendëse. Dekshmëria, koprracia dhe lakmia e tyre ka sjellur deri te urrejtja e fesë së tyre, deri sa përhapja e fesë ka shërbyer si instrument të përparimit politik.126)

Sëkëndejmi nuk është rëndë të kuptohet kundërshtimi që popullësia vendëse ka dëftuar ndaj ardhjes së krishterizmit. Ajo është bërë fe e popullit në ato vise ku popullësia ka qenë mjaft e dobët ose ujdhesat kanë qenë krejtësisht të vogla prandaj Spanjollët kanë mundur që plotësisht t'i nënshtrojnë.

Të krishterët vendas, pas konvertimit, kanë qenë të detyruar t'i kryejnë detyrat e veta fetare nga frika prej ndëshkimit. Kanë qenë njëmend të trajtuar si fëmijët shkollor.127)

Deri në okupimin amerikan të ujdhesave filipinase mbretëria Mindanao ka qenë strehimore e atyre që kanë dëshiruar të shpëtojnë nga administrata e urrejtur e krishterë.128)

389

Ujdhesa Sabo, që nominalisht ka qenë në pronësi spanjolle deri në vitin 1878, ka krijuar qendrën e dytë të rezistencës muslimane ndaj krishterizmit. Këtu kanë mundur129) të gjenden edhe renegatët që kanë ditur spanjollsiht.

Islami në Sulu

Nuk kemi prova të sigurta historike për atë sa gjatë banorët e

Suluit kanë qenë muslimanë paraardhjes së Spanjollëve.

Historia e Suluve përmend emrin e Sherif Kerim el-Mahdumit si misionarin e parë të islamit në Ujdhesë.

Për të thuhet se ka qenë Arab që ka ardhur në Malakkë kah mesi i shekullit XIV dhe ka kthyer në islam msulltan Muhammedin dhe popullin e Mallakës.

Duke vazhduar rrugëtimin e vet drejt lindjes, arriti në Suluu rreth vitit 1380 dhe u vendos në Bvause, 130) në kryeqendrën e vjetër të Suluve. Aty populli ia ndërtoi xhaminë dhe shumë krerë pranuan mësimin e tij.

Për të thuhet se ka vizituar pothuaj çdo ujdhesë në Arkipelog dhe se në islam ka kthyer shumë njerëz në shumë vende. Thuhet se tyrben e ka në ujdhesën Sibutu. 131)

Misionari vijues që përmendet është Ebu Bekri dhe për të thuhet se ka qenë Arab dhe se punën e vet misionariste e ka filluar në Malakkë dhe se ka kaluar nëpër Pallambang dhe Brunej dhe ka arritur në Sulu rreth vitit 1450. Ka ndërtuar xhaminë dhe ka vazhduar propagandimin e suksesshëm.

Mbreti musliman i Bvanse, lideri i Bagindëve. ia dha vajzën për grua dhe e ka bërë trashëgimtar të vetin.

Është meritë e Ebu Bekrit që e ka organizuar administratën.

Jurisprudencën e Suluve e ka vënë në bazat ortodokse islame, aq sa këtë traditat vendase kanë lejuar. 132)

Ndonëse aq mati kanë kaluar në islam, banorët e Suluit janë larg asaj se janë muslimanë të mirëfilltë. Në këtë kanë ndikuar robët e shutë të krishterë, të sjellur nga Filipinët, në ekspeditat e veta grabitëse. Ndikimi ka qenë aq i fuqishëm sa disa hulutues kanë konsideruar "se ata janë të krishterë të mirëfilltë tashmë ka herë, por duke supozuar se ndryshimi i tillë i fesë me ndarjen e dominimit të ndikimit të priftërisë medoemos ka shpjerë në rrënimin e pushtetit 390

vetjak dhe ka konfirmuar rrugën e përcjelljes së pushtetit të tyre nën zgjedhën spanjolle.

Ky është rast përvoja e kobshme e të cilit bindshë i ka mësuar të gjithë popujt përreth të cilët nga pakujdesia kanë përqaftuar besimin e krishterë."

Kësaj i shtohet edhe sjellja agresive e priftërve spanjollë, të cilët e kanë formuar misionin në Suluu dhe i cili në shpirtin e popullësisë ka krijuar antipati të tmerrshme ndaj fesë së huaj. 134)

Nga koha e okupacionit amerikan të Filipineve ndikimi i islamit ka qenë mjaft i kufizuar. Tash është ngushtuar në ujdhesën Polavan, bregun përendimor të Mindanaos dhe në arkipelagu Sulu. 135)

Islami përpiqet ta zgjerojë propagandën e vet në ujdhesat veriore. Thuhet se ka filluar me aktivitetin isionarist madje në Manilë. Thuhet se disa rrethana i kanë ndihmuar suksesit të tij, veçan fakti

se Filipinasit kanë ushqyer paragjykime ndaj krishterizmit për shkak të keqpërdorimeve, që i kanë shtyrë që t'i kapin armët kundër murgëve spanjollë.136)

Islami në mesin e Papuanëve

Siç është cekur tashmë, isla është pranuar me entuziazmin ë të madh te populli me nivel më të lartë kulturor në arkipelogun Malajas, deri se tek ato me stadio më të ulët kulturor ka lëshuar rrënjë ë të cekta.

Të tillë janë Papuanët e Guinesë së Re dhe ujdhesave në veriperëndimin e tij. Vaigej, Misool, Varigama dhe Salavatti.

Këta ujdhesa, së bashku me siujdhesën Onin, në veriperëndim të Guinesë së Re, kanë qenë në shekullin XVI nën sundiin e sulltanit të BAçanit,137) njërit nga mbretërit Molukas.

Me anë të ndikimit të sunduesve muslimanë të Butçanit krerët popuanas të këtyre ujdhesave e kanë pranuar islain,138) ndonëse shumë njerëz në brendi kanë mbetur deri sot idhujtarë. Popullsia e bregut me shumicë janë muslianë. Nuk ka dyshi se merita për këtë i përket kolonistëve nga Moluka.139)

Duhet se në vetë Guinenë e Re një numër i vogël i Papuanëve ka pranuar islamin. Islami ka hyrë në bregun perëndior (ndoshta në siujdhesën Onin) nëpërmjet tregtarëve muslimanë të cilët fenë e vet e kanë propaganduar në mesin e popullësisë në filli të vitit 1606.140)

391

Por, duket se ka bërë përpari të vogël gjatë kohës së shekullit të kaluar nga ajo kohë.141) Papuanët nuk janë bregosur të bëhen muslimanë, sikur që nuk kanë pasur prirje ndaj praniit të mësimit të misionarëve të krishterë, të cilët kanë punuar në mesin e tyre pa ndonjë sukses më të madh prej vitit 1855.

Muslimanët e ujdhesave fqinje janë akuzuar se ndaj Papuanëve sillen me përbuzje të amdhe që ta japin ndonjë përpjekje në përhapjen e islamit në mesin e tyre.142)

Sidoqoftë, është gjetur emri i një isionari, njëfarë Imami Dhikri (Zikr?) që ka ardhur nga Kerami, ujdhesa në juglindje, rreth vitit 1856, dhe e futi islamin në ujdhesën e vogël Adi, në jug nga Onim.

Pasi e përmbushi detyrën e vet, iu kthye shtëpisë së vet. Iu kundërvu përpjekjes së popullësisë që të mbetet në mesin e tyre.143)

Tregtarët muslimanë nga Kerami dhe Garami njoftojnë se kanë kthyer në islamnjë numër të caktuar të idhujtarëve në decenien e parë të shekullit XX.144)

Angazhi të ngjashëm është dhenë në konvertimin e Papuanëve në ujdhesat fqinje Kei.

Thuhet se kah mesi i shekullit XIX ka qenë vështirë të gjenden çfarëdo muslimanësh në këto ujdhesa përpos pasardhësve të të shpërngulurve nga ujdhesat Banda.

Diç më herët, misionarët nga Kerani kanë patur sukses në

konvertiin e disave në islam, por rregullat e Kur'anit janë kryer shumë pak. Veta i kanë lejuar ngrënien e mishit të ndaluar dhe pimjes së pijeve dehëse.

Femrat, si thuhet, kanë qenë më të përpikta në lojalitetin fesë së vet se mashkujt. Kështu, kur ashkujt vetes i lejonin ngrënien e mishit të derrit, duhet këtë ta bënin fshehurazi, sepse gratë nuk e lejonin këtë të futet në shtëpi.145)

Por në vitin 1877 vërehet njëfarë ringjallje e jetës fetare në mesin e banorëve të ujdhesës së Kaias, kurse edhe numri i muslimanëve për çdo ditë rritej.

Tregtarët arabë nga Maduza, Java dhe Bali janë dëshmuar si propagandues të zjarrtë të islamit. Nuk e kanë lëshuar asnjë mjet që nuk e kanë përdoruar në përvetësimin e konvertitëve.

Nganjëherë dëshmitë e veta i kanë provuar me kërcënim dhe forcë, e në rastin tjetër me mito.

392

Thuhet se rëndo konvertiti i ri ka marrë 200 florine si vlerë e dhuratës, deri sa krerët merrnin dhuratë nga njëmijë florinë.146)

Shtrohet se kah fundi i shekullit XIX rreth 8000 banorë të ujdhesave, nga numri i përgjithshëm e banorëve të ujdhesave Kei, kanë pranuar islamin.147)

Misionarët e islamit: tregtarët dhe shtresa "El-Haxhi"

Pasqyra e përgjithshme e përhapjes së islamit prej perendimit drejt lindjes nëpërmjet arkipelogut alajas përmbanë një pjesë të vogël të historisë së punës misionariste islame në këto ujdhesa.

Shumë fakte të kësaj historie në tërësi nuk janë shënuar. Por çka ka mund të tubohet nga kronikat e vendësve, punimeve të udhëtarëve evropianë, nëpunësve dhe misionarëve pa kusht është fragmentare dhe jo e plotë.

Por, ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme që tregojnë në ekzistimin e punës së qetë misionariste në përhapjen e islamit gjatë gjashtëqind viteve të kaluara.

E vërteta, shpata nganjëherë është nxjerrë që të përmbahet parimi i fesë, por thirrja dhe bindja, e jo fuqia dhe dhuna, kanë qenë karakteristikat kryesore të kësaj lëvizjeje misionariste.

Sukseset e shkëlqyeshme që janë arritur në të shumtën janë përpjekjet e tregtarëve që e kanë gjetur rrugën e vet deri te zemrat e vendasve me mësimin e gjuhës së tyre, me praniin e sjelljes dhe traditës së tyre. Ata në mënyrë joatakuese dhe shkallërisht kanë përhapur dijen për fenë e vet, së pari me kthimin e grave të vendit me të cilat janë martuar dhe personave me të cilat janë lidhur me punët e veta tregtare.

Në vend që ta mbajnë veten të ndarë në izolim mendjemadh, ata shkallërisht janë shkrirë në masën e popullësisë. E kanë përdorë supremacionin e vet intelektual dhe kulturor në punën e vet në kthimin

në islam. Gjatë kësaj kanë bërë kompromise të shkathta në mësimin dhe praktikën e fesë së vet që ka qenë e domosdoshme në afrimin e kësaj feje popullit që kanë dëshiruar ta tërheqin.148)

Në realitet, sikur që edhe Bikle ka thënë për ta, misionarët muslimanë janë mjaft mendjemprehtë.149)

Pos tregtarëve ka qenë aty edhe një numër i caktuar i atyre që mund të quhen misionarë profesionalë: teologë, predikues, kadi dhe 393

haxhi. Këta të fundit, viteve të kaluara, kanë qenë veçan aktiv në punën për përhapjen e fesë, ngritjen dhe forcimin e jetës strikt fetare në mesin e bashkëbesimtarëve të vet.

Kanë punuar në pastrimin e tyre nga mbeturinat e shprehive dhe besimneve pagane.

Numri i atyre që shkojnë në haxh në Mekke nga të gjitha anët e Arkipelagut gjithnjë është në rritje. Pasojë e kësaj është rritja proporcionale e ndikiit musliman dhe mendimit islam.

Deri kah mesi i shekullit XIX pushteti holandez ka tentuar të vë pengesa në rrugë haxhinjve. Ka dhënë urdhëresë se askujt nuk do t'i lejohet ta kryejë pelegrinin qytetit të shenjtë Mekkes pa pasaportë për të cilin duhet paguar 110 florinë. Secili që i shmangëtij rregulli, pas kthimit, do të detyrohet ta paguaj gjobën në të holla në sasi të dyfishtë.150)

Sandejmi nuk është për t'u çuditur që në vitin 1852 është zvogëluar numri i haxhinjve vetëm në 70, por po atë vit kjo urdhëresë është anuluar dhe prej atëherë nuri i haxhinjve është rritur në mënyrë konstante.

Numri mesatar i haxhinjve gjatë dekadës së fundit të shekullit XIX ka qenë 7000, kurse gjatë dekadës së parë të shekullit XX ka qenë 7300.151) por numri nga viti në vit ka qenë tjetërfare.

Numri më i madh i shënuar i haxhinjve në vitin 1910 nga India holandeze ka qenë 14.234.152) Nuk ka dyshim, për rritjen e këtillë të numrit të haxhinjve meritë kanë edhe trafiku i lehtësuar ndërmjet Mekkes dhe arkipelagut Malajas.

Vetëm kjo, siç e ka vërejtur një misionar i krishterë, "nuk e zvogëlon rëndësinë e faktit që haxhinjt, numri i të cilëve aq shpejtë rritet, në ansjë mënyrë nuk humbin, për shkak të numërsisë, në kualitetin e arritur.

Përkundrazi, në mesin e atyre ka tani shumë sosh që më hollësisht janë njoftuar me principet e islamit dhe krejtësisht e kanë përshkuar me zellë uslimanë dhe me urrejtjen ndaj paganizmit ë shumë se që kanë qenë më herët."153)

Raporti i adminisratës holandeze dhe misionarëve të krishterë sjellin pohl unik mbi ndikimin dhe entuziazmin fetar të këtyre haxhinjve. Ata kthehen në shtëpitë e tyre njëkohësisht sikur reformatore dhe misionarë.154)

394

Përveç haxhinjëve që janë kënaqur vetëm me vizitën e vendeve të shenjta dhe me kryerjen e ritualeve të detyrueshme, ka edhe asosh që kanë mbetur më gjatë nga nevoja e plotësimit të studimeve të veta teologjike. Ekziston edhe kolonia e madhe e Malajaseve në Mekke në këtë kohë, që për gjithmonë janë vendosur në qytetin e shenjtë.

Ata janë në lidhje të përhershme me bashkëqytetarët e vet në vendlindje. Përpyekjet e tyre janë mjet të suksesshme në pastrimin e islamit në arkipelogun Malajas nga elementet e traditave pagane dhe mënyrës së mendimit, që janë ruajtur nga koha më e hershme.

Numri i madh i librave fetare po ashtu është shtypur në mekke në shumë gjuhë e të cilat flasin muslimanët malajas. Këto libra janë dërguar në të gjitha pjesët e Arkipelogut.

Me të drejtë është thënë se Mekkeja më shumë ka ndikuar në jetën fetare të këtyre ujdhesave se sa në Turqinë, Indinë ose Buhanën.155)

Sikur që mund të pritët nga shqyrtimi i këtyre fakteve, në vitet e kaluara ka ndodhur rilindje e madhe e aktivitetit misionariste në arkipelogun Malajas.

Haxhinjt që ktheheshin, barabartë sikur edhe tregtarët dhe mësuesit fetar, janë bërë thirrës në islam, sa herë kanë ardhur në kontakt me popullësinë pagane.

Mbi të gjitha, vëllazëritë fetare e kanë shtrirë organizatën e vet në arkipelogun Malajas.156)

Madje edhe më e reja prej tyre, senusitë, kanë gjetur ithtarë në ujdhesat më të largëta.157) Një nga dëshmitë e ndikiit të tyre shihet në atë që emrin "Senusi" e kanë marrë shumë Malajas kur në Mekke i ndërrojnë emrat vendes për ata arab.158)

Misionarët e krishterë e kanë akuzuar pushtetin holandez që po ndihmon përhapjen e islamit.

Sido qoftë, është e sigurtë se puna e misionarëve muslimanë është lehtësuar me faktin që gjuha e Malajasëve, me të cilin pothuaj askush nuk flet porse muslimanët është marrë, pos në Javo, si gjuhë zyrtare i sundiit holandez.

Pasi që shërbimet civile holandeze çdokund kanë qenë përplotë nëpunës ndihmës muslimanë, përfaqësues politikë, shkrues, përkthyes dhe tregtarë, ato me vete e kanë përcjellur islamin në çdo vend që i kanë vizituar.

395

Të gjithë personat që kanë bashkëpunuar me pushtetin kanë qenë të obliguar që ta mësojnë gjuhën malajase, dhe rrallë e kanë mësuar e që njëkohësisht nuk janë bërë muslimanë.

Në këtë mënyrë bota më influencuese ka kaluar në islam. Në fund edhe të tjerët kanë ndjekur shembullin e tyre.159)

Kështu islami edhe sot punon në zhdukjen e paganizmit nga arkipelogu Malajas.

- 1) Niemann, fq. 337.
- 2) Reinaud Geographie d. Aboulfeda, bl. I, fq. CCCXXXIX.
- 3) Groeneveldt, fq. 14, 15.
- 4) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 66, 80.
- 5) Veth (3), vol. I, fq. 231, Ibn Batutah, bl. IV, fq. 89.
- *) Emri i vjetër i Suamtrës, thonë se është me prejardhje sauskrite dhe d.m.th. det.
- 6) Ibn Batutah, bl. fq. 230, 234.
- 7) Snouck Hurgronje (I), fq. 8-9.
- 8) Padre Gainza, cituar sipas C. Semper, fq. 67.
- 9) Crawford (2), vol. II, fq. 265.
- 10) Snouck Hurgronje, L'Arabie et les Indes Neerlandaises (Revue de l'Histoire des Religions, vol. LVII, fq. 69 sqq.).
- 11) De Hollander, vol. I, fq. 581, Veth (17, fq. 60. Ky aluzion i paqartë ka të bëjë me Arabinë, Persinë ose Indinë. Por, nëse personaliteti i Xhahan-shahut është i vërtetë, atëherë ka mundësi se ka arritur nga bregu i Koromandeles ose Malabarës (Chronique de Royaume d'Ateheh, traduite du Malay par Ed Dulanrier, fq. 7).
- 12) Marco Polo, vol. II, fq. 284.
- 13) Veth (I), fq. 61.
- 14) Yule's Marco Polo, vol. II, fq. 294, 303.
- 15) Ibn Batutah, bl. IV, fq. 230-236.
- 16) Groeneveldt, fq. 94.
- 17) Në kulminacion të fuqisë së vet është shtrirë prej 20 në veri deri 20 në jug në bregun perëndimor, dhe prej 10 në veri deri 20 në jug në bregun lindor. Në shekullin XVI ka humbur sundimin në bregun lindor.
De Hollander, vol. I fq. 3.
- 18) Marsdeu, fq. 343.
396
- 19) J.H. Mooer (Apendix, fq. 1)
- 20) Marsdeu, fq. 355.
- 21) Godsdienstige verselijnselen en toestanden in Dost - Indie. (Uit de Koloniale Verslagen van 1886 en 1887) Med. Ned. Zendelinggen, vol. XXXII, fq. 175-176 (1888). Në vitin 1909 numri i përgjithshëm i Bataksëve ka qenë 500.000, kurse 300.000 ende janë paganë, kurse 125.000 janë muslimanë kurse 80.000 janë të krishterë. (R. du M.M. vol. VIII, fq. 183)
- 22) J. Warneck, Die Religion der Batak, fq. 122 (Leipzig, 1903).
- 23) G.R. Simon, Die Propaganda des Holbmondes. Ein Beitrag zur Skizzierung des Islam unter den Batakken, fq. 425, 429-430. (Allgemeine Missionen - Leitschrift, vol. XXVII, 1900).
- 24) R. du M. M. vol. VIII (1909), fq. 183.
- 25) A. L. von Hassalt, fq. 55, 68.

- 26) Med. Ned. Zendelinggen, id. fq. 173 (Koloniaal VErslag vau 1911, fq. 26, 1912, fq. 17).
- 27) Uit het Kolonial Verslag van 1889 (Med. Ned. Zendelinggen, vol. XXXIV, fq. 168. (1890).
- 28) Kolonial Verslag vau 1910, fq. 30.
- 29) De Hollander, vol. I, fq. 703.
- 30) Koloniaal Verslag van 1904, fq. 80, 1905, fq. 46; 1909, fq. 47, 1910, fq. 33; 1911, fq. 29; 1912, fq. 21.
- 31) Canne, fq. 510.
- 32) Marsdeu, fq. 301.
- 33) Nieman, fq. 356-359.
- 34) J. H. Moor, fq. 255.
- 35) Prej kur këto Hindusë, kurse ne ikonsiderojmë Arabë - Persianë dhe Guxhuratë, janë shpërngulur për shkak të tregtisë, një grup prej tyre na ka konvertuar në fenë e Muhammedit. Pasi që disa prej vendasve kanë hyrë në këtë fe, nuk ka zgjatur shumë që kjo "murtajë e zezë" të arrijë deri në Malakkë." (De Barros, Dec. II, Liv. VI, cop. I, fq. 15).
- 36) Aristide Marre, Malako, Histoire desrois malays de Malaka. Traduit et extrait du Livre des Annales malayses, institule en arabe Selakt al Salatgn, fq. 8 (Paris, 1874).
- 37) Crawford (I), fq. 241-242.
- 38) Barbosa shkruan në vitin 1516 dhe flet për tregtarët e shumtë muslimanë që shpesh vijnë në limanin Kueda (Ramusio, bl. I, fq. 317).
397
- 39) Muzlij, në këtë farmë nuk është përendur në Kur'an; ka mundësi që në të vetëm teë jepet shenjë në suren XXVI, ajeti 90: "Dhe Xhenneti do t'u afrohet të devotshmëve".
- 40) Përkthii i Historisë së Kedahut (Kedoh Annals) prej Lient - Col. James Low, vol. III, fq. 474-477.
- 41) Ibid., fq. 480.
- 42) Newbold, vol. I, fq. 252.
- 43) Mc Nair, fq. 226-229.
- 44) J.H. Moor, fq. 242.
- 45) Newbold, vol. II, fq. 106, 396.
- 46) R. du M. M. bl. II 61907, fq. 137-138.
- 47) Snouck Hurgronje (I), fq. 9.
- 48) Veth (3), vol. I, fq. 215. Raffles (ed. of 1830), vol. II, fq. 104, 183.
- 49) Pozita e Çermenëve nuk është caktuar. Viti mendon (3), vol. I, fq. 230, se ka mundësi të jetë në Indi, por Rouffaeri (fq. 115) jep arsye krejtësisht të mir se ky vend gjendet në Sumatre.
- 50) Përshkriin e gjendjes së tashme të këtyre varrezave ka dhënë Z. F. Brumund (fq. 185). Në njërin prej tyre ende është mmbishkrimi në alfabetin arab (fq. 185).

- 51) Greoneveldt VII, fq. 49-50.
52) Kern, fq. 21.
53) Veth (3), vol. I, fq. 233-242, Roffles, vol. II, fq. 113-133.
54) Ranifaer Çampën nuk e vendos në Kamboxha por në bregun verior të Atjeçes dhe e identifikon me Djeumpa-n bashkëkohore (Encyclopedie vau N.I. vol. IV. fq. 206).
55) Ende mund të gjenden në Çampa mbeturinat e minareve dhe varreve islame (Bastion, vol. I, fq. 498-499).
56) Kjo pasqyrë gjenealogjike sqaron këto lidhje farefisnore siç dëfton edhe në raportet tjera për të cilat do të ketë fjalë më vonë.
57) Kujtimi për këtë femëe ruhet te Javanët me respekt të madh dhe shumë vijnë që të luten në varrin e saj. Shih Brumund, fq. 186.
58) Veth (3), vol. , fq. 235-236.
59) Kjo xhami ende ekziston dhe Javanaët e shikojnë si objektin më të shenjtë në ujdhesën e vet.
60) Ekziston dyshimi i caktuar se kjo datë është i hershuar. Studimet e burimeve portugaleze dëftojnë në konkludimin se Magjapakiti ka pësuar disfatë 40 vjet më vonë.
398
61) Populli i Baliut deri në ditët tona ka ofruar rezistencë shumicës së përpjekjeve të zjarrta të muslimanëve që t'i tërheqin ta pranojnë islamin.
Përveç kalimeve të përkohshme në islam edhe të bashkësisë më të vogël të muslimanëve vendas, numri i tyre është tre mijë, kurse numri i përgjithshëm mmbi 862.000 njerëz.
Pozita e favorshme e Ujdhesës për caqet tregtare gjithnjë ka tërhequr një numër të caktuar të të huajve në brigjet e tij, që në rastet e shumta për gjithnjë janë banuar në ujdhesë. Deri sa disa nga këta të shpërngulur kanë qëndruar nga vendasit, të tjerët kanë krijuar lidhje martesore me autoktonët, që ka pasur për pasojë përzierjen me shumicën e popullësisë.
Pikërisht është merita e këtyre që islami më vonë ka bërë përparim të ngadalshë, por të sigurtë.
Si flitet, muslimanët e BALisë përbëjnë bashkësinë përparimtare dhe aktive plotë entuziazëm në përparimin e fesë së vet. Kjo është bashkësi që në fund ka ndikuar në fqinjët e vet paganë. Edhe përveç të gjitha këtyre nuk kanë pasur sukses, në emër të adhurimit të Allahut, t'i kthejnë nga ngrënia e mishit të dërrit për to të dashur. (Liefriek, fq. 241-243).
62) Encyclopaedia von N-I, vol. II, fq. 523.
63) Veth (3), vol. I, fq. 245, 284.
64) raflex, vol. II, fq. 316.
65) Veth (3), vol. I, fq. 285-286.
66) Veth (3), vol. I, fq. 305, 318-319.
67) Udhëtari që ka qenë në Javë në vitin 1596 cek dy apo tre

mbretëri pagane me numër të madh të popullësisë pagane (Niemann, 342).

68) Raffles, vol. II, fq. 132-133.

69) Metzger, fq. 279.

70) L.W.C. van den Berg (10, fq. 35-36. C. Pocnsen fq. 3-8.

71) De Bartos, Dec. III, Live. v. Cap. v. fq. 579-580, Argensola, fq. 11, B.

72) Në këtë periudë Mollukasit më së shpeshti kanë qenë nën administrimin e katër princave: Ternates, Tidarit, Gilolit dhe Botçanit. I pari ka qenë më influencuesi. Pronat i zgjeroheshin në Ternat dhe ujdhesat e vogla fqinje, në një pjesë të Halemakerit dhe në një pjesë të madhe të Celebesit, Ambainit dhe ujdhesat Banda.

399

Sulltani i Tidorit ka sunduar në Tidor dhe në disa ujdhesa të vogla fqinje dhe në një pjesë të Halemaherit dhe në ujdhesat që shtrihen ndërmjet Guinesë së Re së bashku me bregun perëndimor dhe në një pjesë të Seromit.

Duket se territoret e sulltanit të Gilolit janë redukuar në pjesën qendrore të Halemaherit dhe një pjesë të bregut verior të Seronit, deri sa sulltani i Botçanit ka sunduar kryesisht me Botçanin dhe Obigrupin (De Hollander, vol. I, fq. 5).

73) Massimiliano Transilvano (Rannisio, bl. I, fq. 351 D.).

74) P.J.B.C. Robide van der Aa, fq. 18.

75) Pigafetta, bl. I, fq. 365, 368.

76) Sa më shumë që përparonim në Ujdhesë, kohana ka mundësuar të mësojmë nga autoktonët fshehtësinë e këtij besimi, që në vend ka hyrë diç më herët para 80 vjetëve (J. De Barros, Da Asia, Dec. III, Liv. v. Vap. v. fq. 550).

77) De Barros, Da Asia, Dec. III, Liv. v. Cap. v. fq. 580.

78) Simon, fq. 13.

79) Bokemeyer, fq. 39.

80) Simon, fq. 13.

81) Argensola, fq. 3-4.

82) Ibid., fq. 15 B.

83) Ibid., fq. 97, 98.

84) Ibid., fq. 155 dhe 158. Argensola Ternat përshkruan kështu:

"Kjo është grykë në të cilën rrymut takohen nga të gjitha anët, kurse nga ai rrjedhin të gjitha drejtimet jofetare, e veçan është urrejtur besimi i Muhammedit.

Prej kur Holandezët në vitin 1585 kanë hyrë në këto dete, ky besim nuk ka pushuar të zgjerohet dhe të përvetësojë ndihmuesit dhe t'i tërheq kapitenët kusarë. Këta janë udhëheqës që me vete kanë sjell të mirat e Azisë, kurse kanë lënë pas vetes këtë besim dhe në të i kthejnë këta shpirtëra."

85) Pasardhës të tyre ende ka në krahinën e Cavitës në ujdhesën

- Luzon (Crawfurd, (I), fq. 85).
86) W.F. Andriessen, fq. 222.
87) T. Forrest, fq. 68.
88) Piggafetta (Ramusio, vol. I, fq. 366).
69) Dulaurier, fq. 528.
400
90) Campen, fq. 346. Kolonial Verslag van 1910, fq. 56; 1911, fq. 52.
91) Damaku është në bregun verior të Javes, përkundër Borneut jugor.
92) Hageman, fq. 236-239.
93) Pigafetta (Rausio, bl. I), fq. 363-364.
94) Kjo mbretëri është themeluar nga kolonia e mbretërisë induse Magjapahit (De Hollander, vol. II, fq. 67) dhe ka undësi që, natyrisht, të këtë ra nën ndikimin islam, pas kalimit të Javasëve në islam.
95) Dozy (I), fq. 386.
96) Veth (2), vol. I, fq. 193.
97) Oliver de Noort (Historie generale des vo yages, vol. XIV, fq. 225). (The Hague, 1756).
98) Safiuddini ka vdekur rreth vitit 1677. Duket që babai nuk ka marrë emër musliman, ai është i njohur vetëm me emrin e vet paganë Panembakan Giri - Kusuma (Netscher, fq. 14-15).
99) Thomas Forrest, fq. 371.
100) Essay towards an account of Sulu, fq. 557.
101) B. Panciera, fq. 161.
102) J. Hageman, fq. 224.
102) Veth (2), vol. I, fq. 179.
104) De Hollander, vol. II, fq. 61.
105) Coolsma, fq. 556. Kolonial Verslag van 1911, fq. 38, 41; 1912, fq. 30.
106) Med. Ned. Zendelinggen, vol. XXXII, fq. 177; vol. XXXIV, fq. 170.
107) D.m.th. Atçehu.
108) A. Compleat History of the Rico and Progress of the Portugeze Empire in the East Indies. Colected chiefly of their own Wirriters. John Harris, Navigantium atque Intinerantium Bibliotheca, vol. I, fq. 682, London, 1764.
109) Crawurd (I), fq. 91. The Encyclopedie van N-J (Vol. I, fq. 216) e jep vitin 1606 si datë të ndodhisë.
109/a) Fernandez Navarette, një klerik spnajokll, ka shkuar në ujdhesat Filipinase në vitin 1646 (Collection of Voyages and Travels, fq. 236, London, 1752). Tavernieri ka vizituar Makassarën në vitin 1648. (Travels in India, fq. 193 (London, 168). Itinerarium Orientale 401
R.P.F. Philipi a S Sma, Trinitate Caramelitae Disalceati ab ipso

Concriptum, fq. 267 (Lugduni, 1649).

110) Crawford, vol. II, fq. 385-389.

111) Duket se një kohë të gjatë nuk është dhënë angazhim i veçant në dobi të fesë së re. Populli i Celebesit dallon nga fiset tjera të ujdhesave Lindore, drohet nga risitë, janë jaft këmbëngulës në fe dhe janë lojal ndaj traditave të vjetra.

Në shiki të parë këto cilësi bëhen pengesa të mëdha në rrugën e përhapjes së islamit.

Sigurisht ky është shkak që ka shtyrë pranimin e fesë së re për periodën aq të gjatë deri sa veten nuk e ka rekomanduar në ruhon e vjetër. (Crawford, (2), vol. II, fq. 387).

112) Crawford, (I), fq. 75. De Hollander, vol. II, fq. 212.

113) De Hollander, vol. II, fq. 666. Ridel (2), fq. 67.

114) Gjendet në lindje prej Minahosses ndërmjet gjërësisë 1240 dhe 1230, 200 me popullësinë numri i të cilëve është shjellur ndërmjet 35.000 dhe 50.000 shpirtëra. (De Hollander, vol.II, fq. 247).

115) Wilken (I), fq. 42-44.

116) Wilken (2), fq. 276-279. Kolonial Verslag van 1910, fq. 52; 1911, fq. 47.

117) Zollinger (2), str. 126, 169.

118) Med. Ned. Zendelinggen, XXXII, fq. 177, XXXIV, fq. 170.

119) Zollinger(1), fq. 527.

120) De Hollander (në 1882) jep numrin prej 20.000 Balinëve dhe 380.000 Sasaksëve (vol. I, fq. 489).

121) Encyclopaedie von N.-I., vol. II, fq. 432-434, 424 W. Cool: With the Dutch in the East, An outline of the mihtary operations in Lombok, 1894, London, 1897.

122) Kapiteni Thomost Forrest shkruan në vitin 1775 dhe thotë se Arabët kanë ardhur në ujdhesën Mindanao tre qind vjet më parë dhe se edhe sot shihet varrii Arabit të parë Sherifit nga Mekkeja: "Në fakt ky është grumbull i papërpunuar ishkëmbinjve koralë." (fq. 201, 313).

123) N.N. Saleeby, Studies in Maro History, Law and Roligion, fq. 24-25, 52-55, Manila, 1905).

124) Relationo di Ivan Gaetan del discoprimiento dell'Isole Molucche (Ramusio, bl. I, fq. 375).

125) Duket se pothuaj është e paundur të kthehen në krishterizëm për shkak të kryeneqësisë së tyre ndaj me shirës së Zotit dhe largësisë 402

nga besii i Tij (Cartes de les PP de la Compania de Jezus de la misiion de Filipines, 1879, quoted by Montero y Vidal, bl. I, fq. 21).

126) Cnaufurd (2), vol. II, fq. 274-280.

127) Pak kanë pasur kujdes në kryerjen e obligimeve të krishtera, që i kanë pranuar Nuk ka pasur rrugë tjetër pos të detyrohen në kryerje me kërcënimin e denimit dhe që me ta të silllet sikur me fëmijët e shkollës.

Relatiod des Isles Philippines, Faite par un Religieux, fq. 7
(Thovenot, vol. 1).

128) "Në Mindanao janë të banuara fiset Tagal në lindje. Me qëlli që të çlirohen nga adminsitrata e urrejtur e zotërinjve katilikë, kanë filluar, pak nga pak, të tubohen rreth krerëve vendas. Këtu ka pasur rreth 360.000 muslimanë që e provojnë Kur'anin si kushtetutën e vet të vetme.

Në vend të jezuitëve, përfaqësuesve të religjionit zyrtar, që janë përzënë nga Ujdheso, kanë ardhur për udhëheqës fetarë dhe mësues të popullit misionarët muslimanë nga Kina dhe India. Kështu të gjithë muslimanët e kanë përtërirë misionin e thirrjes në islam të filluar me pushtimin arab. (a. le Chatelier (2), fq. 45).

129) Montero y Vidal, vol. I, fq. 86).

130) Gjendet tre milo në perëndi mprej Colas (Jolas), kryeqendrës së tashme.

131) N.M. Saleeby, The History of Sulu, fq. 150, 162-163.

134) Dalrymple, fq. 549.

135) R. du M. M. VII, fq. 115-116 (1909).

136) The Missionary Review of the World, N. S. vol. XIV, fq. 877
(New York, 1901).

137) Princi i parë i BAtçanëve që është bërë musliman ka qenë njëfarë Zejnul'abidin, që ka sunduar më 1521, kur Portugalezët për herë të parë ardhën në Molluke.

138) Robide van der A-a, fq. 350, 352-353.

139) Ibid., fq. 147 (Misool) "Banorët e bregut të gjithë janë muslimanë... kurse popullësia malore janë paganë." Ibid., 53 (Salawati). "Pjea e vogël e manifeston besimin e Muhammedit deri sa pjesë më të madhe të popullësisë e bënë fisi pagan e Papuanëe. Numri i vogël prej tyre ka kaluar në islam dhe publikisht ka pranuar principet e tij." Ibid., fq. 290 (Waigyu) Disa Papuanas nga ujdhesa Gobi 403

ndërmjet VAngina dhe Halemaheri, janë konvertuar nga të shpërngulurit muslimanë nga Mulako (Crawfusd, (I), fq. 143).

140) Kapiteni Forrest na njofton në vitin 1778 dhe thotë se shumë Papuanas janë "shndërruar në muslimanë" (Vaqage to New Guinea, fq. 68).

141)

142) Robide won der A-a, fq. 352: "Ashpërsia e Papuanëve ka qenë e atillë që nuk ka ndier nevojë për pranimin e cilës do fe. Aty nuk ka pasur besi mtjetër.

Pos krishterizmit që ka gjetur rrugën, edhe islami, sikur të kishte bërë angazhim në mesin e këtij popujve, ka mundur të ketë sukses. Sa kam parë, gjatë kohës së parë udhëtimeve të mia në këto vende, populli i Tidorit, as populli i Serasmës ose të tjerët, nuk kanë bërë kurrfarë angazhimi në futjen e besimit të Muhammedit këtu...

Mund të numrojmë shumë pak krerë, sikur raxha Ampati nga Vaigea, Salavatta, Misoolodhe Vaigama, që kanë predikuar këtë fe. Shkak është prapambeturia e tyre e shumëfishtë edhe për Tidorin nga arsyeja se janë Papunas. Askush kurrë nuk është përpjekur ta fusë islamin në mesin e popullësisë autoktone. Sigurisht kjo është për shkak të respektit të ksëaj feje që e konsiderojnë larg mbi nivelin e Papuanasëve."

143) Robide van der A-a, fq. 319.

144) Kolonial verslag van 1906, fq. 70, 1911, fq. 52.

145) The Journal of the Indian Archipelago, vol. VII, fq. 64, 71) (Singapore, 1853).

146) G. W. C. Baron van Hoevell, fq. 120, Kieger, fq. 436.

147) Encyclopaedie van N-J. vol. II, fq. 210.

148) Crawford (2), fq. 275, 807.

149) Buckle's Miscolloncus and Posthumous Warks, edited by Helen TAYlor, vol. I, fq. 594 (London, 1872).

150) Neimmann, fq. 406-407.

151) C. Snouck Hurgronje, De hadji - politiek dor Indesche REgeeriyo, fq. 12 (Overdrak uit Onre Ecuw, 1909).

152) Id. Notes sur le mouvement du pelerinage de la Mecque aux Indes Neerlandaises. (R.du M. M. vol. XV, fq. 409, 412).

153) Report of Centenary Conference on Protestant Missions, vol. I, fq. 21, Niemann, fq. 407.

154) Med. Ned. Zendelinggen, vol. XXXII, XXXV, passim.

404

155) Snouck Hurgronje (3) vol. II, fq. XV, 339-393, Encyclopedie van N - I. vol. II, fq. 576-579.

156) Për shembull kaderitët, nakshibenditët dhe senusitët (Snouck Hungronje (2), fq. 186; Ibid., (3), vol. II, fq. 372, etj.

157) J. G. F. Riedel (I), fq. 7, 59, 162.

158) Snouck Hurgronje (3), vol. II, fq. 323.

159) Hauri, fq. 313. Encyclopedie van N. I., vol. II, fq. 524.

KAPTINA XIII

PËRFUNDIMI

Në botën e krishterë puna misionariste nënkupton shoqatat misionariste, agjentët e paguar, kontributet e përhershme, raportet dhe shtypin. Duket se ndërmarrje misionariste ka qenë emërtim jo i saktë nëse ka qenë pa organizi të mirëfilltë dhe institucionin e organizuar. Kierarkia klerikale e kishës së krishterë nga vetë fillimi i historisë së vet ka pasur kujdes për propagandimin e mësimit të krishterë në mesin e jokrishterëve.

Misionarët e saj më së shpeshti ishin klerikët dhe monakët përgjithmonë të caktuar.

Rendet monakiste (prej Benediktëve e më poshtë) dhe shoqëritë misionariste e datave më të reja krejtësisht i janë kushtuar me

vëmendjen veçan të koncentruar në rregullin pjesës propaganduese të punës së krishterë. Prej fillimit kjo punë ka qenë detyra e parë dolluese e Kishës.

Sa i përket islamit, mungesa e cilit do lloj të klerit ose organizatës klerikale është shkak që aktiviteti misionarist i muslimanëve është dëftuar në aspektet krejtësisht tjetërfare nga ato që janë paraqitur në historinë e misioneve të krishtera.

Këtu nuk ka shoqëri misionarise¹⁾ as agjent veçan të ushtruar, dhe shumë i dobët është puna kontimitive në atë kuptim.

Përgjashtim është shfaqja që mund të gjendet te rendet fetare në islam, organizata e të cilëve deri diku i gjason rendeve monakiste në krishterizëm. Mungesa e idealit klerikal dhe çfarëdo teorie për ndarjen e mësuesve fetarë nga ana e masës së besimtarëve ose nevojës së shënjtërimit të veçant dhe autorizimit për kryerjen e detyrave fetare 405

është ajo që bënë dallimin themelor në dy sisteme, dallimin që në çdo vend është aq e qartë.

Humbja e mungesës së klasës klerikale, aparatit të veçant për punë në propagandimin e fesë, është kompenzuar ndjenja e përgjegjësisë që zë fill në personalitetin e besimtarit.

Pasi që ndërmjet muslimanit dhe Zotëriut të tij nuk ka ndërmjetësues, përgjegjësia për shpëtimin e tij personal i ka rënë vetë atij në qafë.

Pasoja është se muslimani është besë, në princip, shumë më i rreptë dhe më i kujdesshëm në kryerjen e detyrave të veta fetare, të durojë më shumë përpjekje në mësimin e principeve dhe ritualeve të fesë së vet.

Në këtë mënyrë thellë i është bërë përfaqësues i karakterit misionarist të mëimit të vet në praninë e atyre që nuk besojnë.

Ai që ka dëshiruar të bëhet thirrës në fe nuk është dashur që konvertitin e ri ta përujë në ndonjë mësues fetar të njohur të mëimit të vet, që ndoshta konvertitin e ri vetëm formalisht e ka kyqur në bashkësinë muslimane.

Nuk i është frikësuar as kontrollit klerik për shkak të bërjes së mëkatit të Karunit. (Karuni është figurë kur'anore, personifiki i pasurimit të tepruar, ver. e përkthyesit).

Prandaj, sado që flitej se është e tepruar, ajo që shpesh thuhet²⁾ se çdo musliman është misionar mbetet e vërtetë.

Pak ka muslimanë të sigurtë që jetojnë për çdo ditë në kontakt me pabesimtarët që do ta mospërfillin urdhërin kur'anor: "Thirrë në rrugën e Krijuesit tënd me urtësi dhe në mënyrë të bukur..."³⁾

Përveç kësaj, paralel me propaganduesit profesionalë - mësuesit fetarë, që tërë kohën dhe fuqinë e vet ia kanë kushtuar punës misionariste, analet e propagandës së islamit përmbajnë regjistrin e emrave të njerëzve dhe femrave të të gjitha ngjyrave shoqërore, prej

sunduesit⁴) deri të fshatari, të të gjitha degëve dhe profesioneve, që kanë punuar në përhapjen e fesë së vet. Tregtari musliman, për dallim nga vëllau i tij i krishterë, veçan është treguar aktiv në punën e atillë.

Në regjistrin e misionarëve indusë të publikuar në revistën e shoqërive fetare dhe bamirëse në Lahore,⁵ i gjejmë emrat e mësuesve dhe nëpunësve fetarë nga dega Kanal dhe Opium, tregtarëve (duke e

406 inkuadruar edhe një tregtar me deve), një botues gazetash, një libërlidhës dhe një punëtor shtypi.

Këta njerëz ia kanë kushtuar kohën e vet të lirë, pas mbarimit të punës së vet të përditshme, që të thërrasin në fenë e vet, në rrugët dhe bazarët e qyteteve induse, duke u orvatur t'i përvetësojë konvertitët në mesin e të krishterëve dhe hindusëve, besimet e të cilëve i kanë përgënjeshtuar dhe atakuar.

Është interesant të hetohet që propagandimi i islamit nuk ka qenë vetë punë e njerëzve, por edhe muslimaneja ka marrë pjesë në këtë punë e devotshme.

Disa princa mongolian kalimin e vet në islam mia kanë borgj ndikimit të grues - muslimane. Rast i ngjashëm është edhe me shumë Turqë paganë, kur sulmet e veta i kanë përcjellë në territoret muslimane.

Misionarët senusijë, që kanë ardhur të punojnë në mesin e Tubuimëve në veri të liqenit të Çadit, kanë hapur shkolla për vajza.

Kanë shfrytëzuar ndikimin e fortë që kryejnë femrat në mesin e këtyre fiseve (sikur edhe në mesin e fqinjve të tyre Berberëve) në përpjekjet e veta që t'i përvetësojnë në rradhët e islamit.⁶)

Në Afrikën lindore gjermane, ku vendasit paganë i lëshojnë shtëpitë e veta nga gjashtë e më shumë muaj që të punojnë në hekurudhë ose në plantazha, kanë qenë të konvertuar nëpërmjet femrave muslimane. Me ata ato kanë lidhur kurorëzime të përkohshme, por kanë refuzuar të kenë çkado qoftë me jomuslimanin e pabërë synet.

Që t'i shmangen turpit, të cilit i është dhënë emri i tillë, burrat e tyre janë bërë synet dhe kështu kanë hyrë në shoqërinë muslimane.⁷)

Thuhet se përparii i islamit në Abesini gjatë pjesës së parë të shekullit të kaluar në masë të madhe i ka borxh punës së gruas - muslimane, veçan grave të princave të krishterë. Këta janë shtirë në kthimin në krishterizëm me rastin e martesës së vet. Fëmijët e vet i kanë edukuar në frymën islame dhe kanë punuar në çdo mënyrë të mundshme për progresin e asaj feje.⁸)

Në anën perëndimore të Abesinisë gjendet fisi pagan që quhet Boruns. Disa nga anëtarët e tij, që janë regrutuar në regjimentin zezak nën administratën anglo-egjiptian në Sudan, kaluan në islam nëpërmjet grave të ushtarëve zezakë deri sa bataljoni kthehej në

Kartum.9)

407

Konsiderohet se Tataraset nga Kazani janë veçan si propagandues të zjarrtë të islaimit.10)

Besimtaren lojale, vetëm pse është grua, nuk e përjashton që ta zë vendin e vet pranë evlijaut mmashkull, në shoqërinë e atyre që thërrasin në fe.

Legjenda për femrat - evlija lidhet deri tek Aliu. Për ta thuhet se fluturojnë nëpër ajër prej Kerbelasë deri në Lahore. Ato me fuqinë e jetesës, faljes dhe agjëriit të vet të devotshë e përetësuar konvertitin e parë nga hinduizmi në islam.11)

Vështirë që kjo legjendë do të kishte bazë sikur ndikimi i këtyre femrave - evlijave të kishte mbetur plotësisht i panjohur.

Një nga tyrbet më të vjetra të Kairos është tyrbaja e Nefises, mbesës së Hasanit (të birit të Aliut që është mbytur). Dituria e saj teologjike ka nxitur admirim të bashkëkohësi i saj i madh Imam Shafiu. Devotshmëria dhe modestia e saj e ka ngritur në dinjitetin e evlijaut.

Për të flitet se në Egjipt ka banuar në fqinjësi të një familje dhimmiu (jomuslimani), që ka pasur vajzën aq seriozisht dhe rëndë të sëmure që nuk ka mundur gjymtyrët t'i lëviz por tërë ditën ka qëndruar shtrirë në shpinë.

Prindërit e vashës së mjerë, një ditë, shkruan në treg, dhe e kanë lutur fqinjen e vet të devotshme muslimane që t'ua mbikqyr vajzën në mungesën e tyre.

Nefisa me dashuri dhe mëshirë e kreu punën e ndërmarë bujare. Kur prindërit e vazhës së sëmure shkuan, me shpirt u ngritë duke e lutur Zotin për të sëmuren e pafuqishme.

Pothuaj se nuk e ka kryer lutjen e vet, e tashmë vasha e sëmure ka mundur të shërbehet me gjymtyrë dhe ka pasur mundësi t'i presë prindërit në kthim.

Plotë mirënjohje, tërë familja ka kaluar në fenë e mirëbërëses së vet.12)

Madje edhe robi musliman ka shfrytëzuar rastin të thërret në fenë e vet të pushtuesit ose ata me të cilët është në robëri.

Hyrja e parë e islamit në Evropën lindore ka qenë nëpërmjet punës së një juristi musliman, që është robëruar, ka mundësi në një prej luftërave ndërmjet imperatorisë bizantinase dhe fqinjve të saj muslimanë. Qe dërguar në tokën e Peçenegëve,13) në filli mtë shekullit XI. Shumicës prej tyre ua ka ekspozuar, paraprakisht, ësimin islam, 408

dhe ata singërisht janë kthyer në fe dhe kështu islami filloi të përhapet në mesin e këtij populli.

Por, Peçenegët tjerë, që nuk e kanë pranuar fenë musliman, ua kanë zënë për të madhe vendasve të vet dhe, në fund, erdhi deri te

konflikti mes tyre.

Muslimanët numri i të cilëve ka qenë rreth 12.000 me sukses i janë kundërvu sulmit të pabesimtarëve numri i të cilëve ka qenë më shumë se dyfish më i madh se i tyre. Pjsa e mbetur e palës së ngadhnyjer ka kaluar në fenë e ngadhnyesit. Para fundit të shekullit XI tërë populli ka predikuar islamin dhe në mesin e tyre ka pasur njerëz që kanë studjuar teologjinë islame dhe të drejtën.14)

Gjatë sundiit të mbretit Gjhangir (1605-1628) ka jetuar një teolog sunnit me emrin shejh Ahmed Muxheddid. Është dalluar me energji të veçantë me të cilën e ka përgënjeshtuar besimin e shuitëve. Diç më vonë disa lojalistë në pallatë kanë arritur që për një çështje të parëndësishme ta mbyllin.

Gjatë kohës prej dy viteve, sa ka qenë në burg, i ka kthyer në isla disa qindra idhujtarë, që kanë qenë me të në burgun e njëjtë.15) Diç para kësaj kohe një mevlevi indus (mawlavi), të cilin pushteti britanik e ka gjykuar në internim të përjetshëm në ujdhesat Andamen, sepse aktivisht ka marrë pjesë në konplatin vehabit në vitin 1864, shumë të denuar ka kthyer në islam para vdekjes së vet.

Në Afrikën qendrore një lider arab, të cilin pushteti belg e patë gjykuar me vdekje, arët e veta të fundit i patë kaluar në tentim që në islam ta kthejë misionarin e krishterë, që i ishte dërguar për shkak të ngushullimit fetar.16)

Faktorët e suksesëve të muslimanëve

Zelli misionarist i muslimanëve është i tillë që janë të gatshë mte flasin për të kur ka mundësi dhe jashtë saj siç e ka thënë këtë, me mendjehollësi të mirë, Doughty: "Biseda e tyre vazhdimisht rrjedh (pa hipokrizi) mbi fenë. Ajo për ta është përkujti i këndshëm i devotshëm."17)

E tash t'i cekim ndisa nga faktorët që kanë ndihmuar sukseset e tyre.

409

Në vend të parë është thjeshtësia18) e mësimit islam. Nuk ka zot tjetër pos All-llahut, Muhammedi është i dërguari i Zotit - miratimi i këtyre dy doktrinave është krejt që prej konvertitëve kërkohet. Tërë historia e dogmatikës islame nuk ka arritur të paraqesë asnjë tentim nga ana e tubimeve priftërore që me forcë t'ia imponojë mmasës së besimtarëve çfarëdo-simboli që fsheh ose që përmbanë termine më të përsosura dhe më të komplikuar.

Ky mësi mi thjeshtë nuk kërkon provë të madhe fetare. Si parim, nuk nxitë vështirësi të veçanta intelektuale, sepse hynë në pikëmbërritjen e botëkuptimit me satar.

E pangarkuar me idetë teologjike, këtë mësi mka mundur ta shpjegojë cilido, madje edhe ai më pak i udhëzuar në shprehjet teologjike.

Gjysma e parë e tij e shpreh doktrinën që gati është unviersale dhe

mund ta pranojnë njerëzit si kërkesë të domosdoshme, deri sa pjesa e dytë bazohet në teorinë e raportit të njeriut ndaj Zotit, e cila është barabartë gjërëisht e përhapur. Kjo d.m.th. që në distancat kohore të historisë botërore Zoti u ka dhënë njerëzve disa zbulime për Vetën nëpërmjet gjuhës së peygamberëve të frymëzuar (wahy).

Këtë karakter racional të mësimi islam dhe dobitë që i ka pasur nga puna e et misionariste më së bukuri e shprehin fjalitë e prof. Montetit. Islami në bazë është racional në domethënien më të gjërë të kësaj fjale, shikuar etimologjikisht dhe historikisht.

Definicioni i racionalizmit si sistem që besimet religjioze i zë fill në principet tëdala nga arsyeja plotësisht mund të aplikohet mbijë në islam.

Është e vërtetë se Muhammedi, që ka qenë entuziast, po ashtu ka poseduar zjarrfetar dhe flokë të lindjes. Ai këtë kualitet të shkëlqyeshëm e ka përcjell në shumë ithtarë të vet. Levizjen e vet reformist e ka ekspozuar si Shpallje (Wahy),⁸ me atë që ky lloj i shpalljes është vetëm aspekt i ekspozimit dhe komentimit. Feja e tij ka të gjitha shenjat të grumbullit të doktrina të zëna fill në faktin e arsyes.

Besimtarët e mësimi të Muhammedit e rezimojnë këtë mësim në besimin në njësinë e Zotit dhe në peygamberinë e Peygamberit të Tij. Nga pikëpamja jonë që ftohtë analizojmë, mësimi i tyre është të besohet në Zotin dhe në botën e ardhshme. Këto dy doktrina janë minimum i besimit religjioz. Këto janë gjëra që te njeriu i devotshëm

410
mbesin në bazën e fuqishme të arsyes dhe e rezimojnë tërë mësimin doktrinor të Kur'anit.

Thjeshtësia dhe qartësia e këtij mësimi sigurisht është fuqia më e shprehur në punën për fenë dhe aktivitetin misionarist të islamit.

Ajo që nuk mund të mohohet është ajo se shumë mësim dhe sisteme teologjike, e po ashtu edhe shumë bestytni, prej të drejtuarit të shenjtërive (evliajve) deri te përdorimi i numratorit (tespihëve) dhe hajmalive, kanë ushqyer trungun kryesor të mësimi musliman.

Por, përkundër zhvillimit të pasur, të kuptimit të mirëfilltë të fjalës, të mësimi të Peygamberit, Kur'ani pandryshueshëm ka mbajtur vendin e vet si pika themelore nisëse. Dogma e njësisë së All-Ilahut gjithnjë është theksuar në atë vend me admirim, dinjitet, me pastërti të pandryshueshme me shenjën e bindjes së sigurtë, që janë veçori që vështirë të gjenden kudo jashtë islamit.

Përkushtimi i sinqertë si principi themelor fetar, thjeshtësia elementare e formulës nëpërmjet së cilës shprehet, prova me të cilën kjo fe ka arritur bindje të zjarrtë të misionarëve që e kanë propaganduar, - të gjitha këto janë shkaqe që shpjegojnë sukseset e përpjekjeve të misionarëve muslimanë.

Me të drejtë pritej që mësimi ashtu i caktuar, i privuan nga

komplikueshmëria teologjike, për ç'arsye është i përshtatshëm për të kuptuarit e personit të rëndomtë, të pranohet, sepse realisht posedon aftësinë e çuditshme që ta gjejë rrugën e vet në vetëdijen e njerëzve."19)

Peshkopi Lefray konsideron së fshehtësia e fuqisë së shkëlqyeshme të pushtimit dhe përparimit, që islamie ka dëftuar në kohën e vet më të mirë, gjendet në të kuptuarit e ekzistencës së Zotit më shumë se në njësinë e Zotit. "Pranimi se Zoti është një nuk është më i madh se pranimi se ekziston, që d.m.th. se ekzistimi i Tij zë fill në faktet e Unviersumit, vullneti i Tij më i lartë, pushteti i Tij absolut fuqia e tij e pakufizuar... besimi që midis kaosit, çrregullimit, prishjes në botë, që tmerrshëm e errësojnë, ekziston megjithatë një Vullnet përfundimtar, e pashmangshëm dhe suprem. Njeriu ftohet të bëhet përfaqësues i këtij. Vullneti dhe që këtë publikisht ta shpallë dhe obligohet - nëse ka nevojë me mjetet edhe të thjeshta edhe themelore - në dëgueshmëri atij Vullneti. Kjo ka qenë ajo që e ka ndihmuar ushtrinë e Muhammedit në rreshtin ashtu të pangardhnjeshë pushtues. Ai i ka frymëzuar me shpirtin ushtarak të dëgjueshmërisë 411

dhe disiplinës njëjtë sikur edhe me përbuzjen e vdekjes, përbuzjen e atillë i cila, ka mundësi, nuk është tejkaluar në asnjë sistem tjetër. Kjo është ajo që, nën është vendosur në cilindo ndjenjë të sinqertë dhe vepruese të muslimanët, njëkohësisht i jep qenësi karakterit, e kjo d.m.th. fortësinë, vendosshmërinë dhe fuqinë e vullnetit. Ky është durim që nuk i pranon vajtiet dhe dorëzimin në praninë e fatkeqësive më të këqija. Tërë kjo e karakterizon dhe i stolisë ithtarët më të mirë të fesë."20)

Kur kovertiti ka pranuar dhe ka mësuar këtë besim të thjeshtë të islamit, ai atëherë me detyrat praktike të fesë të vet:

1. Shqiptimi i besimit-Kelime-i shehadeti.
2. falja e namazit
3. dhënia e zekatit
4. agjërimi i muajit të ramazanit dhe
5. pelegrimi - haxhi në Mekke.

Kryerja e kësaj detyrës së fundit ka qenë shpesh objekt kundërshtimi si traditë e huaj e mbijetuar idhujtare në mesin e monoteizmit të mësimit të Pejgamberit. Nuk bën të hiqet nga mendje se haxhi është lidhje e Muhammedit me Ibrahimin (Abraham), besimin e të cilit misioni i tij e përtërinë.²¹

Por, mbi të gjitha - aty është rëndësia e tij e madhe në historinë misionariste të islamit - haxhi përcakton grumbullimin e besimtarëve të të gjitha kombeve dhe gjuhëve nga të gjitha anët e botës, për t'u falur në atë vend të shenjtë. Në vendin drejt të cilit i kthejnë fytyrat e veta çdo çast në lutjet e tyre personale, në shtëpitë e largëta.

Nuk ka mendjemprehtësi të gjenive fetar që ka mundur të mendojë

mjet më të qëlluar për impresionimin në shpirtin e besimtarëve, domethënien e jetesës dhe vëllazërisë së tyre të përbashkët në lidhjet e fesë.

Këtu, në aktin e përkryes të lutjes së përbashkët, takohet zezaku nga bregu perëndimor i Afrikës me Kinezin sa Lindja e Largët. Turku shërbyes e i edukuar e takon vëllaun e vet musliman, banorin e egër nga ujdhesa nga viset e largëta të arkipelogut të Malajeve. Në po atë kohë, përgjatë botës islame zemrat e besimtarëve ngriten në bashkëpjesëmarrje me vëllazërit e vet të lumtur, që bashkarisht janë tubuar në qytetin e shenjtë, ashtu që në shtëpitë e veta celebrjnë festën Idu al-ad'ha ose (si e quajnë në Turqi dhe Egjipt) festën e Bajramit.

412

Vizita qytetit të shenjtë për shumë muslimanë është një përvojë që i nxitë që të "luftojnë në rrugën e Zotit".

Në faqet paraprake gjenden të dhënat e përhershme për pjesëmarrjen aktive të haxhive në punën misionariste.

Përveç institucionit të haxhit, zekati është detyra e dytë që vazhdimisht e përkujton muslimanin: "Besimtarët janë vëllezër" (22), që është teori fetare që shkëlqyeshëm realizohet në shoqërinë muslimane dhe rrallë dëshpëron që të dëftohet në gjestin dashamirës ndaj muslimanët të ri. Pa marrë parasysh në racën, ngjyrën dhe prejardhjen e tij, muslimani i ri do të pranohet në vëllazërinë e besimtarëve dhe do të zëjë vend si ibarabartë ndër të barabartit.

Nuk është e vërtetë ajo që disa autorë evropianë konsiderojnë nëse robi jomusliman i një muslimani kalon në islam, që ky kalim me çliron nga robëria.

Sipas të drejtës islame, kthimi i robit në islam nuk vepron në pozitën e tij të robit para kësaj. (23) Gjendja e robit - musliman me të madhe varet nga morali i zotëriut të tij. Por në të shumtën e rasteve liria është shpërbli m'për konversion. Shpirtërat e përkushtuar e të devotshëm pranojnë edhe në robëri udhëzimin e Zotit drejt fesë së mirëfilltë, siç është rasti me zezakët nga vendi i Nilit të Epërm, që Doughty i ka takuar në Arabi. "Nuk ka urrejtje te këta Afrikanë për shkak se janë bërë robër... madje edhe atëherë kur vjedhësit e njerëzve të vazhdë i kanë grabitur nga farefisi i tyre.

Zotërinjt, që kanë paguar çmimin e tyre, i kanë pranuar në shtëpitë e veta. Mashkujt janë bërë synet dhe ajo që shpirtërat e tyre i ka çliruar nga mallëngjimi i gjatë për vendlindjen kjo është që Zoti i mbikqyrë në fatkeqësinë e tyre. Ata mund të thonë "Kjo ka qenë begati e Tij (e Zotit)", se për këtë shkak kanë hyrë në fenë shpëtimtare.

Për këtë arsye kanë konsideruar se në vendin më të mirë, kur janë të lirët të Zotit. Në tokën e jetës më tepër të civilizuar, në trollin e dy haremeve të ndershme, në tokën e Muhammedit, për ç'arsye i

falënderolen Zotit që trupat e tyre, njëherë, u janë shitur në robëri.”24)
Është mjaft vepruese, në tërheqshmëri dhe ruajtje, detyra e pesë
namazeve të ditës, në ditë.

Monteskje25) bukur ka thënë: “Njeriu është shumë më i lidhur për
fenë që ka shumë rituale nag feja që i ka më pak. Shkaku është në atë
413

që njeriu është më i lidhur për gjërat që gjithnjë ia preokupojnë
mendimin.”

Besimi i muslimanëve vazhdimisht prezentohet e të. Ai dëftohet në
namazin e përditshëm në ritualin dinjitoz dhe impresiv, që nuk e lënë
indiferent as atë që e kryen namazin as vrojtuesin.

Se'id b. Hasani, një Hebraik aleksandrias, që ka kaluar në islam në
vitin 1298, flet për skenën e namazit të xhumasë të premtën, që ka
qenë faktori vendimtar në konversionin e tij.

Gjatë kohës së sëmundjes së rëndë në gjum e dëgjoji zërin që i
urdhëron të deklarojë se është musliman. “Dhe kur kam mhyrë në
xhami”, vazhdon ai, “dhe i kam parë muslimanët që qëndrojnë në
radhë sikur engjëj, ka mdëgjuar zërin që më flet: Kjo është shoqëri
ardhjen e të cilëve e kanë paralajmëruar pejgamberët (bekimi dhe
paqe qoftë mbi ta!). Dhe kur hatibi u paraqit para tyre i veshtur me
pelerinë të zezë, më mbushi ndjenja e thellë e respektfrikës. Kur
fjalimin e vet e mbaroi me fjalët “All-llahu kërkon që e drejta e secilit
të respektohet, kurse ajo që bëhet - të bëhet me nderë, dhe të afërmve
t’u ndahet, kurse shfrenia dhe çdo gjë neveritëse dhe dhuna ndalohet -
që mësimin ta merrni. Ai ju këshilon,26) vetëm ka filluar namazi, unë
fuqishëm jam ngritur, sepse radhët e muslimanëve më janë dukur
sikur radhët e engjëjve në sexhdet (përrulja në gjunjë) dhe rukutë
(kërrusjet) e të cilëve fuqia e All-llahut është zbuluar. Kam dëgjuar
zërin që më thatë: “Nëse Zoti i ka folur popullit të Izraelit dy herë për
të gjithë shekujt, e ky kësaj bashkësie (xhema’ati) i flet në çdo kohë
namazi. Në vete kam qenë i bindur që jam krijuar të jam musliman.”27)
Prandaj Renani ka mundur të thotë: “Nuk kam hyrë kurrë në xhami
e që nuk më ka dridhur ndjenja e rreptë, ose thënë mmë mirë, që nuk
jam hidhëruar njëmend që nuk jam musliman.”28)

Është lehtë të kuptohet si është skena e tregtarit musliman në
namaz, sexhdet e tij të shpeshta, lutja e tij e thellë dhe e qetë Zotit të
papashëm ka bërë përshtypje në Afrikanin pagan të talentuar me pritje
të fuqishme për fshehtësi, që rëndom e përcjell civilizimin e shkallës
së ultë.

Kurreshtja, natyrisht, nxitë pyetjen. Në këtë mënyrë ofrohet dituria
e islamit, e cila nga njëherë e tërheq konvertitin në islam, nga e cila ka
mundur të kthehet anash sikur t’i ofrohej pakëndshëm, e jo sikur
dhuratë e lirë.

414

Mjafton të thuhet se agjërimi gjatë kohës së uajit të ramazanit

është pjesë e provës së qëndrueshme kundër teorisë se islami është sistem fetar që tërheq nga vetja duke i kënaq epshet e njerëzve.

Karlaj thotë: "Feja e tij nuk është fare e lehtë: agjërimi strikt, pastrii, terësia rigoroze e rregullave, falja pesë herë në ditë, ndalimi i alkoholit, nuk arrinë të bëhet fe e lehtë."

I lidhur me këto dhe ritualet tjera fetare, por i pangarkuar ose i përzier me atë, principet e mësimit islam vazhdimisht gjenden në manifestimin e jashtë mtë jetës së besimtarit.

Pastaj, ky mësim bëhet e gërshetuar i pandërlikuar me jetën e përditshme të besimtarit që muslimanim individ e bënë përfaqësues dhe mësues të mësimit të tij shumë më larg siç është ky rasti me ithtarët e shumicës të feve tjera.²⁹)

E redukuar në gjuhën aq të shkurtër dhe të thjeshtë, mësimi i tij kërkon pak angazhi mintelektual.

Përcaktueshmëria, pozitiviteti dhe preciziteti i ritualit nuk e lë besimtarin në dyshim ç'duhet të bëjë që t'i kryej këto detyra. Ai ndien kënaqësi kur i ka përmbushur të gjitha kërkesat e sheriatit.

Në këtë unitet të racionalizmit dhe ritualit ne mund të gjejmë me të madhe fshehtësinë e fuqisë të cilën e ka poseduar islami mme mendjet njerëzore.

"Nëse dëshiron ta tërheqë masën e madhe, ofroja të vërtetën në formën e plotë, të saktë e të pastër, në pamjen e dukshme e të prekshme."³⁰)

Mund të cekem edhe shumë rrethana tjera që kanë ndihmuar sukseset misionariste të islamit, rrethanat që kanë të bëjnë me kohërat dhe vendet e ndryshme.

Në mesin e këtyre rrethanave mund të ceket dobia që puna misionariste muslimane e ka pasur në faktin që në të shumtën ka qenë në duart e tregtarëve, veçan në Afrikë dhe në disa vende tejra jovicivilizuese, ku i huaji është shikuar me dyshim nga ana e popullësisë lokale.

Në rastin e tregtarit, profesioni i tij mirë i njohur dhe pa djallëzi i ka siguruar siguri nga çfarëdo ndonjë dyshimi. Njohja e tij e njerëzve dhe manireve, rafiniteti i tij tregtar i kanë siguruar pritje të mirë dhe kanë evituar ndjenjën e të përmbajturit, që, natyrisht, kanë burnar në proninë e të huajve.

415

Ai nuk punon në pengesat e tilla në të cilat ngatërrohet misionari profesional i cili i është ekspozuar akuzës për motivet e këqia, dhe këtë jo vetëm të populli niveli përvojtar dhe horizonti mendor i të cilit është i kufizuar dhe mendimi i të cilit për cilindo njeri që u ekspozohet rreziqeve të rrugës së gjatë dhe i cili lënë anash çdo preokupim të kësaj bote vetëm për një qëllim: t'i përvetësojë njerëzit në fe, është gjë e pashpjegueshme. Madje edhe njerëzit më të civilizuar në botë anojnë kah dyshimi në sinqeritetin e përfaqësuesit misionarist të

paguar.

Rrethanat mjaft ndryshojnë ku islami nuk është paraqitur si lutës në vendin e huaj por është vënë me krenari si fe e sunduesve.

Në faqet paraprake është dëftuar që teoria e fesë islame imponon tolerancën dhe lirinë e jetës fetare për të gjithë ithtarët e feve tjera që paguajnë tatim xhizjen si kompenzim për sigurinë.

Ndonëse faqet e historisë muslimane janë ngjyrosur me gjakë të shumë persekutimeve të vrazhda, shikuar në tërësi pabesimtarët, ende, nën sundimin musliman gëzojnë atë amsë të tolerancës çfarë nuk mund të gjendet në Evropë deri më sot.

Kthimi i dhunshëm në islam mëshhtë i ndaluar sipas urdhërit kur'anor: "Nuk ka detyri mnë fe" (II; 256)" "E përse ti t'i detyrosh atëherë njerëzit të bëhen besimtarë? Asnjë njeri nuk është besimtar pa vullnetin e All-llahut..." (X; 99, 100).

Ekzistimi i shumë sekteve dhe bashkësive të krishtere në vendet që me shekuj kanë qenë nën sundimin islam është provë e fuqishme e tolerancës që e kanë gëzuar. Dhe dëftojnë se persekutimet, që kohë pas kohe kanë ndodhur, kanë qenë kërkuar dhe bërë nga duart e entuziastëve dhe fanatikëve. Në fakt, janë motivuar me disa rrethana të veçanta dhe lokale më shumë se sa që janë inspiruar me ndonjë parim të përcaktuar të jotolerancës.³¹⁾

Në kohët e tilla të vështira, presioni i rrethanës shumë pabesimtarë i ka shpjerë në atë që së paku në dukje të bëhen muslimanë.

Ka mundësi të cekën shumë raste për individët që, në rrethanat e veçanta, kanë qenë të detyruar që t'i nënshtrohen fesë së Kur'anit.

Por, ndjekja e këtillë është plotësisht pa harmoni të të drejtës së sheri'atit (islamme), fetare apo qytetare.

Citatet e Kur'anit që e ndalojnë konversionin e dhunshëm dhe rekomandojnë thirrjen (predikimin) si mënyrën e vetme ligjore të përhapjes së fesë, më herët janë cekur (hyrje, fq.).

416

Principi i njëjtë është ndihmuar me vendimet e dijetarëve islamë.

Kur Moshe Maimonidi nën sundimin e Muvehidëve fanatikë ka simuluar kalimin në islam, ka ikur në Egjipt dhe haptazi është prezentuar së Hebraik.

Një juristë musliman nga Spanja e ka akuzuar për renegatje nga islami dhe ka kërkuar që mbi të të zbatohet ndëshkimi më i rreptë ligjor për këtë delikt.

Akuza është refuzuar nga kadiu autoritativ Abdurrahim b. Aliu,³²⁾ njërit prej juristëve më të njohur musliman dhe ministrit të parë të Salahuddin Ejubit të madh. Ai me vendosshmëri ka deklaruar që njeriu që me forcë konvertohet në islam ligjërisht nuk mund të konsiderohet musliman.³³⁾

Në frymën e njëjtë ka vepruar edhe Gazani (1295-1304) duke zbuluar se monakët budistë janë bërë muslimanë (kur iu është rrënuar

tempulli) në filli mtë sundimit të tij dhe vetëm formalisht kanë kaluar në islam. Iu ka lejuar të gjithëve, që kanë dëshiruar, që të kthehen në Tibet, ku ndër banorët e vet budistë mund të jenë të lirë në ndjekjen e fesë vetjake.³⁴⁾

Tavernie na shtron rrëfimin e ngjashëm mbi disa hebraikë të Isfahanit që guvernatori i qytetit i ka ndjekur tmerrshëm "që edhe me fuqi dhe dinakëri ka shkaktuar konversionin e tyre në islam.

Por mbreti Shah Abbasi II (1642-1667), ka kuptuar që vetëm forca dhe frika i kanë detyruar në konvertizëm. Iu ka lejuar që rishtazi t'i kthehen fesë së vet dhe të jetojnë në paqë."³⁵⁾

Një tregim i udhëtarit shumë më të hershëm³⁶⁾ në Persi nga viti 1478 flet se si dikur në kohët jo të qeta një sundues musliman ka pasur qëndri mstrikt në shkatërrimin e atakut të fanatizmit.

Një tregtar i pasur armenas nga Tibrizi është ulur një ditë në dyqanin e vet kur i ka ardhur njëfarë Azi-Haxhi,³⁷⁾ i cili ka qenë i njohur për kah devotshmëria, dhe e ka lutur të kalojë në islam mdhe ta lëshojë fenë e vet të krishterë.

Kur tregtari e ekspozoi qëllimin e vet të mbetka fuqishëm në fenë e vet, i ka ofruar njeriut dhuratë me shpresë që t'i shmanget. I është përgjigjur se ajo që dëshiron nuk është lëmosha e tij pas kalimi i tij në islam. Në fund refuzimi i vazhdueshëm mi tregtarit e stërkeqi Haxhiun. Befas e nxorri shpatën nga dora e një kundruesi dhe tregtarin për vdekje e goditi në kokë, e pastaj iku.

417

Kur drejtuesi i qytetit dëgjoi për lajmet, shumë u zemërua dhe urdhëroi që dorasi të ndiqet dhe mbyllet. Fajtori u soll para tij. Ai personalisht e mbyti dhe urdhëroi që trupi t'u gjuhet qenëve duke thënë: "Çja, a kjo është mënyra me të cilën përhapet feja e Muhammedit."

Kur ra teri, njerëzit e morrën dhe e dogjën trupin. Në këtë drejtuesi u zemërua për shkak të thyerjes së urdhërit të tij. Ka lejuar që në këtë vend të bëjnë kërdi tre-katër orë ushtarët e tij, e pastaj ka caktuar tatim si gjobë vijuese.

Ai po ashtu e ka ftuar të birin e tregtarit tek ai, e ngushëlloi dhe i është drejtuar me fjalët e bukura e të këndshme."

Madje edhe El-Hakimi i marrë (996-1020), ndjekjet e të cilit kanë shkaktuar që shumë Hebraikë dhe të krishterë ta lënë fenë e vetë dhe të bëhen muslimanë, pastaj u ka lejuar atyre të cilët pa vullnetin e vet janë kthyer në islam që serish të kthehen në fenë vetjake dhe t'i përtërijnë vendet dhe faltoret e veta të rrënuara.³⁸⁾

Të krishterët e lindjes janë mospërfillur nga vëllezërit e tyre të krishterë në Perëndim. Më së shpehti kanë qenë të paarmatosur dhe plotësisht të pambrojtur. Lehtë e ka pasur cilido sundues më i fuqishëm islam që plotësisht t'i çrrënjosi shtetasit e vet të krishterë ose që t'i largojë nga vendi i tyre. Kështu Spanjollët kanë bërë me

Moreskët (muslimanët spanjollë), kurse Anglezët me Hebraikët, prej afër katër shekujsh.

Principi që ka gjetur shumë ithtarë në Gjermani në shekullin XVII(40): vendi i kujt është e atij është edhe feja - kurrë nuk është pranuar prej asnjë sunduesi muslimanë.

Evidente, është fakt se islami si religjion shtetëror nuk ka pushuar ta ketë fuqinë e caktuar në rritjen e numrit të ithtarëve të vet.

Personat bindja religjioze e të cilëve ka mbetur sipërfaqësore kanë qenë të gatshëm për ndikim pa marrë parasysh në dobitë e kësaj bote. Ambiciet dhe dobitë personale kanë ardhur në vendin e shkaqeve më të lavdishme për konversion në islam.

Shën Augustini në diç të ngjashme ka bërë kundërshtimin në shekullin V: shumë hyjnë në kishën e krishterë, vetëm për atë sepse shpresojnë në fitimin e ndonjë fitimi botëror. Në lidhje me këtë ka thënë: "Ka shumë prej atyre që synojnë drejt Jezusit vetëm nga një qëllim, e kjo është që pas kësaj ta kenë ndonjë fiti për veten, si tashmë kërkojnë rrethanat e secilit prej tyre.

418

Dikush nga ata ka një punë të caktuar dhe nxiton te priftëri që prej tyre të merrë fjalën e miratimit. Tjetri nxiton në kishë dhe prej saj kërkon mbrojtje nga shoku i vet që është më i pushtetshëm dhe më i fortë dhe e shtrëngon dhe asfikson. I treti në anën tejtër me atë dëshiron që me shokun e vet ta ndajë autoritetin dhe pushtetin, nga lakmia. Edhe ky edhe ai ka provën e vet. Kisha për çdo ditë mbushet me të tillë."41)

Përveç kësaj, fiseve barbare dhe jociivilizuese, që kanë parë madherinë dhe lavdinë të imperatorisë arabe në kulmin e fuqisë së saj, islami është dukur imponant dhe fuqishëm i ka fascinuar. Rasti i njëjtë është edhe me fenë e krishterë kur iu është prezentuar barbarëve të Evropës-veriore. "Kanë hasur në krishterizëm në imperatori. Ka qenë ky krishterizëm i kultivuar, i ngatëruar, luksoz, krishterizmi i konsituat prej mbretërve, e nganjëherë në pushtet ka pasur edhe supra tyre."42)

Kësaj duket shtuar ndikimin e vazhdueshëm e të shkallërishtëm të kontaktit të përhershëm me jetesën dhe mendimin islam. Kjo e ka udhëhequr një autor nestorian nga shekulli XII që gjatë theksimit të emrit të Pejgamberit dhe halifëve të parë43) t'i shtojë fjalët e respektit dhe të lutet që mëshira e Zotit t'i zbret Omer b. Abdulazizit.44)

Në kohën e re, misionarët e krishterë ankohen në sistemin e arsimimit të përgjithshëm në Egjipt nën sundimin britanez sipas të cilit "fëmijët e krishterë janë të detyruar të ulen e të dëgjojnë Kur'anin dhe dinin (mësimin fetar), me të cilin mësohen kolegët e tyre muslimanë, dhe nuk ka dhomë ku do të ishin të veçuar".45) Ky sistem ka për qëllim mdhënien e ndikimit dominues në kolegët e tyre të krishterë.

Një nga ithtarët më aktiv të muftiut të fundit Muhammed Abduhusë ka qenë Kobt origjinal, student i medicinës, që e ka pranuar islamin nën ndikimin e mësimit fetar që e ka dëgjuar gjatë kohës së mësimit shkollor.46)

Por, theksimi i motiveve të këtilla si shpjegime të vogla për të gjitha rastet e konversionit në njërin sikur edhe në religjionin tjetër nuk mund të na verbojnë nga faktorët tjerë në jetën misionariste të islamit, ndikimi i të cilët ka pasur karakteristikë të qartë fetare. Në krye të këtyre faktorëve është ndikimi i jetesës së devotshme të ithtarëve të islamit.

419

gjeneratës që ka bërë shprehi që në islam të shikojë sikur në burimin e të gjitha llojeve të mbrapshtirave i duket e çuditshme që në kohën e hershme shumë të krishterë që vijnë në kontakt me shoqërinë e gjallë muslimane kanë qenë thellë të impresionuar me virtytet që gjatë kësaj këta i kanë dëftuar.

Nëse këto virtyte kanë ndikuar në udhëtarin dhe të huajin, nuk ka dyshim se kanë pasur njëfarë ndikimi në tërheqjen e pabesimtarëve që ditë për ditë ka ardhur me ta në kontakt.

Ricoldus de Monte Crucis, misionari dominikanas që e ka vizituar Lindjen kah fundi i shekullit XIII i lavdon muslimanët në mesin e të cilëve ka punuar dhe thotë: "Çuditëmi se si veprat që shquhen me përsosshmërinë e këtillë mund të ekzistojnë nën ligjin i cili është i ngjyrosur me këtë mendim pabesimtarësh. Për këtë të përgatitemi që shkurtimisht t'i ekspozojmë ato sjelljet e përsosura muslimane (saracene)...". Kush nuk admirohet nëse mendon mirë, sa kujdes muslimanët (Saracenët) i kushtojnë mësimit, çfarë lojaliteti dëftojnë në namaz, çfarë bujarie kanë ndaj varfanjakut, çfarë respekti i bëjnë emrit të Zotit, pejgamberëve dhe vendeve të shenjta! Sa dinjiteti është në moralin dhe mirësjelljen e tyre me të huajt dhe çfarë është dashuria që i lidh mes veti.47)

William Petit nga Newburghu lavdon në mënyrën e ngjashme, para fundit të shekullit XII, kthjelltësinë e muslimanëve (Saracenëve) si shprehje e mësimit të Pejamberit të tyre dhe si frymëzim i tyre krahas ndjenjës së superioritetit moral ndaj të krishterëve: "Pasi që Muhammedi i ka urrejtur pijanecët dhe grykësit në tërë botën, kjo i ka mësuar me çiltërinë dhe modestinë, kurse e ka zgjuar neveri ndaj ushqimit të mirë, dhe ua ndaloi pirjen e alkoholit, pos në festat e caktuara të vogla.8)

Për këtë shkak i shohi muslimanët (Saracenët), ndonsë në fakt u dorëzohen këndshmërive trupore, ndjekin - siç thuhet - rrugën e atij që i ka udhëhequr.

Është i mjerueshme të thuhet se ata janë më të ndershëm dhe në shkallë më të mirë prej neve të krishterëve. Ata na zënë për të madhe - çfarë turpi dhe papastërtia janë - për shkak të lakmisë tonë dhe

dhënies pijeve!

Kur më në fund, dëgjoi Salahuddini, duke i hulumtuar rrethanat e popullit tonë, kurse vetë ka qenë rrënuesi rrënues i emrit të krishterë, në dhjetë vitet e kaluara, se të krishterët po përdorin disa pjata gjatë 420

ushqimit, tregohet se ka thënë: "Këto enë janë turp për vendin e Shenjtë."

Nga kjo është e qartë që pamja e lavdisë sonë mbi ne muslimanët (Agaronos). Ata lavdohen me pasurinë e vet, sikur që i trimëron që në gjuhën e rrethanave të veta të flasin: "Zoti i ka refuzuar pijanecët, ta ndjekim gjurmën e tyre dhe t'i robërojmë duke e marrë parasysht që nuk i gjejnë vetes shpëtues." 48)

Literatura e të krishterëve është e pasur me nota të larta të nderit musliman. Turqit osmanë, në ditët e veta të para të sundit në Evropë, kanë pranuar shumë shprehje të falënderimit në gojët e të krishterëve, në çka është dëftuar në kaptinat paraprake.

Në kohën e tashme ekzistojnë dy faktorë kryesorë (pos atij që më herët është përmendur dhe që e bënë korrekte) që punojnë në aktivitetin misionarist në botën muslimane.

I pari prej tyre është ngjallja e jetës fetare, kurse daton me reformën vehabite prej fundit të shekullit XVIII.

Ndonëse ky orientimi i ri ka humbur gjatë kohë çdo rëndësi politike jashtë kufinjve të Nexhdit, indikimi i tij i përtëritjes fetare ndihet nëpër Afrikë, Indi dhe Arkipelagun Malezias deri në ditët tona. Ai u ka dhënë shkas shumë lëvizjeve që kanë zënë vendin në mesin e forcave më influencuese në botën islame.

Në faqet paraprake është dëftuar se si shumë misione bashkohore muslimane fuqishëm mlidhen për këtë lëvizje gjrë të përhapur.

Ajo ka nxitur entuziazmin e fuqishëm fetar. Ka frymëzuar jetë të re në ishtitucionet ekzistuese fetare. I ka dhënë hovë studimit teologjik dhe rregullimit të ritualeve fetare. Tërë kjo i ka shërbyer zgjimit dhe ngjalljes së frymës natyrore misionariste të islamit.

Krahas kësaj lëvizjeje reformiste shkon faktori tjetër që është i karakterit krejtësisht tjetër. Do ta cekim vetëm një pikë të ndryshueshmërisë.

Deri sa faktori i parë (lëvizja vekabite, Sh. N.) është në kundërshti mtë plotë me civilizimin evropian, faktori tjetër barabartë bashkëndien me mendimin modern dhe punon në prezentimin e islamit ndaj atij mendimi. Kjo është lëvizja e unitetit islam që synon lidhjen e të gjithë popujve islamë në lidhjen e ndjenjës së përbashkët.

Ndonëse ky faktor sipas rëndësisë nuk ka vlerë si i pari, orientimi i tillë i përsiatjes i jep stimulans të fuqishëm mpunës misionariste.

421

Përpjekjen që e sendërton, në jetën e përditshme, ideale

muslimanë i vëllazërisë së të gjithë besitmarëve, manifestohet edhe në idealet plotësuese fetare. Vetëdija mbi unitetin e paskajshëm dhe jetën e përbashkët rrjedhe nëpër këta popuj dhe i frymëzon zemrat me siguri dhe i bënë të guximshëm që të flasin në prani të jomuslimanëve.

Çfarë ndikimi të mëtejshëm të këtyre dy lëvizjeve do të ketë në jetën misionariste të islamit, ardhmëria do të tregojë.

Vetë aktiviteti i tyre, në kohën e tashme, është dëshmi se islami nuk është i vdekur.

Forca shpirtërore e islamit nuk është, siç është menduar shpesh, proporcionale fuqisë së tij politike.⁴⁹

Përkundër kësaj humbja e fuqisë politike dhe përparimit të kësaj bote i ka shërbyer daljes në plan të parë vlerave më të bukura shpirtërore, të cilat janë motivimet më të fshehta drejt punës misionariste.

Islami mëson me dobitë e fatkeqësive, dhe është larg nga rënia në mirëqenie e kësaj bote, që është parashenjë e shkatërrimit të kësaj feje.

Është me rëndësi se shumë vende muslimane, që më së gjati kanë qenë nën sundimin e krishterë, kanë dëftuar më aktive në përhapjen e fesë.

Muslimanët Indusë malajas tregojnë zjarrin dhe entuziazin e atillë për përhapjen e fesë, që dikush së koti do ta kërkojë në Turqi apo Maroko.

1) Organizatat të themeluara sipas shembullit të shoqatave të krishtera misionariste nuk janë lajmëruar deri në shekullin XX.

Njëfarë pasqyre e kësaj është dhënë Shtojcën III.

2) "Duket se synii i çdo muslimani në përhapjen e islamit, sado që e don këtë botë, deri diku është çështja e instinktit." (Snouck Hurgronje, *Revue de l'Histoire des Religions*, vol. LVII, fq. 66). "Muslimani sipas natyrës është misionar... ai me misionaristet merret me punën vetjake dhe angazhimin me të holla" (Munzinger, fq. 411). Snouck Hurgronje (I), fq. 8, Lüttke (2), fq. 30; Fulius Richter, fq. 152, Merensky, fq. 154.

3) Kur'an, XVI, 126.

4) SHih letrën interesante të drejtuar prej Mmевlay Ismailit, sherifit të Marokos, më 1698 mbretit Xhemsit II, në të cilën e thërret 422

të kalojë në isla (*Revue de l'Histoire des Religions* vol. XLVII, fq. 174, sqq).

5) Anjuman Himayat-i Islam ka mahwari virhalah, fq. 5-13 (Lahare, October, 1889).

6) Duveyrier, fq. 17.

7) Klamroth, 12.

8) Massaja, vol. XI, fq. 124-125.

9) Artin, fq. 119.

- 10) R. du M. M. IX, 1909, fq. 252.
- 11) Ghulam Sorwar, Khazinat al-Asfija, vol. II, fq. 407-408.
- 12) Goldziher, vol. II, fq. 303-304.
- 13) Peçenegët në atë kohë kanë zënë endet që shtrihen ndërmjet Danubit dhe Donës, ku janë shpërngulur nga brigjet e Uralit, kah fundi i shekullit IX (Karamsin, vol. I, fq. 180-181).
- 14) Abu 'Ubayd al-Bakri (vdiq 1094), fq. 467-468.
- 15) Ghula Sarwar, Khazinat al-Asfiya, vol. I, fq. 613.
- 16) D. Crowford, Thinking Black, fq. 202, (London, 1913).
- 17) Doughty vol. II, fq. 39.
- 18) Këtë e ka konfirmuar edhe Morai (Marracce) në shekullin XVII (Alcurani textur... translatns, fq. 9. (Potavi, 1698).
- *) Autori këtu mohon burimin hyjnor të misionit të Muhammedit a.s. Kur'ani ka herë i ka refuzuar mendimet e këtilla: Dhe Ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur'ani) nuk është tjetër pos shpallja që i shpallet vërejtje e përkthyesit).
- 19) Eduard Montet, La propagande chretienne etses adversaires musulmons, fq. 17-18 (Paris, 1890).
- 20) Mankind and Church, fq. 283-284 (London, 1907).
- 21) Qur'an, II, 118-126.
- 22) Qur'an, XLIX, 10.
- 23) W. H. Macnayhten, Principles and Precedents of Moohumudan Law, fq. 312 (Madras, 1882).
- 24) Arabia Deserta, vol. I, fq. 554-555.
- 25) De l'Espirt des Lois, Livre XXV, shop. 2.
- 26) Qur'an, XVI, 90.
- 27) Goldziher, Sa'id b. Hasa d'Alexandrie (Revne des Etutes Juivers, bl. XXX, fq. 17-18 (Paris, 1895).
- 28) Ernest Renan, L'islamisme et La Science, fq. 19 (Paris, 1883).

423

Këtë e kanë konfirmuar shumë vëzhgues, por këtu mjafton të cekem fjalët e peshkopit të njohur të krishterë: "S'ka askush kush vjen në kontakt me muslimanët për herë të parë, e që nuk është goditur me këtë aspekt të fesë së tyre.

Kudo të jetë njëri prej tyre, në rrugë të hapur, në stacionin hekurudhor, në fushë, gjëja më e shtrirë është që ta shoh njeriun që për një çast e lë punën, çfarëdo qoftë ajo, që pa kurrfarë fariseizmi dhe eimponimi publik, që të dhe përuleshë, t'i kryej namazet e vet në kohën e caktuar.

Mbi të gjitha, nuk ka askush kush e ka parë oborrin e xhamisë së madhe në Delhi të premtën e fundit në muajin e agjërimit (ramazanit) të mbushur, mbase, me 15.000 falës; të gjithë janë të thelluar në lutje dhe me lëvizjen e vet dëftojnë respekt dhe përulje të thellë, - e që nuk është impresionuar thellë me këtë pamje, dhe që së shpejti ta vërejë fuqinë në të cilën zë fill sistemi i këtillë.

Ftesa e rregullt e përditshme për namaz, prej ezanit të hershë të mëngjes, para gdhirjes së dritës, ose në kohën e zhurmës dhe nxitimit të kohës punuese, ose sërish kur mbrëmja përfundon, çdo gjë është përmbushur me porosinë e njëjtë." (Dr. G - A. Lefroy, Mankind and the Church, fq. 287-288 (London, 1907).

29) "Njeriu mund ta vërejë dhe t'i admirohet llojit të krenarisë prinerore së cilës muslimani mesatar i përmbahet në fenë e vet". (Bishop Lefruy, Mankind and the Church, fq. 289).

30) A. Kunenen, National Religions and Unviersal Religious, fq. 35, London, 1882).

31) Shembull është persekutimi që ka ndodhur në kohën e Mutevekillit, si reaksion i ortodoksëve kundër të gjitha aspekteve të shtrembërimit të besimit të thjeshtë popullor.

Në Persi dhe në pjesët tjera të Azisë kah fundi i shekullit XIII. është kryer hakmarrja për sjelljet dhunuese dhe ofenduese të të krishterëve në kohën e përparimit dhe fuqisë së tyre nën Mongolët e parë (Maqrizi (2), bl. I. Premiere Partie, fq. 98, 106). Asemmani flet (bl. III, pars. II, p.s.) për shkaqet që kanë sjellë deri te persekutimi i të krishterëve nën sundimin musliman dhe thotë: "Shpesh konfliktet reciproke të vetë të krishterëve dhe deklaratat e kelrikeve dhe udhëheqësve të tyre dhe lartësive të tyre vetjake kanë nxitur shtrëngatë dhune. në këtë dallohen trajtesat ndërmjet mjekëve dhe shkruesëve si pushteti absolut ndaj popullit të vet."

424

Gjatë kohës së luftërave kryqtare të krishterët e Lindjes shpesh kanë ra nën dyshim të manifestimit të simpatisë kundruall sulmeve të bashkëbesimtarëve të tyre nga Perëndimi.

Në Turqinë bashkëkohore (para vitit 1912, vër. për.) lëvizja e Grekëve për çlirim ka nxitur simpati fetare në Evropën e krishterë, që ka ndihmuar që fati i popujve të krishterë të jetë më i rëndë se që ka qenë sikur mos të akuzoheshin për tradhti dhe pakënaqësi ndaj sunduesit të tyre musliman. De Gobino krejt qartë shprehet për këtë pyetje të tolerancës islame: "Nëse do të ndahej doktrina fetare prej domosdoshmërisë politike, në emër të të cilës flitet dhe punohet, ne nuk gjejmë fe më tolerante se islami; madje për afërsisht mund të thuhet, as fenë që është më pak indiferente ndaj bindjes së njeriut. Kjo strukturë teknike është e fuqishme deri në atë masë që, nëse i përjashtojmë rastet në të cilat rendi ekzistues i shtetit ka qenë i rrezikuar, i shtynë qeveritë islame që t'i ndërmarrin të gjitha masat që ta arrijnë unitetin fetar. Toleranca deri në maksimum është parim i rrjedhur nga baza islame. Nuk guxojmë të ndalemi në rastet e dhunës dhe ashpërsisë të bëra me ndonjë rast. Nëse i shikojmë nga afër, nuk do të dyshojmë në njohjen se shkaqet janë pastër politike, ose janë të motivuar me këndjet njerëzore, dhe me temperamentin që dominon me sunduesin ose popujt. Puna fetare nuk ka shkuar drejt masave të

- këtilla pos kur ato kanë qenë pretekst, por ky pretekst nuk hynë në fushëvepri mtë punës fetare". (A. de Gobineau (I), fq. 24-25).
- 32) Për biografinë e tij shih Ibn Kthallikan, vol. II, fq. 111-115.
- 33) Barhebrans (2), fq. 417-418.
- 34) C. d'Dhsson, vol. IV, fq. 281.
- 35) Tavernier (17, fq. 160).
- 36) Viaggio di Josafa B Arbexo nello Persia (Ramusia, vol. II, fq. 111).
- 37) Nëse nën azi mendon haxhi, haxhiu.
- 38) Makin, fq. 260. Ngjashëm, një shekull para, El-Muktediri (908-932) ka dhënë urdhër që sërish të ndërtohen disa kisha në Ramelë në Palestinë që muslimanët i kanë rrënuar gjatë kohës së trazirës, shkaqet e të cilit nuk janë evidentuar në histori (Euty chius, II, 82).
- Ebu Sahihi përmend ndërtimin e sërishëm të numrit të madh të kishave dhe manastireve në Egjipt, që janë rrënuar gjatë kohës së luftës (d.m.th. në kohën e sulmit të Oguzëve dhe Kurdëve më 1164) 425 (fq. 91, 96, 112, 120), apo janë shkatëruar prej fanatikëve (fq. 85-86, 182 dhe Maqrizi, i përcjell në Shtojcë, fq. 327-328), ose janë shkatërruar për shkak të vjetërsisë (fq. 5,87, 103-104).
- 40) E. Charveriat, Histoire de la guerre de Trente Ans, bl. II, 615, 625 (Paris, 1878).
- 41) In Jvannis evangelium Traotatus, XXV, 10.
- 42) C. Merivale, The Conversin of the Narthern Nitins, fq. 102 (London, 1866).
- 43) Mari b. Sulayan, fq. 62 (II, 4, 6, 13). Një maronit i ditur, Jusuf Sim'an al-Sima'ani, nga shekulli XVIII, shpreh tmerrin e vet për lëshimin e tillë pikëpamjes muslimane dhe thotë: "E ka lavduar Muhammedin dhe ndihmtarët e tij. Gjëja që nuk mund të përmendet e që njeriut mos t'i rrenqethet, e kjo është që ta përmend emrin e atij Pejgamberi... duke ia shtuar fjalët "alejhisselam-shpëtimi qoftë mbi të. Këto janë fjalë që nuk zgjojnë habi, sepse janë të rëndomta te muslimanët" (Assemani, bl. III, par I, fq. 585).
- 44) Mari b. Suleyman, fq. 65 (2.16).
- 45) Methods of Mission Wark among Moslems, fq. 62.
- 46) Ibid. fq. 61-64.
- 47) Laurent, fq. 131.
- *) Është e qartë mosnjohja e autorit e mësimit islam mbi ushqimin dhe ndalesën e alkoholit, që ka karakter të përhershëm e jo të përkohshëm.
- "Hani nga ajo që All-llahu ju furnizoi si hallall të mirë dhe, duke qenë se ju All-llahut i besoni, ruanu denimit të Tij! (El-Maide, 88).
- 48) Historia Rerum Anglicarum Willelmi Parvi de Newburgh, ed. Hans Claude Hamilton, vol. II, fq. 158 (London, 1856).

49) Frederich Denisom Maurice ka shprehur një nga mendimet më të përhapura që ka të bëjë me këtë fe kur kur ka thënë: "Është provuar se islami ka mundur të ketë sukses vetëm deri sa ka synuar pushtimin." (The Religions of the World, fq. 28 (Cambridge, 1852).

SHTOJCA I

SHKRESA E EL-HASHIMIUT NË TË CILËN E FTONË EI-KINDIUN TA PRANOJË ISLAMIN

Vijon teksti i shkresës së El-Hashimiut me të cilën e fton El-Kindiun ta pranojë islamin: "Në emër të All-llahut, të 426

Gjithmishirshmit, Mëshirëplotit. Po e filloj këtë shkresë me përsëndetjen e paqës dhe bekimit, ngjashëm udhëheqësit dhe liderit tim të peygamberit Muhammedit, peygamberit të All-llahut, alejhisselam. Sipas njerëzve të besueshëm e të drejtë që na kanë percjell traditën e Peygamberit tonë (mëshire qoftë mbi të) tregojnë se ai ka bërë traditë që, saherë që fillonte bisedën e vet me njerëzit, fillonte me përsëndetjen e paqës dhe bekimit. Nuk ka bërë dalli mndërmjet dhimmiut dhe ummiut, as ndërmjet besimtarit dhe idhujtarit. Fliste: Jam dërguar të jam i njerëzishëm dhe i kujdesshëm ndaj të gjithë njerëzve, e jo të sillem rreptë dhe vrazhdë me ta. i citonte pastaj fjalët e All-llahut: "Kurse ndaj besimtarëve është i butë e mëshirshëm." (Et-Tevbe, 128).

Këtë e kam parë edhe nga halifët tonë, që i kam takuar, e të cilët e kanë ndjekur Peygamberin e vet më vëmendje, bujari, mëshirë dhe mirëbërësi. Në këtë nuk kanë bërë dallimin as nuk i kanë shtrirë disa mmbi disa të tjerë. Kështu edhe unë e ndjek këtë rrugë të shkëlqyeshme dhe e filloj letrën time me përsëndetjen e paqës dhe bekimit që askush të mos më qartojë kush e sheh shkresën time. Ajo që më udhëheq dhe nxitë ndaj teje është apo që udhëheqësi dhe peygamberi im, Muhammedi alajhisselam, ka bërë traditë të thotë: Ta duash të afërmin është devotshmëri dhe besim i singert.

Kështu unë të shkruaj ty nga dëgjueshmëria Peygamberit të Allllahut, alejhisselam, duke ndier detyrën ta shprehi mirënjohjen për shërbimet që na i bënë, sikur edhe dashurinë, prirjen dhe simpatinë që po e tregon ndaj nesh. Shkak është edhe ajo që e vlerëson udhëheqësin dhe kushëririn tim, liderin e besimdrejtëve (Zoti e ndihmoftë), sikur edhe afërsia e tij dhe besimi dhe lavdimi atij.

Ashtu sinqerisht të dëshiroj ty çka i dëshiroj vetes, farefisit dhe familjes sime. Unë do të tregoj (arsyetojë) fenë së cilës i përmbahemi. Kjo është ajo që Zoti na ka lejuar neve dhe të gjitha krijesave të tij dhe për të cilat na ka premtuar shpërblimin e mirë në fund dhe sigurinë prej denimit kur T'i kthehemi.

*** Kështu unë të dëshiroj ty atë çka i dëshiroj vetes. Duke e vërejtur jetën tënde të lartë morale, diturinë e madhe, fisnikërinë e karakterit, bujarinë e prejardhjes, aftësitë e lartësuarra dhe ndikimin

tënd të konsiderueshëm në bashkëbesimtarët tu, ndiej gjithëmëshirë që mos të vazhdojë ë tej në fenë time të tanishme.

427

Thashë: Do t'ia zbuloj atë me çka Zotina ka dhuruar dhe do ta njoftoj me atë në çka ne me fjalët më të buta dhe më të bukura. Gjatë kësaj ndjek urdhërin e Zotit: "Dhe me ithtarët e Librit diskutoni në mënyrën më të mirë." (El-Ankebut, 46).

Ashtu edhe unë dëshiroj me ty të bisedoj vetëm me fjalët e zgjedhura, me fjalim të bukur dhe të butë. Ndoshta do të zgjohesh dhe do t'i kthehesh rrugës së mirëfilltë dhe do të nisësh fjalëve të Allllahut të Lartësuar, që ia ka zbritur peygamberit të fundit dhe udhëheqësit të fëmijëve të Ademit, peygamberit tonë Muhammedit alejhis-selam. Nuk ja pa shpresë në sukses, por unë të dëshiroj edhe ty nga Zoti, që e udhëzon kënd dëshiron, dhe E lusë që unë të bëhem shkak për këtë.

Zoti në Librin e vet të përsosur thotë: "Pa dyshi mfe e pranuar te All-llahu është vetëm islami." (Ali Imran, 19). Duke i konfirmuar fjalët e veta paraprake, All-llahu thotë: "E ai që dëshiron fe tjetër pos islamit, nuk do t'i pranohet, dhe ai në atë botë do të pësojë!" (Ali Imran, 85). All-llahu sërish vendosshmërisht përsërit kur thotë: "O besimtarë, frikësojuni All-llahut ashtu si duhet T'i frikësoheni dhe vdisni vetëm si muslimanë!" (Ali Imran, 102).

Ti e di - Zoti Të shpëtoftë nga padija dhe pabesimi dhe ta haptë zemrën për dritën e fesë - se jam njeri të cilit i kanë kaluar shumë vjet. Jam zhytur në thellësinë e feve tjera, i hulumtova, i studiova librat e tyre, sidomos tuajat të krishtera. (Këtu i numron kaptinat kryesore të Dhjatës së Vjetër e të Re dhe shpjegon se si i ka studiuar sektet e ndryshme të krishtera). Jam takuar me shumë monakë, të njohur me asketizmin e vet dhe dijen e madhe. Kam vizituar shumë kisha dhe manastire dhe kam prezentuar në lutjet e tyre...

Kam parë zellin e tyre të shkëlqyeshëm, krrusjen e tyre, rënien në përlujë, puthjen e faqeve të tyre me tokën dhe goditja e saj me ball. Kam vërejtur sjellje të çiltër në kohën e lutjes së tyre, veçan para të dielës dhe tubiit të premtën dhe festat tjera, kur vigjilojnë tërë natën, duke ndejur këmbë, dhe e falënderuar dhe lavduar Zotin dhe duke lu rrëfyer. Kur e kalojnë tërë ditën duke qëndruar në lutje, vazhdimisht e përsërisin emrin e Atit, të Birit dhe Shpirtit të Shenjtë.

I kam kundruar në ditët e tërheqjes së tyre që i quajnë Java e Shenjtë, kur qëndrojnë të zbathur në rrobat e vrazhda murgare në hi, krahas të qajturit të fortë dhe derdhjes së vazhdueshme të lotëve dhe kukatjes me dënesje të pastra.

428

Kam parë, po ashtu, sakrificat e tyre, se si pastër e mbajnë bukën për ta. Kam dëgjuar lutjet e gjata që i theksojnë me devotshmëri të madhe kur i ngrejnë në alltar në kishën mirë të njohur në Jerusalem,

me kupat e mbushura verë.

Kam shikuar edhe meditimet e monakëve në qelizat e tyre në kohën e gjashtë agjëriemve të tyre, d.m.th. katër të mëdhenj e dy më të vegjël, etj.

Në të gjitha këto rastet kam prezentuar dhe njerëzit me vëmendje i kam kundruar.

I kam vizituar, po shtu, mitropolitët dhe peshkopët e tyre, të njohur me dijen dhe lojalitetin e vet fesë së krishterë dhe përmbajtjes skajore ndaj kësaj bote. Kam diskutuar me ta pa paragjykime duke e kërkuar të Vërtetën, duke i lënë anash të gjitha gjërat kontestuese, prishjet, dijen dhe arbitraritetin në grindje, pezmatimin dhe mendjemadhësinë e prejardhjes.

Ju kam dhënë rast të favorshëm t'i shtrojnë provat e veta, t'i shprehin mendimet e veta, pa pengesa ose frikësime sikur që ndodh në diskutimin e personave të vrazhdë, analfabetë e të marrë të disa bashkëbesimtarë tonë, të atyre që nuk kanë themele nga të cilat veprojnë, ose mendjen në të cilën mbështeten ose ndjenjës fetare dhe moralit të mirë, që do t'i pengojë nga panjerëzia. Të folurit e tij është frikësimi, polemizimi i fryrë, dhe ata nuk posedojnë dituri apo argumente, pos shfrytëzimit të parimit të pushtetit.

Kur kam diskutuar me ata (me bashkëfolësit e mi) kam kërkuar që lirisht të flasim sipas rezonimit të vet, besimit dhe mmotivimit të bindshëm vetjak. Kanë folur haptazi po kurrfarë lloj mashtrimi.

Ndjenjat e tyre të brendshme më janë dëftuar të lakuriqësuar aq qartë sikur edhe pamja e jashtme.

Po të shkruaj me aq kujdes - Zoti ta tregoftë rrugën më të mirë! - pas soditjes së gjatë, hulumtimit dhe kërkimit të themeltë. Ashtu që askush nuk mund të më pandehë se jam i paditur në gjërat për të cilat po shkruaj, dhe çdokush le të dijë, në duart e të cilit mund të vijë kjo shkresë, se kam dije të plotë për fenë e krishterë.

Unë të thërras tash - Zoti të dhashtë bekimmin - me gjithë dijen time për fenë tënde në të cilën, dhe me dashurinë gjatë ekzistuesë (ndaj teje), ta keshë fenë të cilën Zoti mua ma ka zgjedhur, kurse edhe unë vetes, duke të ta siguruar hyrjen në parajsë dhe shpëtimin nga shëtërra.

429

Kjo d.m.th. se do ta adhuron vetëm Një të Vetmin Zot, të Amshueshëm, që nuk ka lindur as është i lindur, që nuk ka shkak as djal, as që ka gjasues me Të. Ky është atribut me të cilin Zoti Vetën e VEt e ka përcaktuar, dhe asnjë nga krijesat e Tij nuk e njeh më mirë nga Vetë Ai.

Unë të thërras ta adhurosh këtë Zotin e Vetëm, që është me atribut të tillë. Në shkresën time nuk ka mshtuar asgjë me çka e ka përshkruar Vetën e Vet - i lartësuar qoftë emri i Tij nga ajo çka I përkruajnë!

Kjo është feja e babait tënd dhe tonit Ibrahimit (Abrahamit) -

bekimi i Zotit qoftë mbi të -, kurse ai ka qenë "hanif dhe musliman".
Të thërras - Zoti të ruajt - të dëshmosh dhe ta pranosh
pejgamberinë e udhëheqësit ti mdhe udhëheqësit të bijëve të Ademit
(Adamit), të zgjedhurit të Krijuesit të të gjitha botave dhe vulës së
pejgamberëve - Muhammedit...

Zoti e ka dërguar si lajm të gëzueshëm dhe vërejtji gjithë botës "...
me udhëzimin dhe besimin e vërtetë që ta ngrejë mbi të gjitha fetë,
qoftë mos qoftë sipas vullnetit të idhujtarëve." (Et-Tewbe, 33).

Ai i ka ftuar të gjithë njerësit, në lindje dhe në perëndim, në tokë
dhe në det, në male e në fusha, me mëshirë, dhembisuri, me fjalë të
bukura, me sjellje të mirë dhe butësi.

Tërë kjo botë iu përgjigj thirrjes së tij, i ka dëshmuar se është
pejgamber i Zotit, Krijuesit të botës, të dërguar atyre që e dëshirojnë
vërejtjen.

Të gjithë e kanë dhënë miratimin kur e mësuan mirëfillësinë dhe
sinqeritetin e fjalëve të tij, saktësinë e qëllimit të tij, argumente të
qarta dhe prova të thjeshta me të cilat ka ardhur. Ka të bëjë me Librin
që i është dërguar prej Zotit, gjasuese me të cilën nuk mund të bëjnë
njerëzit as xhinnët.

"Thuaj"... (El-Isra, 88).

Kjo është provë e mjaftueshme e misionit të tij. Ai ashtu i ka ftuar
njerëzit në adhurimin e Një Zoti, të Vetmin, Vetëqëndruesin. Ata kanë
hyrë në fenë e tij dhe kanë pranuar autoritetin e tij pa detyrim dhe
jodisponim. Me përunjtësi e evokojnë të ndriçuar me dritën e
udhëzimit të tij. Krahas emrit të tij bëhen ngadhënjimtare mbi atë që e
kanë mohuar misionin e vet hyjnor dhe e kanë mohuar porosinë e tij
dhe me përbuzje kanë refuzuar porosinë e tij. Zoti i ka forcuar në
vendet dhe ua ka ulur qafat të shumë popujve në mesin e njerëzve, pos
atyre që kanë folur, besuar dhe dëshmuar fenë sikur edhe ata.

430

Me këtë kanë ruajtur gjokun, pasurinë dhe nderin e vet. Kanë qenë
të ruajtur e të përjashtuar nga nënçmimi i pagesës së xhizjes. (Këtu
numron disa urdhëra islam siç janë: pesë namazet ditore, agjërimi në
ramazan, xhahadi, shpjegon ringjalljen e të vdekurve, Dita e gjykimit
dhe i përshkruan bukuritë e parajsës dhe mundimet e skëterrës).
Unë të përkujtoj: nëse beson në këtë fe dhe pranon çka të citohet
nga Libri i Shpallur i Zotit, do të kesh dobi nga vërejtja ime dhe shkrii
yt ty. Por nëse refuzon dhe vazhdon në mosbesimin, mashtrimin dhe
kryeneqësinë tënde ndaj të Vërtetës, unë do ta marrë shpërblimin tim,
sepse kam vepruar si më është urdhëruar. Kurse e Vërteta do të
gjykojë ty. (Këtu i numron detyrat e ndryshme fetare dhe veçoritë e
muslimanëve dhe mbaron me fjalët): Në shkresën time t'i kam cituar
fjalet e All-Ilahut të Lartësuar, e këto janë fjalët e të Vërtetës,
premtimet që nuk zhduken. Këto janë fjalët në të cilat nuk ka
gënjeshtër.

Lere mosbesiin dhe mashtrimin, që Zoti nuk i miraton dhe të cilat kërkojnë denim. Kjo ka të bëjë me paqartësinë e fjalëve, që të janë të njohura, por që nuk i mohon, siç janë I biri, I Ati dhe Shpirti i Shenjtë, dhe lutju kryqit, që dëmton e nuk sjell dobi.

Unë dëshiroj të të kthej nga ajo, sepse për këtë shkak nënçmohet dija jote dhe fisnikëria e shpirtit.

Gjej se All-llahu i Lartësuar thotë: "All-llahu nuk fal...". (En-Nisa, 48).

Më tej thotë: "Pabesimbarë janë ata që flasin: ...". (El-Maide, 72-75).

Shmangin bërjes së gabimeve dhe subjektivitetit të rreptë, të gjatë e të zyrtë, agjërimit të pakëndshëm e të lodhshëm, që është mundim i përhershëm mpër ty dhe që nuk të sjell dobi, por ta rraskapitë trupin dhe ta mundon shpirtin.

Provoje këtë dhe lëre atë fe, rrugën e drejtë e të lehtë, fenë e vërtetë, ligjin e mirë dhe rrugën e drejtë e të lehtë, fenë e vërtetë, ligjin e mirë dhe rrugën e gjërë, që All-llahu ua zgjodhi të dashurve të vet në mesin e njerëzve dhe i ftoi në të njerëzit e të gjitha feve.

Me këtë Ai atyre ua ka treguar mirësinë dhe simpatinë e Vet, duke i udhëhequr rrugës së drejtë me Udhëzimin e Vet, që me këtë t'ua plotësojë begatitë e Veta.

Të kam këshilluar dhe ndaj teje kam treguar miqësi merituese dhe dashuri të singertë, sepse të dëshiroj pranë vetes. Të jemi të një
431

mendimi dhe të një feje. Kam dëgjuar se Krijuesi i mthotë në Libri e Vet të përsosur: "Ata që nuk besojnë në mesin e ithtarëve të Librit dhe idhujtarët, do të jenë, sigurisht, në zjarrin e xhehennemit, në të amshueshëm do të mbesin, ata janë krijesat më të këqia. ...". (El-Bejjine, 6-8).

All-llahu në vendin tjetër thotë: "Ju jeni populli më i irë...". (Ali Imran, 110).

Jam dhimbsur ndaj teje të jesh në mesin e banorëve të skëterrës, që janë krijesat më të këqia.

Dëshirave që, me bekimin e Zotit, të bëhesh një prej besimtarëve të singertë, me të cilët All-llahu është i kënaqur, kurse edhe ato me Të, e ato janë krijesat më të mira.

Unë shpresoj se do t'i bashkangjitesh fesë më të mirë që u është dhënë njerëzve.

Por, nëse refuzon dhe vazhdon në kryeneqësinë, konfliktësinë dhe padijen tënde, dhe në pabesimin dhe amshtrimin tënd, dhe nëse i refuzon fjalët e mia dhe e refuzon këshillën e singert, më të propozoj (e të mos shikoj në ndonjë shpërblim dhe mirënjohje): më shkruaj për fenë tënde ç'të duash, çdo gjë që e mbanë për të vërtetë, dhe për çka ke provë të fortë, pa kurrfarë frike ose droje, dhe pa zvogëlimin e provave tua ose pa fshehjen e besit tënd.

Qëllimin e ka që me duri m't'i dëgjojë argumentet tuaja dhe të lejojë dhe pranojë të gjitha ato që në të është bindëse. I nënshtrohem, me dëshirë, pa refuzim, hedhjes apo frikës. Kjo është për atë që të mund t'i krahasojë shkaqet tua dhe të miat.

Je i lirë ta theksosh shkakun tënd, pa arsyetim që frika po të pengon t'i komunikosh arguemntet, ose që gjuha do të frenohet.

Lirisht mund t'i shtrosh dëshmitë tua.

Tash je i lirë t'i shtrosh argumentet tua dhe nuk mund të më akuzosh për mendjemadhësi, padrejtësi apo subjektivitet, që nuk më takon.

Silli të gjitha provat që dëshiron dhe fol ç'të duash, je i lirë në shtruarjen e çdo gjëje që e konfirmon provën tënde.

Je i sigurtë dhe i lirë të thuash ç'të dëshiron, dhe caktoje gjyqtarin, i cili objektivisht do të gjykojë në mes nesh, që do të anojë vetëm kah e vërteta dhe do të jesh i lirë nga fuqia e instinktit.

Ky arbitër do të mund të ishte Arsyjeja, me çka Zoti na bënë përgjegjës për shpërbllimin dhe denimin personal. Kam qenë i drejtë 432

ndaj teje dhe ta kam dhënë sigurinë e plotë. Jam i gatshëm ta pranojë gjykimin e Arsyjes, qoftë ai për mua ose kundër meje, sepse: "Nuk ka dhunë në fe" (El-Beqare, 256). Unë vetëm të thërras që vullnetarisht ta pranosh fenë tonë, sipas dëshirës vetjake. Të kam dëftuar në pashpresën e besimit tënd të tashëm. Paqa, mëshira dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ty".

Mund të ketë vetëm pak dyshim që ky arguemnt ka arritur deri te ne në gjendjen e cunguar dhe që në duart e përkrahësve të krishterë ka pësuar shtrembërim.

Asgjë më tërësisht nuk e përgënjeshton veçantinë e doktrinës së krishterë si mësimi mbi treshin e shenjtë. Aluzionet e atyre sulmeve gjenden në përgjigjen e El-Kindiut. Në këtë me siguri dëfton heqja e pasuseve të tilla, që do të mund t'i ofendonin lexuesit e krishterë.¹⁾

1) Në këtë kuptim botuesi spanjoll i shkresave polemizuese të këmblyera ndërmjet Alvarit dhe "Mekatarit" (i krishteri që ka kaluar në hekrazë) shtonë vërejtjen vijuese pas shkresës (mesazhit) së pesëmbëdhjetë: "Katëmbëdhjetë rreshta të kësaj faeje është fshirë ashtu që është e pamundur të lexohen fjalët në të. Pronari i librit e ka shkoqur faqen vijuese që mos të lexohen të pavërtetat e Mekaturit." (Migne, Patr. Lat. bl. CXXI, fq. 483).

SHTOJCA II

LITERATURA POLEMIZUESE NDËRMJET MUSLIMANËVE DHE ITHTARËVE TË FEVE TJERA

Ndonëse islami nuk ka pasur sistem të organizuar të propagandës, shoqata fetare ose përfaqësi të ngjashme të punës misionariste, nuk ka pasur kurrfarë lëshimi në prezentiin e arsyeshëm m'të fesë

pabesimtarëve, veçan të krishterëve dhe Hebraikëve.

Nuk është qëllimi që këtu të jepet pasqyrë e gjërë e kësaj, por është vetëm me rëndësi që të tërhiqet vëmendja në ekzistimin e tij.

Është e lejueshme ta evitojmë gabimin e zgjeruar që konversioni masovik është atribut dominues në përhapjen e islamit dhe e që bindja individuale nuk ka marrë pjesë në programet propaganduese të misionaritetit musliman.

Në vetë Kur'anin gjenden fillet e polemikës islame me pabesimtarët.

433

Duke filluar prej shekullit IX e.r. fillon seria e gjatë e mesazheve sistematike në mbrojtjen e besimit islam. Ky aktivitet është vazhduar deri në ditët tona.

Numri i punimeve që janë shkruar kundër besimit të krishterë është shumë më i madh nga ai që të krishterët i kanë shkruar në përgënjeshttrimin e islamit.

Disa nga mendimtarët më të njohur islamë i kanë përdorur pendat e veta në shkruarjen e këtyre trajtesave. Shembull janë Ebu Jusuf R. Ishoq el-Kindiu (813-873), El-Mes'udi (vdiq 958), Ibu Hazmi (994 - 1064). El-Gazali (vdiq 1111) e të tejrë.

Është interesant po ashtu të vërehet se disa renegatë kanë shkruar trajtesa për ndërrimin e vet të fesë kurse në mbrojtje të mësimin islam, për shembull Ibn Xhazla në shekullin XI, Jusuf el-Lubuani dhe shejh Zijade b. Jahja në shekullin XIII, dhe Abdullah b. Abdullah në shekullin XV, Dervish Aliu në shekullin XVI, Ahmed b. Abdullahu, Anglez i lindur në Kembrixh, në shekullin XVII etj.

Të gjithë këta të fundit kanë qenë të krishterë par akalimit në islam. Sa u përket renegatëve hebraikë, numri i të cilëve është më i vogël, edhe prej tyre ka pasur në mesin e atyre që kanë shkruar në mbrojtje të islamit.

Në Indi, pos shumë librave muslimane të shkruara kundër fesë së krishterë, ka mjaft libra polemizues kundër hinduizmit.

Nuk kam të dhëna për atë sa kanë qenë muslimanët aktiv në këtë aspekt në vendet tjera pabesimtare.

Lexuesi do të gjejë mjaft të dhëna për literaturën polemizuese uslimane në veprat vijuese:

- Maritz Steinchneider, Polemische and apologetische Litteratur iu arabischer Sprache, zwischen Muslimen, Christen und Juden (Leipzig, 1877).
- Ignaz Goldziher, Uber uhammedanische Polemik gegen Ahl alkitab. (Z.D.M.G., vol. 32, fq. 341, ff. 1878).
- Martin Schreiner, Zur Geschichte der Polemik zwischen Juden und Muhammedanern (Z.D.M.G., vol. 42, fq. 591, ff. 1888).
- W.A. Shedd, Islam and Oriental Churches, fq. 252-253.
- Carl Guterbock, Der Islam in Lichte der byzantinischen

Polemik, Berlin, 1912).

SHTOJCA III

434

SHOQËRITË MISIONARISTE MUSLIMANE

Formimi i shoqërisë për propagandën e organizuar dhe sistematike është i datës së re në historinë misionariste të islamit, që në raport në historinë misionariste të islamit, që në raport në historinë e misioneve të krishtera po ashtu është e datës së re.

Këto shoqëri misionariste islame duket se janë formuar sipas shembullit të organizatave të ngjashme në botën e krishterë. Vetëvetin nuk e shprehin veçantinë e frymës misionariste në islam.

Në botën perëndimore kjo mund të vërehet krejtësisht pak. Duket se nuk ka pasur kurrfarë tentimi për formimin e shoqërisë së këtillë para gjysmës së dytë të shekullit XIX. Përpjekjet e para janë kurorëzuar me pak sukses.

Kur H. M. Stanley ka shkruar në shtypin anglez në vitin 1875, duke nxituar në dërgimin e misionit të krishterë mbretit të Ugandës Mutesit, ftesa e tij ka hasur në vëmendjen gjërë të përhapur për formimin e shoqatës misionariste në Carigrad për shkak të propagandës së islamit në atë vend, por misionarët muslimanë kurrë nuk janë dërguar në Ugandë. Lufta ruso-turke në vitin 1878 e ka tërhequr vëmendjen e Turqëve nga çfarëdo ndërmarrje.1)

Mosukses të ngjashëm që të konstatohet puna e organizuar misionariste është treguar kur qeveria anglo-egjiptiane e Sudanit i përcaktoi zonat e ndikimit të shoqërive të ndryshme misionariste të krishtera në krahinat e popullësisë pagane. Disa usllimanë nga Kairo kanë kërkuar që të caktohet një pjesë e vendit për ithtarët e islamit. Qeveria iu përgjeggj se tërë çka mund ta bëjë është ajo që të dërgohen misionarët muslimanë dhe atyre do t'u ofrohen lehtësitë e njëjta sikur që u janë dhënë edhe misionarëve të krishterë, por organizimi i nevojshëm ka munguar dhe çështje është mospërfillur.2) Shejh Reshid Rida, pronari i revistës "El-Menar" ka themeluar në vitin 1910 shoqërinë misionariste në Kairo. Qëllimin e ka pasur t'i vëjë themelet fakultetit (me titullin Dar ad-da'wa va-l-irshad) që t'i ushtrojë misionarët dhe polemistët për islamin. Qenë prioritetëisht të dërguar në vendet pagane dhe të krishtera, por edhe në vendet muslimane në të cilat bëhen përpjekjet që muslimanët ta lëshojnë besimin e vet.3)

Në Indi ka qenë shtrirja më e madhe e shoqërive të këtilla. Njëra prej më të organizuarave sigurisht është Anxhuman Himajet-i-islama në Lahore. Puna propaganduese ka përbërë vetëm pjesën më të

435

vogël të fushës së gjërë të aktivitetit të tij dhe në çdo rast nuk do të mund të përshkruhet si shoqëri e pastër dhe e thjeshtë misionariste. Qëllimi themelor për ç'arsye u themelua shoqëria Anxhuman Hami Islam në Axhmir ka qenë që t'i përgjigjet në kundërshtimet

islait që ia kanë drejtuar anëtarët e Arja Saaxhit. Mirëpo, ky qëllim ka inkuadruar edhe çështjen e thirrjes në islam dhe furnizimi i muslimanëve të ri me ushqim dhe rroba.4)

Shoqëria Anxhuman Wa'z-i-Islam - Shoqëria për predikimin e islamit, sikur që këtë edhe emri ia tregon, i ka koncentruar përpjekjet e veta përthirrjen në islam.

Kur Mavlavi Baka Husein-kani ka qenë sekretar i kësaj shoqërie, janë publikuar regjistrat me emrat e atyre që kjo shoqëri i ka përfituar për islam.

Ngjashëm ka punuar edhe Anxhuman-i-Islam dhe Anxhuman Tablig-i Islam (Shoqëria për proklamimin e islamit) (që ka synuar konversionin e hindusëve që nuk kanë ardhur në kontakt me islamin). Është formuar në Hajderabad (Dekan). Duket se të dy këto shoqëritë gjatë nuk kanë ekzistuar.5)

Në mesin e shoqërive që janë formuar në shekullin XX është Medreseja Ilahiyat (Shkolla fetare) në Kaunpur (Cawnpore) për aftësimin e misionarëve dhe botimin e trajtesave në mbrojtjen e islamit dhe refuzimit të sulmit mbi të.

Anxhuman Isa'at wa Ta'lim-i-islam (Shoqata për përhapjen dhe mësimin e islamit) në Batal në Penxhab është themeluar me qëllimet e ngjashme.

Por më e madhja prej të gjitha këtyre organizatave është Anxhuman Hidayet al-islam m(Shoqata për përudhje në islam) në Delhi, e cila i tubon njëzet e katër shoqata tjera në pjesët e ndryshme të Indisë.

Ky anxhuman (shoqatë) i dërgon misionarët të ftojnë në mësimin islam dhe zhvillojnë polemika me jomuslimanët. E botojnë literaturën polemizuese, veçan në përgjigjen në sulmet që i kanë drejtuar anëtarët e Arja Samaxhit.

1) Richter, fq. 164-165.

2) Artin, fq. 35.

436

3) The Moslam World, vol. I, fq. 441; R.de M.M., vol. XV, fq. 374, vol. XVIII, fq. 216, 224.

4) Rajaputana Herald, Prill 17, 1889.

5) Mohammedan Warld of Today, fq. 183.

6) Emrat e këtyre shoqatave gjenden në faqen 19. The Annual Report për vitin 1328 Hixhrij.

437